
بسم الله الرحمن الرحیم

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i njëzetedytë)

Nga ajeti 31 i sures "Ahzab" e deri ajeti 27 i sures "Ja Sin"

TIRANË, 2021

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i njëzetedytë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***Edmond ABAZI & H. Selim STAFA*** *(Allahu e mëshiroftë!)*

E redaktoi: ***Jerida KULLA***

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Ajetet 31 - 34

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿وَمَنْ يَقْنُتْ مِنْكُنَّ لِلَّهِ وَرَسُولِهِ وَتَعْمَلْ صَالِحًا نُؤْتِهَا أَجْرَهَا مَرَّتَيْنِ وَأَعْتَدْنَا لَهَا رِزْقًا كَرِيمًا٣١ يَا نِسَاءَ النَّبِيِّ لَسْتُنَّ كَأَحَدٍ مِنَ النِّسَاءِ إِنِ اتَّقَيْتُنَّ فَلَا تَخْضَعْنَ بِالْقَوْلِ فَيَطْمَعَ الَّذِى فِى قَلْبِهِ مَرَضٌ وَقُلْنَ قَوْلًا مَعْرُوفًا٣٢ وَقَرْنَ فِى بُيُوتِكُنَّ وَلَا تَبَرَّجْنَ تَبَرُّجَ الْجَاهِلِيَّةِ الْأُولَى وَأَقِمْنَ الصَّلَاةَ وَآتِينَ الزَّكَاةَ وَأَطِعْنَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ إِنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيُذْهِبَ عَنْكُمُ الرِّجْسَ أَهْلَ الْبَيْتِ وَيُطَهِّرَكُمْ تَطْهِيرًا٣٣ وَاذْكُرْنَ مَا يُتْلَى فِى بُيُوتِكُنَّ مِنْ آيَاتِ اللَّهِ وَالْحِكْمَةِ إِنَّ اللَّهَ كَانَ لَطِيفًا خَبِيرًا٣٤﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Ndërsa atyre prej jush që binden ndaj All'llahut e të Dërguarit të Tij dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'u japim shpërblim të dyfishtë e u kemi përgatitur begati të mëdha."

"O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni All'llahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!"

"Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes! Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni All'llahut e të Dërguarit të Tij! O Familje e Profetit! Në të vërtetë, All'llahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."

"Mbani në mendje ato që lexohen në shtëpitë tuaja prej Shpalljes së All'llahut dhe Urtësisë! Me të vërtetë, All'llahu është Bamirës i pakufishëm dhe di çdo gjë."

Komentimi

Kështu duhet të jenë gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"Ndërsa atyre prej jush që binden ndaj All'llahut e të Dërguarit të Tij dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'u japim shpërblim të dyfishtë e u kemi përgatitur begati të mëdha."**.

Fjala *"jeknutu"* rrjedh nga fjala *"el kunutu"*. Kuptimi i saj është: Bindje e shoqëruar me përulje dhe edukatë.[1]

1 "El Mufredatu", lënda *"Kunutun"*.

Me këtë mënyrë shprehjeje, Kur'ani dëshiron t'i urdhërojë ato që t'i binden All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, e bashkë me të, të kujdesen plotësisht edhe për edukatën.

Këtu përballemi edhe një herë tjetër me këtë çështje: Nuk mjafton thjesht dhe vetëm pohimi i besimit dhe i bindjes, përkundrazi duhet të preken gjurmët e tij nëpërmjet punëve të mira.

Fjala *"err rrizkul kerim"* ka një kuptim të gjerë. Përfshin të gjitha dhuratat materiale dhe shpirtërore. Komentimi i tij me Xhennetin bëhet sepse Xhenneti i bashkon të gjitha këto dhurata.

Në ajetet e kaluara bëhej fjalë për pozicionin e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe përgjegjësitë e tyre. Kjo temë trajtohet edhe në këto ajete, gjatë bisedës, i urdhëron gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me shtatë urdhëresa të rëndësishme.

All'llahu i Madhëruar thotë: **"O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera."**.

Përkatësia juaj ndaj Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nga njëra anë, prania juaj në shtëpinë e Shpalljes, dëgjimi i ajeteve të Kur'anit dhe i mësimeve islame, nga ana tjetër, ju ka dhënë juve një vend të veçantë, saqë ju vlerësoheni të jeni shembull për të gjitha gratë, si në rrugën e devotshmërisë, ashtu edhe të gjynahut. Në bazë të kësaj, ju duhet ta kuptoni pozicionin tuaj dhe të mos i harroni përgjegjësitë që keni marrë mbi supe. Dijeni mirë se, nëse ju ruheni, ju keni tek All'llahu një pozitë të falënderuar.

Pas kësaj paraqitjeje, që i përgatit ato që të pranojnë dhe t'i mbajnë përgjegjësitë, All'llahu jep urdhrin e parë, në aspektin e virtytit. Për të qartësuar çështjet e tjera, përqendrohet mbi një çështje: **"Mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore."**.

Flisni në mënyrë të matur dhe normale, jo si gratë e lëvizshme, biseda e të cilave shoqërohet me shprehje nxitëse të pasionit dhe zë ledhatues. Jo vetëm kaq, por shoqërohet edhe me lëvizje eksituese, që nxisin epshet dhe çojnë drejt shthurjes dhe bërjes së gjynahut.

Sifjalia: **"ai që ka zemër epshore"**, është një shprehje shumë elokuente dhe tregon një të vërtete, se instinkti seksual, kur është në kufijtë e temperamentit dhe të legjitimitetit, është syri i paqes. Kur e kalon këtë kufi, të kaplon një sëmundje që arrin deri në çmenduri, që vlerësohet me emrin çmenduria seksuale. Sot shkencëtarët e kanë analizuar dhe e kanë ndarë në shumë lloje këtë sëmundje psikologjike, që e ka rrënjën nga mizoria e këtij instinkti dhe nga nënshtrimi ndaj të këqijave seksuale dhe mjediseve të degjeneruara e të ndotura shoqërore.

Në fund të ajetit, bëhet i qartë urdhri i dytë. All'llahu thotë se, me të tjerët, duhet të flisni në mënyrë të përshtatshme, që të kënaqni All'llahun dhe të Dërguarin e Tij: **"Flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!"**.

Fjalia: **"Mos flisni me përkëdheli..."**, tregon mënyrën e të folurit, kurse fjalia: **"Flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!"**, tregon përmbajtjen e bisedës.

Fraza *"el kaulul ma'ruf"* ka kuptim të gjerë, që përfshin gjithçka që është thënë, duke shtuar se ajo ndalon çdo fjalë të kotë,

që nuk ka dobi, që nuk ka asnjë qëllim nga pas. Po kështu, e ndalon gjynahun e çdo gjë që e kundërshton të drejtën.

Fjalia e fundit mund të jetë sqarim i fjalisë së parë, që dikush të mos imagjinojë se trajtimi i grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duhet të jetë ndëshkuese dhe shumë larg edukatës islame, madje ato duhet të trajtohen me atë kulturë që u shkon për shtat atyre. Në të njëjtën kohë, të jetë e boshatisur nga çdo cilësi eksituese.

Pastaj del urdhri i tretë në kapitullin e ruajtjes së virtytit: **"Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes!"**.

Fjala *"karne"* rrjedh nga fjala *"el uikaru"*, që do të thotë: peshë, rëndesë. Ajo është metaforë ndaj urdhrit për të qëndruar në shtëpi. Disa kanë supozuar se kjo fjalë mund të rrjedhë nga fjala *"el kararu"*. Ajo nuk ndryshon shumë nga kuptimi i parë.[1]

Fjala *"et teberruxhu"*, do të thotë: shfaqje para njerëzve. Ajo rrjedh nga fjala *"burxhun"*. Kuptimi i saj është: duket hapur dhe u shfaqet shikimeve të të gjithëve.

1 Fjala *"akrarne"* është folje në mënyrën urdhërore. Ajo rrjedh nga fjala *"el kararu"*. Për lehtësim është hequr shkronja e parë, *"ra"* dhe është transferuar zanorja *"e"* e shkronjës *"ra"* te shkronja *"kaf"*. Me praninë e saj, nuk kemi nevojë për *"hemzen"*. Bëhet *"karne"*. Vëreni me kujdes.

Çfarë kuptohet me fjalën "injorancë"?

Nga sa thamë deri tani, fjala *"injorancë"* tregon injorancën që ishte në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në atë kohë, gratë nuk kanë qenë të mbuluara, siç thuhet edhe në histori. Mbi shpinë hidhnin mbulesën, duke treguar fytin, vathët dhe një pjesë të gjoksit të tyre. Kur'ani Famëlartë u ndaloi bashkëshorteve të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* sjellje të tilla.

Nuk ka dyshim se ky ligj është i përgjithshëm dhe përqendrimi te gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është në kuptimin e miratimit, njëjtë sikur t'i themi një dijetari: "Ti je dijetar, prandaj mos gënje.".

Por kjo nuk do të thotë se gënjeshtra i lejohet dhe pëlqehet për të tjerët, përkundrazi ajo nënkupton se dijetari duhet ta ketë frikë këtë punë.

Kjo shprehje bën të qartë se një injorancë tjetër do të vijë, njësoj si injoranca e hershme, e cila është përmendur në Kur'an. Ne sot i shohim gjurmët e kësaj profecie kur'anore në botën e qytetëruar. Komentuesit e vjetër nuk e kanë parashikuar dhe nuk e kanë ditur këtë çështje, prandaj kanë derdhur mund për komentimin e kësaj fjalie. Disa prej tyre e kanë konsideruar injorancën e hershme si hapësira kohore mes Ademit dhe Nuhut, ose hapësira kohore mes Daudit dhe Sulejmanit, ku gratë, në atë kohë, dilnin me veshje të tilla, saqë u dukej qartë trupi. Injorancën arabe, para Islamit, e kanë komentuar si injoranca e dytë.

Siç thamë, nuk kemi nevojë për këto fjalë, madje nga sa duket, injoranca e hershme është injoranca para Islamit. Për të është folur në disa vende të Kur'anit: në ajetin 143 të sures "Ali Imran", në ajetin 50 të sures "El Maide" dhe në ajetin 26 të sures "El Fet'h". Injoranca e dytë është injoranca që do të vijë më pas, injoranca e kohës sonë.

Do ta mbyllim fjalën rreth kësaj teme me diskutimin e shënimeve.

Në fund, rrjedh urdhri i katërt, i pestë dhe i gjashtë: **"Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni All'llahut e të Dërguarit të Tij!"**.

Nëse ajeti përqendrohet më shumë te namazi dhe zekati, në mesin e adhurimeve të tjera, kjo bëhet sepse namazi është një nga mënyrat më të rëndësishme të lidhjes dhe afrimit me All'llahun. Zekati konsiderohet një lidhje e fortë me krijesat e All'llahut dhe, në të njëjtën kohë, është një adhurim madhështor.

Fjalia: **"Bindjuni All'llahut e të Dërguarit të Tij!"**, është ligj universal, që përfshin të gjitha programet hyjnore.

Këto tri urdhëresa tregojnë se ligjet, rregullat e përmendura nuk janë të veçuara për gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përkundrazi ato janë për të gjithë njerëzit, edhe pse është përqendruar tek ato.

All'llahu i Madhëruar shton në fundin e ajetit: **"All'llahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**.

Fjala *"innema"*, tregon zakonisht kufizimin, është një argument se ky virtyt është vetëm për familjen e shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Fjala *"juridu"* - *"dëshiron"*, është tregues i vullnetit kreativ të All'llahut. Këtu tregohet për *el iradetu tekuinijehtu* (vullneti i All'llahut për të krijuar) dhe nuk tregon për vullnetin legjislativ *(el iradetu teshriijetu)*. Thënë ndryshe, domosdoshmëria e pastrimit të shpirtrave, nuk kufizohet vetëm me familjen e shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi të gjithë njerëzit duhet të pastrohen nga çdo faj dhe gjynah.

Mund të thuhet: Vullneti kreativ e bën të domosdoshëm imponimin. Përgjigjja e kësaj saj bëhet e qartë nga shikimi i diskutimeve, të cilat i kemi përmendur në çështjen e pagabueshmërisë e të mbrojtjes së Profetëve dhe Imamëve nga gjynahet. Për ata, të mbrojturit nga gjynahu *(el ma'sumijne)*, ka një pritshmëri përfitimi, nëpërmjet punëve të tyre. Ata kanë përparësi të dhuruar nga All'llahu i Madhëruar, që të jenë shembull për njerëzit.

Thënë ndryshe: Njerëzit e mbrojtur nga gjynahu, janë rezultat i ruajtjes hyjnore dhe punëve të tyre të pastra. Ata nuk i afrohen gjynahut, edhe pse i kanë mundësitë dhe zgjedhjen në kryerjen e tyre. Është njësoj sikur ne shohim një njeri me logjikë, që të marrë prush zjarri dhe ta fusë në gojën e tij, edhe pse ai as nuk është i detyruar dhe as i shtrënguar të bëjë këtë punë, pasi kjo situatë buron nga thellësia e qenies së njeriut, si rezultat i

informacioneve, i diturive, i parimeve të natyrshmërisë, pa pasur as detyrim e as dhunë në këtë çështje.

Fjala *"err rrixhsu"* do të thotë: *"gjë e shëmtuar e keqe"*, njësoj si të ishte e pisët, e ndotur nga njeriu. Në të njëjtin kuptim thuhet për mendjen dhe ligjin apo të gjitha së bashku.[1] Në disa raste, përdoret në kontekstin e gjynahut, apo kur i vihet ortak All'llahut, apo kur besohet në të pavërtetën. Përdoret edhe për një njeri që është koprrac apo ziliqar. Nocioni i kësaj fjale është gjithëpërfshirës, për të gjitha llojet e çmendurive. Këtë e japin shkronjat *"elif"* dhe *"lam"*, të cilat emërtohen si *elifi* dhe *lami i gjinisë*.

Kuptimi i fjalës *"et tat'hijru"*, është largimi i pisllëkut. Përdoret në kontekstin e heqjes së papastërtisë dhe ndalimit nga e keqja. Ndërsa këtu, duke qenë kundrinor, merr një tjetër kuptim.

Fjalia: **"O Familje e Profetit!"**, tregon familjen e shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Dijetarët e Islamit dhe komentuesit e Kur'anit janë të këtij mendimi. Kjo kuptohet jo vetëm në pamje të parë të ajetit, por edhe sipas kontekstit të ajeteve të mësipërme dhe atyre që vijnë më pas.[1]

Pavarësisht kësaj, ka një kontradiktë se çfarë përfshin togfjalëshi: **"familje e Profetit"**.

---

1 Ajo që kanë përmendur disa se fjala *"el bejtu"*, këtu, tregon Shtëpinë e All'llahut (Qaben), kurse familjarët e saj janë "të devotshmit", nuk është në harmoni me kontekstin e ajeteve, sepse në këto ajete flitet për Profetin Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe bashkëshortet e tij, jo për Shtëpinë e All'llahut (Qaben). Për këtë, nuk ka asnjë argument për thënien e tyre.

Disa kanë supozuar se ky togfjalësh përfshin vetëm gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sepse ajetet e mëparshme dhe ato që vijnë më pas, flasin për bashkëshortet e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Shikimi me kujdes i çështjes, e refuzon këtë pohim, pasi përemrat që janë përmendur në ajetet e mëparshme dhe ato që vijnë më pas, janë përemra të gjinisë femërore. Përemrat e kësaj pjese të ajetit, kanë ardhur në numrin shumës mashkullor. Kjo tregon se është një kuptim tjetër.

Një grup tjetër komentuesish hodhën një hap më të gjerë dhe e konsideruan ajetin përfshirës për të gjithë njerëzit e shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, burra dhe gra.

Nga ana tjetër, transmetimet e shumta, të përmendura në librat e dy grupeve, e mohojnë që ajeti përfshin të gjithë familjarët e shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata thonë se togfjalëshi i këtij ajeti, përfshin vetëm pesë persona. Ata janë: Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Aliu, Fatimja, Hasani dhe Hysejni *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Të gjitha këto tekste janë argumente për komentimin e ajetit. Komentimi që mund të pranohet, është komentimi i tretë, domethënë, togfjalëshi përcakton pesë të mirët.

Pyetja e vetme që ngrihet këtu, është: Si mund të propozohet një çështje, në faqet e diskutimit, për detyrat e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të mos i përfshijë ato kjo çështje?

Dijetari dhe komentuaeis i madh Tabersiju, i është përgjigjur kësaj pyetjeje në veprën "Mexhmaul Bejan": "Nuk është hera e parë që diskutojmë për këtë çështje. Ajetet e Kur'anit lidhen me njëra-tjetrën dhe flasin për tema të ndryshme. Pa dyshim se Kur'ani është i mbushur me diskutime të tilla. Në fjalën e literaturës së pastër arabe dhe poezive të tyre, ka shumë dëshmi për këtë temë."

Komentuesi i madh, autori i veprës "El Mijzan", ka shtuar edhe një përgjigje tjetër: "Ne nuk kemi një argument se fjalia: **'All'llahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht.'**, ka zbritur bashkë me këto ajete. Nga transmetimet e shumta, përfitohet se kjo pjesë ka zbritur e veçuar dhe Imami (Imam Aliu) e ka vënë bashkë me këto ajete në tubimin e tij të ajeteve të Kur'anit, në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo pas tij.".

Përgjigjja e tretë është: Kur'ani dëshiron t'u thotë grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se janë në mesin e një familjeje të nderuar. Një pjesë e tyre janë të mbrojtura nga gjynahu, jetojnë nën hijen e mbrojtjes, ruajtjes dhe shtëpisë së të mbrojturve. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duhet të kontrollojë veten e tij më shumë se të tjerët. Ju gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk duhet të harroni përkatësinë tuaj në këtë shtëpi. Pesë njerëz të kësaj shtëpie, janë të mbrojtur nga gjynahu.

Në shënimet e ardhshme, do të diskutojmë transmetimet e traditës Profetike dhe shi'ite, për komentimin e këtij ajeti.

Ajeti 34 ka sqaruar shtatë detyra të tjera për gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. I paralajmëroi ato, që të përfitojnë nga mundësia që u jepet, në rrugën e gjithëpërfshirjes me të vërtetat e Islamit: **"Mbani në mendje ato që lexohen në shtëpitë tuaja prej Shpalljes së All'llahut dhe Urtësisë! Me të vërtetë, All'llahu është Bamirës i pakufishëm dhe di çdo gjë."**.

S'ka asnjë dyshim se ato janë në vendin e zbritjes së Shpalljes dhe në qendrën e Dritës së All'llahut, saqë, edhe sikur të rrinë në shtëpi, janë të afta të përfitojnë prej ajeteve që qarkullojnë në hapësirën e kësaj shtëpie prej mësimeve të Islamit dhe haditheve (thënieve) të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Çdo frymëmarrje e tij është mësim dhe çdo shprehje e fjalës së tij është program jete.

Cili është dallimi mes "ajeteve të All'llahut" dhe "urtësisë"? Disa komentues kanë thënë se secila prej tyre tregon Kur'anin. Mënyra e të shprehurit me *"el ajatu"* e bën të qartë anën e mrekullisë së Kur'anit, kurse fjala *"el hikmetu"*, flet për përmbajtjen e thellë dhe diturinë e fshehur në të.

Disa të tjerë kanë thënë se *"el ajatu"*, janë argumente të All'llahut, kurse *"el hikmetu"*, tregon traditën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, këshillat dhe udhëzimet e tij të mençura.

Edhe pse secili komentim harmonizohet me pozitën dhe shprehjet e ajetit, komentimi i parë duket më i përafërt, sepse mënyra e të shprehurit me lexim, harmonizohet më shumë me

ajetet e All'llahut, duke shtuar se shprehja e zbritjes është përmendur në shumë ajete të Kur'anit, në kuptimin e argumenteve dhe ligjeve, si në ajetin 231 të sures "El Bekare": **"Mos luani me Shpalljet e All'llahut! Kujtoni begatitë që ju ka dhënë Ai, si dhe Librin** (Kur'anin) **dhe diturinë e hollësishme, që jua ka zbritur për t'ju këshilluar. Kini frikë All'llahun dhe ta dini se All'llahu është i Dijshëm për çdo gjë!"**.

Ky ajet, është i ngjashëm me ajetin 113 të sures "En Nisa".

Në fund, ajeti thotë: **"Me të vërtetë, All'llahu është Bamirës i pakufishëm dhe di çdo gjë."**.

Kjo fjali tregon se All'llahu i Madhërishëm, është i informuar për punët më të holla e më të fshehta dhe e di shumë mirë se çfarë kanë njerëzit në zemër. Ai është i Dijshëm për sekretet që njerëzit i mbajnë të fshehura në gjokset e tyre.

Ky është kuptimi, nëse fjalën *"el latijfu"*, e komentojmë me "i informuari për gjërat e hollësishme dhe të fshehtat". Nëse komentohet me të qenit mirësues, atëherë ajeti tregon se All'llahu i Madhëruar është mirësues dhe i mëshirshëm me gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Ai është i mirinformuar për veprat e tyre.

Supozohet, gjithashtu, që fjala *"el latijfu"*, tregon anën e mrekullisë sëKur'anit, kurse togfjalëshi *"el khabijru"*, tregon përmbajtjen e tij të urtë. Nuk ka asnjë kundërshtim mes këtyre kuptimeve dhe bashkimi i tyre është i mundur.

Hulumtim

1- Ajeti i pastrimit është një fakt i qartë i mbrojtjes nga gjynahu *(el ismetu)*

Disa komentues, fjalën *"err rrixhse"*, e përmendur në këtë ajet, e kanë konsideruar vetëm si tregues të idhujtarisë dhe të gjynaheve të mëdha, si imoraliteti *(ez zina)*. Ndërkohë që nuk ka argument për këtë përcaktim, sepse përgjithësija e llojit dhe në mënyrë të veçantë, duke parë *elifin* dhe *lamin* e tij (*elifi* dhe *lami i llojit)*, i përfshin të gjitha llojet e gjynaheve dhe të kundërshtive, sepse çdo gjynah është papastërti. Kjo fjalë është përdorur në Kur'an, për: idhujtarinë, pijet alkoolike, bixhozin, hipokrizinë dhe mishrat e ndaluara për t'u konsumuar dhe të papastra, etj. Shiko ajetin 30 të sures "El Haxh", ajetin 90 të sures "El Maide", ajetin 125 të sures "Et Teube", ajetin 125 të sures "En En'am".

Duke parë se vullneti i patjetërsueshmë i All'llahut në zbatim dhe se fjalia: **"All'llahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**, është argument i vullnetit të All'llahut e sidomos prania e fjalës *"innema"*, e cila tregon kufizim dhe miratim, qartësohet se vullneti i All'llahut të Madhëruar është i prerë, që familja dhe shtëpia të jetë e pastër, larg çdo papastërtie dhe gabimi. Kjo është ajo pozita e mbrojtjes nga gjynahu.

Mirëpo ka edhe një çështje që meriton të sqarohet: Vullneti hyjnor te ky ajet nuk janë urdhëresat dhe ligjet hyjnore në çështjet e hallallit dhe të haramit, sepse këto ligje i përfshijnë të gjithë dhe nuk është vetëm për familjen dhe shtëpinë. Në bazë të kësaj, nuk

ka dyshim se ajo nuk harmonizohet me kuptimin e fjalës *"innema"*.

Atëherë, kjo dëshirë e vazhdueshme është vetë ajo që thuhet në vizitat e xhamive: "All'llahu ju mbrojttë nga tërmetet dhe ju ruajttë nga të këqijat, ju pastroftë nga papastërtitë dhe ju largoftë ndyrësitë dhe ju pastroftë juve plotësisht."

Pas këtij sqarimi, duhet të mos dyshojmë në argumentimin e ajetit të përmendur për mbrojtjen nga gjynahet e familjes së shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

2- Për kë ka zbritur ajeti i pastrimit?

Kemi thënë se ky ajet përfshihet brenda ajeteve që lidhen me gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Shprehja e kontekstit të tij, ku përemri i shumësit femëror zëvendësohet me përemrin e shumësit mashkullor, është një argument se ky ajet ka kuptim dhe përmbajtje të pavarur nga ato ajete.

Duke u nisur nga ky fakt, edhe ata që këtë ajet nuk e kanë konsideruar ajet që flet për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin, u bindën se ka një kuptim të gjerë, që i përfshin këta njerëz të mëdhenj dhe gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Transmetimet e shumta që kemi në duar, e bëjnë të qartë se ky ajet është vetëm për këta njerëz të mëdhenj dhe gratë nuk

hyjnë brenda ajetit, pavarësisht se ata i gëzohen një respekti të veçantë. Do të paraqesim disa nga këto transmetime:

a) Transmetime që transmetohen nga vetë bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ato kanë thënë se, kur e pyetën Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për këtë ajet, nëse ato ishin pjesë e këtij ajeti, ai u përgjigj: *"Ju jeni në mirësi, mirëpo nuk jeni pjesë e saj."*.

Transmetim tjetër është transmetimi që ka bërë Tha'lebij nga Ummu Seleme, për komentimin e këtij ajeti: "Kur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte në shtëpinë e saj, erdhi Fatimja *(Paqja qoftë mbi të!)* me një copë mëndafshi. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: *'Thirr burrin tënd dhe dy fëmijët e tu, Hasanin dhe Hysejnin.'* Ata erdhën dhe hëngrën së bashku. Pastaj Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* hodhi mbi ta një mbulesë nga Hajberi dhe tha: *'O All'llah, këta janë familja e shtëpisë sime dhe gjaku im. Largoje prej tyre ndyrësinë dhe pastroi ata plotësisht.'"*.

Më pas zbriti ajeti i pastrimit. Unë e pyeta: *"O i Dërguari i All'llahut, a jam edhe unë bashkë me ju?"* Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj: *"Ti je në mirësi, mirëpo nuk je prej tyre."*.[1]

1 Tabersiju transmeton në tefsirin "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 358, fundi i ajetit është burimi i komentimit. Ky hadith me këtë përmbajtje, është transmetuar në mënyra të ndryshme nga Umu Selme. Hakim El Haskenij, "Sheuahidu Tenzijl", vëll. 2, f. 56 e më pas.

Eth Tha'lebij transmeton nga Aishja se, kur ajo u pyet për Luftën e devesë dhe pjesëmarrjen e saj në atë luftë shkatërrimtare, tha me keqardhje: "Ai ishte caktim i All'llahut.".

Kur u pyet për Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të !)*, ajo tha: "Po më pyet mua për njeriun më të dashur të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe bashkëshortin e njeriut më të dashur të të Dërguarit të All'llahut? Kam parë Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin, kur i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi u hodhi një rrobë, tha: *'O All'llah, këta janë familja e shtëpisë sime dhe mbrojtësit e mi. Largoi ndyrësitë prej tyre dhe pastroi ata plotësisht.'*

Unë e pyeta: "O i Dërguari i All'llahut, a jam unë nga familja jote?!"

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Qetësohu, bëj mënjanë. Ti je për mua mirësi,[2] vetëm se ti nuk je pjesë e tyre.*".

Këto transmetime e bëjnë të qartë se bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk janë pjesë e familjes së shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

b) Janë përmendur shumë transmetime, për Hadithul Kisa. Prej këtyre transmetimeve përfitohet se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ftoi Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin. Ata erdhën tek ai. Hodhi sipër tyre një mantel dhe tha: "*O All'llah, këta janë familja e shtëpisë sime! Largoje prej tyre ndyrësinë dhe pastroi ata plotësisht.*". Më pas zbrit

ajeti: **"All'llahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**.

Dijetari i njohur Hakim El Haskenij Nisabeviju i ka pasqyruar këto transmetime, në mënyra të ndryshme, nga transmetues të ndryshëm, në veprën "Sheuahidu Tenzijl".[1]

Këtu ka një pyetje që tërheq vëmendjen: Cili ishte qëllimi, që këta persona u bashkuan nën mbulesë?

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dëshironte t'i përcaktonte dhe t'i përkufizonte plotësisht këta, prandaj thotë se ajeti i mësipërm është në të drejtën e këtyre, që askush të mos mendojë e as ta çojë ndërmend se atyre që u adresohet ky ajet, janë të gjithë ata që kanë lidhje me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe çdokush që konsiderohet pjesë e familjes së tij.

Në disa transmetime thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka përsëritur këtë fjali tri herë: *"O All'llah, këta janë familja e shtëpisë sime dhe të veçantët e mi. Largoje prej tyre ndyrësinë e gjynahut dhe pastroi ata plotësisht."*.[2]

c) Në shumë transmetime të tjera, lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për gjashtë muaj, pas zbritjes së këtij ajeti, kur kalonte pranë shtëpisë së Fatimes *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur shkonte në namazin e sabahut, thoshte: *"Namaz, o familja e shtëpisë!*

1 "Sheuahidu Tenzijl", vëll. 2, f. 31 e më pas.
2 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthur", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

All'llahu dëshiron të largojë prej jush ndyrësinë e gjynahut të familjarëve të shtëpisë dhe t'ju pastrojë juve plotësisht.".

Hakim Haskaniju e ka transmetuar këtë hadith nga Enes ibn Maliku.[1]

Këtë hadith e ka transmetuar edhe Ibn Abasi nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[24]

Këtu ka një çështje që meriton të vërehet me kujdes: Përsëritja e kësaj lutjeje për gjashtë muaj apo nëntë muaj në anë të shtëpisë së Fatimes, nuk është gjë tjetër vetëm qartësim i kësaj çështjeje, me qëllim që tek asnjë person të mos mbetet asnjë dyshim, se ky ajet ka zbritur për këta njerëz.

Kur All'llahu urdhëroi që të gjitha dyert e shtëpive, që shërbenin për të hyrë në xhami, të mbylleshin, dera e shtëpisë së Fatimes mbeti e hapur.

Nuk ka asnjë dyshim se një grup njerëzish do ta kenë dëgjuar atë fjalë të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjatë kohës së namazit.

E megjithatë, ajo që shkakton habi është se një pjesë e komentuesve ngulin këmbë se ajeti ka kuptim të përgjithshëm, ku futen edhe bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Shumica e dijetarëve synit dhe shiit kanë përcaktuar këta pesë persona.

1 "Sheuahidu Tenzij", vëll. 2, f. 28-29.
2 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthur", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Ajo që meriton të vërehet me kujdes, është se Aishja, bashkëshortja e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk pretendonte të përmendeshin hollësitë e lidhjes së saj me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në dëshmitë e transmetimeve islame, pasi, nëse ky ajet do ta përfshinte atë, ajo do të fliste për të në situata të ndryshme, në kohën kur askush nuk ka dëgjuar asgjë pres saj.

d) Nga sahabi i njohur, Ebu Said El Khuderij, ka shumë transmetime, që dëshmojnë qartë se ky ajet ka zbritur për këta pesë njerëz të pastër: "*Ka zbritur për pesë vetë, për të Dërguarin e All'llahut, Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin.*".[1]

Këto transmetime janë të shumta dhe një pjesë e vërtetuesve i ka vlerësuar ato.

Nga sa thamë, dalim në përfundimin se burimet dhe transmetuesit e haditheve, që tregojnë specifikimin e ajetit me pesë të pastrit, janë të shumtë, sa askujt nuk i lënë hapësirë të dyshojë në këtë argumentim.

Në veprën "Ihkakul Hakk" janë përmendur më shumë se shtatëdhjetë burime prej burimeve të njohura universale, kurse prej burimeve shi'ite, në këtë kapitull, janë përmendur më shumë se një mijë.[2]

1 "Sheuahidu Tenzijl", vëll. 2, f. 25.
2 "Sheuahidu Tenzijl", vëll. 2, prej veprës "Ihkakul Hakk ue hauamishihi".

Autori i librit "Sheuahidu Tenzijl", një nga dijetarët e njohur të traditës Profetike, për këtë temë, transmeton më shumë se 130 hadithe.[1]

Duke e larguar shikimin nga kjo, nuk ka dyshim se disa gra të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjatë gjithë jetës së tyre kanë bërë vepra që e kundërshtojnë pozitën e mbrojtur nga gjynahu, si Lufta e devesë, e cila ishte një revolucion dhe dalje mbi Imamin e kohës. Kjo luftë shkaktoi gjakderdhje të madhe. Numri i të vrarëve në këtë luftë, sipas disa historianëve, ishte shtatëmbëdhjetëmijë.

Nuk ka asnjë dyshim se kjo betejë nuk mund të përballej, madje Aishja është penduar për këtë veprim të saj. Një shembull i kësaj pendese është përmendur në diskutimet e mëparshme.

Ulja, poshtërimi që Aishja i bëri Hatixhesë, një nga gratë më të mëdha të myslimanëve, më sakrifikuesja, më altruistja, më e nderuara, më e larta se të gjitha gratë, është shumë e njohur në historinë islame. Kjo fjalë e lëndoi shumë të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, saqë në fytyrën e tij fisnike u dukën shenjat e zemërimit. Ai tha: *"Jo për Zotin. All'llahu nuk më ka dhënë ndonjë grua më të mirë se sa ajo. Më besoi mua, kur njerëzit më mohuan, më mbështeti mua, kur njerëzit më përgënjeshtruan dhe ajo më la trashëgimi pasurinë e saj, kur njerëzit ma ndaluan atë."*.[2]

1 "Sheuahidu Tenzijl", vëll. 2, f. 10-92.
2 "El Istiabu", "Sahihu" Bukhari, "Sahihu" Muslim, sipas transmetimit të "El Muraxheat", letërkëmbimi 72, f. 229.

3- Si është vullneti në këtë ajet?

Në këtë temë, ajeti u trajtua në kontekstet e tefsirit. Kemi thënë se vullneti te fjalia: **"All'llahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**, është vullnet kreativ dhe jo legjislativ.

Duhet të kujtojmë se togfjalëshi "vullnet legjislativ" përfshin urdhëresat dhe ndalesat e All'llahut, pasi ne e dimë se All'llahu i Madhëruar, për shembull, dëshiron nga ne faljen e namazit, agjërimin, Haxhin dhe xhihadin. Ky është një vullnet legjislativ. Dihet se vullneti legjislativ lidhet me punët tona, jo me punët e All'llahut të Lartësuar.

Ajeti i mësipërm lidhet me punët e All'llahut të Madhëruar. Ajeti thotë se All'llahu dëshiron të largojë prej jush ndotësinë e gjynahut. Në bazë të kësaj, një vullnet i tillë duhet të jetë kreativ dhe i lidhur me vullnetin e All'llahut të Madhëruar në botën e krijimit.

Çështja e vullnetit legjislativ, në lidhje me devotshmërinë dhe virtytin, nuk kufizohet me familjarët e shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sepse All'llahu i ka urdhëruar të gjithë me devotshmëri dhe pastrim nga gjynahet. Ata nuk kanë dallim, sepse të gjithë janë të përfshirë në këtë urdhër.

E megjithatë, kjo temë, domethënë, vullneti legjislativ, nuk harmonizohet me fillimin e ajetit, por harmonizohet me hadithet e mëpasshme, sepse të gjitha ato hadithe flasin për mirësinë e lartë dhe dhuratën e rëndësishme për familjarët e shtëpisë së Profetit

Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Është e padiskutueshme se fjala "*err rrixhsu*" - "*ndyrësi*", këtu, nuk do të thotë ndyrësi e dukshme, përkundrazi ajo është treguese e ndyrësive të brendshme. Përdorimi i kësaj fjale e ndalon kufizimin e saj me idhujtarinë, me mosbesimin dhe veprat e ndaluara të virtytit e të ngjashme me të, pasi ajo përfshin të gjitha gjynahet, kundërshtitë dhe të këqijat e besimit, të moralit dhe të praktikës.

Çështja tjetër, që duhet të trajtohet me imtësi, është: Vullneti kreativ, i cili ka kuptimin e krijimit dhe të gjetjes, këtu do të thotë "i zbatuar, i kryer, i finalizuar", jo shkakësi e plotë *(el il'letu tammetu)* për të çuar në imponim dhe zhveshje nga përzgjedhja.

Sqarimi i kësaj çështjeje, është: Pozitë e pagabueshmërisë, do të thotë gjendje e devotshmërisë ndaj All'llahut, e cila, me ndihmën e All'llahut të Madhëruar, ekziston tek Profetët dhe Imamët. Mirëpo ekzistenca e kësaj situate, nuk do të thotë se ata janë të paaftë për të kryer gjynah, përkundrazi ata janë të aftë ta bëjnë atë, vetëm se e ndalojnë veten e tyre nga përlyerja me të dhe e largojnë shikimin nga bindja, njësoj si mjeku i zgjuar, i cili nuk konsumon lëndë shumë toksike, sepse ai i di rreziqet që rrjedhin me konsumin e saj, edhe pse ai është i aftë ta përdorë atë. Njohuritë, dituritë, parimet e tij ideologjike dhe shpirtërore e nxisin atë të frenohet me dëshirë, me vullnet dhe me zgjedhje nga kjo vepër.

Duhet të përkujtohet se kjo devotshmëri është dhuratë e veçantë, që u është dhënë Profetëve, jo të tjerëve. All'llahu i Madhëruar ua ka dhënë atyre, për shkak të përgjegjësive të vështira, të rrezikshme që hasnin në udhëheqjen dhe në udhëzimin e njerëzve. Në bazë të kësaj, ai është një dallim, veçori që dobia e tij u referohet të gjithëve. Kjo është vetë drejtësia, njësoj si dallimi i veçantë që All'llahu ua dha shtresave të syrit. Prej perdeve të tij të holla dhe shumë të ndjeshme, përfiton i gjithë trupi.

Duhet të shtojmë se Profetëve u shtohet përgjegjësia dhe detyra, me të njëjtën masë që kënaqen me këtë dhuratë hyjnore, pasi lëshimi i të parës, nga ana e tyre, llogaritet një gjynah i madh, që buron nga njerëz të thjeshtë. Ky është një standard dhe një personifikim i vijës së drejtësisë.

Rezultati është: Ky vullnet është një vullnet kreativ në kufijtë e domosdoshmërisë. Nuk është një arsye e plotë. Në të njëjtën kohë, nuk e obligon korrigjimin dhe as zgjedhjen negative dhe vullnetin njerëzor.

4- Injoranca e shekullit të njëzetë

Është treguar se një grup komentuesish janë përfshirë në komentimin e injorancës së hershme. Ata nuk mund t'i besonin shfaqjes së një injorance tjetër në botë, pas shfaqjes së Islamit. Injoranca e arabëve para Islamit është shumë e vogël, përballë injorancës së re. Kjo çështje është bërë e qartë sot për të gjithë, kur shikojmë dukuritë e tmerrshme të injorancës së shekullit të

njëzetë. Kjo duhet të konsiderohet një nga profecitë e mrekullisë kur'anore.

Nëse arabët, në kohën e injorancës, xhelozonin dhe luftonin dhe, nëse tregu i Ukadhes, për shembull, ishte sheshi i gjakderdhjes për shkaqe të kota, ku u vranë shumë njerëz, në injorancën e kohës sonë, kanë ndodhur luftëra, saqë numri i viktimave ka shkuar në njëzet milionë dhe numri i të plagosurve dhe i të sakatuarve është më shumë se ky numër.

Nëse gratë në kohën e injorancës zbuloheshin dhe hiqnin mbulesat nga kokat e tyre, duke treguar një pjesë të gjoksit të tyre, gjerdanët dhe vathët e tyre, në kohën tonë janë formuar klube që quhen klubet e lakuriqësisë. Modeli i tyre është i njohur në Angli, ku njerëzit zhvishen ashtu siç i kanë lerë nëna e tyre. Edhe në plazhe, në brigjet e deteve dhe të pishinave, madje edhe në vendet publike, në mes të rrugës, është e njëjta panoramë, saqë lapsi ka turp ta përmendë.

Nëse në injorancë ka pasur "prostituta që kishin shenjat dalluese", të cilat ngrinin flamuj sipër shtëpive të tyre, që t'i ftonin njerëzit drejt vetes së tyre, në injorancën e kohës sonë, ka njerëz që propozojnë çështje dhe kërkesa në këtë fushë, nëpërmjet revistave të veçanta, që frikacakët u bashkohen. Injoranca arabe është njëqind herë më fisnike se sa kjo injorancë.

Përmbledhje: Çfarë mund të themi për situatën e të këqijave në kohën tonë aktuale, në kohën e qytetërimit material familjar, të boshatisur nga besimi? Duke mos folur për të, është më mirë, pasi nuk duhet të ndotim këtë koment me përmendjen e saj.

Ajo çka thamë, ishte njëra anë e ngarkesës së hedhur mbi supet tona, për sqarimin e jetës së atyre që largohen nga All'llahu i Lartësuar, pasi, edhe pse ata kanë mijëra universitete, qendra shkencore dhe shkencëtarë të njohur, përsëri janë të mbytur në baltën e shthurjes dhe në kënetën e imoralitetit, madje ata mund t'i vënë këto qendra shkencore dhe shkencëtarët e saj në shërbim të këtyre katastrofave dhe të këqijave.

Ajeti 35

﴿إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَالْقَانِتِينَ وَالْقَانِتَاتِ وَالصَّادِقِينَ وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ وَالصَّابِرَاتِ وَالْخَاشِعِينَ وَالْخَاشِعَاتِ وَالْمُتَصَدِّقِينَ وَالْمُتَصَدِّقَاتِ وَالصَّائِمِينَ وَالصَّائِمَاتِ وَالْحَافِظِينَ فُرُوجَهُمْ وَالْحَافِظَاتِ وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا٣٥﴾

"Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtaret, të bindurit ndaj All'llahut dhe të bindurat ndaj All'llahut, të drejtët dhe të drejtat, duruesit dhe durueset, të përulurit dhe të përulurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e All'llahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta All'llahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh."

Shkaku i zbritjes

Një grup komentuesish kanë përmendur se shkaku i zbritjes së këtij ajeti është dialogu që bëri Esma bint Amisi, bashkëshortja e Xha'ferr ibn Ebu Talibit me gratë e të Dërguarit të All'llahut. Ajo, kur u kthye nga Abisinia, erdhi te bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i pyeti: "A ka zbritur nga Kur'ani ndonjë gjë për ne?"

Ato thanë: "Jo."

Ajo shkoi te i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "O i Dërguari i All'llahut, gratë janë në dështim dhe humbje."

Ai tha: "Përse kështu?"

Ajo tha: "Ato nuk përmenden për të mirë, siç përmenden burrat." All'llahu i Lartësuar zbriti këtë ajet, i cili i qetësoi gratë. Ato kanë grada tek All'llahu, njësoj si burrat dhe u siguroi se standardi është besimi, vepra dhe morali islam.

Komentimi

Personaliteti i gruas dhe pozita e saj në Islam

Pas shumë diskutimeve që u përmendën në ajetet e mëparshme rreth detyrave të bashkëshorteve të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ky ajet ka përmendur një fjalë universale, me përmbajtje të thellë, për të gjitha gratë dhe për të gjithë burrat, duke dhënë cilësitë e tyre. Pasi ka përmendur dhjetë cilësi, prej cilësive të tyre ideologjike, morale dhe praktike, ka bërë të qartë shpërblimin e madh që është përgatitur për to në fund.

Nuk ka dyshim se një pjesë e këtyre dhjetë cilësive flet për fazat e besimit: pranimi me zemër e shpirt, të shprehurit me gjuhë dhe vërtetimi me vepra.

Pjesa e fundit diskuton për mbizotërimin e gjuhës, të barkut dhe pasionit seksual. Këta tre faktorë janë vendimtarë në jetën e njeriut.

Nga ana tjetër, ka folur për çështjen e mbrojtjes nga haramet dhe mënyrën e përballjes me ngjarje të vështira, duke theksuar durimin, si thelbin e besimit.

Në fund, flet për faktorin e vazhdimësisë së këtyre cilësive, domethënë, përmendjes së All'llahut të Lartësuar.

Ajeti thotë: **"Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtaret, të bindurit ndaj All'llahut dhe të bindurat ndaj All'llahut..."**. Në këto fjalë,

përfshihen të dy gjinitë, edhe mashkulli, edhe femra. Ata duhet të jenë të bindur ndaj urdhëresave të All'llahut të Madhëruar.

Pavarësisht se një pjesë e komentuesve të Kur'anit, e kanë trajtuar ajetin, vetëm me një kuptim, besimin në fenë islame, është e qartë se kjo përsëritje thekson rëndësinë e këtyre dy gjërave. Kjo gjë paraqitet në ajetin 14 të sures "El Huxhurat": **"Arabët e shkretëtirës deklarojnë: 'Ne besojmë'. Thuaju: 'Ju nuk keni besuar!' Por më mirë thoni: 'Ne përulemi', pasi besimi ende nuk ka hyrë në zemrat tuaja. E, nëse i bindeni All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk do t'ju pakësohet asgjë prej veprave tuaja. Sigurisht, All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**.

Këto ajete na lenë të kuptojmë, se Islami është shprehja me gjuhë, që e bën njeriun të jetë në radhët e myslimanëve dhe të përfshihet plotësisht me rregullat e tij, kurse besimi është pranimi me zemër dhe shpirt.

Tregimet islame kanë treguar për këtë ndryshim në kuptim. Në një transmetim thuhet se një nga shokët e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* e pyeti atë për Islamin dhe besimin, nëse kanë ndryshim nga njëri-tjetri. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjigj: *"Besimi është pjesë e Islamit, ndërsa Islami ndoshta nuk është pjesë e besimit."*. Ai njeri pyeti për më shumë sqarim dhe Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Islami është dëshmia se nuk ka tjetër Zot veç All'llahut dhe pranimi i të Dërguarit të All'llahut. Me të (Islamin) janë kursyer gjaqet; me të janë zhvilluar martesat dhe trashëgimitë dhe grupe njerëzish jetojnë nën hijen e Islamit. Kurse*

besimi është udhëzim dhe çfarë vërtetohet në zemër dhe shfaqet nëpërmjet punës.”.[1]

Fjala *“kánete”* rrjedh nga fjala *“el kunut”* dhe, siç e kemi thënë, është bindje e shoqëruar me përulje dhe nënshtrim, që buron nga besimi. Kjo tregon anët praktike të besimit dhe ndikimin e tij në jetën e njeriut.

Pastaj përmend një nga cilësitë më të rëndësishme të besimtarëve të vërtetë, ruajtjen e gjuhës: **“të drejtët dhe të drejtat”**.

Nga transmetimet e ndryshme përfitohet se drejtimi i besimit të njeriut dhe sinqeriteti i tij është në drejtimin e gjuhës dhe të sinqeritetit të tij: *“Nuk drejtohet besimi i një njeriu, derisa të drejtohet zemra e tij dhe nuk drejtohet zemra e tij, derisa të drejtohet gjuha e tij.”*[2]

Përderisa durimi, ngarkesa dhe vendosmëria para problemeve dhe vështirësive ishte thelbi i besimit, roli dhe shkalla e tij në moralin e njeriut është njësoj si koka për trupin. Ajeti i përshkroi ata me cilësinë e tyre të pestë: **“duruesit dhe durueset”**.

Ne e dimë se një nga sëmundjet më të këqija morale, është mendjemadhësia, kryeneçësia dhe pëlqimi i vetes, kurse e kundërta e tyre, është: përulja, modestia. Prandaj edhe cilësia e gjashtë ishte: **“të përulurit dhe të përulurat”**.

Nëse e kalojmë pëlqimin e vetes, atëherë, pa dyshim, se dashuria e pasurisë është një tjetër sëmundje e madhe. Adhurimi

1 “Usulul Kafij”, vëll. 2, f. 21.
2 “El Mehexhxhetul Bejda”, vëll. 5, f. 193.

dhe lidhja e fortë me të është një ulje e rrezikshme, e hidhët. Përballë saj qëndron shpenzimi dhe ndihma e nevojtarëve. Për këtë, cilësia e tyre e shtatë ishte: **"mirëbërësit dhe mirëbërëset"**.

Nëse njeriu çlirohet prej të keqes së tri gjërave, ai do jetë i sigurt prej shumë dëmeve dhe të këqijave morale, që janë: gjuha, stomaku dhe pasioni seksual. Për të parën u tregua në cilësinë e katërt, kurse për sa i përket stomakut dhe pasionit seksual, ajeti ka folur në cilësinë e tetë dhe të nëntë: **"agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit"**.

Në fund, ajeti thekson cilësinë e dhjetë, që lidhet me vazhdimësinë e të gjitha cilësive të mëparshme: **"përkujtuesit e All'llahut vazhdimisht dhe përkujtueset"**.

Nuk ka asnjë dyshim se këta duhet të jenë me All'llahun dhe ta përmendin Atë në çdo situatë, në çdo kusht dhe të largojnë nga zemrat e tyre perden e hutimit dhe të injorancës, të largojnë nga vetja e tyre ngacmimet dhe cytjet e shejtanëve. Nëse nuk duket shkarje prej tyre, atëherë ata i dorëzohen në moment fatalizmit, me qëllim që të mos largohen nga Rruga e Drejtë.

Shumë transmetime kanë ardhur për përkujtuesit e All'llahut. Të gjitha këto transmetime duken si një formë e hapur e përmendjes së All'llahut. Në lidhje me këtë, në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "*Nëse një njeri e zgjon familjen e tij (bashkëshorten) në një pjesë të natës, pastaj marrin abdes dhe falen të dy,*

ata të dy do të shkruhen prej përkujtuesëve dhe përkujtueseve të të shumtë të All'llahut.".[1]

Në një transmetim nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Kush i bën vazhdimisht tesbihatet e Fatimesë (Paqja qoftë mbi të!), do jetë prej përkujtuesëve dhe përkujtueseve të shumtë të All'llahut."*.[2]

Disa komentues kanë thënë se përkujtimi i All'llahut është përmendja e Tij në çdo çast: në këmbë, ulur dhe shtrirë në shtrat.

Për çdo lloj vlerësimi, nuk ka asnjë dyshim se përmendja e All'llahut është shenjë e mendimit dhe mendimi është paraprirëse e veprës. Duhet të kihet parasysh se përmendja duhet të jetë e lidhur me mendimin dhe veprën.

Ajeti, në fund, e bën të qartë shpërblimin e madh për këtë grup burrash dhe grash, të cilët kënaqen me këto dhjetë cilësi, sepse: **"All'llahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh."**

All'llahu i Lartësuar, me ujin e faljes, ua ka larë atyre gjynahet, të cilat janë shkaktarë të ndotjes së shpirtrave të tyre. Pastaj u shkroi atyre shpërblimin e madh, masën e të cilit nuk e njeh askush përveç All'llahut të Madhëruar.

Realiteti është se njëra prej këtyre çështjeve dëbon të gjitha gjërat e urryera, kurse tjetra tërheq të gjitha të mirat.

---

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 358; Tefsiri i "Kurtubijut", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

2 Sipas transmetimit të veprës "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 385, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Mënyra e shprehjes me fjalën *"exhren"*, është argument i madhështisë së All'llahut, kurse përshkrimi i All'llahut me fjalën *"adhim"* - *"madhështor"*, është miratim i kësaj madhështie. Madhështia absolute është një tjetër argument i gjerësisë dhe i shtrirjes së saj. Është e padiskutueshme, se atë gjë që All'llahu e konsideron madhështore, Ai është i jashtëzakonshëm në madhështinë e saj.

Ka një çështje që meriton të vërehet me kujdes. Fjala *"eadde"* - *"ka përgatitur"*, është përmendur në kohën e shkuar. Kjo është sqarim për patjetshmërinë e realizimit të këtij shpërblimi të madh, ose është tregues se Xhenneti dhe mirësitë e tij janë përgatitur që tani për besimtarët.

Hulumtim

Te All'llahu janë të barabartë, edhe burri, edhe gruaja

Ndonjëherë disa mendojnë se Islami favorizon karakterin e burrit dhe gratë nuk kanë pozitë të rëndësishme në programet e Islamit. Burimi i këtij dyshimi kanë qenë disa kontradikta të së drejtës. Për secilën prej tyre ka një filozofi të veçantë.

E largojmë shikimin nga këto kontradikta, të cilat kanë lidhje me pozitat, qendrat shoqërore dhe kushtet e tyre normale. Nuk ka asnjë dyshim në mungesën e ekzistencës së çdo dallimi mes burrit dhe gruas në mësimet islame, si nga ana njerëzore, ashtu edhe nga pozita shpirtërore.

Ajeti i përmendur është një argument i qartë për këtë të vërtetë, sepse e ka vënë gruan dhe burrin në të njëjtën shkallë të peshores, duke qartësuar veçoritë e besimtarëve, besimtareve, një nga çështjet më të rëndësishme ideologjike, morale dhe shkencore. U ka premtuar atyre shpërblime të mëdha dhe të barabarta, pa asnjë dallim dhe ndryshim.

E thënë ndryshe: Nuk mund të mohohet dallimi gjinor mes burrit dhe gruas, ashtu siç nuk mund të mohohet ndryshimi shpirtëror mes tyre. Gjithashtu, është e padiskutueshme që ky dallim të jetë i domosdoshëm për vazhdimësinë e sistemit shoqëror njerëzor, ashtu siç ka lënë mënjanë gjurmë dhe rezultate në disa ligje të së drejtës për gruan dhe burrin. Islami nuk e ka propozuar personalitetin njerëzor të gruas për debat, ashtu siç e kanë bërë atë disa priftërinj katolikë në shekullin e kaluar, që hidhnin pyetjet: A është gruaja njeri? A ka ajo shpirt njerëzor apo jo?

Islami nuk u mjaftua vetëm me këtë, madje ka miratuar mungesën e dallimit mes dy gjinive, nga ana e shpirtit njerëzor. Atë e lexojmë në ajetin 97 të sures "En Nahl": **"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë."**.

Islami ka vendosur për gruan të njëjtën pavarësi ekonomike, siç e ka vendosur për burrin, të kundërtën e shumë ligjeve të mëparshme të botës, madje edhe ligjeve të sotme të botës, të cilat nuk ia kanë dhënë gruas pavarësinë ekonomike.

Theksojmë se në diturinë islame është një kapitull i veçantë për gratë dijetare, të cilat kanë qenë në radhët e transmetuesve dhe të dijetareve. Ato janë përmendur si karaktere ndikuese dhe aktive në historinë islame.

Nëse kthehemi në historinë e arabëve beduinë para Islamit dhe hetojmë gjendjen e grave në atë shoqëri, shikojmë se ato ishin të privuara nga të drejtat më elementare të njeriut, madje idhujtarët nuk besonin ndonjëherë se ato kishin të drejtën e jetës dhe për këtë i varrosnin ato të gjalla pasi që kishin lindur.

Po kështu, nëse shikojmë gjendjen e gruas në botën tonë të sotme, ajo është bërë një lodër pa zgjedhje dhe pa dëshirë në dorën e një grupi të veshur me rrobat njerëzore, që pretendojnë civilizimin, do të kuptojmë shumë mirë se Islami i ka shërbyer gruas çdo lloj shërbimi dhe ai ka një të drejtë të madhe ndaj tyre.[1]

1 Kemi pasur një diskutim tjetër për këtë temë, në fund të ajetit 228 të sures "El Bekare". Gjithashtu, është përmendur një diskutim tjetër në fund të ajetit 97 të sures "En Nahl".

Ajetet 36 – 38

﴿وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ وَلَا مُؤْمِنَةٍ إِذَا قَضَى اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَمْرًا أَنْ يَكُونَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ مِنْ أَمْرِهِمْ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا مُبِينًا٣٦ وَإِذْ تَقُولُ لِلَّذِى أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَأَنْعَمْتَ عَلَيْهِ أَمْسِكْ عَلَيْكَ زَوْجَكَ وَاتَّقِ اللَّهَ وَتُخْفِى فِى نَفْسِكَ مَا اللَّهُ مُبْدِيهِ وَتَخْشَى النَّاسَ وَاللَّهُ أَحَقُّ أَنْ تَخْشَاهُ فَلَمَّا قَضَى زَيْدٌ مِنْهَا وَطَرًا زَوَّجْنَاكَهَا لِكَيْ لَا يَكُونَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ حَرَجٌ فِى أَزْوَاجِ أَدْعِيَائِهِمْ إِذَا قَضَوْا مِنْهُنَّ وَطَرًا وَكَانَ أَمْرُ اللَّهِ مَفْعُولًا٣٧ مَا كَانَ عَلَى النَّبِيِّ مِنْ حَرَجٍ فِيمَا فَرَضَ اللَّهُ لَهُ سُنَّةَ اللَّهِ فِى الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلُ وَكَانَ أَمْرُ اللَّهِ قَدَرًا مَقْدُورًا٣٨﴾

"Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur All'llahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren. Kush e kundërshton All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur."

"Ti (o Muhammed) **i the atij, që All'llahu dhe ti vetë i keni bërë mirësi: 'Mbaje gruan tënde dhe frikësoju All'llahut!'**

Në të vërtetë, ti po fsheh në vetvete atë që All'llahu do ta nxjerrë në shesh dhe ti po u frikësohesh njerëzve, kur më e drejtë është t'i frikësohesh All'llahut. E, pasi Zejdi bashkëjetoi me gruan e vet dhe u nda prej saj, Ne ta dhamë ty për bashkëshorte, në mënyrë që besimtarët të mos ngurrojnë, që të martohen me gratë e të birësuarve të tyre, pasi ata ta kenë plotësuar dëshirën e tyre dhe të jenë ndarë. Urdhri i All'llahut do të përmbushet detyrimisht."

"S'ka kurrfarë fajësimi për Profetin, kur bën atë që i ka urdhëruar All'llahu. Kështu ka qenë ligji i All'llahut edhe për ata (Profetë) **që kanë qenë më parë, - urdhri i All'llahut është vendim i detyruar të ndodhë."**

Shkaku i zbritjes

Këto ajete, sipas shumicës së komentuesve të Kur'anit, kanë zbritur, për çështjen e martesës së Zejneb bintu Xhahshit, vajza e xhaxhait të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Zejd ibn Harithen, djalin e adoptuar të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Historia ka qenë: Hatixheja, para misionit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pas martesës së saj me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kishte blerë

një skllav, që quhej Zejd. Këtë skllav ia bëri dhuratë Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i dha lirinë atij. Kur fisi i tij e dëboi atë dhe hoqën dorë prej tij, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e adoptoi atë.

Pasi u shfaq Islami, Zejdi u bë mysliman i sinqertë, i devotshëm dhe pati një vend të shkëlqyer në Islam. Siç e dimë, ai u bë në fund një nga komandantët e ushtrisë islame në betejën e El Mu'tetu dhe ra dëshmor në të.

Kur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vendosi të zgjidhte një grua për Zejdin, e bisedoi me Zejneben, të bijën e Xhahshit, e cila ishte vajza e Umejetu, e bija e Abdul Mutalibit, domethënë vajza e hallës së tij. Zejnebja mendonte se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dëshironte të martohej vetë me të, prandaj u gëzua dhe u kënaq shumë. Mirëpo ajo, sapo mori vesh më pas se fejesa e saj ishte me Zejdin, u prek aq shumë, sa u frenua. Këtë fejesë e kundërshtoi fort edhe vëllai i saj, Abdullahu.

Këtu zbriti ajeti 36, duke paralajmëruar Zejneben, Abdullahun, dhe të tjerë si ata, se ata nuk mund të kundërshtojnë një urdhër që All'llahu dhe i Dërguari i Tij e shikojnë të domosdoshëm. Sapo e dëgjuan këtë, iu dorëzuan urdhrit të All'llahut.

Kjo nuk qe një martesë e lehtë, siç do ta shikojmë, madje ishte një prezantim i shkatërrimit të traditës së gabuar të

injorancës, ku asnjë grua nuk kishte pozitën dhe personalitetin e saj në shoqëri, e gatshme të bashkohej me një skllav, edhe nëse ai ishte i plotësuar me vlerat më të larta njerëzore.

Kjo martesë nuk zgjati shumë, përfundoi me divorc, si rezultat i mungesës së harmonisë dhe i konfliktit të sjelljeve të të dy bashkëshortëve, edhe pse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ngulte këmbë që kjo ndarje të mos bëhej.

Pas kësaj, me urdhrin e All'llahut, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e mori Zejneben si bashkëshorte të tij, për të kompensuar dështimin në martesën e saj. Çështja përfundoi këtu, por thashethemet dhe fjalët u shfaqën në mesin e njerëzve. Kur'ani i shkuli ato dhe me këto ajete që po komentojmë, i kuroi zemrat e tyre. Me dëshirën e All'llahut do të vijë sqarimi i kësaj çështjeje.[1]

1 Fragmente nga tefsiri "Mexhmaul Bejan", tefsiri i Kurtubijut, tefsiri "El Mijzan", tefsiri "El Kebir" dhe tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an". Po kështu, nga "Tarijkhu Ibn Hisham", vëll. 1, f. 264 dhe "El Kamilu i Ibn Ethirit", vëll. 2, f. 177.

Komentimi

Rebelimi i madh ndaj zakonit

Ne e dimë se shpirti i Islamit është dorëzimi i plotë ndaj urdhrit të All'llahut të Lartësuar. Ky kusht dhe ky kuptim është përmendur me shprehje të ndryshme në ajete të ndryshme të Kur'anit Famëlartë. Njëri ajet është ajeti i mësipërm: **"Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur All'llahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren."**.

Përkundrazi, vullnetin e tyre duhet ta bëjnë ndjekëse të vullnetit të All'llahut të Lartësuar, ashtu si e gjithë ekzistenca e tyre, nga flokët deri te këmbët janë të lidhura me Të dhe të bindura ndaj Tij.

Fjala *"kada"*, këtu ka kuptimin: caktim ligjor, ligj, urdhër, vendim dhe caktim. Është e padiskutueshme se All'llahu i Lartësuar është i Pasuri Absolut dhe Ai nuk ka nevojë për bindjen e njerëzve dhe dorëzimin e tyre. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, këtë bindje, nuk e shikonte me syrin e lakmisë, përkundrazi ajo, është për të mirën dhe interesin e tyre, sepse ata mund ta injorojnë atë për shkak të kufizimit të diturisë së tyre. Vetëm All'llahu i Lartësuar e di këtë dhe urdhëron Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që ta përcjellë atë mesazh.

Kjo situatë i ngjason situatës së mjekut të shkëlqyer, i cili i thotë të sëmurit: "Unë filloj kurimin tënd, nëse ti i bindesh

plotësisht urdhëresave të mia dhe nuk ke asnjë kundërshtim kundrejt saj. Këto fjalë bëjnë të qartë kujdesin e mjekut, për të kuruar pacientin e tij. All'llahu është më i lartë dhe më i mëshirshëm me robtë e Tij se sa ky mjek. Ajeti, për këtë çështje, ka treguar në fundin e tij: **"Kush e kundërshton All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur."**.

Ai që kundërshton urdhrin e All'llahut, nëpërmjet të Dërguarit të Tij, do të humbasë rrugën e lumturisë dhe do të zgjedhë rrugën e dështimit dhe të humbjes. Ku urdhër përmban të mirën dhe lumturinë e tij. A ka humbje më të qartë se sa kjo?!

Ajeti 37 trajton historinë e njohur të Zejdit dhe të bashkëshortes së tij, Zejnebes. Kjo ngjarje është një nga çështjet më të ndjeshme në jetën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi ka lidhje me çështjen e bashkëshorteve të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që janë përmendur në ajetet e mëparshme. Ajeti thotë: **"Ti** (o Muhammed) **i the atij, që All'llahu dhe ti vetë i keni bërë mirësi: 'Mbaje gruan tënde dhe frikësoju All'llahut!'"**.

Ajo që kuptohet me mirësinë e All'llahut të Lartësuar, është mirësia e udhëzimit dhe e besimit, që All'llahu ia pati dhënë Zejdit, të birit të Harithit, kurse prej mirësisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte liria që ai i dha atij dhe e trajtonte atë si të ishte djali i tij i dashur.

Nga ky ajet përfitohet se grindjet kishin nisur mes Zejdit dhe Zejnebes. Këto grindje zgjatën, derisa arritën në prag të divorcit. Duke shikuar me vëmendje sifjalinë: *"etekulu" - "i the*

atij", ku folja është në të shkuarën, përfitohet se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e këshillonte gjithmonë atë dhe e pengonte të divorcohej. A ishte kjo grindje, rezultat i mungesës së shanseve të barabarta të situatës shoqërore mes Zejnebes dhe Zejdit, ku ajo ishte nga një fis me famë, kurse ai ishte një skllav i çliruar? Apo ishte produkt i një lloj ashpërsie në sjelljen e Zejdit? Apo as kjo e as ajo, por prej mungesës së ekzistencës së harmonisë shpirtërore dhe morale mes atyre të dyve, pasi është plotësisht e mundur, që të dy të kenë qenë njerëz të mirë, por ata ndryshonin nga ana e sjelljes, e mendimit dhe e natyrës, saqë nuk mund të vazhdonin më një jetë të përbashkët.

Sido që të jetë çështja, problemi nuk është aq i komplikuar deri këtu.

Ajeti shton: **"Në të vërtetë, ti po fsheh në vetvete atë që All'llahu do ta nxjerrë në shesh dhe ti po u frikësohesh njerëzve, kur më e drejtë është t'i frikësohesh All'llahut.".** Komentuesit e Kur'anit këtë fjali e kanë komentuar duke theksuar tolerancën e njëri-tjetrit, në mënyrën e të shprehurit, aq sa u dha armiqve një shigjetë shpifjeje dhe përfoljeje. Nga kontekstet ekzistuese në të njëjtin ajet, nga shkaku i zbritjes dhe nga rrjedhja e ngjarjeve të historisë, del i qartë se kuptimi i ajetit nuk është as kërkesë, as hetim dhe as komplikim, sepse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte vendosur ta merrte Zejneben si bashkëshorte të tij, nëse do të dështonte pajtimi mes dy bashkëshortëve dhe çështja e tyre do të arrinte deri në divorc, prej arrogancës shpirtërore, që zbriti mbi vajzën e xhaxhait të tij, Zejnebes. Por Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte shumë

i frikësuar se njerëzit do ta poshtëronin dhe kundërshtarët e tij do të shkaktonin një zhurmë të madhe, nga të dyja anët. Po japim disa fakte, që zbërthejnë frikën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për këtë martesë:

Fakti i parë: Zejdi ishte djali i birësuar i të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Djali i birësuar, sipas traditës së injorancës, përfitonte të gjitha të drejtat si djali i vërtetë. Njëra prej tyre ishte se ata besonin në ndalimin absolut të martesës, me gruan e djalit të adoptuar.

Kurse tjetra është se, si mund të martohet Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me gruan e ndarë të skllavit të tij, të lirë, kur ai është në atë shkallë të lartë?

Në disa transmetime shfaqet se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vendosi ta zbatojë këtë çështje me urdhrin e All'llahut të Madhëruar, pavarësisht rrethanave dhe kushteve. Në pjesën më pas të ajetit, ka një kontekst të këtij kuptimi.

Në bazë të kësaj, nuk ka asnjë dyshim se kjo, jo vetëm që ishte një çështje morale dhe njerëzore, por ishte një mënyrë ndikuese e thyerjes së dy traditave të gabuara të asaj kohe të injorancës, që janë: lidhja e kurorës me gruan e divorcuar të djalit të adoptuar dhe martesa me gruan e divorcuar të robit të liruar nga skllavëria.

Është e padiskutueshme se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk duhet të frikësohet nga njerëzit për çështje të tilla, duke mos i lënë rrugë dobësisë, tronditjes dhe frikës në nxitjen e armiqve, që ata të mbanin qëndrim ndaj tij. Është normale që njeriu të sprovohet me frikë dhe mëdyshje në situata të tilla, sepse thelbi i këtyre çështjeve ishte zgjedhja e bashkëshortes dhe ishte e mundur që të shkaktonte këtë potere, për përhapjen e qëllimeve të tij të shenjta dhe për zgjerimin e Islamit. Si rrjedhojë, do të ndikonte te ata me besim të dobët dhe do të mbillte në zemrat e tyre dyshim dhe hezitim.

Për këtë, në vazhdim të çështjes, ajeti thotë: **"E, pasi Zejdi bashkëjetoi me gruan e vet dhe u nda prej saj, Ne ta dhamë ty për bashkëshorte, në mënyrë që besimtarët të mos ngurrojnë, që të martohen me gratë e të birësuarve të tyre, pasi ata ta kenë plotësuar dëshirën e tyre dhe të jenë ndarë. Urdhri i All'llahut do të përmbushet detyrimisht."**.

Fjala *"el eddijau"* është shumësi i fjalës *"da'jun"*, që do të thotë: *"djalë i adoptuar"* dhe kuptimi i fjalës *"el uataru"*, është: nevojë e rëndësishme. Zgjedhja e kësaj shprehjeje, në kuptimin e ndarjes së Zejnebes, është për një sqarim më të butë, me qëllim që të mos bëhet e qartë me fjalën divorc, që konsiderohet turp jo vetëm për gratë, por edhe për burrat, pasi duket sikur secili prej këtyre dy personave kishte nevojë për tjetrin, që të jetojë një jetë të përbashkët për një periudhë të caktuar. Ndarja e tyre ishte rezultat i përfundimit të kësaj nevoje.

Mënyra e shprehjes me: **"Ne ta dhamë ty për bashkëshorte"**, është argument se kjo ishte një martesë me

urdhrin e All'llahut. Në histori përmendet shumë se Zejnebja i mburrej me këtë çështje bashkëshorteve të tjera të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe thoshte: "Juve ju ka martuar familja juaj, kurse mua më ka martuar All'llahu nga qielli.".[1]

Ajo që meriton të shikohet me kujdes, është se Kur'ani Famëlartë e bën të qartë qëllimin kryesor të kësaj martese, anulimin e traditës injorante, që zbatohej me ndalimin e martesës me gratë e të adoptuarve. Kjo vetë tregon se numri i madh i martesave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ishte një çështje e zakonshme, e lehtë, madje kishte si qëllim për të përhapur fenë e tij në shoqëri.

Fjalia: **"Urdhri i All'llahut do të përmbushet detyrimisht."**, tregon domosdoshmërinë e vendimit të prerë në çështje të tilla, se çdo punë duhet të kryhet deri në fund, pasi nuk ka kuptim dorëzimi para zhurmës dhe poteres në çështjet që lidhen me qëllimet e përgjithshme dhe thelbësore.

Nga komentimi i qartë që përmendëm në diskutimin e ajetit të mësipërm, sqarohet se pretendimet e armiqve dhe të injorantëve, mbështetja e tyre për këtë ajet, nuk kishte asnjë kuptim.

Ajeti 38 thekson plotësimin e kërkesave të mëparshme: **"S'ka kurrfarë fajësimi për Profetin, kur bën atë që i ka urdhëruar All'llahu."**. All'llahu i Madhëruar e urdhëron atë se

1 "El Kamilu" i Ibn Ethirit, vëll. 2, f. 177. Ajo që meriton të shikohet, është se martesa e Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Zejneben është bërë në vitin e pestë të hixhretit. Burimi i mëparshëm.

nuk lejohet miklimi përballë urdhrit të Tij dhe ai duhet të zbatohet pa asnjë mëdyshje.

Pa dyshim se udhëheqësit hyjnorë nuk duhet të dëgjojnë këtë apo atë fjalë, kur zbatojnë urdhëresat hyjnore, apo kur ruajnë atmosferën e gabuar politike, kulturore dhe tradicionale, të përhapur në shoqëri. Mbase ky urdhër është dhënë për të prishur këto zakone të gabuara dhe për të shkatërruar shpikjet e shëmtuara.

Udhëheqësit hyjnorë duhet të zbatojnë urdhrin e All'llahut, pa pasur frikë nga qortimet, sharjet, poterja dhe thashethemet dhe duhet të jenë miratues, pasi ata **"...që luftojnë në rrugën e All'llahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi."**.[1]

Nëse ne duam të ulemi dhe të presim kënaqësinë e të gjithëve dhe gëzimin e tyre e pastaj të zbatojmë urdhrin e All'llahut të Madhëruar, atëherë ta dimë mirë se ky urdhër nuk mund të zbatohet, sepse disa grupe nuk kënaqen, derisa ne t'i dorëzohemi asaj që ata duan dhe të ndjekim fenë dhe mendimin e tyre, siç e thotë edhe Kur'ani Famëlartë: **"As hebrenjtë, as të krishterët nuk do të jenë të kënaqur me ty, derisa të pranosh besimin e tyre. Thuaju: 'Vetëm udhërrëfimi i All'llahut është i drejtë!' E, në qoftë se pas diturisë që të ka zbritur, ti ndjek dëshirën e atyre, atëherë askush nuk do të të ndihmonte apo mbronte nga dënimi i All'llahut."**.[2]

E tillë është edhe çështja në kuptimin e ajetit që po diskutojmë, sepse për martesën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe*

1 Sure "El Maide", ajeti 54.
2 Sure "El Bekare", ajeti 120.

bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) me Zejneben, në mendjet e të gjithë njerëzve, rrotulloheshin dy probleme. Po i rijapim edhe një herë:

Problemi i parë: Martesa me gratë e të adoptuarve, në optikën e tyre ishte njësoj si martesa me bashkëshorten e djalit të vërtetë. Kjo ishte një shpikje që duhet të anulohej.

Problemi i dytë: Martesa e një njeriu që kishte pozitë të lartë në shoqëri, si Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me gruan e ndarë të djalit të liruar nga skllavëria, konsiderohej një turp i madh, sepse e pozicionone Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe skllavin në një nivel. Kjo kulturë e gabuar duhet të shkulej dhe të çrrënjosej nga rrënjët, që në vendin e saj të mbilleshin vlerat njerëzore dhe përshtatshmëria e dy bashkëshortëve drejtohet dhe vlerësohet vetëm në bazë të Islamit, besimit dhe devotshmërisë.

Nuk ka dyshim se kundërshtimi i traditave, i zakoneve dhe çrrënjosja e kulturave dhe zakoneve trilluese dhe jo njerëzore, zakonisht shoqërohet me zhurmë dhe potere të madhe. Profetët, në mënyrë absolute, nuk duhet t'i japin rëndësi kësaj zhurme dhe potereje. Për këtë, vazhdon fjalia vijuese e ajetit: **"Kështu ka qenë ligji i All'llahut edhe për ata** (Profetë) **që kanë qenë më parë."**.

Pra, ti nuk je i vetmi i sprovuar me këtë problem, përkundrazi të gjithë Profetët u përballën me këto vështirësi, kur ata kundërshtonin traditat, ligjet e shoqërive të tyre, në përpjekjen për të çrrënjosur prej tyre themelet e zakoneve të gabuara.

Problemi i madh nuk ishte i kufizuar vetëm në luftimin e këtyre dy ligjeve injorante, madje pa dyshim se kjo martesë, përderisa kishte lidhje me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk ka asnjë dyshim se mund t'u jepte armiqve një tjetër shkak për të turpëruar veprën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të lakmonin, të shpifnin në fenë e tij.

All'llahu i Madhëruar, duke miratuar ndjekjen e vendimit të kryer për çështje të tilla thelbësore, në fund të ajetit thotë: **"...urdhri i All'llahut është vendim i detyruar të ndodhë."**.

Togfjalëshi **"vendim i detyruar"**, mund të tregojë urdhrin e patjetërsueshëm të All'llahut, por mund të tregojë ruajtjen e urtësisë dhe interesit në të. Duke u nisur nga ajeti, më e përshtatshme është që të nënkuptohen të dyja kuptimet, domethënë: urdhri i All'llahut të Lartësuar buron mbi bazën e llogarisë së hollë dhe interesit, kështu që zbatimi i tij është i padiskutueshëm, pa pyetur apo pa e vonuar.

Në historitë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë se ai u shtroi njerëzve një gosti. Kjo nuk kishte ndodhur më parë, para martesës me gratë e tij.[1]

1 Komentuesi i madh, i mëshiruari, Tabarsij, në tefsirin "Mexhmaul Bejan", transmeton: "Kur i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u martua me të, shtroi një gosti. Për asnjë grua nga gratë e tij, nuk ka shtruar gosti më të madhe se sa gostia që i shtroi asaj. Theri një dhi dhe u dha njerëzve për të ngrënë bukë dhe mish deri në fund të ditës. Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 361.

Dukej sikur ai dëshironte t'ua bënte të qartë njerëzve, se ai nuk trembet dhe as nuk i frikësohet traditave trilluese që ishin përhapur në atë mjedis, madje ai krenohej me zbatimin e këtij urdhri hyjnor, duke shtuar se dëshironte, që, nëpërmjet kësaj rruge, zëri i anulimit të kësaj tradite injorante të arrinte në veshët e të gjithëve në Gadishullin Arabik.

Dy hulumtime

1- Legjenda mashtruese

Edhe pse Kur'ani Famëlartë ishte i qartë në historinë e martesës së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Zejneben, për sqarimin e kësaj çështjeje, shpalli se synimi është luftimi i traditës injorante, në lidhje me martesën e gruas së ndarë të djalit të adoptuar. Fatkeqësisht, ajo vazhdoi të mbetej në kapitullin e shfrytëzimit të rastit të një pjese të armiqve të Islamit, të cilët u përpoqën të fabrikojnë një histori romantike prej saj, që të shëmtonin figurën e shenjtë të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Si mjet dhe shigjeta kërcënimi, përdorën hadithet e dyshimta për këtë çështje.

Është shkruar se, kur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* erdhi te shtëpia e Zejdit, që ta pyeste për gjendjen e tij, sapo u hap dera, sytë e tij shkuan te

bukuria e Zejnebes. Ai tha: "I lavdëruar qoftë All'llahu, Krijuesi i dritës! I madhëruar është All'llahu, më i miri krijues!".

Këtë fjali, armiqtë e Islamit e përdorën si një argument të lidhjes së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Zejneben, duke mos përfillur çështjen e mbrojtjes nga gjynahu dhe profecinë. Për këto fjalë, ka argumente të qarta, që i përgënjeshtrojnë këto trillime:

Argumenti i parë: Zejnebja ishte vajza e hallës së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata të dy u edukuan dhe u rritën së bashku në atë rreth shoqëror dhe vetë Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e fejoi me Zejdin. Nëse Zejnebja do ta kishte atë bukuri mbresëlënëse, duke supozuar se kishte tërhequr vëmendjen e tij, bukuria e saj nuk ishte një çështje e fshehtë për të. Martesa e tij me të nuk ishte një problem i vështirë para kësaj ngjarjeje, madje Zejnebja nuk shfaqi asnjë dëshirë të martohej me Zejdin, madje ajo e kundërshtoi hapur këtë martesë. Ajo dëshironte shumë që të ishte gruaja e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ajo u kënaq dhe u gëzua shumë, kur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shkoi për ta fejuar, duke menduar se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po kërkon dorën e saj për veten e tij. Ajo iu dorëzua urdhrit të All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, pas zbritjes së këtij ajeti kur'anor dhe u martua me Zejdin.

Me gjithë këto fakte, a mbetet ndonjë aspekt për këtë imagjinatë, se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kishte dijeni për bukurinë e Zejnebes? E çfarë aspekti ka ky mendim i gabuar, që të ketë dëshirë të martohet me të dhe nuk mund të guxojë?

Argumenti i dytë: Zejdi ia përsëriste shpesh Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndarjen me gruan e tij, Zejneben. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e këshillonte atë shpesh, që të mos e mendonte këtë çështje. Kjo vetë është një dëshmi tjetër për të pavërtetën e këtyre pretendimeve dhe trillimeve.

Nga ana tjetër Kur'ani Famëlartë e ka bërë të qartë qëllimin e kësaj martese, që të mos mbetej asnjë aspekt për thashetheme të tjera.

Gjithashtu, në ajetet e përmendura më lart, lexuam se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ua kishte frikën thashethemeve të njerëzve, për këtë martesë, kur frika e tij ndaj All'llahut, është më e merituar se frika ndaj njerëzve.

Pa dyshim se çështja e frikës së All'llahut të Madhëruar shpall se kjo martesë është bërë si zbatim i një detyre ligjore, tek ajo duhet të shtrohen të gjitha konsideratat personale, nga njëra anë, për hir të All'llahut të Lartësuar, që të vërtetohet qëllimi i shenjtë nga qëllimet e mesazhit, edhe sikur çmimi i saj të ishin plagët e gjuhës që i thoshte një grup hipokritësh. Ky ishte çmimi i rëndë që pagoi dhe vazhdon ta paguajë edhe tani Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!), në këmbim të bindjes së urdhrit të All'llahut të Madhëruar dhe anulimit të një zakoni të gabuar dhe një traditë të shpikur.

Ka edhe çaste kritike në jetën e udhëheqësve të sinqertë, të pastër, që duhet të ekspozojnë dhe të sakrifikojnë veten e tyre në akuza të këtyre njerëzve, që të vërtetohet qëllimi i tyre.

Sikur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk do ta kishte parë më parë Zejneben, nuk do ta njihte atë e Zejnebja nuk do të kishte dëshirë të martohej me të, dhe Zejdi nuk do të ishte i gatshëm të ndahej nga Zejnebja, duke lënë mënjanë çështjen e profecisë dhe të mbrojtjes nga gjynahu, do të kishte një aspekt të këtyre thashethemeve dhe fabrikimeve të gënjeshtërta. Mirëpo, duke parë mbarimin e të gjitha këtyre kushteve, situatave, bëhet e qartë se të gjitha këto fjalë janë gënjeshtra të fabrikuara.

Duhet shtuar se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka reflektuar asnjë argument apo panoramë, që tregon ekzistencën e dëshirës së veçantë të tij, për martesën me Zejneben, madje ajo është si të gjitha gratë e tjera. Mbase, në disa anë, ka qenë më pak se disa gra. Kjo është një dëshmi tjetër kronologjike për mohimin, ndalimin e këtyre trillimeve.

Në fund të udhëtimit, shikojmë domosdoshmërinë e tregimit të supozimit të një personi, që thotë, se luftimi i një traditë të tillë të gabuar është detyrë. Mirëpo çfarë nevoje e thërret Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të hyjë i vetëm në këtë arenë?

Ai kishte mundësi ta propozonte këtë çështje dhe ta sqaronte si një ligj dhe t'i detyronte të tjerët në martesën e gruas së ndarë të djalit të adoptuar.

Nga ana tjetër, kundërshtimi i traditës injorante, të gabuar, sidomos ajo që lidhet me martesën me njerëz që duken që janë në çështjen e kundërt, mund të mos jetë e pranuar me fjalë dhe rezerva ndonjëherë, ku njerëzit mund të thonë: "Nëse kjo punë do të ishte e mirë, atëherë përse nuk e ka bërë vetë ai? Përse nuk është martuar me gruan e ndarë të skllavit të tij të liruar dhe djalit të adoptuar të tij?".

Në kuptime të tilla përfundon guximi dhe kryerja praktike e të gjitha këtyre pyetjeve dhe problemeve dhe tek ata do të thyhen dhe do të zhduket ajo traditë e gabuar, duke shtuar, se kjo punë ishte vetë një sakrificë dhe altruizëm.

2- Shpirti i Islamit është dorëzimi para All'llahut

Nuk ka dyshim se pavarësia mendore dhe shpirtërore e njeriut nuk ia lejon atij që t'i dorëzohet dikujt pa asnjë kusht, sepse ai është njeri dhe është e mundur të ketë gabime dhe dyshime në shumë çështje.

Mirëpo, nëse përfundon çështja tek All'llahu, i Dituri, i Mençuri dhe te Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që flet nga ana e Tij dhe ecën me urdhrin e Tij, atëherë, nuk ka asnjë dyshim, se mungesa e dorëzimit absolut është argument i humbjes. Nuk ka as dyshimin më të vogël në urdhrat e All'llahut të Madhëruar, duke shtuar se urdhri i Tij është i ruajtur për vetë dobitë e njeriut dhe asgjë nuk i

referohet Unit të Tij të shenjtë. A ka njeri me logjikë, që t'u bjerë të mirave me këmbë, pas personifikimit të kësaj të vërtete?

Përveç kësaj, nuk ka asnjë dyshim se ne jemi prej All'llahut të Lartësuar dhe çdo gjë që ne kemi, është prej Tij. Ne nuk mund të kemi asnjë urdhër dhe vendim, vetëm se dorëzimin ndaj vullnetit dhe urdhrit të Tij. Për këtë, mes dy anëve të Kur'anit, shikon shumë ajete që flasin për këtë çështje:

Ajeti 51 i sures "En Nur", thotë: **"Ndërsa përgjigjja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek All'llahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, është: 'Dëgjojmë dhe bindemi'. Pikërisht këta janë të shpëtuarit."**.

Ajeti 65 i sures "En Nisa", thotë: **"Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht."**.

Në ajetin 125, të sures "En Nisa", lexojmë: **"Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht All'llahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin All'llahu e ka marrë për mik të ngushtë?!"**.

Fjala Islam vjen nga lënda *"et teslimu"* - që do të thotë *"dorëzim"*. Kjo tregon për këtë të vërtetë. Në bazë të kësaj, çdo njeri kënaqet me shpirtin e Islamit, aq sa ai i dorëzohet All'llahut të Madhëruar.

Nga kjo anë, njerëzit ndahen në disa kategori. Disa i dorëzohen urdhrit të All'llahut, vetëm në ato kapituj ku u

intereson atyre. Këta janë idhujtarët. E pretendojnë emrin e Islamit, por vepra e tyre është fraksionim i ligjeve të All'llahut të Lartësuar, pasi ata miratojnë: **"besojmë një pjesë dhe mohojmë një pjesë"**. Besimi i tyre është një besim për interesin e tyre, jo për All'llahun e Lartësuar.

Disa të tjerë e kanë bërë dëshirën e tyre ndjekëse të vullnetit të All'llahut. Nëse interesat e tyre të përkohshme, bien në kundërshtim me urdhrin e All'llahut të Madhëruar, ata e injorojnë atë anë dhe i dorëzohen plotësisht urdhrit të All'llahut. Këta janë besimtarët e vërtetë.

Kategoria e tretë është më lart se këta. Ata dëshirojnë vetëm atë që dëshiron All'llahu. Në zemrat e tyre nuk ka asgjë tjetër përveç asaj që do All'llahu i Madhëruar, pasi e kanë tejkaluar shkallën e lartë. Nuk urrejnë gjë, vetëm se ato që urren All'llahu.

Këta janë të veçantit, të sinqertit dhe shumë të afërt me All'llahun e Madhëruar, pasi Teuhidi ka ngjyrosur të gjithë ekzistencën e tyre, "janë mbytur" në dashurinë e All'llahut dhe janë zbukuruar me bukurinë e Tij.[1]

1 Kemi përmendur një diskutim tjetër në këtë kapitull, në fundin e ajetit 65 të sures "En Nisa".

Ajeti 39

﴿الَّذِينَ يُبَلِّغُونَ رِسَالَاتِ اللَّهِ وَيَخْشَوْنَهُ وَلَا يَخْشَوْنَ أَحَدًا إِلَّا اللَّهَ وَكَفَى بِاللَّهِ حَسِيبًا٣٩﴾

"Ata kumtuan Shpalljet e All'llahut dhe i frikësoheshin Atij e askujt tjetër përveç Tij. All'llahu mjafton si llogaritës."

Komentimi

Cilët janë përcjellësit *(el mubeligun)* e vërtetë?

Ajeti në fjalë tregon për një nga programet universale të Profetëve: **"Ata kumtuan Shpalljet e All'llahut dhe i frikësoheshin Atij e askujt tjetër përveç Tij."**.

E tillë është gjendja edhe në lidhje me ty o Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi ti nuk duhet të kesh frikë askënd në kumtimin e mesazheve të All'llahut. Kur All'llahu i Madhëruar të urdhëron ty që të shkatërrosh traditën e gabuar të injorancës, në çështjen e martesës me gruan e ndarë të djalit të adoptuar, ti nuk duhet të kesh frikë nga fjalët e këtij apo atij, për të zbatuar këtë detyrë për veten

tënde, pasi nuk ka asnjë dyshim se kjo traditë është e të gjithë Profetëve.

Puna e Profetëve, në shumë prej fazave të profecisë së tyre, zakonisht është thyerja e traditave dhe zakoneve të tilla. Sikur ata të lejojnë frikën apo dyshimin më të vogël në veten e tyre, atëherë do të dështonin në përcjelljen e mesazhit të tyre, prandaj duhet të ecin me vendosmëri dhe siguri të plotë, të kapërcejnë fjalët lënduese e të paarsyeshme të keqbërësve, të vazhdojnë rrugën e tyre, pa i dhënë rëndësi sintezës, fabrikimit të atmosferës kundër tyre, zhurmës notuese dhe komploteve të njerëzve të prishur dhe bashkëpunimin e tyre në të këqija, sepse të gjitha llogaritë janë në dorë të All'llahut të Madhëruar. Për këtë, ajeti thotë në fund: **"All'llahu mjafton si llogaritës."**.

Ai llogarit përpjekjet dhe sakrificat e Profetëve në këtë rrugë dhe u jep atyre shpërblimin për to, ashtu siç i ruan fjalët e pista, të këqija të armiqve dhe fjalët e tyre të kota, që t'i llogarisë dhe t'u japë atyre shpërblimin për to.

Fjalia: **"All'llahu mjafton si llogaritës."**, është argument që udhëheqësit hyjnorë duhet të mos kenë frikë asgjë apo askënd në përcjelljen e mesazheve, sepse All'llahu i Madhëruar është llogaritësi i mundimeve të tyre dhe është Ai që i shpërblen ata.

Hulumtime

1- Çfarë kuptimi ka fjala kumtim *(teblijg)*?

Ajo që nënkuptohet nga fjala *"et tebligu"* - *"kumtimi, përcjellja e mesazhit"*, është përçimi dhe çuarja në vend e fjalës. Kur çështja lidhet me "mesazhet e All'llahut", ajo ka kuptimin: Profetët t'u mësojnë njerëzve atë që All'llahu ua ka mësuar atyre nëpërmjet Shpalljes dhe ta përçojnë atë në zemrat e njerëzve nëpërmjet argumentimit, paralajmërimit, përgëzimit, qortimit dhe këshillës.

2- Çfarë kptimi ka fjala *"el khashjetu"*?

Fjala *"el khashjetu"*, do të thotë: *"frikë e shoqëruar me madhështim dhe respekt"*. Ndryshon nga frika e thjeshtë, nga kjo veçanti dhe karakteristikë. Ndonjëherë përdoret me kuptimin e frikës absolute.

Në shkrimet e hulumtuesit Et Tusij, ka thënie rreth dallimit mes këtyre dy shprehjeve. Në të vërtetë ai tregon kuptimin gnostik dhe jo kuptimin gjuhësor. Ai thotë: *El khashjetu* (frika e shoqëruar me respekt) dhe *el khauf* (frika), edhe pse kanë të njëjtin kuptim gjuhësor, - apo i afrohen të njëjtit kuptim-, pa dyshim se mes tyre ka dallim te njerëzit e mençur, largpamës. Dallimi është se fjala *"el khauf"*, do të thotë frikë dhe shqetësim i brendshëm prej dënimeve që e presin njeriun, si rezultat i kryerjes së gjynaheve apo si rezultat i mosbindjes ndaj All'llahut. Kjo situatë i ndodh

shumicës së njerëzve, edhe nëse ndryshojnë nivelet e tyre. Për sa i përket shkallës së tyre më të lartë, i ndodh vetëm një grupi të vogël prej tyre.

Kurse, për sa i përket *"el khashjetu"*, ajo është një situatë që e kaplon njeriun, kur percepton madhështinë e All'llahut dhe frikën se mund të mbetet larg dritave të bollëkut të All'llahut. Kjo situatë nuk u ngjet vetëm atyre që kanë qëndruar para madhështisë së All'llahut të Vetëm e të Pashoq dhe që kanë shijuar shijen e të qenit afër All'llahut.

Kur'ani e ka konsideruar këtë situatë vetëm për robtë e All'llahut, dijetarët dhe ka thënë në suren Fatir, ajeti 28: **"Robtë e Tij, dijetarët e kanë frikë All'llahun."**.[1]

3- Përgjigje për një pyetje

Mund të thuhet se ky ajet bie në kundërshtim me atë që është thënë në ajetet e mëparshme, pasi këtu thuhet se Profetët e All'llahut nuk kanë frikë askënd përveç Tij. Mirëpo, në ajetin e mëparshëm thuhej: **"Në të vërtetë, ti po fsheh në vetvete atë që All'llahu do ta nxjerrë në shesh dhe ti po u frikësohesh njerëzve, kur më e drejtë është t'i frikësohesh All'llahut."**.[2]

Përgjigjja për këtë pyetje bëhet e qartë, duke parë me kujdes dy pikat që vijojnë:

Pika e parë: Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i frikësuar nga

1 "Mexhmaul Bahrejn", Lënda "khashije".
2 Sure "El Ahzab", ajeti 37.

mungesa e mbështetjes së një numri të madh njerëzish për prishjen e kësaj tradite dhe pranimin e kësaj çështjeje. Me këtë do të tronditeshin themelet e besimit të tyre. Një frikësim i tillë i referohet frikës së All'llahut të Madhëruar.

Pika e dytë: Profetët nuk e përjetojnë gjendjen e frikës dhe të tmerrit ndaj një personi çfarëdo, në përcjelljen e mesazheve të All'llahut, kurse për sa i përket çështjeve të jetës personale, nuk ka ndonjë problem që të frikësohen nga një çështje e rrezikshme, si akuzimi dhe lëndimi i njerëzve, apo që të jenë si Profeti Musa *(Paqja qoftë mbi të!)*, që u frikësua, sipas natyrës njerëzore, kur hodhi shkopin dhe ai u shndërrua në një gjarpër të madh. Një frikë dhe një shqetësim i tillë, nëse nuk është e ekzagjeruar, nuk konsiderohet turp dhe mangësi, përkundrazi kjo çështje mund të përballë, ndonjëherë, njerëzit më guximtarë. Turpi dhe mangësia është frika ndaj zbatimit të detyrës hyjnore në jetën shoqërore.

4- A e kanë përdorur Profetët *tekijjetun* (fshehjen)?

Një seri e këtyre ajeteve na thotë se *et tekijjetu* është absolutisht e ndaluar për Profetët, në përcjelljen e mesazhit, sepse Kur'ani, në ajetin në fjalë, thotë: **"I frikësohen vetëm All'llahut e askujt tjetër pos Tij."**.

Duhet patur parasysh se fshehja *(et tekijjetu)* është shumë llojesh. Ajeti që flet për thirrjen e Profetëve dhe për kumtimin e mesazheve të All'llahut nuk mohon veçse një lloj të *et tekijjetu*, që është *et tekijjetu* nga frika.

Ajo që nënkuptohet nga "*et tekijjetu el mudaratijetu*" – "*fshehje dashamirësie*", është që njeriu të fshehë besimin e tij, ndonjëherë, për të tërhequr palën përballë, për të forcuar lidhjen e tij për bashkëpunim, në qëllime të përbashkëta.

Qëllimi i "*et tekijjetu et teurijetu*" – "*fshehjes dykuptimëshe*", është se njeriu duhet t'i fshehë prezantimet dhe planet e arritjes së qëllimit, pasi, nëse shpërndahet, përhapet mes njerëzve dhe bëhet publike, dhe armiku e kupton atë, është e mundur që të çojë në dështimin e tyre.

Nuk ka dyshim se ka një kuptim të gjerë për "*et tekijjetu*" – "*fshehjen*", që është: *Fshehja e të vërtetave dhe e realitetit për të mbrojtur qëllimet nga përplasja me rrezikun dhe shkatërrimin.* Kjo gjë është e njohur mes njerëzve të zgjuar të botës. Udhëheqësit hyjnorë e bëjnë këtë në disa faza, për të arritur qëllimet e tyre të shenjta. Këtë e lexojmë në tregimin e Profetit Ibrahim *(Paqja qoftë mbi të!)*, heroit të Teuhidit, i cili e fshehu qëllimin e tij, kur qëndroi në qytet, kur adhuruesit e statujave do të dilnin jashtë qytetit për të kryer zakonet e festës. Arsyeja se pse e fshehu qëllimin e tij, ishte që të gjente rastin e përshtatshëm për të prishur statujat e për t'i shkatërruar ato.

Po kështu edhe "besimtari i familjes së Faraonit" e fshehu besimin e tij, që të mund të ndihmonte Profetin Musa *(Paqja qoftë mi të!)* në çastet e vështira e ta shpëtonte atë nga vrasja. Për këtë shkak, Kur'ani i ka përmendur atij nëntë qëndrime dhe cilësi të mëdha.

Pavarësisht se mund të thuhet shumë për këtë çështje, ne do ta mbyllim këtë diskutim me një hadith gjithëpërfshirës nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Et tekijjetu është feja ime dhe feja e*

baballarëve të mi. Nuk ka fe ai që nuk ka et tekijjetu, sepse et tekijjetu është mburoja e All'llahut në tokë. Nëse besimtari i familjes së Faraonit do ta shfaqte hapur Islamin e tij, do të vritej.".[11]

Ne kemi pasur një diskutim të detajuar për *et tekijjetu*, në fundin e ajetit 106 të sures "En Nahl".

5- Kushti i triumfit në përcjelljen e mesazhit

Ajeti i përmendur është argument i qartë se vendosmëria, sinqeriteti dhe mungesa e frikës nga çdokush, pos All'llahut të Lartësuar, është kusht thelbësor për përparimin në fushën e informacionit dhe përcjelljes së mesazhit.

Njerëzit që kujdesen të ruajnë dëshirat dhe pasionet e kësaj apo asaj, përballë urdhrit të All'llahut, e shënjestrojnë të vërtetën dhe drejtësinë me atë që i përshtatet pasioneve të tyre, nuk do të arrijnë rezultat, pasi nuk ka mirësi më të lartë se sa mirësia e udhëzimit në Rrugë të Drejtë dhe nuk ka shërbim më të dobishëm se sa dhurimi i kësaj mirësie njerëzimit. Për këtë qëllim, shpërblimi i kësaj pune ishte më i madh se çdo shpërblim dhe dhuratë tjetër.

Lexojmë një hadith nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*: "I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më dërgoi mua në Jemen dhe më tha: *'O Ali, mos lufto askënd, derisa ta ftosh atë në*

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 521, fundi i ajetit 28 të sures "El Mu'minun".

Islam. Betohem për All'llah! Sikur All'llahu të udhëzojë me dorën tënde një njeri, është më e mirë se sa lindja dhe perëndimi i diellit.'".[1]

Për këtë shkak, kumtuesit e vërtetë duhet të mos kenë nevojë për njerëzit dhe të mos kenë asnjë pozitë apo post, sepse ajo nevojë dhe frikë do të lërë gjurmë në mendjen dhe vullnetin e tyre, deshën apo s'deshën.

Kumtuesi hyjnor mendon vetëm sipas **"All'llahu është mjaftueshëm të jetë llogaritës**", që llogaritësi i veprave dhe matësi i tyre është All'llahu i Lartësuar. Shpërblimi është në dorën e Tij. Ky mendim dhe kjo dituri është ajo që i zgjat dorën dhe e ndihmon atë në këtë rrugë të mbushur me vështirësi.

1 "Usulul Kafij", sipas veprës "Biharul Anuar", vëll. 21, f. 361.

Ajeti 40

﴿مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِنْ رِجَالِكُمْ وَلَكِنْ رَسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا.﴾

"Muhammedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i All'llahut dhe vula e Profetëve; All'llahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë."

Komentimi

Çështja e vulosjes së profetësisë

Ky është ajeti i fundit i sqarimit që ka bërë All'llahu i Madhëruar për martesën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me gruan e ndarë të Zejdit, për të vetmin qëllim, për të thyer zakonin e gabuar të injorancës. Ky ajet është përgjigjja e fundit, në fundin e të cilit, sqarohet mirë, një e vërtetë tjetër e rëndësishme që është përmbyllja e profetësisë.

N*ë* fillim ajeti thotë: **"Muhammedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj"**, as i Zejdit e as i askujt tjetër. Nëse një

ditë ia etiketojnë atij se ai është "i biri i Muhammedit", kjo është thjesht prej zakonit, traditës e asgjë tjetër. Kur erdhi Islami, këtij zakoni ia shkuli rrënjët. Lidhja e Zejdit me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk është lidhje e natyrshme familjare.

Sigurisht që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka pasur fëmijë natyralë. Emrat e tyre janë: Kasem, Tajib, Tahir dhe Ibrahim.[1] Ata, sipas transmetimit të historianëve, i dhanë lamtumirën kësaj bote dhe u larguan prej saj para se të rriteshin, të bëheshin burra, prandaj edhe nuk është thënë për ta se ishin "burra".[22]

Dy Imamët, Hasani dhe Hysejni, që njerëzit i quanin djemtë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pavarësisht se ata e kaluan moshën me vite, vazhdonin të ishin të vegjël kur zbriti ky ajeti. Duke u bazuar në këto fakte, pa dyshim se fjalia: **"Muhammedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj"**, edhe pse ka ardhur shumë kohë më parë, në të shkuarën e largët, është e vërtetë për të gjithë.

Në disa shprehje, vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Unë dhe Aliu jemi baballarët e këtij umeti."*. Është e padiskutueshme se qëllimi në këtë fjali, nuk ishte theksimi i atësisë nëpërmjet prejardhjes, por atësia që buron nga mësimi, edukimi, udhëheqja dhe udhëzimi.

1 Shiko veprën "Usdul Gabeti" dhe të libra të tjerë të historisë dhe të biografive (err rrixhal).
2 Tefsiri i "Kurtubijut" dhe tefsiri "El Mijazan", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Në këtë situatë, pa dyshim se martesa me gruan e ndarë të Zejdit, filozofinë e të cilës, e sqaroi qartë Kur'ani, që është një anulim i zakoneve të gabuara, nuk ishte ndonjë gjë që kërkonte diskutim dhe debat mes këtij dhe atij apo se ata duan të zgjedhin një mënyrë për të arritur synimet e tyre të këqija.

Ajeti 40 shton se lidhja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me ta, është vetëm nga ana e përcjelljes së mesazhit hyjnor, dhe se ai **"...është i Dërguari i All'llahut dhe vula e Profetëve..."**. Në këtë mënyrë, fillimi i ajetit e shkëputi prerazi lidhjen relative e atësore. Kurse fundi i ajetit vërteton lidhjen shpirtërore, që buron nga mesazhi hyjnor dhe vulosja e profetësisë. Nga kjo bëhet e qartë ndërlidhja e fillimit të ajetit me fundin e tij.

Ajeti na tregon këtë të vërtetë: Lidhja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me ata, në të njëjtën kohë, është më e fortë dhe më e lartë se lidhja e djalit me babain e tij, sepse lidhja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është lidhja e të Dërguarit me popullin.

Ai e di mirë se nuk do të ketë më të Dërguar tjetër pas tij. Kjo ishte një detyrë e tij, që duhet t'i sqaronte dhe t'i propozonte këtij populli çdo gjë, që do të kishte nevojë, me saktësinë dhe me kujdesin më të madh, deri në Ditën e Kiametit.

S'ka dyshim se All'llahu i Gjithëdijshëm dhe i Mirinformuar, kishte vënë në dispozicion të tij çdo gjë që ishte e nevojshme, që nga bazat, degët deri te detajet, në të gjitha

aspektet. Në fund të ajetit, All'llahu i Madhëruar thotë: **"All'llahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë."**.

Duhet të theksojmë se togfjalëshi *"khatemul enbijai"*, do të thotë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është vula e të Dërguarve dhe lajmëtarëve. Ajo që disa shpikës të feve kanë thënë se Kur'ani e ka konsideruar Profetin Muhammed *"khatemul enbijai"* dhe jo *"khatemul murselijne"*, është një e pavërtetë e madhe, sepse ai është vulë e të gjithë të Dërguarve dhe lajmëtarëve të All'llahut të Madhëruar.

Në bazë të kësaj, pa dyshim se All'llahu i Lartësuar, nëse e ka quajtur Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si vulën e të Dërguarve, atëherë si është e mundur, që të mos jetë vulë e Profetëve? All'llahu e ka quajtur Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* "vula e Profetëve", atëherë është e padiskutueshme që ai të jetë, gjithashtu, edhe vula e të Dërguarve. Pa dyshim se lidhja mes Profetit dhe të Dërguarit bazohet te *el umumu uel khususul mutlak* (e përgjithshmja dhe e veçanta absolute). Pra, jo të gjithë Profetëve e Dërguar nga All'llahu u ka zbritur Shpallja.

Hulumtime

1- Çfarë është vula?

Fjala *"el khatemu"* - *"vula"* është njësoj si fjala *"hatemun"*. Kuptimi gjuhësor i saj është: gjëja me të cilën përfundohen çështjet. Po kështu, vjen me kuptimin e diçkaje me të cilën vulosen dokumentet, e ngjashme me të.

Kjo çështje ka qenë e zakonshme jo vetëm më parë, por vazhdon edhe sot. Kur duan të mbyllin një letër, apo kapakun e enës, apo derën e shtëpisë, që të mos e hapë njeri, ata vendosin një lëndë ngjitëse mbi derë apo mbi dry dhe e vulosin atë. Kjo bëhej vulë e fortë, saqë duhet ta thyeje vulën, që të hapje derën. Kjo lëndë që vihet në gjëra të tilla, quhet "vulë".

Në të kaluarën, për këtë çështje, përdornin baltën e ngjeshur që ngjit. Në tekstet e librave të njohur të gjuhës, ne lexojmë se kuptimi i vulës është: "ajo që vihet mbi baltë".[1]

E gjitha kjo, për shkak se kjo fjalë rrjedh nga fjala *"el khatmu"*, domethënë fundi. Përderisa kjo punë, domethënë fundi, zhvillohej në fund, atëherë, për të, u përdor emri *"el khatemu"* - *"vula"*.

Do të shikojmë se një nga kuptimet e fjalës *"vulë"* - *"khatem"*, është edhe për unazën që vihet në gisht, sepse ata vendosnin firmën dhe vulën e tyre mbi unazat e tyre dhe vulosnin letrat me to. Prandaj, të gjitha çështjet që përmenden në

1 "Lisanul arab", lënda "khateme".

situatat e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të Imamëve të udhëzimit dhe personaliteteve të tjera, është gdhendja e unazave të tyre.

Kulejni transmeton një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Unaza e të Dërguarit të All'llahut ishte prej argjendi. Në të ishte gdhendur 'Muhammedi, i Dërguari i All'llahut.'"*.[1]

Në disa libra të historisë tregohet për një nga ngjarjet e vitit të gjashtë të hixhretit. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* zgjodhi një unazë për veten e tij dhe e gdhendi atë. Këtë veprim e bëri, pasi i thanë, se mbretërit nuk i lexojnë letrat, nëse nuk është e vulosur.[2]

Në librin "Et Tabakat" thuhet se, sapo Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vendosi ta përhapë ftesën e tij në horizonte dhe t'i shkruante mesazhe mbretërve dhe sulltanëve të tokës, urdhëroi që t'i bënin një unazë, ku të shkruhej: "Muhammedi, i Dërguari i All'llahut". Me këtë unazë vuloste letrat e tij.[3]

Me këtë sqarim, bëhet e qartë se fjala *"khatem"*, edhe nëse përdoret për unazat e zbukurimit, rrënja është marrë nga fjala *"el khatem"*, domethënë, fundi. E përdornin në ato kohë për unazat që vulosnin letrat.

Duhet të shtojmë se kjo fjalë është përdorur në Kur'anin Famëlartë në kapituj të ndryshëm dhe të gjitha me kuptimin "fundi apo përfundimi", "mbyllja", si për shembull: **"Sot Ne do**

1 E ka përmendur këtë hadith edhe Bejhakiu, në zinxhirin e transmetimit të tij, vëll. 10, f. 128.
2 "Sefinetul Bihar", vëll. 1, f. 376.
3 "Et Tabakatul Kubra", vëll. 1, f. 285.

t'ua vulosim atyre gojët e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë.".[1]

Dhe: **"All'llahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh."**.[2]

Prej këtej mësohet se ata që dyshuan në argumentimin e këtij ajeti, që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është vula e Profetëve dhe mbarimi i zinxhirit të Profetëve, nuk e kuptojnë plotësisht kuptimin e kësaj fjale, ose ata pretenduan mungesën e informacionit dhe të diturisë për të, sepse nuk ka dyshim se ai që ka sadopak informacion për kulturën arabe, duhet ta dijë se fjala *"khatemu nebijjine" - "vula e Profetëve"* tregon përfundimin, vulosjen.

Nëse për komentimin e këtij ajeti thuhet diçka tjetër që nuk është ky komentim, pa asnjë dyshim se ai është një komentim i pasaktë.

Nëse themi se Profeti i Islamit ishte vula e Profetëve, se ai ishte zbukurimi i Profetëve, sepse unaza është një mjet zbukurues për njeriun dhe nuk mund ta paralelizojë njeriun në gradë, atëherë e kemi degraduar pozitën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e kemi zbritur gradën e tij në nivelet më të ulëta, edhe pse ai nuk i përshtatet kuptimit gjuhësor.

Kjo fjalë, kudo që është përdorur në Kur'anin Famëlartë, në tetë kapituj, ka dhënë kuptimin e përfundimit dhe të mbylljes.

---

1 Sure "Ja Sin", ajeti 65.
2 Sure "El Bekare", ajeti 7.

2- Argumentet tregojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është vula e Profetëve

Pavarësisht se ajeti i përmendur mjafton për të miratuar këtë fakt, se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është vula e Profetëve dhe e të Dërguarëve, edhe ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë kanë treguar për këtë kuptim, duke shtuar edhe transmetime të shumta, që janë përmendur për këtë çështje.

Një prej tyre është ajeti 19 i sures "El En'am": **"...Ky Kur'an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet..."**. Hapësira e gjerë e nocionit të shprehjes: **"kujtdo që i përcillet"**, bën të qartë mesazhin botëror të Kur'anit dhe të Profetit të Islamit nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, çështjen e vulosjes së profetësisë.

Ka edhe ajete të tjera që vërtetojnë universalitetin e mesazhit të Profetit të Islamit për të gjithë njerëzimin, si: **"I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët."**.[1]

Dhe: **"Ne të kemi dërguar ty** (o Muhammed) **vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë."**.[2]

Dhe: **"Thuaj** (o Muhammed)**: 'O njerëz, unë jam i Dërguari i All'llahut për të gjithë ju...'"**.[1]

1 Sure "El Furkan", ajeti 1.
2 Sure "Sebè", ajeti 28.

Duke vënë re gjerësinë e fjalëve: *"alemijne" - "botëve"*, *"nas" - "njerëzve"* dhe *"kaffetun" - "për të gjithë"*, përforcohet ky kuptim. Duhet të shtojmë se mendimi i përbashkët i dijetarëve të Islamit, nga njëra anë, rëndësia e kësaj çështjeje te myslimanët, nga ana tjetër, transmetimet e shumta nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe pjesa tjetër e Imamëve të udhëzimit, nga ana e tretë, e bëjnë të qartë këtë çështje.

Këtu do të mjaftohemi me përmendjen e disa hadithe si dëshmi për këtë çështje:

a- Në një hadith të njohur nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Hallalli im është hallall deri në Ditën e Kiametit, harami im është haram, deri në Ditën e Kiametit."*.[24]

Nuk ka asnjë dyshim se kjo shprehje sqaron qartë vazhdimësinë e këtij ligji, deri në fund të kësaj bote.

Ndonjëherë është transmetuar ky hadith, në këtë mënyrë: *"Hallalli i Muhammedit është hallall gjithmonë, deri në Ditën e Kiametit dhe harami i tij është haram gjithmonë, deri në Ditën e Kiametit, as nuk do të ketë njeri si ai, e as nuk do të vijë njeri tjetër si ai."*.[35]

b- Hadithi i njohur me emrin "Hadithul Menzileti", është përmendur në libra të ndryshëm të shi'itëve dhe të sunitëve. Ky hadith tregon historinë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i*

1 Sure "El A'raf", ajeti 158.
2 "Biharul Anuar", vëll. 2, K. 31, Hadithi 17, f. 260.
3 "Usulul Kafij", vëll. 1, kreu "el bid'a, er ra;ju dhe el mekajisu", hadithi 19.

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), kur u nis në luftën e Tebukut. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* të qëndronte në Medine, në vend të tij. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nëpërmjet kësaj thënie, e bën të qartë çështjen e vulosjes: "*Ti je në gradë me mua, siç ishte Haruni me Musain, vetëm se pas meje nuk ka më Profet.*".[1]

c- Ka edhe një hadith tjetër të njohur që është transmetuar nga shumë burime të Ehli Suynetit. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Shembulli im dhe shembulli i Profetëve të tjerë është si shembulli i një burri që ka ndërtuar një ndërtesë, e përsosi dhe e zbukuroi atë. Njerëzit nisën të sillen rrotull saj, duke thënë se nuk kishin parë ndërtesë më të bukur se sa kjo, përveç kësaj tulle. Unë isha ajo tullë.*".

Ky hadith është përmendur në Sahihun e Muslimit, me shprehje të ndryshme. Është transmetuar nga shumë transmetues hadithesh.

Në fund të hadithit të përmendur më parë, është përmendur kjo fjali: "*Unë jam vula e Profetëve.*".

Shohim në fund të një hadithi tjetër: "*Erdha dhe vulosa Profetët.*".[2]

---

1 Këtë hadith e ka transmetuar: Muhibudin et Tabari, në veprën "Dhekhairul Ukba", f. 79, botim i bibliotekës së Kudsit; Ibn Haxheri, në veprën "Sauaikul Muhrika", f. 177, botim i bibliotekës së Kajros; "Tarijkhu Bagdad", vëll. 7, f. 452, botim i shtëpisë botuese "Es Seadetu". Gjithashtu, është transmetuar edhe në libra të tjerë, si: "Kenzul Ummal", "Muntekhab Kenzul Ummal" dhe "Jenabiul Meudetu." Për më tepër sqarim rreth "Hadithul Menzileti", shiko këtë komentim, fundi i ajetit 144 i sures "El A'raf".

2 "Sahihul" Muslim, vëll. 4, f. 1790-1791, kreu i përmendjes së të qënurit të tij vula e Profetëve nga libri "El Fadailu".

Ky hadith është përmendur edhe në: Sahihun e Buhariut, libri "El Menakibu", "Musnedi" i Ahmed ibn Hanbel, "Es Sunenu" i Tirmidhiut dhe i Nisaiut dhe në libra të tjerë. Ai është nga hadithet e njohura. E kanë përmendur atë komentuesit e të dyja grupeve, si: Tabersiu në "Mexhmaul Bejan", Kurtubiju në tefsirin e tij, në fundin e ajetit që po komentojmë.

ç- Në shumë fjalime të veprës "Nehxhul Belaga", është përmendur qartë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është vula e Profetëve. Në Fjalimin 173, në përshkrimin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si Profeti i Islamit, thuhet: *"Besniku i Shpalljes së All'llahut, vula e të Dërguarve të Tij, përgëzuesi i mëshirës së Tij dhe paralajmëruesi i hakmarrjes së Tij."*.

Në fjalimin 133 thuhet: *"All'llahu e dërgoi, pasi një kohë ishte ndërprerë dërgimi i Profetëve, kur kishte shumë thashetheme. Me të All'llahu shteroi zinxhirin e Profetëve dhe e përmbushi Shpalljen."*.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, në fjalimin e parë, në "Nehxhul Belaga", pasi numëroi mësimet e Profetëve të mëparshëm, thotë: *"All'llahu i Madhëruar e dërgoi Muhammedin si Profet të Vetin, për të përmbushur premtimin e dhënë dhe për të plotësuar misionin e Profetësisë."*

d- Në fund të fjalimit të Lamtumirës, që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e mbajti në Haxhin e fundit të tij, është përmendur çështja e vulosjes së Profetësisë. Ky fjalim është kështillë gjithëpërfshirëse për njerëzit. Midis të tjerash ka thënë: *"Ai që është dëshmitar, t'ua përcjellë mesazhin atyre që mungojnë, se nuk ka më Profet pas meje dhe as ymet pas ymetit tuaj."* Pastaj ngriti duart e tij në qiell, derisa iu

duk pjesa e bardhë e sqetullës dhe tha: *"O All'llah, ji dëshmitar, se unë e përcolla mesazhin!"*.[1]

dh- Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"All'llahu i vulosi Profetët me Profetin tuaj dhe nuk do ketë kurrë më Profet pas tij. Me librin tuaj, vulosi librat e tjerë, prandaj nuk ka kurrë më libër pas tij."*.[2]

Pa dyshim se hadithet e përmendura për këtë çështje janë shumë. Një pjesë e tyre janë mbledhur në librin "Mealimu Nubuveti", të marra nga libra të dijetarëve të mëdhenj të Islamit. Numri i tyre shkon n*ë* 135 hadithe të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nga Imamët e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*.[3]

Përgjigje për disa pyetje

a) Si harmonizohet vulosja me rrugëtimin e njeriut drejt përsosmërisë?

Pyetja e parë që shtrohet në këtë diskutim, është: A mund të ndalojë shoqëria njerëzore? Vallë, a ka një kufi të caktuar për rrugëtimin e njeriut drejt përsosmërisë? A nuk po e shikojmë me sytë tanë se njerëzimi sot, në dituri dhe kulturë, ka arritur një pikë shumë të lartë, saqë ka kaluar standardin e të parëve të tyre? E bashkë me këtë, si mund të mbyllet në mënyrë absolute regjistri i

1 "Biharul Anuar", vëll. 21, f. 381.
2 "Usulul Kafij", vëll. 1, kreu "Imamët u ngjasojnë atyre që kanë kaluar më parë", f. 3.
3 "Mealimu Nubuveti", kreu i teksteve që thonë se Profeti Muhamed është vula e të gjithë Profetëve.

profecisë dhe njeriu të ndalohet nga udhëheqja e Profetëve të rinj në rrugëtimin e tij drejt përsosmërisë?

Përgjigjja për këtë pyetje qartësohet, duke e kthyer shikimin në një çështje të vetme, që është: Njeriu arrin fazën e pjekjes mendore dhe kulturore dhe bëhet i aftë të vazhdojë rrugën e tij, me ndihmën e vazhdueshme, me bazat dhe mësimet që ia ka lënë atij Profeti i fundit, në formë të përgjithshme, pa pasur nevojë për ndonjë legjislacion të ri.

Kjo çështje i ngjason plotësisht situatës, kur njeriu, gjatë edukimit dhe arsimimit të tij, ka gjithmonë nevojë për mësues. Kur të marrë doktoraturën apo të bëhet i aftë në dije apo shkenca të tjera të ndryshme, atëherë ai nuk ka më nevojë të mësojë nga një profesor i ri, madje e argumenton, e vërteton vetë problemin, duke u mbështetur në atë që ka përfituar nga profesorët e mëparshëm e në mënyrë të veçantë nga profesori i fundit.

Me një mënyrë tjetër të shprehuri, themi: Ai i zgjidh problemet dhe vështirësitë që i dalin, duke u mbështetur tek ato baza totale, të cilat i ka mësuar nga profesori i tij i fundit. Në bazë të kësaj, ai nuk ka nevojë që të shfaqet një fe e re, me kalimin e kohës.

Secili Profet i mëparshëm përgatiti njërën anë të rrugëtimit të përsosjes, që njeriu të jetë i aftë në rrugëtimine kësaj rruge të vështirë drejt përsosjes dhe të marrë meritat në pritjen e metodës së plotësuar të kësaj rruge në dorën e një Profeti tjetër, që është dërguar nga All'llahu i Lartësuar.

Është e padiskutueshme se me t'u marrë në dorëzim harta e plotë dhe plani total, nuk do jetë nevoja për një projektues tjetër.

Kjo është shprehja që është përmendur në transmetimet që tregojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është vula e Profetëve, që e ka konsideruar Profetin e Islamit tullën e fundit, apo vendosësin e tullës së fundit në kështjellën e përcjelljes së mesazhit të Shpikësit, të Mençurit. E gjitha kjo plotëson mungesën e nevojës për një fe të re dhe një legjislacion të ri.

Për sa i përket çështjes së udhëheqjes dhe të drejtimit, që ka kuptimin e nderimit të plotë në zbatimin e këtyre bazave themelore dhe marrjen për dore e njerëzve në këtë rrugë, është një çështje tjetër, që njeriu nuk mund të përfitojë prej saj në çdo kohë. Për këtë, mbyllja e zinxhirit të profecisë nuk do të thotë kurrë fundi i zinxhirit të udhëheqjes, sepse "qartësimi" dhe "sqarimi", këto baza themelore dhe "vërtetimi i tyre nga jashtë", nuk mund të plotësohet pa mbështetjen e ekzistencës së një udhëheqësi dhe Imami të mbrojtur nga gjynahet.

b) Si harmonizohen ligjet e pandryshueshme me nevojat e ndryshueshme?

Duke lënë mënjanë çështjen e rrugëtimit të përsosjes së njerëzimit, ka një pyetje tjetër, që shtrohet: Ne e dimë se nevojat, kërkesat e krizës dhe mundësitë janë të ndryshme. Thënë ndryshe: pa dyshim se nevojat e njeriut janë në ndryshim të vazhdueshëm, në kohën kur për sheriatin e vulosur ka ligje fikse, por a janë kaq të forta këto ligje fikse, sa të sigurojnë nevojat e ndryshueshme të njeriut me kalimin e kohës?

Mund t'i përgjigjemi mirë kësaj pyetjeje, duke parë këtë çështje: Sikur të gjitha ligjet e Islamit të merreshin me çdo çështje të pjesëshme, atëherë do të kishte hapësirë për këtë pyetje. Mirëpo, ne e dimë se në Islam ka një zinxhir të bazave themelore, të cilat kanë mundësi të plotësojnë nevojat e ndryshueshme dhe t'i garantojnë ato. Atëherë, nuk mbetet ndonjë aspekt për këtë problem.

Me të vërtetë, ne shikojmë modernizimin e paketave të reja të transaksioneve dhe lidhjet e të drejtave mes njerëzve, që nuk ekzistonin në kohën e zbritjes së Kur'anit. Për shembull, në atë kohë nuk kishte ndonjë gjë me emrin: "garanci", me gjithë degët e saj të shumta, po kështu, llojet e agjencive, të cilat janë shfaqur në kohën tonë, sipas nevojës së përditshme.

Ne kemi në Islam një bazë të përgjithshme, që është përmendur në fillim të sures "El Maide", besnikëria në premtime dhe marrëveshje: **"O ju që keni besuar, mbani premtimet** (përmbajuni kontratave)**."**.

Sigurisht, në Islam ka kualifikime dhe kushte në formë të përgjithshme, që janë vënë për këtë bazë dhe duhet të merren në konsideratë.

Në bazë të kësaj, ligji total është i vendosur, pavarësisht miratimeve të tij të ndryshueshme, si rrjedhim, nuk ka ndonjë pengesë që të shfaqet një miratim tjetër për të çdo ditë.

Marrim një shembull tjetër: Në Islam kemi një ligj të diskutueshëm, që është ligji nuk ka dëm *(la darar)*. Nëpërmjet tij, mund të përcaktohet çdo ligj që është burim dhe rrjedhojë i dëmit dhe i humbjes në shoqëri. Nga kjo mënyrë ngrihen shumë prej

nevojave, duke shtuar edhe se çështjet: "domosdoshmëria e ruajtjes së shoqërisë", "obligimi i përparësisë së detyrës" dhe "paraprirja e më të rëndësishmes ndaj të rëndësishmes", mund të jenë zgjidhje të problemeve në shumë prej kapitujve.

Përpos gjithë kësaj, kompetencat që i jepen qeverisë islame nëpërmjet "mbrojtjes së juristit", vë në dispozicion të saj fuqi të mëdha për zgjidhjen e problemeve, në kornizën e bazave të përgjithshme islame.

Sqarimi i këtyre çështjeve, duke e marrë në konsideratë kapitullin e jurisprudencës, domethënë derivimin e ligjeve hyjnore nga burimet islame, ka nevojë për diskutim të gjerë. Trajtimi i tij na largon ne nga tema. Megjithatë, ajo që përmendëm këtu nga kapitulli i tregimit, mund të jetë një përgjigje për problemin e përmendur.

3- Si mund të privohet njerëzimi nga mirësia e lidhjes me botën e të padukshmes *(el gajbu)*?

Pyetja tjetër: Me të vërtetë, zbritja e Shpalljes dhe lidhja me botën e të padukshmes dhe përtej natyrshmërisë konsiderohet një dritare shprese për të gjithë besimtarët e vërtetë. Nw shtesw tw kwsaj, kjo është dhuratë dhe krenari për njerëzimin. A nuk konsiderohet ndwrprerja e kwsaj lidhjeje dhe mbyllja e kwsaj dritareje njw privim I madh pwr njerwzimin pas vdekjes së vulës së Profetëve, Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje qartësohet duke parë dy pikat më të afërta, që janë:

E para: Shpallja dhe lidhja me botën e padukshme *(el gajbu)* është një mënyrë për të kuptuar të vërtetat e asaj që janë sqaruar, nevojat dhe të vërtetat deri në Ditën e Kiametit, në bazat e përgjithshme dhe mësimet e përmbledhura, të cilat i vuri vula e Profetëve, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Prandaj, këputja e rrugës së lidhjes nuk krijon ndonjë problem.

E dyta: Ajo që ndërpritet përgjithmonë pas vulosjes së profecisë, është shpallja e një legjislacioni të ri, apo për të plotësuar legjislacionin e vjetër, nuk janë të gjitha llojet e lidhjes përtej botës së natyrshme, sepse për Imamët ka një lidhje me botën e padukshme. Po kështu, edhe besimtarët e vërtetë, të cilët kanë larguar perden nga zemrat e tyre dhe kanë arritur në pozitën e shpalljes dhe të dëshmisë, si rezultat i edukimit të shpirtrave të tyre.

Filozofi i njohur Sadru Mute'lihine Shirazij, në veprën "Mefatijhul Gajbi", thotë: "Dije se nëse Shpallja ndërpritet e nëse bllokohet dera e mesazhit, njerëzit nuk do të kenë nevojë për të Dërguarit dhe shfaqjen e thirrjes, pas ardhjes së argumentit të saktë dhe plotësimit të fesë. All'llahu i Lartësuar ka thënë: **"Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj."**.[1] Për sa i përket portës së frymëzimit, ajo nuk bllokohet dhe zgjatja e dritës hyjnore nuk ndërpritet, për shkak të nevojës së njerëzve, kur ata jetojnë në këto ngacmime të përkujdesjes dhe të përkujtimit. All'llahu i Lartësuar

1 Sure "El Maide", ajeti 3.

e ka mbyllur derën e Shpalljes dhe ka hapur derën e frymëzimit, si mëshirë prej Tij për robtë e Tij.[1]

Kjo lidhje lind zakonisht nga: lartësia e nefsit, ngritja e shpirtit, pastrimi i saj dhe i stomakut. Ajo nuk ka lidhje me çështjen e profecisë dhe të mesazhit. Në bazë të kësaj, kur të vërtetohen përparësitë dhe kushtet e tij, do të gjendet kjo lidhje shpirtërore. Me këtë nuk ka pasur dhe nuk do të ketë asnjë njeri të privuar nga bollëku i madh. (Mendoni mirë!)

1 Tefsiri "Mefatijhul Gajbi", f. 13.

Ajetet 41 – 44

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اذْكُرُوا اللَّهَ ذِكْرًا كَثِيرًا٤١ وَسَبِّحُوهُ بُكْرَةً وَأَصِيلًا٤٢ هُوَ الَّذِى يُصَلِّى عَلَيْكُمْ وَمَلَائِكَتُهُ لِيُخْرِجَكُمْ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ وَكَانَ بِالْمُؤْمِنِينَ رَحِيمًا٤٣ تَحِيَّتُهُمْ يَوْمَ يَلْقَوْنَهُ سَلَامٌ وَأَعَدَّ لَهُمْ أَجْرًا كَرِيمًا٤٤﴾

“O ju që keni besuar, përmendeni shpesh All’llahun!”

“Dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!”

“Është Ai që ju bekon, ndërkohë që melekët e Tij luten për ju, me qëllim që Ai t’ju nxjerrë nga errësira në dritë. Ai është Mëshirues ndaj besimtarëve.”

“Përshëndetja e tyre, kur ta takojnë Atë, është ‘Paqe’. Ai u ka përgatitur atyre shpërblim bujar.”

Komentimi

Përshëndetja e All'llahut dhe e engjëjve është lehtësim për besimtarët

Ajetet e mëparshme folën për përgjegjësitë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe detyrat e tij të rënda, që kishte mbi shpatulla. Ajetet që po komentojmë, sqarojnë njërën anë të detyrave të besimtarëve, me qëllim përgatitjen e kushteve të domosdoshme për përcjelljen e mesazhit dhe për zgjerimin e skajeve të tij, në të gjitha dimensionet. Për këtë, ajetet e adresojnë bisedën tek të gjithë. Dy ajetet e para, prej ajeteve në fjalë thonë: **"'O ju që keni besuar, përmendeni shpesh All'llahun'. 'Dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!'"**

Meqenëse faktorët e pavëmendshmërisë në jetën materiale janë të shumta dhe shigjeta e cytja e shejtanëve lëshohet nga çdo anë drejt njeriut, atëherë nuk ka asnjë mënyrë luftimi të tyre përveç se duke përmendur sa më shumë All'llahun.

Me të vërtetë, "përmendja e shumtë", me kuptimin e plotë të fjalës, do të thotë drejtimi nga All'llahu i Madhëruar me të gjithë qenien, jo vetëm me fjalë goje.

"Përkujtimi sa më shpesh", është ajo që hedh dritë mbi të gjitha punët e njeriut dhe i mbulon ato me dritë. Për këtë, Kur'ani ka urdhëruar çdo besimtar në këtë ajet, që ta përmendë All'llahun në çdo situatë. Pra, përkujtojeni All'llahun gjatë adhurimit, me zemër dhe me sinqeritet.

E përkujtoni All'llahun, kur i afroheni një gjynahu dhe largojuni atij. Nëse papritur bëni një hap të gabuar, atëherë bëni hapin e parë drejt pendimit dhe kthehuni në Rrugën e Drejtë.

Përmendeni All'llahun në mirësi dhe falënderojeni për to. Përmendeni All'llahun në fatkeqësi, durojini dhe përballojini ato.

Përmbledhja: Mos e harroni përmendjen e All'llahut në çdo skenë të skenave të jetës. Largohuni nga çdo gjë që shkakton zemërimin e Tij dhe afrohuni në gjithçka që sjell kënaqësinë e Tij.

Në "Sunenin" e Tirmidhiut, dhe në "Musnedin" e Ahmedit përmendet një hadith i transmetuar nga Ebu Said El Khuderij, i cili thotë: Kur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është pyetur: *"Cilët adhurues janë në gradën më të preferuar tek All'llahu, në Ditën e Kiametit?"*, ai është përgjigjur: *"Ata që e përmendin shumë All'llahun."*.

Ebu Saidi ka thënë: E kam pyetur Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"O i Dërguari i All'llahut, kush është luftëtari në rrugë të All'llahut?!"* Ai u përgjigj: *"Edhe sikur jobesimtarët dhe idhujtarët ta godasin me shpatën e tyre, derisa t'u thyhet shpata dhe të rrjedhë gjak, ata që përmendin shumë All'llahun, do të jenë më lart në gradë se ai."*.[1] E kjo për shkak se lufta e sinqertë nuk mund të bëhet pa përmendur shumë All'llahun.

Nga këtu mësohet se përmendja shumë e All'llahut ka një kuptim të gjerë. Në disa transmetime mësojmë se madhërimi që i bënte Fatime Zahraja *(Paqja qoftë mbi të!)* All'llahut të Madhëruar,

1 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthur", sipas transmetimit të tefsirit "El Mijzan", vëll. 16, f. 353.

ishte: 34 herë All'llahu Ekber (All'llahu është më i Madhi!), 33 herë Elhamdulilah (Falënderimi i qoftë All'llahut!), 33 herë SubhanAll'llah (I madhëruar është All'llahu!).

Sipas fjalës së disa komentuesve, përmendja e All'llahut realizohet duke listuar emrat e All'llahut dhe duke e mbajtur All'llahun larg asaj që nuk përshtatet me Të.

Ashtu siç shfaqet qartë nga konteksti i ajeteve, ajo që nënkuptohet nga "madhërimi i All'llahut", çdo mëngjes e mbrëmje, është vazhdimësia e madhërimit dhe përmendja e këtyre dy kohëve në mënyrë të veçantë, duke i konsideruar ato si fillimin dhe mbarimin e ditës. Disa komentues kanë thënë se kuptimi janë dy namazet e mëngjesit dhe të ikindisë, të pasdites, ose të ngjashëm me të, pasi ajo është njësoj si përmendja e miratuar.

Për këtë , s'ka dyshim se përmendja e shpeshtë e All'llahut dhe madhërimi i Tij, mëngjes e mbrëmje nuk arrihet vetëm se me vazhdimësinë e drejtimit kah All'llahut, mbajtja e Tij larg çdo të mete dhe mangësie dhe shenjtërimi i Tij në lidhje të vazhdueshme, pasi përmendja e All'llahut është ushqim për shpirtin e njeriut, ashtu si buka dhe pija është ushqim për trupin.

Në ajetin 28 të sures "Er Rra'd" thuhet: **"Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e All'llahut!"**.

Rezultati i këtij qetësimi të zemrës është ajo që thuhet në ajetet 27-30 të sures "El Fexhr": **"O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai i kënaqur me ty! Bashkohu me robtë e Mi dhe hyr në Xhennetin Tim!"**.

Ajeti i mëpasshëm, prej ajeteve në fjalë, është ekuivalent i rezultatit dhe arsyes finale të madhërimit: **"Është Ai që ju bekon, ndërkohë që melekët e Tij luten për ju, me qëllim që Ai t'ju nxjerrë nga errësira në dritë. Ai është Mëshirues ndaj besimtarëve."**. Pra, lutja e melekëve do t'ju nxjerrë nga errësirat e idhujtarisë, të mosbesimit dhe të injorancës drejt dritës së besimit, diturisë dhe devotshmërisë. Për shkak të kësaj mëshire, All'llahu e udhëzon njeriun duke e drejtuar kah Rruga e Drejtë dhe i ka urdhëruar melekët e Tij që ta ndihmojnë njerëzimin.

Fjala *"jusal'li"* rrjedh nga fjala *"salatun"* dhe këtu ka kuptimin e *"ruajtjes dhe të kujdesit të veçantë"*. Ky kujdes, për sa i përket All'llahut të Lartësuar, do të thotë zbritja e mëshirës, kurse në lidhje me engjëjt, do të thotë lutje, duke kërkuar falje. Lutja e mëshirës është ashtu siç e lexojmë në ajetin 7 të sures "El Gafir": **"Ata** (melekë)**, që e mbajnë Fronin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata lypin falje për besimtarët, duke thënë: 'O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin Rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit të Zjarrit flakërues!"**.

Ky ajet përmban një përgëzim të madh për besimtarët që e përmendin vazhdimisht All'llahun.

Folja *"jusal'li"*, që është në kohën e tashme, tregon vazhdimësinë e veprimit. Ajeti e thotë qartë se besimtarët nuk janë të vetmit që ecin drejt All'llahut, që ecin nën hijen e mëshirës së All'llahut, por edhe melekët e Tij ecin nën hijen e kësaj mëshire. Nga kjo ecje largohen perdet e errësirës, kurse zemrat dhe

shpirtrat e tyre zhyten në dritën e diturisë, të mençurisë, të besimit dhe të devotshmërisë.

Ky ajet është përgëzim i madh për çdo njeri që zgjedh rrugën e vërtetë, sepse atje ka një forcë të madhe tërheqëse nga ana e atij që pëlqehet, dëshirohet, i cili e tërheq të dashurin drejt saj, që përpjekja e këtij të dashuruari të përfundojë me rezultat konkret dhe të mos shkojë dëm.

Ky ajet është garanci për të gjithë luftëtarët në rrugë të All'llahut, që të mos i zërë betimi i shejtanit në mashtrimin e bijve të Ademit, sepse ata janë në gradën e të sinqertëve. Shejtani ka shfaqur dobësinë e tij në humbjen e këtij grupi, që herën e parë: **"Ai tha: 'Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robve të Tu të mbrojtur.'"**.[1]

Fjalia: **"Ai është Mëshirues ndaj besimtarëve."**, tregon se All'llahu është gjithmonë i mëshirshëm me besimtarët. Kjo është një garanci e përsëritur, që thuhet në fillim të sures.

Kjo është mëshira e All'llahut, që i nxjerr besimtarët nga errësira e imagjinatave, e pasioneve dhe e cytjeve djallëzore dhe i udhëzon drejt dritës së besimit, ekuilibrit dhe kontrollit ndaj vetes. Sikur të mos ishte mëshira e All'llahut të Madhëruar, kjo rrugë e mbushur me kthesa dhe bllokada, nuk do të ishte e kalueshme.

Ajeti i fundit prej ajeteve që po komentojmë, sqaron pozitën e besimtarëve dhe shpërblimin e tyre, me mënyrën më të mahnitshme të mishërimit e me shprehjen më të shkurtër. Ai

1 Sure "Sad", ajetet 82-83.

thotë: **"Përshëndetja e tyre, kur ta takojnë Atë, është 'Paqe'. Ai u ka përgatitur atyre shpërblim bujar."**.

Fjala *"et tehijjetu"*, rrjedh nga fjala *"hajatun"*. Kuptimi i saj është: ftesë për paqe dhe një jetë tjetër. Për më tepër sqarim, shiko kwtw komentim, fundi i ajetit 85 i sures "En Nisa".

Kjo paqe do të thotë ruajtja nga dënimi dhe nga të gjitha llojet e dhimbjes dhe të vështirësisë, një paqe e përzier me qetësi dhe qëndrueshmëri.

Edhe pse një pjesë e komentuesve besojnë se togfjalëshi **"përshëndetja e tyre"** tregon paqen e besimtarëve dhe përshëndetjen ndaj njeri–tjetrit, mirëpo thënia e ajeteve të mëparshëm, që folën folur për begatinë dhe mëshirën e All'llahut dhe të engjëjve në këtë dynja, zbulon se kjo përshëndetje është, gjithashtu, nga melekët, në Ahiret. Këtë fakt e lexojmë në ajetet 23-24 të sures "Er Rra'd": **"Xhenneti i Adnit, në të cilin do të hyjnë ata dhe besimtarët e ndershëm prej prindërve të tyre, grave dhe pasardhësve të tyre. Dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë** (e Xhennetit)**."**

"(E do t'u thonë)**: 'Shpëtimi qoftë mbi ju, për durimin që keni treguar** (në jetën e kësaj bote)**!' Sa vendbanim i bukur që është ky!".**

Nga sa thamë, është bërë i qartë kuptimi i sifjalisë: **"Kur ta takojnë."**. Ajo është Dita e Kiametit, e cila ndryshe quhet Ditën e takimit me All'llahun. Kjo shprehje zakonisht përdoret me këtë kuptim në Kur'an.

Pas kësaj përshëndetjeje, e cila lidhet me fillimin e çështjes, ajeti ka treguar në fund: **"Ai u ka përgatitur atyre shpërblim bujar."**. Në këtë fjali është bashkuar shkurtimisht çdo gjë dhe janë fshehur të gjitha mirësitë dhe dhuratat.

Hulumtime

1- All'llahu duhet të përmendet në çdo situatë

Kur përmendet emri i All'llahut të Lartësuar, në zemrën e njeriut manifestohet qartë një botë madhështie, fuqie, diturie dhe mençurie, sepse të All'llahut janë emrat e bukur dhe cilësitë sublime. Zoti i të gjitha përsosjeve, është larg çdo të mete dhe mangësie.

Pa dyshim se ballafaqimi i vazhdueshëm i kësaj të vërtete, e drejton shpirtin e njeriut drejt veprave të mira dhe pastërtive, duke e larguar atë nga veprat e këqija dhe të shëmtuara. Drita e All'llahut është në shpirtin e njeriut.

Drejtimi kah një të adhuruari të tillë të madhërishëm, nxit ndjenjën e përhershme për praninë e tij para All'llahut të Lartësuar. Kjo ndjenjë çon në zgjerimin e kufirit mes njeriut dhe gjynahut dhe kundërshtimit.

Ta përmendësh All'llahun, do të thotë të përmendësh kontrollin e Tij, të përmendësh llogarinë dhe shpërblimin e Tij, të përmendësh gjykimin e Tij të drejtë, të përmendësh Xhennetin

dhe Zjarrin e Tij. Kjo përmendje e pastron shpirtin dhe e mbush zemrën me dritë dhe gjallëri.

Në transmetimet islame thuhet se për çdo gjë, ka një kufi, përveç përmendjes së All'llahut. Ajo nuk njeh cak.

Në veprën "Usulul Kafij", transmetohet një thënie nga Imam Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: "*Nuk ka gjë që të mos ketë një kufi që mbaron, përveç përmendjes së All'llahut, e cila nuk ka kufi.*". Më pas shton e thotë: "*All'llahu i ka bërë obligim namazet. Kush i fal ato, ai është kufiri i tyre. Edhe për Muajin e Ramazanit, kush e agjëron atë, ai është kufiri i tij. Edhe Haxhit i ka vënë kufi. Vetëm përmendja e All'llahut nuk ka kufi. All'llahu nuk kënaqet duke e përmendur pak dhe nuk i ka vënë kufi që të mbarojë përmendja e tij.*". Pastaj lexoi: "**O ju që keni besuar, përmendeni shpesh All'llahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!"**.[1]

Në fund të këtij transmetimi, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Babai im ka qenë nga ata që e përmendte shumë All'llahun. Unë ecja bashkë me të, kurse ai e përmendte All'llahun. Hanim bashkë ushqimin dhe ai pa dyshim e përkujtonte All'llahun. Edhe kur i fliste popullit, nuk e pengonte atë nga përmendja e All'llahut.*".

Ky hadith mbaron me një përmbajtje të pasur: "*Shtëpisë ku lexohet Kur'ani dhe përmendet shumë All'llahu, i shtohen begatitë e All'llahut të Madhëruar, janë të pranishëm melekët dhe largohen shejtanët. Ata i bëjnë dritë banorëve të qiellit ashtu si yjet e përhapura, i bëjnë dritë banorëve të tokës.*".[2]

1 "Usulul Kafij", vëll. 2, Libri "Lutja", kreu "Dhikrullah", hadithi 1.
2 Burimi i mëparshëm.

Kjo temë, "përmendja e All'llahut", për nga rëndësia, barazohet me të mirën e dynjasë dhe të Ahiretit. I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Kujt i jepet një gjuhë përkujtuese, atij i është dhënë gjëja më e mirë e dynjasë dhe e Ahiretit.*".[1]

Transmetimet e përmendura për rëndësinë e përmendjes së All'llahut janë aq shumë, sa po t'i listonim të gjitha, do të dilnim nga tema e librit, prandaj e mbyllim këtë çështje me një hadith tjetër nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Kush e shton përmendjen e All'llahut, All'llahu do t'i bëjë atij hije në Xhennetin e Tij.*".[2]

Për më tepër informacion, lexo vëllimin e dytë të librit "Usulul Kafij", kapitujt që lidhen me përmendjen e All'llahut.

Të gjitha këto begati dhe të mira nuk lidhen vetëm me përmendjen me fjalë dhe lëvizjen e gjuhës së boshatisur nga mendimi dhe vepra, përkundrazi qëllimi është përmendja që sjell meditim, atë meditim që pasohet me veprat e njeriut, siç e kanë bërë të qartë transmetimet e ardhura për këtë kuptim.[3]

2- Një sqarim për togfjalëshin "takimi i All'llahut"

Ne kemi thënë se ky togfjalësh, në Kur'anin Famëlartë, zakonisht tregon për Kiametin, përderisa takimi konkret me All'llahun nuk është i vërtetë. Ky takim nuk është me trup dhe

1 Burimi i mëparshëm.
2 Burimi i mëparshëm, hadithi 5.
3 "Karakteristikat e të sinqertëve", sipas transmetimit të tefsirit "El Mijzan", vëll. 16, f. 353.

nuk ka ekspozim trupor. Për këtë shkak, një pjesë e komentuesve u detyrua që të bënte këtu një vlerësim. Ata thanë: Qëllimi i përdorimit të këtij togfjalëshi, është "takimi i shpërblimit të All'llahut" apo "takimi i melekëve të All'llahut".

Fjala "*takim*", këtu mund të merret me kuptimin e takimit të vërtetë, me sytë e zemrës, ku perdja, në Kiamet, largohet, madhështia dhe argumentet e All'llahut duken qartë, më shumë se në çdo kohë tjetër që ka kaluar dhe çdo njeri përfiton me këtë pamje një shkallë që harmonizohet me peshën e njohurisë dhe punës së tij të mirë.

Fakhru Raziu, ka një sqarim të bukur, që mund të bashkohet me ato që thamë: "Njeriu, shpesh, në këtë dynja tregohet i pavëmendshëm ndaj All'llahut, si rezultat i mbytjes së tij në çështjet materiale dhe përpjekjes për sigurimin e jetesës, por ai, në Ditën e Kiametit drejtohet drejt Zotit të gjithë botëve me gjithë qenien e tij, sepse të gjitha këto pengesa mendore do të mbarojnë. Ky është ai kuptimi i takimit të All'llahut.".[1]

Nga sa thamë më lart, u bë e qartë fjala e disa komentuesve të Kur'anit, se kjo shprehje tregon çastin e vdekjes dhe takimin me engjëllin e vdekjes, nuk harmonizohet jo vetëm me ajetet që po komentojmë, por as edhe me shprehjet e ngjashme të përmendura në ajetet e tjera të Kur'anit, pasi përemri, në funksionin e kundrinorit, është në numrin njëjës. Kjo mënyrë tregon se përemri "*atë*" i dedikohet Unit të shenjtë të All'llahut, ndërkohë që engjëjt që marrin shpirtrat, janë në numrin shumës.

1 "Tefsirul Kebijr", vëll. 25, f. 215, fundi i ajetit është burimi i diskutimit.

3- Shpërblimet e besimtarëve janë të përgatitura që tani

Fjalia: **"Ai u ka përgatitur atyre shpërblim bujar."**, shpall se Xhenneti dhe mirësitë e tij janë krijuar dhe po presin besimtarët.

Përgatitja dhe bërja gati harmonizohet me njeriun, me fuqi të kufizuara. Ai, mbase, brenda një kohe të shkurtër, nuk mund të përgatisë gjithçka që i duhet. Por një nevojë e tillë për përgatitje, nuk është e vërtetë për All'llahun e Madhëruar, pasi fuqia e Tij nuk mund të llogaritet. Nëse Ai dëshiron ndonjë gjë në çdo çast, Ai i thotë asaj: "Bëhu!", e ajo bëhet. Në mendje mund të sillet rrotull kjo pyetje: Atëherë, çfarë kuptimi ka përgatitja dhe bërja gati, jo vetëm në këtë ajet, por edhe në ajetet e tjera të Kur'anit?

Duke parë vetëm një pikë të vetme, zgjidhet ky shqetësim, se përgatitja e diçkaje nuk buron nga ekzistenca e kufizuar e fuqisë, përkundrazi ndonjëherë mund të jetë për hir të qetësimit të mendjes dhe të shpirtit. Herë tjetër mund të jetë për shkak të shtimit të respektit dhe nderimit. Prandaj nuk ka dyshim se, nëse ne ftojmë një mik dhe fillojmë me përgatitjet e mikpritjes së tij, atëherë do të duket se i kemi dhënë rëndësi më shumë dhe e kemi respektuar më shumë dhe kundërta e saj, nëse i bëjmë përgatitjet ditën kur ai vjen dhe në orën e mbërritjes së tij, kjo tregon moskujdesin tonë dhe respektin e paktë për këtë mysafir.

Në të njëjtën kohë, kjo fjalë nuk e ndalon shpërblimin e madh dhe shtimin e tij sipas veprës. Besimtarët, sa më shumë të përpiqen të edukojnë dhe të pastrojnë shpirtin e tyre, aq më shumë shtohen shpërblimet e përgatitura hyjnore. Ata ecin drejt përsosjes.

Ajetet 45 – 48

﴿يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَاهِدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا٤٥ وَدَاعِيًا إِلَى اللَّهِ بِإِذْنِهِ وَسِرَاجًا مُنِيرًا٤٦ وَبَشِّرِ الْمُؤْمِنِينَ بِأَنَّ لَهُمْ مِنَ اللَّهِ فَضْلًا كَبِيرًا٤٧ وَلَا تُطِعِ الْكَافِرِينَ وَالْمُنَافِقِينَ وَدَعْ أَذَاهُمْ وَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ وَكَفَى بِاللَّهِ وَكِيلًا٤٨﴾

“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues.”

“Njëkohësisht (të kemi çuar) **si thirrës, që i fton njerëzit në Rrugën e All’llahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.”**

“Jepu lajmin e mirë besimtarëve se All’llahu ka (përgatitur) **për ata dhunti të madhe!**

“Mos i dëgjo mohuesit dhe hipokritët! Mos i përfill fyerjet e tyre dhe mbështetu tek All’llahu; All’llahu mjafton për mbrojtës.”

Komentimi

Pishtari ndriçues

Pavarësisht se biseda në këto ajete i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, mesazhi është për të gjithë Profetët. Këto ajete plotësojnë ajetet e mëparshme, ku janë diskutuar disa detyra dhe punë të besimtarëve .

Në ajetet 45-46 janë përmendur pesë cilësi të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse në ajetet 47-48 janë bërë të qarta katër detyra, që jo vetëm janë të lidhura me njëra–tjetrën, por plotësojnë njëra–tjetrën.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar..."**.

Së pari: Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është dëshmues i veprave të popullit të tij, sepse ai i shikon veprat e tyre. Këtë kontekst e shikojmë në një ajet tjetër: **"Thuaj: 'Punoni, se All'llahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë."**.[1] Kjo dituri mund të vërtetohet nëpërmjet demonstrimit të veprave të ymetit ndaj Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamëve. Komentimi i

1 Sure "Et Teube", ajeti 105.

hollësishëm i këtij ajeti është bërë në komentimin e sures "Et Teube".

Së dyti: Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është dëshmitar i Profetëve të kaluar, të cilët kanë qenë dëshmitarë për popullin e tyre: **"Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty** (o Muhammed) **për dëshmitar mbi të gjithë ata?!"**.[1]

Së treti: Prania jote, me të gjitha cilësitë e tua, moralin, programet dhe mësimet konstruktive, duke shtuar edhe historinë tënde vezulluese dhe punët e tua fisnike, është dëshmitar jo vetëm i vërtetësisë së fesë tënde, por edhe i madhështisë së All'llahut.

Ajeti vazhdon me dy cilësi të tjera: **"sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues"**. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është përgëzues për punëmirët, me shpërblimin e pafund të All'llahut, me paqe dhe lumturi të përhershme, me fitore dhe sukses, me krenari dhe respekt.

Ai është paralajmërues për jobesimtarët dhe hipokritët, për dënimin e dhimbshëm të All'llahut, për humbjen e të gjitha të mirave materiale të ekzistencës së tyre, për hidhërimin e dynjasë dhe të Ahiretit.

Siç kemi thënë më parë, përgëzimi dhe paralajmërimi duhet të shoqërohet në çdo vend dhe secili prej tyre të ekuilibrojë tjetrin, sepse gjysma e ekzistencës së njeriut është shprehje e

1 Sure "En Nisa", ajeti 41.

dashurisë së tij për marrjen e dobisë, kurse gjysma tjetër është përpjekja e tij për të larguar dëmin prej vetes. Pra, përgëzimi formon mbrojtjen nga pjesa e parë, kurse paralajmërimi ndaj gjysmës tjetër, pasi metodat që mbështeten në një anë të vetme, nuk e kuptojnë të vërtetën e njeriut dhe nuk i kuptojnë nxitësit dhe dëshirat e tij.[1]

Ajeti 46 tregon cilësinë e katërt dhe të pestë: **"Njëkohësisht** (të kemi çuar) **si thirrës, që i fton njerëzit në Rrugën e All'llahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues."**.

Hulumtime

Këtu kërkohet kujdes, për disa pika:

1- Pozita e dëshmisë dhe e dëshmitarit, është përmendur para të gjitha cilësive të tjera të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sepse kjo pozitë ka nevojë për paraqitje të njëvlershme për ekzistencën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe mesazhit të tij. Kur plotësohet qëndrimi i tij në këtë pozitë, ai bëhet dëshmitar për të gjitha anët. Pozita e përgëzimit dhe e paralajmërimit është një çështje që vërtetohet pas kësaj.

1 Kemi paraqitur një diskutim të detajuar në këtë kapitull, në adresën "Dy origjina të rëndësishme edukative", në fundin e ajetit 119 të sures "El Bekare".

2- Nuk ka dyshim se thirrja për në Rrugën e All'llahut të Madhëruar është një fazë që vjen pas përgëzimit dhe paralajmërimit, sepse përgëzimi dhe paralajmërimi është një mënyrë e përgatitjes së personave për pranimin e të vërtetës, sepse, kur piqen kushtet nëpërmjet rrugës së ngjalljes së dëshirës dhe frikësimit, fillon faza e thirrjes drejt Rrugës së All'llahut të Madhëruar. Kjo thirrje do të jetë efektive vetëm në këtë situatë.

3- Megjithëse punët e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë me lejen dhe me urdhrin e All'llahut, thirrja është e vetmja gjë e lidhur ngushtë me lejen e All'llahut, sepse puna më e vështirë dhe më e rëndësishme e Profetëve është thirrja drejt Rrugës së All'llahut të Madhëruar.

Detyra e tyre ishte që të drejtonin njerëzit në rrugën që kundërshtonte pasionet dhe epshet e tyre. Ata duhet ta mbanin të fshehtë lejen e All'llahut, urdhrin dhe ndihmën e Tij në këtë fazë, që të përmbushej zbatimi i saj. Që këtu, bëhet e qartë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kishte gjë nga vetja e tij, përkundrazi çdo gjë që ai thoshte, ishte me lejen e All'llahut.[1]

4- Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është pishtar ndriçues. Ky epitet është argument i vërtetësisë së thirrjes së tij, është një shenjë e sinqeritetit të tij, sepse ai vetë është një pishtar ndriçues për veten e tij, i largon errësirat, i tërheq shikimet dhe i drejton zemrat drejt

1 Supozohet se kushti "me lejen e tij" i referohet të gjitha përshkrimeve të mëparshme. Përemri në fillim të ajetit i referohet çështjes së thirrjes së Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* drejt Rrugës së All'llahut.

tij. Ashtu si shfaqja e diellit është argument i ekzistencës së diellit, po kështu edhe ekzistenca e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është argument i vërtetësisë së tij.

Ajo që meriton vëmendje, është shprehja *"pishtar"*, e përmendur katër herë në Kur'anin Famëlartë. Tri prej tyre janë në lidhje me diellin dhe njëra përmendet në ajetin 16 të sures "Nuh": **"...dhe në ta e ka bërë Hënën dritë, kurse Diellin e ka bërë fener."**.

Kuptimi i fjalës *"es siraxhu"* - *"pishtari"*, është llambë. Në fillimet e saj, llamba ishte e ndërtuar me fitil, i zhytur në vaj. Me zhvillimin e teknologjisë, sot, llamba është elektrike. Sipas fjalorit, ajo është përdorur për çdo burim drite. Emërtimi i diellit me fjalën *"fener"*, është sepse drita i buron nga brendësia e tij dhe nuk e merr dritën nga burime të tjera, siç e merr Hëna.

Prania e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është si dielli ndriçues, i cili largon errësirat e injorancës, të idhujtarisë dhe të mosbesimit, nëpërmjet ngritjes lart të shpirtit të njeriut.

Ashtu siç i verbri nuk përfiton nga drita e diellit dhe lakuriqët e fshehin veten e tyre prej dritës, pasi sytë e tyre nuk kanë fuqi ta shikojnë këtë dritë, edhe zemrat e verbra të kokëfortëve dhe fanatikëve nuk përfituan dhe nuk do të përfitojnë nga kjo dritë.

Ebu Xhehli e të tjerë si ai, i vendosnin gishtat në veshët e tyre, që të mos dëgjonin zërin dhe melodinë e Kur'anit.

Errësira përhap gjithmonë frikë dhe tmerr, kurse drita përhap qetësi dhe rehati. Hajdutët e shfrytëzojnë errësirën e natës për të hipur lart dhe të grabisin ç'të mundin, kurse kafshët grabitqare dalin nga strofullat e tyre në errësirën e natës.

Errësira shkakton ndarjen, kurse drita sjell bashkimin. Nëse ne ndezim një pishtar në një natë të errët, atëherë për një kohë shumë të shkurtër rreth saj do të mblidhen insektet.

Drita dhe ndriçimi është baza e zhvillimit të pemëve dhe e pjekjes së frutave. Përmbledhja është: Të gjitha aktivitetet e jetës dhe krahasimi i ekzistencës së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me një burim drite, i argumenton të gjitha këto nocione.

Prania e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është baza e qetësisë, e largimit të hajdutëve të fesë dhe e besimit, e arratisjes së ujqërve dëmtues e zullumqarë të shoqërisë dhe sjell qetësinë e mendjes, zhvillimin e shpirtit të besimit dhe të moralit.

Si përfundim, themi se baza e jetës, e lëvizjes dhe kronologjia e jetës së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është dëshmi e gjallë për këtë temë.

Në ajetet 47-48 jepet një sqarim për pesë detyrat më të rëndësishme të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas sqarimit të pesë cilësive të tij: **"Jepu lajmin e mirë besimtarëve se All'llahu ka** (përgatitur) **për ata dhunti të madhe! Mos i dëgjo mohuesit dhe hipokritët! Mos**

i përfill fyerjet e tyre dhe mbështetu tek All'llahu; All'llahu mjafton për mbrojtës.".

Çështja e përgëzimit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk përcaktohet me shpërblimin hyjnor sipas masës së veprave të mira të besimtarëve, madje All'llahu i Madhëruar ua shton atyre mirësitë e Tij, saqë e shtyn barazinë mes veprës dhe shpërblimit. Këtë e dëshmojnë ajetet e Kur'anit.

Në ajetin 160 të sures "El En'am", thuhet: **"Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë dhe nuk do t'i bëhet kurrfarë padrejtësie."**.

Në ajetin 261 të sures "El Bekare", thuhet: **"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në Rrugë të All'llahut, i shëmbëllejnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. All'llahu ia shton** (shpërblimin) **edhe më tepër kujt të dëshirojë; All'llahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm."**.

Në ajetin 17 të sures "Es Sexhde", thuhet: **"Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata** (në Jetën Tjetër)**, si shpërblim për punët e mira që kanë bërë."**.

Dimensionet e mirësisë së madhe të All'llahut janë më të gjera e më të larta seç mund ta imagjinojnë mendjet.

Pastaj ajeti trajton detyrën e dytë dhe të tretë: **"Mos i dëgjo mohuesit dhe hipokritët."**.

Nuk ka asnjë dyshim se i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk u është bindur jobesimtarëve dhe hipokritëve. Kjo temë ka një vend të rëndësishëm, prandaj edhe ajeti është përqendruar kaq shumë, sepse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është paralajmërues dhe shembull për të tjerët. Ai i paralajmëron ata nga rreziqet dhe rezultatet e këqija, nëse kundërshtojnë rrugën e udhëheqësve të sinqertë dhe fillojnë e bëjnë pazare të ndryshme, për t'iu shmangur Rrugës së Drejtë. Ndonjëherë, kushtet e këtij dorëzimi, piqen nëpërmjet kërcënimit. Një herë tjetër, nëpërmjet dhënies së privilegjeve, saqë edhe njeriu mund të dyshojë ndonjëherë dhe të mendojë se dorëzimi dhe miratimi ndaj këtij pazari dhe dorëzimi i plotë, është rruga e arritjes së qëllimit, në kohën kur rezultati i këtij dorëzimi është shpenzimi i të gjitha përpjekjeve dhe mundimeve.

Pa dyshim se kronologjia e Islamit e bën të qartë se jobesimtarët dhe hipokritët janë përpjekur shpesh ta tërheqin Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në këtë situatë. Një herë i propozuan atij që të mos i përmendë për keq statujat, as t'i kritikojë e as t'i degradojë.

Një herë tjetër i kërkuan leje që ata për një vit, të adhuronin Zotin e tij, kurse vitin tjetër, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të adhuronte zotat e tyre.

Ndonjëherë i thoshin që t'u jepte një vit kohë të qëndronin edhe një vit në fenë e tyre, pastaj të besonin fenë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Një herë i propozuan atij që të largonte prej vetes besimtarët e varfër e të vobektë, që të pasurit me pozitë të lartë, të bashkonin zërin e tyre, me zërin e tij.

Ndonjëherë deklaronin se do të besonin, nëse u linin disa privilegje: pasuri, pozitë, gra të bukura, etj.

Është e padiskutueshme se të gjitha këto ishin hapa të rrezikshme në rrugën e përhapjes së shpejtë të Islamit dhe shkuljes së rrënjëve të mosbesimit dhe të hipokrizisë. Sikur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të shfaqte butësi dhe të anonte nga marrëveshja, qoftë edhe para njërës prej këtyre propozimeve, nuk ka asnjë dyshim se shtyllat e revolucionit islam do të shkatërroheshin dhe të gjitha përpjekjet do të shkonin kot, pa asnjë rezultat.

Urdhri i katërt dhe i pestë: **"Mos i përfill fyerjet e tyre dhe mbështetu tek All'llahu; All'llahu mjafton për mbrojtës."**.

Kjo pjesë e ajetit tregon se ata e kishin vënë Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nën një presion të madh. Ata përdorën kundër tij dhe kundër shokëve të tij të gjitha llojet e lëndimit: plagosje me fjalë të rënda, të këqija, poshtërim, lëndim trupor, bllokadë ekonomike.

Ky lloj lëndimi, në Mekë, kishte panoramën e tij, ndërsa në Medine, kishte metodë tjetër.

Fjala *"el edha"* ka ardhur në mënyrë të përgjithshme në ajet dhe përfshin të gjitha llojet e lëndimit.

Fjalori thotë se fjala *"el edha"* është çdo lloj dëmtimi që e godet qenien e gjallë, njësoj si në shpirt, edhe në trupin e tij, apo godet atë që është i lidhur me të, njësoj si në dynja edhe në Ahiret.

Kjo fjalë është përdorur në ajetet e Kur'anit në mënyra të ndryshme. Ajeti 61 i sures "Et Teube" tregon lëndimin me fjalë: **"Ka të atillë që e shqetësojnë të Dërguarin dhe thonë: 'Ai dëgjon çdo gjë që i thuhet'. Thuaj** (o Muhammed)**: 'Ai dëgjon atë që është e mirë për ju, beson në All'llahun dhe u beson besimtarëve. Ai është mëshirë për ata midis jush që besojnë. Kurse ata që e lëndojnë të Dërguarin e All'llahut, i pret një ndëshkim i dhembshëm.'"**.

Në ajetin 16 të sures "En Nisa", është përdorur me kuptimin "lëndimi trupor": **"Dhe ata të dy prej jush që kanë bërë këtë punë të turpshme, i ndëshkoni që të dy; e nëse pendohen dhe përmirësohen, ua hiqni dënimin. Se All'llahu e pranon pendimin dhe është Mëshirues."**.

Historia thotë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimtarët e parë kanë qëndruar të fortë si mali, para llojeve të ndryshme të lëndimit. Nuk e kanë pranuar kurrë turpin e dorëzimit dhe të mposhtjes. Në fund ata triumfuan në lëvizjen e tyre.

Baza e kësaj rezistence dhe ndihma e tyre ishte "mbështetja fort tek All'llahu". Para vullnetit të All'llahut lehtësohen të gjitha vështirësitë dhe problemet. Njeriut i mjafton që ndihmësi dhe mbrojtësi i tij të jetë Zoti i Madhëruar.

Nga sa thamë, u bë e qartë, se përmbajtja e ajetit 48 nuk ishte kopje e ligjit të luftës, ashtu siç mendojnë disa komentues,

madje nga sa duket, këto ajete kanë zbritur pas një periudhe kohe nga zbritja e ligjit të luftës. Ajo është në rrethin e ngjarjeve të lidhura me suren "El Ahzab".

Nuk ka asnjë dyshim se ky ligj është për të gjitha periudhat dhe shekujt, që udhëheqësit hyjnorë të mos shpenzojnë fuqitë e tyre jetësore duke u kujdesur për provokimin e kundërshtarëve të tyre, pasi, nëse ata e bëjnë atë dhe i shpenzojnë fuqitë dhe forcat e tyre në këtë aspekt, armiku i tyre do ta ketë realizuar qëllimin e tij, sepse ai dëshiron ta angazhojë mendimin e atij që ka përballë vetes dhe t'i shkatërrojë fuqitë e tij nëpërmjet kësaj rruge. Këtu është urdhri: lëre lëndimin e tyre, sepse ajo është rrugëzgjidhja e vetme.

Këtu ka një çështje që meriton kujdes: Pesë urdhëresat e përmendura, të cilat janë thënë në dy ajetet e fundit, plotësojnë njëra-tjetrën dhe lidhen me njëra–tjetrën, pasi nuk ka dyshim se përgëzimi i besimtarëve është për tërheqjen e forcave besimtare, kurse mosdorëzimi ndaj jobesimtarëve dhe hipokritëve, mosdhënia interes lëndimit të tyre dhe mbështetja tek All'llahu, formojnë një seri parimesh, që të çojnë drejt qëllimit dhe një vepre të bashkuar për çdokënd që zgjedh rrugën e vërtetë.

Ajeti 49

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نَكَحْتُمُ الْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ طَلَّقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمَسُّوهُنَّ فَمَا لَكُمْ عَلَيْهِنَّ مِنْ عِدَّةٍ تَعْتَدُّونَهَا فَمَتِّعُوهُنَّ وَسَرِّحُوهُنَّ سَرَاحًا جَمِيلًا٤٩﴾

"O ju që keni besuar! Kur martoheni me besimtaret dhe i ndani ato para se t'i prekni, ato nuk janë të detyruara t'ju presin në afatin kohor të caktuar, por jepuni një dhuratë të kënaqshme dhe i ndani njerëzishëm."

Komentimi

Një anë e ligjeve të ndarjes *(divorcit)*

Ajetet e sures "El Ahzab" kanë ardhur në formën e serive të ndryshme. Biseda, në një pjesë të tyre, i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse në disa herë të tjera u drejtohet besimtarëve, prandaj ndonjëherë thotë: **"O Profet!"**, kurse herë të tjera thotë: **"O ju që keni besuar!"**.

Në këto ajete janë përmendur urdhëresa të domosdoshme që mund të ekuilibrojnë njëra–tjetrën. Kjo do të thotë se në këto urdhëresa nuk urdhërohej vetëm Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por të gjithë besimtarët.

Ajeti që po komentojmë është prej ajeteve që e drejtojnë bisedën e tyre te të gjithë besimtarët. Ndërkohë që ajetet e mëparshme, në pamje të jashtme, i drejtoheshin Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Edhe në ajetet e ardhshme, edhe një herë tjetër, biseda i drejtohet Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Një pjesë e kësaj sureje ndjek metodën "mbështjellja dhe përhapja e sistemuar".

Ajeti thotë: **"O ju që keni besuar! Kur martoheni me besimtaret dhe i ndani ato para se t'i prekni, ato nuk janë të detyruara t'ju presin në afatin kohor të caktuar, por jepuni një dhuratë të kënaqshme dhe i ndani njerëzishëm."**.

Në këtë ajet All'llahu i Madhëruar, ka bërë të qartë një ligj përjashtues prej ligjit të afatit të pritjes *(el iddetu)* për gratë e divorcuara. Ligji është: Nëse ky divorc bëhet para kontaktimit seksual, atëherë nuk nevojitet afat. Nga kjo mënyrë të shprehuri, kuptohet se ligji i afatit të pritjes *(el iddetu)* është bërë i qartë para këtij ajeti.

Fjala *"el mu'minatu"* - *"besimtaret"* nuk tregon se martesa me jo myslimanet është e ndaluar plotësisht, madje mund të jetë një shenjë e përparësive të besimtareve. Duke u bazuar nga kjo, ajo nuk i ndalon transmetimet dhe fetvatë e dijetarëve të njohur,

që të lejojnë martesën e përkohshme me ndjekëset e atyre që u ka zbritur Libri.

Nga fjala *"lekum"* e sifjalisë: **"të presin afatin e caktuar"**, përftohet se pritja e afatit të gruas konsiderohet një e drejtë e burrit. Duhet të jetë kështu, sepse mund të ndodhë që gruaja të jetë shtatzënë në atë kohë. Shkelja e aftit të caktuar dhe martesa me një burrë tjetër, situatën e fëmijës e bën të panjohur, duke humbur të drejtën e hakut të burrit. Pritja e afatit, i jep burrit dhe gruas një shans tjetër për rinovimin e mendimit dhe mundësi rikthimi te njëri-tjetri, pasi divorci mund të ndodhë si rezultat i reaksioneve të forta. Një shans dhe një meditim i tillë është e drejtë e burrit dhe e gruas së bashku.

Një pjesë e komentuesve, për këtë ligj kanë thënë se, nëse caktimi i afatit është e drejtë e burrit, ai ka të drejtë ta rrëzojë atë. Ky mendim i tyre është i gabuar, sepse në jurisprudencën fetare ka shumë të drejta që nuk mund të rrëzohen, si: e drejta e trashëgimisë së të vdekurit në pasurinë e tij, e drejta e të varfrit ndaj zekatit. Askush nuk është i aftë, i fuqishëm ta rrëzojë këtë të drejtë ligjore.

Pastaj ajeti futet në një ligj tjetër prej ligjeve të grave, që ndahen para marrëdhënieve seksuale. Këtij ligji, i ka paraprirë ligji që thuhet në suren "El Bekare": "**jepuni një dhuratë të kënaqshme"**.

Nuk ka asnjë dyshim se dhënia e një dhurate të përshtatshme gruas, bëhet detyrë kur nuk është përcaktuar më parë mehri (shpërblimi), ashtu siç thuhet në ajetin 236 të sures "El Bekare": **"Nuk është gjynah për ju nëse i ndani gratë para se të**

keni marrëdhënie me to ose para se të caktoni shumën e dhuratës martesore (që do t'u jepni)**. Por u jepni dhuratë të pëlqyeshme: i pasuri sipas gjendjes së tij dhe i vobekti sipas gjendjes së vet. Kjo është detyrë e atyre që dëshirojnë të bëjnë vepra të mira."**.

Në bazë të kësaj, ajeti që po komentojmë, edhe nëse është absolut, përfshin kuptimet edhe ku është përcaktuar, edhe ku nuk është përcaktuar shpërblimi i martesës. Ne i vendosim ato me kuptimin që shpërblimi i martesës nuk është përcaktuar, duke u bazuar në kontekstin e ajetit të sures "El Bekare", sepse në situatën përcaktimit të shpërblimit të martesës dhe mungesës së kontaktit, duhet të paguhet gjysma e shpërblimit të martesës, siç thuhet në ajetin 237 të sures "El Bekare": **"Në qoftë se i ndani gratë para se të keni marrëdhënie me to, por ia keni caktuar shumën e dhuratës martesore, atëherë atyre u përket gjysma e dhuratës, veç nëse ua falin ato ose ua falin ata që kanë në dorë lidhjen e martesës. Por që të falni është më pranë devotshmërisë. Mos harroni që të bëheni bamirës midis jush! Vërtet, All'llahu e sheh mirë se çfarë bëni."**.

Disa komentues të Kur'anit kanë supozuar se ligji i dhënies së një dhurate të përshtatshme është i përgjithshëm në ajetin që po komentojmë dhe përfshin edhe kapitujt ku është përcaktuar shpërblimi i martesës, megjithëse, në këto kapituj ai ka cilësinë e rekomandimit.

Në kapitujt, ku nuk është caktuar shpërblimi i martesës, ka cilësinë e obligimit. Në disa ajete dhe transmetime, vihet re një tregues i këtij kuptimi.[1]

Mirëpo sa është masa e kësaj dhuratë? Këtë e ka sqaruar mirë Kur'ani Famëlartë, në suren "El Bekare", në ajetin 236: **"Nuk është gjynah për ju nëse i ndani gratë para se të keni marrëdhënie me to ose para se të caktoni shumën e dhuratës martesore** (që do t'u jepni)**. Por u jepni dhuratë të pëlqyeshme: i pasuri sipas gjendjes së tij dhe i vobekti sipas gjendjes së vet. Kjo është detyrë e atyre që dëshirojnë të bëjnë vepra të mira."**.

Bazuar mbi këtë, nëse në transmetimet islame janë përmendur gjëra të njëvlershme, me: shtëpinë, shërbëtorin, rrobat, etj, pa dyshim se ato janë miratime për këtë tërësi. Ato ndryshojnë sipas mundësive të burrit dhe problemeve të gruas.

Rregulli i fundit i ajetit 49 është: **"i ndani njerëzishëm"**.

Fjala *"es sirahul xhemilu"* ka kuptimin: ndarje e shoqëruar me dashuri dhe respekt, duke lënë mënjanë çdo ashpërsi, padrejtësi, mizori dhe përbuzje.

Përmbledhja e asaj që përmendet në ajetin 229 të sures "El Bekare": **"Ose mbajini me të mirë, ose lërini të ikin me të mirë.**", është: Nuk ka dyshim se jo vetëm vazhdimësia në jetën bashkëshortore duhet të jetë e ngritur mbi baza njerëzore, por edhe ndarja, pasi burrit, nëse e ka vendosur ta ndajë gruan e tij,

1 Si ajeti 241 i sures "El Bekare". Janë përmendur shumë transmetime shi'ite për këtë çështje, si: vëll. 15, Libri "En Nikahu", kreu 50, nënkapitulli "Shpërblimi i martesës", f. 59. Njëra prej tyre është ajo që përmendet nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Për çdo grua të lëshuar, ka një pagesë, përveç gruas së ndarë me ndarje khul'i (e cila kërkon ajo të ndahet)."*.

nuk i lejohet t'ia hajë hakun, pensionin, të drejtën, bashkëshortes së tij. Nuk i lejohet fjala e shëmtuar dhe sjellja ashpër me të, sepse kjo sjellje nuk është kurrë sjellje islame dhe nuk ka fare lidhje me Islamin.

Disa komentues të Kur'anit, "ndarjen në mënyrë të njerëzishme", e kanë konsideruar me kuptimin: zbatim i ndarjes sipas traditës islame. Ky kuptim është thënë në transmetimin e përmendur në tefsirin e Ali ibn Ibrahimit. Është e padiskutueshme se "ndarja në mënyrë të njerëzishme" nuk kufizohet me këtë kuptim, megjithëse ajo është një nga konfirmimet e saj.

Disa komentues të tjerë kanë mendimin se ndarja në mënyrë të njerëzishme, këtu, do të thotë dalja nga shtëpia, sepse gruaja nuk është e obliguar të presë afatin, atëherë duhet të bëhet ndarja e saj, që të shkojë ku të dëshirojë.

Ky kuptim duket shumë larg kuptimit të parë të ajetit, sepse në Kur'anin Famëlartë janë përmendur ajete që flasin jo vetëm për ndarjen në mënyrë të njerëzishme apo shembujt të ngjashëm me të, por edhe ajete që flasin për gratë që duhet të presin afatin e caktuar.

Ne kemi pasur një diskutim të detajuar rreth kuptimit të fjalës *"es sirahu"*, rreth origjinës së saj gjuhësore dhe përse përdoret me kuptimin e ndarjes dhe lëshimit. Ky diskutim ndodhet në fund të ajetit 28 të kësaj sureje "El Ahzab".

Ajeti 50

﴿يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَحْلَلْنَا لَكَ أَزْوَاجَكَ اللَّاتِي آتَيْتَ أُجُورَهُنَّ وَمَا مَلَكَتْ يَمِينُكَ مِمَّا أَفَاءَ اللَّهُ عَلَيْكَ وَبَنَاتِ عَمِّكَ وَبَنَاتِ عَمَّاتِكَ وَبَنَاتِ خَالِكَ وَبَنَاتِ خَالَاتِكَ اللَّاتِي هَاجَرْنَ مَعَكَ وَامْرَأَةً مُؤْمِنَةً إِنْ وَهَبَتْ نَفْسَهَا لِلنَّبِيِّ إِنْ أَرَادَ النَّبِيُّ أَنْ يَسْتَنْكِحَهَا خَالِصَةً لَكَ مِنْ دُونِ الْمُؤْمِنِينَ قَدْ عَلِمْنَا مَا فَرَضْنَا عَلَيْهِمْ فِي أَزْوَاجِهِمْ وَمَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ لِكَيْلَا يَكُونَ عَلَيْكَ حَرَجٌ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا﴿٥٠﴾

"O Profet! Ne t'i kemi lejuar ty (për martesë)**, gratë që u ke dhënë dhuratat e martesës, skllavet, që t'i ka dhënë ty All'llahu** (si pre të luftës)**, vajzat e xhaxhallarëve, hallave, dajave dhe tezeve të cilat mërguan bashkë me ty, si edhe gruan besimtare, që u vetëdha për Ty, nëse Ti dëshiron të martohesh me atë. Kjo të është lejuar vetëm ty e jo besimtarëve të tjerë. Ne e dimë çfarë u kemi caktuar atyre për gratë e tyre dhe për ato që gjenden nën pushtetin e tyre, që për ty të mos ketë fajësim. All'llahu është Falës e Mëshirëplotë."**

Komentimi

Ti mund të martohesh me këto gra

Kemi thënë se disa pjesë të kësaj sureje diskutojnë detyrat e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të besimtarëve, nëpërmjet lidhjes dhe përhapjes së sistemuar. Prandaj, pas përmendjes së një ane të ligjeve, lidhur me ndarjen e grave, biseda këtu i adresohet Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajeti ka detajuar shtatë kategori të grave, me të cilat Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mund të martohet.

1- Së pari ajeti thotë: **"O Profet! Ne t'i kemi lejuar ty** (për martesë)**, gratë që u ke dhënë dhuratat e martesës."**.

Ajo që nënkuptohet me këto gra, janë gratë që Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka pasur lidhje farefisnie me to, por u martua me ato. Mbase arsyeja e martesës ka qenë çështja e pagesës së mehrit, sepse zakoni që ndiqej në atë kohë ishte që meshkujt paguanin me para, kur martoheshin me gra të huaja, duke shtuar preferencën e nxitimit, të urgjencës në këtë pagesë, sidomos nëse gruaja kishte nevojë për të. Kjo çështje nuk është e detyruar, sido që të jetë, ku është e mundur që mehri të mbetet si borxh në garancinë e martesës, nëse të dyja palët nuk bien dakord për atë.

2- Më pas ajeti thotë: **"skllavet, që t'i ka dhënë ty All'llahu** (si pre të luftës)**"**.

Fjala *"el fej'u"* përdoret për pasuritë që njeriu përfiton pa mund dhe vështirësi. Kështu që kjo fjalë përdoret për plaçkën e luftës dhe për *el enfalë*, që janë pasuri natyrore, të cilat i referohen qeverisë islame dhe nuk janë pasuri individuale.

Ragibi në librin e tij "El Mufredatu" thotë: Fjala *"el fej'u"*, ka kuptimin e rikthimit në gjendje të kënaqshme. Kjo fjalë përdoret për plaçkën e fituar pa vështirësi e lodhje. Një pjesë e dijetarëve kanë thënë se përdorimi i fjalës *"fej'un"*, brenda këtij konteksti, bëhet për të na tërhequr vëmendjen se ofertat më fisnike të dynjasë ecin me shpejtësinë e hijes.

Është e vërtetë se plaçkat e luftës, ndonjëherë, mund të fitohen me mundim të madh dhe harxhim të energjive të shumta, mirëpo se vështirësia e saj është më e vogël se vështirësia e marrjes së pasurive të tjera. Fjala *"el fej'u"* mund të përdoret ndonjëherë për pasuritë e mëdha, të cilat përfitohen nëpërmjet një sulmi të vetëm.

Mirëpo, te cila prej grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vërtetohet ky ligj?

Disa komentues kanë thënë se një nga gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që është Maria Kubtije, ishte prej pasurive të luftës. Ka pasur dy gra të tjera, Safijetu dhe Xheurijetu, prej enfalëve. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u dha në fillim atyre lirinë, pastaj u martua me to. Kjo punë ishte pjesë e planit të përgjithshëm të Islamit, lirimin e

skllevërve në mënyrë graduale dhe kthimin e personalitetit njerëzor atyre.

3- "Vajzat e xhaxhallarëve, hallave, dajave dhe tezeve të cilat mërguan bashkë me ty".

Kështu që, prej grave që i lejohen Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të martohet mes të gjitha atyre të afërmve, janë: bijat e xhaxhait dhe të hallave, bijat e tezes dhe dajës, me kusht që të kenë migruar bashkë me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Përcaktimi i këtyre katër grupeve është i qartë. Mirëpo kushti i migrimit ishte argument i besimit në atë kohë, kurse mosmigrimi ishte argument i mohimit, i mosbesimit. Migrimi u jep atyre një veçori dhe krenari më të madhe. Qëllimi i ajetit është të përcaktojë se cilat gra e meritojnë të bëhen gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

A është një ligj i përgjithshëm përmendja e këtyre katër grupeve, një miratim i jashtëm mes grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo jo? Kuptimi i vetëm që mund të përmendet si një miratim, është martesa e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Zejneben, të bijën e Xhahshit. Kjo histori tërheqëse është përmendur në kontekstet e kësaj sureje, sepse Zejnebja ishte vajza e hallës së Profetit Muhammed *(Paqja*

dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), kurse Xhahshi ishte bashkëshorti i hallës së tij.[1]

***4-* "Si edhe gruan besimtare, që u vetëdha për Ty,** (pa mehr) **nëse Ti dëshiron të martohesh me të. Kjo të është lejuar vetëm ty e jo besimtarëve të tjerë."** Ky rregull është vetëm për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nuk i përfshin të gjithë besimtarët: **"Ne e dimë çfarë u kemi caktuar atyre për gratë e tyre dhe për ato që gjenden nën pushtetin e tyre..."**. Duke u bazuar në këtë pjesë të ajetit, All'llahu i ka kufizuar disa çështje, në lidhje me martesën me këto gra. Kjo ishte në dobi të jetës së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të jetës së besimtarëve. Asnjë prej këtyre ligjeve dhe vendimeve nuk ka qenë kot dhe pa asnjë llogari.

Pastaj ajeti shton: **"...që për ty të mos ketë fajësim."**. Si rrjedhim, do të jesh i aftë në zbatimin e përgjegjësive që ke marrë mbi supe në kryerjen e kësaj detyre: **"All'llahu është Falës e Mëshirëplotë."**.

Po japim disa shpjegime për gratë që nuk kanë mehër.

1- Nuk ka asnjë dyshim se lejimi i marrjes së një gruaje pa mehër, ishte prej veçorive të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajeti është tepër i

1 Një pjesë e komentuesve kanë përmendur pikëpamjen që transmeton Fadil Mikdad, në veprën "Kenzul Urfan". Përse xhaxhai është përmendur në numrin njëjës, kurse hallat në numrin shumës. Po kështu, daja në numrin njëjës, kurse tezet në numrin shumës. Kuptimi më i afërt i kësaj pyetjeje është: Xhaxhai dhe daja përdoren si emra gjinie në gjuhën arabe dhe nuk është kështu për tezet dhe hallat. Këtë argumentim e ka përmendur Ibn Arabiju dhe njohës të gjuhës. ("Kenzul Urfan", vëll. 2, f. 241).

qartë në këtë çështje dhe është prej domosdoshmërive të jurisprudencës islame. Në bazë të kësaj, askujt nuk i lejohet të martohet me një grua pa mehër, pak apo shumë qoftë ai, edhe sikur të mos dëshirohet të përmendet mehri gjatë zbatimit të nënshkrimit të marrëveshjes, apo nuk ka pasur një shenjë që ta caktojë atë (mehrin), atëherë duhet të jepet *mehru mithl*[1].

2- Mes komentuesve ka diskutim, nëse për këtë ligj të përgjithshëm, ka një miratim në kuptimin e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Disa, si Ibn Abasi, mendojnë se Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk është martuar me asnjë grua me këtë situatë. Në bazë të kësaj, ligji i mësipërm ishte një leje e përgjithshme për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, vetëm se ai nuk e zbatoi praktikisht.

Disa të tjerë kanë përmendur emrat e tre apo katër grave prej grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilat janë martuar pa mehër. Ato janë: Mejmuneh, e bija e Harithit dhe Zejneb e bija e Khazijmes. Të dyja kanë qenë prej ensarëve. Një grua nga fisi Beni Esed, që quhej Umu Sherik, e bija e Xhabirit dhe Khaule, e bija e Hakimit.

Ka transmetime, se, kur Khaule ia dhuroi veten Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Aishja kundërshtoi dhe tha: "*Si është çështja e grave që martohen pa mehër?!*". Atëherë zbriti ajeti i mësipërm. Mirëpo,

1 *Mehrul mithl* është ai mehër që gratë me kushtet dhe veçantit e tij e caktojnë për vetat e tyre.

edhe pse zbriti ajeti, Aishja u kthye nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe tha: *"E shoh, All'llahu po përmbush me nxitim dëshirën tënde."*. E ky ishte një lloj kundërshtimi ndaj Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha asaj: *"Edhe ti, nëse i bindesh All'llahut, Ai do të nxitojë ta plotësojë dëshirën tënde."*.[1]

Nuk ka asnjë dyshim se këto gra nuk dëshironin asgjë përveç shoqërimin me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kishin krenari të madhe shpirtërore, sa ishin të gatshme të martoheshin me të, pa asnjë lloj pagese, mehri. Vetëm se ekzistenca e një miratimi të tillë, të ligjit të mësipërm, nuk është e pa diskutueshme nga ana kronologjike, siç kemi thënë, përkundrazi e padiskutueshme është se All'llahu i Madhëruar i kishte dhënë leje Profetit të Tij për atë gjë. Se cili ishte qëllimi i kësaj leje, do të flasim në vijim.

3- Nga ky ajet përfitohet se zbatimi i modelit të kontratës së martesës, me shprehjen *"el hibetu"* - *"të dhuroj veten"*, ishte vetëm për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Asnjë person tjetër nuk mundet të zbatojë marrëveshjen e martesës me këtë shprehje. Lejohet zbatimi i aktit, me shprehjen e martesës apo të nikahut, edhe sikur të mos

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 365. Fundi i ajetit është burimi i komentimit. Në tefsirin e "Kurtubijut" gjendet thënia: *"Për Zotin, mendoj se po nxiton shumë në përmbushjen e dëshirës tënde."*. E ka përmendur atë edhe Alusij në tefsirin "Ruhul Meanij", në fundin e ajetit që po komentojmë. Me të vërtetë, shëmtia e kësaj shprehjeje dhe kuptimi që u fsheh në të, nuk i fshihet askujt, vetëm se Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ia vuri veshin dhe e kaloi në mënyrë të shkëlqyer.

përmendet mehri në të. Edhe në mungesë të përmendjes së mehrit, duhet të bëhet e njëjta pagesë, siç thamë më parë.

Hulumtim

Ana urtësisë në poligaminë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Fjalia e fundit në ajetin e mësipërm tregon filozofinë e këtyre ligjeve të veçanta për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka rrethana që të tjerët nuk i jetojnë. Ky ndryshim në rrethana është bërë shkak i ndryshimit në ligje.

Qëllimi i vendosjes së këtyre ligjeve, ishte largimi i disa problemeve dhe vështirësive nga kurrizi i Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo është një shprehje e ëmbël, që bën të qartë se martesa e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me disa gra ishte për zgjidhjen e një zinxhiri problemesh shoqërore dhe politike në jetën e tij, sepse ne e dimë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i vetëm kur ftonte Islam. Pas një kohe të gjatë, atij nuk i besoi vetëm se një numër i vogël. Ai kundërshtoi të gjitha besimet të kohës së tij dhe mjedisit të tij pagan e të mbushur me legjenda. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) shpalli luftë kundër të gjithëve. Ishte e padiskutueshme që popujt dhe fiset të bashkoheshin kundër tij.

Në këtë situatë, ai duhet të mbrohej me të gjitha mjetet dhe t'i shfrytëzonte ato për të thyer bashkimin e armiqve. Njëra prej këtyre mjeteve, ishte martesa me fise të ndryshme, për të krijuar lidhje të afërta fisnore dhe trashëguese, pasi lidhja farefisnore, mes arabëve të injorancës së hershme, konsiderohej ndër lidhjet më të forta. Mbrojtjen e dhëndrit nga i njëjti fis ishte detyrë, kurse braktisja e tij, duke e lënë vetëm, konsiderohej krim dhe mëkat.

Kemi shumë fakte që bëjnë të qartë se martesa e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me shumë gra kishte karakter politik, si martesa e tij me Zejneben, që ishte për të thyer zakonin e injorancës. Këtë e kemi sqaruar në analizën e fundit të ajetit 37 të kësaj sureje. Një pjesë e martesave ishte për të zvogëluar armiqësinë apo për të tërhequr dashurinë e personave apo popujve fanatikë dhe kokëfortë.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u martua në moshën njëzet e pesë vjeçare, në lulen e rinisë së tij, me një grua që kishte dyzet vite mbi supe dhe jetoi vetëm me të deri në moshën pesëdhjetë e tre vjeçare. Me këtë grua ai kishte kaluar fazën e rinisë dhe po arrinte moshën e pleqërisë, pastaj kalon në martesën e shumëfishtë. Në këtë veprim të tij, patjetër duhet të ketë një shkak dhe filozofi. Në asnjë mënyrë nuk mund të komentohet me shkaqet e lidhjes dhe dëshirës seksuale, sepse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kishte pengesë

shoqërore apo rrethana të vështira pasurore, apo mangësinë më të vogël që ta pengonte të martohej shumë herë në moshën e rinisë së tij. Numri i madh i grave ishte një gjë normale mes arabëve në atë kohë, madje gruaja e parë mund ta fejonte vetë me gruan e dytë. Nuk njihnin asnjë kufi në marrjen e grave.

Është interesante se në librat e historisë përmendet se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është martuar vetëm me një virgjëreshë, që është Aishja. Pjesa tjetër e grave të tij kanë qenë të gjitha të veja.[1]

Në disa histori lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është martuar me disa gra dhe nuk ka bërë asgjë tjetër përveç ceremonisë së lidhjes, nuk ka kryer kurrë marrëdhënie me to. Madje, në disa raste është mjaftuar vetëm me fejesën e grave të disa fiseve.[2]

Ato fise kënaqeshin, gëzoheshin dhe krenoheshin se një grua nga fisi i tyre është quajtur gruaja e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. E kishin për mburrje. Pa dyshim se lidhjet e tyre shoqërore me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* rriteshin, forcoheshin dhe ata bëheshin më të vendosur për ta mbrojtur atë.

Nga ana tjetër, edhe pse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ishte një burrë steril, ai ka pasur shumë pak fëmijë, në kohën kur martesa me shumë gra, sikur të ishte për shkak të tërheqjes së këtyre grave dhe eksitimit seksual, atëherë ai duhet të kishte shumë fëmijë.

1 "Biharul Anuar", vëll. 22, faqe 191-192.
2 I njëjti burim.

Duhet të themi se disa prej këtyre grave, si Aishja, e cila ka qenë shumë e vogël, kur është bërë bashkëshorte e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kaluan vite, derisa ajo u bë grua e vërtetë për të. Kjo shpall se qëllimi i martesave me këto vajza të vogla, nuk ka qenë ana seksuale. Qëllimi kryesor ishte ai që treguam pak më parë.

Armiqtë e Islamit, numrin e madh të martesave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e bënë shigjetë për sulmet e tyre më të fuqishme e të padrejta. Fabrikonin me to trillime më të ngatërruara se fija e merimangës, për të kundërshtuar Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Vetëm se mosha e madhe e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur ai guxoi përsëritjen e martesës, nga njëra anë dhe rrethanat e veçanta në lidhje me gratë, nga aspekti i moshës dhe fisit, nga ana tjetër dhe kontekstet e ndryshme që i treguam në një pjesë të tyre, pak më parë, nga një anë e tretë, e bëjnë të vërtetën të qartë si Dielli dhe i shkatërron kurthet e tendenciozëve dhe ua çjerr maskën atyre.

Ajeti 51

﴿تُرْجِي مَنْ تَشَاءُ مِنْهُنَّ وَتُؤْوِي إِلَيْكَ مَنْ تَشَاءُ وَمَنِ ابْتَغَيْتَ مِمَّنْ عَزَلْتَ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْكَ ذَلِكَ أَدْنَى أَنْ تَقَرَّ أَعْيُنُهُنَّ وَلَا يَحْزَنَّ وَيَرْضَيْنَ بِمَا آتَيْتَهُنَّ كُلُّهُنَّ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا فِي قُلُوبِكُمْ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَلِيمًا٥١﴾

"Ti mund ta largosh kë të duash prej tyre e të afrosh kë të duash e nuk është gjynah për ty t'i kërkosh (ato) **prej të cilave je larguar. Kjo është më e përshtatshme që ato të gëzohen, që të mos pikëllohen dhe që të jenë të kënaqura me atë që u ke dhënë. All'llahu e di ç'ka në zemrat tuaja; All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Butë."**

Shkaku i zbritjes

Kur kemi komentuar ajetet 28-29 të kësaj sureje, për shkakun e zbritjes së tyre, kemi thënë se një pjesë e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sipas asaj që kanë transmetuar komentuesit, i patën thënë Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë*

mbi të dhe mbi familjen e tij!) që t'ua shtonte më shumë buxhetin për shpenzimet ditore. Ato dëshironin më shumë pjesë nga plaçka e luftës, sepse mendonin se pjesa më e madhe e saj, u takonte atyre. Zbritën ajetet 28-29 dhe u folën tepër qartë atyre se, nëse ato dëshironin jetën e kësaj bote dhe bukurinë e saj, atëherë le të ndahen përgjithmonë nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe, nëse e duan All'llahun, të Dërguarin e Tij dhe Ditën e Fundit, atëherë le të jetojnë me të një jetë të thjeshtë.

Duhet të shtojmë se kishte konkurrencë mes tyre, për mënyrën se si Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ndante kohën e jetës së tij mes tyre. E shqetësonin dhe e ngushtonin atë, pavarësisht problemeve dhe angazhimeve që ai kishte.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i kujdesshëm, i drejtë mes tyre dhe shpenzonte kohën e nevojshme, duke ia plotësuar secilës kohën e saj. Por polemika e tyre ishte e vazhdueshme. Prandaj zbriti ky ajet dhe i dha liri Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në ndarjen e kohës së tij. Ajeti u shpalli atyre se ky është një ligj hyjnor, me qëllim që në shpirtrat e tyre të mos lindte asnjë frikë dhe mendim i keq.[1]

1 Marrë nga tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 366 dhe tefsiret e tjera.

Komentimi

Zgjidhja e një problemi tjetër në jetën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Nuk ka asnjë dyshim se një udhëheqës i madh i zgjedhur nga All'llahu si Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që u sprovua me rrjedhjen e ngjarjeve të vështira, të hidhëta, që i thurnin intriga dhe kurthe të jashtme dhe të brendshme, nuk kishte mundësi të mendonte shumë për jetën e tij personale, përkundrazi ai duhet të kishte qetësi të brendshme, që të forconte angazhimin e tij në zgjidhjen e problemeve që e kishin rrethuar atë nga çdo anë. Pa dyshim se shqetësimi i jetës personale dhe angazhimi i zemrës dhe i mendjes së tij në gjendjen e tij familjare, në këto çaste të vështira, ishte një çështje tejet e rrezikshme.

Megjithëse poligamia e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, çështjet e të cilës i kemi përmendur në komentimin e ajetit 50, kishte më shumë dimensione politike, shoqërore dhe familjare dhe në të vërtetë ishte pjesë e zbatimit të mesazhit të All'llahut të Madhëruar, mirëpo kontradikta mes grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe konkurrenca femërore, e njohur mes tyre, shkaktoi furtunë brenda shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo gjë e futi në mendime dhe e shtoi shqetësimin e tij.

Këtu All'llahu i Madhëruar i dha Profetit të Tij një tjetër veçori. I ndaloi përgjithmonë këto ngjarje, këto ecejake dhe polemika. Qetësoi mendjen dhe shpirtin e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. All'llahu i Madhëruar e nis këtë ajet: **"Ti mund ta largosh kë të duash prej tyre e të afrosh kë të duash."**.

Fjala *"turxhi"*, rrjedh nga fjala *"irxhaun"*, që do të thotë: të largosh. Fjala *"tu'viu"*, rrjedh nga fjala *"el iuau"* dhe do të thotë: të shtosh një person në shtëpinë tënde.

Ne e dimë se rregullat e Islamit në lidhje me poligaminë, kërkojnë që burri ta ndajë me drejtësi kohën e tij mes bashkëshorteve. Nëse një natë fle te njëra, atëherë natën tjetër duhet të shkojë te tjetra, pasi nuk ka dallim dhe ndarje mes grave nga kjo anë. Në librat e jurisprudencës islame, kjo temë etiketohet me emrin "E drejta e ndarjes së kohës".

Një nga veçoritë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte lirimi nga kujdesi i të drejtës së betimit nga ai, me ligjin e ajetit 51. Kjo si rezultat i rrethanave të veçanta dhe situatave shqetësuese që e rrethonin atë nga çdo anë e në mënyrë të veçantë, lufta që i kërcënohej atij gati çdo muaj. Në të njëjtën kohë, ai kishte shumë gra. Me anë të këtij ligji, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte mundësi ta ndante kohën e tij si të dëshironte. Por ai kujdesej shumë për zbatimin e drejtësisë, pavarësisht këtyre rrethanave.

Prania e këtij ligji hyjnor u dha grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!) ekuilibrin shpirtëror dhe futi në jetën e tij të brendshme qetësinë dhe paqen shpirtërore.

Ajeti i thotë se, nëse je i pakënaqur me ndonjërën prej tyre dhe e veçon atë, pastaj ti shfaq interes për të, atëherë ti nuk ke asnjë mëkat: **"Nuk është gjynah për ty t'i kërkosh** (ato) **prej të cilave je larguar."**.

Me këto fjalë, All'llahu i thotë se zgjedhja e tij nuk është vetëm në fillim, por është edhe në vazhdim, d.m.th, të bësh zgjedhje në mënyrë të vazhdueshme. Me këtë ligj të gjerë do të priten justifikimet nga programi i jetës tënde në lidhje me bashkëshortet e tua dhe mendimin tënd mund t'ia nënshtrosh përgjegjësive të mesazhit madhështor.

Gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duhet ta mësonin se, nëse ato i binden urdhrit të All'llahut të Lartësuar, në çështjen e ndarjes së kohës së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ajo konsiderohet medalje nderi për to, që i shtohet nderit si bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky dorëzim është një lloj sakrifice dhe altruizmi. Nuk ka në të asnjë turp dhe lëshim.

All'llahu i Madhëruar vazhdon fjalën e Tij: **"Kjo është më e përshtatshme që ato të gëzohen, që të mos pikëllohen dhe që të jenë të kënaqura me atë që u ke dhënë."**.

Ka disa pika që duhet të theksohen në këtë ligj:

Së pari: Ky ligj i përgjithshëm i përfshin të gjitha ato dhe nuk bën asnjë dallim.

Së dyti: Ligji që vendoset nga ana e All'llahut të Madhëruar, bëhet legjitim për një dobi të rëndësishme. Në bazë të kësaj, duhet t'i bindesh atij me dëshirë dhe kënaqësi dhe, përveç mungesës së frikës, duhet të gëzohesh për të.

Mirëpo Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, siç e kemi treguar, kujdesej shumë për ndarjen me drejtësi të kohës mes tyre, aq sa mundej, përveç rrethanave të veçanta, ku ishte i detyruar të mos mbante drejtësi.

Kjo vetë ishte një kërkesë tjetër, që nxiste rehatinë e tyre, sepse ato mendonin se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përpiqet për barazinë mes tyre, ishte vetë ai që zgjidhte.

Në fund, e përfundon kërkesën me këtë fjali: **"All'llahu e di ç'ka në zemrat tuaja; All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Butë."**. Ai nuk nxiton në zbritjen e dënimit ndaj mëkatarëve.

All'llahu e di se për çfarë ligji jeni të kënaqur dhe i jeni bindur Atij me zemrat tuaja. Gjithashtu, e di se për çfarë ligji nuk jeni të kënaqur. All'llahu i Madhëruar e di se kë prej grave tuaja ju doni më shumë dhe kë prej tyre interesoheni më pak. E di se si e ruani dhe e zbatoni ligjin e Tij.

Po kështu, All'llahu i Madhëruar, e di se kush janë ata që të ulen afër dhe kundërshtojnë ligjet e All'llahut, në lidhje me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i kundërshtojnë ato me zemrat e tyre. Ai e di se kush kënaqet me ligjet e Tij dhe i pranon ato pa kundërshtuar.

Në bazë të kësaj, togfjalëshi **"zemrat tuaja"**, është gjithëpërfshirës, përfshin Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, bashkëshortet e tij dhe të gjithë besimtarët që i pranojnë, i kundërshtojnë apo i mohojnë këto ligje, edhe nëse ky kundërshtim dhe mohim nuk duket.

Hulumtim

A ishte ky ligj në të drejtën e të gjitha grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)***?**

Kjo çështje ka qenë objekt diskutimi në jurisprudencën islame, në kapitullin "Veçoritë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*": Ndarja e barabartë e kohës, mes numrit të madh të bashkëshorteve ishte detyrë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, siç ishte detyrë e të gjithë myslimanëve, apo për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte ligji i përzgjedhjes përjashtuese?

Ajo që dihet dhe është e njohur mes dijetarëve shiitë dhe te shumica e dijetarëve synitë, është se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i përjashtuar nga ky ligj. Ajeti i mësipërm është argument për këtë: **"Ti mund ta largosh kë të duash prej tyre e të afrosh kë të duash."**.

Kjo fjali përfshin vetëm gratë Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këtë e tregon përemri *"hunne"*. Kjo gjë është pranuar te dijetarët dhe te shumica e komentuesve të Kur'anit.

Disa mendojnë se përemri i mësipërm lidhet me gratë që ia dhuruan veten e tyre Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pa mehër.[1] Ndërkohë që nuk është vërtetuar historikisht se ky ligj është zbatuar apo jo dhe a ka objektivitet dhe vërtetësi apo jo. Disa të tjerë mendojnë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk është martuar në këtë mënyrë përveçse me një grua. Si do që të jetë, **së pari** rrënja e çështjes nuk është vërtetuar nga ana historike.

Së dyti: Ky komentim është në kundërshtim me aparencën dhe nuk harmonizohet me shkakun e zbritjes, që e përmendëm për këtë ajet. Në bazë të kësaj, duhet të pranohet ligji i përmendur nga të gjithë.

1 Për më tepër sqarim, shiko tefsirin "Mexhmaul Bejan", fundi i ajetit është burimi i komentimit dhe tefsirin "Kenzul Urfan", vëll. 2, f. 238 e më pas.

Ajeti 52

﴿لَا يَحِلُّ لَكَ النِّسَاءُ مِنْ بَعْدُ وَلَا أَنْ تَبَدَّلَ بِهِنَّ مِنْ أَزْوَاجٍ وَلَوْ أَعْجَبَكَ حُسْنُهُنَّ إِلَّا مَا مَلَكَتْ يَمِينُكَ وَكَانَ اللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ رَقِيبًا٥٢﴾

"Këtej e tutje nuk të lejohen më gra të tjera, as të marrësh tjetër grua në vend të tyre, edhe sikur të të magjepsë bukuria e tyre, përveç skllaveve. All'llahu është mbikëqyrës për çdo gjë."

Komentimi

Një ligj tjetër i rëndësishëm për gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

All'llahu i Madhëruar ka bërë të qartë në këtë ajet një ligj tjetër prej ligjeve, për bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Këtej e tutje nuk të lejohen më gra të tjera, as të marrësh tjetër grua në vend të tyre, edhe sikur të të magjepsë bukuria e tyre, përveç skllaveve."**.

Ajeti ia ka ndaluar të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të martohet përsëri, përveç vejushave dhe atyre që ka (robëreshat): **"All'llahu është mbikëqyrës për çdo gjë."**.

Komentuesit e Kur'anit dhe dijetarët islamë kanë pasur shumë hulumtime për këtë ajet. Për këtë kapitull janë përmendur transmetime të ndryshme në burimet islame. Po përmendim në fillim atë që duket në pamje të parë të ajetit, i cili është i lidhur me ajetet e mëparshme dhe me ato që vijnë më pas, duke lënë mënjanë thëniet e komentuesve, e më pas do të trajtojmë temat e tjera.

Nga aparenca e shprehjes *"min ba'du"*, duket se martesa për ty është e ndaluar pas kësaj. Në bazë të kësaj, fjala *"ba'du"*, ose vjen me kuptimin kohorë, domethënë, mos merr grua pas kësaj kohe. Ose kuptimi mund të jetë: Ti i bëre gratë e tua të zgjedhin mes qëndrimit me ty dhe jetës së thjeshtë në shtëpinë tënde dhe mes lëshimit, divorcit të tyre. Ato vendosën të qëndrojnë me ty, pavarësisht dëshirave të tyre, prandaj nuk të lejohet të martohesh me një grua tjetër.

Po kështu ti nuk mund të ndash një pjesë të tyre dhe të zgjedhësh në vend të tyre gra të tjera. Thënë ndryshe: as mos e shto numrin e tyre dhe as mos i zëvendëso ato.

Hulumtime

1- Filozofia e këtij ligji

Ky përcaktim për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk konsiderohet mangësi, madje ai është një rregull që ka një filozofi shumë preçize, sepse, sipas dëshmive që përfitohen nga historia, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qenë nën një presion të madh nga ana e personave dhe fiseve të ndryshme, që të martohej me gra të tjera prej fiseve të tyre. Secili fis mysliman i krenohej fiseve arabe se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i lidhur me martesë me ta dhe një pjesë e grave ishin të gatshme që t'ia dhuronin veten e tyre Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pa mehër, martoheshin me të pa asnjë kusht dhe marrëveshje, siç u përmend.

Kjo lidhje bashkëshortore me këto fise dhe popuj ishte një zgjidhje e problemeve të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe realizuese e qëllimeve të tij shoqërore dhe politike. Nëse kalohet kufiri, është normale që të krijohen probleme. Mbase çdo fis shpresonte se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të merrte një bashkëshorte prej tyre. Po të donte Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të realizonte shpresat e të gjithëve dhe të zgjidhte prej tyre bashkëshorte, edhe sikur të ishte thjesht formale, pa kryer marrëdhënie, do t'i sillte shumë vështirësi atij. Për këtë

arsye, All'llahu i Urtë, e ndaloi këtë gjë dhe doli me një ligj, duke e ndaluar Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të martohej sërish dhe të zëvendësonte gratë e tij.

Por, kishte njerëz që gjenin mënyra të ndryshme për t'ia arritur qëllimit të tyre, duke u justifikuar se shumica e grave të tij ishin të veja. Në mesin e tyre kishte edhe gra të bukura dhe ishte më e mirë për të, që të martohej me grua të bukur. Kur'ani vendosi edhe këtë çështje: Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka më të drejtë të martohej me gra të tjera pas kësaj, edhe nëse i pëlqenin dhe ishin të bukura.

Duhet të shtojmë se bukuria e bënte të detyrueshme që All'llahu i Lartësuar ta bënte këtë ligj dhe ta urdhëronte Profetin e Tij ta zbatonte këtë ligj, duke ruajtur kështu pozitën e bashkëshorteve të tij, pasi ato e dhanë fjalën, besën e tyre dhe pëlqyen jetën e thjeshtë shpirtërore me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndaj çdo gjëje tjetër.

Ndërsa, përsa i përket çështjes që ka lidhje me robëreshat dhe me ato që janë nën pronësi, me të cilat u lejua martesa, kjo është përmendur sepse problemi i Profetit ishte me gratë e lira. Prandaj, nuk gjendej domosdoshmëri që të ftonte në përcaktimin e këtij ligji në lidhje me robëreshat, edhe pse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka përfituar nga ky përjashtim sipas dëshmive historike.

Kjo është ajo që duket në pamje të parë të ajetit.

2- Transmetimet kundërshtuese

Në disa transmetime, një pjesë e të cilave të dobëta nga ana e zinxhirit të transmetimit dhe një pjesë tjetër meritojnë vëmendjen, e kanë konsideruar fjalinë: **"Këtej e tutje nuk të lejohen më gra të tjera"**, se tregon ndalimin e martesës me ato gra, dispozita e të cilave u sqarua në ajetet 23-24 të sures "En Nisa", që janë: nëna, vajza, motra, halla dhe tezja... Në fund të disa prej këtyre transmetimeve thuhet qartë: Si është e mundur që gratë të jenë të lejuara për të tjerët dhe të ndaluara për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*? Nuk ka pasur asnjë grua të ndaluar për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përveç atyre që u janë ndaluar të gjithëve.[1]

Sigurisht, duket shumë larg që ajeti 52 të tregojë kategoritë e grave të përmendura në ajetet e sures "En Nisa". Disa transmetime kanë bërë të qartë se ajo që ka për qëllim togfjalëshi: **"këtej e tutje"**, është dimensioni i ndalesave në ajetet e sures "En Nisa".

Në bazë të kësaj, më e mira është ta heqim shikimin nga komentimi i këtyre transmetimeve. Le ta lëmë diturinë e asaj tek ithtarët e tij, domethënë, ata që janë të mbrojtur nga mëkati, sepse ata nuk harmonizohen në dukje me ajetin. Ne jemi të detyruar të lexojmë fillimin e ajetit, kurse lajmet e përmendura janë nga mendja.

1 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 294-295.

Një grup i madh beson se ajeti 52 ia ka ndaluar Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* çdo martesë të re. Por ky ligj më pas është anuluar dhe iu lejua atij të martohej, edhe pse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas kësaj, nuk u martua më, derisa erdhi ajeti: **"Ne të kemi lejuar ty bashkëshortet e tua, të cilave u ke dhënë shpërblimin e tyre..."**. Ky ajet ka zbritur para ajetit 52. Ata e konsiderojnë atë kopje të këtij ajeti dhe besojnë se ky ajet, është shkruar në Kur'an pas ajetit: **"Ne ta kemi lejuar ty ..."**. Vetëm se ky ajet i fundit ka zbritur para të parit. Madje, Fadil El Mikdad, në veprën "Kenzul Urfan", transmeton se ky është mendimi këshillues i njohur mes djetarëve.[1]

Ky mendim bie në kontradiktë me transmetimet e mësipërme, si dhe nuk harmonizohet me aparencën e ajeteve, sepse aparenca e ajeteve inspiron se ajeti: **"Ne t'i kemi lejuar ty bashkëshortet e tua.**", ka zbritur para ajetit që po komentojmë. Çështja e abrogimit *(en neskhu)* ka nevojë për një argument të prerë.

Si do që të jetë, ne nuk kemi asnjë gjë më të plotësuar e më të qartë se sa vetë aparenca e ajetit dhe sipas saj, çdo martesë e re apo zëvendësim i grave iu ndalua Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pas zbritjes së këtij ajeti. Për këtë ligj kishte dobi dhe interesa të rëndësishme, që i kemi treguar më sipër.

1 "Kenzul Urfan", vëll. 2, f. 244.

3- A është e lejuar ta shikosh gruan e ardhshme, para martesës?

Një grup komentuesish, fjalinë: **"edhe sikur të të magjepsë bukuria e tyre"**, e kanë konsideruar një argument për ligjin e njohur, që përmendet në transmetimet islame. Ai ligj thotë: Ai që dëshiron të martohet me një grua, mund ta shikojë atë që të mund të dallojë formën dhe tiparet e saj.

Urtësia e këtij ligji është që njeriu të zgjedhë gruan e tij me një shikim të plotë, që më pas të mos pendohet, t'i vijë keq, kur lidhja bashkëshortore dhe formimi familjar të kërcënohet me ndarje. Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë këshillën që ai i ka thënë njërit prej shokëve të tij, kur ai dëshironte të martohej: *"Shikoje atë, sepse është më e merituar që martesa të vazhdojë gjatë mes jush."*.[1]

Nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë përgjigjen e kësaj pyetjeje: A mund ta shohë burri me imtësi gruan, nëse ai dëshiron të martohet me të? A mund ta shikojë fytyrën e saj? Ai u përgjigj: *"Nuk ka asnjë gjë të keqe, që burri ta shikojë gruan, nëse ai dëshiron të martohet me të. Lejohet ta shikojë edhe fytyrën."*.[2]

Hadithet e përmendura për këtë çështje janë të shumta. Disa kanë bërë të qartë se ky shikim nuk duhet të jetë nxitës i pasionit dhe i epshit.

Është e qartë gjithashtu se ky ligji është i veçantë për ato raste kur njeriu dëshiron dhe ka vendosur me të vërtetë të

1 Tefsiri i Kurtubijut, vëll. 8, f. 5303.
2 "Uesailu Shia", vëll. 14, kreu 36 "Martesa", Hadithi 3.

martohet. Ndërsa, ai person që nuk vendos për martesë, por supozon të martohet dhe dëshiron thjeshtë të kërkojë, atëherë nuk i lejohet atij që të shikojë femrat.

Disa komentues të tjerë kanë supozuar se ky ajet tregon për shikimin e grave aksidentalisht dhe jo me dëshirë. Mbi këtë fakt, ajeti nuk tregon për ligjin e përmendur më parë dhe argumenti i vetëm për të do të jenë transmetimet. Vetëm se fjalia: **"edhe sikur të të magjepsë bukuria e tyre",** nuk harmonizohet me shikimin e shpejtë aksidental. Si rrjedhim, tregimi i saj për ligjin e përmendur duket larg.

Ajetet 53 – 54

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتَ النَّبِيِّ إِلَّا أَنْ يُؤْذَنَ لَكُمْ إِلَى طَعَامٍ غَيْرَ نَاظِرِينَ إِنَاهُ وَلَكِنْ إِذَا دُعِيتُمْ فَادْخُلُوا فَإِذَا طَعِمْتُمْ فَانْتَشِرُوا وَلَا مُسْتَأْنِسِينَ لِحَدِيثٍ إِنَّ ذَلِكُمْ كَانَ يُؤْذِي النَّبِيَّ فَيَسْتَحْيِي مِنْكُمْ وَاللَّهُ لَا يَسْتَحْيِي مِنَ الْحَقِّ وَإِذَا سَأَلْتُمُوهُنَّ مَتَاعًا فَاسْأَلُوهُنَّ مِنْ وَرَاءِ حِجَابٍ ذَلِكُمْ أَطْهَرُ لِقُلُوبِكُمْ وَقُلُوبِهِنَّ وَمَا كَانَ لَكُمْ أَنْ تُؤْذُوا رَسُولَ اللَّهِ وَلَا أَنْ تَنْكِحُوا أَزْوَاجَهُ مِنْ بَعْدِهِ أَبَدًا إِنَّ ذَلِكُمْ كَانَ عِنْدَ اللَّهِ عَظِيمًا ٥٣ إِنْ تُبْدُوا شَيْئًا أَوْ تُخْفُوهُ فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا ٥٤﴾

"O ju që keni besuar, mos hyni në shtëpitë e të Dërguarit, përveç rastit kur ju është dhënë leje për të ngrënë, por jo të pritni përgatitjen e tij (ushqimit)**! Hyni vetëm kur t'ju thërrasin dhe, pasi të hani, shpërndahuni! Mos qëndroni pas ushqimit për të biseduar me njëri-tjetrin. Kjo, me të vërtetë, e shqetësonte të Dërguarin e ai turpërohej** (që t'jua thoshte këtë)**, ndërsa All'llahu nuk turpërohet që t'jua thotë të vërtetën. Kur të kërkoni prej grave të Profetit diçka, kërkojeni prapa perdes! Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të atyre. Juve nuk ju lejohet që ta shqetësoni të Dërguarin e All'llahut, as që të**

martoheni me gratë e tij pas (vdekjes së) **tij. Kjo është vërtet gjynah i madh para All'llahut."**

"Çfarëdo që të shfaqni apo të fshihni, (dijeni se) **All'llahu është vërtet i Gjithëdijshëm për çdo gjë."**

Shkaku i zbritjes

Komentuesit, për shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve, kanë thënë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sapo u martua me Zejneb bint Xhahshin, u shtroi njerëzve një gosti të madhe. Kemi thënë më parë se këto rregulla mbase kanë qenë për shkak të shkatërrimit të zakonit të injorancës, në aspektin e ndalimit të grave të divorcuara të djalit të adoptuar. Ky shkatërrim ka pasur rreze të gjerë përhapje. Me këtë martesë, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kërkonte ta fshinte këtë zakon të injorancës, që e konsideronte martesën me gra të veja të skllevërve të lirë, një turp dhe çnderim.

Enesi, shërbëtori i veçantë i Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tregon: "Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më urdhëroi të ftoj shokët e tij për drekë. I ftova. Ata vinin në grupe, hanin dhe largoheshin. I thashë: 'O i Dërguari i All'llahut, nuk ka mbetur njeri që nuk e kam ftuar.'". Pastaj urdhëroi që të ngrihej sofra dhe e ngritëm. Njerëzit u shpërndanë,

përveç tre personave që mbetën në shtëpinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe bisedonin.

Kur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pa që biseda e tyre u zgjat, u ngrit. U ngrita edhe unë bashkë me të, me qëllim që njerëzit të kthenin shikimin dhe të shkonin në punë të tyre. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* doli dhe iu afrua dhomës së Aishes. Pastaj u kthye përsëri dhe unë isha bashkë me të dhe i pashë ata njerëz të ulur akoma në gjendjen e tyre. Atëherë, zbriti ajeti i mësipërm dhe ua kumtoi atyre mënyrën e sjelljes.[1]

Nga disa transmetime lexojmë se komshinjtë dhe njerëzit e tjerë vinin te disa gra të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe zbulonin gjëra sipas njohjes dhe zakonit. Ata nuk bënin ndonjë mëkat, sipas jetës së thjeshtë në atë kohë. Ajeti i mësipërm ka zbritur për të ruajtur bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i urdhëroi besimtarët se, nëse ata dëshirojnë të marrin diçka nga gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, atëherë le ta marrin atë nga pas perdes.

Në një transmetim tjetër thuhet se disa kundërshtarë të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kanë thënë se një pjesë e grave të tyre janë martuar me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë*

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 366, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

mbi të dhe mbi familjen e tij!). Nëse ai vdes, ata do t'i martojmë gratë e tij. Zbriti ajeti i mësipërm dhe e ndaloi martesën me gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas vdekjes së tij dhe i dha fund këtij kurthi.[1]

Komentimi

Edhe një herë tjetër, biseda u adresohet besimtarëve. Ajeti, me fjali të shkurtra, të qarta dhe elekuente, sqaron një anë tjetër të dispozitave islame, veçanërisht dispozitën që lidhet me edukatën e shoqërimit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shtëpisë së profecisë.

Dispozita e parë thotë: Nuk u lejohet juve hyrja në shtëpitë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, vetëm nëse ftoheni për ushqim dhe ju jepet leja për të hyrë, me kusht që të hyni në kohën e caktuar e jo të vini para asaj kohe dhe të uleni duke pritur kohën e ngrënies: **"O ju që keni besuar, mos hyni në shtëpitë e të Dërguarit, përveç rastit kur ju është dhënë leje për të ngrënë, por jo të pritni përgatitjen e tij** (ushqimit)**!"**.[2]

Ajeti bën të qartë një nga etikat e rëndësishme të shoqërimit, e cila, sadopak, ruhej në atë mjedis, edhe pse fjala

1 Burimi i mëparshëm, f. 366-368.

2 Fjala *"inahu"* rrjedh nga fjala *"enna, je'nni"*, domethënë, afrimi i kohës së diçkaje. Këtu ka kuptimin: përgatitja e ushqimit për konsumim.

sillet rrotull shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Është e padiskutueshme se ky ligj nuk është vetëm për të, pasi nuk duhet të hyhet në shtëpinë e askujt pa lejen e tij (siç thuhet në ajetin 27 të sures "Nur"). Lexojmë se, kur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dëshironte të hynte në shtëpinë e vajzës së tij, Fatimes *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, qëndronte jashtë dhe merrte leje. Një ditë me të ishte Xhabir ibn Abullahu dhe kërkoi leje për të, pasi kërkoi leje për veten e tij.[1]

Duke shtuar se, nëse ata ftohen për ushqim, atëherë duhet ta dinë mirë kohën, me qëllim që të mos e fusin të parin e shtëpisë në mundim dhe shqetësim, jashtë mundësive të tij.

Dispozita e dytë: "Hyni vetëm kur t'ju thërrasin dhe, pasi të hani, shpërndahuni!"

Kjo dispozitë është plotësuese dhe miratuese e dispozitës së mëparshme, prandaj mos hyni në shtëpinë që jeni ftuar, jashtë kohës së thirrjes dhe në një kohë të papërshtatshme. Mos e neglizhoni përgjigjen e ftesës apo të mos interesoheni për të. Mos u vononi shumë, pasi të keni ngrënë. Është e padiskutueshme se kundërshtimi i këtyre çështjeve dhe mosndjekja e tyre, do të çojë në lëndim dhe shqetësim të mikpritësit. Kjo nuk i shkon përshtat bazave morale.

Dispozita e tretë: "Mos qëndroni pas ushqimit për të biseduar me njëri-tjetrin."

1 "Usulul Kafij", vëll. 5, f. 528.

Pasi të konsumoni ushqimin, mos u ulni në rreth dhe të filloni bisedën, njësoj si ishte në shtëpinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo në shtëpinë e kujtdo tjetër që ju ka ftuar.

Sigurisht që mysafirët mund të kënaqen në tubime dhe biseda të tilla. Kjo është një situatë përjashtuese, mirëpo fjala është nëse ftesa është vetëm për ngrënie e jo për të formuar mbledhje. Duhet të largoheni, pasi të keni konsumuar ushqimin, sidomos nëse shtëpia është si shtëpia e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, vendi i zbatimit, i kryerjes së mesazheve më të mëdha e madhështore të All'llahut. Nuk duhet ta çojë dëm kohën e tij me çështje anësore, dytësore, që e pengojnë atë për zbatimin e mesazhit të All'llahut.

Më pas ajeti sqaron arsyen e kësaj dispozite: **"Kjo, me të vërtetë, e shqetësonte të Dërguarin e ai turpërohej** (që t'jua thoshte këtë)**, ndërsa All'llahu nuk turpërohet që t'jua thotë të vërtetën."**.

Është e padiskutueshme se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ishte në dyshim asnjë çast dhe nuk i frikësohej asgjëje apo të turpërohej në sqarimin e një të vërtete që nuk ka pasur dimension personal, vetëm se qartësimi i të vërtetës, nëse i referohet vetë folësit, nuk është çështje e bukur, e mirë, ndërsa sqarimi i saj nga ana e të tjerëve, pa dyshim se është i shkëlqyer, i pëlqyeshëm.

Më pas ajeti sqaron dispozitën e katërt në kapitullin e hixhabit: **"Kur të kërkoni prej grave të Profetit diçka, kërkojeni prapa perdes!"**.

Kemi thënë se kjo çështje ka qenë dhe vazhdon të jetë e zakonshme mes arabëve dhe shumë prej njerëzve. Nëse ata kishin nevojë ndonjë gjë, atëherë ata e kërkonin atë te komshinjtë e tyre. Edhe shtëpia e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk përjashtohej nga ky rregull, madje vinin tek ai në çdo kohë dhe kërkonin ndonjë gjë prej grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Është e qartë se ekspozimi i grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndaj shikimeve të njerëzve, edhe nëse ishin të veshura me hixhab, nuk ishte gjë e mirë, prandaj doli urdhri për njerëzit, që t'i merrnin gjërat pas perdes, ose pas derës.

Duhet të kihet kujdes këtu, se fjala "hixhab", në këtë ajet, nuk kupton veshjen e grave, madje ai është një dispozitë, rregull që i shtohet asaj që është vetëm për gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Nëse njerëzit duan diçka nga gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duhet ta marrin atë nga prapa perdes, për shkak të rrethanave të veçanta të grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ato duhet të mos shfaqen para njerëzve dhe të dalin para tyre, edhe sikur të jenë të veshura me hixhab. Ky ligj nuk ka ardhur për gratë e tjera, sigurisht, përkundrazi atyre u mjafton të ruajnë hixhabin islam.

Dëshmi për këtë që po themi është fjala *"el hixhabu"*. Nëse në bisedat tona të përditshme është përdorur me kuptimin e mbulimit të gruas, ajo, jo vetëm në librat e gjuhës, por edhe në shprehjet e dijetarëve tanë të jurisprudencës, nuk ka këtë kuptim.

Kuptimi i fjalës *"el hixhabu"*, është ajo gjë që pengon mes dy gjërave.[1]

Prandaj për membranën që gjendet mes zorrëve, zemrës dhe mushkërisë është përdorur togfjalëshi: *"perdja ndarëse"* .

Kur'ani Famëlartë e ka përdorur këtë fjalë me kuptimin, mbulesa apo perdja në disa vende, si ajeti 45 i sures "El Isra": **"Kur ti** (Muhammed) **lexon Kur'anin, Ne vëmë një perde të fshehtë mes teje dhe atyre që nuk besojnë në Jetën e Ardhshme."**.

Në ajetin 32 të sures "Sad", lexojmë: **"Ai tha: 'Unë shfaqa dashuri më të madhe për pasurinë** (kuajt)**, sesa për lutjen ndaj Zotit tim, derisa dielli humbi mbas malit."**.

Në ajetin 51 të sures "Esh Shuara": **"Asnjë njeriu nuk i është dhënë t'i flasë All'llahu, përveçse me anë të Frymëzimit ose pas perdes..."**.

Dijetarët e jurisprudencës islame për veshjen e grave, që nga kohët e hershme deri në ditët tona, kanë përdorur fjalën *"es sitru"*. Edhe në transmetimet islame është përdorur kjo shprehje apo e ngjashme me të. Përdorimi i fjalës *"el hixhabu"*, në lidhje me veshjen e gruas, është një term që është shfaqur më shumë në kohën tonë dhe shumë pak gjendet në historitë dhe në transmetimet islame.

Dëshmi tjetër është ajo që lexojmë në hadithin e transmetuar nga Enes ibn Maliku, shërbëtori i Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

1 "Lisanul Arab", lënda "Haxhebe".

familjen e tij!). Ai thotë: "Unë jam më shumë në dijeni se sa të tjerët me këtë ajet, ajetin e hixhabit. Kur Zejnebja iu dhurua të Dërguarit të All'llahut, isha bashkë me të në shtëpi. Gatoi ushqim dhe ftoi njerëzit. Ata u ulën duke biseduar. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* doli nga dhoma, pastaj u kthye brenda dhe ata vazhdonin duke biseduar. All'llahu i Madhëruar zbriti ajetin: **'O ju që keni besuar, mos hyni në shtëpitë e të Dërguarit...'** e deri te thënia '**kërkojeni prapa perdes'**. Ai vendosi ndarësen (el hixhab) dhe njerëzit u ngritën e ikën.".[1]

Në një transmetim tjetër nga Enesi lexojmë: "Ai shtroi mbulesën, perden mes meje dhe atij dhe, kur njerëzit e panë atë, u shpërndanë.".[2]

Në bazë të kësaj, Islami nuk i ka urdhëruar gratë myslimane që të ulen pas perdes dhe as ta braktisin rolin e tyre. Fjalët: "të mbuluara" apo "të veshura me hixhab", nuk kanë lidhje me gratë myslimane, pasi femra myslimane e ka për detyrë të zbatojë ligjin e All'llahut, mbulesën. Gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u urdhëruan me këtë urdhër të veçantë, për shkak të pranisë së shumë armiqve, ndjekës të turpit dhe tendenciozë. Ishte shumë e lehtë që t'u bëheshin akuza nga më të ndryshmet atyre.

Thënë ndryshe: Njerëzit u urdhëruan të kërkojnë pas perdes atë që duan nga gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Fjala *"uerae"* - *"prapa"*, e dëshmon këtë kuptim.

1 "Sahihu" i Buhariut, vëll. 6, f. 149.
2 Burimi i mëparshëm.

Për këtë, Kur'ani e sqaron filozofinë e kësaj dispozite dhe thotë: **"Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të atyre."**.

Pavarësisht se një justifikim i tillë nuk e kundërshton dispozitën e rekomandueshme, shfaqja e urdhrit në fjalinë: **"kërkojeni prapa perdes"**, nuk trondit argumentimin e tij, sepse një justifikim, shpjegim i tillë, është përmendur në kapitujt e dispozitave të tjera, të detyruara.

Në vijim ajeti sqaron **dispozitën e pestë**: **"Juve nuk ju lejohet që ta shqetësoni të Dërguarin e All'llahut."**. Edhe pse këto fjalë janë përmendur në të njëjtin ajet, që është shkuarja te shtëpia e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në një kohë të papërshtatshme dhe qëndrimi pas mbarimit të ushqimit, u ritheksuan përsëri këtu, për rëndësinë dhe peshën e madhe të përgjegjësisë që kishte mbi supe Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në shkakun e zbritjes u tha se disa hipokritë u betuan se do të martoheshin me gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas vdekjes së tij. Kjo e lëndoi shumë të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Pavarësisht kësaj, kuptimi i ajetit është universal sido që të jetë, pasi ai përfshin çdo lloj lëndimi.

Në fund ajeti bën të qartë **dispozitën e gjashtë** dhe të fundit, ndalimin e martesës së grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas vdekjes së tij: **"As që të martoheni me gratë e tij pas** (vdekjes së) **tij. Kjo është vërtet gjynah i madh para All'llahut."**.

Këtu shtrohet një pyetje: Si ua ndaloi All'llahu grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të merrnin një burrë tjetër, pas vdekjes së tij, kur një pjesë e tyre ishin shumë të reja?

Përgjigjja e kësaj pyetje bëhet e qartë, duke vërejtur synimin e këtij ndalimi:

Së pari: Nga shkaku i zbritjes së ajetit mësuam se një pjesë ngulën këmbë në këtë punë, jo vetëm si hakmarrje ndaj Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por edhe poshtërim ndaj shenjtërisë së tij. Nëpërmjet kësaj mënyre, ata dëshironin t'i jepnin një goditje shpirtit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Së dyti: Sikur kjo çështje të ishte e lejuar, pa dyshim se një grup do të merrte gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si gra të tyre, pas vdekjes së tij. Ishte e mundur që ta shfrytëzonin këtë martesë për të realizuar objektivat e tyre dhe të arrinin një pozitë të lartë shoqërore, apo të fillonin të falsifikonin Islamin në bazë të asaj se ata kanë informacione që burojnë nga brenda shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe familjarët e shtëpisë janë më të diturit për këtë. Apo hipokritët, në mesin e njerëzve, të përhapnin kërkesa, që të kundërshtonin pozitën e profecisë.

E theksojmë këtë fakt, pasi e dimë, se një grup e përgatiti veten për të bërë këtë punë. Një pjesë e tyre e bëri të qartë atë,

kurse pjesa tjetër e mbajti të fshehur në zemër. Njëri prej atyre që e kanë përmendur komentuesit e Ehli Synetit, ishteTalha.[1]

Nuk ka asnjë dyshim se All'llahu është i dijshëm për sekretet e fshehta dhe të dukshme dhe i mirinformuar për gjithçka. Ai nxori një ligj të prerë, për të shkatërruar këtë plan të fëlliqur, që të pengojë ndodhinë e këtyre çështjeve dhe të forcojë shtyllat e këtij ligji. Bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i quajti "nënat e besimtarëve", që ata ta mësojnë se martesa me to, është njësoj si të martoheshin me nënat e tyre. Duke e parë mirë atë që u tha, bëhet e qartë se përse gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duhet ta pranonin me gjithë zemër këtë ndalesë.

Ndonjëherë mund të shtrohen çështje të rëndësishme gjatë jetës së njeriut, që sakrifica dhe altruizmi duhet të shfaqin orientimin kah tyre dhe ta largojë shikimin nga disa të drejta që i takojnë atij. Sidomos mburrjet, krenaritë madhështore i shoqërojnë përgjegjësi të rrezikshme. Nuk ka dyshim se bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke u martuar me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kanë fituar krenari të pakrahasueshme. Fitimi i kësaj krenarie e ka të nevojshme këtë sakrificë.

Për këtë shkak, gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, edhe pas vdekjes së tij, kanë pasur respektin dhe vlerësimin e të gjithëve.

1 Tefsiri i Kurtubijut, vëll. 8, f. 5310.

Ato ishin shumë të kënaqura me gjendjen e tyre. Përballë këtyre krenarive, atë ndalesë e konsideronin një gjë të kotë.

Ajeti 54 i ka paralajmëruar njerëzit me ashpërsi: **"Çfarëdo që të shfaqni apo të fshihni,** (dijeni se) **All'llahu është vërtet i Gjithëdijshëm për çdo gjë."**.

Mos mendoni se All'llahu i Madhëruar nuk i di planet tuaja, në rrugën e dëmtimit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* njësoj si atë që e keni përmendur apo atë që e keni fshehur. All'llahu i Lartësuar di mirë çdo gjë dhe çdo njeri e trajton me atë që i përshtatet puna e tij.

Hulumtime

Diskutimin tonë, për detyrat e myslimanëve, kur ftohen si mysafirë në shtëpinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, do ta bëjmë duke përmendur se çfarë thonë mësimet islame për mikpritjen, të drejtat e mikut dhe detyrat e mikpritësit.

1- Mikpritja

Islami, çështjes së mikpritjes, i ka dhënë një rëndësi të veçantë. Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) thuhet: *"Miku është argumenti i Xhennetit."*.[11]

Rëndësia e mikut, e respektimit dhe e vlerësimit të tij, ka arritur deri aty sa është konsideruar si një dhuratë qiellore. I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: *"Nëse All'llahu i dëshiron të mirën një populli, i jep atij një dhuratë."*. E pyetën Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Cila është ajo dhuratë?". Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Ajo është miku. Ai vjen me rrizkun e tij dhe largohet me gjynahet e banorëve të shtëpisë."*.[2]

Është interesante se një njeri vjen te Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe thotë: "T'u bëftë kurban, nëna e babai im! Unë e marr abdesin, e fal namazin, e jap zekatin në kohën e tij, e mirëpres dhe e respektoj mikun për hir të All'llahut.". Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: *"Urime, urime, urime! Ti nuk ke rrugë në Xhehennem! All'llahu të ka liruar ty nga koprracia, nëse je i tillë."*.[3]

Për këtë çështje, ka shumë hadithe. Ne mjaftohemi me kaq, duke ruajtur përmbledhjen.

1 "Biharul Anuar", vëll. 75, kreu 93, hadithi 14, f. 460.
2 Burimi i mëparshëm.
3 Burimi i mëparshëm.

2- Ruajtja e thjeshtësisë në mikpritje

Nëse mikpritja karakterizohet me shpenzime të shumta, ajo është e papranuar nga pikëpamja islame, madje Islami e ka ndaluar atë. Islami këshillon që mikpritja të jetë e thjeshtë dhe ka vënë një standard të drejtë mes mikut dhe mikpritësit, që është: mikpritësi të mos jetë kurnac në atë që ka e t'ia shërbejë atij, kurse miku të mos pretendojë më shumë se aq.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: *"Besimtari nuk turpërohet nga vëllai i tij. Unë nuk e di se cili prej tyre është më i pëlqyeshëm? Ai që e detyron vëllain e tij, kur hyn në shtëpinë e tij që t'i ngarkohet atij apo ai që bën sikur ngarkohet nga vëllai i tij?!"*.[1]

Selman El Farisiju transmeton nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Mos e ngarko veten për mikun për atë që nuk e ke aty dhe merr atë që shërbehet."*.[2]

3- E drejta e mikut

Kemi thënë se, nga pikëpamja islame, miku është si një dhuratë qiellore dhe duhet të mikpritet mirë e të respektohet, me kuptimin e plotë të respektit. Të nderohet sa më shumë. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, transmeton nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

1 "Biharul Anuar", vëll. 75, f. 453.
2"El Mehexhxhetul Bejda", vëll. 3, kreu 3, f. 29.

familjen e tij!): "*Një e drejtë e mikut është që të ecësh bashkë me të dhe ta përcjellësh atë nga shtëpia jote deri jashtë saj.*".[1]

Duhet të kujdesesh që të plotësosh jo vetëm nevojat e tij, por të kujdesesh edhe për qetësinë e tij, deri aty sa të mos e kalojë obligimin. Në një hadith nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: "*Prej të drejtës së mikut, është që atij t'i jepet koha që i duhet.*".[2]

Mirëpo miqtë ndonjëherë mund të jenë të ndrojtur, për këtë ka dalë një urdhëresë, për të mos i pyetur ata se a e kanë ngrënë ushqimin apo jo, madje u shtron mbulesën e tavolinës. Nëse duan, hanë.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: "*Mos i thuaj vëllait tënd, kur të hyjë: A ka ngrënë gjë sot? Por ofroi atij çfarë të kesh. Mirësia e të gjitha të mirave është shpenzimi nga ajo që ke.*".[3]

Prej detyrave të mikpritësit është që të mos e poshtërojë ushqimin që ka përgatitur, sepse begatia e All'llahut të Madhëruar është e nderuar, e respektuar, sido që të jetë. Mirëpo, është e njohur mes të pasurve, të cilët e mbushin tryezën me lloj ushqimesh të ndryshme, ata thonë: Kjo është diçka e thjeshtë dhe nuk përshtatet me pozitën tuaj.!

Në këmbim, miku nuk duhet ta poshtërojë atë që i është ofruar. Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë:

1 "Biharul Anuar", vëll. 75, f. 451.
2 Burimi i mëparshëm, f. 455.
3 Burimi i mëparshëm.

"Është shkatërruar ai njeri që ka përbuzur atë që i ka ofruar vëllai i tij dhe është shkatërruar ai njeri që poshtëron vëllain që i ka ardhur.".[1]

Islami është shumë i saktë në nderimin e mikut. Në mësimet islame thuhet se mikun prite dhe ndihmoje, kur të hyjë në shtëpinë tënde. Mirëpo, kur të dëshirojë të dalë, mos e ndihmo, që ai të mos mendojë se ti po kënaqesh se ai po del.[2]

4- Detyrat e mikut

Nuk ka dyshim se përgjegjësitë janë të pranueshme gjithmonë, pasi ashtu siç ka detyra mikpritësi ndaj mikut, po kështu ka detyra, edhe miku, që duhet të kujdeset për to.

Ashtu siç është përmendur në hadithet e mëparshme, detyra e mikut është që të zbatojë atë që i kërkon i pari i shtëpisë, në lidhje me shtëpinë e tij. Nëse i kërkon atij që të ulet diku, ai duhet ta bëjë atë.

Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: *"Nëse ndonjëri prej jush hyn në shtëpinë e vëllait të tij, le të ulet aty ku e urdhëron i pari i shtëpisë, sepse i pari i shtëpisë është më i njohur për shenjtëritë e shtëpisë së tij se sa ai që vjen aty."*.[3]

Çështja e mikpritjes dhe kultura e saj, ka pasur një diskutim të gjerë në etikën e sjelljes islame. Për më tepër sqarim, lexo veprën "Biharul Anuar", vëllimi i 17, kapitujt 88-94 prej

1 "El Mehexhxhetul Bejda", vëll. 3, f. 30.
2 "Biharul Anuar", vëll. 75, f. 455, Hadithi 27.
3 "Biharul Anuar", vëll. 75, f. 451.

kapitujve të sjelljes dhe veprën “El Mehaxhxhetul Bejda”, vëllimi 3, kapitulli katër, “Mirësia e mikpritjes”.

Fatkeqësisht, ky zakon i vjetër njerëzor është fashitur në kohën tonë moderne. Tani është koha e mposhtjes materiale, është koha e mizorisë në botë. Kemi dëgjuar se një pjesë e perëndimorëve, kur vijnë të vizitojnë vendet islame dhe e shikojnë të gjallë mikpritjen, jo vetëm në bujtina, por edhe në ndjenjat tona, habiten se si është e mundur që njerëzit të ofrojnë gjërat më të preferuara që ka në shtëpi dhe ushqimet më të mira e më të shijshme për miqtë, të cilët mbase ndonjëherë kanë një lidhje të dobët, ose mbase e kanë njohur në një udhëtim të shkurtër.

Hadithet islame, që u thanë pak më parë, e bëjnë të qartë shkakun e kësaj sakrifice dhe altruizmi. Ato sqarojnë llogaritë shpirtërore në këtë aspekt, ato llogari që nuk kanë asnjë kuptim te “skllevërit” e materies dhe të mbyturit në detin e saj.

Ajeti 55

﴿لَا جُنَاحَ عَلَيْهِنَّ فِي آبَائِهِنَّ وَلَا أَبْنَائِهِنَّ وَلَا إِخْوَانِهِنَّ وَلَا أَبْنَاءِ إِخْوَانِهِنَّ وَلَا أَبْنَاءِ أَخَوَاتِهِنَّ وَلَا نِسَائِهِنَّ وَلَا مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُنَّ وَاتَّقِينَ اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدًا﴾

"Nuk është gjynah për ato, nëse dalin të pambuluara para etërve të tyre, djemve të tyre, vëllezërve dhe djemve të vëllezërve të tyre, djemve të motrave të tyre e grave të tyre, si dhe para skllaveve që janë nën pushtetin e tyre. Frikësojuni All'llahut, se, me të vërtetë, All'llahu është dëshmitar për çdo gjë."

Shkaku i zbritjes

Një pjesë e komentuesve transmetojnë se baballarët e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, bijtë e tyre dhe familjarët e tyre e pyetën të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pas zbritjes së ajetit të hixhabit, mbulimit: "O i Dërguari i All'llahut, edhe ne duhet të flasim nga prapa perdes?". Zbritja e këtij ajeti, ua bëri të qartë dispozitën e kësaj çështjeje.

Komentimi

Kuptimet e përjashtuara nga ligji i hixhabit

Meqenëse dispozita që u përmend në ajetin e mëparshëm rreth mbulimit të grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte e përgjithshme, ka mundësi që nga ky përgjithësim të hamendësohet se personat që nuk mund të martohen me ta, duhet ta zbatojnë atë dhe t'u flasin atyre nga prapa perdes, si të panjohura. Atëherë zbriti ky ajet dhe sqaron ligjin e kësaj çështjeje.

Ajeti thotë: **"Nuk është gjynah për ato, nëse dalin të pambuluara para etërve të tyre, djemve të tyre, vëllezërve dhe djemve të vëllezërve të tyre, djemve të motrave të tyre e grave të tyre, si dhe para skllaveve që janë nën pushtetin e tyre."**. E thënë ndryshe: Ata që nuk mund të martohen e janë përjashtuar nga martesa, në këtë ajet, janë vetëm gjashtë. Nëse thuhet se ka persona që nuk mund të martohesh dhe që nuk janë përmendur në ajet, si: xhaxhallarët edhe dajat, kësaj i jepet përgjigjja se: Kur'ani tregon kujdes të madh për letërsinë dhe elekuencën. Një nga bazat e letërsisë së pastër është që në fjali të mos ketë fjalë shtesë. Ai nuk i përmend këtu xhaxhallarët dhe dajat, sepse, kur përmend fëmijët e vëllait dhe fëmijët e motrës, atëherë do të qartësohet dispozita e xhaxhallarëve dhe e dajave.

Për këtë ndalesë ka dy anë: Ashtu si djali i vëllait është nga ata që nuk mund të martohesh, atëherë pa dyshim nuk mund të martohesh me djalin e vëllait të saj.

Ne e dimë se shembulli i një gruaje të tillë, është halla, sepse djali i motrës, ashtu si e ka të ndaluar martesën me të, pa dyshim edhe ajo është prej atyre që nuk i lejohet të martohet me djalin e motrës. Një grua e tillë quhet teze.

Kur halla dhe tezja e ka të ndaluar të martohet me djalin e vëllait dhe djalin e motrës, atëherë pa dyshim se edhe xhaxhai dhe daja, do të jenë prej personave që nuk mund të martohet me vajzën e motrës dhe vajzën e vëllait, pasi nuk ka ndryshim mes xhaxhait dhe hallës, as mes dajës dhe tezes. Ky është një nga saktësitë e Kur'anit Famëlartë.

Këtu shtrohet një pyetje tjetër: Babai i bashkëshortit dhe djali i burrit janë pjesë e atyre që nuk mund të martohen me gruan, atëherë përse nuk janë përmendur këtu? Në kohën kur ata të dy janë përmendur në fjalinë e të ndaluarve për martesë, në ajetin 31 të sures "Nur".

Përgjigjja për këtë pyetje është e qartë, sepse fjala në këtë ajet është e kufizuar vetëm për gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ne e dimë se babai i Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka qenë i pranishëm gjatë jetës së tij e as nëna e tij dhe ai nuk kishte djalë.[1]

1 Historianët kanë përmendur tre djemtë e Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: Kasemi dhe Abdull'llah (të mbiquajtur i miri dhe i pastri). Të dy ishin djem të Hatixhesë dhe të dy u ndanë nga kjo jetë që në fëmijëri. Ibrahimi lindi në vitin e tetë të hixhretit. Nuk jetoi më shumë se 16 apo 18 muaj. Askush prej tyre nuk ka qenë i gjallë gjatë zbritjes së sures "El Ahzab". Ibrahimi lindi pas zbritjes së sures dhe vdiq shumë shpejt. Lexo veprën "Usdul Gabeh" dhe libra të tjerë të historisë dhe të biografive.

Mungesa e përmendjes së vëllezërve dhe motrave të ushqyer me gji dhe të ngjashëm me ta, është për shkak se këta janë në lidhje me vëllain dhe motrën dhe të gjithë atyre që nuk mund të martohesh me ta dhe nuk kanë nevojë për një përmendje të veçantë.

Metoda e ajetit ndryshon në fundin e tij. U flet grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Frikësojuni All'llahut, se, me të vërtetë, All'llahu është dëshmitar për çdo gjë."**.

Hixhabi, mbulesa e të tjera si ato, janë mjete për t'u ruajtur dhe për t'u larguar nga mëkati dhe gjynahu dhe asgjë tjetër. Shtylla kryesore është vetëm devotshmëria. Sikur të mos jetë ajo, asgjë nga këto mënyra nuk do të bëjë dobi.

Ajo që e meriton të përmendet, është se togfjalëshi **"grave të tyre"**, tregon gratë myslimane. Kjo është e papërshtatshme për gratë myslimane, siç e kemi thënë në komentimin e sures "Nur", që të qëndrojnë të pambuluara para jomyslimaneve, pasi jomyslimanet mund t'ju përshkruajnë ju te burrat e tyre.[1]

Togfjalëshi **"skllaveve të tyre",** ka kuptim të gjerë, siç e kemi thënë në komentimin e sures "Nur", që përfshin robëreshat dhe fëmijët, por ajo specifikohet me robëreshat, sipas disa transmetimeve islame.

Duke u bazuar në këtë fakt, përmendja e tyre pas përmendjes së fjalës "grave", mund të përfshijë robëreshat jomyslimane, në përgjithësi.

1 Lexo komentimin e fundit të ajetit 31, të sures "Nur".

Ajetet 56 – 58

﴿إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا٥٦ إِنَّ الَّذِينَ يُؤْذُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ لَعَنَهُمُ اللَّهُ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَأَعَدَّ لَهُمْ عَذَابًا مُهِينًا٥٧ وَالَّذِينَ يُؤْذُونَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ بِغَيْرِ مَا اكْتَسَبُوا فَقَدِ احْتَمَلُوا بُهْتَانًا وَإِثْمًا مُبِينًا٥٨﴾

"Vërtet, All'llahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O ju që keni besuar, dërgoni salavat për atë dhe përshëndeteni me 'selam'!"

"Pa dyshim, ata që fyejnë All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, i mallkon All'llahu në këtë botë dhe në Tjetrën. Ai ka përgatitur për ta ndëshkim poshtërues."

"Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtaret, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe një gjynah të qartë."

Komentimi[1]

Salavati për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* **dhe përshëndetja e tij me selam**

Ajetet e mëparshme flisnin për detyrën që ka çdo mysliman për të ruajtur shenjtërinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kujdesin që duhet të tregohet që të mos lëndohet Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këto ajete flasin për dashurinë e All'llahut dhe të engjëjve të Tij për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nderimin që i bëjnë.

Më pas i urdhëron besimtarët ta nderojnë Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Përmend dënimet e dhimbshme për ata që e lëndojnë Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në fund ajetet sqarojnë gjynahun e madh që bëjnë ata që lëndojnë besimtarët, duke i akuzuar ata dhe duke trilluar për ta.

Ajeti 56 thotë: **"Vërtet, All'llahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O ju që keni besuar, dërgoni salavat për atë dhe përshëndeteni me 'selam'."**.

1 Është interesante se fillimi i komentimit të këtyre ajeteve përkoi me natën e lindjes së Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* në muajin Rebiul Evel, në vitin njëmijë e katërqind e katër të hixhrit.

Pozita dhe grada e madhështisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është e tillë, që Krijuesi i botës së ekzistencës dhe i të gjithë engjëjve, të ngarkuar me drejtimin e çështjeve të kësaj bote, me urdhrin e All'llahut të Madhëruar e bekojnë dhe e mëshirojnë atë. Bashkoni zërat tuaj në këtë thirrje të botës së ekzistencës: **"O ju që keni besuar, dërgoni salavat për atë dhe përshëndeteni me 'selam'!"**.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është xhevahir i paçmueshëm për botën e krijesave. Është vënë në mesin e njerëzve, me mirësinë e All'llahut. Mos e zvogëloni vlerën e tij dhe mos e harroni pozitën dhe gradën e tij te All'llahu dhe te engjëjt e qiejve. Ai është një njeri që doli në mesin tuaj, mirëpo ai nuk është njeri i zakonshëm, përkundrazi ai është një njeri, ku bota e ekzistencës bashkohet në ekzistencën e tij.

Këtu ka disa çështje që duhet të shikohjen me kujdes:

1- Fjala *"es salatu"* dhe shumësi i saj *"salavatun"*, i atribuohen All'llahut të Madhëruar. Kuptimi i tyre është: dërgimi i mëshirës. Engjëjt janë ata që sjellin mëshirën e All'llahut te njerëzit, besimtarët.[1]

2- Koha e tashme e foljes *"jusal'lune"*, tregon vazhdimësinë e këtij veprimi. All'llahu dhe engjëjt e Tij dërgojnë gjithmonë mëshirë mbi të.

3- Komentuesit kanë mosmarrëveshje në dallimin e fjalëve *"sal'lu"* dhe *"sel'limu"*. Ajo që duket më e përshtatshme për

1 Er Ragib e ka përcjellë këtë kuptim me fraza të tjera në librin e tij "El Mufredat".

origjinën gjuhësore të dy fjalëve dhe më e pranueshme për fillimin e ajetit kur'anor, është: Fjala *"sal'lu"* është urdhër për kërkimin e mëshirës dhe begatisë për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse fjala *"sel'limu"* do të thotë: dorëzim ndaj urdhëresave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, siç thuhet në ajetin 65 të sures "En Nisa": **"Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht."**.

Në një transmetim të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë se Ebu Besiri e ka pyetur atë: "E kam kuptuar dërgimin e salavatit për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por si është dorëzimi *(teslimi)*?". Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* u përgjigj: *"Bindja ndaj tij në çështjet."*.[1]

Selami për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është: "Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi ty i Dërguari i All'llahut!", si dhe shprehje të ngjashme me të. Kjo do të thotë kërkimi i paqes së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga All'llahu i Madhëruar.

Ebu Hamza Themalij transmeton nga Ka'bi, një nga shokët e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i cili ka thënë: "Kur zbriti ky ajet, ne thamë: 'E

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 369-370, fundi i ajetit është burimi i komentimi

kemi njohur selamin mbi ty, por si të dërgojmë salavat për ty?'. Ai u përgjigj: "*Thoni: O All'llah, bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, ashtu siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit! Ty të lavdërojmë! Begatoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit! Ty të lavdërojmë dhe të falënderojmë!'*".[1]

Nga ky hadith bëhet e qartë mënyra se si dërgohet salavati për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Po kështu sqarohet kuptimi i "selamit".

Pavarësisht se këto dy kuptime të selamit duken plotësisht të ndryshme, por të dy kuptimet mund të lidhen dhe të referohen në një pikë të vetme, nëse e vërejmë me imtësi, e ajo është teslimi (dorëzimi, bindja) gjuhësor dhe praktik ndaj Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sepse ai që e përshëndet atë dhe kërkon nga All'llahu paqen, ai e do dhe e njeh atë si Profet që është detyrë bindja ndaj tij.

4- Ajo që na tërheq vëmendjen është se në transmetime të ardhura nga Profeti, të cilat janë të shumta si nga Ehli Syneti ashtu edhe nga Ehli Bejti, qartësohet mënyra e dërgimit të salavatit për Profetin. Ato transmetime thonw qw tw shtohet edhe Ehli Bejtin e tij kur tw dwrgohet salavati.

Në veprën "Ed Durr'rrul Menthur", në "Sahihun" e Buhariut dhe të Muslimit, në "Sunenin" e Ebu Davudit, të Tirmidhiut, të Nisaiut, të Ibn Maxhes dhe të Ibn Merdevijut, transmetohet një hadith nga Ka'b ibn Uxhre : "Një njeri erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

1 Burimi i mësipërm. Në librat e të dy grupeve, është transmetuar në rrugë të ndryshme dhe me shprehje të përafërta hadithi i dytë.

familjen e tij!) dhe i tha: 'Për sa i përket përshëndetjes tënde, ne e dimë atë, por si është salavati për ty?'. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: *"Thuaj: O All'llah, bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, ashtu siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit! Ti je i falënderuar dhe i lavdëruar! O All'llah, begatoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit! Ti je i falënderuar dhe i lavdëruar!'"*.

Autori i tefsirit "Ed Durr'rrul Menthur" ka përmendur tetëmbëdhjetë hadithe të tjera, duke shtuar edhe këtë hadith. Të gjitha e kanë bërë të qartë domosdoshmërinë e përmendjes së "familjes së Muhammedit" tek salavatet.

Këto hadithe janë transmetuar nga librat e njohur të ndjekësve të traditës Profetike, nga një grup i shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Shokët e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishin: Ibn Abasi, Talha, Ebu Said El Khuderij, Ebu Hurejre, Ebu Mes'ud El Ensariu, Burejde, Ibn Mes'udi, Ka'b ibn Axhre dhe Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*.[1]

Në "Sahihun" e Buhariut (një nga burimet më të njohura të haditheve të ndjekësve të rrugës Profetike) transmetohen shumë hadithe për këtë çështje. Për më shumë sqarime, kushdo, le t'i referohet atij.[2]

1 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthur", vëll. 6, f. 465, fundi i ajetit është burimi i komentimit, sipas tefsirit "El Mijzan", vëll. 16, f. 344.
2 . Sahihul Buhari, vëll. 6, f. 151.

Po kështu, edhe në "Sahihun" e Muslimit janë përmendur dy transmetime për këtë çështje.[1]

E çuditshme në këtë libër është se, pavarësisht përmendjes së togfjalëshit "familjes së Muhammedit", disa herë në këto dy hadithe, ai zgjodhi këtë titull për këtë çështje, "Kapitulli i salavatit për Profetin Muhammed", pa përmendur fjalën "familjen".

Ka edhe një çështje që meriton të vërehet me kujdes, që është: Në disa transmetime të ithtarëve të traditës Profetike dhe në shumë transmetime të familjarëve të shtëpisë, nuk është përmendur as fjala "ala", në ndarjen mes Muhammedit dhe familjes së Muhammedit. Mënyra e salavatit është: O All'llah, mëshiroje, fale Muhammedin dhe familjen e Muhammedit!

E përfundojmë këtë diskutim me një hadith tjetër nga Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ibn Haxheri transmeton në veprën "Vetëtimat", se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Mos më dërgoni mua salavat të cunguar."* Ata i thanë: "Çfarë është salavati i cunguar?" Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: "Mos thoni: 'O All'llah, bekoje Muhammedin!'". Pastaj pushoni, por thoni: *"O All'llah, bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit!"*[2]

Për shkak të këtyre transmetimeve, një grup dijetarësh të Ehli Synetit, e kanë konsideruar vaxhib shtimin e togfjalëshit

1 Sahihul Muslim, vëll. 1, f. 305, kreu "Salavati për Profetin Muhamed (s.a.v.a.s)".
2 "Es Seuaikul Muhrikatu", f. 144.

"familjen e Muhammedit" tek emri i "Muhammedit", në uljen (teshehudin) e namazit farz.[11]

5- A është apo jo detyrë, salavati për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*? Nëse është detyrë, ku është e detyrueshme?

Dijetarët i kanë dhënë përgjigje kësaj pyetjeje. Të gjithë dijetarët e jurisprudencës islame e konsiderojnë atë detyrë në uljen e parë dhe të dytë të namazit dhe të pëlqyeshme në vende të tjera, veç namazit.

Përveç haditheve të përmendura nga familjarët e shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për këtë çështje, përmendim edhe transmetimet në librat e ndjekësve të traditës Profetike, që tregojnë për obligimin. Këto transmetime nuk janë pak. Njëra prej tyre është ajo që përmendet nga Aishja. Ajo ka thënë se ka dëgjuar të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të thotë: "*Nuk pranohet namazi, vetëm se duke qenë i pastër dhe duke rënë në salavate për mua.*".[2]

Shafiu, një prej dijetarëve të përgjithshëm, kërkimin e faljes dhe mëshirës për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e quan të detyrueshëm thënien në uljen e dytë. Po ashtu, edhe Ahmedi, ka këtë mendim, në një nga dy transmetimet e tij.

---

1 Këtë fjalë e ka përmendur dijetari Hil'lij, në përkujtimin e hulumtimin e teshehudit në uljes në namaz. Ai përmend thënie nga imam Ahmedi dhe një pjesë e shafitëve. Gjithashtu shton mendimin e të gjithë dijetarëve shi'itë.
2 "Biharul Anuar", vëll. 82, f. 278, kreu. "Teshehudi dhe rregullat e tij".

Ebu Hanife nuk e konsideron atë të detyrueshëm.[1]

E veçanta është se Shafiu e ka shprehur mjaft qartë mendimin e tij nëpërmjet vargjeve të një poezie:

"O familjarët e shtëpisë së të Dërguarit të All'llahut,

dashuria juaj është bërë obligim nga All'llahu, e zbritur në Kur'an.

Juve ju mjafton madhështia e vlerësimit.

Kush nuk bie në salavate për ju, nuk ka namaz për të."[2]

Ajeti 57 qartëson të kundërtën e ajetit 56 ku thotë: **"Pa dyshim, ata që fyejnë All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, i mallkon All'llahu në këtë botë dhe në Tjetrën. Ai ka përgatitur për ta ndëshkim poshtërues."**.

Çfarë kuptohet me togfjalëshin "fyerje e All'llahut të Madhëruar"?

Disa kanë thënë se ajo që kuptohet prej këtij togfjalëshi është mohimi dhe mosbesimi, që e hidhërojnë All'llahun, sepse "fyerja" e All'llahut të Lartësuar, nuk do të thotë gjë tjetër veç hidhërimi i Tij.

Gjithashtu, fyerja e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e besimtarëve është fyerja e All'llahut të Lartësuar. Përmendja e All'llahut në ajet është theksimi i rëndësisë së kërkesës dhe miratimi i saj.

1 "Et Tedhkiretu", i eruditit El Hil'lij vëll. 1, f. 126.
2 Dijetari El Emijni, në librin me vlerë "El Gadijr", vëll. 7, f. 7, përmend lidhjen e vjershave të Shafiut me shpjegimin e dhuratave të Zarkanijut.

Kurse, për sa i përket fyerjes së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ajo ka një kuptim të gjerë dhe përfshin çdo vepër që e lëndon atë, njësoj si të ishte mohimi, mosbesimi, kundërshtimi i urdhëresave të All'llahut, gënjeshtrat dhe akuzat apo lëndimi që ai shikon, kur i fton ata në shtëpinë e tij, siç u tha në ajetin 53 të kësaj sureje.

Në ajetin 61 të sures "Et Teube"përmendet akuzua që iu bë Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke e quajtur "vesh" (beson çka dëgjon), pasi ai dëgjonte fjalët e njerëzve dhe kujdesej për mënyrën e të folurit: **"Ka të atillë që e shqetësojnë të Dërguarin dhe thonë: 'Ai dëgjon çdo gjë që i thuhet..."**.

Madje nga transmetimet e përmendur, në fund të ajetit, përftohet se lëndimi i familjarëve të shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e në mënyrë të veçantë, Aliut dhe Fatimesë, e përfshin ky ajet. Në vëllimin e pestë të "Sahihut" të Buhariut thuhet se i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Fatimja është pjesë e trupit tim dhe kush e hidhëron atë, më ka hidhëruar mua."*.[1]

Ky hadith është përmendur në "Sahihun" e Muslimit, me këtë shprehje: *"Fatimja është pjesë e imja, më lëndon mua, ajo që lëndon atë."*.[2]

1 "Sahihul" Buhari, vëll. 5, f. 26.
2 "Sahihul" Muslim, vëll. 4, f. 1903, kreu "Fadailu Fatime".

Ky kuptim është transmetuar në të drejtën e Aliut ndaj Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[1]

Për sa i përket "mallkimit", të përmendur në ajetin e mësipërm, ai është me kuptimin e largimit nga mëshira e All'llahut. Ajo është përballë mëshirës dhe salavateve, të cilat janë përmendur në ajetin paraardhës.

Mallkimi dhe dëbimi nga mëshira e All'llahut të Madhëruar, konsiderohet nga llojet më të këqija të dënimit, sidomos, nëse dënimi është në dynja dhe në Ahiret, siç është në ajetin që po diskutojmë. Mbase përmendja e çështjes së mallkimit është para dënimit të poshtëruar për këtë shkak.

Fjala *"eadde"* është një argument i miratimit të këtij dënimi dhe theksimi i ashpërsisë së tij.

Ajeti 58 flet për ofendimin e besimtarëve dhe u jep shumë rëndësi atyre, pas ofendimit të All'llahut dhe të Dërguarit të Tij: **"Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtaret, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe një gjynah të qartë."**.

Besimtarët lidhen me All'llahun dhe të Dërguarin e Tij nëpërmjet besimit e për këtë janë ngritur këtu në nivelin afër All'llahut dhe të Dërguarit të Tij.

Shprehja: **"duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë"**, tregon se këta nuk kanë bërë ndonjë gjynah që të ofendohen. Nga këtu bëhet e qartë se, nëse papritur ata bëjnë një mëkat, që ta

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

meritojnë dënimin dhe ndëshkimin, atëherë nuk ka ndonjë pengesë në zbatimin e saj në të drejtën e tyre.

Po kështu, kjo fjalë nuk përfshin urdhërimin në punë të mira dhe ndalimin nga e keqja.

Fjala *"buhtanun" - "akuzë false"* paraprihet nga fjala *"ithmun mubin" - "gjynah i madh"*. Arsyeja e kësaj strukture të fjalisë është për shkak të rëndësisë së këtij veprimi, sepse akuza false konsiderohet prej gjynaheve të mëdha dhe plagët që rezultojnë prej saj, janë më të dhimbshme se plagët e majës së shigjetës. Për këtë çështje, një poet arab thotë: "Plagët e majës së shigjetës kanë shërim, por nuk kanë shërim plagët e gjuhës.".

Transmetimet islame kësaj çështjeje i kanë dhënë rëndësi të madhe. Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: All'llahu thotë: *"Do të jetë në luftë me Mua ai që lëndon robin tim besimtar."*.[1]

Disa komentues të Kur'anit kanë thënë se nga metodika e ajetit kuptohet se një grup nga Medina publikonte dhe hidhte dyshime rreth besimtarëve. I akuzonin ata për diçka që nuk ishte e vërtetë, saqë edhe Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk shpëtoi nga gjuhët e këtyre ofenduesve. Ky grup nuk është i pakët në shoqëritë e tjera, sidomos në shoqëritë e sotme. Ata nuk bëjnë gjë tjetër përveç ngritjes së kurtheve kundër njerëzve të mirë dhe atyre që bëjnë punë të mira, duke fabrikuar gënjeshtra dhe akuza.

1 "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 35.

Kur'ani Famëlartë i ka sulmuar shumë ashpër këta njerëz dhe veprat e tyre i ka përshkruar me akuza false dhe mëkat të madh. Dëshmia për këto fjalë janë ajetet që pasojnë.

Në një hadith tjetër, që e transmeton Imam Ali ibn Musa Ridha, nga gjyshi i tij, i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "*Kush akuzon me pa të drejtë një besimtar apo besimtare, apo thotë për të diçka që nuk e ka, All'llahu i Lartësuar, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallë atë mbi një kodër zjarri, derisa ta nxjerrë atë që ka thënë për të.*".[1]

1 "Biharul Anuar", vëll. 75, f. 194.

Ajetet 59 – 62

﴿يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِأَزْوَاجِكَ وَبَنَاتِكَ وَنِسَاءِ الْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلَابِيبِهِنَّ ذَلِكَ أَدْنَى أَنْ يُعْرَفْنَ فَلَا يُؤْذَيْنَ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا٥٩ لَئِنْ لَمْ يَنْتَهِ الْمُنَافِقُونَ وَالَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ وَالْمُرْجِفُونَ فِي الْمَدِينَةِ لَنُغْرِيَنَّكَ بِهِمْ ثُمَّ لَا يُجَاوِرُونَكَ فِيهَا إِلَّا قَلِيلًا٦٠ مَلْعُونِينَ أَيْنَمَا ثُقِفُوا أُخِذُوا وَقُتِّلُوا تَقْتِيلًا٦١ سُنَّةَ اللَّهِ فِي الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلُ وَلَنْ تَجِدَ لِسُنَّةِ اللَّهِ تَبْدِيلًا٦٢﴾

"O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) **përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**

"Nëse nuk heqin dorë (nga veprimet e tyre) **hipokritët, ata që kanë sëmundje** (dyshimi) **në zemrat e tyre dhe ata që përhapin lajme të gënjeshtërta në Medine, Ne me siguri, ty do të të japim pushtet mbi ta dhe ditët e tyre në Medine do të jenë të numëruara."**

"Ata janë të mallkuar kudo që të gjenden dhe do të kapen e do të vriten pa mëshirë."

"Kështu ka qenë ligji i All'llahut edhe për ata që kanë qenë më parë! Ti kurrsesi nuk do të gjesh ndryshim në ligjet e All'llahut."

Shkaku i zbritjes

Në tefsirin e Ali ibn Ibrahimit, për shkakun e zbritjes së ajetit 59, thuhet: "Gratë shkonin të faleshin në xhami pas të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur ishte natë, ato dilnin për namazin e akshamit, të jacisë dhe të mëngjesit. Të rinjtë uleshin në rrugë, i ofendonin ato dhe u zinin rrugën. Zbriti ajeti: **"O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre** (të kokës) **përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**.[1]

Në të njëjtin libër, thuhet shkaku i zbritjes së ajetit 60. Ky ajet ka zbritur për njerëzit hipokritë që ishin në Medine, dridheshin nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur ai dilte në betejat e tij, duke thënë se vrau dhe robëroi. Myslimanët shqetësoheshin për këtë dhe ankoheshin te i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë shqetësim të

1 Tefsiri i Ali ibn Ibrahimit, vëll. 2, f. 196.

tyre dhe që të vendosej drejtësia, All'llahu zbriti këtë ajet: **"Nëse nuk heqin dorë** (nga veprimet e tyre) **hipokritët, ata që kanë sëmundje** (dyshimi) **në zemrat e tyre dhe ata që përhapin lajme të gënjeshtërta në Medine, Ne me siguri, ty do të të japim pushtet mbi ta dhe ditët e tyre në Medine do të jenë të numëruara."**.[1]

Ajeti i kërcënoi ashpër fabrikuesit e gënjeshtrave.

Komentimi

Një paralajmërim i ashpër për ofenduesit dhe fabrikuesit e thashethemeve

Ajetet e mëparshme tregonin ofendimin që iu bë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimtarëve. Këto ajete janë përqendruar në një nga kuptimet e ofendimit dhe për hir të qëndrimit përballë tij, ka zgjedhur dy rrugë: së pari, ka urdhëruar besimtaret, që të mos u lënë shkak të shthururve dhe atyre që kërkojnë justifikim, që përpiqen me çdo mënyrë për t'i lënduar. Pastaj ka sulmuar hipokritët dhe fabrikuesit e thashethemeve. I ka kërcënuar ata me një kërcënim të pashembullt në ajetet e Kur'anit.

1 Burimi paraprirës, sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 307.

Ajeti thotë në pjesën e parë: **"O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre** (të kokës) **përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët."**.

Te komentuesit e Kur'anit ka dy mendime për qëllimin e fjalës *"el ma'rifetu"*:

Mendimi i parë: Më parë, robëreshat dilnin nga shtëpitë e tyre, me kokë dhe qafë të zbuluar. Edhe pse nuk ishte e pranueshme nga ana morale, disa të rinj kokëndezur, të nxituar, i ngacmonin ato. Për këtë myslimanet e lira, u urdhëruan që të mbanin veshur hixhabin, që të dalloheshin nga robëreshat. Si rrjedhim, nuk do të mund të ofendoheshin nga ata të rinj.

Është e padiskutueshme se kjo fjalë nuk do të thotë që ata njerëz të papërmbajtur kishin të drejtë të ofendonin robëreshat, përkundrazi qëllimi ishte largimi, shfaqja e justifikimit prej njerëzve të shthurur.

Mendimi i dytë: Myslimanet të mos e tolerojnë urdhrin e mbulesës, si disa gra të hardallosura dhe të zbuluara, që nuk kanë turp, pavarësisht se në dukje janë të mbuluara. Ky zbulim i femrës ndez njerëzit e ulët dhe të poshtër dhe tërheq shikimin e tyre.

Komentuesit e Kur'anit dhe profesorët e gjuhës kanë përmendur disa kuptime të fjalës *"el xhilbabu"*:

1- *"El milhafetu"*, është rrobë më e gjatë se mbulesa që mbulon kokën, qafën dhe gjoksin.

2- Ajo është maskë dhe mbulesë.

3- Ajo është këmishë e gjerë pompoze.[1]

Edhe pse këto kuptime ndryshojnë nga njëra-tjetra, faktori i përbashkët në to është se ato mbulojnë trupin.

Duhet të thuhet se fjala *"el xhilbabu"* lexohet me zanoren *"i"* të shkronjës *"xhim"* dhe me zanoren *"e"* të saj.

Kuptimi bazë i fjalës është hixhabi, mbulesë më e madhe se mbulesa e kokës, e qafës dhe e gjoksit dhe më e shkurtër se manteli, siç e përmend atë autori i gjuhës arabe.

Nënkuptimi i fjalës *"judnine"* është që të veshin mbulesat trupit të tyre, për të qenë më të mbuluara, e të mos e vënë atë si të duan ato duke rënë sa andej-këtej dhe të zbulojnë trupin. Me një shprehje tjetër më të thjeshtë, ta vërejnë me kujdes dhe ta ruajnë hixhabin e tyre.

Ka disa komentues që thonë se ajeti tregon për detyrimin që ka femra për të mbuluar fytyrën, pasi nuk ka argument kundër saj.[21]

E megjithatë, nga ky ajet përfitohet se ligji i mbulesës për gratë e lira kishte zbritur më parë, por disa gra e toleronin zbatimin e këtij ligji dhe zbriti ajeti i lartpërmendur për të theksuar përpikërinë në zbatim.

---

1 "Lisanul Arab"; "Mexhmaul Bahrejn"; "El Mufredatu" i Rragib dhe "Taxhul Arus".

2 Kemi pasur diskutime rreth filozofisë së hixhabit dhe rëndësisë së tij. Në fundin e dy ajeteve, 31-32, të sures "Nur", flitet rreth përjashtimit të fytyrës dhe dy duarve.

Meqenëse zbritja e këtij ligji i kishte frikësuar disa besimtare, pasi ishin prej atyre që nuk e kishin zbatuar hixhabin, atëherë ajeti, në fundin e tij shtoi: **"Me të vërtetë, All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**.

All'llahu do t'ju falë, pasi çdo gjë që keni bërë deri tani, ishte si rezultat i injorancës. Pendohuni, kthehuni tek All'llahu dhe kryeni mirë detyrën e pendimit dhe të hixhabit.

Pas urdhërimit që jepet në ajetin paraprirës për besimtaret, ky ajet trajtoi një dimension tjetër për këtë çështje, domethënë metodat e poshtërimit dhe të pisllëqeve në aspektin e ofendimit, të lëndimit: **"Nëse nuk heqin dorë** (nga veprimet e tyre) **hipokritët, ata që kanë sëmundje** (dyshimi) **në zemrat e tyre dhe ata që përhapin lajme të gënjeshtërta në Medine, Ne me siguri, ty do të të japim pushtet mbi ta dhe ditët e tyre në Medine do të jenë të numëruara."**.

Fjala *"el muexhifne"* rrjedh nga fjala *"irxhafun"*. Kuptimi është: përhapja e gënjeshtrave, me qëllim lëndimin e të tjerëve dhe dëshpërimin e tyre.

Kuptimi i rrënjës së fjalës *"irxhafun"* është: shqetësim dhe tronditje. Meqenëse përhapja e gënjeshtrave shkaktonte shqetësim të përgjithshëm, atëherë u përdor kjo fjalë për të.

Fjala *"nugrijenneke"* rrjedh nga fjala *"el igrau"* dhe do të thotë: thirrje për zbatimin e veprës, apo mësimi i diçkaje. Një thirrje që shoqërohet me ngjallje dëshire, nxitje dhe shtysë.

Nga konteksti i ajetit përfitohet se tri grupe në Medine ishin të angazhuara me punët e shkatërrimit dhe të prishjes. Secili prej tyre vërtetonte qëllimet e tij me një metodë të veçantë. Ajo u

shfaq si një rrymë dhe një planifikim kolektiv. Ata nuk kishin vetëm një formë, model.

Grupi i parë janë hipokritët, të cilët përpiqeshin të shkulnin rrënjët e Islamit nëpërmjet kurtheve të tyre.

Grupi i dytë janë të poshtrit, për të cilët Kur'ani shprehet: **"kanë sëmundje** (dyshimi) **në zemrat e tyre"**. Kjo shprehje përmendet në ajetin 32 të sures "El Ahzab", për ata që ndjekin epshin e vet dhe pasionet e veta: **"Mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!"**.

Grupi i tretë janë ata që përhapnin gënjeshtrat në Medine e në mënyrë të veçantë, kur Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ushtria e myslimanëve shkonin në luftë, për të dobësuar moralin e tyre, përhapnin lajmet e gënjeshtërta për mposhtjen e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të besimtarëve. Këta janë çifutët, sipas mendimit të disa komentuesve.

Kjo është arsyeja, se pse Kur'ani Famëlartë i ka kërcënuar këto tri grupe.

Në komentimin e ajetit supozohet se të gjitha veprat shkatërruese të të tri grupeve ishin vepër e hipokritëve dhe ndarja e saj nga njëra-tjetra është ndarje cilësish e jo personash.

Kur'ani thotë, se nëse këta vazhdojnë me veprat e tyre të shëmtuara dhe të këqija, do të nxjerrim një urdhër për një sulm të përgjithshëm ndaj tyre, që t'i shkulim rrënjët e tyre nga Medina,

me lëvizjen popullore të besimtarëve, që ata të mos kenë fuqi të qëndrojnë pas kësaj në Medine.

Kur të dëbohen nga ky qytet dhe të dalin nga mbrojtja e qeverisë islame, atëherë: **"Ata janë të mallkuar kudo që të gjenden dhe do të kapen e do të vriten pa mëshirë."**.

Fjala *"thekufu"* rrjedh nga fjala *"thekafe"* dhe *"thekafetun"*. Kuptimi është: Kontrolli me imtësi dhe zgjuarsi i diçkaje. Kjo është arsyeja se pse kjo fjalë përdoret edhe për diturinë dhe përfitimit prej saj. Kjo shprehje tregon se ata nuk do të gjejnë një vend të sigurt pas këtij sulmi, madje besimtarët do t'i kërkojnë, derisa t'i gjejnë ata dhe do t'i dërgojnë në shtëpitë e shkatërruara.

Ka edhe dy supozime të tjera për synimin e ajetit: ose do t'i dëbojnë hipokritët, t'i kapin ata jashtë Medines dhe t'i vrasin, ose, nëse ata qëndrojnë në Medine, pas ligjit të eksodit të përgjithshëm, do të marrin këtë dënim. Nuk ka kundërshtim mes atyre të dyve. Kuptimi i ajetit është se këta hipokritë, shkatërrues dhe fabrikues gënjeshtrash dhe me zemra të sëmura, nuk do të jenë të sigurt nga hegjemonia e myslimanëve guximtarë, pasi derdhën gjakun e tyre. Prandaj doli ligji për nxjerrjen e tyre nga Medina.

Ajeti 62 shton se ky urdhër nuk është i ri: **"Kështu ka qenë ligji i All'llahut edhe për ata që kanë qenë më parë! Ti kurrsesi nuk do të gjesh ndryshim në ligjet e All'llahut."**.

Sa herë që shtohej lëvdata e atyre që bëjnë shkatërrim dhe kurthet e tyre e kalonin kufirin, del urdhri për t'i sulmuar ata.

Meqenëse ky ishte një ligj hyjnor, atëherë ai nuk do të ndryshojë dhe nuk të ndërrohet kurrë, pasi ligji i All'llahut është i

pandryshueshëm: **"Ti kurrsesi nuk do të gjesh ndryshim në ligjet e All'llahut."**.

Kjo mënyrë të shprehuri mishëron kërcënimin e vërtetë, që ata ta dinë mirë se kjo çështje është e mbyllur. Historia ka shumë shembuj të sjelljes së tyre. Nuk ka asnjë rrugë për të ndryshuar dhe për ta zëvendësuar atë, prandaj ose t'u japim fund punëve të tyre të pështira, ose të presin këtë përfundim të dhimbshëm.

Hulumtime

1- Fillo me veten tënde!

Urdhri që u përmend në këto ajete, rreth domosdoshmërisë së ruajtjes së hixhabit (mbulesës), e urdhëroi Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që ta përcjellë atë. Në fillim e nisi me gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pastaj me bijat e tij, pastaj me besimtaret. Kjo tregon se çdo program dhe korrigjim duhet të niset nga vetja dhe me familjarët e shtëpisë tënde. Ky është një plan për të gjithë reformatuesit e njerëzimit.

E nisi me bashkëshortet dhe bijat, sepse ato janë më të afërta me burrin, sepse bijat do të martohen dhe do të shkojnë në shtëpitë e bashkëshortëve.

2- Kurimi nga dy mënyra

Meqenëse prishjet shoqërore zakonisht nuk buronin vetëm nga një arsye, duhej të përqafohej nga të gjitha anët. E veçanta në çështje është se ajetet e përmendura, për shkak të qëndrimit para problemeve të njerëzve të papërmbajtur, i ka urdhëruar besimtaret, së pari, të mos lenë arsye në dorë të këtyre njerëzve kokëndezur, pastaj i ka ndaluar ata në kufirin e tyre, duke i kërcënuar ashpër.

Edhe ky është, gjithashtu, një program i përhershëm për të gjithë, që shoku duhet të korrigjohet dhe armiku duhet të mbahet me forcë në kufirin e tij.

3- Pozita e fortë e myslimanëve

Nga kërcënimet e forta dhe të ashpra të ajeteve përfitohet se pas përfundimit të ngjarjes së Beni Kurejdhas dhe shkuljes së rrënjëve të këtij grupi prej armiqve të brendshëm të rrezikshëm, pozita e myslimanëve u forcua shumë në Medine dhe nuk kishte më kontradikta, përveç atyre të hipokritëve të fshehur në radhët e besimtarëve, apo nga ana e një grupi të nxituarish, kokëndezurish dhe fabrikuesish gënjeshtrash.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përdori ndaj tyre forcën dhe i paralajmëroi ashpër ata se, nëse ata nuk ndalojnë kurthet e tyre dhe pwrhapjen helmit tw tyre, atëherë ai do t'i zhdukw me ta me një sulm të vetëm dhe do t'ua presë kokat.

Kjo sjellje e vendosur pati shumë ndikim në radhët e tyre.

4- Shkulja e rrënjëve të shkatërrimit

Ajo që është përmendur në ajetet e mësipërme: shkulja e të këqijave, kurthet e hipokritëve, vënia në shënjestër e nderit të myslimanëve, lëndimi i tyre, thashethemet, a rregullohen duke u kuruar në të gjitha periudhat dhe shekujt dhe për të gjitha qeveritë islame?

Vetëm pak komentues e kanë diskutuar atë, por duket se ky ligj, si të gjitha ligjet islame, nuk veçohet me një kohë, vend apo njerëz.

Nëse derdhja e helmeve dhe kurthet e kanë kaluar kufirin në tokën e realitetit dhe është bërë si një rrymë e dhunshme që kërcënon shoqërinë islame, me rreziqe të vërteta, atëherë nuk ka asnjë pengesë që qeveria islame të zbatojë urdhrat e ajeteve të mësipërme, të cilat u zbritën te Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i dhanë atij këtë reformim. Njerëzit duhet t'i japin rëndësi shkuljes së rrënjëve të shthurjes.

5- Ligjet e pandryshueshme të All'llahut

Kemi lexuar në ajetet e mëparshme se Kur'ani ka përmendur se një nga ligjet e All'llahut, që nuk pranon ndryshim, është shkulja e rrënjëve të kurtheve, me një sulm të përgjithshëm. Ky ligj ka qenë i zbatueshëm në popujt e mëparshëm.

Në vende të tjera të Kur'anit është përmendur e njëjta shprehje. Njëra prej tyre është në ajetin 38 të kësaj sureje, "El Ahzab". Pasi All'llahu i Lartësuar e lejoi kundërshtimin e traditës

së gabuar të injorancës dhe anulimin e saj në çështjen e gruas së ndarë të djalit të adoptuar, thotë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka asnjë mëkat, nëse ai nuk i zbaton urdhëresat e All'llahut, sido që të jetë: **"S'ka kurrfarë fajësimi për Profetin, kur bën atë që i ka urdhëruar All'llahu. Kështu ka qenë ligji i All'llahut edhe për ata** (Profetë) **që kanë qenë më parë, - urdhri i All'llahut është vendim i detyruar të ndodhë."**.

Në ajetin 43 të sures "El Fatir", pasi i kërcënon jobesimtarët dhe kriminelët me shkatërrim dhe zhdukje, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ata u sollën me mendjemadhësi në Tokë dhe me dredhi të shëmtuara, të cilat godasin vetëm atë që i bën. Vallë, a presin ata diçka tjetër veç asaj që ka goditur të mëparshmit? Vërtet, Ti nuk mund të gjesh ndryshim ose shndërrim në ligjet e All'llahut."**.

Në ajetin 85 të sures "El Gafir", pasi e ka bërë të qartë se besimi i jobesimtarëve kokëfortë prej popujve të mëparshëm nuk u solli dobi, por vetëm dënim shfarosës, shton: **"Por besimi i tyre nuk u solli kurrfarë dobie, kur panë dënimin Tonë. I tillë është ligji i All'llahut, që ka vepruar gjithmonë midis robve të Tij. Të humbur kanë qenë jobesimtarët."**.

Në ajetin 23 të sures "Fet'h", pasi ka përmendur triumfin e besimtarëve dhe mposhtjen e jobesimtarëve në luftëra, se ata nuk kanë as ndihmës e as mbrojtës, shton: **"I tillë ka qenë ligji i All'llahut edhe më parë, e ti kurrë nuk do të gjesh ndryshime në ligjin e All'llahut."**.

Po kështu, në ajetet 76-77 të sures "El Isra", kur bën të qartë kurthin e largimit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe vrasjen e tij, shton: **"Në të vërtetë, ata po përpiqen të të trembin që të të dëbojnë ty nga vendi, por atëherë, ata do të qëndronin vetëm pak kohë pas ikjes sate. Ky ishte ligji Ynë, për të Dërguarit e ardhur para teje, kështu që edhe ti nuk do të gjesh shmangie nga ligji Ynë."**.

Nga seria e këtyre ajeteve përfitohet se ligjet janë hyjnore, të qëndrueshme, thelbësore, njësoj si krijimi, të cilat nuk ndryshojnë në mënyrë absolute.

Me një mënyrë tjetër të shprehuri: All'llahu i Madhëruar, në botën e formimit dhe të legjislacionit, ka vënë ligje dhe baza të qëndrueshme, njëjtë si ligjet kryesore dhe kushtetutat e ligjëruara mes popujve te botës, të cilat as nuk ndryshojnë dhe as nuk kanë prirje për të ndryshuar. Këto ligje hyjnore ishin të zbatueshme mbi popujt e mëparshëm, zbatohen edhe sot dhe do të zbatohen në të ardhmen nga brezat që do të vijnë.

Ndihma e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, mposhtja e jobesimtarëve, domosdoshmëria e zbatimit të urdhëresave të All'llahut dhe të vepruarit me detyrat e saj, edhe sikur të çojë në zemërimin e njerëzve dhe pakënaqësinë e tyre, kur zbret dënimi hyjnor dhe ngjashëm me të, ato janë një pjesë e këtyre ligjeve të përhershme.

Shprehjet mbështesin rreziqet e të gjithë atyre që ecin në Rrugën e Drejtë dhe u jep atyre qetësinë dhe sigurinë, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, e bën të qartë unitetin e thirrjes së Profetëve, harmoninë e tyre, harmonizimin e ligjeve vepruese mbi sistemin e krijesave dhe sistemin e jetës njerëzore. Në të vërtetë, ajo është një degë prej degëve të Njehsimit.

Ajetet 63 – 68

﴿يَسْأَلُكَ النَّاسُ عَنِ السَّاعَةِ قُلْ إِنَّمَا عِلْمُهَا عِنْدَ اللَّهِ وَمَا يُدْرِيكَ
لَعَلَّ السَّاعَةَ تَكُونُ قَرِيبًا٦٣ إِنَّ اللَّهَ لَعَنَ الْكَافِرِينَ وَأَعَدَّ لَهُمْ
سَعِيرًا٦٤ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا لَا يَجِدُونَ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا٦٥ يَوْمَ تُقَلَّبُ
وُجُوهُهُمْ فِي النَّارِ يَقُولُونَ يَا لَيْتَنَا أَطَعْنَا اللَّهَ وَأَطَعْنَا الرَّسُولَا٦٦ وَقَالُوا
رَبَّنَا إِنَّا أَطَعْنَا سَادَتَنَا وَكُبَرَاءَنَا فَأَضَلُّونَا السَّبِيلَا٦٧ رَبَّنَا آتِهِمْ
ضِعْفَيْنِ مِنَ الْعَذَابِ وَالْعَنْهُمْ لَعْنًا كَبِيرًا٦٨﴾

"Njerëzit të pyesin për Orën (Kiametin)**, thuaju: 'Vetëm All'llahu ka dijeni mbi atë'. Kush e di?! Ndoshta Kiameti mund të jetë afër?!"**

"Vërtetë, All'llahu i ka mallkuar jobesimtarët dhe ka përgatitur për ata zjarr të flakëruar."

"Në të cilin ata do të qëndrojnë përgjithmonë; aty nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës."

"Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: 'Ah, sikur t'i ishim bindur All'llahut dhe të Dërguarit!'"

"Dhe do të thonë: 'O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë tonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej Rrugës së Drejtë."

"O Zoti ynë, atyre jepu dënim të dyfishtë dhe mallkim të madh!"

Komentimi

Kur do të bëhet Kiameti?

Ajetet e mëparshme folën për kurthet e hipokritëve dhe njerëzve të këqij. Këto ajete flasin për një tjetër plan të tyre shkatërrues. Ndonjëherë ata shtronin këtë pyetje: Kur do të bëhet Kiameti, për të cilën lajmëron Muhammedi dhe i përmend të gjitha këto cilësi? Kjo pyetje bëhej ose për t'u tallur, ose për të mbjellë dyshim për të në zemrat e mendjelehtëve. Ajeti nis: **"Njerëzit të pyesin për Orën** (Kiametin)**."**.

Supozohet, gjithashtu, se një pjesë e besimtarëve mund ta kenë pyetur Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për këtë gjë, të nxitur nga dashuria e diturisë, apo për të marrë më shumë informacion rreth kësaj teme.

Por, po të vërejmë argumentet që vijojnë në këtë ajet, favorizohet komentimi i parë. Dëshmitar për këtë fjalë është ajo që përmendet në ajetet 17-18 të sures "Esh Shura": **"...E si do ta dije ti që ndoshta Dita e Kiametit është afër?! Kiametin kërkojnë ta shpejtojnë ata që nuk besojnë në të, kurse ata që besojnë, kanë frikë nga ai dhe e dinë se është plotësisht i vërtetë. Pa dyshim, ata që kundërshtojnë për Ditën e Kiametit, janë në një gabim shumë të madh!"**.

Ajeti 63 vazhdon: **"Thuaju: 'Vetëm All'llahu ka dijeni mbi atë'. Kush e di?! Ndoshta Kiameti mund të jetë afër?!"**.

Atë nuk e dinë as të Dërguarit e as engjëjt shumë të afërt të All'llahut.

Në bazë të kësaj, ne duhet të jemi gjithmonë të përgatitur për ardhjen e Ditës së Kiametit. Kjo është mençuria e të qenit i fshehtë, i panjohur, që askush të mos mendojë se është i sigurt nga ai dhe të mendojë se Kiameti është larg dhe ta konsiderojë veten e tij të veçuar nga dënimi dhe ndëshkimi i All'llahut.

Ajetet 64-65 flasin për kërcënimin e jobesimtarëve dhe trajton një anë të dënimit të tyre të dhimbshëm: **"Vërtetë, All'llahu i ka mallkuar jobesimtarët dhe ka përgatitur për ata zjarr të flakëruar, në të cilin ata do të qëndrojnë përgjithmonë; aty nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës."**.

Dallimi mes fjalës *"el uelijju"* dhe *"en nesiru"* këtu është: Fjala: *"el uelijju* është ai që merr përsipër të bëjë të gjitha punët dhe t'i zbatojë ato, kurse fjala *"en nesiru"* - *"ndihmësi"* tregon atë që ndihmon për të arritur këtë synim dhe kërkesë. Këta jobesimtarë, në Kiamet, nuk do të kenë as mbrojtës e as ndihmës.

Pastaj ajeti sqaron një pjesë tjetër të dënimit të dhimbshëm në Kiamet: **"Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: 'Ah, sikur t'i ishim bindur All'llahut dhe të Dërguarit!'"**.

Kjo përmbysje, ose do të jetë në ngjyrën e lëkurës dhe të fytyrës, ku bëhet e kuqe, ose e zezë ndonjëherë, ose nga ana e përmbysjes së tyre në zjarr dhe formës së saj, ku fytyrat e tyre do të jenë ndonjëherë përballë zjarrit dhe ndonjëherë tjetër në anë të tjera. (Zoti na ruajtë prej saj!)

Këtu do të shpërthejnë klithmat e keqardhjes së tyre: **"Dhe do të thonë: 'Ah, sikur t'i ishim bindur All'llahut dhe të**

Dërguarit! O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë tonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej Rrugës së Drejtë.".

Fjala *"es sadetu"* është shumësi i fjalës *"sejjidun"*. Kuptimi është: Mbreti i madh që mbikëqyr drejtimin e qyteteve të rëndësishme ose të shteteve.

Fjala *"el kubra"* është shumësi i fjalës *"kebirun"*. Kuptimi është: Njeri i madh, njësoj si nga ana e moshës, apo nga ana e diturisë apo nga ana e pozitës shoqërore. Pronarët janë tregues të kryetarëve të mëdhenj të qyteteve, kurse të mëdhenjtë janë ata që mbikëqyrin drejtimin e çështjeve nën urdhrat e atyre padronëve dhe konsiderohen ndihmës dhe këshilltarë të tyre. Ata thonë se iu bindën padronëve, në vend që t'i bindeshin All'llahut dhe iu bindën të mëdhenjve, në vend që t'i bindeshin Profetëve. U sprovuan me lloje të ndryshme hidhërimesh e vështirësish.

Është e padiskutueshme se standardi i padronëve dhe i njeriut i madh, mes atyre popujve, është fuqia dhe kontrolli, pasuria e paligjshme, kurthet dhe mashtrimi.

Mbase zgjedhja e këtyre dy shprehjeve këtu ishte se ata përpiqen të drejtojnë arsyen e tyre dhe thonë se kanë qenë nën ndikimin e madhështisë së jashtme të atyre.

Këtu zien zhurma e këtyre xhehennemlinjve të humbur. Ata meritojnë dyfishin e dënimit dhe të mallkimit, për shkak të përpjekjeve të tyre në rrugën e përhumbjes së të tjerëve dhe shtyrjes së tyre drejt rrugës së devijimit.

E çuditshme është ajo që thuhet në ajetin 38 të sures "El A'raf". Këta ndjekës të humbur, kur kërkojnë dyfishin e dënimit

për padronët dhe udhëheqësit e tyre, u thuhet: **"All'llahu do t'u thotë: 'Hyni në zjarr me popujt - xhindët dhe njerëzit - që kanë qenë para jush'. Kurdo që një popull do të hyjë në zjarr, do të mallkojë të tjerët që kanë hyrë para tij. Dhe, kur të tubohen të gjithë atje, atëherë i fundmi i tyre do t'u thotë të parëve: 'O Zoti ynë, këta na kanë sjellë në humbje, prandaj jepu atyre një dënim të dyfishtë zjarri!' All'llahu do t'u thotë: 'Për secilin** (nga ju) **ka dënim të dyfishtë, por ju nuk e dini."**.[1]

Dënimi i udhëheqësve të mosbesimit dhe të humbjes është i dyfishtë, por përse është dyfish dënimi për ata që i kanë ndjekur?

Shkaku është se ata e meritojnë dënimin për shkak të humbjes së tyre, kurse dënimi tjetër është për shkak të ndihmës së zullumqarëve dhe asistencës së tyre, sepse zullumqarët nuk kanë mundësi të vazhdojnë të vetëm të bëjnë diçka, sado të fuqishëm që të jenë, por janë ndjekësit e tyre që ndezin zjarrin e luftërave të tyre dhe ndezin padrejtësinë dhe mosbesimin më të humbur. Dënimi i udhëheqësve të mohimit, nëse krahasohen me dënimin e ndjekësve, është më i ashpër dhe më i dhimbshëm, pa asnjë dyshim.

Ne kemi pasur një diskutim të detajuar për këtë çështje, në ajetin 30 të kësaj sureje.

1 Ajo që meriton vëmendje, është se është përmendur *"dhi'fani"* - *"dyfish"* në ajetet që po komentojmë, kurse *"dhi'fun"* - *"një* herë" në ajetin e sures "El A'raf". Me analizën e kuptimit të fjalës, *"një herë"*, bëhet e qartë se të dyja fjalët kanë një kuptim.

Ajetet 69 – 71

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ آذَوْا مُوسَى فَبَرَّأَهُ اللَّهُ مِمَّا قَالُوا وَكَانَ عِنْدَ اللَّهِ وَجِيهًا٦٩ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا٧٠ يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا٧١﴾

"O ju që keni besuar, mos u bëni si ata, që e shqetësuan Musain. All'llahu e çliroi atë nga përgojimet e tyre; ai është i nderuar në sytë e All'llahut."

"O ju që keni besuar, frikësojuni All'llahut dhe thoni vetëm të vërtetën."

"Ai do t'jua bekojë veprat tuaja dhe do t'jua falë gjynahet. Kush i bindet All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore."

Komentimi

Me çfarë e ofenduan dhe e akuzuan Musain *(Paqja qoftë mbi të!)*?

Ajetet e mëparshme flisnin për detyrën që ka çdokush, për të respektuar pozitën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të lërë mënjanë çdo gjë që e lëndon atë, si dhe të largohet prej tyre. Këto ajete e orientojnë bisedën drejt besimtarëve dhe thonë: **"O ju që keni besuar, mos u bëni si ata, që e shqetësuan Musain. All'llahu e çliroi atë nga përgojimet e tyre; ai është i nderuar në sytë e All'llahut."**.

Pa dyshim se përzgjedhja e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* mes të gjithë Profetëve ishte se, ofenduesit Beni Israili, e kanë ofenduar atë më shumë se çdo Profet tjetër, duke shtuar edhe se një pjesë e ofendimeve të ndryshme që i pa, i ngjasonin ofendimit të hipokritëve të Profetit të Islamit *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ka një diskutim mes komentuesve për kuptimin e ofendimit të Musait *(Paqja qoftë mbi të!)*. Përse Kur'ani e përmend atë në mënyrë të paqartë? Komentuesit kanë përmendur shumë mendime për komentimin e ajetit. Disa prej tyre janë:

1- Sipas transmetimit, Musai dhe Haruni *(Paqja qoftë mbi të!)* shkuan të dy në mal dhe Haruni ndërroi jetë. Kurse frikacakët prej Beni Israilëve përhapën fjalë sikur Musai ishte shkaktar për vdekjen e tij. All'llahu i Madhëruar e qartësoi të vërtetën e çështjes dhe e rrëzoi atë që kishin në dorë frikacakët.

2- Siç e kemi përmendur në mënyrë të detajuar, në fund të ajeteve të sures "El Kasas", Karuni mashtrues donte që të rrëshqiste nga ligji i zekatit dhe të mos i jepte të drejtën që u takonte njerëzve të dobët dhe fukarenj, kështu që pajtoi një prostitutë dhe ra dakord me të që të futej në mesin njerëzve dhe ta akuzonte Musain *(Paqja qoftë mbi të!)* se ai kishte bërë imoralitet me të. Ky plan dështoi me mirësinë e All'llahut të Madhëruar, madje ajo grua dëshmoi vetë për pastërtinë dhe virtytin e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe për atë se çfarë donte prej saj Karuni.

3- Një grup armiqsh e akuzuan Musain *(Paqja qoftë mbi të!)* për magjistar, budalla dhe mashtrues ndaj All'llahut, mirëpo All'llahu i Lartësuar, me mrekulli brilante, e pastroi atë nga ato akuza.

4- Një grup injorantësh Beni Israilë e akuzuan atë se ai ka disa mangësi në trup, si lebrosa e të tjera si ajo, sepse ai, kur donte të lahej dhe të merrte gusul, nuk zhvishej lakuriq para askujt. Një ditë u la larg syve të njerëzve dhe i vendosi rrobat e tij mbi një gur, por guri u rrotullua bashkë me rrobat e tij dhe Beni Israilët e panë trupin e tij, që ishte i pastër nga mangësitë.

5- Justifikimi i Beni Israilëve ishte një nga faktorët e ofendimit të Musait *(Paqja qoftë mbi të!)*, pasi ata, një herë kërkonin prej tyre që të shfaqej All'llahu (ta shikonin me sy), kurse herë tjetër thoshin se vetëm një lloj ushqimi, "manat dhe mjalti" nuk u përshtatej atyre.

Herë të tretë thoshin se nuk janë të gatshëm të hyjnë në Shtëpinë e Shenjtë dhe të luftojnë "gjigantët". I thoshin Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* që të shkonte bashkë me Zotin, të luftonin dhe

ta çlironin Shtëpinë e Shenjtë për ta, që më pas ata të hyjnë brenda saj.

Komentimi më i afërt i ajetit është: Beni Israilët e ofenduan Musain *(Paqja qoftë mbi të!)* në shumë aspekte. Ishte i njëjti ofendim, lëndim me ofendimin e një pjese të banorëve të Medines (ndaj Profetit tonë), si: përhapja e disa gënjeshtrave dhe akuzave ndaj bashkëshorteve të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Komentimi i tyre i detajuar është bërë në suren "Nur", në fundin e ajeteve 11-20.

Ata kundërshtuan martesën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Zejneben. Përmendim ofendimet e ndryshme dhe shqetësimet në shtëpinë e tij, apo kur i drejtoheshin atij me një mënyrë të paedukatë dhe pa moral.

Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* është akuzuar për magji, idiotësi e mangësi trupore. Të gjitha këto, nuk përshtaten me fillimin e ajetit: **"O ju që keni besuar"**, pasi besimtarët nuk e akuzuan as Musain *(Paqja qoftë mbi të!)* e as Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për magji, budalla e për mangësi trupore. Nëse kjo ka ndodhur me Musain dhe All'llahu i Lartësuar e mbrojti atë, atëherë kjo ngjarje nuk e mbështet historinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Nga ky ajet mund të përfitohet: Ai që ka famë dhe grada tek All'llahu, All'llahu i Madhëruar e mbron atë përballë atyre që e ofendojnë, e lëndojnë dhe e akuzojnë me të pavërteta, prandaj qëndro i pastër dhe virtuoz. Ruaje famën tënde tek All'llahu, sepse All'llahu i Madhëruar do t'ua shfaqë virtytin tënd dhe

pastërtinë tënde njerëzve, edhe sikur njerëzit e këqij të përpiqen duke të akuzuar ty, për të thyer gradën tënde dhe për të zhurmuar famën tënde mes njerëzve.

Të njëjtin kuptim e kemi lexuar në historinë e Jusufit, të sinqertit, besnikut të pastrit. All'llahu i Madhëruar e mbrojti atë nga një akuzë e madhe dhe e rrezikshme e gruas së ministrit të Egjiptit.

E njëjta histori është edhe me Merjemen, vajzën e Imranit, nënën e Isait *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Foshnja e saj dëshmoi për pastërtinë dhe virtytin e të ëmës. Me këtë dëshmi i preu gjuhët e Beni Israilëve, që rrinin në pritje, përgjim dhe përpiqeshin ta akuzonin atë, ta ndotnin me pisllëk famën e saj.

Ajo që meriton të përmendet është se kjo fjalë nuk ishte vetëm për besimtarët në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Madje ajeti mund të përfshijë edhe ata që do të lindin pas tij dhe do të bëjnë diçka që do ta lëndojë shpirtin e tij të pastër, do ta djegin fenë e tyre, do ta zvogëlojnë pozitën e tyre, do ta harrojnë trashëgiminë e tyre. Për këtë arsye thuhet në disa transmetime të familjarëve të shtëpisë Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"O ju që keni besuar, mos e ofendoni të Dërguarin e All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) për Aliun dhe Imamët."*.[1]

Fjala e fundit për komentimin e këtij ajeti është: Pasi vërejmë situatat e Profetëve të cilët nuk ishin të sigurt nga plagët e gjuhëve të injorantëve dhe të hipokritëve, nuk duhet të presim

1 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 308.

që besimtarët dhe njerëzit e pastër të mos sprovohen me njerëz të tillë.

Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kënaqësia e njerëzve nuk mund të matet dhe gjuhët e tyre nuk mund të ndalohen."*. Pastaj shton: *"A nuk e akuzuan Musain (Paqja qoftë mbi të!) se ai ishte impotent dhe e ofenduan atë, derisa All'llahu e pastroi atë? Muasi ishte me famë tek All'llahu."*.[1]

Thoni të vërtetën që të rregullohen veprat tuaja

Pas diskutimeve të mëparshme, rreth atyre që përhapin fjalë e ofendojnë Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, vjen ajeti që pason me një urdhër, që në të vërtetë është një kurë për këtë sëmundje të rrezikshme shoqërore: **"O ju që keni besuar, frikësojuni All'llahut dhe thoni vetëm të vërtetën."**.

Fjala *"el kaulu sedid"* rrjedh nga fjala *"sedde"*, domethënë, fjalë e lidhur mirë, e padepërtueshme, që nuk i mvishet e keqja dhe pranon të drejtën dhe realitetin; fjalë që qëndron si bllokadë e padepërtueshme para dallgëve të shthurjes dhe të së kotës. Disa komentues e kanë komentuar me të drejtën, kurse disa të tjerë e kanë cilësuar të pastër nga gënjeshtra dhe e kota; disa të tjerë e kanë cilësuar si ekuivalente me të jashtmen dhe të brendshmen, uniteti mes tyre, ose përmirësimi dhe udhërrëfimi, e të ngjashme me to.

1 Burimi i mëparshëm, f. 309.

Ajeti që pason, sqaron rezultatin e fjalës së drejtë: **"Ai do t'jua bekojë veprat tuaja dhe do t'jua falë gjynahet."**.

Devotshmëria është shtylla e rregullimit të gjuhës, themeli i saj dhe burimi i fjalës së drejtë. Fjala e drejtë është një nga faktorët e përmirësimit të veprave, kurse përmirësimi i veprave të mira është shkak i faljes së gjynaheve, sepse **"Veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat."**.[1]

Filozofët thonë: Gjuha është një nga organet me më shumë begati dhe nga mjetet më të rëndësishme që ndikojnë për të bindur, për të udhëzuar për punë të mira, rregullim. Ajo, në të njëjtën kohë, konsiderohet një nga organet më të rrezikshme të trupit, më kundërshtuesja dhe mëkatarja, saqë tridhjetë gjynahet e mëdha, burojnë nga ky organ i vogël.[2]

---

1 Sure "Hud", ajeti 114.

2 Gazaliu, në veprën "Ihjaul Ulumi", ka numëruar njëzet mëkate të mëdha që dalin nga gjuha. Ato janë: 1- gënjeshtra, 2- përgojimi, 3- thashethemet, 4- hipokrizia në fjalë, domethënë një njeri që ka dy gjuhë dhe dy fytyra, 5- lavdërimi i pavend, 6- fjala e keqe, 7- kënga dhe poezitë e papëlqyeshme, 8- ekzagjerimi në shaka, 9- tallja dhe përbuzja, 10- përhapja e sekreteve të të tjerëve, 11-premtimi i rrejshëm, 12- mallkimi jo me vend. 13- grindja dhe përleshja, 14- polemika dhe dukja, 15-diskutimi në çështje të kota, 16-llafazania, 17– diskutimi në çështje që nuk i interesojnë njeriut, 18- përshkrimi i vendeve ku pihet dhe luhet bixhoz, 19- pyetja për çështje jashtë konceptit të njeriut dhe diskutimi për të, 20- mënyra artificiale e të folurit.
Përveç këtyre, do të shtojmë edhe dhjetë pika të rëndësishme. Ato janë: 1- akuza, 2- dëshmia e rrejshme, 3- përhapja e të keqes dhe përhapja e gënjeshtrave, të cilat nuk kanë bazë, 4- qëndrimi jo në vendin që i takon, 5- lavdërimi i vetvetes, 6- ashpërsia dhe vrazhdësia në të folur, 7- ofendimi me gjuhë, 8- qortimi i atij që nuk e meriton qortimin, 9- mohimi i mirësisë me gjuhë, 10- informimi i pavërtetë.

Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Nuk drejtohet në rrugë të drejtë besimi i një robi, derisa të drejtohet zemra e tij dhe zemra e tij nuk drejtohet, derisa të drejtohet gjuha e tij."*.[1]

Më e mrekullueshmja është ajo që përmendet në një hadith tjetër nga Imam Sexhadi *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Gjuha e birit të Ademit nderon çdo ditë organet e tij dhe i thotë: 'Si u gdhitë sot?' Ato thonë: 'Mirë, nëse na lë rehat ti. Dhe thonë: Përkujtoje All'llahun për ne, përkjtoje All'llahu për ne. Më pas thonë: Shpërblehemi prej teje dhe dënohemi prej teje* (gjuhës).'".[2]

Ka shumë transmetime për këtë çështje, që të gjitha tregojnë rëndësinë dhe rolin e gjuhës në rregullimin e moralit dhe edukimin e shpirtrave njerëzorë. Për këtë lexojmë në një hadith: "Kurrë nuk është ulur i Dërguari i All'llahut në këtë minder, pa lexuar këtë ajet: **'O ju që keni besuar, frikësojuni All'llahut dhe thoni vetëm të vërtetën.'"**.[3]

Më pas ajeti shton në fund: **"Kush i bindet All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore."**.

Cili sukses dhe cila fitore është më e lartë se sa punët e njeriut të jenë të mira dhe mëkatet e tij të falura dhe All'llahu të jetë i kënaqur me të?!

1 Tefsiri "Biharul Anuar", vëll. 71, f. 287.
2 I njëjti burim, f. 278.
3 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthur", sipas transmetimit të veprës "Nuruth Thekalejn", vëll. 16, f. 376.

Ajetet 72 – 73

﴿إِنَّا عَرَضْنَا الْأَمَانَةَ عَلَى السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَالْجِبَالِ فَأَبَيْنَ أَنْ يَحْمِلْنَهَا وَأَشْفَقْنَ مِنْهَا وَحَمَلَهَا الْإِنْسَانُ إِنَّهُ كَانَ ظَلُومًا جَهُولًا ٧٢ لِيُعَذِّبَ اللَّهُ الْمُنَافِقِينَ وَالْمُنَافِقَاتِ وَالْمُشْرِكِينَ وَالْمُشْرِكَاتِ وَيَتُوبَ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا ٧٣﴾

“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie)**.”**

“Si pasojë, All’llahu do t’i dënojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtaret, ndërsa do t’ua pranojë pendimin besimtarëve dhe besimtareve. Vërtetë All’llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”

Komentimi

Mbajtja e amaneteve hyjnore është një nga vlerat më të mëdha të njerëzimit

Këto dy ajetet e fundit të sures "El Ahzab" plotësojnë çështjet e rëndësishme që janë përmendur në këtë sure, në aspektin e besimit, të punës së mirë, të luftës në Rrugë të All'llahut, të altruizmit, të virtyti, të edukatës dhe moralit. Këto ajete bëjnë të qartë se si njeriu zë një vend shumë të lartë, ku mund të jetë bartës i mesazhit të madh të All'llahut. Nëse nuk do ta injoronte vlerën e tij jetësore dhe ekzistenciale, do t'i bënte padrejtësi të madhe vetes së tij dhe do të zbresë në vendet më të ulëta.

Në fillim ajeti 72 sqaron një nga veçoritë më të mëdha të njeriut dhe më të rëndësishme në të gjithë botën e krijimit: **"Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë."**.

Nuk ka asnjë dyshim se refuzimi i marrjes së përgjegjësisë dhe ndalimi ndaj saj nuk ishte prej mendjemadhësisë së tyre, siç ishte për shejtanin, ashtu si e sqaron ajeti 34 i sures "El Bekare": **"...refuzoi dhe bëri mendjemadhësi."**.

Përkundrazi, refuzimi ishte i shoqëruar me shqetësim të madh, domethënë frikë, e përzier me orientim dhe përulje.

Por njeriu, për habi të botës së krijimit, bëri përpara: **"...kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur** (për pasojat e kësaj përgjegjësie)**."**.

Komentuesit e mëdhenj të Islamit kanë folur shumë rreth këtij ajeti. Ata janë përpjekur shumë që të arrijnë të vërtetën e kuptimit të fjalës "amanet" dhe kanë paraqitur pikëpamje të ndryshme.

Do të zgjedhim më të mirat e tyre, duke dhënë fakte krahasuese, që gjenden në brendësi të ajetit.

Në këtë ajet me përmbajtje të thellë, duhet të fokusohemi në pesë çështje:

1- Çfarë kuptohet me fjalën "amanet"?

2- Çfarë do të thotë paraqitja e saj ndaj qiejve, tokës dhe maleve?

3- Pse dhe si e refuzuan këto krijesa bartjen e këtij amaneti?

4- Si e barti njeriu peshën e këtij amaneti?

5- Pse dhe si është i padrejtë, injorant ?

Janë bërë shumë komentime të ndryshme për amanetin. Po përmendim disa prej tyre:

Prej ajetit kuptohet:

• Mbrojtja hyjnore dhe plotësimi i virtytit të adhurimit, i cili arrihet nëpërmjet njohurisë dhe veprës së mirë.

• Virtyti i zgjedhjes, i lirisë dhe i vullnetit, të cilat e dallojnë njeriun nga të gjitha krijesat e tjera.

• Logjika është pjesë e përgjegjësisë, e shpërblimit dhe e dënimit.

• Organet e trupit të njeriut, si: syri, për shembull, është amanet i All'llahut, duhet të mbrohet dhe të mos përdoret në rrugët e mëkatit; edhe veshi, dora, këmba dhe gjuha, të gjitha janë amanete që duhet të ruhen.

• Amanetet që marrin njerëzit nga njeri-tjetri dhe mbajtja e premtimeve.

• Njohja e All'llahut të Madhëruar.

• Detyrat hyjnore, si: namazi, agjërimi dhe Haxhi.

Bëhet e qartë se këto komentime nuk kundërshtojnë njëra–tjetrën, madje është e mundur ndërthurja e një pjese me pjesën tjetër, pasi një pjesë e tyre ka marrë një anë të temës, kurse pjesa tjetër e ka marrë të gjithën.

Për hir të marrjes së një përgjigje të plotë, duhet t'i hedhim një shikim njeriut, për të parë se çfarë gjëje është ajo që kanë dhe e kanë humbur qiejt, tokat dhe malet?

Ekzistojnë pajisje të shumta, ku njeriu mund të përfitojë nëpërmjet tyre, që të jetë si mëkëmbës i All'llahut. Ai mund të arrijë në majën e madhështisë dhe të respektit, duke përfituar njohuri dhe duke edukuar nefsin, egon, për të arritur përsosjet, duke u ngjitur në gradë deri edhe mbi engjëjt.

Kjo përgatitje, e shoqëruar me liri, vullnet dhe zgjedhje, do të thotë se njeriu e zgjedh këtë rrugë me dëshirën dhe zgjedhjen e tij dhe fillon nga zeroja dhe shkon deri në fund.

Pa dyshim se qielli, toka dhe malet kanë një lloj njohurie hyjnore dhe ato e përkujtojnë dhe e madhërojnë All'llahun e

Madhëruar. I përulen Madhështisë së Tij dhe i frikësohen Atij dhe bëjnë në sexhde për Të. Vetëm se e gjitha kjo është personale, kreative dhe detyruese dhe për këtë arsye nuk ka përsosje në të. Krijesa e vetme që përfundon dy kthesat e ngjitjes dhe të zbritjes së tij, që është i aftë të ngjisë majat e përsosjes në një formë që nuk njeh kufi dhe i bën të gjitha këto vepra me vullnetin dhe zgjedhjen e tij, është njeriu. Ky është ai "amaneti hyjnor", për të cilën u stepën të gjitha krijesat që ta mbanin dhe e mbajti atë njeriu.

Ajeti që vjen më pas, e ndan njerëzimin në tri grupe: besimtarët, jobesimtarët dhe hipokritët.

Në bazë të kësaj, duhet të themi se amaneti hyjnor është pranimi i përsosjes së pakufishme, e përzier me vullnet të lirë dhe zgjedhje. Arritja e pozitës së përsosur të njeriut, e në mënyrë të veçantë e adhurimit të All'llahut dhe pranimi i mbrojtjes së All'llahut.

Mirëpo, përse është shprehur me fjalën "amanet", edhe pse e gjithë ekzistenca jonë dhe ajo çfarë kemi, është amanet i All'llahut?

Është shprehur në këtë formë për rëndësinë e kësaj karakteristike të madhe të njerëzimit, sepse edhe pjesa tjetër e dhuratave janë amanete të All'llahut, por rëndësia e tyre është e vogël para kësaj veçorie.

Këtu ne mund të shprehemi për amanetin me një shprehje tjetër dhe themi: Ai është premtimi, kryerja dhe pranimi i përgjegjësisë.

Në bazë të kësaj, ata që e komentuan amanetin, me cilësinë e zgjedhjes dhe lirisë së vullnetit, kanë folur për një anë tjetër të këtij amaneti të madh, ashtu si ata që e komentuan atë me logjikë apo me organet e trupit, apo amanetet e njerëzve te njëri-tjetri, apo detyrat, secili ka treguar një degë prej degëve të pemës së madhe me fruta dhe ka këputur prej tyre një fryt.

Mirëpo çfarë kupton shprehja: "*ofrimi i këtij amaneti ndaj qiejve dhe tokës"*?

A ka për qëllim që All'llahu i Madhëruar u ka dhënë këtyre krijesave një pjesë të logjikës dhe ndjenjave, pastaj u ka ofruar atyre bartjen e këtij amaneti?

Apo qëllimi me ofrimin, është shoqërimi, domethënë se, kur krahasoi përmasën e këtij amaneti, me çfarë ka në të prej pranimeve dhe përgatitjeve, toka, qiejt shpallën mosmiratimin e tyre dhe mospërgatitjen për bartjen e këtij amaneti të madh.

Sigurisht, duket se kuptimi i dytë është më i saktë. Pa dyshim se qiejt, toka dhe malet thanë me zë të lartë, që të gjitha, se nuk kanë fuqi ta bartin këtë amanet.

Prej këtu bëhet e qartë përgjigjja për pyetjen e tretë, se përse dhe si këto krijesa e refuzuan dhe nuk deshën të merrnin përsipër këtë amanet të madh dhe të shfaqin frikën e shoqëruar me përulje prej asaj?

Prej këtu bëhet e qartë mënyra se si njeriu e bart këtë amanet hyjnor, sepse njeriu është krijuar në atë formë që të mbajë përgjegjësinë dhe ta vërë në praktikë atë, të pranojë mbrojtjen e All'llahut, të ecë në rrugën e adhurimit dhe të përsosjes, të drejtohet drejt të adhuruarit të përhershëm, ta zgjedhë këtë rrugë

me këmbët dhe vullnetin e tij dhe të kërkojë ndihmë prej Zotit të tij.

Në shumë transmetime nga familjarët e shtëpisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për komentimin e këtij amaneti hyjnor thuhet se kuptohet mbrojtja e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe djalit të tij, sepse mbrojtja e Profetëve dhe e Imamëve është një dritë që ndriçon nga ajo mbrojtje e përgjithshme hyjnore. Mbërritja në pozitën e adhurimit dhe zgjedhja e rrugës së përsosjes, nuk mund të plotësohet pa pranuar mbrojtjen e miqve të All'llahut.

Në një hadith nga Imam Ali ibn Musa Ridha *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Amaneti është mbrojtja. Kush e pretendon atë me pa të drejtë, ka mohuar."*.[1]

Kur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për komentimin e këtij ajeti, ka thënë: *"Amaneti është mbrojtja, kurse njeriu është koka e të këqijave të hipokritit."*.[2]

Pranimi i amanetit hyjnor nuk ishte një pranim i marrëveshjes dhe i lidhjes, përkundrazi ishte një pranim që në krijim *(kabulun tekuinij)* , sipas botës së përgatitjes.

Pyetja e vetme që mbetet, është çështja e karakterit të njeriut, **"...i padrejtë me veten dhe i paditur** (për pasojat e kësaj përgjegjësie)**."**. Mos vallë, përshkrimi i njeriut me këto dy cilësi, nga sa duket nga pamja e jashtme, janë poshtërim dhe kritikë e ashpër për të, ishte rezultat i pranimit të këtij amaneti?

1 Tefsiri i Burhanit, vëll. 3, f. 341, fundi i ajetit është burimi i komentimit.
2 Burimi i mësipërm.

Është e padiskutueshme se mohimi është përgjigjja e kësaj pyetjeje, sepse pranimi i kësaj çështjeje është krenaria më e madhe dhe karakteristika më e veçantë e njeriut, pra, si është e mundur që shembulli i kësaj pozite të lartë të qortojë pranimin e tij?

A mos vallë ky përshkrim është për shkak të harresës së shumicës së njerëzve, padrejtësisë që i bëjnë vetes së tyre, mungesës së njohurisë për vlerën e njeriut dhe gradën e tij, për shkak të veprës që e nisi që në zanafillë të pasardhësve të Ademit, nga ana e Kabilit dhe ndjekësve të tij dhe vazhdon deri sot.

Njeriu thërret nga Arshi dhe bijtë e Ademit, mbi kokat e të cilëve janë vënë kurora (nderuam bijtë e Ademit) dhe njerëzit janë zëvendësit e All'llahut në tokë, sipas Fjalës së All'llahut të Madhëruar: **"Kur Zoti yt u tha engjëjve: 'Unë do të krijoj një mëkëmbës** (që do të zbatojë ligjet e Zotit) **në tokë', ata thanë: 'A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!' Ai tha: 'Unë di atë që ju nuk e dini.'"**.[1]

Njeriu ishte mësues i engjëjve dhe i bënë sexhde atij. Si mund të jetë njeriu i padrejtë ndaj vetes dhe i paditur, nëse i harron të gjitha këto vlera të larta në gradë, e bën veten e tij të burgosurin e kësaj bote dhe ndjekës të këtij dheu dhe rreshtohet në radhët e shejtanëve dhe zbret në nivelin më të ulët?!

Pranimi i kësaj rruge të devijuar, e cila vazhdon të ketë ndjekës dhe që e zgjedhin shumë, është argumenti më i mirë që njeriu është i padrejtë dhe i paditur. Vetë Ademi, i cili ishte koka e

1 Sure "El Bekare", ajeti 30.

zinxhirit dhe i veshur me pafajësi, e pranon se edhe ai i ka bërë padrejtësi vetes: **"Ata thanë: 'O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.'"**.[1]

E megjithatë, duhet të dimë se njeriu i dobët, i vogël në pamje të parë, është çudia e botës së krijesave. Ai mundi të mbajë vështirësitë e amanetit, që qiejt dhe tokat ishin të pafuqishme ta bartnin atë.[2]

Ajeti që pason bën të qartë arsyen e paraqitjes së këtij amaneti ndaj njeriut dhe sqaron të vërtetën se njerëzimi, pas bartjes së këtij amaneti, është ndarë në tri grupe: hipokritët, idhujtarët dhe besimtarët. Ajeti thotë: **"Si pasojë, All'llahu do t'i dënojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtaret, ndërsa do t'ua pranojë pendimin besimtarëve dhe besimtareve. Vërtetë All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**.

Ka dy mendime për kuptimin e shkronjës *"lam"* te fjala *"li juadh'dhibe"* - *"të ndëshkojë"*.

Mendimi i parë: Ajo është *"lami"* i qëllimit, që përmendet për të qartësuar fundin dhe përfundimin e diçkaje. Në bazë të

1 Sure "El A'raf", ajeti 23.

2 Nga sa thamë për komentimin e ajetit, është bërë e qartë se nuk ka nevojë të vlerësojmë gjë në ajet. Një grup komentuesish ka thënë se ajo që nënkuptohet me paraqitjen e amanetit të All'llahut ndaj qiellit, tokës dhe maleve, është paraqitja e tij banorëve të tyre, domethënë engjëjve. Ata kanë thënë se ata që e refuzuan ta bartnin amanetin, e kishin kryer atë, kurse ata që e bartën atë, e tradhtuan. Në pamje të parë, ky komentim nuk e kundërshton ajetin, vetëm nga ana e nevojës dhe e vlerësimit, madje mund të debatohet dhe të përmendet në bindjen e tij se mbi engjëjt ka një lloj detyrimi, se ata janë bartës të një pjese të këtij amaneti. Duke e larguar shikimin nga e gjitha kjo, pa dyshim se komentimi i banorëve të maleve dhe engjëjt, nuk janë larg çudisë.

kësaj, kuptimi i ajetit bëhet: Përfundimi i bartjes së këtij amaneti ishte se një grup zgjodhi rrugën e hipokrizisë, kurse një grup tjetër rrugën e idhujtarisë. Këta do të sprovohen me dënimin e All'llahut, për shkak të tradhtisë së amanetit të Tij. Grupi tjetër, që janë ithtarë të besimit, do t'i përfshijë mëshira e All'llahut, për shkak të mbajtjes së amanetit dhe kryerjes së detyrimeve.

Mendimi i dytë: "*Lami*" te fjala *"li juadh'dhibe" - "të ndëshkojë"* është "lami i arsyes", duke i dhënë fjalisë ton vlerësues. Në bazë të këtij mendimi, komentimi i ajetit është: Qëllimi i paraqitjes së amanetit ishte se i gjithë njerëzimi të vihet në pikën e sprovës, çdo njeri të pastrojë pjesën e brendshme të tij dhe të mendojë se çfarë shpërblimi dhe dënimi meriton.

Këtu ka disa çështje, që meritojnë t'i trajtojmë:

1- Shkaku i paraprirjes së grupit të hipokrizisë ndaj idhujtarisë është se hipokriti shfaqet sikur është besnik, kur në të vërtetë ai është tradhtar. Tradhtia e idhujtarit është e dukshme, e zbuluar. Për këtë arsye, hipokriti meriton pjesën më të madhe të dënimit.

2- Shkaku i paraprirjes së këtyre dy grupeve ndaj besimtarëve, është se ajeti i mëparshëm mbaron: **"...njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur** (për pasojat e kësaj përgjegjësie)**."**.

Këto dy cilësi i përshtaten hipokritit dhe idhujtarit, pasi hipokriti është zullumqar, kurse idhujtari është injorant.

3- Fjala "All'llah" është përmendur vetëm një herë në lidhje me hipokritët dhe idhujtarët dhe një herë në lidhje me besimtarët,

sepse përfundimi i dy grupeve të para është një, kurse llogaria e besimtarëve ndryshon nga ata të dy.

4- Ka mundësi që mënyra e shprehjes me pendim, në vend të shpërblimit, t'u adresohet besimtarëve, sepse frika më e madhe e besimtarëve është nga gjynahet dhe kundërshtimet që del prej tyre. Prandaj ajeti i qetëson ata dhe u jep rehatinë shpirtërore, se gjynahet e tyre do të falen.

Pranimi i pendimit nga All'llahut për robtë e Tij, do të thotë rikthimi i Tij tek ata me mëshirë. Ne e dimë se të gjitha dhuratat dhe shpërblimet janë fshehur në fjalën *"rahmetin"* - *"mëshirë"*.

5- Përshkrimi i All'llahut si Falës i madh dhe Mëshirues, përballë padrejtësisë dhe injorancës mbase ishte për të harmonizuar pendimin e besimtarëve dhe të besimtareve.

Tani, që e kemi arritur fundin e sures "El Ahzab", me mirësinë e All'llahut të Madhëruar, e shohim të domosdoshme përmendjen e kësaj çështjeje: Harmonia e fillimit të kësaj sureje me fundin e saj meriton kujdes, sepse kjo sure ka nisur duke i folur Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke e urdhëruar atë me devotshmëri ndaj All'llahut, duke e urdhëruar të mos dëgjojë jobesimtarët dhe hipokritët, por të pohojë Njëshmërinë e All'llahut të Gjithëdijshëm dhe ka përfunduar me përmendjen e çështjes më të madhe në jetën e njeriut, domethënë, bartjes së amanetit të All'llahut. Pastaj ka përmendur ndarjen e njerëzimit në tri grupe: hipokritët, jobesimtarët dhe besimtarët. Gjithashtu, ka theksuar cilësitë e All'llahut, Falës, Mëshirues.

Midis këtyre dy diskutimeve janë shtruar diskutime të shumta për këto tri grupe, për metodën e tyre të sjelljes me këtë amanet hyjnor. Të gjitha këto diskutime plotësojnë dhe sqarojnë njëra-tjetrën.

O All'llah, na bëj ne prej atyre që e kanë pranuar me sinqeritet amanetin Tënd, që e kanë bartur atë me dashuri dhe ëmbëlsi dhe i kanë kryer detyrat karshi tij.

O All'llah, na bëj ne prej besimtarëve që i ka mbuluar mëshira Jote! Mos na bëj prej hipokritëve dhe idhujtarëve, të cilët e kanë merituar dënimin, sepse ishin të padrejtë ndaj vetes dhe të paditur.

O All'llah, zbrite zemërimin dhe hidhërimin Tënd mbi grupet e mosbesimit, të cilat janë bashkuar përsëri dhe kanë pushtuar qytetin e Islamit në kohën tonë. Shkatërroi kështjellat e tyre mbi kokat e tyre!

O All'llah, na jep ne vendosmëri dhe qëndrim në Rrugën e Drejtë, që të qëndrojmë në të si mali, që ta mbrojmë qytetin e Islamit në këto çaste delikate.

SURJA "SEBÈ"

Zbritur në Mekë, ajete 54

Përmbajtja e sures

Është quajtur me këtë emër "Sebè", pasi përmendet historia e popullit të Sebeit. Kjo sure ka zbritur në Mekë dhe përfshin hulumtime rreth njohurive islame dhe bazave të besimit, në mënyrë të veçantë "fillimi i krijit", "Ditën e Ringjalljes" dhe "Profecia". Shumica e hulumtimeve sillen rrotull këtyre temave, për shkak të nevojës së myslimanëve për kristalizimin e çështjeve të besimit në Mekë dhe përgatitja e tyre për të kaluar në degët e fesë, në formimin e qeverisë dhe në zbatimin e programit të plotë islam.

Në mënyrë të përgjithshme, mund të themi se përmbajtja e kësaj sureje ndahet në pesë tema:

1- Njehsimi (Teuhidi). Disa gjurmë që tregojnë për të në botën e ekzistencës, disa cilësi *(es sifatu)* të shenjta të All'llahut, si: njëshmëria, të qenit i adhuruar dhe hyjni.

2- Çështja e Ringjalljes ka zënë pjesën më të madhe të kësaj sureje, duke e demonstruar atë brenda diskutimeve, nga këndvështrime të ndryshme.

3- Profecia e Profetëve të mëparshëm e në mënyrë të veçantë i të Dërguarit më i nderuar të Islamit, Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe kundërpërgjigjja për fabrikimet e armiqve të tij. Përmendet një anë e mrekullive të Profetëve që kanë qenë para tij.

4- Ekspozimi, duke përmendur disa mirësi të mëdha hyjnore. Përfundimi i falënderuesve dhe i mohuesve nëpërmjet demonstrimit të një ane të jetës së Profetit Sulejman *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe jeta e popullit të Sebeit.

5- Thirrja në meditim dhe shikimi me kujdes i besimit dhe i veprës së mirë. Ndikimi i këtyre faktorëve në lumturinë dhe suksesin e njerëzimit.

Kjo sure, përmban një program edukativ gjithëpërfshirës për edukimin e atyre që kërkojnë të drejtën, të vërtetën.

Mirësia e kësaj sureje

Në transmetime vihen re fraza tërheqëse rreth rëndësisë së kësaj sureje dhe rëndësisë së leximit të saj. Prej atyre transmetimeve është ai që ka ardhur nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i cili ka thënë: "*Kush e lexon suren 'Sebè', çdo Profet dhe çdo i Dërguar do jenë shoqëruesit e tij në Ditën e Kiametit.*".[1]

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Kush lexon, në një natë, të dy suret që fillojnë me falënderimin e All'llahut, 'Sebè' dhe 'El Fatir', gjatë asaj nate do të jetë i mbrojtur nga All'llahu i Lartësuar. Nëse i lexon ditën, asnjë e keqe nuk do ta godasë gjatë ditës. Nga e mira e dynjasë dhe e Ahiretit i jepet aq shumë, sa nuk e ka ndier ndonjëherë me zemër e nuk e ka çuar ndonjëherë nëpër mend.*".[2]

Kujtojmë, si në fillimin e çdo sureje, se këtë shpërblim të madh nuk e përfiton ai që mjaftohet vetëm me leximin me gjuhë, por leximi duhet të paraprihet me meditim, i cili është nxitës i veprës së mirë.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 375, fillimi i sures "Sebè".
2 Burimi i mëparshëm.

Ai që e lexon këtë sure, për shembull, do të mësojë shkatërrimin e popullit të Sebeit. Vdekjen e tyre e bëri mësim për botët dhe përfundimin e tyre për t'u marrë shembull. Ky shkatërrim u bë, sepse ata mohuan mirësitë e shumta të All'llahut.

Kush e lexon këtë sure, falënderimin e mirësisë duhet ta zbatojë në mënyrë praktike. Falënderuesi për mirësinë e All'llahut do të jetë në mbrojtjen dhe sigurinë e All'llahut të Lartësuar.

Kemi përmendur një shpjegim të mjaftueshëm rreth kësaj teme, në komentimin tonë të parë të sures "Nur".

Ajetet 1 – 2

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِى لَهُ مَا فِى السَّمَاوَاتِ وَمَا فِى الْأَرْضِ وَلَهُ الْحَمْدُ فِى الْآخِرَةِ وَهُوَ الْحَكِيمُ الْخَبِيرُ، يَعْلَمُ مَا يَلِجُ فِى الْأَرْضِ وَمَا يَخْرُجُ مِنْهَا وَمَا يَنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ وَمَا يَعْرُجُ فِيهَا وَهُوَ الرَّحِيمُ الْغَفُورُ﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"I lavdëruar qoftë All'llahu, të Cilit i përket gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë! I lavdëruar qoftë Ai edhe në Jetën Tjetër! Ai është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."

"Ai di çfarë hyn në tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbret nga qielli dhe çfarë ngrihet drejt tij. Ai është Mëshirëploti dhe Falësi."

Komentimi

All'llahu është zotëruesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshëm për çdo gjë

Pesë nga suret prej sureve të Kur'anit Famëlartë fillojnë me falënderimin e All'llahut. Në tre prej tyre, falënderimi është lidhur me krijimin e qiejve dhe të tokës. Ato sure janë: "Sebè", "El Fatir" dhe "El En'am". Në suren "El Kehf" falënderimi shoqërohet me zbritjen e Kur'anit në zemrën e të Dërguarit më të nderuar. Surja hapëse e Kur'anit, "El Fatiha", nis me një shprehje gjithëpërfshirëse për të gjitha këto çështje: **"Çdo lavdërim i përket All'llahut, Zotit të botëve."**. Lavdërimi dhe falënderimi në fillim të sures "Sebè" është për All'llahun e Lartësuar, për sundimin dhe posedimin e Tij në dynja dhe Ahiret.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"I lavdëruar qoftë All'llahu, të Cilit i përket gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë! I lavdëruar qoftë Ai edhe në Jetën Tjetër!"**.

Kështu që sundimi dhe posedimi në dynja dhe Ahiret janë për All'llahun e Madhëruar. Çdo dhuratë, çdo mirësi, dobi, begati dhe çdo krijesë e krijuar e habitshme e mrekullueshme, lidhet me All'llahun e Lartësuar. Pa dyshim se falënderimi, e vërteta e të cilit është "lavdërimi për një punë të mirë e të pëlqyeshme" i referohet All'llahut të Lartësuar. Edhe nëse disa krijesa e meritojnë falënderimin dhe lavdërimin, kjo sepse ata janë rrezatim nga prania e All'llahut të Lartësuar dhe se punët dhe cilësitë e tyre janë prej veprave dhe cilësive të All'llahut të

Lartësuar. Për All'llahun e Lartësuar është çdo lavdërim dhe falënderim, që buron nga dikush për diçka në këtë botë.

Më pas ajeti vazhdon: **"Ai është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."**.

Urtësia e gjerë e All'llahut ka caktuar që gjithësia t'i nënshtrohet këtij sistemi të mrekullueshëm e të habitshëm dhe me diturinë dhe gjithëpërfshirjen e Tij, të vendosë ekuilibrin në çdo gjë në gjithësi. Çdo krijesë ndodhet në vendin e saj në gjithësi dhe çdo krijesë e gjen atë për të cilën ka nevojë.

Komentuesit kanë folur shumë për këtë ajet, për falënderimin dhe lavdërimin në Ahiret të All'llahut. Disa prej tyre kanë thënë se, edhe pse Ahireti nuk është shtëpia e detyrave dhe e veprave, adhuruesit e All'llahut të Madhëruar, shpirtrat e të cilëve janë ngritur lart me dashurinë e Krijuesit të tyre, falënderojnë, lavdërojnë dhe shijojnë një kënaqësi të veçantë prej saj.

Disa komentues te tjerë kanë thënë se banorët e Xhennetit e falënderojnë All'llahun për mirësitë e Tij, kurse banorët e zjarrit e falënderojnë Atë për drejtësinë e Tij.

Është thënë se njeriu, si rezultat i ekzistencës së perdeve të ndryshme në zemrën dhe mendjen e tij në dynja, nuk mund ta falënderojë All'llahun me një falënderim të sinqertë. Kur të largohen këto pengesa në Ditën e Kiametit, atëherë bëhet e qartë vepra dhe puna e All'llahut të Lartësuar mbi botën e ekzistencës, duke miratuar fjalën e Tij: **"I tërë pushteti atë Ditë i përket All'llahut."**.[1]

1 Sure "El Haxh", ajeti 56.

Atë Ditë gjuhët shqiptojnë, me nijetin më të pastër, falënderime dhe lavdërime pa fund për All'llahun e Lartësuar.

Njeriu mund të hutohet në këtë botë dhe të falënderojë disa krijesa, duke imagjinuar pavarësinë e tyre, por ai në Ahiret, ku bëhet e qartë lidhja e gjithçkaje me All'llahun e Lartësuar, ashtu si lidhja e rrezeve të dritës me diskun e tyre, nuk do të falënderojë dhe nuk do të lavdërojë askënd tjetër veç All'llahut të Madhëruar.

Përveç gjithë kësaj, është përmendur shpesh në Kur'anin Famëlartë, se banorët e Xhennetit e falënderojnë All'llahun, kur hyjnë në Xhennetet e përhershme: **"Pastaj do të thonë: 'Lavdi All'llahut, i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne. Vërtetë, Zoti ynë është Falës dhe Falënderues.'"**.[1]

Dhe: **"Lutja e tyre aty do të jetë 'Qofsh i lavdëruar, o Zot!'. Përshëndetja e tyre do të jetë 'Selam' dhe lutja e tyre e fundit 'Falënderuar qoftë All'llahu, Zoti i botëve'!"**.[2]

Sido që të jetë, ky falënderim dhe lavdërim nuk ndahet vetëm nga gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve, madje dëgjohen pëshpëritjet e falënderimit dhe të madhërimit nga çdo atom në botën e ekzistencës, pasi nuk ka gjallesë që nuk e falënderon dhe e madhëron All'llahun e Lartësuar.

Ajeti i dytë shfaq një anë të diturisë së pakufishme të All'llahut, në përshtatje me përshkrimin e All'llahut të Lartësuar në ajetin 1: **"Ai di çfarë hyn në tokë dhe çfarë del prej saj."**.

1 Sure "El Fatir", ajeti 34.
2 Sure "Junus", ajeti 10.

Ka përfshirë dituri në çdo kokërr shiu dhe në çdo pikë uji që del dhe futet në thellësitë e tokës, derisa të arrijë shtresat e forta që të mblidhet atje dhe të bëhet depozitë për njeriun.

Ai e di për farat që përhapen mbi sipërfaqen e tokës nëpërmjet erës dhe insekteve, që do të mbijnë në një vend dhe do të bëhen pemë të frytshme, ose dru të freskët.

Ai i di për rrënjët e pemës që depërtojnë në thellësitë e dheut, duke kërkuar ujë dhe ushqim.

Ai e di edhe për rrymat elektrike dhe të gazeve të ndryshme, për atomet e ajrit që depërtojnë në tokë, e di për qeniet e gjalla që çajnë rrugën e tyre në të dhe u japin atyre jetë.

Po kështu, Ai e di për thesaret, kufomat dhe trupat e vdekur të njerëzve, etj. All'llahu është i Dijshëm për të gjitha këto.

Ai është i Mirinformuar dhe i Gjithëditur për bimët që dalin nga toka dhe njerëzit që kujdesen për to, për burimet që nxjerrin ujë prej tyre, për gazrat që dalin prej tyre, për vullkanet që tundin llavën e tyre, për insektet që bëjnë fole në të dhe dalin prej tyre.

Përmbledhja është se All'llahu është më i Dijshëm për të gjitha krijesat që hyjnë në tokë dhe dalin prej saj, më universale se ajo që ne dimë, apo nuk dimë.

Pastaj shton: **"Çfarë zbret nga qielli dhe çfarë ngrihet drejt tij."**.

All'llahu e di për pikat e shiut dhe për rrezet e diellit që gjallërojnë jetën, për valët e Shpalljes dhe ligjeve madhështore qiellore, për melekët që zbresin në tokë për të përcjellë mesazhet

apo për të zbatuar urdhëresat e ndryshme të All'llahut, për rrezet e galaktikës që hyjnë në atmosferën e tokës nga hapësira e jashtme, për hirin dhe atomet që lëvizin në hapësirë dhe që fryhen drejt tokës. All'llahu i Madhëruar është i Gjithëditur për të gjitha këto.

All'llahu i di veprat e robve që ngjiten në qiell dhe të melekëve, që mbyllin shkallët e qiellit pas kryerjes së detyrave; për shejtanët që ngjiten në qiell për të vjedhur ndonjë informacion me të dëgjuar dhe për degët e pemëve që ngjiten në qiell me majat e tyre; për avujt që ngjiten lart prej deteve në lartësitë e qiellit, për të bërë të dendur retë; për ofshajet që dalin nga zemra e atij që i është bërë padrejtësi... All'llahu është i Gjithëditur për çdo gjë.

A ka ndonjë që t'i dijë të tëra këto gjëra përveç All'llahut të Madhëruar? A mund të përfshijnë dituritë e të gjithë dijetarëve të mbledhur bashkë, qoftë edhe një pjesë të këtyre informacioneve?

Në fund të ajetit All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ai është Mëshirëploti dhe Falësi."**.

All'llahu i Madhëruar e ka përshkruar veten e Tij me këto dy cilësi, ose për shkak se Ai është pjesë e çështjeve që veprat e robve dhe shpirtrat e tyre ngjiten në qiell dhe i përfshin ata me mëshirën e Tij, ose sepse zbritja e begative dhe e dhuratave qiellore burojnë nga mëshira e Tij. Punët e mira të robve që ngjiten, janë të përfshira në faljen e All'llahut të Madhëruar, siç thotë ajeti: **"...Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë..."**.[1]

1 Sure "El Fatir", ajeti 10.

Ose, sepse mëshira e All'llahut të Madhëruar përfshin atë që falënderon këto mirësi, kurse "falja" përfshin ata që kanë neglizhuar në kryerjen e falënderimit.

Përmbledhja është: Ajeti 2 ka kuptim të gjerë, nga të gjitha drejtimet dhe përmbajtja e tij nuk duhet të kufizohet në një kuptim të vetëm.

Ajetet 3 – 5

﴿وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَا تَأْتِينَا السَّاعَةُ قُلْ بَلَى وَرَبِّي لَتَأْتِيَنَّكُمْ عَالِمِ الْغَيْبِ لَا يَعْزُبُ عَنْهُ مِثْقَالُ ذَرَّةٍ فِي السَّمَاوَاتِ وَلَا فِي الْأَرْضِ وَلَا أَصْغَرُ مِنْ ذَلِكَ وَلَا أَكْبَرُ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ۝ لِيَجْزِيَ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَئِكَ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ۝ وَالَّذِينَ سَعَوْا فِي آيَاتِنَا مُعَاجِزِينَ أُولَئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ مِنْ رِجْزٍ أَلِيمٌ۝﴾

"Jobesimtarët thonë: 'Nuk do të na vijë Ora (e Kiametit)**'! Thuaju: 'Po, për Zotin tim! Me siguri që ajo do t'ju vijë"! Ai i di të gjitha të fshehtat. Atij nuk mund t'i fshihet asnjë grimë as në qiej, as në Tokë e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe se ajo, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë."**

"(Kiameti do t'ju vijë) **me qëllim që Ai të shpërblejë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Për njerëz të tillë do të ketë falje dhe begati të mrekullueshme."**

"Ndërsa për ata që luftojnë kundër Shpalljeve Tona, duke u përpjekur që t'i pengojnë ato, do të ketë dënim të tmerrshëm dhe të dhembshëm."

Komentimi

Ajetet që po komentojmë, flasin për Teuhidin dhe cilësitë e All'llahut. Në të njëjtën kohë ato përgatitin kushtet për temën e Kiametit, sepse problematikat e hulumtimit rreth Kiametit nuk mund të zgjidhen vetëm se nëpërmjet rrugës së diturisë së pakufishme të Krijuesit.

Ajetet që po komentojmë, fillojnë me fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"Jobesimtarët thonë: 'Nuk do të na vijë Ora** (e Kiametit)**!'"**. Kjo thënie e tyre nuk është gjë tjetër vetëm se gënjeshtër dhe mashtrim. Nuk ka asnjë dyshim se Kiameti nuk i vjen askujt prej njerëzve. Me këto fjalë duan të zgjidhen dhe të lirohen nga detyrat e këtij besimi: llogaria, Libri, drejtësia dhe shpërblimi, që të veprojnë atë që u duket atyre e mirë prej punëve.

Mirëpo Kur'ani, në bazë të qartësisë së argumenteve të Kiametit, i flet të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në një formë të prerë, duke i treguar qartë rezultatin: **"Thuaju: 'Po, për Zotin tim! Me siguri që ajo do t'ju vijë'! Ai i di të gjitha të fshehtat."**

Këtu duhet vënë theksi mbi fjalën *"rabbun"* - *"Zot"*, sepse Kiameti, në thelb, është prej çështjeve të Zotit. Si është e mundur që All'llahu të jetë zotërues dhe edukues i njerëzimit, që i drejton ata në rrugëtimin drejt përsosjes së tyre, pastaj i lë ata në mes të rrugës, duke e përfunduar çdo gjë me vdekjen? Si mund të jetë jeta e tyre pa një qëllim kurse krijimi i tyre i kotë pa asnjë kuptim?

Për këtë përshkrim Kur'ani është përqendruar në ajetin e shtatë të sures "Et Tegabun" ku thotë: **"Mohuesit kujtojnë se nuk do të ringjallen kurrsesi. Thuaju: 'Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjalleni e pastaj do të njoftoheni për atë ç'keni bërë!' Dhe kjo është e lehtë për All'llahun."**.

Meqenëse një nga problemet e jobesimtarëve me Kiametin është dyshimi, nga njëra anë, në mundësinë e bashkimit dhe të rikthimit të ndërtimit të organeve të njeriut të vdekur, pasi është shpërbërë dhe është dekompozuar në dhè. Nga ana tjetër, në mundësinë e ekzistencës së atij që mund të shikojë të gjitha veprat e robve që kanë vepruar në fshehtësi dhe në dukje, të jashtme dhe të brendshme, për këtë All'llahu i Madhëruar në vazhdimësi të ajetit thotë: **"Atij nuk mund t'i fshihet asnjë grimë as në qiej, as në Tokë e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe se ajo, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë."**.[1]

Për këtë, shpërbërja e atomeve të trupit të njeriut në dhè nuk i fshihet dijes së All'llahut, as përzierja e tyre me krijesat e tjera, madje as hyrja e tyre në trupat e njerëzve të tjerë nëpërmjet ushqimit. Kjo nuk përbën asnjë problem për rikthimin dhe ndërtimin e tij rishtazi. Veprat e tyre në dynja mbeten të ruajtura, edhe nëse ndryshon paraqitja e tyre, pasi All'llahu i Madhëruar i ka përfshirë në diturinë e Tij absolute.

E njëjta shprehje përmendet në ajetin e tretë dhe të katërt të sures "Kaf": **"'Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur** (do të

1 Fjala *"ja'zebu"* rrjedh nga fjala *"uzubun"*. Kuptimi i saj është: i larguari në kërkimin e mbrojtjes nga familja e tij. Thuhet "*azebe, ja'zubu* dhe *ja'zibu*". Pastaj u tha për çdo të munguar; thuhet burrë beqar dhe grua beqare, kur i mungon bashkëshorti, bashkëshortja.

ringjallemi sërish)**? Ai kthim është i largët!' Ne e dimë sa prej tyre i merr toka, tek Ne është Libri që i ruan të gjitha."**.

Çfarë kuptohet me sifjalinë: **"Libri që i ruan të gjitha."**?

Pjesa më e madhe e komentuesve ka thënë se kjo sifjali nënkupton "pllakën e ruajtur" *(El Leuhul Mahfudh)*. Nga këtu lind pyetja: Çfarë është pllaka e ruajtur?!

Siç e kemi përmendur më parë, komenti më i përafërt (i pllakës së ruajtur) është "pllaka e diturisë së pafundme të All'llahut". Në atë pllakë është shkruar dhe është vulosur çdo gjë, pa gjetur asnjë ndryshim apo zëvendësim.

Bota e pranishme me te gjitha skajet është një reflektim tjetër për atë pllakë të ruajtur. Duke patur parasysh se të gjitha atomet e ekzistencës sonë, të gjitha fjalët dhe veprat tona, mbeten të ruajtura në të, edhe nëse dukuritë ndryshojnë. Ato nuk dalin kurrë nga kufijtë e tyre.

Pastaj All'llahu i Lartësuar, në ajetet 4-5, bën të qartë qëllimin e bërjes së Kiametit. E thënë me një mënyrë tjetër të shprehuri: Jep argumente për domosdoshmërinë e asaj bote, pas botës sonë aktuale, për ata që e mohojnë Kiametin. Ai thotë: **"**(Kiameti do t'ju vijë) **me qëllim që Ai të shpërblejë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Për njerëz të tillë do të ketë falje dhe begati të mrekullueshme."**.

Nëse besimtarët nuk e marrin shpërblimin e veprave të tyre të mira, a nuk do të thotë kjo prishje e rrënjës së drejtësisë, e cila është një nga themelet më të rëndësishme të themeleve të krijesave? A mbetet ndonjë kuptim për drejtësinë e All'llahut pa

këtë nocion? Në kohën kur ne shikojmë se shumica e këtyre njerëzve të mirë nuk e marrin kurrë shpërblimin e punëve të tyre të mira në këtë botë, atëherë është e padiskutueshme ekzistenca e një bote tjetër, që të vërtetohet kjo gjë.

Paraprirja e fjalës **"falje"** ndaj togfjalëshit **"begati të mrekullueshme"** është bërë për të qetësuar zemrat e besimtarëve. Frika më e madhe e besimtarëve janë gjynahet që kanë bërë, prandaj edhe ajeti i qetëson ata, duke paraqitur më parë faljen.

Përveç kësaj, kush nuk lahet me ujin e faljes hyjnore, nuk do të jetë i mirëpritur për begati të mrekullueshme dhe pozitë të nderuar.

Togfjalëshi **"begati të mrekullueshme"** përfshin të gjitha furnizimet me vlerë. Nocioni i tij është aq i gjerë, sa i përfshin të gjitha dhuratat hyjnore. Ka dhurata, që syri kurrë nuk i ka parë, veshi kurrë nuk i ka dëgjuar dhe askush nuk i ka ndjer kurrë me zemër.

Me një shprehje tjetër: Në këtë togfjalësh është bashkuar Xhenneti, me të gjitha mirësitë e tij shpirtërore dhe materiale. Disa komentues, fjalën *"el kerim"*, e kanë komentuar me dy variante: e mirë dhe e pastër nga e keqja. Por duket se nocioni i fjalës është shumë herë më i gjerë se sa kaq.[1]

Ajeti 5, duke bërë të qartë një lloj tjetër të drejtësisë, në lidhje me dënimin e gjynahqarëve dhe të kriminelëve, thotë: **"Ndërsa për ata që luftojnë kundër Shpalljeve Tona, duke u përpjekur që t'i pengojnë ato, do të ketë dënim të tmerrshëm dhe të dhembshëm."**.

1 Tefsiri "Ruhul Meanij", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Ata përgënjeshtruan argumentet Tona, u përpoqën t'i mohojnë ato, duke menduar se mund të çlirohen nga rrethi i fuqisë Sonë.

Pra, në ajetin 4 flitej për **"begati të mrekullueshme"**, kurse në këtë ajet për **"dënim të tmerrshëm dhe të dhembshëm"**.

Kuptimi i rrënjës se fjalës *"err rrixhzu"* është: shqetësimi dhe mungesa e fuqisë, përpjekja për të ruajtur ekuilibrin. Në fillim është përdorur për kafshën, p.sh: deveja është "e lodhur", nëse hapat e saj përplasen me njëra-tjetrën dhe pengohet. Nga pafuqia e saj detyrohet të zvogëlojë hapat e saj, për të ruajtur ekuilibrin.

Pastaj fjala është përdorur për çdo gjynah dhe punë të shëmtuar. Përdorimi i fjalës *"err rrexhezu"* për fragmentet poetike të veçanta, për zbritjen në luftë, është në kuptimin e shkurtimit të shprehjeve dhe përngjasimit të tyre.

Si do që të jetë, ajo që synohet me fjalën *"err rrixhzu"*, në këtë ajet, është theksimi i një nga llojeve më të këqija të dënimeve. Kjo përforcohet më shumë me ardhjen e fjalës *"el elijmu"* - *"i dhimbshëm"* pas kësaj fjale, e cila vërteton llojet e dënimeve trupore dhe shpirtërore të dhimbshme.

Disa kanë thënë se Kur'ani Famëlartë, kur ka përmendur mirësitë e banorëve të Xhennetit, nuk e ka përdorur fjalën *"min"*, për të treguar hapësirën e gjerë të saj. Kjo fjalë është përdorur, kur përmendet dënimi. Arsyeja e përmendjes është theksimi i kufizimit të tij, si dhe për t'u bërë e qartë mëshira e All'llahut të Madhëruar.

Fjala *"seau"* rrjedh nga fjala *"es sa'ju"*. Kuptimi i saj është: mund dhe përpjekje për një çështje. Ajo që nënkuptohet prej saj këtu, është mundi dhe përpjekja në përgënjeshtrimin dhe mohimin e argumenteve të së vërtetës dhe ndalimin e njerëzve për të shkuar drejt Rrugës së All'llahut të Madhëruar.

Fjala *"muaaxhizine"* rrjedh nga fjala *"el muaxhezetu"*. Kuptimi i saj është: i paaftë, domethënë i demoralizuar. Në kuptime të tilla, përdoret për atë që largohet nga një person tjetër, që nuk ia mundëson atij ta kontrollojë atë.

Ky përshkrim përdoret për kriminelët, për imagjinatën e tyre, që e shfaqin atë me vepra. Puna e tyre i ngjason shumë atij që mendon se mund të bëjë çdo lloj krimi që të dojë, pastaj mund të largohet nga autoriteti i fuqisë së All'llahut të Madhëruar!!

Ajetet 6 – 9

﴿وَيَرَى الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ الَّذِى أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ هُوَ الْحَقَّ وَيَهْدِى إِلَى صِرَاطِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ٦ وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا هَلْ نَدُلُّكُمْ عَلَى رَجُلٍ يُنَبِّئُكُمْ إِذَا مُزِّقْتُمْ كُلَّ مُمَزَّقٍ إِنَّكُمْ لَفِى خَلْقٍ جَدِيدٍ٧ أَفْتَرَى عَلَى اللَّهِ كَذِبًا أَمْ بِهِ جِنَّةٌ بَلِ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ فِى الْعَذَابِ وَالضَّلَالِ الْبَعِيدِ٨ أَفَلَمْ يَرَوْا إِلَى مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ إِنْ نَشَأْ نَخْسِفْ بِهِمُ الْأَرْضَ أَوْ نُسْقِطْ عَلَيْهِمْ كِسَفًا مِنَ السَّمَاءِ إِنَّ فِى ذَلِكَ لَآيَةً لِكُلِّ عَبْدٍ مُنِيبٍ٩﴾

“Ata, të cilëve u është dhënë dituria, e shohin se ajo, që të është zbritur ty nga Zoti yt, është e vërteta, e cila të udhëzon në Rrugën e të Plotfuqishmit dhe të Denjit për çdo lavd.”

“Ndërsa jobesimtarët thonë: ‘A doni t’ju tregojmë një njeri që pretendon se, kur të shpërbëheni plotësisht e të bëheni pluhur, ju, me siguri do të rikrijoheni nga e para?’”

“’A po trillon gënjeshtra për All’llahun apo është i çmendur?’ (Nuk është kështu)**, por ata që nuk besojnë në Jetën Ttjetër, do të dënohen dhe janë në humbje të madhe.”**

"Vallë, a nuk shohin ata çfarë ka para tyre e pas tyre në qiell dhe në Tokë? Sikur të donim, Ne do t'i fundosnim ata në tokë ose do të hidhnim mbi ta copa nga qielli. Me të vërtetë, në këtë ka shenjë për çdo rob që kthehet tek All'llahu me pendesë."

Komentimi

Dijetarët e mendojnë thirrjen tënde se ajo është e vërtetë

Në ajetet e mëparshme është folur për shikimet e verbra dhe të hutuara. U fol për të gjithë ata që e mohuan Kiametin, pavarësisht argumenteve të prera. Ata u përpoqën të përgënjeshtrojnë argumentet hyjnore, duke çuar në humbje të tjerët.

Në bazë të kësaj, ajetet që po komentojmë, flasin për dijetarët dhe mendimtarët, që u besuan argumenteve të All'llahut. Ata u përpoqën t'i nxitin të tjerët që t'i besojnë ato. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ata, të cilëve u është dhënë dituria, e shohin se ajo, që të është zbritur ty nga Zoti yt, është e vërteta, e cila të udhëzon në Rrugën e të Plotfuqishmit dhe të Denjit për çdo lavd."**.

Disa komentues, sifjalinë: **"të cilëve u është dhënë dituria"**, e kanë komentuar duke theksuar se u drejtohet

dijetarëve të ithtarëve të Librit, të cilët e pranojnë të vërtetën, kur shikojnë gjurmët e vërtetësisë së Kur'anit Famëlartë.

Nuk ka ndonjë pengesë që ajeti t'u jetë drejtuar dijetarëve të ithtarëve të Librit, por përcaktimi i tyre me ta nuk ka argument. Madje, duke parë foljen e kohës së tashme *"jera"* dhe kuptimit të saj të gjerë të fjalisë: **"të cilëve u është dhënë dituria"**, bëhet e qartë se ajeti përfshin të gjithë dijetarët dhe mendimtarët, në çdo kohë dhe vend.

Nëse komentohet se kjo sifjali i drejtohet Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, ashtu siç thuhet në tefsirin e Ali ibn Ibrahimit, ky mendim është i drejtë, pasi qartëson dhe tregon një prej kuptimeve më të plota e më të sakta të ajetit.

Sigurisht, cilido dijetar i logjikshëm dhe jo fanatik, nëse e shikon me kujdes atë çka është përmendur në këtë Libër qiellor dhe reflekton në njohuritë e tij të thella, te këshillat e tij të mençura, te qortimet e tij, te tregimet e tij historike, që rrezatojnë mësim, te kërkimet e tij të mrekullive shkencore, atëherë do ta kuptojë se të gjitha ato janë një argument i vërtetësisë së këtyre argumenteve.

Sot ka larmi librash, që i kanë shkruar mendimtarët perëndimorë dhe lindorë rreth Islamit dhe Kur'anit, që përmbajnë njohuri të dukshme për madhështinë e Islamit dhe vërtetësinë e ajetit që po komentojmë.

Grupi foljor: **"është e vërteta"**, është një shprehje e përgjithshme që përputhet me të gjithë përmbajtjen e Kur'anit Famëlartë. E vërteta është ai realitet i prekshëm dhe ekzistencë e

jashtme. Kjo do të thotë se përmbajtja e Kur'anit përshtatet dhe harmonizohet me ligjet e krijimit, të vërtetat e ekzistencës dhe të botës njerëzore.

Për shkak të kësaj cilësie, ai udhëzon në Rrugën e All'llahut. All'llahu, i Fuqishmi dhe i Falënderuari, meriton të gjitha falënderimet dhe lavdërimet, sepse fuqia e Tij është maja e fuqisë dhe e triumfit. Ai nuk është si njerëzit e fuqishëm, që sillen dhunshëm, padrejtësisht dhe shpërdorojnë pushtetin që u është dhënë.

Është e njëjta shprehje me ajetin e parë të sures "Ibrahim": **"Këtë Libër ta kemi shpallur ty** (o Muhammed)**, për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në Rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd."**.

Është e qartë se kush është i aftë dhe meditues për falënderim dhe lavdërim dhe kush është i ditur dhe i mirinformuar, i mëshirshëm dhe i dhimbshëm, kush është i padiskutueshmi që rruga e tij të jetë qetësi, pasi kush e zgjedh Rrugën e Tij, afrohet me burimin e forcës dhe me të gjitha cilësitë e falënderuara.

All'llahu i Madhëruar kthehet te çështja e Kiametit dhe e Ringjalljes në ajetin 7 dhe plotëson diskutimet e mëparshme me një formë tjetër: **"Ndërsa jobesimtarët thonë: 'A doni t'ju tregojmë një njeri që pretendon se, kur të shpërbëheni plotësisht e të bëheni pluhur, ju, me siguri do të rikrijoheni nga e para?'"**.

Duket se këmbëngulja e jobesimtarëve, në mohimin e çështjes se Kiametit mbështetet në dy gjëra:

E para: Imagjinata e tyre se Kiameti, për të cilën ka folur i Dërguari i Islamit, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është Kiameti trupor, është një çështje që e lehtëson problemin dhe përfoljen ndaj tij. Kështu që ata kanë mundësi të largojnë njerëzit prej tij dhe ta mohojnë Kiametin me lehtësi.

E dyta: Besimi në Kiamet, apo edhe supozimi për ndodhinë e tij, e ngarkon njeriun me përgjegjësi dhe premtime. E vë atë ballë për ballë me të vërtetën. Kjo është ajo që kokat e mohimit e kanë konsideruar atë një rrezik të vërtetë, prandaj kanë ngulur këmbë në anulimin e mendimit të Kiametit dhe të shpërblimit të Ahiretit për veprat e njerëzve. Ata kanë thënë se si mund të bashkohen këto kocka të copëtuara, këto atome të kalbëzuara, të cilat era i shpërndan në çdo anë, dhe të veshin sërish rrobat e jetës?

Përdorimi i fjalës *"rexhulun" - "një njeri"*, në trajtë të pashquar nga ana e tyre për të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* synon përbuzjen e tij (Zoti na ruajtë!).

Mirëpo atyre u shpëtoi se ne, në fillimin e krijimit, nuk kemi qenë vetëm se disa pjesë të dekompozuara, pasi çdo pikë uji në trupat tanë ishte vetëm një pikë uji në një cep të detit apo një burimi uji dhe çdo atom prej lëndëve të trupave tanë ishte në një anë të tokës së gjerë. All'llahu i Madhëruar i bashkoi ato në fund, ashtu siç i bashkoi ato në fillim. All'llahu është i aftë për çdo gjë.

E çuditshme është se ata e konsideruan atë një argument për gënjeshtrën e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe fjalët e tij i quajtën pjesë e çmendurisë së tij: **"A po trillon gënjeshtra për All'llahun apo është i çmendur?"**. Nëse jo, si është e mundur që një njeri me logjikë apo i sinqertë, të flasë në këtë mënyrë?!

Mirëpo Kur'ani u përgjigjet atyre në mënyrë të prerë: **"**(Nuk është kështu)**, por ata që nuk besojnë në Jetën Tjetër, do të dënohen dhe janë në humbje të madhe."**.

Pra, cila humbje është më e qartë se sa sytë e këtij mohuesi të Kiametit, të shikojë një shembull të këtij Kiameti në botën e natyrës, të realitetit, çdo vit, me ringjalljen e tokës së vdekur me mbjelljet?

Sikur të mos ekzistonte Kiameti për jetën e kësaj bote, nuk do të kishte asnjë kuptim apo përmbajtje.

Së fundi, mohimi i Kiametit është baras me mohimin e fuqisë, të drejtësisë dhe të Urtësisë së All'llahut të Madhëruar.

Mirëpo, përse All'llahu i Lartësuar e përforcon se tani ata janë në dënim dhe humbje?

Kjo për shkak se njeriu, gjatë jetës së tij, përballet me probleme dhe ngjarje që pa besimin në Ahiret, nuk mund t'i përballojë ato. E vërteta është se, nëse jeta kufizohet me këto ditë të pakta të jetës së tokës, imagjinata e vdekjes, në lidhje me çdo njeri, do të ishte një presion i frikshëm. Nga ky shkak, shohim se mohuesit e Kiametit janë në frikë të përhershme, të shqetësuar dhe në dënim të dhimbshëm, kurse besimtarët, që e besojnë Kiametin, e konsiderojnë vdekjen si trampolinë në botën e përhershme dhe një mënyrë për thyerjen e zinxhirëve dhe çlirimin nga burgu i dynjasë.

Besimi në Kiamet e mbush zemrën e njeriut me qetësi dhe i lehtëson problemet. E bën atë më të fortë ndaj altruizmit, vetëmohimit dhe sakrificës.

Për sa u përket atyre që i mbërthen Kiameti, për shkak të injorancës dhe mosbesimit të tyre, duke treguar gënjeshtra dhe çmenduri, ata e burgosin veten e tyre në dënimin e verbër dhe humbjen e largët.

Një pjesë e komentuesve e kanë konsideruar këtë dënim, si dënim i Ahiretit, mirëpo fillimi i ajetit na argumenton se ata janë të burgosur të këtij dënimi dhe janë në humbje edhe tani, në këtë botë.

Pastaj Kur'ani Famëlartë paraqet një argument tjetër të Kiametit, i shoqëruar me kërcënimin e atyre që janë të pavëmendshëm dhe kokëfortë: **"Vallë, a nuk shohin ata çfarë ka para tyre e pas tyre në qiell dhe në Tokë?"**.

Pa dyshim se ky qiell i madh, me të gjitha mrekullitë e tij, me planetet që qëndrojnë në vend dhe ato që ecin, me sistemet që formojnë, po kështu edhe toka, me çuditë e saj dhe larminë e krijesave të gjalla, të begative dhe të dhuratave të saj, është argumenti më i qartë për fuqinë e Krijuesit Madhështor.

A është e mundur që Ai, i cili është i aftë për të gjitha këto çështje, të jetë i pafuqishëm ta rikthejë njeriun në jetë pas vdekjes së tij?

Ky është "argumenti i fuqisë", që Kur'ani Famëlartë e ka argumentuar në ajete të tjera, përballë mohuesve të Kiametit. Disa

prej këtyre ajeteve janë: ajeti 82 i sures "Jasin", ajeti 99 i sures "Isra" dhe ajetet 6-7 të sures "El Kaf".

Kjo fjali paraqet kërcënimin e atij grupi mendjengushtë, me zemër të zezë, të cilët ngulin këmbë për mos shikimin e të gjitha këtyre të vërtetave, prandaj edhe All'llahu i Madhëruar shton e thotë se e urdhëron tokën dhe ajo çahet me tronditje, dridhje të tmerrshme dhe i përpin ata. Apo e urdhëron qiellin dhe u qëllon atyre me copa guri, u shkatërron shtëpitë dhe i shfaros ata: **"Sikur të donim, Ne do t'i fundosnim ata në tokë ose do të hidhnim mbi ta copa nga qielli."**.

Nuk ka asnjë dyshim se në këtë çështje ka argumente të qarta për fuqinë e All'llahut të Lartësuar mbi çdo gjë. Mirëpo, me kuptimin e saj, veçohet çdo njeri që mediton në përfundimin e tij dhe nxiton të kthehet drejt All'llahut: **"Me të vërtetë, në këtë ka shenjë për çdo rob që kthehet tek All'llahu me pendesë."**.

Secili prej nesh ka dëgjuar apo ka parë fakte nga tërmetet, apo nga rënia e meteorëve nga qielli, apo nga rrëzimi dhe rrokullisja e shkëmbinjve të maleve, për shkak të një vetëtime apo shpërthimi vullkani. Çdo njeri i mençur e kupton fuqinë e ndodhisë së çështjeve të tilla në çdo çast dhe në çdo vend të botës, pasi, nëse toka është e stabilizuar nën këmbët tona dhe qielli është i sigurt sipër kokave tona, kjo është për shkak se ato janë kështu nga një forcë tjetër dhe me një urdhër të Atij që urdhëron, atëherë, kur ne jemi të bindur për fuqinë e All'llahut të Lartësuar, në çdo cep të syrit, si mund të mohojmë fuqinë e Tij, për ringjalljen pas vdekjes, apo si mund të arratisemi nga autoriteti i qeverisë së Tij?!

Këtu duhet të kthejmë shikimin në disa çështje:

1- Kur'ani Famëlartë shprehet këtu për qiellin që është sipër nesh dhe për tokën që është nën këmbët tona, me sifjalinë: **"ka para tyre e pas tyre"**. Ky është kuptimi i vetëm që vihet re në shprehje të tilla.

Kjo shprehje mbase tregon se fuqia dhe madhështia e All'llahut është shfaqur në qiell, në kohën e lindjes dhe të perëndimit të diellit, në shfaqjen e hënës dhe yjeve në të. E dimë se, kush qëndron shpesh në drejtim të horizontit, e ka qiellin para tij, kurse për tokën, që vjen e dyta, për nga shkalla e rëndësisë, është përdorur fjala **"pas tyre"**.

Po kështu, kjo sifjali tregon ata kryeneçë, duke u thënë, se, nëse nuk ia lejojnë vetes shikimin sipër kokës së tyre, të paktën të shikojnë përpara tyre, në krah të horizontit.

2- Ne e dimë se jetojmë në mes dy burimeve të mëdha rreziku të jetës sonë.

I pari: Brendësia e zjarrtë e lëmshit të tokës, me gurët e shkrirë e të zjarrtë, gati të shpërthejnë. Jeta e të gjithë njerëzimit është sipër një grumbulli vullkanesh dhe, thjesht me dhënien e një urdhri të vogël hyjnor, vihet në lëvizje njëri nga këto vullkane që do të tronditë një zonë të madhe të tokës dhe do të derdhë mbi të gurët e zjarrtë dhe llavën përvëluese.

I dyti: Qindra, mijëra gurë të vegjël e të mëdhenj që notojnë në hapësirën e jashtme të atmosferës, çdo ditë tërhiqen nga toka, nga forca e gravitetit të saj. Sikur ato të mos digjeshin, si rezultat i përplasjes së tyre me shtresën e gaztë, do të ishim në

mënyrë të vazhdueshme, natë e ditë, objektivi i "shiut meteor". Ndonjëherë, përmasat e tyre, shpejtësia dhe forca e tyre shkon deri aty sa e kapërcejnë këtë pengesë në drejtim të tokës, që të përplasen me të. Kjo është një nga rreziqet qiellore. Është detyrë e All'llahut që t'i sigurojë këto forca. Nëse ne jetojmë në mes të këtyre dy burimeve të tmerrshme rreziku, a nuk mjafton ajo që të drejtohemi drejt madhështisë së fuqisë së All'llahut të Lartësuar dhe të bimë në sexhde, duke e madhëruar dhe duke e adhuruar Atë?!

3- Ajo që meriton vëmendje, është se ajeti 9 ka treguar se: **"në këtë ka shenjë"**. Por ajeti ka përcaktuar: **"për çdo rob që kthehet tek All'llahu me pendesë"**.

Ky tregues e mënjanon atë që vazhdon në kundërshti, i cili ka hequr nga qafa e tij rrethin e adhurimit të All'llahut të Madhëruar. Gjithashtu, tregon ata që janë të hutuar, që vazhdojnë të ecin në rrugën e gabuar, të ndotur me gabime. Ata kanë larguar nga mendja e tyre pendimin dhe kthimin e mendjes nga All'llahu.

Këta nuk mund të përfitojnë nga ky ajet fisnik, sepse ekzistenca e Diellit nuk mjafton për të arritur shikimin, përkundrazi është i domosdoshëm syri shikues, gjithashtu, duhet të largohet pengesa mes atyre të dyjave.

Ajetet 10 – 11

﴿وَلَقَدْ آتَيْنَا دَاوُودَ مِنَّا فَضْلًا يَا جِبَالُ أَوِّبِي مَعَهُ وَالطَّيْرَ وَأَلَنَّا لَهُ الْحَدِيدَ١٠ أَنِ اعْمَلْ سَابِغَاتٍ وَقَدِّرْ فِي السَّرْدِ وَاعْمَلُوا صَالِحًا إِنِّي بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ١١﴾

"Me të vërtetë, Ne i dhamë Daudit mirësi prej Nesh (dhe thamë)**: 'O male dhe zogj! Lavdërojeni emrin Tim bashkë me Daudin'. Ne ia zbutëm atij hekurin."**

"(Dhe i thamë)**: Puno parzmore të gjera! Thuri ato me maja të barazpeshuara dhe bëj vepra të mira! Pa dyshim, Unë shoh çfarë punoni ju."**

Komentimi

Dhuratat e mëdha të All'llahut për Daudin *(Paqja qoftë mbi të!)*

Në serinë e fundit të ajeteve të mëparshme, folëm për njeriun që kthen mendjen te Zoti dhe për shpërblimin që merr nga ky besim. Ky përshkrim është përmendur për Profetin Daud

(Paqja qoftë mbi të!), në ajetin 24 të sures "Sad". E mira është që të përmendim një anë nga jeta e këtij Profeti, si shembull për kthimin te All'llahu i Madhëruar, për pendimin dhe përuljen. Gjithashtu, jeta e këtij Profeti, i tërheq vëmendjen kujtdo që mohon mirësitë e All'llahut, që bën sikur i harron dhe zhvishet nga adhurimi i All'llahut, kur ulet mbi kolltukun e fuqisë dhe të autoritetit.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë nis: **"Ne i dhamë Daudit mirësi prej Nesh** (dhe thamë)**..."**.

Fjala *"fadlun"* ka një kuptim të gjerë dhe përfshin të gjitha dhuratat që All'llahu ia pati dhënë Daudit, duke i shtuar edhe maskimin, si shtesë. Ai ka treguar për madhështinë e atyre dhuratave.

Daudi *(Paqja qoftë mbi të!)* është përfshirë nga shumë dhurata të mëdha, si nga ana materiale, ashtu edhe nga ana shpirtërore. Kur'ani Famëlartë na i ka përmendur shpesh ato.

Në një ajet, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ne i dhamë Daudit dhe Sulejmanit dituri dhe ata thanë: 'Qoftë lavdëruar All'llahu që na ka ngritur mbi shumicën e robve të Tij besimtarë!'"**.[1]

Në një vend tjetër, me gjuhën e Daudit, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Sulejmani e trashëgoi Daudin** (në misionin e tij profetik) **dhe tha: 'O populli im! Neve na është mësuar gjuha**

1 Sure "En Neml", ajeti 15.

e shpendëve dhe na është dhënë gjithçka. Kjo është vërtet dhunti e madhe.'".[1]

Gjatë bisedës sonë, rreth fundit të këtyre ajeteve, do të përmendim mrekulli të ndryshme, që përfaqësojnë një pjesë të kësaj mirësie të madhe. Po kështu, do të përmendet edhe zëri brilant dhe forca e lartë e gjykimit dhe drejtësia, për të cilën është folur në suren "Sad".

Të gjitha këto përfaqësojnë një ngjyrë tjetër të asaj mirësie të All'llahut. Më e rëndësishmja se të gjitha ato, është profecia dhe mesazhi me të cilin u nderua Daudi *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Pas këtij treguesi të përgjithshëm, ajeti fillon me një shpjegim dhe një sqarim të anëve të mirësive shpirtërore dhe materiale me të cilat u kënaq Daudi. All'llahu i Madhëruar thotë: **"O male dhe zogj! Lavdërojeni emrin Tim bashkë me Daudin."**.

Fjala *"eu'uibi"*, rrjedh nga fjala *"et te'uibu"* dhe ka kuptimin: kthimi dhe rikthimi i zërit në fyt. Kjo rrënjë përdoret, gjithashtu, me kuptimin e "pendimit", sepse e vërteta e saj është rikthimi tek All'llahu.

Megjithatë të gjitha atomet e ekzistencës e përmendin dhe e madhërojnë All'llahun, njësoj si e madhëroi bashkë me to Daudi *(Paqja qoftë mbi të!)*. Arsyeja se pse është veçuar Daudi, është se ai, sapo ngrinte zërin e tij dhe fillonte të bënte tesbihate, i shfaqej çfarë ishte e padukshme dhe i mbuluar prej krijesave dhe murmuritjen e brendshme e zëvendësonte në një melodi të hapur, të harmonizuar, siç thuhet në transmetimet e tesbihateve të

1 Sure "En Neml", ajeti 16.

gurëve, në dorën e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur përmend historinë e Daudit *(Paqja qoftë mbi të!)*, thotë: *"Ai doli të lexojë Zeburin. Kur e lexonte Zeburin, nuk mbetej as mal, e as gur dhe as zog, vetëm se i përgjigjej atij."*.[1]

Pas përmendjes së kësaj mirësie shpirtërore, ajeti përmend një të mirë tjetër materiale: **"Ne ia zbutëm atij hekurin."**.

Mund të thuhet se All'llahu i Lartësuar ia mësoi Daudit *(Paqja qoftë mbi të!)*, duke ia bërë të lehtë, aq sa mundej me mundësinë e tij, zbutjen e hekurit, që ai të mund të përpunonte korpuset e petëzuara, për të modeluar armaturat e tij. Para Daudit përpunimi i hekurit, për ndërtimin e armaturave, ishte shumë i vështirë. Armatimi shkaktonte shqetësim dhe bezdi për luftëtarët, si rezultat i rëndesës së hekurit nga njëra anë dhe pamundësia e atyre armaturave për t'u përthyer dhe për t'u palosur, kur visheshin. Askush, deri në atë ditë, nuk kishte mundur t'i modelonte armaturat prej telave të fortë të hekurit, që të bëheshin rroba që visheshin me lehtësi, duke iu përshtatur formës dhe lëvizjes së trupit.[2]

Fillimi i ajetit tregon se zbutja e hekurit u bë për Daudin *(Paqja qoftë mbi të!)* me urdhrin e All'llahut, pasi çfarë e pengon atë që i jep furrës së zjarrit veçorinë e zbutjes së hekurit, që t'ia japë këtë veçori Daudit, me një formë tjetër. Disa transmetime e kanë treguar këtë kuptim.

1 Tefsiri "El Mijzan", vëll. 16, f. 390.
2 Shiko tefsirin e Burhanit, vëll. 3, f. 343 dhe tefsirin "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 315.

Nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* transmetohet: *"All'llahu e frymëzoi Daudin, duke i thënë se ishte robi më i mirë, vetëm se ushqehej nga thesarmbajtësja (Bejtul Mali). Daudi qau për dyzet mëngjese. All'llahu ia zbuti atij hekurin dhe çdo ditë ai bënte një parzmore dhe e shiste me njëmijë derhemë. Ai përpunoi treqind e gjashtëdhjetë parzmore, i shiti ato me treqind e gjashtëdhjetë mijë derhemë. Pas kësaj nuk kishte më nevojë për thesarin."*.[1]

Është e vërtetë se thesari siguron shpenzimet e njerëzve, të cilët japin shërbim falas për popullin dhe kalojnë ngarkesa që nuk i kalon kush veç tyre. Sa e mrekullueshme është, që njeriu të mund ta ofrojë këtë shërbim dhe ta sigurojë jetesën e tij, nga puna e duarve të tij. Daudi *(Paqja qoftë mbi të!)* dëshiroi që të ishte njeri i shkëlqyer.

Daudi *(Paqja qoftë mbi të!)* e drejtoi këtë fuqi, të cilën ia dhuroi All'llahu në mënyrën më të mirë, që ishte prodhimi i mjeteve të luftës dhe mbrojtja nga armiku. Nuk u përpoq të përfitojë prej saj, në prodhimin e mjeteve të zakonshme të jetës. Për më tepër, duke përfituar nga të ardhurat, në shpenzimin e çështjeve të jetesës së thjeshtë të jetës së tij, ai përgatiti një pjesë prej të ardhurave, që ta shpenzonte për ata që kishin nevojë.[2][3]

Mbi të gjitha, vetë puna e tij ishte një mrekulli, që u lidh me të.

Disa komentues kanë thënë se Lukmani erdhi te Daudi, kur ai bëri armaturën e parë. E bëri atë të mendonte në të. Nuk e dinte se çfarë donte dhe nuk e pyeti atë, derisa e përfundoi armaturën. Pastaj u çua në këmbë, e veshi atë dhe tha se kjo ishte

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 381, fundi i ajetit është burimi i komentimit.
2 Shih tefsirin "Ruhul Xhinan", vëll. 9, f. 192.

mburoja e luftës. Lukmani tha: *"Heshtja është urtësiri, por pak e veprojnë atë."*.[1]

Ajeti 11 na paraqet shpjegimin e përpunimit të armaturave të Daudit dhe urdhrin hyjnor, me kuptim të thellë: **"Puno parzmore të gjera! Thuri ato me maja të baraspeshuara."**.

Fjala *"es sabigatu"* është shumësi i fjalës *"sabigun"*. Kuptimi është: këmisha e plotë, e gjerë. Edhe fjala *"isbagu ni'meti"*, gjithashtu, është me kuptimin e zgjerimit të tij.

Kuptimi i rrënjës së fjalës *"serdun"* është: qepja e asaj që është e fortë dhe e ashpër, si modelimi i këmishës së luftës. Shpimi, çarja e lëkurës, është marrë hua për rregullimin e hekurit.

Kuptimi i sifjalisë: **"Thuri ato me maja të baraspeshuara"**, është: ruajtja e harmonizuar e pjesëve të armaturës dhe mënyra e saktë e modelimit të saj.

All'llahu i Madhëruar e urdhëroi Daudin *(Paqja qoftë mbi të!)* që të jetë shembull që të imitohet nga të gjithë artizanët dhe punëtorët besimtarë në botë, duke u kujdesur për saktësinë në punë, si nga sasia, ashtu edhe nga mënyra e prodhimit. Si rrjedhojë, ata që do ta përdorin atë, të mund ta përdorin me lehtësi dhe në një mënyrë të mirë dhe të dobishme.

All'llahu i Madhëruar i thotë Daudit që t'i bëjë armaturat të gjera dhe të rehatshme, që të mos jenë si burg për luftëtarin, kur ai ta veshë atë. Të mos i bëjë ndarjet e saj të vogla dhe të ngushta, më shumë seç duhet, sepse e humbin veçorinë e elasticitetit dhe të

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 382, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

përdredhjes, si dhe as të mëdha, aq sa ta kalojnë kufirin e shpatës, kamës dhe majën e shigjetës, pasi çdo gjë duhet të jetë brenda standardit të përcaktuar dhe në harmoni.

Përmbledhja është: All'llahu i Madhëruar ia përcaktoi Daudit "lëndën", sipas: **"Ne ia zbutëm atij hekurin."**.

Po kështu, e mësoi atë si ta shndërrojë dhe ta përpunojë atë, derisa produkti të jetë i plotë me bashkimin e lëndës dhe të formës.

Më pas ajeti mbyllet duke i folur Daudit dhe familjarëve të tij: **"Bëj vepra të mira! Pa dyshim, Unë shoh çfarë punoni ju."**.

Vihet re se adresimi në fillim të ajetit ishte vetëm për Daudin *(Paqja qoftë mbi të!)*, kurse në fund të ajetit, biseda përfshin Daudin dhe familjarët e shtëpisë së tij, ose Daudin dhe popullin e tij. Ky kalim në numrin shumës bëhet, sepse këto çështje paraprijnë veprën e mirë, pasi objektivi nuk është përpunimi i armaturave dhe realizimi i përfitimeve, përkundrazi, e gjitha kjo, është një mënyrë në rrugën drejt punës së mirë, që të përfitojë edhe Daudi, edhe familjarët e tij. Një nga veçoritë e veprës së mirë, është ruajtja e saktësisë në të gjitha anët dhe paraqitja e një rezultati të plotë, të dobishëm, pa asnjë mangësi.

Biseda mund t'i adresohet Daudit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe të gjithë atyre që përfitojnë nga mundi dhe prodhimet e tij, duke treguar se ky mjet mbrojtës duhet të përdoret në rrugën e veprës së mirë dhe jo në rrugën e mëkateve, të mizorisë e të padrejtësisë.

Ajetet 12 – 14

﴿وَلِسُلَيْمَانَ الرِّيحَ غُدُوُّهَا شَهْرٌ وَرَوَاحُهَا شَهْرٌ ۚ وَأَسَلْنَا لَهُ عَيْنَ الْقِطْرِ ۖ وَمِنَ الْجِنِّ مَنْ يَعْمَلُ بَيْنَ يَدَيْهِ بِإِذْنِ رَبِّهِ ۖ وَمَنْ يَزِغْ مِنْهُمْ عَنْ أَمْرِنَا نُذِقْهُ مِنْ عَذَابِ السَّعِيرِ ١٢ يَعْمَلُونَ لَهُ مَا يَشَاءُ مِنْ مَحَارِيبَ وَتَمَاثِيلَ وَجِفَانٍ كَالْجَوَابِ وَقُدُورٍ رَاسِيَاتٍ ۚ اعْمَلُوا آلَ دَاوُودَ شُكْرًا ۚ وَقَلِيلٌ مِنْ عِبَادِيَ الشَّكُورُ ١٣ فَلَمَّا قَضَيْنَا عَلَيْهِ الْمَوْتَ مَا دَلَّهُمْ عَلَىٰ مَوْتِهِ إِلَّا دَابَّةُ الْأَرْضِ تَأْكُلُ مِنْسَأَتَهُ ۖ فَلَمَّا خَرَّ تَبَيَّنَتِ الْجِنُّ أَنْ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ الْغَيْبَ مَا لَبِثُوا فِي الْعَذَابِ الْمُهِينِ ١٤﴾

"Sulejmanit Ne ia nënshtruam erën, me të cilën udhëtimin e një muaji ai e bënte brenda një paraditeje ose një pasditeje. Ne i dhamë atij një burim të rrjedhshëm bakri të shkrirë dhe xhindë që i bëmë të punonin para syve të tij, me urdhrin e Zotit të tij. Këdo prej tyre që largohet nga urdhri Ynë, do ta bëjmë që të shijojë dënimin e Zjarrit."

"Ata punonin për atë çfarë të dëshironte: faltore dhe statuja, enë të gjera si puse dhe kazanë të mëdhenj të palëvizshëm. 'O familje e Daudit! Bëni falënderim (për All'llahun)**!' Megjithatë, pak nga robtë e Mi, janë falënderues."**

“Kur Ne ia caktuam atij vdekjen, atyre nuk u dha shenjë askush për vdekjen e tij, pos krimbit të drurit. Dhe, kur u rrëzua (Sulejmani)**, u bë e qartë se, sikur ta dinin xhindët të padukshmen, nuk do të vijonin në dënimin e poshtëruar.”**

Komentimi

Madhështia e Sulejmanit dhe vdekja e tij, është leksion që duhet të merret në konsideratë

Pas bisedës për dhuratat që All’llahu ia dha Daudit *(Paqja qoftë mbi të!)*, ajetet zhvendosen për të folur për djalin e tij, Sulejmanin *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ajetet e mëparshme na treguan për dy dhuratat e veçanta të Daudit. Këto ajete na tregojnë për tri dhurata të mëdha për djalin e tij, Sulejmanin *(Paqja qoftë mbi të!)*. All’llahu i Madhërishëm, thotë: **“Sulejmanit Ne ia nënshtruam erën, me të cilën udhëtimin e një muaji ai e bënte brenda një paradite ose një pasdite.”**.[1]

Ajo që tërheq vëmendjen këtu është se All’llahu i Madhëruar, kur ia nënshtroi babait një trup shumë të fortë, të pathyeshëm, siç është hekuri, shohim se Ai ia nënshtroi të birit një krijesë shumë më të butë. Të dyja punët ishin të dobishme dhe të mrekullueshme, një trup i fuqishëm, i shkathët për Daudin dhe

1 Disa komentues besojnë se shkronja *“lam”* tek togfjalëshi *“li Sulejmane”* është për specifikim, dhe tregon se mrekullia me të cilën u specifikua Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk e shoqëron në të asnjë Pejgamber tjetër.

dallgët e ëmbla të ajrit, që i bëjnë të kontrollueshme dhe aktive për Sulejmanin.

Butësia e erës nuk e pengon atë të kryejë punë të rëndësishme, pasi ka erëra që lëvizin anijet e mëdha mbi sipërfaqen e oqeaneve. Ka erëra që vënë në lëvizje gurët e rëndë të mullinjve me erë, ka prej tyre që i ngrenë lart në qiell balonat dhe i lëvizin ato si zogjtë. Sigurisht, kjo erë, me këtë fuqi pozitive, iu nënshtrua Sulejmanit.

Mirëpo si e bart era karrigen e Sulejmanit, (qoftë karrige apo qilim)? Kjo nuk është e qartë për ne dhe masa e vërtetë është se asgjë nuk mund ta përfaqësojë një problem apo rrugë maloreje para fuqisë së All'llahut, pasi njeriu, me fuqinë e tij, të nënçmuar para fuqisë së All'llahut, ka mundur të vërë në lëvizje balonat dhe avionët, që bartin qindra e mijëra udhëtarë dhe ngarkesa të tjera në kupën e qiellit. Po a është e mundur të përbëjë problemin më të vogël për Krijuesin, kur fuqia e Tij ka kapërcyer çdo gjë, të lëvizë qilimin e Sulejmanit nëpërmjet erës?!

Cilët janë ata faktorë që e ruajnë Sulejmanin dhe mjetin e tij transportues nga rënia apo nga presioni i ajrit dhe nga problemet e tjera që lindin nga lëvizja në ajër? Edhe kjo, gjithashtu, është nga çështjet, që është mbajtur e fshehtë. Ajo që ne dimë, është se kronologjia e historisë së Profetëve është e mbushur me mrekulli të zakonshme, të cilat, me keqardhje, e ka përzier rezultatin e përpjekjeve të disa injorantëve apo të armiqve të diturisë, me trillime, derisa është bërë fotografia e vërtetë e këtyre çështjeve

kaotike dhe të shëmtuara. Ne jemi të bindur me këtë veçori, me masën që është treguar në Kur'anin Famëlartë.[1]

Kuptimi i fjalës *"guduvun"* është: mëngjesi i ditës. Përballë kësaj fjale, është fjala *"err rrevahu"*, kuptimi i të cilës është: perëndimi i ditës. Kjo fjalë përdoret edhe për kafshët, kur kthehen në banesat e tyre në fund të ditës për të pushuar. Prej kontekstit të ajetit që po komentojmë, duket se fjala *"el guduvu"*, këtu është me kuptimin e gjysmës së parë të ditës, kurse fjala *"err rrevahu"*, tregon gjysmën tjetër të saj. Kjo supozohet edhe për kuptimin e ajetit, se Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)* e shkurton vlerën e kohës nga mëngjesi në drekë, me mjetin e tij udhëtues, që është baras me largësinë që bënin udhëtarët në atë kohë me një muaj të plotë. Kështu është edhe gjysma e dytë e ditës.

Ajeti më pas vazhdon me dhuratën e dytë që All'llahu e dalloi Sulejmanin *(Paqja qoftë mbi të!)*: **"Ne i dhamë atij një burim të rrjedhshëm bakri të shkrirë."**.

Fjala *"eselna"*, rrjedh nga fjala *"sijlanun"*, me kuptimin *"rrjedhje"*, kurse fjala *"el kitr"*, ka kuptimin e bakrit. Kuptimi është: All'llahu ia shkriu atij këtë metal dhe e bëri si burim uji. Disa kanë thënë se fjala *"el kitru"* do të thotë llojet e ndryshme të metaleve apo plumbi. Babait i është zbutur hekuri, kurse të birit i janë shkrirë të gjitha metalet. Por, më i njohur është kuptimi i parë i ajetit.

Si mund të jetë bakri apo metalet e tjera, si burim uji në duart e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*? A mos ndoshta All'llahu ia ka mësuar këtij Profeti mënyrën e shkrirjes së këtyre metaleve me

1 Kemi diskutuar në këtë kapitull, te fundi i ajetit 81, të sures "El Enbija".

përmasa të mëdha nëpërmjet mrekullisë? Apo ka bërë një burim nga ky metal i lëngshëm në dispozicion të tij, që i ngjason burimeve të vullkaneve gjatë kohës së aktivizimit të tyre, kur llava shpërthen prej tij nga të gjitha skajet e malit? Nuk është e qartë për ne. Ajo që ne dimë është: Kjo gjë ishte prej mirësive hyjnore, për këtë Profet gjigant.

Në fund, ajeti tregon dhuratën e tretë të All'llahut për Sulejmanin *(Paqja qoftë mbi të!)*), që është nënshtrimi i një grupi të madh xhindësh, për t'i shërbyer atij: **"E prej Xhindëve që i bëmë të punonin para syve të tij, me urdhrin e Zotit të tij. Këdo prej tyre që largohet nga urdhri Ynë, do ta bëjmë që të shijojë dënimin e Zjarrit."**.

Fjala *"el xhinnu"*, siç dihet edhe nga emri, është ajo krijesë e padukshme nga shqisat e njeriut. Ka mendje, fuqi, është i obliguar me detyrat e All'llahut, siç përfitohet kjo nga ajetet e Kur'anit.

Janë trilluar shumë përralla dhe tregime për xhindët. Sikur t'i fshinim ato, origjina e ekzistencës së tyre dhe e cilësive të veçanta të tyre, nga ato që përmenden në Kur'an, do të ishte një temë që nuk e kundërshton shkenca dhe logjika, në mënyrë absolute. Në dashtë All'llahu, në analizën e kësaj teme, do të përballemi më shumë te komentimi i sures "El Xhinn".

Nga shprehja e ajetit të mësipërm, përftohet se nënshtrimi i kësaj force të madhe ishte me urdhrin e All'llahut. Ata përballeshin me dënim për neglizhimin dhe moszbatimin e detyrave të tyre.

Disa komentues kanë thënë se ajo që synohet me grupin foljor: **"të shijojë dënimin e Zjarrit"**, është theksimi i dënimit të Ditës së Kiametit, kur, në dukje, ajeti na tregon se ai është dënimi në dynja.

Në ajetet 37-38 të sures "Sad" lexojmë se All'llahu ia nënshtroi Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* një grup xhindësh, për të kryer vepra të rëndësishme ndërtimi. Ata lidheshin me zinxhirë, me urdhrin e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur shfaqej ndonjë kundërshtim prej tyre: **"**(Gjithashtu ia nënshtruam) **edhe djajtë, ndërmjet të cilëve kishte ndërtues dhe zhytës në ujë, si dhe të tjerë të lidhur në pranga."**.

Meriton të theksohet se për drejtimin e një qeverie të madhe, një shteti shumë të shtrirë, si shteti i Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*, e bën të domosdoshme ekzistimin e shumë faktorëve. Po përmendim disa prej faktorëve që ka përmendur ajeti i mësipërm:

Faktori i parë: Pasja në dispozicion e mjetit të shpejtë të transportit, i gatshëm përherë, me qëllim që kryetari i qeverisë të mund të inspektojë të gjitha skajet e shtetit të tij nëpërmjet saj.

Faktori i dytë: Lëndët e para ishin në dispozicion të tij. Prej tyre ndërtoheshin veglat e nevojshme për jetën e njeriut.

Faktori i tretë: Forcë punëtore aktive. Kjo bën të mundur përdorimin e atyre lëndëve në një shkallë të madhe.

Shohim se All'llahu i Lartësuar ia ka caktuar Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* këto tri elemente. Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)*

mori prej tyre dobinë më të mirë për zhvillimin e njerëzve dhe të qyteteve, duke u dhënë siguri njerëzve të tij.

Kjo temë nuk është posaçërisht vetëm për kohën e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe qeverisjes së tij. Kthimi i shikimit nga ai dhe kujdesi që tregonte ai për të siguruar mjetet e domosdoshme të jetesës, jo vetëm për të sotmen, por edhe për të nesërmen, është për çdo vend, për hir të drejtimit të shteteve në mënyrë të drejtë.

Ajeti 13 tregon për një anë të rëndësishme të punëve prodhuese, të cilat i bënte grupi i xhindëve me urdhrin e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*: **"Ata punonin për atë çfarë të dëshironte: faltore dhe statuja, enë të gjera si puse dhe kazanë të mëdhenj të palëvizshëm."**.

Pra, çdo gjë që dëshironte Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)*: tempuj, skulptura, enë të mëdha për ushqim, të cilat ishin si rezervuare të mëdha dhe pjata të mëdha të palëvizshme, ata ia bënin, pasi një pjesë e tyre lidhet me çështjet shpirtërore dhe adhuruese, kurse të tjerat lidheshin me çështje trupore. Këto ishin në harmoni me numrin e madh të ushtrisë dhe punëtorëve të tij.

Fjala *"meharibu"* është shumësi i fjalës *"mihrabun"* dhe do të thotë *"vend i adhurimit"* apo *"kështjellat dhe ndërtesat e mëdha"* të cilat u ndërtuan si tempuj. Po kështu është thënë për ballin e këshillit. Kur u ndërtuan xhamitë, u quajt balli i këshillit.

Vendi i adhurimit të xhamisë është quajtur kështu, sepse ai është vendi i luftimit të shejtanit dhe pasionit.[1]

1 "El Mufredatu" i Ragib, lënda e (harebe).

Është quajtur kështu, sepse njeriu në të është i larguar nga punët e dynjasë dhe nga ato gjëra që e trazojnë mendjen.[1]

Këta punëtorë të shkathët i ndërtuan këta tempuj të mëdhenj e të bukur nën hijen e qeverisë së tij hyjnore, që njerëzit të kryejnë me lehtësi detyrat e tyre adhuruese.

Fjala *"temathil"* është shumësi i fjalës *"timthalun"*. Kuptimi i saj është: pikturë, fotografi dhe skulpturë. Janë përmendur shumë komentime rreth këtyre statujave. Çfarë krijesash kanë qenë ato që i ndërtuan? Përse Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)* urdhëroi për ndërtimin e tyre?

Mbase janë ndërtuar për të zbukuruar ndërtesat, siç e vëmë re atë në ndërtesat e rëndësishme antike.

Një hamendësim është se pikturimi i llojeve të ndryshme të kafshëve, si luani, simbolizonte madhështi dhe forcë në mendjet e njerëzve.

Lind pyetja: Në sheriatin e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*, a ishte i lejuar krijimi i statujave me shpirt, duke qenë se ato janë të ndaluara në sheriatin islam? Ndoshta statujat që ndërtoheshin, ishin pa shpirt prej gjallesave, si: pemët apo malet, dielli, hëna dhe yjet?

Apo sepse ato ishin thjesht figura dhe piktura në mure, siç vërehet në gjurmët antike, dhe ato nuk janë të ndaluara, ashtu siç është situata për ndalimin e statujave të trupëzuara.

1 Burimi i mësipërm.

Të gjitha këto hamendësime janë të mundshme, sepse ndalimi i prodhimit të skulpturave në Islam, kishte si qëllim luftimin e adhurimit të putave dhe shkuljen e tyre nga rrënjët. E kjo në kohën e Sulejmanit, nuk ishte në atë shkallë të domosdoshmërisë, prandaj në sheriatin e tij nuk ishte ndaluar.

Në një komentim të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* për këtë ajet, lexojmë: "*Për Zotin, ato nuk ishin statuja burrash apo grash, por ato ishin pemë dhe ngjashme me to.*".[1]

Duke u mbështetur në këtë transmetim, pa dyshim se bërja e statujave të atyre që kanë shpirt, në sheriatin e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte e ndaluar.

Fjala "*xhefan*", është shumësi i fjalës "*xhufnetun*" dhe ka kuptimin: "*ena e ushqimit*".

Fjala "*xhevabiju*", është shumësi i fjalës "*xhabijetun*" dhe ka kuptimin: "*rezervuar uji*".

Nga shprehja e përdorur në ajet, kuptojmë se këta punëtorë i ndërtuan Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* enë, kazanë shumë të mëdhenj ushqimi, saqë secili prej tyre dukej si rezervuar. Qëllimi i ndërtimit të këtyre kazanëve të mëdhenj ishte që të uleshin sa më shumë njerëz rreth tyre, për të konsumuar ushqim. Këto enë të përbashkëta, të mëdha për të ngrënë ushqim, janë përdorur deri vonë. Tavolina e tyre ishin ato enë të mëdha, të cilat nuk u ngjasojnë atyre që përdorim ne sot, enë të vogla e të veçanta.

1 "Uesailu Shijah", vëll. 12, f. 219-220, kreu 94, "ma juktesebu bihi?", Hadithi 1.

Fjala *"kudurun"*, është shumësi i fjalës *"kidrun"*, njësoj si fjala *"kishrun"*, me të njëjtin kuptim të tanishëm, domethënë, ena ku gatuhet në të ushqimi.

Fjala *"rasijatun"*, është shumësi i fjalës *"rasijetun"*, me kuptimin: *"të fiksuara"*. Enët e gatimit ishin aq të mëdha, sa ishte e pamundur që të lëvizeshin prej vendit ku ishin.

Pas përmendjes së dhuratave hyjnore te familja e Daudit, mbyllja e ajetit u flet atyre: **"O familje e Daudit! 'Bëni falënderim** (për All'llahun)**!' Megjithatë, pak nga robtë e Mi, janë falënderues."**.

"Falënderimi" për të cilin ka folur ajeti, nuk është vetëm falënderimi me gjuhë, por "falënderimi me vepra", domethënë përfitimi prej atyre dhuratave në rrugën e objektivave për të cilat janë krijuar. Është e padiskutueshme se ata që përfitojnë nga mirësitë e All'llahut, për të realizuar objektivat për të cilat janë krijuar, janë shumë të rrallë.

Disa dijetarë kanë thënë se falënderimi ka tri faza: falënderimi me zemër, duke menduar mirësinë, kënaqësinë dhe gëzimin me të; falënderimi me gjuhë, falënderim dhe lavdërim për Bamirësin; falënderimi me të gjitha pjesët e trupit, duke i zbatuar veprat me kërkesat e asaj mirësie.

Fjala *"shukurun"* është formë hiperbolike. Me të shprehet falënderimi i tepërt dhe vazhdimësia e saj me zemër, gjuhë dhe me organet e trupit.

Kjo cilësi përdoret ndonjëherë edhe për All'llahun e Madhëruar. Në ajetin 17 të sures "Et Tegabun" thuhet: **"Nëse i**

jepni All'llahut një hua të bukur, Ai jua kthen shumëfish atë dhe ju fal. All'llahu është Mirënjohës dhe nuk nxiton në dënime.".

All'llahu i Madhëruar i përfshin robtë e bindur të Tij me dhurata dhe mirësi. I falënderon ata dhe ua shton atyre më shumë seç meritojnë nga mirësia e Tij.

Fjalia: **"Pak nga robtë e Mi, janë falënderues."**, tregon nderimin e pozitës së këtij grupi shembullor. Mund të jetë edhe nxitje për ata që i dëgjojnë këto fjalë, që të jenë prej këtyre njerëzve dhe grupet e falënderuesve të shtohen.

Ajeti 14 është ajeti i fundit që flet për Profetin Sulejman *(Paqja qoftë mbi të!)*. All'llahu i Madhëruar na lajmëron ne për mënyrën e çuditshme të vdekjes së këtij Profeti dhe thirrësi. E sqaron shumë mirë vdekjen e këtij Profeti, që edhe pse kishte shumë fuqi e madhështi, nuk mundi të shtrihej në shtratin e qetë, kur e zuri vdekja. Shpirti i tij u nda me shumë lehtësi dhe shpejtësi nga trupi i tij.

All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kur Ne ia caktuam atij vdekjen, atyre nuk u dha shenjë askush për vdekjen e tij, pos krimbit të drurit."**.[1]

Nga mënyra e të shprehurit të ajetit dhe nga transmetime të shumta, të përmendura për komentimin e tij, mësohet se

1 Fjala *"mense'etehu"* rrjedh nga fjala *"nese'e"*. Kuptimi i saj është: vonesë në kohë. Disa komentues kanë thënë se kjo fjalë është nga fjalët e popullit të Jemenit. Meqë Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)* e ka qeverisur atë zonë, atëherë Kur'ani e ka përdorur atë kur ka folur për këtë Profet. Shiko "El Mufredat" i Ragib, Tefsirin e "Kurtubijut" dhe tefsirin "Ruhul Meanij".

Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)* ka qenë i mbështetur mbi shkopin e tij, kur i erdhi vdekja e papritur dhe shpirti u largua nga trupi i tij. Kufoma e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* mbeti për një kohë të gjatë në gjendjen e tij, derisa krimbat hëngrën shkopin e tij. Ekuilibri i tij u lëkund dhe u rrëzua në tokë, kështu që vdekja e tij u kuptua.

Ajeti më pas shton: **"Dhe, kur u rrëzua** (Sulejmani)**, u bë e qartë se, sikur ta dinin xhindët të padukshmen, nuk do të vijonin në dënimin e poshtëruar."**.

Fjala *"tebejjenet"* rrjedh nga fjala *"bejjene"* zakonisht me kuptimin *"ittedaha" - "u bë e qartë"*. Ajo është folje jokalimtare. Ndonjëherë vjen, gjithashtu, me kuptimin "dituria dhe informimi", folje kalimtare. Këtu harmonizohet gjendja me kuptimin e dytë, me kuptimin se xhindët nuk e dinin për vdekjen e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* deri në atë moment, pastaj e mësuan dhe e kuptuan. Sikur ata ta dinin të fshehtën, nuk do të qëndronin për aq shumë kohë në lodhje dhe dhimbje, për t'i kryer punët e rënda me të cilat ishin ngarkuar.

Një grup komentuesish e kanë marrë kuptimin e ajetit, me situatën e parë dhe kanë thënë se qëllimi i ajetit është: Pasi trupi i Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* ra në tokë, njerëzve iu bë e qartë e vërteta e xhindëve, se ata nuk dinë gjë nga e fshehta, se ishte i kotë besimi i një pjese se xhindët e dinin të fshehtën.

Togfjalëshi *"el adhabul muhinu" - "mundimi i rëndë"*, mund të tregojë punët shumë të rënda që Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)* i kishte vënë një grupi prej xhindëve, si një lloj ndëshkimi. Nuk ka

dyshim se Profeti i All'llahut nuk mund të vërë askënd kot në dënim. Nga sa duket, ai është një dënim poshtërues.

Hulumtime

1- Fragmente nga jeta e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*

Teurati i sotëm, përshkruan Sulejmanin si një nga sulltanët kolosë, gjigantë, ndërtues i tempujve të idhujve dhe magjepsës i grave.[1] E kundërta është te Kur'ani Famëlartë, i cili e vlerëson Sulejmanin *(Paqja qoftë mbi të!)* si një prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut, një model i qeverisjes dhe fuqi e pakrahasueshme.

Kur'ani Famëlartë i ka dhënë hapësirën e tij diskutimeve të ndryshme, lidhur me Sulejmanin *(Paqja qoftë mbi të!)*. Kemi lexuar në këto ajete të bekuara se All'llahu i Madhëruar i dha këtij të Dërguari të madh dhurata madhështore: mjete shumë të shpejta transporti, me të cilat mund të zhvendosej në mbretërinë e tij të shtrirë, në një hapësirë të shkurtër kohore, deri te lëndët e ndryshme e të shumta minerale, te forcat punëtore aktive, të mjaftueshme në përpunimin e atyre mineraleve.

Sulejmani *(Paqja qoftë mbi të!)* përfitoi nga dhuratat e përmendura, duke ndërtuar tempuj të mëdhenj dhe duke i nxitur njerëzit në adhurim. Po kështu, organizoi programe jo vetëm për shtimin e njerëzve në ushtrinë e tij dhe në ndërmarrjet e tij, por

1 "Teurati", Libri "El Mulukul Evvel", Pjesa 11-12.

edhe ne të gjithë mbretërinë e tij. Prej kohërave që kanë kaluar, ne mund të imagjinojmë më shumë se aq. Në këmbim të kësaj, All'llahu i kërkoi që të ishte falënderues për këto mirësi, duke e siguruar se ata që e bëjnë falënderimin, janë vetëm një grup shumë i vogël dhe i rrallë.

Pastaj bëhet e qartë se si një njeri, me gjithë këtë fuqi dhe madhështi, ishte i dobët para vdekjes, i paaftë dhe i pafuqishëm. Kaloi papritur dhe në një çast të vetëm nga kjo botë. Si mundet që exheli (afati i vdekjes) nuk i dha atij një shans, që të ulej apo të shtrihej në krevatin e tij? Kjo u bë për të treguar se kryeneçët dhe ata që kundërshtonin, të mos imagjinonin, se, kur të arrinin një pozitë apo post, janë bërë të fuqishëm. Fuqia e vërtetë, që ishin: xhindët, njerëzit dhe shejtanët i shërbenin atij. Ai udhëtonte në tokë dhe në qiell dhe e kishte kaluar kulmin e frikës dhe të modestisë. Pastaj në një çast të shkurtër, u nda nga kjo botë.

U bë e qartë se si është e mundur që një shkop i vogël, ka mbajtur kufomën e tij për shumë kohë dhe i ka bërë xhindët që të punonin shumë dhe me mund. Ata e shikonin, duke menduar trupin e tij në këmbë, ose ulur. Pastaj krimbat e rrëzuan atë mbi tokë dhe shteti, me të gjithë përgjegjësit e tij, u detyrua të binte. Një shkop i vogël mbajti në këmbë një shtet të madh, pastaj një krimb i vogël e pushoi së ekzistuari atë shtet.

E bukur është ajo që përmendet në transmetimin e Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Sulejmani, i biri i Daudit, urdhëroi xhindët që t'i ndërtonin një kube prej qelqi. Ai ishte i mbështetur mbi shkopin e tij në kube, duke parë xhindët se si e shikonin atë. Kur u kthye, pa një njeri afër tij në kube dhe e pyeti: 'Kush je ti?'* Ai iu përgjigj: *'Unë jam ai që nuk pranon ryshfet dhe nuk u bëj apel mbretërve, unë jam*

engjëlli i vdekjes.'. Ia mori shpirtin atij, kur ishte në këmbë, i mbështetur mbi shkopin e tij, në kube. Xhindët e shikonin atë dhe qëndruan një vit duke bërë punën e tyre, derisa All'llahu dërgoi një krimb të vogël dhe e brejti shkopin e tij. Kur u rrëzua në tokë, xhindëve iu bë e qartë se, sikur ta dinin të fshehtën, nuk do qëndronin kaq shumë në një mundim të rëndë.".[1]

Këtu duhet të përmendim se historia e Profetit Sulejman *(Paqja qoftë mbi të!)* si shumë prej historive të Profetëve, me keqardhje është përzier me transmetime të shumta të fabrikuara, me trillime që kanë deformuar figurën e këtij Profeti të madh. Pjesa më e madhe e këtyre trillimeve është nga Teurati i sotëm që qarkullon. Nëse ne bindemi plotësisht me atë që ka përmendur Kur'ani Famëlartë rreth këtij Profeti të madh, nuk do të përballemi me asnjë problem.

2- Përse u fsheh vdekja e Sulejmanit për një periudhë kohore?

Sa e gjatë ishte periudha kohore e vdekjes së fshehtë të Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* ndaj qeverisë së tij? A ishte një vit, një muaj, apo disa ditë? Komentuesit kanë mendime të ndryshme rreth kësaj teme. A ishte kjo fshehje nga ana e njerëzve të afërt të tij, të cilët kishin si qëllim ecurinë e çështjeve shtetërore, apo janë të tjerë ata që e fshehën atë?

Duket e papranueshme plotësisht që të mbahej e fshehtë çështja e vdekjes së tij nga oborrtarët e tij për një periudhë të gjatë

1 Tefsiri i Burhanit, vëll. 3, f. 345; "Ilelu Sheraiati", sipas transmetimit të tefsirit "El Mijzan", vëll. 16, f. 391.

kohore, madje edhe për një ditë të vetme, sepse është e padiskutueshme që të ketë pasur njerëz që kishin për detyrë të plotësonin dëshirat, nevojat e tij dhe t'i çonin ushqimin. Këta do ta mësonin për vdekjen e tij. Nuk mund të lihet mënjanë fakti, siç kanë thënë disa komentues, se ata e kanë ditur çështjen e vdekjes së tij, mirëpo ata e mbajtën të fshehtë atë çështje për objektiva të caktuara. Në disa transmetime thuhet se Asif ibn Berkhija, ministri special i Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*, ishte ai që i drejtonte punët e shtetit.

A nuk shkaktonte çështja e mungesës së konsumimit të ushqimit dhe ujit për një periudhë të gjatë, një pikëpyetje tek ata që e shikonin atë?

Me bindjen se të gjitha punët e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* ishin të çuditshme, atëherë edhe kjo çështje mund të konsiderohet prej çudive të tij. Në disa transmetime thuhet se pas një periudhe kohe të qëndrimit të Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* në gjendjen e tij, u shtua pështpëritja mes disave për domosdoshmërinë e vizitës së Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*, sepse ai është në atë gjendje, që prej një periudhe të gjatë kohe, nuk ka lëvizur, nuk ka ngrënë, nuk ka pirë e nuk ka fjetur.[12] Kur u thye shkopi dhe ra trupi mbi tokë, u larguan të gjitha ato mendime dhe imagjinata. Megjithatë, vonesa e lajmërimit të vdekjes së Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* ka zbuluar shumë gjëra:

a) U bë e qartë për të gjithë se njeriu, edhe sikur të arrijë kulmin e forcës dhe të fuqisë, vazhdon të mbetet ajo krijesë e dobët përballë ngjarjeve. Ai është si kashta në mizërinë e tufaneve, që e përplas atë nga njëra anë në tjetrën.

1 Tefsiri i "Burhanit", vëll. 3, f. 345.

Prijësi i besimtarëve, Ali ibn ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*, në një nga fjalimet e tij, thotë: "*Po të ekzistonte ndonjë tjetër, që do të mund të siguronte shkallët drejt Jetës së Amshueshme, ose të gjente mënyrën për ta larguar vdekjen, ai do të ishte Sulejmani (Paqja qoftë mbi të!), i biri i Daudit (Paqja qoftë mbi të!), të cilit, pos misionit dhe pozitës së lartë, i ishte dhënë pushtet mbi xhindët dhe njerëzit.*".[1]

b) U bë e qartë për të gjithë se xhindët nuk e dinë të fshehtën dhe njerëzit e hutuar, të cilët i adhuronin ata, ishin në një gabim të hapur.

c) U bë e qartë për të gjithë njerëzit e vërteta e një mundësie, që sistemi i shtetit të lidhej me një subjekt të vogël, me ekzistencën e tij mund të mbahej në këmbë ky sistem dhe me shkatërrimin e tij, shkatërrohej ky sistem. Pas kësaj u kristalizua fuqia e pakufishme e Krijuesit.

3- Sulejmani në Kur'anin dhe Teuratin e sotëm

Kur'ani e përshkruan Sulejmanin *(Paqja qoftë mbi të!)* me figurën e një Profeti të madh, me dituri të gjerë dhe devotshmëri të lartë, që nuk e ka burgosur kurrë pozita dhe pasuria, me gjithë atë autoritet dhe qeveri të madhe që ai kishte. Kur mbretëresha e Sebeit, për t'iu nënshtruar asaj, i dërgoi dhurata të çmueshme, tha: **"A mos doni të më ndihmoni me pasuri?! Ajo që më ka dhënë All'llahu, është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve. Por ju gëzoheni me dhuratën tuaj."**.[2]

1 "Nehxhul Belaga", Fjalimi 182.
2 Sure "En Neml", ajeti 36.

Ata nuk kishin asnjë problem tjetër përveç zbatimit të falënderimit të All'llahut për mirësitë e Tij. **"O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robve të Tu të devotshëm!"**.[1]

Një komandant që nuk e lejoi t'i bëhej padrejtësi milingonës, kur ata ishin në luginën e milingonave: **"Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: 'O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!'"**.[2]

Ai ishte "një adhurues". Nëse hutohej ndaj përmendjes së Zotit të tij, apo e angazhonte dynjaja, rikthehej me përulje te Zoti dhe thoshte: **"Unë shfaqa dashuri më të madhe për pasurinë** (kuajt)**, sesa për lutjen ndaj Zotit tim, derisa dielli humbi mbas malit."**.[3]

Ishte i urtë, nuk mbante anën e logjikës në fjalë, deri edhe kur foli me pupëzën *(el hud hud)*, nuk hoqi dorë nga e vërteta dhe drejtësia.

Ai kishte një komandant, që e ndihmonte atë e kishte dituri nga Libri, që mundi t'i sillte atij fronin e Belkisës në më pak kohë se përplasja e qepallave të syrit.

Kur'ani Famëlartë e ka përshkruar atë me epitetet: "i penduar" dhe "robi më i mirë".

1 Sure "En Neml", ajeti 19.
2 Sure "En Neml", ajeti 18.
3 Sure "Sad", ajeti 32.

Një njeri që All'llahu i dha atij qeverisjen, diturinë dhe e përfshiu atë me udhëzimin e Tij, që nuk i ka bërë kurrë shok All'llahut.

Në Teuratin e sotëm, të falsifikuar, lexojmë se faqen e këtij Profeti të madh e ka përlyer me idhujtari e të tjera dhe i ka atribuuar atij përshkrimet më të këqija për ndërtimin e tempujve të paganizmit dhe promovimin e adhurimit të idhujve. Ai jepet: i pasionuar, abuzues me gratë. Përdor shprehje shumë të shëmtuara për përshkrimet e dashnoreve, për të cilat kemi turp t'i përmendim.

Mjaftohemi të përmendim një pjesë prej atyre trillimeve më të shëmtuara e më të përbuzura, që thuhet në Teurat dhe në Librin e parë të mbretërve, nga Teurati.

Lexojmë: "Sulejmani i pasionuar me gratë e shumta përveç vajzës së faraonit, u martua me gra dashakeqe, gra që kamufloheshin çuditshëm, me gra lëkurëregjëse, me gra gjahtare dhe gra induktive. Të gjitha ato ishin prej bijave të popujve që Zoti ua ndaloi Beni Israilëve që të martoheshim me to, duke u thënë atyre që as të mos merrnin nuse prej tyre dhe as të mos jepnin tek ata, sepse ata jua devijojnë zemrat pas zotave të tyre. Mirëpo Sulejmani u bashkua me to për superdashurinë e tij për to. Ai kishte shtatëqind gra me martesë të përherhme dhe treqind gra me martesë të përkohshme. Ato ia devijuan zemrën nga Zoti dhe në kohën e pleqërisë arritën ta mashtrojnë dhe t'ia afrojnë zemrën e tij pas zotave të tjerë. Zemra e tij nuk ishte më e drejtë me perëndinë, zotin e tij, si zemra e babait të tij, Daudit. Nuk kaloi shumë, kur adhuroi Ashtarutin, zotat e gjahtarëve dhe Malkumin, zotin e urryer të atyre që kamufloheshin në mënyrë të çuditshme.

E keqja u shfaq në sytë e Zotit dhe ai nuk e ndoqi rrugën e Zotit me përsosje, siç bëri babai i tij, Daudi.

Qëndroi mbi një kodër, në lindje të Urshelimit, ku qëndronte lart Tekmushi, zoti i grave të çuditshme, të shthurura dhe Lemulku, zoti i urryer i Beni Amunëve. Ndërtoi kulla të larta për të gjitha gratë perëndimore, të cilat nisën të ndezin zemërim ndaj saj dhe ofruan djegie kufomash për zotat e tyre. Zoti u zemërua me Sulejmanin, sepse zemra e tij humbi prej Tij, edhe pse Ai e pastroi dy herë dhe e ndaloi atë nga devijimi pas zotave të tjerë, por Sulejmani nuk iu bind këshillës së Tij. Për këtë, Zoti i tha Sulejmanit: Meqë ti u largove nga Unë, e theve premtimin Tim dhe nuk iu binde urdhrave të Mia, me të cilat të këshillova ty, atëherë Unë do t'i shkatërroj degët e mbretërisë tënde dhe do t'ia jap njërit prej skllevërve të tu. Unë nuk do ta bëj atë në ditët e tua, për hir të babait tënd, Daudit, madje edhe nga dora e birit tënd do ta heq, por Unë do t'i ruaj atij vetëm një tribu, që do të mbretërojë për nder të Daudit, robit Tim ...".[1]

Nga seria e këtij tregimi të trilluar të Teuratit bëhet e qartë:

1- Sulejmani i donte shumë gratë pagane dhe u martua me shumë prej tyre, në kundërshtim me urdhëresat e All'llahut të Madhëruar. E gradualisht anoi nga feja e tyre. Numri i madh i grave të tij (700 gra dhe 300 gra me kontratë të përkohshme) dhe dashuria për to, e largoi nga rruga e vërtetë. (Zoti na ruajttë!)

2- Sulejmani dha një urdhër të qartë për ndërtimin e tempujve të paganëve, sipër malit, përballë Urshelimit, qendrës

1 "Teurati", kitabu "El Mulukul Eveli", Pjesa e 11-12, "Bashkëshortet e Sulejmanit".

fetare të shenjtë të Beni Israilëve. Një nga tempujt ishte për statujën Kemush, të cilin e adhuronte fisi i Muabijeve, kurse tjetri i statujës Ashtron, të cilin e adhuronte fisi i gjahtarëve. E gjitha kjo ka ndodhur në ditët e pleqërisë së tij.

3- All'llahu i Madhëruar vendosi ta ndëshkojë Sulejmanin për shkak të devijimit dhe gjynaheve të tij të mëdha. Ai do ta humbiste mbretërinë e tij, por jo nga dora e tij, por nga dora e djalit të tij, Rahbuam. Do ta lërë atë deri në fund të jetës së tij duke luajtur dhe duke bërë çfarë të dojë, për hir të babait të vet, Daudit, robit të sinqertë. Për këtë figurë, Teurati thotë se ka bërë vetëvrasje dhe ka bërë zina me grua të martuar, gruan e devotshme të komandantit të ushtrisë së tij. Po a mund të besohet një akuzë e tillë, kundër një njeriu të shenjtë si Sulejmani?!

Edhe sikur të supozojmë se Sulejmani nuk ka qenë Profet, siç e bën tepër të qartë atë Kur'ani, themi se ai është një nga mbretërit e Beni Israilëve. Nuk mund të besohet një akuzë e tillë, sepse, nëse ai nuk ka qenë Profet, atëherë të paktën ai ka qenë në një gardë të lartë me gradën e Profetit. Ai ka dy libra prej librave të vjetër të premtimit. Njëri prej tyre quhet "Këshillat e Sulejmanit", kurse tjetri "Poezitë e Sulejmanit".

Problemi është se si çifutët dhe kristianët, të cilët besojnë me këtë Teurat aktual, u përgjigjen këtyre pyetjeve dhe paradokseve. Si është e mundur që ata të pranojnë skandale të tilla?

4- Të paktë janë robtë e Mi falënderues

Para së gjithash, duhet të diskutojmë rrënjën gjuhësore të fjalës *"shukrun"*.

Ragib Asfahanij, në librin e tij "El Mufredatu", thotë se kuptimi i fjalës *"esh shukru"*, është: përfytyrim i mirësisë dhe shfaqja e saj. Thuhet se është e përmbysura e fjalës *"el kishru"*, domethënë *zbulimi*. E kundërta e saj është mohimi që do të thotë harresa e mirësisë dhe mbulimi i saj.

Falënderimi është me tri forma: falënderim me zemër, që është imagjinimi, mendimi i mirësisë; falënderimi me gjuhë, që është lavdërimi ndaj Bamirësit; dhe falënderimi i të gjitha pjesëve të trupit, që është përqafimi i mirësisë me masën e meritës së saj.

Shprehja kur'anore në ajet: **"O familje e Daudit! Bëni falënderim** (për All'llahun)**!"**, na tregon se falënderimi është më tepër se thënie. Falënderimi duhet të shfaqet në mesin e punëve të njeriut. Kur'ani Famëlartë, falënderuesit e vërtetë, i ka konsideruar një numër i vogël, për këtë shkak. Përveç asaj që është thënë në këto ajete, në ajetin 23 të sures "Mulk" është përmendur, pas numërimit të disa mirësive të mëdha hyjnore, si: krijimi i dëgjimit, i shikimit dhe i zemrës: **"Thuaju: Është Ai që ju ka krijuar dhe ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrat, e megjithatë ju pak e falënderoni!"**.

Në ajetin 73 të sures "En Neml" thuhet: **"Në të vërtetë, Zoti yt, është Bamirës i madh i njerëzve, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës."**.

Nga ana tjetër, njeriu është i zhutur nga koka e tij deri në fund të këmbëve të tij, me mirësitë e All'llahut, që nuk numërohen dhe nuk llogariten: **"Ai ju jep gjithçka që i kërkoni. Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e All'llahut, nuk do të mund t'i numëroni dot. Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës."**.[1]

Nga të gjitha këto, bëhet e qartë se përse frenohet falënderimi siç duhet ndaj All'llahut, përballë të gjitha mirësive që ka derdhur Krijuesi.

Me një mënyrë tjetër të shprehuri dhe siç është thënë me gjuhën e disa komentuesve të mëdhenj, themi: Falënderimi është që njeriu ta përmendë gjithmonë All'llahun, pa harresën më të vogël, duke ecur në Rrugën e Tij, pa bërë asnjë gjynah, duke iu bindur urdhëresave të Tij, pa më të voglën mëdyshje. Është e padiskutueshme, se këto përshkrime bashkohen vetëm te një pakicë shumë e vogël. Nuk dëgjon dikë të thotë se ai është një urdhër që nuk diskutohet, sepse ai buron nga meditimi i pakët në këto të vërteta dhe largimi nga arena e adhurimit.[2]

Sa herë që njeriu derdh më shumë mund në rrugën e falënderimit, aq më shumë do të jetë i përfshirë me mirësi shtesë, që ai bashkë me to, nuk mund të bëjë falënderimin e tyre. Nëse bëjmë kujdes, se një nga rrugët e zbatimit të falënderimit të All'llahut, është shfaqja e dobësisë ndaj zbatimit të saj, siç e ka bërë të qartë Kur'ani Famëlartë, bëhet e qartë e vërteta e pakicës së falënderuesve. Leximi me kujdes i hadithe që vijnë më pas, ndihmojnë në sqarimin e kësaj kërkese.

1 Sure "Ibrahim", ajeti 34.
2 Tefsiri "El Mijzan", vëll. 4, f. 38.

Ebu Besiri ka thënë: E pyeta Ebu Abdullah, imam Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)*, nëse ka kufi falënderimi. Nëse robi e bën atë, a është falënderues, mirënjohës?

Ai m'u përgjigj: *"Po."*

Unë e pyeta sërish: "Cila është?" Ai tha: *"Të falënderojë All'llahun për çdo të mirë që i ka dhënë në familje dhe pasuri, qoftë edhe për atë që e ka kryer hakun e tij në pasurinë e tij."*.[1]

Ebu Abdilahu ka thënë: *"Falënderimi ndaj mirësisë, është largim ndaj gjërave të ndaluara (haram)."*.[2]

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: Në lidhje me atë që All'llahu i ka shpallur Musait *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"O Musa më falëndero Mua, siç e meritoj falënderimin."* Musai u përgjigj: *"O Zot, po si të të falënderoj ty ashtu siç duhet, kur nuk ka falënderim që të të falënderojë Ty, vetëm për mirësinë që më ke dhënë mua?"* Zoti i tha: *"O Musa, tani më ke falënderuar Mua, kur e kuptove mirë se ajo mirësi është nga Unë."*.[3]

Falënderimi i njeriut është mjet i mirësisë për një njeri tjetër, është një pjesë e falënderimit të All'llahut.

Ka ardhur nga imam Ali ibn Husein, Es Sexhad *(Paqja qoftë mbi të!)*, se ka thënë: *"All'llahu e do çdo zemër të mërzitur dhe e do çdo rob falënderues. All'llahu i Madhëruar i thotë njërit prej robve të Tij, në Ditën e Kiametit: 'A e falënderove filanin?'"*. Ai thotë: *"Të kam falënderuar ty, o Zot."*. All'llahu i thotë: *"Nuk më ke falënderuar Mua,*

1 "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 95, kreu "esh shukru", hadithi 10, 12.
2 "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 95, kreu "esh shukru", hadithi 10, 12.
3 Burimi i mëparshëm, f. 94, Hadithi 27.

nëse nuk e falënderon edhe atë.". Pastaj tha: *"Ju falënderoj juve për All'llahun, ju falënderoj juve për njerëzit."*.[1]

Për këto çështje: E vërteta e falënderimit; Falënderimi, shkaktar i shtimit të mirësisë; Mohimi, shkak i largimit të së mirës; ka shpjegime të detajuara, në komentimin e ajetit 7 të sures "Ibrahim".

1 Burimi i mëparshëm, f. 99, Hadithi 30.

Ajetet 15 – 17

﴿لَقَدْ كَانَ لِسَبَإٍ فِي مَسْكَنِهِمْ آيَةٌ جَنَّتَانِ عَنْ يَمِينٍ وَشِمَالٍ كُلُوا مِنْ رِزْقِ رَبِّكُمْ وَاشْكُرُوا لَهُ بَلْدَةٌ طَيِّبَةٌ وَرَبٌّ غَفُورٌ١٥ فَأَعْرَضُوا فَأَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ سَيْلَ الْعَرِمِ وَبَدَّلْنَاهُمْ بِجَنَّتَيْهِمْ جَنَّتَيْنِ ذَوَاتَيْ أُكُلٍ خَمْطٍ وَأَثْلٍ وَشَيْءٍ مِنْ سِدْرٍ قَلِيلٍ١٦ ذَلِكَ جَزَيْنَاهُمْ بِمَا كَفَرُوا وَهَلْ نُجَازِي إِلَّا الْكَفُورَ١٧﴾

"Vendbanimi i Sebës ishte një shenjë e qartë për banorët e tij: dy kopshte në të djathtë dhe në të majtë të lumit. (Ne u thamë atyre)**: 'Hani nga ato që ju ka dhënë Zoti juaj dhe falënderojeni Atë. I mrekullueshëm është vendi juaj dhe Falës i madh është Zoti juaj!'"**

"Por ata nuk ua vunë veshin (fjalëve Tona)**, prandaj Ne lëshuam mbi ta ujërat e digës dhe dy kopshtet e tyre ua zëvendësuam me kopshte të tjera, me fruta të idhëta marine dhe pak lotusa."**

"Ne i dënuam kështu si pasojë e mosbesimit dhe e mosmirënjohjes së tyre. Vallë, a dënojmë Ne tjetërkënd, përveç mosmirënjohësve?"

Komentimi

Mohimi e çoi në humbje qytetin e lartë

Ajetet e mëparshme qartësuan mirësitë e mëdha hyjnore, që All'llahu i dhuroi Daudit dhe Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*, përshkroi zbatimin e detyrës së këtyre dy Profetëve të mëdhenj, duke falënderuar All'llahun e Madhëruar. Ajetet e mësipërme e zhvendosin bisedën rreth popujve të tjerë. Supozohet që të jenë bashkëkohës të Daudit dhe të Sulejmanit, ose të kenë jetuar pak kohë pas atyre të dyve. Një popull që All'llahu e përfshiu në mirësi të ndryshme, mirëpo ata zgjodhën rrugën e mohimit dhe ia mohuan All'llahut ato të mira. All'llahu i shkatërroi plotësisht, derisa ata u bënë leksion për të tjerët. Ai ishte kombi i Sebeit.

Kur'ani Famëlartë e ka paraqitur historinë e tyre, nëpërmjet pesë ajeteve dhe shkurtimisht ka treguar për disa veçori nga jeta e tyre. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Vendbanimi i Sebës ishte një shenjë e qartë për banorët e tij."**.

Siç do ta shohim, madhështia e këtij ajeti buron nga fakti se ata përfituan nga karakteristikat e vendit të tyre, rrethimin e zonës së tyre të banimit me male. Ata, me zgjuarsinë e lartë, të cilën ua dhuroi All'llahu, mundën të izolonin ujërat e rrjedhshme, që vetëm shkatërronin, pas një dige të madhe, gjigante. Aty ndërtuan një shtet të qytetëruar. Ky ishte një argument i madh, që shkaku i prishjes dhe i shkatërrimit të shndërrohej në faktorin kryesor të gjallërisë dhe të qytetërimit.

Çfarë është Sebe? Emri i kujt është? Këto pyetje janë debatuese mes komentuesve. Mendimi më i njohur është se Sebe është emri i "Ebi arab" në Jemen. Sipas një transmetimi të ardhur nga i Dërguari i All'llahut për Sebein thuhet se ishte një burrë prej arabëve, që kishte djem dhe secili prej tyre formoi një fis arab.

Disa prej komentuesve shkuan deri aty sa thanë se Sebe është emri i një toke në Jemen apo njërës prej zonave të saj. Ajetet kur'anore që kanë folur për historinë e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe zogut pupëz, kanë treguar për këtë kuptim. Në ajetin 22 të sures "En Neml", me gjuhën e pupëzës, thuhet: **"Nuk vonoi shumë e ajo erdhi dhe tha: 'Kam marrë vesh diçka që ti nuk e ke ditur dhe të kam sjellë lajme të vërteta prej** (qytetit të) **Shebës.'"**, domethënë, erdha nga toka e Sebeit me një lajm të sigurt.

Nga ajeti që po komentojmë, kuptojmë se Sebe ishte një komb që ka jetuar në atë zonë. Përemri pronorë *"hum"* që ndodhet te fraza *"mesakinihim"* – *"vendbanimet e tyre"* u referohet atyre.

Nuk ka asnjë kundërshtim mes komentuesve se Sebei mund të jetë emri i një personi si fillim, pastaj, të gjithë fëmijët dhe populli i tij pas tij, janë emëruar me emrin e tij. Më pas, ky emërtim, është zhvendosur për të përfshirë vendin dhe vendbanimet e tyre.

Ajeti kristalizon qëndrimin ndaj asaj mirësie hyjnore, që ishte vënë në duart e popullit të Sebeit. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...dy kopshte në të djathtë dhe në të majtë të lumit."**. Ajo që arriti të bënte populli i Sebeit, ishte ndërtimi i një dige të madhe mes maleve, në zonën e tyre, duke mbledhur ujërat e

rrjedhjeve shkatërruese, të padobishme. Duke hapur dritare në atë digë, e vunë nën kontroll plotësisht atë magazinues gjigant uji. Duke e kontrolluar atë, ata bënë të mundur mbjelljen e sipërfaqeve të mëdha të tokës.

Paradoksi që ka shkaktuar Fakhru Razi është: Cila është rëndësia e ekzistencës së dy kopshteve, që përmendet në këtë ajet? Pastaj, thotë se këto dy fusha të mbjella nuk ishin të zakonshme, por ishin shprehje e një zinxhiri prej kopshteve të lidhura me njëra-tjetrën dhe të shtrira në të dy anët e një lumi të madh që furnizohej nga ajo digë e madhe.

Ato kopshte ishin të mbushura me begati aq të madhe, sa është përmendur në librat e historisë. Sikur një njeri të kalonte poshtë pemëve dhe të mbante mbi kokën e tij një enë bosh, në stinën e pjekjes së frutave, ajo do të mbushej me shpejtësi, si rezultat i rënies së frutave të pjekura.

A nuk është e çuditshme, që motivi i prishjes dhe i shkatërrimit të shndërrohet në motivin kryesor, të gjallërisë, me atë pamje të habitshme? Pastaj a nuk konsiderohet ajo prej mrekullive të argumenteve të All'llahut të Madhëruar?

Përveç të gjitha këtyre, ashtu siç do të tregohet në ajetet që pasojnë, nuk ka asnjë dyshim se prej argumenteve të All'llahut është siguria e pazakontë që kishte përfshirë ato toka.

Pastaj Kur'ani shton: **"**(Ne u thamë atyre)**: 'Hani nga ato që ju ka dhënë Zoti juaj dhe falënderojeni Atë. I mrekullueshëm është vendi juaj dhe Falës i madh është Zoti juaj.'"**.[1]

Ky tregim i shkurtër, me shprehjen më të bukur, na jep foton e një serie begatish materiale dhe shpirtërore. Duke parë mirësitë materiale, ajo është toka e mirë e pastër nga sëmundjet e ndryshme, nga hajdutët, zullumqarët, nga sëmundjet dhe fatkeqësitë, nga thatësira dhe lagështira e tepërt, nga frika dhe egërsirat. Thuhet se ishte e pastër edhe nga insektet dëmtuese.

Ajër i pastër, një fllad që dërgon gëzim, një tokë bujare dhe pemë të mbushura plot me fruta.

Duke vërejtur të gjitha këto mirësi shpirtërore, themi se falja e All'llahut i kishte përfshirë ata; mbyllja e syve për lëshimet që ata bënin, largimi i fatkeqësive dhe i dënimit prej tyre dhe prej qytetit të tyre. Mirëpo këta mohues mosmirënjohës, nuk i vlerësuan ato të mira ashtu siç duhej dhe nuk dolën me sukses nga pika e provimit. Zgjodhën rrugën e kundërshtimit dhe të mohimit. All'llahu i qortoi ashpër ata, e çfarë qortimi.

All'llahu i Madhëruar thotë: **"Por ata nuk ua vunë veshin** (fjalëve Tona)**."**.

I nënvlerësuan mirësitë e All'llahut dhe menduan se jeta, zhvillimi dhe siguria janë gjëra të zakonshme dhe e harruan All'llahun. I dehu mirësia. Të pasurit u mburreshin të varfërve dhe mendonin se ishin ata që u jepnin furnizim atyre.

---

1 Fjala *"beldetun"* është kallëzues i një kryefjale të munguar. Vlerësimi është: Ky qytet i mirë dhe ky Zot mëkatfalës.

Kështu, e keqja, mosmarrja e shpërblimit i preku ata. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...prandaj Ne lëshuam mbi ta ujërat e digës..."**.

Kjo gjë shkatërroi shtëpitë dhe të mbjellat e tyre. Arat i shndërroi në shkretëtira.

Fjala *"el aremu"* rrjedh nga fjala *"el arametu"*. Kuptimi i saj është: agresiviteti dhe vështirësia, te krijesat që shfaqen me veprim. Ndjekja e fjalës *"sejlun"* - *"rrjedha"* nga fjala *"aremun"* është tregues i ashpërsisë dhe i fuqisë së All'llahut për të shkatërruar. Thuhet se kuptimi i fjalës *"el aremu"* është një mi shkretëtire, i cili shkaktoi shkatërrimin e digës, duke depërtuar brenda saj (historia e depërtimit të kafshës shkretinore në dig). Mirëpo shprehja e ajetit nuk ka as harmoninë më të vogël me këtë kuptim.

Në "Lisanul Arab", fjala *"areme"* është përmendur me kuptime të ndryshme. Njëra prej tyre është "rrjedhje që nuk mund të bllokohet". Kemi fjalën e All'llahut të Madhërishëm, ajetin. Kjo fjalë është përdorur edhe për miun.[1]

Komentimi i parë është më afër kuptimit të ajetit. Ai që tha Aliu, i biri i Ibrahimit, për komentimin e ajetit. Kur'ani Famëlartë e përshkruan fundin e kësaj toke: **"...dy kopshtet e tyre ua zëvendësuam me kopshte të tjera, me fruta të hidhëta marine dhe pak lotusa."**.

Kuptimi i fjalës *"ukulin"*, është: *"ushqim"*.

Kuptimi i fjalës *"khamtin"*, është: *"bimët e hidhëta"*.

1 "Lisanul Arab", vëll. 12, Lënda "areme", f. 396.

Kuptimi i fjalës *"ethelin"*, është: *"pemët e njohura"*.

Vendin e pemëve jeshile dhe me fruta e kanë zënë pemët shkretinore, të ashpra, që nuk kanë asnjë vlerë, si lotusi. Edhe kjo ishte, gjithashtu, një gjë e rrallë. Imagjino, o lexues, se çfarë fatkeqësie i zuri këta me tokat e tyre.

Mbase përmendja e këtyre tri llojeve të pemëve që mbetën në atë tokë të shkatërruar, është tregues i tri gjërave. Njëra prej tyre është panorama e shëmtuar; e dyta, është padobishmëria e tyre dhe e treta, interesi shumë i vogël.

All'llahu i Madhëruar, në mënyrë të qartë, si një përmbledhje dhe rezultat i kësaj historie, në ajetin që vjen pas, thotë: **"Ne i dënuam kështu si pasojë e mosbesimit."**.

Nuk duhet t'u shkojë ndërmend se ky dënim ishte vetëm për këtë popull, përkundrazi është e padiskutueshme se ai dënim i përfshin të gjithë ata që kanë bërë vepra të ngjashme me veprat e këtyre.

Ajeti shton: **"Vallë, a dënojmë Ne tjetërkënd, përveç mosmirënjohësve?"**.

Kjo ishte shkurtimisht historia e dënimit të popullit të Sebes. Më gjerësisht, do të flasim në komentimin e ajeteve që vijojnë.

Ajetet 18 – 19

﴿وَجَعَلْنَا بَيْنَهُمْ وَبَيْنَ الْقُرَى الَّتِي بَارَكْنَا فِيهَا قُرًى ظَاهِرَةً وَقَدَّرْنَا فِيهَا السَّيْرَ سِيرُوا فِيهَا لَيَالِيَ وَأَيَّامًا آمِنِينَ١٨ فَقَالُوا رَبَّنَا بَاعِدْ بَيْنَ أَسْفَارِنَا وَظَلَمُوا أَنْفُسَهُمْ فَجَعَلْنَاهُمْ أَحَادِيثَ وَمَزَّقْنَاهُمْ كُلَّ مُمَزَّقٍ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِكُلِّ صَبَّارٍ شَكُورٍ١٩﴾

"Midis atyre dhe qyteteve që i kemi bekuar, Ne vendosëm vendbanime të dukshme buzë rrugës dhe e bëmë të lehtë udhëtimin (duke u thënë)**: 'Udhëtoni të sigurt nëpër to natë e ditë!'"**

"Por ata thanë: 'O Zoti ynë, bëje më të madhe largësinë e udhëtimeve tona'. Kështu ata e ngarkuan veten me gjynahe dhe Ne i bëmë ata rrëfenja dhe i përndamë plotësisht. Sigurisht, në këtë, ka shenja si mësime për çdo të durueshëm dhe falënderues."

Komentimi

“Ne i bëmë ata rrëfenja dhe i përndamë plotësisht”!!

Këto ajete kthehen edhe një herë tjetër te historia e popullit Sebe dhe jep një shpjegim më shumë rreth tyre, për dënimin që i rrethoi ata. Historia e tyre është një mësim për çdokënd që e dëgjon.

All’llahu i Madhëruar thotë se tokën e tyre e bëri vendbanim. Ata i mbuloi begatia. Mes tyre dhe mes tokës së bekuar, bëri qytete dhe fshatra të tjera të lidhura me ndarje të vogla, deri në atë shkallë sa fshati shikonte fshatin tjetër: **“Midis atyre dhe qyteteve që i kemi bekuar, Ne vendosëm vendbanime të dukshme buzë rrugës.”**.

Disa komentues kanë thënë se togfjalëshi *“kura dhahire”* tregon fshatrat që shiheshin me sy të lirë, prej rrugës dhe udhëtarët mund të ndalonin në to apo se ato fshatra janë të ngritura në faqe të kodrës dhe dukeshin qartë nga kalimtarët.

Por cila është ajo *“tokë e bekuar”*? Shumica e komentuesve kanë rënë dakord se bëhet fjalë për tokat e Shamit: Siria, Palestina dhe Jordania. Kjo shprehje është përdorur për të njëjtën zonë, në ajetin e parë të sures “Isra” dhe në ajetin 81 të sures “El Enbija”.

Një pjesë e komentuesve kanë supozuar se ajo që synohet me këtë togfjalësh, është “San’a” ose “Me’reb”. Secila prej atyre zonave ishin toka në Jemen. Ky komentim i përafrohet kuptimit të ajetit, sepse largësia mes Jemenit aktual, në jugun më të largët të

Gadishullit Arabik dhe Shamit aktual, në veriun e largët është shumë e gjerë dhe e mbushur me shkretëtira të thata, të shkreta. Kjo gjë e bën komentimin e tokës së bekuar për Shamin shumë larg. Nuk transmetohet në histori diçka që të tregojë për këtë.

Një pjesë e tyre supozoi, gjithashtu, se përdorimi i togfjalëshit "*tokë e bekuar*" mund të ketë si qëllim Mekën. Por edhe ky mendim është shumë larg kuptimit të ajetit.

Kjo për sa i përket anës së vendbanimit. Mirëpo vetëm vendbanimi nuk është i mjaftueshëm, përkundrazi kushti i tij kryesor është "siguria". Për këtë, ajeti shton: **"...e bëmë të lehtë udhëtimin."**.

Mes tyre ka ndarje të ekuilibruara: **"Udhëtoni të sigurt nëpër to natë e ditë!"**.

Ndarjet dhe largësitë mes fshatrave ishin të harmonizuara, të mirëllogaritura. Ato rrugë janë të ruajtura nga plaçkitësit, nga hajdutët apo banditët. Njerëzit udhëtonin nëpërmjet këtyre rrugëve, pa pasur gjë me vete apo kafshë dhe pa përfituar nga rojat e armatosura. Nuk kishin frikë nga ndodhitë e rrugës apo nga uji i pakët dhe i ushqimeve.

Por me çfarë mjeti u bë përcjellja e këtij mesazhi ndaj njerëzve? Për këtë pjesë të ajetit: **"Udhëtoni të sigurt nëpër to"**, përmenden dy hipoteza: një mund të ketë qenë nëpërmjet njërit prej Profetëve, ose, e dyta, logjika ua përcillte këtë mesazh në koshiencën e tyre.

Paraprirja e fjalës **"natë"** ndaj fjalës **"ditë"**, mund të jetë: Ekzistenca e sigurisë gjatë natës, nga hajdutët apo egërsirat, është më e rëndësishme se gjatë ditës, ku çështja e sigurisë është e lehtë.

Mirëpo këta i mohuan mirësitë e mëdha të All'llahut, të cilat kishin përfshirë të gjitha hapësirat e jetës së tyre, siç është situata në lidhje me popujt e tjerë të begatuar. Ata u veshën me kryeneçësi, i rrethoi hutimi, dehja e begatisë dhe mos dhënia përparësi atyre, duke i bërë ata të zgjedhin rrugën e mohimit e jo të falënderimit. Si rrjedhim, u larguan nga Rruga e Drejtë dhe i hodhën pas shpine urdhëresat e All'llahut.

Një nga kërkesat e tyre të çuditshme ndaj All'llahut ishte: **"Por ata thanë: 'O Zoti ynë, bëje më të madhe largësinë e udhëtimeve tona.'"**.

Ata kërkuan nga All'llahu, që t'i zgjasë largësitë mes fshatrave të tyre, me qëllim që jo vetëm fukarenjtë të mos kishin mundësi të udhëtonin dot nga njëri krah në tjetrin me të pasurit, pa ushqim, ujë apo mjet udhëtimi, por edhe ata me gjendje të mesme. Kështu që udhëtimi të ishte një nga mburrjet e të pasurve, shenjë e fuqisë, e pasurisë dhe e ekspozimit të kësaj veçorie, që të vërtetohej tek të gjithë.

Ata u mërzitën nga rehatia dhe luksi, ashtu si u mërzitën Beni Israilët nga manat dhe mjalti (ushqimi qiellor) dhe kërkuan nga All'llahu: qepë, thjerrëza dhe hurdha.

Disa komentues të tjerë kanë supozuar se ajo që nënkuptohet me shprehjen: **"...bëje më të madhe largësinë e udhëtimeve tona."**, ishte se ata u bënë përtacë, deri aty sa nuk e pëlqenin më udhëtimin, që të ruanin kafshët, të mbjellat, mallin e tregtisë dhe për këtë kërkuan nga All'llahu që të qëndrojnë gjithmonë në vendin e tyre dhe të zmadhojë largësitë. Komentimi i parë është më i mirë.

Ata i bënë padrejtësi vetes të tyre: **"ata e ngarkuan veten me gjynahe"**. Po nëse kanë menduar se do t'u bënin padrejtësi të tjerëve, atëherë janë gabuar. Ata morën hanxharët dhe shqyen gjokset e tyre, kurse tymi i zjarrit që ata ndezën, u verboi sytë.

Eh, sa e mrekullueshme është shprehja që flet për dënimin e tyre të dhimbshëm: **"i bëmë ata rrëfenja"**, qytetet e tyre u shkatërruan e bashkë me to edhe jetesa e tyre.

Nga ajo jetë luksoze dhe nga ai qytetërim i përhapur në Lindje, mbeti vetëm lajmi, përkujtimi dhe fjalë në faqet e historisë: **"i përndamë plotësisht"**.

Toka e tyre u shkatërrua e bashkë me to fuqia e vazhdimësisë. Si rrjedhim, ata u detyruan të ndaheshin në grupe, për të vazhduar jetën e tyre. U shpërndanë siç shpërndahen gjethet e vjeshtës, kur i fryn era. Ndarja e tyre u bë shembull për të tjerët.[1]

Një pjesë e komentuesve ka thënë se fisi Gasan shkoi në Sham, fisi Esed në Jemen, fisi Khazaatun në anën e Tuhames, kurse enmarët në Jethrib.[2]

Ajeti mbyllet: **"Sigurisht, në këtë, ka shenja si mësime për çdo të durueshëm dhe falënderues."**. Kjo, sepse vetëm durimtarët dhe falënderuesit mund të vlerësojnë atë që ka ndodhur. Me falënderimin e tyre ndaj All'llahut të Madhëruar, në

1 Ky shembull është transmetuar në dy forma: *"teferreku ejdi Sebe"* dhe *"ejadi Sebe"*. Forma e parë tregon ndarjen njerëzore, kurse forma e dytë tregon ndarjen e mirësive dhe forcave, sepse fjala *"ejadi"* zakonisht përdoret me kuptimin e mirësive.

2 Tefsiri i "Kurtubijut" dhe tefsiri "Ruhul Meanij", fundi i ajeteve është burimi i komentimit.

rrugën e bindjes ndaj Tij, ata janë të lidhur fort me Të. Ata marrin mësim në mënyrë të bukur. Ata që i kanë hipur anijes së pasionit dhe i injoruan mirësitë e All'llahut, si mund të marrin mësime për atë që ka ngjarë?

Hulumtime

1- Fundi i habitshëm i popullit Sebe

Nga çfarë është thënë në Kur'anin Famëlartë, nga transmetimet dhe nga librat e historisë, përfitohet se populli Sebe banonte në jug të Gadishullit. Ata kishin një qeveri të pasur dhe një qytetërim tërheqës.

Pavarësisht se toka e Jemenit ishte e gjerë dhe e mirë për bujqësi, mungesa e një lumi të vetëm, nuk lejonte shumë përfitime prej saj. Ujërat e shiut, që binin me dendësi mbi majat e maleve, shkonin kot në kodrat dhe shkretëtirat e asaj zone, mirëpo populli i zgjuar i asaj zone mendoi mënyrën e përfitimit prej atyre ujërave të rrjedhshme. Për këtë qëllim, në pikat kryesore të vendit, ndërtoi një numër të madh digash.

Kuptimi i fjalës "*me'rebun*" është: ndërtim i vogël, që bëhet në fund të korridorit. Në brendësi të ngushticës së malit Surra dhe Belk, ndërtuan një digë gjigante. Në të bënë shumë dritare uji. Kjo digë mundi të grumbullojë sasi të mëdha ujërash, aq sa formuan kopshte shumë të bukura, të mbushura me begati në të dyja anët e

lumit që rridhte, duke filluar që në fillim të grykëderdhjes së digës.

Siç e kemi përmendur më parë, fshatrat e populluara në atë tokë, ishin të lidhura me njëra–tjetrën. Hija e pemëve ndiqte njëra–tjetrën. Pemët ishin të ngarkuara me sasi të mëdha frutash, saqë ai që kalonte poshtë tyre me një enë bosh, dilte pas një kohe të shkurtër me një enë të mbushur plot. Begatia e madhe, gërshetuar me siguri, përgatiti një oqean luksoz për një jetë të pastër, një oqean shembullor ndaj bindjes së All'llahut dhe përsosjes shpirtërore. Mirëpo ata nuk e vlerësuan siç duhet mirësinë e dhënë, e harruan All'llahun, i mohuan ato mirësi, u angazhuan me mburrje.

Në disa libra historie, thuhet se kafsha e shkretëtirës, miu i gjirizit, larg nga shikimet e këtyre kryeneçëve të dehur, bënte gropa në atë digë ranore dhe e prishte, e dobësonte digën nga brenda. Papritur ranë shira të dendura dhe u grumbulluan rrjedhje të mëdha pas asaj dige, e cila, deri në atë kohë, vazhdonte të ishte e përgatitur për të përballuar presionin e madh të ujit. Në një çast, kjo digë u shemb, duke firmosur fundin e asaj jete të bukur. I shkatërroi fshatrat e banuara, kopshtet, arat dhe të korrat, u mbyti kafshët, i bëri copë-copë kështjellat dhe shtëpitë e bukura tërheqëse. Ajo tokë e gjallë u shndërrua në një shkretëtirë të thatë, pa ujë dhe pa bar. Nuk mbeti nga ato kopshte dhe pemë me fruta përveç drunjve të thatë, të hidhët. U larguan zogjtë këngëtarë, duke ua lënë vendin bufave dhe egërsirave.[1]

1 Marrë nga tefsiri "Mexhmaul Bejan" dhe historitë e Kur'anit dhe tefsireve të tjera.

Kur All'llahu i Madhëruar dëshiron të tregojë fuqinë e Tij, atëherë Ai shkatërron një qytet të bukur me disa minj, derisa robve t'u bëhet e qartë masa e dobësisë së tyre dhe të mos mashtrohen me forcën e tyre, sado lart të arrijnë.

2- Mrekullia historike e Kur'anit

Kur'ani Famëlartë ka treguar historinë e popullit të Sebes, kur historianët nuk kanë ditur asgjë për ekzistencën e këtij populli. Ajo që na tërheq shikimin, është se historianët, para zbulimeve moderne, nuk kanë përmendur asgjë për zinxhirin e mbretërve të Sebeit dhe qytetin e madh të tyre. Ata kanë menduar se Sebe është një person, i njohur si babai krijues i "shtetit gomar". Por Kur'ani Famëlartë ka paraqitur një sure të plotë me emrin e këtij populli dhe ka treguar një nga panoramat e qytetit të tyre, që është ndërtimi i tyre historik (diga brilante).

Mirëpo, pas zbulimit të gjurmëve arkeologjike të këtij populli në Jemen, ndryshuan mendimet e historianëve. Shkaku i vonesës së zbulimit të gjurmëve arkeologjike të këtij populli i referohet:

1- Vështirësia e rrugës që të çonte në zonat e eksplorimit dhe nxehtësia e madhe e atmosferës atje.

2- Mbajtja larg e banorëve të sotëm të zonës nga të huajt. Kjo gjë i bëri evropianët, të painformuar dhe të panjohur, duke përdorur epitetin "egërsira", për ndodhitë që u ndodhnin banorëve të zonës. Një numër i madh arkeologësh zbuluan

sekrete arkeologjike, jo vetëm në zemër të qytetit Me'reb, por edhe në rrethinat e tij.

Ata zbuluan një grumbull gurësh që përmbanin shumë kaligrafi dhe skulptura. Pastaj, në shekullin e nëntëmbëdhjetë gregorian, alternuan rregullisht konventa eksploruesish, duke raportuar një seri skulpturash, kaligrafish, monumente antike, duke përfituar nga ato relike, të cilat ishin afër njëmijë të tjerave. Shkencëtarët e kuptuan domethënien dhe karakteristikat e periudhës së zhvillimit të këtij populli, kronologjinë e ndërtimit të digës së Me'rebit dhe karakteristikat e tjera. Perëndimorëve iu vërtetua se ajo që përmend Kur'ani Famëlartë, nuk ishte legjendë, trillim, por realitet historik. Ata nuk e kishin gjetur dhe nuk e kishin kuptuar akoma dhe pas kësaj mundën ta përshkruajnë projektin e plotë të asaj dige gjigante dhe dritaret e kalimit të ujit në të, të përrenjve të veçantë për kopshtet dhe arat, nga e djathta dhe e majta. Ata i kuptuan të gjitha karakteristikat e tjera të zonës.

3- Vëmendje e rëndësishme rreth mësimit në një histori të shkurtër

Paraqitja e historisë së populllit të Sebeit, pas historisë së Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka një kuptim të veçantë:

a- Daudi dhe Sulejmani *(Paqja qoftë mbi ta!)* ishin Profetë të mëdhenj, që mundën të ndërtonin një qeveri të fuqishme dhe të krijonin një periudhe të artë, që u zhduk pas vdekjes së tyre. Po kështu, periudha e zhvillimit të madh, që e ndërtoi populli Sebe, u zhduk me shkatërrimin e digës së Me'rebit.

Ajo që meriton të shikohet me kujdes, është: Tregimet na tregojnë se shkopin e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)* e brejti krimbi i drurit, ashtu si edhe digën e Me'rebit e shpoi miu i gjirizit shkretinor. Njeriu kryeneç, ta dijë mirë se mirësitë materiale, sado të mira të jenë, shkatërrohen, vetëm nëpërmjet një insekti apo kafshe të dobët, që e kthen përmbys. Nga ky rezultat, besimtarët dhe të diturit të kenë kujdes dhe të mos bëhen të burgosur në marrjen e këtyre të mirave. Kryeneçi të zgjohet nga dehja e hutimit të tij dhe të mos zgjedhë rrugën e padrejtësisë dhe të armiqësisë.

b- Këtu vërejmë dy periudha të mëdha zhvillimi. Njëra prej tyre është dhënë nga All'llahu i Mëshirshëm, kurse tjetra është rruga djallëzore. Të dy këto periudha u përballën me shkatërrimin dhe nuk qëndruan përherë.

c- Ajo që meriton vëmendje, është: Kryeneçët e popullit Sebe, të cilët nuk e duronin dot ekzistencën e të varfërve, të vobektëve në mesin e tyre, kërkuan një pengesë mes pakicës së fisnikëve dhe shumicës së fukarenjve, që të mos përziheshin me ta. Ata e lutën All'llahun që të rritë largësinë mes fshatrave të tyre, me qëllim që të vështirësohej udhëtimi për njerëzit e varfër. All'llahu i Madhëruar iu përgjigj lutjes së tyre dhe e ndau bashkimin e tyre, ua shkatërroi atyre mirësitë e Sebeit, saqë, nëse ata do të donin të takoheshin, do të kërkonte prej tyre që të shpenzonin një jetë të gjatë në udhëtim.

ç- Kur medituesi të hetojë me kujdes për situatën e asaj toke, para rrjedhës së pandalshme dhe pas saj, nuk do ta besojë se këto toka pas përmbytjes, janë ato toka jeshile, të mbushura me pemë, me shumë gjethe dhe fruta. Do të habitet se si u bënë

shkretëtira të egra, ku gjen vetëm disa pemë të shkreta prej pemëve të hidhëta dhe pak nga pema e sidrit. Këto ngjajnë nga larg si udhëtarët që kanë humbur rrugën dhe vijnë rrotull sa andej-këtej.

Qenia e njeriut është si kjo tokë. Nëse mund të kontrollojë forcat krijuese dhe i përdor ato në mënyrë të rregullt, atëherë nuk ka dyshim se ai do të bëjë kopshte të mbushura me freski të diturisë, të punës dhe të mirësive shpirtërore, mirëpo, nëse thyhet diga e devotshmërisë, rrëzohen instinktet si rrjedha shkatërruese dhe toka mbulon jetën e njeriut, atëherë nuk mbetet gjë tjetër veç shkatërrimit, gërmadhës. Ndonjëherë, disa vepra që janë të thjeshta, fillojnë gradualisht, që në rrënjë, derisa të rrëzohet çdo gjë, prandaj duhet të kesh frikë dhe kujdes edhe nga këto çështje të vogla, që mund të duken të kota.

d- Gjëja e fundit që dëshirojmë të tregojmë, është: Ai dënim i çuditshëm vërteton edhe një herë tjetër të vërtetën se vdekja është e fshehur në brendësi të jetës së njeriut dhe e njëjta gjë që mund të jetë shkaku i jetës së njeriut dhe e ndërtimit të saj një ditë, bëhet faktor i vdekjes së tij dhe i shkatërrimit të tij ditën tjetër.

Ajete 20 – 21

﴿وَلَقَدْ صَدَّقَ عَلَيْهِمْ إِبْلِيسُ ظَنَّهُ فَاتَّبَعُوهُ إِلَّا فَرِيقًا مِنَ الْمُؤْمِنِينَ٢٠ وَمَا كَانَ لَهُ عَلَيْهِمْ مِنْ سُلْطَانٍ إِلَّا لِنَعْلَمَ مَنْ يُؤْمِنُ بِالْآخِرَةِ مِمَّنْ هُوَ مِنْهَا فِي شَكٍّ وَرَبُّكَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ حَفِيظٌ٢١﴾

"Me të vërtetë, hamendja e Iblisit për ata u vërtetua; ata shkuan pas tij, përveç një grupi besimtarësh të vërtetë."

"Por ai (Iblisi) **nuk ka pasur kurrfarë pushteti mbi ta. Ne vetëm kemi dashur të zbulojmë se kush beson në Jetën Tjetër e kush dyshon në të. Zoti yt është Mbikëqyrës i çdo gjëje."**

Komentimi

Askush nuk është i detyruar të ndjekë shejtanin

Këto ajete përfaqësojnë një lloj produkti të përgjithshëm nga historia e popullit të Sebeit, i cili është përmendur në ajetet e mëparshme. Pamë se si ata, duke ia dorëzuar veten pasionit dhe cytjeve të djallit, u ekspozuan ndaj çdo dështimi dhe fundi të keq.

All'llahu i Madhëruar, në ajetin 20, thotë: **"Me të vërtetë, hamendja e Iblisit për ata u vërtetua; ata shkuan pas tij, përveç një grupi besimtarësh të vërtetë."**.

Thënë ndryshe: Nuk ka asnjë dyshim se djalli u frenua t'i bëjë sexhde Ademit dhe, pasi u dëbua nga prania e madhështisë hyjnore, shpresoi dhe tha: **"Ai tha: 'Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robve të Tu të sinqertë!'"**.[1]

Kjo shpresë e tij, në lidhje me këtë popull, u realizua, sepse, edhe pse ai e ka thënë këtë bisedë me hamendje, kjo hamendje u bë realitet. Atë e ndoqën ata me besim të dobët dhe ranë në kurthin e tij, në grupe dhe tek e tek, përveç një grupi të vogël besimtarësh, që arritën t'i thyejnë zinxhirët e cytjeve djallëzore dhe u larguan nga kurthi i tij. Jetuan të lirë dhe u larguan të lirë, edhe pse ata ishin të paktë në numër, por secili prej tyre ishte i barabartë me dynjanë dhe çka ka në të, për nga vlera shpirtërore. *Ata janë të paktë në numër, por me vlerë shumë të madhe te All'llahu*.[2]

Ajeti 21 na tregon për dy kërkesa, në lidhje me cytjet djallëzore, për njerëzit që bien nën kontrollin e tij dhe njerëzit që janë jashtë kontrollit të tij. Ajeti i bekuar thotë: **"Por ai** (Iblisi) **nuk ka pasur kurrfarë pushteti mbi ta."**.

Atëherë jemi ne ata që e lejojmë hyrjen e tij dhe i japim atij vizën e kalimit nga kufiri personal i shtetit, në brendësi të zemrave tona. Kjo është ajo që transmeton Kur'ani nga vetë gjuha

1 Sure "Sad", ajetet 82-83 .
2 "Nehxhul Belaga", Fjalët e urta, Fjalia 147.

e shejtanit: **"...Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m'u përgjigjët..."**.[1]

Duket qartë se ai, pas përgjigjes së thirrjes prej atyre që nuk besojnë dhe skllevërve të pasionit, nuk i qetësohet shpirti, por nxiton t'i pushtojë ato qenie.

Ajeti thotë se qëllimi i shtrirjes së dorës së djallit dhe cytjeve të tij, është vetëm për hir të njohjes së besimtarëve ndaj atyre që janë në dyshim: **"Ne vetëm kemi dashur të zbulojmë se kush beson në Jetën Tjetër e kush dyshon në të."**.

Është e padiskutueshme se All'llahu i Lartësuar është i mirinformuar për çdo gjë që ndodh në këtë botë, që nga zanafilla deri në pafundësi, prandaj folja *"lina leme"* – *"të dihet"* nuk është një nocion që kufizon dijen e All'llahut të Madhëruar. All'llahu i njeh se kush janë besimtarët për Ahiretin nga ata që janë në dyshim për të. Duhet të jetë ngacmimi i shejtanit, që ne ta kuptojmë atë.

Ajo që kuptohet nga kjo folje, është vërtetimi absolut i dijenisë së All'llahut, sepse All'llahu i Madhëruar nuk e dënon askënd në bazë të diturisë së Tij për të padukshmen dhe veprave të ardhshme të atij njeriu, përkundrazi, kur ka një shesh provimi dhe nëpërmjet ngacmimeve të djajve dhe pasionit të egos, njeriu tregon pjesën e brendshme të tij, me vullnetin dhe zgjedhjen e tij të plotë, deri në realitetin praktik. Kështu vërtetohet plotësisht dituria e All'llahut të Madhëruar, sepse, nëse nuk vërtetohen punët me vepra, atëherë nuk arrihet vërtetimi, meritimi i shpërblimit dhe i dënimit.

1 Sure "Ibrahim", ajeti 22.

Me një mënyrë tjetër të shprehuri: Shpërblimi dhe dënimi nuk bëhet për pjesën e brendshme, të mirë apo të keqe, pasi, sa të ketë fuqi, duhet të vërtetohet me vepër.

Mbyllja e ajetit u tërheq vërejtjen robve: **"Zoti yt është Mbikëqyrës i çdo gjëje."** ***Me*** qëllim që ndjekësit e djallit të mos mendojnë se veprat dhe fjalët e tyre shkatërrohen në këtë botë, apo All'llahu harron, kurrsesi, kurrë, përkundrazi nuk ka asnjë dyshim se All'llahu i përcjell dhe i ruan ata deri në Ditën e Shpërblimit.

Ajetet 22 – 27

﴿قُلِ ادْعُوا الَّذِينَ زَعَمْتُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَا يَمْلِكُونَ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ فِي السَّمَاوَاتِ وَلَا فِي الْأَرْضِ وَمَا لَهُمْ فِيهِمَا مِنْ شِرْكٍ وَمَا لَهُ مِنْهُمْ مِنْ ظَهِيرٍ٢٢ وَلَا تَنْفَعُ الشَّفَاعَةُ عِنْدَهُ إِلَّا لِمَنْ أَذِنَ لَهُ حَتَّى إِذَا فُزِّعَ عَنْ قُلُوبِهِمْ قَالُوا مَاذَا قَالَ رَبُّكُمْ قَالُوا الْحَقَّ وَهُوَ الْعَلِيُّ الْكَبِيرُ٢٣ قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ قُلِ اللَّهُ وَإِنَّا أَوْ إِيَّاكُمْ لَعَلَى هُدًى أَوْ فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ٢٤ قُلْ لَا تُسْأَلُونَ عَمَّا أَجْرَمْنَا وَلَا نُسْأَلُ عَمَّا تَعْمَلُونَ٢٥ قُلْ يَجْمَعُ بَيْنَنَا رَبُّنَا ثُمَّ يَفْتَحُ بَيْنَنَا بِالْحَقِّ وَهُوَ الْفَتَّاحُ الْعَلِيمُ٢٦ قُلْ أَرُونِيَ الَّذِينَ أَلْحَقْتُمْ بِهِ شُرَكَاءَ كَلَّا بَلْ هُوَ اللَّهُ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ٢٧﴾

“Thuaju (o Muhammed)**: ‘Thirrini ata që i hyjnizoni krahas All’llahut! Ata nuk kanë pushtet as sa pesha e një thërrmije, qoftë në qiej apo në Tokë; për ata nuk ka pjesë as në qiej, as në Tokë dhe All’llahu nuk ka asnjë ndihmës nga radhët e tyre.’”**

“Asnjë ndërmjetësim tek Ai nuk bën dobi, përveçse për atë që Ai jep leje. Kur t’u hiqet frika nga zemrat e tyre, ata do të thonë: ‘Çfarë tha Zoti juaj?’ dhe do të përgjigjen: ‘Të vërtetën! Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm.’”

"Thuaju: 'Kush ju furnizon juve prej qiejve dhe prej Tokës?' - Thuaju: 'All'llahu! Ne nuk mund të jemi që të dyja palët në Rrugën e Drejtë, ose ju, ose ne jemi në humbje të qartë!'"

"Thuaju: Ju, nuk do të pyeteni për atë që kemi gabuar ne, as ne nuk do të përgjigjemi për atë që bëni ju."

"Thuaju: Ne do të na mbledhë Zoti ynë e do të gjykojë ndërmjet nesh me drejtësi. Ai është Gjykatës i drejtë e i Gjithëdijshëm."

"Thuaju: 'M'i tregoni ata, që ia vishni Atij si ortakë'. Kurrsesi, ata nuk mund të jenë ortakë të Tij. Ai është All'llahu (Një i Vetëm)**, i Plotfuqishmi dhe i Urti."**

Komentimi

Më thoni përse?

Në fillim të sures, kemi thënë se ka një seri ajetesh që flasin për zanafillën, Kiametin dhe besimet e vërteta. Kush i lidh ato me njëra-tjetrën, do të përfitojë të vërteta të reja.

Në këtë fragment ajetesh, Kur'ani i tërheq idhujtarët në gjykim dhe me goditjet shkatërruese të pyetjeve logjike, i tubon ata në një cep të ngushtë. Pastaj ua bën të qartë zvetënimin e mendjes së tyre të dobët në lidhje me ndërmjetësimin e statujave.

Në këtë seri ajetesh, i flitet pesë herë të Dërguarit më të nderuar, duke e udhëzuar se si të sillet me adhuruesit e statujave.

Çdo herë, ajetet shfaqin një kërkesë të re, që lidhet me fundin e statujave dhe adhurimin e tyre, në atë mënyrë sa ndihet se nuk ka besim më bosh dhe më të thatë se adhurimi i statujave, madje edhe në rrënjë këto mund të quhen (besim) apo (fe).

Në ajetin e parë prej ajeteve në fjalë, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Thuaju** (o Muhammed)**: 'Thirrini ata që i hyjnizoni krahas All'llahut!'"**.

Dijeni mirë se këto statuja dhe rivalë nuk do t'u përgjigjen kurrë lutjeve tuaja, as nuk do t'ju zgjidhin asnjë problem. Pastaj ajeti jep argumentin për këtë fjalë: **"Ata nuk kanë pushtet as sa pesha e një thërrmije, qoftë në qiej apo në Tokë; për ata nuk ka pjesë as në qiej, as në Tokë dhe All'llahu nuk ka asnjë ndihmës nga radhët e tyre."**.

Sikur ata të mundeshin për ndonjë gjë, atëherë duhet të kishin një nga këto cilësi: ose zotërim të pavarur për një gjë në qiell apo në tokë, ose të paktën pjesëmarrje me All'llahun në urdhrin e krijimit, ose ndihma, përkrahja e Krijuesit në një nga këto tri gjëra.

Është e qartë se "domosdoshmëria e ekzistencës" është vetëm një, kurse e gjithë pjesa tjetër, që është "mundësia e ekzistencës", është e lidhur me të. Sikur All'llahu i Madhëruar ta largojë vetëm një çast shikimin e mirësisë ndaj tyre, do t'i zinte vendi i shkatërrimit dhe i mosekzistencës. E ëmbël është fjala e All'llahut të Lartësuar: **"...sa pesha e një thërrmije, qoftë në qiej apo në Tokë."**.

Ata janë krijesa që nuk kanë asgjë, as sa "grimca e një atomi", në këtë qiell të pakufishëm dhe në këtë tokë me skaje të

gjera. Pra, çfarë problemi mund të zgjidhin ata për veten e tyre, që të pengojë ty njësoj si ajo?!

Këtu të vjen ndërmend menjëherë pyetja: Nëse çështja është e tillë, atëherë si do jetë çështja e ndërmjetësimit të ndërmjetësuesve?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e jep ajeti që vjen pas: **"Asnjë ndërmjetësim tek Ai nuk bën dobi, përveçse për atë që Ai jep leje."**.

Sikur të kishte ndërmjetësues te All'llahu i Madhëruar, pa dyshim se ata nuk ndërmjetësojnë vetëm se me lejen dhe urdhrin e Tij.

Arsyeja që putistët e motivojnë fjalën e tyre, është: **"Këta janë ndërmjetësit tanë te All'llahu."**![1]

All'llahu i Madhëruar nuk e ka lejuar kurrë ndërmjetësimin e tyre.

Sifjalia: **"...përveçse për atë që Ai jep leje."**, tregon ndërmjetësuesit ose të ndërmjetësuarit. Komentuesit kanë supozuar dy hipoteza. Edhe sikur të harmonizohet me atë që përmendet në ajetin e kaluar, kur flitet rreth statujave, ata menduan se statujat janë ndërmjetësuesit e tyre, pra, sifjalia tregon "ndërmjetësit" .

Ajo që nënkuptohet me "ndërmjetësimin", këtu është ndërmjetësimi i dynjasë, apo i Ahiretit? Të dyja hipotezat janë përmendur, mirëpo fjalia që vjen më pas, fakton se qëllimi është ndërmjetësimi i Ahiretit.

1 Sure "Junus", ajeti 18.

Prandaj shprehja që është pas saj, thotë se në atë ditë mbizotëron ashpërsia dhe shqetësimi. Ndërmjetësuesit dhe të ndërmjetësuarit i kaplon frika, duke pritur të shikojnë se kë do të urdhërojë All'llahu me lejimin e ndërmjetësimit. Kujt do t'i lejohet ai ndërmjetësim? Situata e tmerrit dhe e shqetësimit vazhdon. Ajo frikë dhe ai shqetësim largohet nga zemrat e tyre, me paraqitjen e urdhrit hyjnor. **"Kur t'u hiqet frika nga zemrat e tyre."**.

Megjithatë, ajo është dita e tmerrit të atyre syve që shpresojnë ndërmjetësimin për ndërmjetësuesit, duke pritur nga ata ndërmjetësimin, me gjuhën e situatës apo me fjalë. Por edhe ndërmjetësuesit, gjithashtu, presin urdhrin e All'llahut. Si? Kujt i lejohet ndërmjetësimi? Ajo frikë dhe ai shqetësim qëndron një vit, deri sa shfaqet nga Gjykatësi, urdhri i Tij, me veçoritë e atyre që e meritojë ndërmjetësimin.

Kur përballen të dy grupet, pyesin, (apo mëkatarët pyesin ndërmjetësuesit): **"...ata do të thonë: 'Çfarë tha Zoti juaj?'"** dhe do të përgjigjen: **"Të vërtetën!"**.

E vërteta nuk është tjetër, veç lejimi i ndërmjetësimit për të gjithë ata që nuk i kanë prerë plotësisht lidhjet e tyre me All'llahun e jo për ata që i kanë prerë të gjitha hallkat e lidhjes dhe u bënë si të huaj edhe për të Dërguarin dhe të dashurit e Tij.

Ajeti mbyllet: **"Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm."**. Kjo shprehje është plotësuese e asaj që e kanë thënë "ndërmjetësuesit", që All'llahu është i Larti, i Madhi dhe çdo urdhër që del, është vetë e vërteta dhe çdo e vërtetë, zbatohet bashkë me urdhëresat e Tij.

Ajo që kemi shfaqur, është komenti më i afërt që harmonizohet me shprehjet e ajetit. Komentuesit kanë komentime të tjera, në lidhje me këtë çështje. E çuditshme është se një pjesë e tyre nuk e kanë marrë në konsideratë lidhjen mes fillimit të ajetit dhe fundit të tij, lidhjen e ajetit paraardhës me atë pasardhës.

Në ajetin që vjen pas, Kur'ani Famëlartë hyn në një rrugë tjetër për të shkatërruar besimet e idhujtarëve dhe e bën çështjen e "furnizimit me të mira", adresë pas shtrimit të çështjes së "krijimit", e cila është përmendur si kuptim në ajetet e kaluara. Këtë argument, Kur'ani e shtron në formën e pyetjes dhe të përgjigjes, me qëllim që të zgjojë ndjenjën e tyre, që atyre t'u kthehet shikimi nga dyshimet, nëpërmjet nxitjes së marrjes së përgjigjes nga vetja e tyre.

All'llahu Madhëruar thotë: **"Thuaju: 'Kush ju furnizon juve prej qiejve dhe prej Tokës?'"**. Është e padiskutueshme se askush prej tyre nuk mund të thotë se këto statuja prej guri dhe druri janë ato që zbresin shiun nga qielli, apo që i mbijnë bimët në tokë, apo që na i nënshtrojnë neve burimet tokësore dhe qiellore.

E bukura është se, pa pritur marrjen e përgjigjes prej tyre, All'llahu thotë: **"Thuaju: 'All'llahu!'"**.

All'llahu është burimi i të gjitha këtyre të mirave, begative. Çështja është e qartë, aq sa nuk ka asnjë nevojë për përgjigjen e një pale tjetër, por për atë që pyet dhe përgjigjet, ka një mendim të vetëm, sepse idhujtarët mendojnë se All'llahu është Krijuesi dhe Furnizuesi, kurse statujat kanë vetëm pozitën e ndërmjetësimit.

Ajo që meriton vëmendje, është se furnizimet që arrijnë te njerëzit nga qielli, nuk janë magazinat e shiut, madje nuk ka asnjë

dyshim se drita dhe nxehtësia që burojnë nga dielli dhe ajri që gjendet në atmosferën e tokës, nuk e pakësojnë rëndësinë e pikave të shiut.

Begatitë e tokës, nuk janë të depozituara te bimët, por burimet e ujit nën sipërfaqen e tokës dhe mineralet e ndryshme që s'ishin të njohura në atë kohë, por u njohën me kalimin e kohës, futen nën këtë adresë, gjithashtu.

Fundi i ajetit tregon një temë, që mund të jetë thelbësore për një argument aktual dhe në harmoni me qëllimin e moralit dhe të drejtësisë, në atë mënyrë që e zbret palën përballë nga mjeti i kryeneçësisë dhe i kokëfortësisë dhe e shtyn drejt të menduarit dhe shikimit me kujdes.

All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ne nuk mund të jemi që të dyja palët në Rrugën e Drejtë, ose ju, ose ne jemi në humbje të qartë!"**.

Kjo tregon se besimi ynë dhe besimi juaj janë kundërshtarë, në bazë të pamundësisë së bashkimit të dy antipodeve, atëherë nuk ka asnjë mundësi që të dy ftesat të jenë në të vërtetë. Prandaj patjetër që njëri nga grupet të jenë ithtarët e udhëzimit, kurse tjetri, të burgosurit e humbjes.

Tani ju duhet të mendoni, se cili prej dy grupeve është i udhëzuar në Rrugë të Drejtë dhe cili është në humbje. Shikoni shenjat dhe karakteristikat e secilit prej tyre dhe masës së përputhjes së tyre me shenjat e udhëzimit dhe të humbjes.

Kjo është një nga metodat më të mira të krahasimit dhe të diskutimit, që palën tjetër ta vërë në situatën e të menduarit dhe

të reagimit. Ajo që mendojnë disa, se ajo është një lloj *tekijje* (fshehje), është kulmi i dyshimit.

Na tërheq shikimin përmendja e fjalëve *"ala"* me *"huda"* dhe *"fi"* me *"dalal"*. Kjo dukuri tregon se të udhëzuarit janë njësoj sikur i hipin një mjeti të shpejtë apo hipin në një minare të lartë dhe kontrollojnë çdo gjë, situatën e të humburve, të mbyturve në errësirat e injorancës së tyre.

All'llahu i Lartësuar, në fillim, ka folur për "udhëzimin", pastaj për "humbjen". All'llahu ka thënë: *"inna"* - *"Ne"* në fillimin e fjalisë së parë, pastaj ka thënë *"ijjakum"* - *"ju"*, për të qenë pikë referimi për udhëzimin e grupit të parë dhe humbjen e grupit të dytë.

Një pjesë e komentuesve kanë thënë se cilësimi i humbjes me mbiemrin *"të qartë"*, është bërë për të theksuar se humbja është shumë llojesh dhe humbja nga idhujtaria është më e qarta e tyre. Supozohet se ky përshkrim të jetë edhe për udhëzimin, edhe për humbjen, në një linjë, sepse "cilësia" në kuptime të tilla nuk përsëritet për të qenë më e hiperbolizuar, prandaj "udhëzimi" është i palakueshëm dhe "humbja" e palakueshme, siç thuhet në shumë ajete kur'anore.[1]

Ajeti 25 vazhdon argumentimin në një formë tjetër, duke e bërë kundërshtarin të zbresë nga mjeti i kokëfortësisë dhe i kryeneçësisë. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Thuaju: 'Ju, nuk do të pyeteni për atë që kemi gabuar ne, as ne nuk do të përgjigjemi për atë që bëni ju.'"**.

1 Ajetet: ajeti 1, sure "En Neml"; ajeti 12, sure "Nur"; ajeti 6, sure "El Hud"; ajeti 2, sure "El Kasas"; ajeti 79, sure "En Neml".

E çuditshme këtu është se i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është urdhëruar të përdorë shprehjen *"xheremun"* - *"gabim"*, në lidhje me të dhe shprehjen *"a'malun"*, për palën tjetër. Me këtë bëhet e qartë e vërteta, se çdo person është përgjegjës që të komentojë, të shpjegojë veprat dhe veprimet e tij, sepse rezultatet e veprave të çdo njeriu kthehen kundër tij, të mirat apo të këqijat. Në përmbajtje, është tregues i bukur, sepse Ne këmbëngulim në udhërrëfimin dhe udhëzimin tuaj, jo se gjynahet tuaja bashkohen në llogarinë tonë, dhe jo se e keqja juaj na dëmton ne. Ne këmbëngulim për atë, të nxitur nga entuziazmi juaj dhe duke kërkuar të vërtetën.

Ajeti 26 është sqarim i rezultatit të dy ajeteve të mëparshme, se, pasi na tërhoqi vërejtjen se njëri nga të dy grupet është në të vërtetën, kurse tjetri në humbje dhe secili prej tyre është përgjegjës për veprat e tij, u zhvendos të vërtetojë situatën e të gjithëve, ndarjen mes të vërtetës dhe të kotës dhe shpërblimit të secilit grup, sipas përgjegjësisë së tij. All'llahu i Madhëruar e orienton se çfarë t'u thotë atyre, se All'llahu do të na tubojë ne Ditën e Ringjalljes, do të gjykojë me drejtësi mes nesh dhe do të na ndajë ne nga njëri–tjetri, që të njihen mirë të udhëzuarit nga të humburit. Pastaj do t'i përcjellë secilit grup rezultatet e veprave të tij. **"Thuaju: 'Ne do të na mbledhë Zoti ynë e do të gjykojë ndërmjet nesh me drejtësi.'"**.

Nëse sot shikoni se ju jeni të përzier me njëri-tjetrin dhe secili pohon se është në të vërtetën dhe është nga njerëzit e shpëtuar, atëherë kjo situatë nuk do të zgjasë përgjithmonë. Është e domosdoshme që të vijë dita e ndarjes mes radhëve, sepse hyjnia e All'llahut e ka obliguar ndarjen e "të mirës" nga "e

keqja" dhe "të sinqertit" nga "i prishuri" dhe "të vërtetës" nga "e pavërteta" në fund. Secili prej tyre mban vendin që meriton.

Mendohuni mirë tani se çfarë do të bëni atë ditë. Në cilin rresht do të qëndroni? A keni sjellë ndonjë përgjigje për pyetësorin e All'llahut në atë ditë?

Në fundin e ajetit, duke theksuar përfundimin e asaj ndarjeje, thotë: **"Ai është Gjykatës i drejtë e i Gjithëdijshëm."**.

Këto dy emra janë nga emrat e bukur të All'llahut. Njëri prej tyre tregon fuqinë e All'llahut të Lartësuar në procesin e ndarjes së radhëve, kurse tjetri për diturinë e Tij të pakufishme. Procesi i ndarjes së radhëve të së vërtetës nga e pavërteta nuk mund të realizohet pa këto dy cilësi. Përdorimi i fjalës *"rrab"*, në ajetin e mësipërm tregon se All'llahu është zotëruesi dhe edukatori i të gjithëve, në atë çfarë kërkon, që programi i një dite të tillë të jetë i gatshëm. Kjo është tregues i bukur, i një prej argumenteve të Kiametit.

Fjala *"feteha" - "hap"*, siç thotë Rragib në librin e tij El Mufredat, *"el fet'hu"* është largimi i mbylljes dhe i problemit. Për këtë janë dhënë dy shembuj. Njëra prej tyre kuptohet me shikim, siç është hapja e derës apo të tjera si ajo dhe hapja e drynit, mbyllja. E dyta: kuptohet nga ana shpirtërore, siç është largimi i shqetësimit apo largimi i pikëllimit.

Disa transmetime kanë treguar për përmendjen e *"ja fettah"* (o Lehtësues, Çlirues) në duatë për zgjidhjen e disa problemeve, sepse ky emër madhështor i All'llahut, tregon fuqinë e All'llahut në zgjidhjen e çdo problemi, largimin e çdo brenge dhe pikëllimi dhe përgatitjen e shkaqeve të çdo çlirimi dhe ndihme.

All'llahu është i vetmi Çlirues dhe Lehtësues nga çdo gjë *(fettah)*. Çelësi i të gjitha dyerve të mbyllura është në dorën e fuqisë së All'llahut të Lartësuar.

Në ajetin 27, që shpreh urdhrin e pestë për të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Kur'ani kthehet edhe një herë të flasë për çështjen e Teuhidit, me të cilën e nisi. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Thuaj: 'M'i tregoni ata, që ia vishni Atij si ortakë.'"**.

Cila është vlera dhe forca e këtyre? Nëse keni për qëllim statujat e gurta dhe drunjtë e palëvizshëm, të vdekur, atëherë pa dyshim se ajo është nga ato që ftojnë në turpe dhe tregojnë për suksesin e keq, që të imagjinoni ngjasimin e krijesave më të ulëta, që janë sendet që ju i keni bërë me duart tuaja, me All'llahun e Lartësuar. Nëse besoni se ato përfaqësojnë shpirtrat e engjëjve, atëherë fatkeqësia është edhe më e madhe, sepse këta janë, gjithashtu, krijesa të All'llahut të Madhëruar dhe janë zbatues të urdhëresave të Tij.

Prandaj, menjëherë pas kësaj fjalie dhe me një fjalë të vetme, i bën të pavlefshme këto gjëra të kota dhe trillime: **"Kurrsesi"**, pasi këto gjëra nuk e meritojnë kurrë të adhurohen. Këto imagjinata dhe mendime nuk kanë asnjë lidhje me realitetin. Deri kur do të zgjidhni këtë rrugë të gabuar?

Fjala: *"kel'la"*, kaq e vogël sa është, përmban gjithë këto kuptime.

Pastaj, për shkak të vërtetimit të këtij kuptimi, duke e mbyllur bisedën, thotë: **"Ai është All'llahu** (Një i Vetëm)**, i Plotfuqishmi dhe i Urti."**.

Forca dhe fuqia e mahnitshme e All'llahut e detyron hyrjen në shenjtërinë e hyjnisë së Tij dhe mençuria e Tij orienton këtë forcë drejt vendit të saj.

Zotërimi i këtyre cilësive është shenjë e domosdoshmëri për të ekzistuar gjërat. All'llahu i Madhëruar është i domosdoshëm në ekzistencë, është ekzistues i përhershëm, që nuk ka as fund dhe nuk e pranon numërimin. Nuk ka as rival e as ortak të ngjashëm, sepse çdo numërim, do të thotë kufizimi i fuqisë së Tij.

Hulumtim

Mënyra e nënshtrimit të zemrës

Ajo që vihet re më shumë, janë njerëzit e nderuar dhe me një standard diturie dhe njohurish, që nuk mund të hyjnë në mendjen e të tjerëve, për shkak të mosnjohjes së tyre të arteve speciale të kërkimit, argumentimit dhe mosruajtjes së anëve të tyre personale. E kundërta e një pjese tjetër, të cilët nuk kanë shumë dituri, por janë të suksesshëm nga ana e tërheqjes së zemrave, nënshtrimit të tyre dhe depërtimit në mendimet e të tjerëve.

Arsyeja kryesore e saj është se mënyra e kërkimit, e diskutimit dhe mënyra e sjelljes me palën përballë, duhet të jetë e shoqëruar me baza dhe rregulla që harmonizohen me moralin

dhe shpirtin, dhe nuk kërkon të gjejë anët negative në palën përballë, me qëllim që të mos nxisë kokëfortësi dhe këmbëngulje. Ruajtja e ekuilibrit personal do të çojë në zgjimin e ndjenjave të tij dhe tërheqjen e shpirtit të diskutimit për të vërtetën dhe ringjalljen e saj.

Është e rëndësishme të dimë, se njeriu nuk është se dorëzohet me mendje, logjikë dhe pastërti para fuqisë së argumentimit, por përveç asaj, një seri dhembshurish dhe ndjenjash, që formojnë njërën anë të rëndësishme të shpirtit të tij, janë të palosura në ekzistencën e tij, në qenien e tij. Këto duhet të trajtohen në mënyrë të rregullt dhe të logjikshme.

Kur'ani Famëlartë na ka mësuar mënyrën e diskutimeve logjike, me baza morale, me qëllim që të depërtohet në shpirtrat e të tjerëve.

Kushti i ndikimit dhe i depërtimit në shpirtin e palës përballë, është nxitja e ndjesisë së palës përballë, se folësi është i veshur me këto cilësi:

1- Besimtar në atë që thotë dhe ajo që ai thotë, buron nga thellësitë e tij.

2- Qëllimi i diskutimit të tij është kërkimi i të vërtetës dhe jo të tregojë përparësinë e tij dhe mendjemadhësi.

3- Ai nuk ka për qëllim përbuzjen e palës përballë dhe të ngrejë lart pozitën e vet.

4- Ai nuk ka asnjë interes personal në atë që thotë, madje ajo që ai thotë, buron nga sinqeriteti.

5- Ngjall respekt për palën përballë dhe flet me edukatë dhe delikatesë.

6- Nuk dëshiron të shkaktojë kokëfortësi te pala përballë, por mjaftohet me diskutimin e një teme, në masë të mjaftueshme, pa këmbëngulur se vërtetimi i të vërtetës është në anën e tij, që të kundërshtojë bisedën e tij.

7- I paanshëm, nuk abuzon kurrë me drejtësinë, edhe sikur pala tjetër përballë të mos kujdeset për këtë parim.

8- Nuk synon imponimin e mendimeve të veta te të tjerët, madje dëshiron të nxisë motivimin te të tjerët, derisa t'i çojë ata tek e vërteta, me kulmin e lirisë.

Korrektësia e pamasë në këto ajete dhe mënyra e sjelljes së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me urdhrin e All'llahut, me kundërshtarët, e shoqëruar me shumë gjeste të bukura, është argument i gjallë për atë që kemi përmendur, pasi ajo ndonjëherë arrin në një pikë që nuk tregon me përpikëri korrektësinë e të udhëzuarit dhe të humburit: **"Ne nuk mund të jemi që të dyja palët në Rrugën e Drejtë, ose ju, ose ne jemi në humbje të qartë!"**, derisa të ndikojë në intelektin e pyetësit për shenjat e udhëzimit apo të humbjes në secilin grup.

"Thuaju: 'Ne do të na mbledhë Zoti ynë e do të gjykojë ndërmjet nesh me drejtësi.'".

Nuk mund të mohohet se e gjithë kjo është për njerëzit që ngjallin shpresë në udhëzimin e tyre, ose në të kundërt, Kur'ani

sillet ashpër me armiqtë kokëfortë dhe zullumqarë, prej të cilëve, pranimi i saj nuk shpresohet në një mënyrë tjetër.[1]

Metoda e dialogëve të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe imamëve me kundërshtarët e tyre, përfaqëson një model të gjallë në këtë aspekt. Si shembull për këtë çështje, vëreni atë që thuhet nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Në fillim të librit të Teuhidit lexojmë: "Muhammedi, i biri Senanit ka thënë: "Më ka thënë Mufeddal ibn Omeri se një ditë, pas ikindisë, ishte ulur në një kopsht të begatë, mes varrit dhe minberit dhe po mendonte për atë që All'llahu i Lartësuar ka veçuar të nderuarin Muhammed, prej fisnikëve dhe të mirave. Çfarë i ka dhënë atij dhe e ka nderuar atë dhe të dashurit e tij. Një pjesë e ymetit nuk e di dhe e ka injoruar mirësinë dhe shkallën e lartë të tij. Kur isha në këtë gjendje, erdhi Ibn Ebi Auxhau, një ateist i njohur. Mufeddali tha : 'Nuk kisha në shpirt as urrejtje, as inat, as mllef'. I thashë: 'O armik i All'llahut, ti je bërë ateist në fenë e All'llahut dhe mohove Krijuesin që të ka krijuar ty në formën më të bukur, të ka formësuar ty në paraqitjen më të bukur, më të plotë dhe të ka larguar ty situatat, derisa ke ardhur këtu ku je. Sikur të mendosh mirë brenda vetes dhe sinqeritetit tënd, dhe ndjenjës tënde të butë, do të gjeje te vetja argumentet hyjnore, gjurmët e krijimit. Dëshmitë e All'llahut në krijimin tënd janë të qarta, kurse argumentet e Tij janë të listuara.'".

Ai tha: "O ti njeri, nëse je prej oratorëve, do të flasim me ty. Nëse vërtetohet argumenti yt, të ndjekim ty. Nëse nuk je prej tyre, atëherë nuk flasim fare me ty. Nëse je prej shokëve të Xhaferrit

1 Kemi diskutuar për këtë aspekt, te fundi i ajetit 46, të sures "El Ankebut".

ibn Muhammed Sadikut, a kështu na flet ti neve dhe nuk e vlerëson përgjigjen tonë? Ai është i duruari, i përmbajturi, i zgjuari e i maturi. Atij nuk i vishet dhuna, as rrëmbimi, as temperamenti i dobët. E dëgjon fjalën tonë, na dëgjon mirë dhe e pranon justifikimin tonë, derisa të vjellim atë që kemi brenda nesh. Justifikimi ynë hidhet poshtë me një fjalë të thjeshtë. Një bisedë e shkurtër na detyron ne justifikimin dhe e pret arsyen. Nuk mund t'i kthejmë atij përgjigje. Nëse je prej shokëve të tij, atëherë na fol siç fliste ai.".[1]

1 "Teuhidi" i Mufaddalit, fillimi i librit.

Ajetet 28 – 30

﴿وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِلنَّاسِ بَشِيرًا وَنَذِيرًا وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ٢٨ وَيَقُولُونَ مَتَى هَذَا الْوَعْدُ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ٢٩ قُلْ لَكُمْ مِيعَادُ يَوْمٍ لَا تَسْتَأْخِرُونَ عَنْهُ سَاعَةً وَلَا تَسْتَقْدِمُونَ٣٠﴾

"Ne të kemi dërguar ty (o Muhammed) **vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë."**

"Ata thonë: Kur do të vijë ky premtim (Ringjallja)**, nëse ju thoni të vërtetën?"**

"Thuaju atyre: Dita juaj tashmë është caktuar. Ju nuk do të mund ta shtyni atë e as ta shpejtoni, qoftë edhe për një çast."

Komentimi

Thirrja botërore

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë flet për profecinë e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse ajetet që vijnë pas, flasin rreth Ringjalljes. Duke marrë parasysh ajetet e mëparshme që folën për Teuhidin, atëherë jemi përballë një serie të plotë të hulumtimeve rreth doktrinës *(el akaidu)*. Kështu që këto hulumtime janë në përshtatje me të qënit e kësaj sureje prej sureve që kanë zbritur në Mekë.

Ajeti në fillim tregon për gjithëpërfshirjen e thirrjes së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe universalitetin e profecisë së tij për të gjithë njerëzit: **"Ne të kemi dërguar ty** (o Muhammed) **vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë."**.

Fjala *"kaffetun"* rrjedh nga fjala *"keffe"*, që do të thotë pëllëmba e dorës së njeriut. Meqenëse njeriu, herë i kap gjërat me pëllëmbë dhe herë i largon prej vetes me pëllëmbë, për këtë kjo fjalë përdoret ndonjëherë për kapjen, herë tjetër për largimin, ndalimin.

Komentuesit kanë supozuar këtu dy hipoteza: Kuptimi i parë është: të gjithë. Në këtë situatë, ajeti bëhet: "Ne të kemi dërguar për të gjithë njerëzit.". Domethënë universaliteti i thirrjes së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky kuptim përforcohet nga shumë

transmetime që janë përmendur në komentimin e ajetit nga të dy grupet.

Kështu që, përmbajtja e ajetit është e ngjashme me ajetin 1 të sures "El Furkan": **"I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët."**.

Po ashtu edhe përmbajtja e tij është e ngjashme me ajetin 19 të sures "El En'am": **"Ky Kur'an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet."**.

Komentuesit e Kur'anit transmetojnë një hadith nga Ibn Abasi për këtë ajet, se universaliteti i thirrjes së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është përmendur si një nga krenaritë e tij madhështore.

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Më janë dhënë pesë gjëra. Nuk e them për krenari, mburrje. Jam dërguar te i kuqi dhe i ziu. Toka më është bërë pastruese dhe xhami. Më është lejuar mua plaçka e luftës, gjë që nuk i është lejuar askujt para meje. Unë jam ndihmuar (kam marrë forcë) nëpërmjet frikës që është në zemrat e armiqve (dhe Zoti e shkuli frikën nga zemra jonë). Më është dhënë ndërmjetësimi dhe e kam ruajtur atë për ymetin tim në Ditën e Kiametit."*.[1]

Edhe nëse nuk është përmendur në hadithin e mësipërm ndonjë sqarim i komentimit të ajetit, ka hadithe të tjera për këtë çështje, të cilët ose flasin qartë për komentimin e ajetit, ose në ato

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 391.

transmetime përmendet shprehja "për të gjithë njerëzit", e cila është përmendur po në këtë ajet.[1]

Të gjitha ato argumentojnë se qëllimi i ajetit të mësipërm është universaliteti i thirrjes së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për ajetin është përmendur një komentim i marrë nga kuptimi i dytë i fjalës *"keffe"*, që është *"el men'u" - "ndalimi, frenimi"*. *S*ipas këtij komentimi, fjala *"kaffetun" - "për të gjithë"*, bëhet cilësi e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[2]

All'llahu i Madhëruar e ka dërguar të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për të gjithë njerëzit, si ndalues dhe frenues nga mohimi, kundërshtimi dhe mëkati. Komentimi i parë është më i afërt.

Ashtu si çdo njeri që ka natyrën, instinktin e tërheqjes së dobisë dhe largimit të së keqes, edhe i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka pasur pozitën e "përgëzimit" dhe të "paralajmërimit", me qëllim që t'i angazhojë këto dy instinkte dhe t'i vërë në lëvizje ato. Por shumica e të pavëmendshmëve injorantë, pa e hedhur shikimin te përfundimi i tyre, ngrihen për t'i kundërshtuar ato, i fshehin, i maskojnë ato dhurata të mëdha hyjnore.

Në bazë të asaj se çfarë kanë treguar ajetet e mëparshme, All'llahu i Madhëruar i tubon njerëzit dhe do të gjykojë mes tyre.

---

1 Shiko tefsirin "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 255-256.

2 Ndonjëherë *"ta-ja"* e shoqëron emrin e subjektit, për t'i dhënë nuanca zmadhuese dhe jo si shenjë e gjinis*ë* femërores, ashtu si në "transmetim" .

Ky ajet na përmend pyetjen e mohuesve të Kiametit: **"Ata thonë: Kur do të vijë ky premtim** (Ringjallja)**, nëse ju thoni të vërtetën?"**.

Kjo pyetje është shtruar shpesh nga ana e mohuesve të Ringjalljes ndaj të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo Profetëve të tjerë, në kohën kur kuptohej. Kuptimi i kësaj kërkese, në pjesën më të madhe të tyre, ishte tallje dhe përbuzje: Ku është ky Kiameti, që ju mbështeteni shumë, që e përmendni vazhdimisht atë? Nëse është i vërtetë, atëherë na thoni ju, se kur do të vijë. Njeriu i sinqertë, në lajmërimin e tij, duhet t'i dijë të gjitha detajet e temës për të cilën ai lajmëron.

Mirëpo Kur'ani Famëlartë frenohet gjithmonë për të dhënë një përgjigje të qartë për këtë pyetje, për përcaktimin kohës së ndodhisë së Ringjalljes. Ai thotë se këto çështje janë nga dituria e All'llahut të Madhëruar. Askush tjetër veç All'llahut të Lartësuar nuk ka dijeni për të.

Prandaj ajeti që vjen pas, ka përsëritur këtë kuptim me një shprehje tjetër: **"Thuaju atyre: Dita juaj tashmë është caktuar. Ju nuk do të mund ta shtyni atë e as ta shpejtoni, qoftë edhe për një çast."**.

Pa dyshim se fshehja e kronologjisë së Kiametit (Ringjalljes), deri edhe për vetë të Dërguarit më të nderuar, siç e kemi thënë më parë, është sepse All'llahu i Madhëruar ka dashur për robtë e Tij një lloj lirie veprimi, e shoqëruar me një situatë përgatitjeje të përhershme. Sikur data e ndodhisë së Kiametit të dihej, atëherë nuk ka asnjë dyshim se të gjithë do të bëhen të

pavëmendshëm dhe do të binin në kryeneçësi dhe injorancë, kur të jetë larg prej tyre. Ndërsa, kur ndodhia e Kiametit u afrohet atyre, atëherë punët e tyre do të kenë një anë detyrimi. Në të dy rastet ka qëllime edukimi për njeriun. Për këtë, koha e Kiametit është e fshehtë, ashtu siç është situata për Natën e Kadrit, nata më e mirë se njëmijë muaj, apo historia e daljes së Mehdiut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ky kuptim është përmendur në ajetin 15 të sures "Ta ha": **"Ora** (e Kiametit) **do të vijë me siguri, por Unë e mbaj tepër të fshehur, që secili të shpërblehet për atë që ka bërë."**.

Për sa u përket atyre që mendojnë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duhet të ketë dijeni për datën e saktë të Ditës së Kiametit, sepse ai lajmërohet për të, atëherë nuk ka asnjë dyshim se ai është kulmi i dyshimit dhe një argument i mosnjohjes së tyre me detyrën e profecisë, pasi Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i ngarkuar me përcjelljen e mesazhit, me përgëzim dhe paralajmërim. Çështja e Kiametit është e lidhur me All'llahun e Madhëruar. Ai është i vetmi që i di plotësisht detajet e tij. Atë që All'llahu e ka parë të nevojshme për qëllimet e edukimit, ia ka lexuar të Dërguarit të nderuar, Muhammedit *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Këtu lind një pyetje: Kur'ani Famëlartë i kërcënon kundërshtuesit: **"Ju nuk do të mund ta shtyni atë e as ta shpejtoni, qoftë edhe për një çast."**. Cili është qëllimi i këtij kërcënimi?

Për t'u përgjigjur, duhet të kthejmë shikimin në dy pika:

Pika e parë: Përmendja e atyre të dyjave së bashku tregon sigurinë dhe saktësinë e kronologjisë së çdo çështjeje. Njësoj kur thonë: "Filani është i prerë në orar, nuk vjen as para, as me vonesë.".

Pika e dytë: Një grup jobesimtarësh kokëfortë këmbëngulnin gjithmonë ndaj Profetëve, duke i pyetur se përse nuk vjen Kiameti. E thënë me një shprehje tjetër: Ata e kërkonin përshpejtimin e kësaj çështjeje, qoftë për tallje, apo për diçka tjetër. Kur'ani u thotë atyre të mos nxitohen se data e asaj dite është vetë ajo që e ka vendosur All'llahu i Madhëruar.

Ajetet 31 – 33

﴿وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَنْ نُؤْمِنَ بِهَذَا الْقُرْآنِ وَلَا بِالَّذِى بَيْنَ يَدَيْهِ وَلَوْ تَرَى إِذِ الظَّالِمُونَ مَوْقُوفُونَ عِنْدَ رَبِّهِمْ يَرْجِعُ بَعْضُهُمْ إِلَى بَعْضٍ الْقَوْلَ يَقُولُ الَّذِينَ اسْتُضْعِفُوا لِلَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا لَوْلَا أَنْتُمْ لَكُنَّا مُؤْمِنِينَ٣١ قَالَ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا لِلَّذِينَ اسْتُضْعِفُوا أَنَحْنُ صَدَدْنَاكُمْ عَنِ الْهُدَى بَعْدَ إِذْ جَاءَكُمْ بَلْ كُنْتُمْ مُجْرِمِينَ٣٢ وَقَالَ الَّذِينَ اسْتُضْعِفُوا لِلَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا بَلْ مَكْرُ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ إِذْ تَأْمُرُونَنَا أَنْ نَكْفُرَ بِاللَّهِ وَنَجْعَلَ لَهُ أَنْدَادًا وَأَسَرُّوا النَّدَامَةَ لَمَّا رَأَوُا الْعَذَابَ وَجَعَلْنَا الْأَغْلَالَ فِي أَعْنَاقِ الَّذِينَ كَفَرُوا هَلْ يُجْزَوْنَ إِلَّا مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ٣٣﴾

"Ata që nuk besojnë, thonë: 'Ne nuk do të besojmë kurrsesi në këtë Kur'an, as në ato që janë zbritur para tij'. Eh, sikur t'i shihje keqbërësit duke dalë para Zotit të tyre dhe duke shkëmbyer akuza me njëri-tjetrin. Të dobëtit do t'u thonë atyre që madhështoheshin: 'Sikur të mos ishit ju, ne do të ishim besimtarë.'"

"Ata që madhështoheshin, do t'u thonë atyre që i quanin për të dobët: 'Vallë, ne ju penguam nga udhëzimi i All'llahut, kur ju erdhi juve?! Jo, por ju jeni keqbërës.'"

"Ndërsa të dobëtit do t'u thonë atyre që madhështoheshin: 'Nuk është kështu! Ju keni komplotuar natë e ditë, duke na urdhëruar, që ta mohonim All'llahun dhe t'i vishnim Atij (zota të tjerë) **të barabartë me Atë'. Dhe ata do ta fshehin pikëllimin, kur ta shohin dënimin. Ne do të vëmë vargonj në qafat e atyre që mohuan. A do të ndëshkohen ndryshe, veçse sipas asaj që kanë bërë?"**

Komentimi

Ajetet e mëparshme kanë pasqyruar qëndrimet e idhujtarëve ndaj çështjes së Ringjalljes. Këto ajete përshkruajnë disa nga pjesët e dhimbshme të Ringjalljes për këta idhujtarë, si rrjedhim i veprimeve të tyre.

All'llahu i Lartësuar, në fillim të ajetit 31, tregon mendimin e tyre: **"Ata që nuk besojnë, thonë: Ne nuk do të besojmë kurrsesi në këtë Kur'an, as në ato që janë zbritur para tij."**, domethënë, as librat e mëparshëm qiellorë.

Fjala *"len"* - *"nuk"* tregon mohimin e përhershëm. Me këtë fjalë, ata dëshirojnë t'i thonë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se, sikur ti të qëndrosh deri në pafundësi, duke na ftuar neve të besojmë, ne kurrë nuk do të të besojmë ty. Ky është një argument i kokëfortësisë së tyre. Ata ngulën këmbë në qëndrimin e tyre të përhershëm, në kohën kur dikush kërkon të vërtetën dhe përpiqet

ta gjejë atë. Nëse ai nuk bindet me një argument çfarëdo, ai nuk mund t'i mohojë të gjitha argumentet e mundshme që mund të shfaqen në të ardhmen, para se t'i dëgjojë ato dhe të thotë se i refuzoj të gjitha argumentet e tjera.

Mirëpo çfarë nënkuptohen me sifjalinë: **"Ata që nuk besuan."**? Një pjesë e komentuesve kanë treguar se ata janë idhujtarët. Disa të tjerë kanë thënë se janë çifutët dhe ithtarët e Librit. Kontekstet e përmendura në ajetet pasuese, të cilat flasin për shirkun (vënies ortak All'llahut), na argumentojnë se kjo sifjali tregon për idhujtarët.

Sifjalia: **"as në ato që janë zbritur para tij"**, tregon për librat qiellorë që u kanë zbritur Profetëve të mëparshëm, para Kur'anit. Kjo sifjali është përmendur në shumë ajete kur'anore, duke na treguar për këtë kuptim, sidomos pas përmendjes së Kur'anit.

Një pjesë tjetër e komentuesve mendon se kjo sifjali tregon Ringjalljen apo përmbajtjen e Kur'anit. Ky mendim duket shumë larg kuptimit bazë të ajetit.

Megjithatë, ajeti ka mundësi të tregojë mohimin e besimit në librat e Profetëve të mëparshëm, mohimin e profecisë së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nëpërmjet mohimit të librave të tjerë qiellorë, duke marrë në konsideratë se Kur'ani e ka miratuar në Teurat dhe Ungjill, temën e përmendjes së argumenteve ndaj profecisë së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo është arsyeja që ata thonë se nuk besojnë as këtë libër dhe as librat që kanë qenë para tij.

Biseda zhvendoset rreth situatës së tyre në Kiamet, nëpërmjet bisedës së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: All'llahu i Madhëruar thotë: **"Eh, sikur t'i shihje të padrejtët duke dalë para Zotit të tyre dhe duke shkëmbyer akuza me njëri-tjetrin."**.

Edhe një herë tjetër, ajeti i mësipërm thekson se padrejtësia, zullumi më i madh është vënia ortak All'llahut dhe mohimi i Tij.

Togfjalëshi: **"Zotit të tyre"** tregon se ata do të qëndrojnë para zotëruesit të tyre dhe Zotit të tyre. Po sa shumë e turpshme është që njeriu të qëndrojë para atij që ai e ka mohuar, në kohën kur e gjithë qenia e tij është e mbuluar nga mirësitë e Tij.

"Të dobëtit", të cilët, me injorancën e tyre, ndoqën ata që **"madhështoheshin"**. Këta zgjodhën rrugën e kryeneçësisë, të autoritetit ndaj të tjerëve dhe ua përshkruan atyre metodën e tyre djallëzore. **"Të dobëtit"** u thonë këtyre: **"Sikur të mos ishit ju, ne do të ishim besimtarë."**.

Me këtë fjali ata duan që përgjegjësitë e gjynaheve të tyre t'ia hedhin në qafë kësaj "parie", edhe pse ata, me sjelljen e tyre, nuk kanë qenë të vendosur për të ndryshuar, sepse dobësia, përulja dhe përbuzja ishte mbizotëruese te ata, pasi kishin humbur lirinë e tyre. Atje, pasi të fshihen ato nocione shtresore, të cilat kanë qenë të përhapura në shtëpinë e dynjasë dhe zbulohen rezultatet e veprave të të gjithëve, atëherë ata qëndrojnë ballë për ballë këtyre, flasin qartë dhe mallkojnë njëri-tjetrin.

Mirëpo ata që madhështoheshin nuk qëndron gojëkyçur, por: **"Ata që madhështoheshin, do t'u thonë atyre që i quanin për të dobët: 'Vallë, ne ju penguam nga udhëzimi i All'llahut,**

kur ju erdhi juve?'". Jo, ne nuk jemi përgjegjës. Edhe pse zotëronit lirinë e veprimit, ju iu dorëzuat thënieve tona të pavërteta, mohuat dhe këmbëngulët duke harruar fjalët logjike të Profetëve: **"Jo, por ju jeni keqbërës."**.

Është e vërtetë se ata që madhështoheshin kanë bërë një gjynah të madh me cytjet e tyre. Mirëpo thënia e tyre, të cilën e përmend ajeti, ka një të vërtetë, gjithashtu, e cila është se lajkatarët nuk mund të rrinin e të bllokonin veshët, shikimet e tyre e të lëpiheshin pas tyre, por, gjithashtu, edhe ata kanë përgjegjësinë e gjynaheve të tyre.

Mirëpo, të dobëtit nuk ishin të bindur me këtë përgjigje dhe përsëritin fjalën për të vërtetuar krimin e parisë: **"Ndërsa të dobëtit do t'u thonë atyre që madhështoheshin: 'Nuk është kështu! Ju keni komplotuar natë e ditë, duke na urdhëruar, që ta mohonim All'llahun dhe t'i vishnim Atij** (zota të tjerë) **të barabartë me Atë.'"**.

Sigurisht, ju jeni ata që nuk hezituat të përhapnit helme dhe nuk latë pa shfrytëzuar asnjë rast, natë e ditë, për hir të realizimit të qëllimeve tuaja të përbuzura. Është e vërtetë se ne kemi qenë të lirë në pranimin e asaj dhe prandaj jemi neglizhues dhe mëkatarë, mirëpo duhet të konsideroni faktorin e shthurjes, pasi ju jeni përgjegjës dhe keqbërës. Ju keni vënë gurin e themelit për atë, sidomos kur bisedonit me ne, gjithmonë nga pozita e fuqisë dhe e autoritetit. (Fraza: **"duke na urdhëruar"**, është dëshmitare për këtë kuptim.)

Është e padiskutueshme se paria nuk ka ndonjë përgjigje për këtë fjalë dhe as nuk mund ta mohojë këtë krim të madh të tyre. Si rrjedhim, të dy grupet pendohen për atë që ka kaluar më

parë, paria për humbjen e të tjerëve, kurse të dobëtit për besimin dhe pranimin e atyre trillimeve të përbuzura. Me qëllim që të skandalizohen më shumë, ata e fshehin pendimin, kur përballen me dënimin e All'llahut: **"Dhe ata do ta fshehin pikëllimin, kur ta shohin dënimin. Ne do të vëmë vargonj në qafat e atyre që mohuan."**.

Megjithëse fshehja nuk bën dobi në Ditën e Zbulimit, edhe pse nuk është e mundur që të fshihet asgjë në atë Ditë, porse ata, sipas asaj që janë mësuar në dynja, imagjinojnë se mund ta fshehin gjendjen e tyre dhe të strehohen në të.

Ata, në dynja, kur e kthenin shikimin në dyshimet e tyre dhe pendoheshin, nuk kishin guxim për të shfaqur pendimin e tyre, që është rruga e parë e pendimit dhe e rikthimit të shikimit. Ajo është karakteristika morale e veçantë për ta, të cilën e praktikojnë në Ahiret. Mirëpo nuk ka asnjë dobi.

Disa komentues kanë supozuar se ajo fshehje mund të jetë për pendimin, për shkak të tmerrit të madh, kur shikojnë dënimin e All'llahut: mbërthimin e shpirtrave të tyre, lidhjen e gjuhëve të tyre, si rezultat i prangave me të cilat janë lidhur qafat e tyre, zinxhirët i kanë rrethuar, edhe pse lëshojnë ulërima në situata të tjera të Kiametit: **"Mjerë ne, me të vërtetë, kemi qenë të padrejtë."**.[1]

Disa të tjerë kanë thënë se fjala: *"eserr'rru"* është me kuptimin: *"shfaqni, zbuloni"*. Kjo shprehje përdoret për dy kuptime të kundërta në gjuhën arabe. Duke parë kuptimet me të cilat është përdorur kjo shprehje në Kur'an dhe në vende të tjera përveç

1 Sure "El Enbija", ajeti 14.

Kur'anit, ky kuptim duket i largët. Fjala *"sirrun"* zakonisht përdoret për të treguar të kundërtën e fjalës: *"el alunu"* - *"hapur, zbuluar"*. Ragibi e ka quajtur të dobët këtë kuptim, edhe pse një pjesë e gjuhëtarëve ka folur për të dyja kuptimet.[1]

Sido që të jetë, këta do të shohin rezultatet e veprave të tyre: **"A do të ndëshkohen ndryshe, veçse sipas asaj që kanë bërë?"**.

Vërtet, veprat dhe krimet e jobesimtarëve dhe të kriminelëve, janë shkaktarë që ata kanë pranga dhe zinxhirë rreth qafës, duarve dhe këmbëve të tyre, pasi në dynja kanë qenë të burgosurit e pasionit, të ambicies, të padrejtësisë dhe dëshirës për pozitë të lartë. Në Ditën e Kiametit, ku mishërohen veprat, ajo burgosje shfaqet me një formë tjetër. Ajeti na tregon, gjithashtu, për çështjen e mishërimit të veprave, për të cilat kemi folur shpesh: **"A do të ndëshkohen ndryshe, veçse sipas asaj që kanë bërë?"**. A ka shprehje më të qartë dhe më të gjallë se sa kjo shprehje që flet për mishërimin e veprave?

Ata që mohuan, mashtruesit dhe të mashtruarit e dobët, të gjithë jobesimtarët, marrin atë dënim. Nuk ka dyshim se përmendja e atij përshkrimi tregon se arsyeja e dënimit të tyre është vetëm mosbesimi i tyre.

1 Shiko "Lisanul Arab", fundi i lëndës "sirrun" , vëll. 4, f. 358. Atje ka një hulumtim të detajuar për këtë çështje edhe pse ka mospajtim mes dijetarëve dhe specialistëve të gjuhës .

Ajetet 34 – 38

﴿وَمَا أَرْسَلْنَا فِي قَرْيَةٍ مِنْ نَذِيرٍ إِلَّا قَالَ مُتْرَفُوهَا إِنَّا بِمَا أُرْسِلْتُمْ بِهِ كَافِرُونَ٣٤ وَقَالُوا نَحْنُ أَكْثَرُ أَمْوَالًا وَأَوْلَادًا وَمَا نَحْنُ بِمُعَذَّبِينَ٣٥ قُلْ إِنَّ رَبِّي يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَشَاءُ وَيَقْدِرُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ٣٦ وَمَا أَمْوَالُكُمْ وَلَا أَوْلَادُكُمْ بِالَّتِي تُقَرِّبُكُمْ عِنْدَنَا زُلْفَى إِلَّا مَنْ آمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَأُولَئِكَ لَهُمْ جَزَاءُ الضِّعْفِ بِمَا عَمِلُوا وَهُمْ فِي الْغُرُفَاتِ آمِنُونَ٣٧ وَالَّذِينَ يَسْعَوْنَ فِي آيَاتِنَا مُعَاجِزِينَ أُولَئِكَ فِي الْعَذَابِ مُحْضَرُونَ٣٨﴾

“Në çdo vendbanim që Ne kemi nisur ndonjë të Dërguar, ata që bënin jetë luksoze thoshin: ‘Me të vërtetë, ne nuk besojmë në mesazhin që keni sjellë!’”

“Dhe thanë: ‘Ne kemi më shumë pasuri dhe fëmijë, prandaj ne nuk do të jemi të dënuar.’”

“Thuaju: ‘Pa dyshim, Zoti im ia shton riskun ose ia pakëson kujt të dojë, por shumica e njerëzve nuk e dinë këtë.’”

“As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t’ju afrojnë më shumë te Ne, por vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira (e meritojnë këtë)**. Ata do të kenë shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë dhe do të jenë të sigurtë në banesa të larta** (në Xhennet)**.”**

"Ndërsa, ata që përpiqen t'i luftojnë Shpalljet Tona, ata do të dënohen."

Komentimi

Pasuritë dhe fëmijët nuk janë argument i të afruarit te All'llahu

Në ajetet e kaluara u fol për të humburit që madhështoheshin. Ajetet e mësipërme, pasqyrojnë një anë tjetër të këtij diskutimi. Ato e ngushëllojnë Profetin *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të mos habitet, nëse kundërshtarët e tij e kundërshtojnë, sepse ata që madhështohen i kanë kundërshtuar Profetët e të vërtetës. Ajeti 34 thotë: **"Në çdo vendbanim që Ne kemi nisur ndonjë të Dërguar, ata që bënin jetë luksoze thoshin: 'Me të vërtetë, ne nuk besojmë në mesazhin që keni sjellë.'"**.

Fjala: *"nedhirun"* rrjedh nga fjala *"indharun"*. Kuptimi i saj është: lajmërim brenda të cilit ka frikësim. Kjo fjalë na tregon se të Dërguarit e All'llahut i paralajmërojnë njerëzit nga dënimi i All'llahut përballë devijimeve, padrejtësive, gjynaheve dhe shthurjeve.

Fjala *"mutrefuha"* është shumësi i fjalës *"mutrifun"* dhe rrjedh nga fjala *"terefun"*, me kuptimin: *"begati e madhe, e gjerë"*.

Fjala: *"el mutrifu"* është ai i cili begatia dhe jetesa e mirë e prishin atë dhe e bën tiran, mizor.[1]

Ky grup pasanikësh të hutuar e mizorë, **së pari**, ishte në ballin e kundërshtarëve të Profetëve, sepse ata shikonin se mësimet e Profetëve përplaseshin me sigurinë dhe pasionet e tyre nga njëra anë, pasi Profetët mbronin të drejtat e të paprivilegjuarve, të cilat ua kishin marrë këta me dhunë.

Së dyti: Ata gjithmonë përdornin faktorin e autoritetit, për të mbrojtur interesat dhe pasuritë e tyre.

Së treti: Profetët qëndronin përballë tyre në të gjitha këto situata. Si rrjedhim, ata nxitojnë për të kundërshtuar Profetët.

E çuditshme është se ata nuk tregojnë ndonjë dispozitë apo një paragraf të veçantë për të kundërshtuar Profetët, madje ata menjëherë e me shpejtësi thoshin se nuk u besonin të gjitha atyre me të cilat ishin dërguar dhe nuk do të hidhnin as edhe një hap të vetëm bashkë me ta. Ky është argumenti më i qartë i kokëfortësisë dhe i mendjengushtësisë së tyre kundër të vërtetës.

Kur'ani, në ajete të ndryshme, ka zbuluar një çështje të rëndësishme, që të paprivilegjuarit janë të parët që i përgjigjen thirrjes së Profetëve, kurse ata që notojnë në luks, mirësi dhe kryeneçët, ngrenë lart flamurin e kundërshtimit.

Mohuesit e thirrjes së Profetëve nuk kufizohen vetëm me këtë grup. Në shumicën e rasteve, janë faktorët e parë të shthurjes, të shkatërrimit dhe ata që bëjnë thirrje në idhujtari dhe trillime, përpiqen gjithmonë të dhunojnë të tjerët, që të zgjedhin rrugën e

1 "Lisanul Arab", vëll. 9, f. 17.

tyre. Ky kuptim është përmendur në ajetet: ajeti 23, i sures "Ez Zuhruf", ajeti 116, i sures "Hud" dhe ajeti 33, i sures "El Mu'minun".

Ky grup nuk ka mbajtur këtë qëndrim vetëm përballë Profetëve, por përballë çdo hapi rregullues nga ana e çdo dijetari, punëmiri, apo mendimtari luftëtar, pasi ishin të parët në kundërshtim dhe nuk tërhiqeshin në kryerjen e çdo krimi apo kurthi kundër punëmirëve.

Ajeti 35 tregon për logjikën e thatë që kapnin këta, për të vërtetuar interesat e tyre dhe për të shfrytëzuar gjithçka: **"Dhe thanë: 'Ne kemi më shumë pasuri dhe fëmijë, prandaj ne nuk do të jemi të dënuar.'"**.

Ata thoshin se All'llahu na do, pasi Ai na ka dhënë ne shumë pasuri dhe fuqi njerëzore. Ky është një argument i mirësisë së Tij në të drejtën tonë dhe është tregues i pozitës sonë dhe vendit tonë tek Ai. Për këtë gjë ne nuk do të ndëshkohemi kurrë.

Nëse ne jemi të dëbuar nga mëshira e All'llahut, atëherë përse na ka dhuruar neve gjithë këtë pasuri? Përmbledhja e fjalëve të tyre është: Nuk ka asnjë dyshim se begatia e bollshme në dynjanë tonë, është një argument i qartë se të tillë do ta kemi edhe Ahiretin tonë.

Disa komentues të Kur'anit, kanë supozuar se fjala e tyre: **"...ne nuk do të jemi të dënuar."**, mund të jetë argument i mohimit të Kiametit dhe dënimit. Ajetet që vijnë më pas, argumentojnë mossynimin e këtij kuptimi, madje ajo që kuptohet, është afrimi me All'llahun, për shkak të pasurisë që ata kanë.

Ajeti 36 i kthen përgjigje në mënyrë të hollësishme kësaj logjike të thatë mashtruese dhe e shpërthen atë që në themel, nëpërmjet dialogut të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Thuaju: 'Pa dyshim, Zoti im ia shton riskun ose ia pakëson kujt të dojë, por shumica e njerëzve nuk e dinë këtë.'"**.

Nuk ka asnjë dyshim se Zoti i jep furnizim atij që do, edhe ia pakëson atij që do. Kjo është sipas interesave të lidhura me sprovimin e krijesave dhe rregullit të jetës së njeriut. Ajo nuk ka asnjë lidhje me pakësimin dhe pozitën e njeriut te All'llahu i Madhëruar.

Bazuar në këtë, shtimi i begatisë nuk duhet të konsiderohet një argument i lumturisë, kurse pakësimi i saj argument për vështirësinë: **"...por shumica e njerëzve nuk e dinë këtë."** Sigurisht shumica e injorantëve dhe ata që janë të pavëmendshëm, të hutuar, janë të tillë, sepse, në të kundërt, kjo çështje është e qartë për atë që di.

Më pas ajetet e vazhdojnë këtë kuptim me më shumë qartësi: **"As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t'ju afrojnë më shumë te Ne."**.[1] Ky dyshim i rrezikshëm përfshiu një pjesë të atyre që ishin naivë. Ata menduan se, përderisa ata vazhdojnë të jenë në dynja të paprivilegjuar, atëherë ata janë të zemëruar me pasanikët dhe të dëbuar nga mëshira e All'llahut, kurse këta pasanikë të kalbur në mirësi, janë të dashurit e pranuar tek Ai.

1 Fjalët: *"zulfa"* dhe *"zulfetun"* kanë kuptimin e pozitës dhe respektit (El Mufredatu i Rragib).

Sa shumë ishin të paprivilegjuarit që u sprovuan me këtë privim dhe morën shkallën më të lartë shpirtërore.

Ka shumë pasanikë, që pasuria dhe të mirat e tyre u bënë shqetësim për ta dhe shkak i dënimit të tyre.

Ajeti 15 i sures "Et Tegabun" e ka përmendur qartë këtë fakt: **"Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju. All'llahu ka shpërblim të madh."**.

Kjo nuk do të thotë se njeriu të nxitet për të lënë, për të hedhur pas shpine përgjegjësitë e tij. Qëllimi i këtij ajeti është të theksojë se çfarëdo përpjekje për të siguruar mundësi të mirë ekonomike dhe fuqi të mëdha njerëzore, nuk përfaqëson kurrë asnjë vlerë shpirtërore për njeriun tek All'llahu.

Ajeti trajton temën e vlerësimit të njerëzve dhe atë që shkakton afrimin e tyre me All'llahun e Madhëruar: **"...por vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira** (e meritojnë këtë)**. Ata do të kenë shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë dhe do të jenë të sigurt në banesa të larta** (në Xhennet)**."**.

Të gjitha vlerësimet rikthehen te këto dy çështje: besimi dhe vepra e mirë.

Ky vlerësim përfshin të gjithë njerëzit, në çdo vend, në çdo kohë dhe nga çdo shtresë apo grup qoftë.

Ndryshimi i pozitës së njerëzve para All'llahut është vetëm me kontrastin e shkallëve të besimit dhe të veprave të tyre të mira dhe asgjë tjetër përveç kësaj. Madje, edhe kërkimi i diturisë apo lidhja, shoqërimi me njerëz të mëdhenj, madje deri edhe me

Profetët, nëse nuk është i shoqëruar me këto dy çështje, nuk shton asgjë në vlerën e njeriut.

Këtu Kur'ani kritikon ashpër dhe qartë, e thotë me pastërti se standardi është vetëm në dy gjëra dhe çdo njeri mund t'i arrijë ato. Fuqitë dhe privilegjet materiale nuk kanë asnjë ndikim për të.

S'ka dyshim se pasuritë dhe fëmijët, nëse përballen me këtë përfundim, ngjyrosen me ngjyrën hyjnore dhe e pranojnë ngjyrën e besimit dhe të veprës së mirë, bëhen shkak për afrimin me All'llahun, kurse, nëse pasuria dhe fëmijët e largojnë njeriun nga All'llahu, bëhen për të statuja që adhurohen pos All'llahut dhe shkak i prishjes dhe i shkatërrimit, pasi ato janë forca tërheqëse të Xhehennemit.

Kur'ani Famëlartë thotë: **"O ju që keni besuar! Në të vërtetë, ju keni armiq në radhët e grave tuaja dhe të fëmijëve tuaj, andaj ruajuni prej tyre!"**.[1]

Fjala *"da'fun"* nuk është vetëm me kuptimin e *"shumimit të diçkaje dy herë"*, por me kuptimin *"shtohen shumëfish më shumë se dy herë"*. Në këtë ajet është përmendur me këtë kuptim, sepse ne e dimë se çdo punë e mirë llogaritet, me të paktën, dhjetëfish tek All'llahu: **"Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë dhe nuk do t'i bëhet kurrfarë padrejtësie."**.[2]

Fjala *"gurfatun"* është shumësi i fjalës *"gurfetun"*, që do të thotë dhomat e sipërme të ndërtesës. Këto dhoma, në shumicën e

1 Sure "Et Tegabun", ajeti 14.
2 Sure "El En'am", ajeti 160.

rasteve, ndriçimin dhe ajrosjen e kanë më të mirë. Zhurmat e jashtme nuk arrijnë deri lart, në këto dhoma. Kjo është arsyeja se pse Kur'ani e ka shprehur shkallën më të lartë në Xhennete me dhoma. Kjo shprehje vjen nga fjala *"garfun"*, njësoj si fjala *"bahrun"*, me kuptimin: ngritja lart e diçkaje dhe konsumimi i saj.

Mënyra e të shprehurit me fjalën *"ãminune"* për banorët e Xhennetit, është një shprehje e përgjithshme, që reflekton gjendjen e qetësisë shpirtërore dhe trupore të tyre nga të gjitha anët, pasi nuk ka asnjë frikë nga sulmi i armikut, apo sëmundje apo dhimbje. Nuk ka frikë edhe nga vetë frika. Nuk ka gjë më të shtrenjtë se sa kjo mirësi, që njeriu të jetë i sigurt nga çdo anë, pasi nuk ka shqetësim më të madh se sa ndjenja e mungesës së sigurisë në aspekte të ndryshme të jetës.

Ajeti 38 përshkruan grupin përballë këtyre. Ata që përpiqen të mposhtin argumentet e All'llahut, nuk besojnë dhe nuk i lejojnë të tjerët që të ecin në rrugën e besimit, por fantazojnë se mund të arratisen nga dora e fuqisë së All'llahut, këta do të marrin një dënim të dhimbshëm në Ditën e Kiametit: **"Ndërsa, ata që përpiqen t'i luftojnë Shpalljet Tona, ata do të dënohen."**.

Këta janë mbështetur te pasuritë dhe te numri i madh i fëmijëve, për të përgënjeshtruar Profetët. Ata kanë punuar që të mashtrojnë, të largojnë robtë e All'llahut. Kryeneçësia e tyre arriti deri në atë shkallë, sa imagjinuan se do të shpëtojnë nga kapja e dënimit hyjnor. Mirëpo, mjerë ata, përfundimi i tyre është në zemër të Xhehennemit.

Edhe pse fjalia: **"Ata do të dënohen"**, nuk ka diçka që të tregojë për kohën e ardhshme, mund të jetë tregues se ata janë të burgosur, të dënuar edhe në të tashmen. Cili dënim është më i

ashpër se sa ky burg, të cilin e kanë ndërtuar për veten e tyre me pasuritë dhe fëmijët e tyre?

Po kështu, supozohet se fjalia argumenton se premtimi i All'llahut është i padiskutueshëm për ta deri në atë shkallë sa mund të thuhet se ata janë aktualisht në të, siç është situata që tregohet me këtë fjali: **"Ata do të kenë shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë dhe do të jenë të sigurt në banesa të larta** (në Xhennet)**."**.

Sipas mendimit të disa profesorëve të gjuhës, kuptimi i fjalës "*muãxhizine*", është: Këta menduan se mund të largohen nga rrethi i fuqisë, i shpërblimit dhe i ndëshkimit të All'llahut të Madhëruar, por kjo fantazi e tyre është e kotë, e pavërtetë dhe një largim i mashtruar.[1]

Hulumtim

Kriteri vlerësimit

Prej çështjeve të rëndësishme në jetën e njerëzve dhe shoqërive, është çështja e kriterit të vlerësimit dhe të sistemit të vlerave. Këto pasqyrohen në kulturën e shoqërisë, sepse të gjitha

1 Kuptimi i fjalës "*muãxhizine*", të cilin e kemi marrë komentin e saj nga "El Mufredatu" i Rragib, është i ngjashëm me shprehjen "*mashtrojnë All'llahun dhe të Dërguarin e Tij*", të cilën e kemi trajtuar, kur kemi folur për komentimin e ajetit, 9 të sures "El Bekare".

lëvizjet që rrjedhin nga njerëzit dhe grupet, burojnë nga ky sistem, që synon krijimin e atyre vlerave.

Dyshimi i çdo kombi dhe populli në këtë çështje dhe trajtimi i vlerave boshe që nuk kanë asnjë bazë, mund të çojë në impresionizmin e kronologjisë së tyre me vulën e kryeneçësisë. Konceptimi, kuptimi i vlerave dhe kritereve të vërteta të vlerësimit, formojnë një bazë të fortë në ndërtimin e lumturisë njerëzore.

Skllevërit kryeneçë të dynjasë mendojnë se vlerat kufizohen, në: pasuri, fuqi materiale dhe numrin e madh të njerëzimit. Edhe vlerën para All'llahut, e shikojnë nga brenda kësaj kornize. Një model të saj e kemi vënë re në ajetet e mëparshme. Ka shumë modele, shembuj për këtë, që vihen re në Kur'anin Famëlartë.

Disa prej tyre janë:

1- Faraoni, mizori mendjemadh, që u thoshte atyre që kishte rrotull tij, se nuk besonte se - Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* është i dërguar nga All'llahu, pasi, nëse është i vërtetë në atë që thotë, atëherë përse All'llahu nuk i ka dhënë atij byzylykë floriri: **"Përse nuk i janë dhënë atij byzylykë ari? Përse nuk kanë ardhur bashkë me të engjëjt?"**.[1]

Ai, mungesën e tyre, e shikonte një argument të përbuzjes dhe të inferioritetit: **"Vallë, a nuk jam unë më i mirë se ky i mjerë, i cili mezi mund të shprehet?"**.[2]

1 Sure "Ez Zukhruf", ajeti 53.
2 Sure "Ez Zukhruf", ajeti 52.

2- Idhujtarët e kohës së mesazhit muhammedan, u habitën që Kur'ani i zbriti një burri të varfër, si Profetit Muhammed. Ata thanë: **"Sikur t'i kishte zbritur ky Kur'an ndonjë njeriu të madh prej njërit nga këto dy qytete!"**.[1]

3- Beni Israilët e kundërshtuan Profetin e kohës së tyre, Eshmuil, në çështjen e zgjedhjes së Talutit si komandant të ushtrisë: **"...ne kemi më tepër merita se ai për të sunduar?! Përveç kësaj, ai nuk ka ndonjë pasuri të madhe..."**.[2]

4- Idhujtarët e kohës së Nuhut *(Paqja qoftë mbi të!)*, të pasurit, e kundërshtuan, sepse atë e ndiqte shtresa e ulët e njerëzve: **"Ata thanë: Vallë, a të të besojmë ne ty, ndërkohë që ty po të pasojnë më të ulëtit?"**.[3]

5- Pasanikët e Mekës kanë paraqitur të njëjtin kundërshtim ndaj të Dërguarit të All'llahut. Ata thoshin se të Dërguarin e All'llahut e kanë rrethuar këmbëzbathurit dhe nuk e duronin dot erën e tyre. Ata nuk e ndiqnin atë, derisa t'i dëbonte ata nga vetja e tij. Por Kur'ani Famëlartë i përbuzi ashpër ata dhe i kërcënoi në suren "El Kehf". E urdhëroi të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të jetë me ata që e duan shumë All'llahun dhe e lusin atë mëngjes e mbrëmje, edhe pse janë fukarenj: **"Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën** (kënaqësinë) **e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata** (tek të tjerët)**..."**.[4]

---

1 Sure "Ez Zukhruf , ajeti 31.
2 Sure "El Bekare", ajeti 247.
3 Sure "Esh Shuara", ajeti 111.
4 Sure "El Kehf", ajeti 28.

Për këto shkaqe, puna e parë rregulluese që bënin Profetët ishte shkatërrimi i vlerave mashtruese dhe zëvendësimi i tyre me vlerat origjinale hyjnore dhe kryerja e "revolucionit kulturor". Ata e ndryshuan thelbin e personalitetit, boshti i të cilit ishte pasuria, fëmija, pasuria, prestigji, fama farefisnore dhe familjare, me devotshmërinë, besimin dhe punën e mirë.

Modeli i kësaj është përmendur në ajetet e mëparshme, duke mos e miratuar vlerën e pasurisë dhe të fëmijëve, si një metodë e afrimit te All'llahu i Lartësuar: **"As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t'ju afrojnë më shumë te Ne."**. Pas saj, dha menjëherë vlerat origjinale: **"...vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira."**.

Ajeti 18 i sures "El Huxhurat": **"Më i nderuari prej jush tek All'llahu është ai që i frikësohet më shumë Atij."**, që u bë një ndjenjë islame, pas largimit të vlerave të lidhura me fisin dhe rrethin shoqëror, na tregon për këtë revolucion ideologjik. Nuk ka asgjë përveç këtij kriteri, për vlerësimin e personalitetit të njeriut dhe afrimin e tij me All'llahun e Madhëruar: devotshmëri, besim i shoqëruar me ndjenja dhe përgjegjësi dhe vepra të mira. Çdokush që ka më tepër shans, do të jetë më afër dhe më i nderuar tek All'llahu.

Ajo që na tërheq vëmendjen, është se Gadishulli Arabik, para zbritjes së mësimeve të larta kur'anore të Islamit, ka qenë nën ndikimin e vlerave të padrejta, i nënshtruar ndaj pasanikëve dhe gënjeshtarëve, si: Ebu Sufjani, Ebu Xhehli dhe Ebu Lehebi. Pas revolucionit të vlerave njerëzore, u shfaq i njëjti rreth nga ai oqean, si: Ebu Dherri, Ammari dhe Mikdadi *(All'llahu qoftë i kënaqur me ta!)*.

E bukura është se Kur'ani Famëlartë, në suren "Ez Zukhruf", pas përmendjes së ajeteve që i përmendëm pak më parë, në ajetet 33-35, thotë: **"Dhe, sikur njerëzit të mos ishin një bashkësi mohuesish, Ne do t'i bënim prej argjendi çatitë e shtëpive të atyre që nuk besojnë në të Gjithëmëshirshmin, madje edhe shkallët nëpër të cilat ngjiten, edhe dyert e shtëpive të tyre, edhe divanet në të cilat mbështeten, dhe** (do t'u jepnim) **stoli prej ari. Por të gjitha këto janë vetëm kënaqësi të kësaj jete, kurse Jeta Tjetër te Zoti yt është për punëdrejtët që ruhen** (nga gjynahet dhe nga dënimi i All'llahut)**."**.

E gjithë kjo theksohet, me qëllim që vlerat e falsifikuara të mos zënë vendin e vlerave të vërteta njerëzore.

Ajetet 39 – 42

﴿قُلْ إِنَّ رَبِّي يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ وَيَقْدِرُ لَهُ وَمَا أَنْفَقْتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَهُوَ يُخْلِفُهُ وَهُوَ خَيْرُ الرَّازِقِينَ٣٩ وَيَوْمَ يَحْشُرُهُمْ جَمِيعًا ثُمَّ يَقُولُ لِلْمَلَائِكَةِ أَهَؤُلَاءِ إِيَّاكُمْ كَانُوا يَعْبُدُونَ٤٠ قَالُوا سُبْحَانَكَ أَنْتَ وَلِيُّنَا مِنْ دُونِهِمْ بَلْ كَانُوا يَعْبُدُونَ الْجِنَّ أَكْثَرُهُمْ بِهِمْ مُؤْمِنُونَ٤١ فَالْيَوْمَ لَا يَمْلِكُ بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ نَفْعًا وَلَا ضَرًّا وَنَقُولُ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا ذُوقُوا عَذَابَ النَّارِ الَّتِي كُنْتُمْ بِهَا تُكَذِّبُونَ٤٢﴾

"Thuaj: Me të vërtetë, Zoti im i jep begati të bollshme kujt të dojë nga robtë e Tij dhe ia pakëson kujt të dojë. Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i mirë."

"Ditën, kur do t'i tubojë të gjithë, do t'u thotë engjëjve: 'Vallë, këta juve ju adhuronin?'"

"Ata do të thonë: Qofsh i lavdëruar Ti, o Zoti ynë! Ti je Mbrojtësi ynë, jo ata. Ata adhuronin xhindët dhe shumica e mohuesve u besonin atyre."

"Atë Ditë ata nuk do të mund t'i bëjnë as dobi, as dëm njëri-tjetrit. Ne do t'u themi atyre që bënë padrejtësi: 'Shijoni dënimin e zjarrit të cilin e keni mohuar!'"

Komentimi

Largimi i adhuruesve nga të adhuruarit e tyre

Këto ajete rikthehen për të miratuar edhe një herë, gabimin tjetër të atyre që fantazojnë se pasuritë dhe fëmijët e tyre janë shkaku i afrimit me All'llahun: **"Thuaj: 'Me të vërtetë, Zoti im i jep begati të bollshme kujt të dojë nga robtë e Tij dhe ia pakëson kujt të dojë. Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i mirë.'"**.

Edhe pse përmbajtja e këtij ajeti miraton dhe përforcon atë që kanë paraqitur ajetet e mëparshme, por vetëm se këtu ka diçka të re në të dy anët:

Së pari: Ajeti i mëparshëm, që paraqiti të njëjtën ide, ka folur për pasuritë dhe fëmijët e jobesimtarëve, kurse ajeti që po komentojmë, ka në përmbajtje të tij fjalën "*ibadun*" - "*robtë*", duke folur për besimtarët. Kuptimi është se edhe kur bëhet fjalë për besimtarët, All'llahu mund t'ua shtojë furnizimin, sepse kjo është më e dobishme për besimtarët, po ashtu mund t'ua ngushtojë e pakësojë furnizimin, sepse interesi e kërkon atë. Megjithatë, shtimi dhe pakësimi i furnizimit nuk mund të formojë asnjë argument për asgjë.

Së dyti: Ajeti i mëparshëm ka folur për furnizimin e bollshëm dhe pakësimin e tij për dy grupe të ndryshme. Ky ajet na flet për dy situata të ndryshme, në lidhje me një person të vetëm, kur ia shton dhe kur ia pakëson atij furnizimin.

Në shtesë të kësaj, ajo që është në fillim të këtij ajeti, në të vërtetë, është parahyrje e asaj që vjen në fund të tij, që është dëshira për të shpenzuar në rrugë të All'llahut.

Fjalia: **"Ai ua zëvendëson atë"**, është një shprehje e bukur dhe tregon se ajo që shpenzohet në Rrugë të All'llahut, ka fitim të madh, sepse All'llahu i Madhëruar ka premtuar se do ta zëvendësojë atë. Ne e dimë se, kur All'llahu e premton atë, me zëvendësin, pa asnjë dyshim se ai nuk e shikon masën me të cilën do ta zëvendësojë atë, por Ai e zëvendëson atë disa herë më shumë, madje me njëqindfish.

Sigurisht, ky premtim i All'llahut nuk kufizohet me Ahiretin, sepse ajo është e padiskutueshme, por edhe në dynja e zëvendëson atë që ka shpenzuar në Rrugë të Tij me begati të ndryshme.

Fjalia: **"Ai është Dhuruesi më i mirë."**, ka një kuptim të gjerë dhe me të mund të përfitohet në shumë drejtime.

All'llahu është i miri që jep begati, furnizim, sepse Ai e di se çfarë jep dhe deri ku i jep, aq sa ajo që Ai i jep, të mos bëhet faktor i shthurjes dhe i kryeneçësisë, sepse Ai di çdo gjë. All'llahu jep çdo gjë që dëshiron të japë, sepse Ai është i fuqishëm për çdo gjë.

All'llahu nuk dëshiron shpërblim për atë që jep, sepse Ai është vetë i Pasuri. All'llahu jep në fillim, sepse Ai është i Mençuri dhe i Dijshëm për çdo gjë. Madje e vërteta është se nuk ka furnizues, begatues si All'llahu, sepse çdo dhurues jep nga ajo që Ai e ka furnizuar atë, si rrjedhim, ai nuk është veç "një mjet transporti" e jo furnizues.

All'llahu i Madhëruar jep begatitë e përhershme përballë pasurisë së kufizuar dhe shumicën, përballë pakicës.

Një grup pasanikësh zullumqarë e mizorë ishin në radhët e idhujtarëve dhe pohuan se ata adhurojnë engjëjt, sepse ata janë ndërmjetësit e tyre në Ditën e Kiametit. Kur'ani iu përgjigj këtij pohimi të pavërtetë dhe tha: **"Ditën, kur do t'i tubojë të gjithë, do t'u thotë engjëjve: 'Vallë, këta juve ju adhuronin?'"**.

Është e padiskutueshme se kjo pyetje nuk është në kapitullin pyetje-përgjigje, sepse All'llahu i Lartësuar është i dijshëm për çdo gjë. Synimi i kësaj pyetjeje është që të shfaqen qartë të vërtetat nga përgjigjja e engjëjve, me qëllim që këta të humbur të largohen dhe mendimet e tyre dhe të dështojnë. Ata ta dinë mirë se engjëjt janë të frikësuar për punët e tyre. Ata i godet dëshpërimi deri në pafundësi.

Përmendja e engjëjve në mesin e krijesave që idhujtarët adhuronin, mund të jetë, sepse engjëjt janë krijesat më fisnike që ata të humbur kanë adhuruar dhe dëshirojnë të marrin ndërmjetësimin e tyre në Ditën e Kiametit. Atëherë, çfarë mund të arrijnë prej një grushti gurësh, drurësh apo xhindësh dhe shejtanësh?!

Mos ndoshta përmendja e engjëjve bëhet për arsyen se adhuruesit e idhujve besonin se gurët dhe drurët janë një panoramë dhe model i krijesave të larta (si, engjujt dhe shpirtrat e Profetëve), dhe prandaj i kanë adhuruar ato. Në historinë e paganizmit tek arabët thuhet se shkaku i adhurimit të statujave te arabët është: Amër ibn Lahij[1] kishte kaluar pranë një populli në

1 Amër ibn Lahij: një nga personalitetet e njohura në Mekë, para Islamit.

Sham dhe i kishte parë ata të adhuronin statujat. Ai i kishte pyetur ata. Ata ishin përgjigjur se këta janë zota që i kanë marrë në strukturën më të lartë dhe u kërkojnë ndihmë, u kërkojnë ujë për të pirë. Amër ibn Lahij i ndoqi ata dhe solli me vete një statujë në Hixhaz. Arabët u joshën dhe e adhuruan atë. Adhurimi i statujave në mesin e tyre vazhdoi derisa erdhi Islami.[1]

Tani le të shikojmë se çfarë thonë engjëjt në përgjigjen e pyetjes së Krijuesit.

Engjëjt zgjodhën përgjigjen më gjithëpërfshirëse dhe me kulturën më madhështore: **"Ata do të thonë: 'Qofsh i lavdëruar Ti, o Zoti ynë! Ti je Mbrojtësi ynë, jo ata. Ata adhuronin xhindët dhe shumica e mohuesve u besonin atyre.'"**.

Çfarë synohet nga përgjigjja që dhanë engjëjt? Komentuesit kanë shumë mendime. Mendimi më i afërt është: Qëllimi me fjalën xhind është për shejtanin dhe të gjitha krijesat e pista që kanë nxitur adhuruesit e putave në adhurim, duke ua zbukuruar shikimin atyre, prandaj synimi me adhuruesit e xhindëve janë bindja ndaj urdhëresave të tyre.

Atëherë, engjëjt, duke lajmëruar frikën dhe pakënaqësinë e tyre për këto vepra, thonë se faktori kryesor i këtij shkatërrimi janë shejtanët, edhe pse në dukje ata na adhurojnë ne. E rëndësishme është zbulimi i fytyrës së vërtetë të kësaj pune para masës së njerëzve.

1 Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 22, f. 140. Ky kuptim përmendet me një ndryshim të lehtë në historinë e Ibn Hishamit, vëll. 1 f. 79. Atje lexojmë se ai mori me vete statujën Hebel .

I njëjti kuptim i këtij ajeti, përmendet në ajetin 28 të sures "Junus": **"Ditën, kur do t'i tubojmë të gjithë, do t'u themi idhujtarëve: 'Rrini në vendet tuaja ju dhe idhujt tuaj!' Pastaj do t'i ndajmë ata dhe idhujt e tyre do të thonë: 'Ju nuk na keni adhuruar neve.'"**.

Ju nuk na keni adhuruar ne, por keni adhuruar dëshirat, mendjet dhe imagjinatat tuaja, pa përmendur se ky adhurim nuk ishte me urdhrin dhe kënaqësinë tonë. Ky adhurim, forma e tij, nuk është një adhurim i vërtetë. Me këtë mënyrë, zëvendësohet shpresa e idhujtarëve në atë ditë, me një dëshpërim të plotë. Atyre u bëhet e qartë një e vërtetë: Me adhurimin e tyre nuk do të zgjidhin as nyjën më të vogël të problemeve të tyre, por e kundërta, ata janë të larguar prej tyre të indinjuar.

Prandaj, si një përmbledhje e rezultatit, ajeti 42, thotë: **"Atë Ditë ata nuk do të mund t'i bëjnë as dobi, as dëm njëri-tjetrit."**.

Në bazë të kësaj, as engjëjt, që ata adhurojnë, nuk mund të ndërmjetësojnë për ta dhe as nuk mund të ndihmojnë njëri-tjetrin.

"Ne do t'u themi që bënë padrejtësi: 'Shijoni dënimin e zjarrit të cilin e keni mohuar!'".

Nuk është hera e parë që Kur'ani shprehet në këtë mënyrë për idhujtarët, me "padrejtësi", por është përmendur në shumë ajete kur'anore.

Bashkëshoqërimi i fjalës "mohim" me padrejtësi për "jobesimtarët dhe idhujtarët" me "zullumqarë", bëhet se ata, para së gjithash, i bënë padrejtësi vetes së tyre. Ata, duke hequr nga koka e tyre kurorën e adhurimit të All'llahut, u rrethuan me

litarin e poshtërsisë së putave në qafat e tyre. Shkatërruan personalitetin e tyre dhe fundin e tyre. Ata do të ndëshkohen në Ditën e Kiametit për idhujtarinë dhe për mohimin e tyre të Kiametit. Fjalia: **"Ne do t'u themi atyre që bënë padrejtësi: 'Shijoni dënimin e zjarrit të cilin e keni mohuar!'"**, i përfshin të dyja kuptimet.

Hulumtime

1- Shpenzimi në Rrugë të All'llahut është shkak i shtimit dhe jo i pakësimit

Shprehja që përmendet në ajetin e mëparshëm, përmban disa kuptime:

Kuptimi i parë: Kuptimi i gjerë i fjalës *"shejun" - "diçka"*, përfshin të gjitha llojet e shpenzimit, material dhe shpirtëror, të paktë dhe të shumtë, për çdo nevojtar, që shpenzimi ka qenë i vogël apo i madh. E rëndësishme është që njeriu të japë diçka nga ajo që ka në Rrugë të All'llahut, me çdo mënyrë qoftë dhe me çdo sasi.

Kuptimi i dytë: Ajeti e ka nxjerrë shpenzimin, nga nocioni i tij i "mbarimit" dhe e ka ngjyrosur atë me ngjyrën e "përjetësisë", sepse All'llahu ka siguruar zëvendësimin e asaj që shpenzohet në Rrugën e Tij, me dhuratat e Tij materiale dhe shpirtërore, me disa herë shumëfish, qindra e mijëra. Më e pakta e

saj është dhjetëfish. Pa dyshim se ai që shpenzon, me këtë shpirt dhe besim, do të hyjë në sheshin e shpenzimit me dorë në zemër, më shumë mendjehapur. Nuk do ta shqetësojë fare ndjesia e pakësimit dhe nuk do të mendojë për varfëri, madje ai do ta falënderojë All'llahun për suksesin e tij të mirë që i ka dhënë për këtë tregti me fitim të madh.

Në ajetet 10-11 të sures "Saff", Kur'ani është shprehur: **"O ju që keni besuar, a doni t'ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm?! Besoni në All'llahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në Rrugën e All'llahut me pasurinë dhe trupin tuaj. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju."**.

Në hadithin e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "Çdo natë, një thirrës thërret: 'Përleshuni me vdekjen!'

Një thirrës tjetër, thërret: 'Mbillni shkatërrimin!'

Tjetri thërret: 'O All'llah, jepi kompensim atij që shpenzon në rrugën Tënde!'

Një thirrës i katërt thërret: 'O All'llah, jepi koprracit shkatërrim, dëme!'

Një thirrës i pestë thërret: 'Ah, sikur njerëzit të mos ishin krijuar!'

Thirrësi i gjashtë thërret: 'Ah, sikur ta dinë ata që u krijuan dhe të mendojnë thellë për atë që janë krijuar!'".[1]

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Fjala "thirrës", në këtë hadith, nënkupton engjëjt, të cilët kontrollojnë çështjet e kësaj bote me urdhrin e All'llahut.

Në një hadith tjetër nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Kush është i bindur për kompensimin, e ka ngarkuar veten e tij me shpenzim."*.[1]

I njëjti kuptim është përmendur nga transmetimet e dy imamëve, Imam Bakirit dhe Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Ajo që meriton të përmendet, është se shpenzimi duhet të jetë nga pasuria hallall (e lejuar) dhe nga fitimi i ligjshëm. Në të kundërt, nuk i pranohet askujt tek All'llahu dhe nuk ka begati në të.

Po japim një dialog midis Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe një personi, për këtë çështje: Dikush e ka pyetur Imam Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Po kërkoj dy ajetet në librin e All'llahut, por nuk po i gjej."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Cilat janë ato ajete?"*

Personi i tha: "Fjala e All'llahut: **'M'u lutni Mua, që t'ju përgjigjem.'** Ne i lutemi Atij, por nuk vjen ndonjë përgjigje."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* e pyeti: *"A mendon ti se All'llahu e ka thyer premtimin e Tij?"*

Personi u përgjigj: "Jo."

1 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 340.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* e pyeti: *"Po nga të erdhi kjo ide?"*

Personi u përgjigj: "Nuk e di."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Unë të them ty, se, kush i bindet All'llahut në atë që Ai ka urdhëruar në lutjen e tij nga balli i duasë, Ai i përgjigjet atij."*

Personi e pyeti: "Çfarë është balli i duasë?"

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* u përgjigj: *"Falëndero All'llahun dhe përmend mirësitë e Tij tek ti, pastaj e falënderon Atë dhe thua salavate për Profetin Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), pastaj përmend gjynahet e tua dhe i pranon ato me gojë, pastaj kërkon ndihmën ndaj tyre, të ruhesh prej tyre. Ky është balli i duasë."*

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* e pyeti: *"Cili është ajeti tjetër?"*

Personi u përgjigj: "Fjala e All'llahut: **'Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i mirë.'** Unë jap, por nuk shoh zëvendësim."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* e pyeti: *"A mendon se All'llahu nuk e ka mbajtur premtimin e Tij?"*

Personi u përgjigj: "Jo."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* e pyeti: *"Po pse, e thua atë?"*

Personi u përgjigj: "Nuk e di."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Nëse njëri prej jush e fiton pasurinë e tij hallall dhe e jep atë në hallall, All'llahu ia zëvendëson atij çdo derhem që ai jep."*.[1]

2- Sigurojini pasuritë tuaja me garanci hyjnore

Një komentues i Kur'anit ka një analizë të bukur në lidhje me këtë. Ai thotë: "Është e çuditshme se si tregtari, nëse e mëson se një pjesë e pasurisë së tij është në prag të prishjes, e shet atë me kredi, qoftë edhe fukarenjve. Ai thotë se kjo shitje është më e vlefshme se shpërdorimi i prishjes së pasurisë. Nëse nuk e shet, derisa pa u prishur, ia vë shkakun gabimit. Nëse i ndodh që të marrë një garanci të plotë dhe nuk e shet, ia lë shkakun mendjes së shkurtër. Nëse i ndodh ta lërë peng dhe të shkruajë një dokument dhe nuk e shet atë, ia lë shkakun budallallëkut, pastaj çdokush e bën këtë dhe nuk e di se ajo është afër çmendurisë. Të gjitha pasuritë tona janë në prag të shkatërrimit të vërtetë, kurse shpenzimi për familjen dhe fëmijën është borxh dhe All'llahu i Lartësuar, garantuesi i plotë, ka bërë: **'Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju.'**. Pastaj lë peng te secili, ose një tokë, ose një kopsht, ose një mulli drithi, ose një banjë apo një interes.

Njeriu duhet të ketë patjetër një cilësi apo një anë, që të përfitojë pasuri prej saj. E gjitha ajo është pronë e All'llahut dhe në dorën e njeriut është njësoj si borxhi, edhe sikur ai është i lënë peng. Me atë, All'llahu, me begatinë e Tij, garanton që t'i japë njeriut besimin e plotë. Edhe pse çështja është e tillë, njeriu nuk

1 Tefsiri i Burhanit, vëll. 3, f. 353.

jep dhe e lë pasurinë e tij të dëmtohet pa patur as shpërblim e as falënderim.".[1]

3- Hapësira e nocionit të dhënies

Për të kuptuar kufirin e nocionit të dhënies në Islam, lexojmë hadithin nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që thotë: *"Çdo vepër e mirë, është sadaka. Çdo gjë që njeriu shpenzon për veten dhe familjen e tij, i shkruhet sadaka. Edhe ruajtja e nderit të njeriut, është sadaka. Çdo gjë që njeriu e jep si shpenzim në Rrugë të All'llahut, All'llahu ia kompenson atij, përveç asaj që jepet në ndërtesa (në ndërtimin e shtëpisë) apo në gjynah."*.[2]

Ka mundësi që përjashtimi i ndërtesës është sepse ajo është e përhershme, apo sepse njerëzit e shohin vazhdimisht atë.

1 Tefsiri "Kebijr", vëll. 25, f. 263, fundi i ajeteve është burimi i komentimit.
2 Tefsiri i "Kurtubijut", vëll. 6, f. 5389, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Ajetet 43 – 45

﴿وَإِذَا تُتْلَى عَلَيْهِمْ آيَاتُنَا بَيِّنَاتٍ قَالُوا مَا هَذَا إِلَّا رَجُلٌ يُرِيدُ أَنْ يَصُدَّكُمْ عَمَّا كَانَ يَعْبُدُ آبَاؤُكُمْ وَقَالُوا مَا هَذَا إِلَّا إِفْكٌ مُفْتَرًى وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلْحَقِّ لَمَّا جَاءَهُمْ إِنْ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُبِينٌ٤٣ وَمَا آتَيْنَاهُمْ مِنْ كُتُبٍ يَدْرُسُونَهَا وَمَا أَرْسَلْنَا إِلَيْهِمْ قَبْلَكَ مِنْ نَذِيرٍ٤٤ وَكَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَمَا بَلَغُوا مِعْشَارَ مَا آتَيْنَاهُمْ فَكَذَّبُوا رُسُلِي فَكَيْفَ كَانَ نَكِيرِ٤٥﴾

"Kur iu lexohen atyre Shpalljet Tona të qarta, ata (paganët e Mekës) **thonë: 'Ky** (Muhammedi) **është vetëm njeri, që dëshiron t'ju largojë nga ajo që etërit tuaj kanë adhuruar'. Dhe ata thonë: 'Ky** (Kur'an) **nuk është asgjë tjetër veçse një gënjeshtër e trilluar!' Dhe, kur u vjen e Vërteta, jobesimtarët thonë: 'Kjo është vetëm magji e qartë.'"**

"Ne nuk u kemi dërguar asnjë Libër, për ta mësuar ata dhe Ne nuk u kemi dërguar atyre para teje asnjë paralajmërues."

"Ata, që kanë qenë para tyre, i mohuan Shpalljet Tona. Ata ishin dhjetë herë më të begatë dhe më të fuqishëm (se idhujtarët e Mekës) **e, megjithatë, i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit e Mi. Eh, si ka qenë dënimi Im (ndaj** tyre)**."**

Komentimi

Me çfarë logjike i mohojnë argumentet e All'llahut?

Këto ajete rikthehen për të plotësuar diskutimin që e kanë trajtuar ajetet e mëparshme, rreth idhujtarëve dhe jobesimtarëve dhe thëniet e tyre për Ditën e Kiametit. Këto ajete flasin rreth situatës së këtyre në dynja dhe qëndrimeve të tyre kur dëgjonin Kur'anin, derisa të bëhet e qartë se dënimi i tyre i përbuzur i Ahiretit, është vetëm rezultat i qëndrimeve të gabuara, që ata mbajtën ndaj argumenteve të All'llahut në dynja.

Ajeti 43 thotë: **"Kur iu lexohen atyre Shpalljet Tona të qarta, ata** (paganët e Mekës) **thonë: 'Ky** (Muhammedi) **është vetëm njeri, që dëshiron t'ju largojë nga ajo që etërit tuaj kanë adhuruar.'"**.

Kjo është kundërpërgjigjja e tyre kundër "argumenteve të qarta", është përpjekja për të vënë në lëvizje ndjenjën e fanatizmit në këtë popull fanatik.

Duke vënë re përdorimin e tyre të shprehjes "etërit tuaj" në vend të "etërve tanë" kuptohet se ata duan t'i thonë popullit të tyre se trashëgimia e gjyshërve është në rrezik, prandaj ju e keni për detyrë të ngriheni dhe të kundërshtoni këtë njeri që ju nëpërkëmb këtë trashëgimi.

Shprehja: **"Ky** (Muhammedi) **është vetëm njeri."**, ka për qëllim përbuzjen e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), sepse fjala *hadha* dhe ajo *rexhulun*, janë në trajtën pashquar, mëgjithëse ata e njihnin mirë Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e dinin se ai ka një të kaluar të shkëlqyer.

Ajo çka e meriton të vihet re, është se Kur'ani i ka përshkruar "argumentet" me qartësi, domethënë se ajeti bart argumente të vërteta, pasi ajo që pranon vëzhgimin, nuk ka nevojë për sqarim dhe qartësim.

Thënia e dytë e tyre kishte për qëllim prishjen e thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Dhe ata thonë: 'Ky** (Kur'an) **nuk është asgjë tjetër veçse një gënjeshtër e trilluar!'"**.

Fjala *"ifkun"*, siç e kemi përmendur më parë, ka kuptimin *"shmangie"*. Është thënë për erërat paralele, të frikshme, erëra që e ndryshojnë drejtimin. Përdoret për çdo shmangie apo ndryshim nga e vërteta, duke besuar të pavërtetën, duke përkrahur gënjeshtrën, në vend të fjalës së sinqertë, duke pëlqyer veprat e shëmtuara, në vend të veprave të bukura. Mirëpo, siç kanë thënë disa, fjala *"ifkun"* përdoret për gënjeshtrat e mëdha.

Nuk mjaftonte përdorimi prej tyre i fjalës *"ifkun"*, për të akuzuar të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si gënjeshtar, por ata dëshironin ta theksonin atë kuptim, duke përdorur fjalën *"muftera" - "e trilluar"*, pa pasur asnjë argument për këtë akuzë.

Akuza e tretë që ia mveshën të Dërguarit All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte

"magjia", siç e shikojmë në fundin e ajetit: **"Dhe, kur u vjen e Vërteta, jobesimtarët thonë: 'Kjo është vetëm magji e qartë!'"**.

E çuditshme është se këta të humbur i thonë këto tri akuza me siguri të madhe. Në një vend ata thonë se ai është magjistar, diku tjetër thonë se është thjesht gënjeshtër.

Në një vend të tretë thonë se ai do t'i bllokonte ata nga trashëgimia e gjyshërve të tyre. Sigurisht që këto tri cilësi të ulëta nuk e kundërshtojnë njëra–tjetrën, edhe pse këta nuk e përbuzin fjalën kontradiktore. Për këtë nuk ka arsye, siç thonë komentuesit, secila prej këtyre cilësive, i atribuohet një grupi të pavarur prej jobesimtarëve.

Po kështu, ajo që meriton të vërehet, është se Kur'ani Famëlartë, në dy herët e para ka përdorur fjalinë: *"kalu" - "ata thanë"*. Herën e tretë ka përdorur fjalinë: **"jobesimtarët thonë"**, duke treguar se burimi i çdo pikëllimi që i ka goditur ata, është mosbesimi, mohimi dhe armiqësia e të vërtetës, pasi, në të kundërt, si mund të akuzojë dikush një njeri që paraqet argumente të vërteta për fjalën, për punën dhe për të kaluarën e tij, duke e akuzuar vazhdimisht, pa asnjë argument.

Duket sikur ata ndjekin një program të mësuar me këto tri akuza, për të kundërshtuar Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi kanë vënë re:

Së pari: Feja është e re dhe ka forcë tërheqëse.

Së dyti: Paralajmërimet e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me dënimin

hyjnor në dynja dhe në Ahiret, frikësuan një grup të shoqërisë, deshën apo nuk s'deshën ata.

Së treti: Mrekullitë e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishin lënë gjurmët e tyre pozitive në shpirtin e shoqërisë, deshën apo nuk deshën ata.

Prandaj, pa dyshim, ata, për hir të prishjes së pasivitetit të këtyre tri çështjeve, menduan për ftesën e ruajtjes së trashëgimisë së të parëve, përballë fesë së re, në kohën kur të parët, sipas asaj që përmend Kur'ani Famëlartë në ajetin 170 të sures "El Bekare", ishin: **"nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar"**.

Nuk është ndonjë krim që njerëzit të heqin dorë nga ato figura trilluese e legjendare, të cilët ishin trashëgimi e injorantëve budallenj.

Për të kundërshtuar paralajmërimet e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me dënim hyjnor, ata e akuzuan atë duke e quajtur gënjeshtar, me qëllim që të qetësonin masën.

Përballë mrekullive, ata shtruan akuzën e magjisë, duke menduar se mrekullitë nuk do të kenë ndikim në shpirtin e njerëzve, për shkak të këtij orientimi.

Historia islame është dëshmitare se secili plan djallëzor, nuk kishte asnjë efekt. Rezultati ishte që njerëzit hynë në këtë fe madhështore turma–turma.

Në ajetin 44, Kur'ani Famëlartë i zhduk të gjitha ato akuza imagjinare, edhe pse dukeshin qartë që ishin të pavërteta: **"Ne**

nuk u kemi dërguar asnjë Libër, për ta mësuar ata dhe Ne nuk u kemi dërguar atyre para teje asnjë paralajmërues.”.

Ajeti tregon se këto akuza mund të ishin të pranuara, nëse atyre do t’u kishte ardhur i Dërguar më parë me një libër qiellor, që përmbajtja e tij të kundërshtonte thirrjen e re. Nuk ka gjë, nëse e ngrenë zërin të përgënjeshtrojnë dhe herë tjetër thërrasin për trashëgiminë e gjyshërve, kurse herën e tretë përgënjeshtrojnë thirrjen e re apo akuzojnë atë që e solli, duke e quajtur magjistar. Kush mbështetet vetëm në mendimin e tij personal, pa asnjë shpallje nga qielli dhe pa pasur dituri, atëherë nuk i lejohet të gjykojë duke fabrikuar trillime.

Nga ky ajet përfitohet se njeriu nuk mund ta zgjedhë vetë rrugën e jetës së tij vetëm me mendjen e tij, por është e domosdoshme që ta mbështesë ndihmën e tij te Shpallja qiellore dhe të përparojë duke kërkuar ndihmë me ligje, ose në të kundërt ato janë errësira dhe frikë nga humbja, labirinti.

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë, i kërcënon këto grupe rebele: **“Ata, që kanë qenë para tyre, i mohuan Shpalljet Tona.”**. Këto grupe nuk ia kalonin në fuqi dhe forcë me as një të dhjetën atyre popujve: **“Ata ishin dhjetë herë më të begatë dhe më të fuqishëm** (se idhujtarët e Mekës)**.”**.

Qytetet e tyre, të shkatërruara me goditjet e ndëshkimit hyjnor, nuk janë shumë larg jush. Ata janë në Sham, afër jush, që të jenë për ju pasqyrë leksioni. Dëgjojini këshillat që i thotë shkatërrimi dhe krahasoni rezultatin tuaj me rezultatin e tyre, pasi as tradita hyjnore nuk do të ndryshojë dhe as ju nuk jeni më të fuqishëm se ata.

Fjala *"mi'sharun"*, ka kuptimin nga njëshi deri te dhjeta. Disa e kanë krahasuar atë me fjalën *"ushrul ushur"*, domethënë nga një deri në njëqind. Shumica e librave të gjuhës dhe komentimet, kanë përmendur kuptimin e parë, edhe pse shembulli i atij numërimi nuk ka për qëllim numërimin. Përdoret për zvogëlimin, përballë shtatëdhjetë e shtatë dhe njëmijë e ngjashëm me to, të cilat përdoren për shumimin.

Kuptimi i synuar nga ajeti është: Ne i shkatërruam kundërshtuesit e fuqishëm. Këta kanë vetëm një pjesë të vogël të fuqisë së tyre.

I njëjti kuptim përmendet në ajete të shumta të Kur'anit Famëlartë. Njëri prej tyre është ajo që thuhet në ajetin 6 të sures "El En'am": **"A nuk e shohin ata se sa brezni i kemi zhdukur para tyre?! Ata ishin njerëz që i kishim dhënë më shumë pushtet në tokë sesa ju kemi dhënë ju** (mekasve)**? Ne u sollëm atyre shira të bollshëm dhe bëmë që të rrjedhin lumenj nëpër viset e tyre; por, për shkak të gjynaheve të veta, i shfarosëm dhe, më pas, krijuam brezni të tjera."**.

Ajeti 21 i sures "El Mu'minun": **"Vërtet, edhe te bagëtitë për ju ka shenja** (për të medituar)**: ju pini atë që gjendet në barkun e tyre, hani mishin e tyre, nxirrni shumë dobi të tjera."**.

Ajeti 9 i sures "Err Rrum": **"Vallë, a nuk udhëtojnë nëpër botë e të shohin se si kanë përfunduar popujt e mëparshëm? Ata kanë qenë më të fortë se këta dhe tokën e kanë shfrytëzuar dhe punuar më mirë se sa e punojnë këta, e të Dërguarit e tyre u kanë sjellë prova të qarta. Nuk ishte All'llahu që u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë vetvetes padrejtësi."**.

Fjala: *"nekjir"* rrjedh nga fjala *"nekire"* dhe është mohimi kundër njohjes, pranimit. Qëllimi i përdorimit të fjalës është të tregojë se mohimi i All'llahut është ai shpërblim dhe dënim që buron nga All'llahu i Lartësuar.[1]

1 Disa komentues kanë supozuar një komentim tjetër për këtë ajet, konkretisht për pjesën e ajetit: **"Ata ishin dhjetë herë më të begatë dhe më të fuqishëm** (se idhujtarët e Mekës)**."**. Ky ajet është një ndër dhjetë ajetet që All'llahu zbriti për idhujtarët kurejsh, për të plotësuar justifikimin kundër tyre. Nuk i ka zbritur mbi popujt e tjerë. Nëse dënimi që u kemi dhënë atyre, ka qenë aq i ashpër, si do të jetë çështja me idhujtarët kurejsh, të cilët kanë marrë dhjetëfishin e argumenteve për të plotësuar justifikimin?! Duket se komentimi i parë është më afër përmbajtjes së ajetit. Në bazë të komentimit të parë, atëherë të katër përemrat që janë të pranishëm në ajet, dy përemrat, i pari dhe i dyti, i referohen jobesimtarëve kurejsh, kurse përemri i tretë dhe i katërt i referohet jobesimtarëve të hershëm. Sipas komentimit të dytë, përemri i parë i referohet jobesimtarëve kurejsh, kurse i dyti jobesimtarëve të hershëm, i treti për jobesimtarët kurejsh, kurse i katërti për jobesimtarët e hershëm. Vëreni me kujdes.

Ajeti 46

﴿قُلْ إِنَّمَا أَعِظُكُمْ بِوَاحِدَةٍ أَنْ تَقُومُوا لِلَّهِ مَثْنَىٰ وَفُرَادَىٰ ثُمَّ تَتَفَكَّرُوا مَا بِصَاحِبِكُمْ مِنْ جِنَّةٍ إِنْ هُوَ إِلَّا نَذِيرٌ لَكُمْ بَيْنَ يَدَيْ عَذَابٍ شَدِيدٍ٤٦﴾

"Thuaj (o Muhammed)**: Unë ju këshilloj vetëm një gjë: ngrihuni sinqerisht për All'llahun, dy nga dy ose një nga një, e pastaj gjykoni për shokun tuaj** (Muhammedin) **që nuk është i çmendur. Ai është dërguar vetëm që t'ju paralajmërojë para një dënimi të rëndë."**

Komentimi

Revolucioni i mendimit është themeli i çdo revolucioni të vërtetë

Në këtë fragment të ajeteve dhe ajeteve që do të pasojnë, të cilat janë ajetet e fundit të sures së bekuar "Sebe", i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhërohet edhe një herë tjetër për të thirrur këta popuj, me argumente të ndryshme, që të besojnë të vërtetën dhe të kthehen nga humbja e tyre.

Siç kemi përmendur në diskutimet e mëparshme, All'llahu i është drejtuar të Dërguarit të Tij *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pesë herë me fjalën "thuaj".

Ajeti është tregues i gurit themelor në të gjitha shndërrimet dhe zëvendësimet shoqërore, morale, politike, ekonomike dhe kulturore. Duke kumtuar një mesazh të thellë, por të shkurtër, i drejtohet të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Thuaj** (o Muhammed)**: Unë ju këshilloj vetëm një gjë: ngrihuni sinqerisht për All'llahun, dy nga dy ose një nga një, e pastaj gjykoni për shokun tuaj** (Muhammedin) **që nuk është i çmendur. Ai është dërguar vetëm që t'ju paralajmërojë para një dënimi të rëndë."**.

Fjalët dhe shprehjet e këtij ajeti tregojnë një temë të rëndësishme, që i mbledhim në dhjetë pika:

1- Fjala *"eidhukum"* - *"këshilloj"* sqaron një realitet: I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dëshiron të thotë se unë ju tërheq vërejtjen për të mirën tuaj, se ajo që ju them juve, është në interesin tuaj dhe asgjë tjetër.

2- Shprehja: *"uahidetun"* - *"me një gjë"* tregon se origjina e të gjitha interesave personale dhe shoqërore është vetëm me veprat e mendimit. Përderisa mendimi i popullit vazhdon të jetë në ofendime, atëherë ata do të jenë objektiv i hajdutëve, i banditëve të fesë, i besimit dhe i lirisë. Kur të rregulloni mendimet, atëherë ato do t'u pritet rruga këtyre.

3- Kuptimi i fjalës *"kijam"*, nuk është thjesht qëndrimi mbi dy këmbë. Kuptimi i saj është përgatitja për të kryer punën, duke

parë se njeriu, me qëndrimin e tij në këmbë, është i gatshëm të plotësojë programet e ndryshme jetësore, prandaj, pa dyshim, se të menduarit ka nevojë për një përgatitje paraprake, që të zgjojë arsyen dhe lëvizjen te njeriu, i cili e nxit atë me vullnet dhe vendosmëri për meditim.

4- Fjala *"li'lah"* bën të qartë se angazhimi dhe përgatitja duhet të jetë motivi hyjnor i njeriut. Meditimi që buron nga ky motiv, ka një vlerë të madhe, pasi zakonisht sinqeriteti në punë, deri edhe në meditim, është thelbi i shpëtimit, i lumturisë dhe i meditimit.

Ajo që na tërheq shikimin, është: Besimi këtu është një urdhër i padiskutueshëm, prandaj meditimi i kërkuar, është vetëm në çështje të tjera dhe tregon se Teuhidi është vetëm një çështje natyrore e qartë, që kuptohet edhe pa medituar fare.

5- Shprehja: **"dy nga dy ose një e nga një"**, tregon se meditimi duhet të jetë larg poteres dhe zhurmës, që njerëzit të jenë më vete, ose më e shumta dyshe-dyshe dhe të meditojnë, sepse meditimi në mes të zhurmës dhe poteres nuk mund të jetë i thellë, sepse faktorët personalë dhe mendjengushtësia në rrugën e mbrojtjes ndaj besimeve personale, do të jenë më shumë aktive në bashkësitë e mëdha.

Disa komentues kanë menduar se këto dy shprehje mund të tregojnë dobinë e këshillimit, duke u përzier mes mendimeve personale dhe shoqërore, sepse njeriu duhet të mendohet i veçuar, pasi kështu përfiton nga mendimet e të tjerëve. Totalitarizmi i mendimit është shkaku i vetëkënaqësisë. Këshillimi dhe bashkëpunimi për hir të zgjidhjes së problemeve shkencore, nuk të çon drejt poteres, do të ketë më shumë ndikim. Ka mundësi që

paraprija **“dy nga dy “** në ajet ndaj **“një nga një”** të jetë për këtë arsye.

6- Na tërheq vëmendjen se Kur’ani Famëlartë thotë **“gjykoni”**, pa përmendur çfarë të gjykohet. Heqja e lidhëzës është argument i universalitetit, domethënë, të gjykoni për çdo gjë, për jetën shpirtërore dhe materiale, për çështje të mëdha dhe të vogla. Me një fjalë: Në çdo çështje, në fillim duhet të mendohet thellë. Më e rëndësishmja nga të gjitha është mendimi i thellë për të gjetur përgjigjen e katër pyetjeve që vijnë: Nga ke ardhur? Për çfarë ke ardhur? Ku do të shkosh? Ku jam unë tani?

Disa komentues të Kur’anit kanë shkuar deri aty sa kanë thënë se folja **“gjykoni”**, lidhet me fjalinë që vjen pas saj: **“për shokun tuaj** (Muhammedin) **që nuk nuk është i çmendur.”**.

Kuptimi është: Nëse ju mendoheni sadopak, do të kuptoni se i Dërguari i All’llahut *(Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është pa të meta nga akuzat tuaja të imagjinuara për çmenduri. Duket se kuptimi i parë është më i qartë.

Është e padiskutueshme se një nga çështjet që duhet të mendohet thellë, është çështja e profecisë dhe e cilësive të larta që përfaqësonte personaliteti i Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pa shkurtuar asgjë nga ajo.

7- Togfjalëshi *“sahibukum” - “shoku juaj”*, i adresohet të Dërguarit të All’llahut *(Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai nuk është i panjohur për ju, sepse ka qenë në

mesin tuaj për vite të tëra dhe e keni njohur atë për amanetin e tij, keni njohur sinqeritetin dhe qëndrimin e tij në Rrugë të Drejtë. Deri tani nuk keni gjetur një pikë të vetme të dobët në ecurinë e jetës së tij, prandaj ju duhet të jeni të drejtë, pasi akuzat që ia ngjisni atij, nuk kanë asnjë bazë.

8- Kuptimi i fjalës *"xhunnetun"* është *"çmenduri"*. Rrënja e fjalës është *"xhinnun"*, me kuptimin, mbulimi i diçkaje nga shqisat. Duke qenë se fjala *"el mexhnunu" - "i çmenduri"* është mbulim i logjikës së tij dhe për të është përdorur kjo shprehje, ajo që meriton të vërehet këtu, është se shprehja dëshiron të zbulojë këtë të vërtetë: Ai që fton në mendim të thellë dhe kujdes, si mund të jetë i çmendur? Thirrja e tij për meditim, është vetëm një argument i logjikës së tij të shëndoshë dhe i diturisë së tij.

9- Fjalia: **"Ai është dërguar vetëm që t'ju paralajmërojë"** përmbledh mesazhin e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në çështjen e paralajmërimit, domethënë tërheq vërejtjen se dënimi hyjnor është i vërtetë. I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka një mesazh përgëzimi ose lajme të mira. Ajo që vë më tepër në lëvizje njeriun, është paralajmërimi. Kjo është arsyeja se pse është përmendur çështja e paralajmërimit në ajetet e tjera të Kur'anit Famëlartë. Ai është angazhimi kryesor i të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Kjo çështje është përmendur në ajetin 9 të sures "El Ahkaf": **"...kam për detyrë vetëm të jap paralajmërime të qarta"** dhe në ajetin 65 të sures "Sad": **"Thuaj** (o Muhammed)**: 'Në të vërtetë, unë jam vetëm paralajmërues...'"**.

10- Togfjalëshi **"dënimi të rëndë"** tregon se Kiameti është aq afër, sa duket sikur është para syve. E vërteta është: Ai është i tillë, në lidhje me moshën e dynjasë. Në transmetime të ndryshme islame është përmendur i njëjti kuptim. I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Jam dërguar unë dhe Kiameti si këto të dyja."* dhe bashkoi gishtin tregues dhe të mesit.[1]

Dy hulumtime

1- Pavarësia e ajeteve të Kur'anit Famëlartë dhe komentimi i tërthortë i tyre

Gjatë komentimit të ajetit të fundit, na u bë e qartë se statujat, putat dhe ato që adhurohen pos All'llahut të Lartësuar kanë veshë të shurdhët, për sa i përket asaj që kërkohet prej tyre. Edhe nëse kanë, janë të pafuqishëm në zgjidhjen e problemeve. Ato nuk kanë asnjë pasuri, qoftë edhe një majë gjilpëre: **"Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj..."**.[2] Duke u bazuar në këtë fakt, vehabistët e morën këtë ajet si justifikim të tyre, për të pohuar se çdo gjë përveç All'llahut, qoftë edhe Pejgamber, nuk e dëgjon lutjen. Edhe nëse e dëgjon, ai nuk i përgjigjet. Ata refuzuan çdo lloj ndërmjetësimi me shpirtrat e Profetëve, të

1 Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 22, f. 143, fundi i ajetit është burimi i komentimit.
2 Sure "Fatir", ajeti 14.

Imamëve dhe miqve të All'llahut. E kanë konsideruar atë kundërshtues të Teuhidit, duke e argumentuar me fjalën e All'llahut të Madhërishëm: **"Kurse ata që i adhuroni në vend të Tij, nuk mund t'ju ndihmojnë as ju e as veten."**.[1]

Nëse e përqendrojmë shikimin në ajetet e kaluara dhe ato që vijnë, ajo që nënkuptohet nga togfjalëshi: **"në vend të Tij"**, janë statujat e asgjë tjetër. Kjo vërtetohet me atë grumbull gurësh dhe drurësh, që ishin në sytë e idhujtarëve injorantë. Ata mendonin se këto statuja kishin fuqi përballë fuqisë së Krijuesit Bujar, ashtu si Profetët dhe miqtë e All'llahut, deri edhe dëshmorët në Rrugë të All'llahut që janë të gjallë në Berzakh (jeta e ndërmjetme). Jeta e Berzakhut, siç dihet, është e zhveshur nga përmasat materiale dhe lidhjet e dynjasë, duke e bërë atë më të gjerë. Ndërmjetësimi me shpirtrat e pastër të Profetëve dhe Imamëve nuk do thotë vendimi ynë për ta, por pavarësia përballë Krijuesit Bujar. Ne vetëm kërkojmë ndihmën dhe mbështetjen nga pozita e tyre, në prani të Formësuesit, të Fuqishmit. Ky është vetë Teuhidi.

Kur'ani Famëlartë e ka bërë të qartë se ndërmjetësuesi e bën ndërmjetësimin vetëm me lejen e All'llahut të Lartësuar: **"Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?"**[2], pra, kush mund t'i mohojë këto argumente të qarta, përveç injorantëve dhe kryeneçëve, që bënë deklarime për të mbjellë përçarjen mes myslimanëve?!

Në historinë e sahabëve, shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë se, kur ata i zinin ngushtë problemet, vinin te varri i

1 Sure "El A'raf", ajeti 197.
2 Sure "El Bekare", ajeti 255.

Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kërkonin ndërmjetësimin e tij, kërkonin ndihmën nga All'llahu nëpërmjet ndërmjetësimit të shpirtit të tij të pastër.

Shembulli ynë për këtë është ajo që ka përmendur Bejhakiju, një prej muhadithëve (ai që di shumë hadithe të Profetit Muhammed): "Në periudhën e kalifit të dytë, njerëzit kaluan një thatësirë të madhe. Kjo gjë e detyroi Bilalin dhe një numër sahabësh, të shkojnë te varri i të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur ishin atje, thanë: "O i Dërguari i All'llahut, jepi ymetit tënd ujë të pijë, sepse ata po vdesin.".[1]

El Alusij, në veprën "Ruhul Meanij", transmeton shumë hadithe për këtë çështje. Midis të tjerash ka thënë: "Unë nuk shikoj pengesë që t'i lutesh All'llahut me pozitën e të Dërguarit më të nderuar, gjatë jetës apo pas vdekjes së tij. Lejohet ndërmjetësimi me të tjerët që kanë një pozitë dhe afrimitet me Krijuesin Bujar, me All'llahun e Madhëruar.".[2]

Për më tepër lexim, përsërit komentimin tonë, fundi i ajetit 35 të sures "El Maide".

1 Nga libri "Et teuessul ila hakikatu teuesesl".
2 Tefsiri "Ruhul Meanij", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

2- Disa transmetime islame rreth të menduarit dhe meditimit

Nën hapat e Kur'anit Famëlartë, historia islame i ka dhënë rëndësi çështjes së meditimit, aq sa e ka vënë atë në vend të parë për nga rëndësia. Nga transmetime të ndryshme, lexojmë shprehje shumë të bukura dhe domethënëse. Kemi nxjerrë disa modele prej tyre:

a) Të menduarit është adhurimi më i madh

Nga fjalët e Imam Ridhait *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Adhurimi nuk është falja e tepërt dhe agjërimi i shumtë, por adhurimi është të menduarit në çështjen e All'llahut."*.[1]

Në një transmetim tjetër, lexojmë: *"Adhurimi më i madh i Ebu Dherrit, ishte meditimi."*.[2]

b) Një orë meditim është më e mirë se një natë adhurim (ibadet)

Hasan Sajkali ka thënë: "Pyeta Ebu Abdullah Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)*: 'Njerëzit thonë se të meditosh një orë, është më e mirë se sa të qëndrosh gjithë natën duke bërë adhurim.' Si bëhet meditimi?" Ebu Abdullah Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha:

1 "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 45, Libri "El kufru uel ijmanu", kreu "et tefekur", Hadithi 4.
2 "Sefijnetul Bihar", vëll. 2, Lënda "et tefekur", f. 383.

"Kuptimi i saj është që të kalohet afër rrënojave apo shtëpive dhe thua: 'Ku janë banorët tuaj e ku janë banesat tuaja, çfarë keni që nuk flisni?".[1]

c) Meditimi është burimi i veprës

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: *"Meditimi të fton në bamirësi, devocion dhe të vepruarit me të."*.[2]

1 Burimi i mëparshëm, f. 382.
2 Burimi i mëparshëm.

Ajetet 47 – 50

﴿قُلْ مَا سَأَلْتُكُمْ مِنْ أَجْرٍ فَهُوَ لَكُمْ إِنْ أَجْرِيَ إِلَّا عَلَى اللَّهِ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ٤٧ قُلْ إِنَّ رَبِّي يَقْذِفُ بِالْحَقِّ عَلَّامُ الْغُيُوبِ٤٨ قُلْ جَاءَ الْحَقُّ وَمَا يُبْدِئُ الْبَاطِلُ وَمَا يُعِيدُ٤٩ قُلْ إِنْ ضَلَلْتُ فَإِنَّمَا أَضِلُّ عَلَى نَفْسِي وَإِنِ اهْتَدَيْتُ فَبِمَا يُوحِي إِلَيَّ رَبِّي إِنَّهُ سَمِيعٌ قَرِيبٌ٥٠﴾

"Thuaj: Çfarëdo shpërblimi, që mund t'ju kem kërkuar, ai qoftë për ju. Shpërblimi im është vetëm tek All'llahu; Ai është dëshmitar për çdo gjë."

"Thuaj: Pa dyshim, Zoti im shpall të Vërtetën. Ai është i Gjithëdijshëm për të gjitha të fshehtat."

"Thuaj: E vërteta erdhi, kurse e pavërteta është fshirë e nuk mund të shfaqet përsëri."

"Thuaj: Nëse gaboj, unë gaboj vetëm për dëmin tim e, nëse udhëzohem në Rrugën e Drejtë, kjo është nga Shpallja e Zotit tim. Ai, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe është afër."

Komentimi

E kota u zhduk pa fillim dhe pa kthim

Kemi thënë se All'llahu i Lartësuar e urdhëroi pesë herë të Dërguarin e Tij, me këtë zinxhir ajetesh të bekuara, që t'u flasë njerëzve të humbur dhe t'ua presë atyre nga çdo anë rrugën e justifikimit.

Ajeti i mëparshëm ishte një ftesë për meditim dhe mohonte çdo rast të prishjes së ekuilibrit shpirtëror te i Dërguari i All'llahut.

Në fillim të këtyre ajeteve, Kur'ani thotë që të mos i kërkojmë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shpërblim, në këmbim të përcjelljes së mesazhit. Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"Thuaj: Çfarëdo shpërblimi, që mund t'ju kem kërkuar, ai qoftë për ju. Shpërblimi im është vetëm tek All'llahu; Ai është dëshmitar për çdo gjë."**.

Kjo tregon se, kur njeriu i mençur bën ndonjë veprim, ai duhet të ketë një motiv për këtë sjellje. Kur juve ju vërtetohet se unë kam mendje të shëndoshë dhe nuk kam ndonjë qëllim material, atëherë ju duhet ta dini se ka një motiv dhe forcë lëvizëse hyjnore e shpirtërore, që më nxit mua në atë sjellje dhe veprim.

Thënë ndryshe: Unë ju ftova ju, që të mendoheni thellë. Tani vëreni me kujdes dhe pyesni veten tuaj se cili shkak më nxit mua, që t'ju paralajmëroj juve nga ndëshkimi i ashpër hyjnor.

Çfarë fitimi do të kem nga kjo punë? Çfarë interesi material kam unë në të? Për më tepër, duke shtuar se, nëse justifikimi juaj ka qenë largimi dhe kundërshtimi i të vërtetës dhe ju do të më paguani mua një shpërblim për të, atëherë do t'ju humbasë në tym, sepse unë nuk kam kërkuar nga ju asnjë shpërblim.

Ky kuptim është përmendur qartë edhe në ajetin 46 të sures "El Kalem": **"A mos po kërkon shpërblim prej tyre, kështu që qenkan të rënduar nga borxhet?"**.

Cili është komentimi i fjalisë: **"Ai qoftë për ju."**? Ka dy mendime për komentimin e kësaj fjalie:

Mendimi i parë: Fjalia konsiston në mungesën e kërkimit të çdo lloj shpërblimi, njësoj sikur të thuash: "Çdo gjë që doja prej teje, është e jotja." duke theksuar se ti nuk dëshiron asgjë. Argumenti për këtë mendim është fjalia që pason: **"Shpërblimi im është vetëm tek All'llahu."**.

Mendimi i dytë: Nëse ju lexoni me vëmendje ato që ju kam lajmëruar, unë jam në një pjesë prej tyre. Unë ju kam thënë juve: **"Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve."**.[1]

Kjo ju kthehet juve në dobi, sepse dashuria e të afërmve lidhet me udhëheqjen, mbrojtjen dhe vazhdimin e vijës së profecisë, e cila është e domosdoshme në udhëzimin tuaj të përhershëm.

Argumenti për këtë fjalë është ajo që përmendet në shkaqet e zbritjes, një pjesë të të cilave i kemi transmetuar këtu. Në tefsirin

1 Sure "Shura" ajeti 23.

"Ruhul Meanin", për zbritjen e ajetit: **"Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve."**[1] , thuhet se i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ka thënë idhujtarëve të Mekës: "Mos i lëndoni të afërmit e mi." Ata e kanë pranuar këtë kërkesë, mirëpo, kur i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ofendoi statujat e tyre, ata thanë: "Muhammedi nuk ka qenë i drejtë me ne, pasi ai, nga njëra anë, na fton ne që të mos i lëndojmë të afërmit e tij, por, nga ana tjetër, i ofendon zotat tanë.". Këtu zbriti ajeti që po komentojmë: **"Thuaj: 'Çfarëdo shpërblimi, që mund t'ju kem kërkuar, ai qoftë për ju.'"**. Ajo që desha unë prej jush, në lidhje me këtë, është në dobinë tuaj, njësoj si i lënduat ata apo nuk i lënduat.[2]

Ajeti mbyllet me thënien **"Ai është dëshmitar për çdo gjë."**. Nëse unë e dua shpërblimin tim, e dua vetëm nga All'llahu, sepse vetëm Ai i di të gjitha veprat e mia dhe di çfarë kam në zemër. Përveç kësaj, All'llahu i Madhëruar, i Lartësuar, është dëshmitar i sinqeritetit dhe i vërtetësisë së thirrjes sime. All'llahu i Madhëruar m'i ka nënshtruar mua të gjitha këto mrekulli dhe argumente të qarta. E vërteta është se All'llahu i Madhëruar është dëshmitari më i mirë, pasi Ai ka përfshirë gjithçka në diturinë e Tij dhe Ai është më i miri në zbatimin e detyrës. Prej Tij del vetëm e vërteta. Ai është dëshmitari më i mirë.

Duke e kthyer shikimin nga sa u tha rreth vërtetësisë së thirrjes së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ajeti 48 shton se Kur'ani është një

1 Sure "Esh Shura", ajeti 23.
2 Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 7, f. 308.

realitet që nuk e pranon mohimin, sepse All'llahu i Madhëruar e ka hedhur atë në zemrën e të Dërguarit të Tij: **"Thuaj: 'Pa dyshim, Zoti im shpall të Vërtetën. Ai është i Gjithëdijshëm për të gjitha të fshehtat.'"**.

Fjala *"jekdhifu"* rrjedh nga fjala *"kadhefe"*. Kuptimi i saj është: gjuajtje nga larg. Ka shumë komentime për këtë ajet, që mund t'i bashkojmë me njëra–tjetrën.

Së pari: Ajo që kuptohet prej grupit foljor **"shpall të Vërtetën"**, janë librat qiellorë dhe shpallja hyjnore në zemrat e Profetëve dhe të Dërguarve, sepse All'llahu i Madhëruar është Njohës i të fshehtave. Ai e di për zemrat e përgatitura, i zgjedh ato dhe çon shpalljen në to, derisa të depërtojë në thellësitë e tyre.

Duke u bazuar në këto fjalë, kuptimi është i ngjashëm me atë që thuhet në hadithin e njohur *"Dituria është një dritë që e hedh All'llahu në zemrën e atij që Ai dëshiron."*.[1]

Togfjalëshi: **"i Gjithëdijshëm për të gjitha të fshehtat"**, e miraton këtë kuptim.

Së dyti: Kuptimi i ajetit: **"E vërteta erdhi, kurse e pavërteta është fshirë e nuk mund të shfaqet përsëri."**[2], është: E vërteta ka një fuqi, që e bën atë të aftë të kapërcejë çdo pengesë në rrugën e saj. Askush nuk ka fuqi t'i qëndrojë përballë. Me këto fjalë, ajeti bëhet kërcënim për kundërshtuesit, që të mos qëndrojnë përballë Kur'anit dhe ta dinë se vërtetësia e Kur'anit do t'i përplasë ata.

---

1 "Misbahu Sheriati", f. 16.

2 Fjala: *"jubdiu"* rrjedh nga fjala: *"bede'e"*, me kuptimin: krijimi i zanafillës. Fjala: *"juidu"* rrjedh nga fjala: *"audun"*, me kuptimin e përsëritjes, rikthimit. *"El batilu"* është subjekti dhe kundrinori është i fshehur dhe aludimi është: E kota *(el batilu)* as nuk krijon gjë e as nuk rikthen gjë.

E kota, e pavërteta nuk do të ketë asnjë rol përballë të vërtetës, as plan për fillim të ri, as plan për t'u rikthyer. Planet e të kotës u tretën në ujë dhe për këtë shkak, e kota nuk mund të errësojë dritën e të vërtetës dhe të fshijë ndikimin e saj në zemër.

Ajeti bëhet një shprehje e ngjashme me atë që thuhet në ajetin 18 të sures "El Enbija": **"Por Ne e godasim të pavërtetën, me të vërtetën, e cila e shkatërron atë dhe ajo zhduket. Dhe, mjerë për ju, për atë që i vishni** (All'llahut)**!"**.

Supozohet se folja *"kadhfun" - hedh"*, tregon depërtimin e vërtetësisë së Kur'anit kudo, jo vetëm në vendet të afërta të botës, por edhe në pikat e largëta të saj. Ajo tregon se kjo Shpallje qiellore do ta ndriçojë të gjithë botën me dritën e saj.

Edhe pse një pjesë e komentuesve ka dashur kufizimin e "të vërtetës" dhe "të kotës" në këtë ajet, është e qartë se nocioni i të dyjave është shumë i gjerë dhe gjithëpërfshirës. Kur'ani, Shpallja hyjnore, mësimet islame, të gjitha këto janë miratime të së vërtetës.

Vënia ortak All'llahut, mosbesimi, padrejtësia, gjynahet, cytjet e shejtanit dhe shpikja e mizorisë, të gjitha këto, stivohen nën kuptimin e të kotës.

Ky ajet është i ngjashëm me ajetin 81 të sures "El Isra": **"Thuaj: 'E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht, e pavërteta është e paracaktuar të zhduket.'"**.

Ibn Mes'udi ka thënë: I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* hyri në Mekë. Rreth e rrotull shtëpisë ishin treqind e gjashtëdhjetë statuja. Nisi

t'i shkatërrojë ato me një shkop që kishte në dorë, duke thënë: **"E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht, e pavërteta është e paracaktuar të zhduket!"**.[1]

Pyetja që lind këtu është: Ajeti i mësipërm thotë se me shfaqjen e të vërtetës fshihet e pavërteta dhe humbet çdo gjurmë e saj. Ne shohim se e pavërteta ka qarqe dhe pozitë deri tani, kontrollon shumë zona. Si ka mundësi?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të trajtojmë disa pika:

Së pari: Me shfaqjen dhe lindjen e të vërtetës, e pavërteta, e cila është idhujtaria, hipokrizia, mosbesimi dhe çdo gjë që buron prej tyre, e humbet shkëlqimin e saj. Edhe nëse ekzistenca e saj vazhdon me forcë, padrejtësi dhe presion, nuk ka dyshim se perçja është hequr nga fytyra e saj dhe është shfaqur fotoja e saj e shëmtuar, për atë që kërkon të vërtetën. Ky është qëllimi i ardhjes së të vërtetës dhe zhdukjes së pavërtetës.

Së dyti: Për hir të vërtetimit të qeverisë së të vërtetës dhe largimit të qeverisë së të pavërtetës, duke shtuar edhe mundësitë që All'llahu i ka vënë në shërbim të robve të Tij, ka edhe disa kushte të tjera në lidhje me vetë robtë. Më e rëndësishmja është "zbatimi i radhitjes së përparësive, për të përfituar nga ato mundësi hyjnore".

E thënë me një shprehje tjetër: Triumfi i të vërtetës ndaj të pavërtetës, nuk është vetëm në drejtimet e qëllimeve të besimit dhe logjikës, por në drejtime zbatuese të dy gjërave kryesore, "rendimenti i vepruesit" dhe "aftësia e pranuesit". Nëse e vërteta nuk ka triumfuar ndaj të pavërtetës, si rezultat i mungesës së

1 Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 8, f. 397.

vërtetimit (forcës), atëherë kjo nuk është argument i mungesës së triumfit të saj.

Le të marrim një shembull nga Kur'ani. Ajeti i bekuar thotë: **"Lutmuni Mua t'ju përgjigjem."**[1] Dihet se përgjigjja e lutjes nuk është pa asnjë kusht. Nëse realizohen kushtet e duasë, atëherë lutja pranohet. Në një situatë krejt tjetër, nuk duhet të pritet që lutja të përgjigjet. Shpjegimi i këtij kuptimi është dhënë në komentimin e ajetit 186, të sures "El Bekare".

Është njësoj sikur ne të sjellim një doktor të shkëlqyer te një i sëmurë i shtrirë në shtratin e tij. I themi atij se u shtua shansi i shpëtimit për të. Në çdo kohë që ne i sjellim atij një ilaç, e kujtojmë atë se i kemi zgjidhur një problem tjetër, kur të gjitha këto çështje janë nga gjërat e detyrueshme të shërimit dhe nuk është sëmundje e përgjithshme. Prandaj që ilaçi duhet të ndikojë te i sëmuri, duhet të zbatojë kështillat e mjekut. Nuk duhet të harrojmë ethet dhe ndikimin e tyre, me qëllim që të realizohet shërimi i plotë.

All'llahu i Madhëruar, sqaron se ajo që thotë, është prej Tij nga All'llahu, çdo udhëzim është prej Tij dhe nuk ka as gabimin më të vogël në Shpalljen e All'llahut: **"Thuaj: 'Nëse gaboj, unë gaboj vetëm për dëmin tim e, nëse udhëzohem në Rrugën e Drejtë, kjo është nga Shpallja e Zotit tim. Ai, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe është afër.'"**.[2]

---

1 Sure "Gafir", ajeti 60.

2 Për pyetjen: Përse në fjalinë e parë thuhet: **"për dëmin tim"**, kurse në fjalinë e dytë thuhet: **"Kjo është nga Shpallja e Zotit tim**.**",** disa komentues kanë thënë se çdo fjali përmban një pjesë të fshehur. Kuptimi i plotë është: Nëse unë kam humbur, atëherë është në dëmin tim. Nëse e kam gjetur të vërtetën, atëherë unë

Nëse unë mbështetem në veten time, atëherë do të humbas, sepse udhëzimi drejt rrugës së vërtetë përmes të kotës është i pamundur pa ndihmën e All'llahut dhe dritës së udhëzimit. Kjo dritë nuk ka humbje dhe qorrsokak, sepse është drita e Shpalljes hyjnore.

Është e vërtetë se mendja është një llambë ndriçuese, mirëpo njeriu nuk është i pagabueshëm dhe rrezet e kësaj llambe nuk mund të zbukurojnë të gjitha perdet e errësirave. Atëherë, ejani dhe lidhuni me këtë dritë të Shpalljes hyjnore, derisa të dilni nga errësirat dhe të vendosni këmbët tuaja në tokën e dritës. Ajeti mbyllet: **"Ai, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe është afër."**.

Mbase ju besoni se All'llahu i Madhëruar nuk e dëgjon atë çfarë themi ne dhe çfarë thoni ju, ose se Ai e dëgjon atë, por është shumë larg. Jo, kurrsesi, All'llahu dëgjon dhe është afër. Prej Tij nuk shpëton as një atom nga ajo që themi apo lutemi.

---

jam udhëzuar për veten time me ndihmën e Zotit tim. Tefsiri "Rruhul Meanij", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Ajetet 51 – 54

﴿وَلَوْ تَرَى إِذْ فَزِعُوا فَلَا فَوْتَ وَأُخِذُوا مِنْ مَكَانٍ قَرِيبٍ۝ وَقَالُوا آمَنَّا بِهِ وَأَنَّى لَهُمُ التَّنَاوُشُ مِنْ مَكَانٍ بَعِيدٍ۝ وَقَدْ كَفَرُوا بِهِ مِنْ قَبْلُ وَيَقْذِفُونَ بِالْغَيْبِ مِنْ مَكَانٍ بَعِيدٍ۝ وَحِيلَ بَيْنَهُمْ وَبَيْنَ مَا يَشْتَهُونَ كَمَا فُعِلَ بِأَشْيَاعِهِمْ مِنْ قَبْلُ إِنَّهُمْ كَانُوا فِي شَكٍّ مُرِيبٍ۝﴾

“Sikur t’i shihje jobesimtarët, kur të frikësohen (gjatë Ringjalljes)**! Ata nuk do të kenë nga ikin dhe do të nxirren prej varreve të tyre.”**

“Pastaj do të thonë: ‘Ne tashmë besojmë’. Por si do ta përvetësojnë (besimin) **nga një vend aq i largët** (prej kësaj bote, ku vlen besimi)**?!”**

“Në të vërtetë, ata e mohuan besimin më parë (në këtë botë) **dhe e përgënjeshtruan të padukshmen prej së largëti.”**

“Një pengesë do të vendoset midis tyre dhe asaj që dëshironin, ashtu siç është bërë me të ngjashmit e tyre më parë. Me të vërtetë, ata të gjithë kanë qenë në dyshim të madh.”

Komentimi

Nuk ka shpëtim për jobesimtarët

Ajetet e fundit të sures "Sebè" i referohen bisedës së idhujtarëve kokëfortë. Për këta është folur në ajetet e mëparshme gjatë bisedës me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Situatën e atij grupi, ajetet e kanë përshkruar në të gjitha çastet e veprimit të tyre: kur u bie dënimi i All'llahut, si mendojnë për besimin, etj. Ata nuk kanë asnjë dobi nga besimi i tyre.

All'llahu i Madhëruar thotë: **"Sikur t'i shihje jobesimtarët, kur të frikësohen** (gjatë Ringjalljes)**! Ata nuk do të kenë nga ikin dhe do të nxirren prej varreve të tyre."**.[1]

Ka disa mendime mes komentuesve të Kur'anit se kur do të ndodhë ajo ulërimë, frikë dhe shqetësim. Një pjesë e tyre mendojnë se është dënimi i dynjasë, ose dënimi i vdekjes. Pjesa tjetër mendon se është vetëm për dënimin e Ditës së Kiametit. Fundi i këtij ajeti tregon se të gjitha këto ajete flasin për dynjanë dhe dënimin e vazhdueshëm, ose çastin e dorëzimit të shpirtit. All'llahu i Lartësuar, në ajetin e fundit të kësaj sureje, thotë: **"Një pengesë do të vendoset midis tyre dhe asaj që dëshironin, ashtu siç është bërë me të ngjashmit e tyre më parë."**.

Kjo shprehje nuk harmonizohet me Ditën e Kiametit, sepse të gjithë, në atë ditë, tubohen për llogarinë. Këtë gjë e tregon edhe

1 Sifjalia: **"Sikur t'i shihje jobesimtarët"**, është fjali kushtore dhe shpërblimi i saj është i fshehur. Kuptimi është: Do të shikoje diçka të madhe; ose: Do të bindeshe me argumente për gjendjen e tyre.

ajeti 103 i sures "Hud": **"Pa dyshim, në këto** (ngjarje) **ka kështillë për atë që i druhet dënimit të Ditës së Gjykimit. Ajo është Dita në të cilën do të tubohen të gjithë njerëzit; ajo është Ditë e dëshmuar."**.

Në ajetet 49-50 të sures "El Uaki'a" lexojmë: **"Thuaju** (o Muhammed)**: 'Me siguri, edhe të parët, edhe të mbramët, do të tubohen në një ditë të caktuar.'"**.

Nuk ka dyshim se kuptimi i fjalisë: **"Ata nuk do të kenë nga ikin dhe do të nxirren prej varreve të tyre."**, është: Këta njerëz jobesimtarë dhe zullumqarë, jo vetëm që nuk mund të largohen nga dora e fuqisë hyjnore, por, përkundrazi, All'llahu i Madhëruar i kap ata me dënim prej varreve të tyre.

A nuk u varrosën faraonët në dallgët e Nilit, i cili ishte burimi kryesor i krenarisë së tyre? A nuk u fundos toka bashkë me Karunin dhe thesaret e tij? A nuk u zhduk qytetërimi i kombit Sebe, historinë e të cilëve e përmendëm në këtë sure? A nuk i zuri ata shkatërrimi nga vendet më të afërta të tyre, nga ajo digë e madhe, e cila ishte burimi i gjallërisë, arsyeja e jetës dhe e lëvizjes së tyre? Pa dyshim, All'llahu i dënon prej vendeve më të afërta të tyre, derisa të dihet fuqia dhe autoriteti i Tij.

Shumica e sulltanëve zullumqarë janë vrarë nga duart e rrethit të tyre më të ngushtë. Shumica e autoritarëve të mendjemëdhenj e kanë marrë goditjen e fundit nga brenda kështjellave të tyre.

Nëse vërejmë se çfarë thuhet në shumicën e transmetimeve, të traditës profetike dhe shi'ite, do të shohim se ky ajet është i miratuar në hadithet e Sufjaniut (një grup i vijës së

Ebu Sufjanit dhe të kohës së injorancës që do të kundërshtojnë ndjekësit e të vërtetës në kohën e shfaqjes së Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!)*). Sufjani dhe ushtria e tij humbet në shkretëtirë, në mes të rrugës për në Mekë. Kjo humbje është një fakt për atë që thotë ajeti: **"...do të nxirren prej varreve të tyre."**. Ata kanë marrë dënimin hyjnor në pikat më të afërta të tyre, nga toka, poshtë këmbëve të tyre, që dikur ishte vendpushteti i tyre. Shumë hadithe me këtë përmbajtje janë përmendur, nga: Ibn Abasi, Ibn Mesudi, Ebu Hurejre, Hudhjefe, Umu Selme dhe Aishja.[1]

Për komentimin e këtij ajeti, janë përmendur shumë hadithe jo vetëm prej librave shi'ite, p.sh: Tefsiri i El Kumij, "Mexhmaul Bejan", "Nuruth Thakalejn", Tefsiri "Es Safij', por edhe shumë prej librave syni të komentimit, si: tefsiri "Ruhul Meanij", "Ruhul Bejan" dhe Tefsiri El Kurtubij.

Eruditi El Mexhlisij *(All'llahu ia lartësoftë pozitë!)*, për këtë çështje, ka përmendur shumë transmetime prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ato transmetime tregojnë se janë një konfirmim i këtyre ajeteve.[2]

Siç e kemi thënë, transmetimet që i përmendin komentuesit, janë për të argumentuar kuptimin e ajetit.

Ajeti 52 paraqet situatën e tyre, pasi kanë marrë dënimi e All'llahut: **"Pastaj do të thonë: 'Ne tashmë besojmë'. Por si do ta përvetësojnë** (besimin) **nga një vend aq i largët** (prej kësaj bote, ku vlen besimi)**?!"**.

1 Tefsiri "El Mijzan", vëll. 16 , f. 419.
2 "Biharul Anuar", vëll. 52, f. 185 e më pas.

Po, sepse me lejimin e vdekjes dhe dënimin shfarosës janë mbyllur plotësisht dyert e rikthimit, ashtu si diga e fortifikuar bëhet ndarëse mes njeriut dhe mes faljes së gjynaheve të tij. Prandaj, shfaqja e besimit në atë moment duket sikur është nga një vend i largët dhe ai është një besim i detyruar, për shkak të frikës së madhe nga dënimi që do të marrin atje, njësoj si besimi, që në rrënjë nuk ka asnjë dobi.

Edhe ajeti 28 i sures "El En'am" shprehet për ta: **"Po, atyre iu doli sheshit ajo që më parë e fshihnin, por edhe sikur të ktheheshin, prapë do të bënin ato që u ishin ndaluar. Vërtet, ata janë gënjeshtarë."**.

Fjala *"et tenaueshu"* rrjedh nga fjala *"neushun"*, njësoj si fjala *"ueznun"*. Kuptimi i saj është: marrje, trajtim. Disa komentues kanë thënë se kuptimi i kësaj fjalë është: marrja me lehtësi. Lindin disa pyetje: Si e gjejnë ata besimin nga një vend i largët, kur nuk e kanë marrë dot nga afër? Si munden ata tani, edhe pasi ka përfunduar çdo gjë, të theksojnë arrogancën e gabimeve të tyre dhe të besojnë, kur ata, para kësaj, mohuan, edhe pse kënaqeshin me zgjedhjen dhe dëshirën.

Ata nuk u mjaftuan vetëm me mohimin, por të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe mësimeve të tij i ngjitën lloje të ndryshme akuzash. Kishin gjykime të gabuara për botën e fshehtë, Kiametin dhe profecinë. Ata thoshin me hamendje se s'ka ringjallje, s'ka përgjegjësi, etj.

Kuptimi i fjalës *"el kadhfu"*, siç kemi thënë, është gjuajtje nga larg. Kuptimi i fjalës *"el gajbu"*, është pas shqisave. Fjalia

është një kumtim i ëmbël për atë që shpall ligjet e tij, pa asnjë dituri të mëparshme apo njohuri, njësoj sikur gjuan diçka nga një pikë e largët. Mendimet, siguria dhe ligjet e tyre nuk i godasin qëllimet Tona, pasi, një herë, të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e quajtën magjistar, herën e dytë të çmendur, herën e tretë gënjeshtar. Jo vetëm kaq, por ata herë e kanë konsideruar Kur'anin produkt të mendimit njerëzor. Herë tjetër kanë mohuar plotësisht Xhennetin, Zjarrin dhe Kiametin. Të gjitha këto mendime e thënie të tyre ishin "thënie të pabaza" apo "gjueti zogjsh në errësirat e natës" apo me një shprehje tjetër "gjuajtja nga një vend i largët" .

Ajeti 54 thotë: **"Një pengesë do të vendoset midis tyre dhe asaj që dëshironin, ashtu siç është bërë me të ngjashmit e tyre më parë."**.

Në një çast të dhimbshëm, bëhet një ndarje mes tyre dhe mes të gjitha pasurive, thesareve, kështjellave dhe amaneteve të tyre. Si do të jetë situata e këtyre, që e donin me shpirt arin dhe argjendin dhe zemra nuk u bindej, për t'u çliruar nga gjërat më të thjeshta materiale, në atë çast kur do të japin lamtumirën e fundit, kur të mbyllin sytë dhe të ecin në drejtim të një të ardhmeje të errët të frikshme?

Sifjalia: **"Një pengesë do të vendoset midis tyre dhe asaj që dëshironin."**, është komentuar me dy mënyra:

Mënyra e parë është ajo që kemi paraqitur më lart.

Mënyra e dytë: Pengesa që vendoset, është midis besimit dhe arrogancës, që ata e humbën. Komentimi i parë harmonizohet më shumë me sifjalinë: **"Asaj që dëshironin."**.

Duke shtuar se fjalia: **"E përgënjeshtruan të padukshmen prej së largëti."**, ka paraqitur çështjen e pamundësisë së besimit të tyre në çastet e vdekjes dhe të dënimit të rëndë, siç e kemi përmendur.

Ajo që meriton të përmendet, është se shumë komentues, i kanë konsideruar këto ajete se janë të veçanta dhe flasin për dënimet në Ahiret dhe për pendimin e keqbërësve në Mahsher (fushën e tubimit). Mirëpo, ajeti i fundit e në veçanti sifjalia: **"Ashtu siç është bërë me të ngjashmit e tyre më parë."**, nuk përshtatet me këtë kuptim. Nuk ka asnjë dyshim, se qëllimi është çasti i vdekjes dhe shikimi i dënimit shkatërrues.

Sa bukur e thotë Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur, me fjalët e tij prej drite, formon një përshkrim të çasteve të ndarjes së shpirtit me botën e dynjasë dhe ndarjes së mirësive të saj: *"Ata njëkohësisht i kishte kapluar frika e vdekjes dhe keqardhja për atë që po u del duarsh. Gjymtyrët e tyre bëhen të plogëta, ndërsa ngjyra e lëkurës ndryshon. Pastaj vdekja shton vuajtjet mbi ta. Te ndonjëri, ajo qëndron mes tij dhe aftësisë së tij të të folurit, ndonëse është i shtrirë mes pjesëtarëve të familjes së vet, duke shikuar me sytë e tij, duke dëgjuar me veshët e tij... Pastaj ai mendon mbi atë që ka kaluar gjatë jetës së tij. Sjell në kujtesë pasurinë që kishte grumbulluar, duke menduar se e kishte siguruar nga burime të sigurta dhe të dyshimta. Ai do të kafshojë thonjtë, duke u penduar për atë që i është paraqitur për punët e tij, në çastin e vdekjes. Do ta urrejë atë që ka gjykuar gjatë jetës së tij dhe do të dëshirojë që tërë këtë, ta ketë grumbulluar në vend të tij ai që ka pasur lakmi për këtë dhe ka qenë xheloz ndaj tij."*.[1]

1 "Nehxhul Belaga", Fjalimi 109.

O All'llah! Na bëj ne prej atyre që janë të kujdesshëm, para se t'i humbim shanset dhe të urrejnë atë që ka humbur.

Dritarja e dynjasë dhe bashkëngjitjet e saj janë të kufizuara për ne, kurse armiku është i përgatitur. Nuk ka dyshim se punët tona janë në qorrsokak dhe të përbuzura.

O All'llah! Na bëj ne prej atyre që falënderojnë mirësinë, kur rrethohen prej tyre dhe na ruaj ne nga hutimi, pavëmendja dhe kryeneçësia!

Na bëj ne prej atyre që nuk e heqin shpresën, kur vijnë fatkeqësitë dhe vështirësitë!

Ti je i Larti, Dëgjuesi!

Perktheu: Edmond Abazi

Fundi i sures "Sebè".

Sure "El Fàtir"

Zbritur në Mekë, numri i ajeteve 45

Përmbajtja e sures

Kjo sure quhet "El Fàtir", ose "El Melàiketu", sepse në fjalinë e parë është përmendur fjala "Fàtir". Është quajtur "El Melàiketu", sepse është prej sureve të zbritura në Mekë. Disa, duke veçuar ajetin 29 dhe ajetin 32 të kësaj sureje, kanë thënë se këto dy ajete të kësaj sureje kanë zbritur në Medine. Ne nuk kemi gjetur argument që të vërtetojë këtë përjashtim.

Duke qenë prej sureve të zbritura në Mekë, përmbajtja e sures "El Fàtir", në përgjithësi, ka tiparet e përbashkëta që kanë suret e zbritura në Mekë, të cilat flasin për thirrjen e Profetëve, për fillimin e krijimit, ringjalljen pas vdekjes, Njëtimin e All'llahut (Teuhidin) (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm). Ato përmendin mirësitë e shumta e të mëdha që All'llahu i Lartësuar ka dhuruar. Gjithashtu, këto sure, flasin edhe për të ardhmen e mohuesve dhe për Ditën e Gjykimit.

Ajetet e kësaj sureje, mund të përmblidhen në pesë pjesë:

1- Një pjesë e ajeteve të kësaj sureje, flet për shenjat e madhështisë së All'llahut në botën e ekzistencës dhe për argumentet që vërtetojnë Njëtimin e All'llahut (Teuhidin).

2- Një pjesë tjetër e ajeteve të kësaj sureje, flet për cilësinë krijuese të All'llahut dhe për fuqinë e Tij, për drejtimin e punëve të të gjitha botëve, në mënyrë të veçantë punët e njeriut. Gjithashtu, kjo pjesë e ajeteve flet për cilësinë krijuese dhe furnizuese të All'llahut, flet për krijimin e njeriut prej dheut dhe për fazat e plotësimit të njeriut.

3- Pjesa tjetër e ajeteve të kësaj sureje, flet për ringjalljen pas vdekjes dhe rezultatin e punëve të njerëzve në Botën Tjetër;

flet për mëshirën e pamat të All'llahut në këtë botë, si dhe për Rrugën e Tij të patjetërsueshme në lidhje me mendjemëdhenjtë.

4- Një pjesë tjetër e ajeteve të kësaj sureje, flet për çështjen e udhëheqjes së Profetëve dhe luftës së tyre të ashpër e të vazhdueshme, në Rrugën e All'llahut, kundër armiqve kokëngjeshur. Në mënyrë të veçantë, këto ajete njoftojnë fjalët e ngrohta e ngushëlluese që i drejtohen Profetit të Islamit, Profetit më të nderuar, Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

5- Pjesa e pestë e ajeteve të kësaj sureje, shpalos këshilla e porosi hyjnore, në lidhje me çështjet e mësipërme dhe konsiderohet si plotësuese për katër pjesët e para.

Disa interpretues të Kur'anit, e kanë përmbledhur përmbajtjen e të gjithë sures në një temë të vetme: hegjemonia e All'llahut në të gjitha punët.[1]

Duke pasur në konsideratë se pjesa më e madhe e ajeteve të kësaj sureje është në harmoni të plotë me përshkrimin e mësipërm, përsëri nuk mund të mohohet mundësia që në ajetet e kësaj sureje, të trajtohen edhe tema të ndryshme.

1 Tefsiri "Fi Dhilàlil Kur'àn", fillimi i sures "Fàtir".

Mirësia e leximit të sures "El Fàtir"

Në një hadith të ardhur prej Profetit më të madh, Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Kush lexon suren 'El Melàiketu', në Ditën e Kiametit, atë e thërresin tri porta prej portave të Xhennetit, që të hyjë në cilën portë të dëshirojë."*.[1]

Duke vështruar në atë që dimë, portat e Xhennetit janë besimi dhe punët e mira, janë mjetet për arritjen e Xhennetit, ashtu siç thuhet në disa transmetime islame, se njëra prej portave të Xhennetit quhet "porta e luftëtarëve në Rrugën e All'llahut" *(bàbul muxhàhidijn)* dhe emra të tjerë të ngjashëm. Nga ky këndvështrim, transmetimi i mësipërm mund të tregojë trekëndëshin e besimit: "Njëtimi i All'llahut – Profetësia – Ringjallja pas vdekjes".

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Dy hamdet, hamd "Sebein" dhe hamd "Fàtir" (dy suret që fillojnë me frazën "El hamdu lil'làhi" - "Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për All'llahun"). Kush i lexon këto dy sure natën, atë natë ai është nën ruajtjen e All'llahut dhe, kush i lexon këto dy sure ditën, atë ditë atë nuk e prek asnjë e keqe dhe atij i jepet prej të mirave të kësaj bote e të Botës Tjetër, aq sa atij nuk i ka shkuar ndërmend dhe as ka pasur shpresë t'i arrijë."*.[2]

Do të përsërisim atë që kemi thënë më sipër: Kur'ani është program pune. Leximi i Kur'anit është fillimi i mendimit, besimi

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 4, f. 399, fillimi i sures "Fàtir".
2 Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 345.

është mjeti për të punuar sipas përmbajtjes së ajeteve të Kur'anit. Ky shpërblim i madh bëhet realitet vetëm me këto kushte. (Mendo rreth kësaj pune!)

Ajetet 1 – 3

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ فَاطِرِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ جَاعِلِ الْمَلَائِكَةِ رُسُلًا أُولِي أَجْنِحَةٍ مَثْنَى وَثُلَاثَ وَرُبَاعَ يَزِيدُ فِي الْخَلْقِ مَا يَشَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ١ مَا يَفْتَحِ اللَّهُ لِلنَّاسِ مِنْ رَحْمَةٍ فَلَا مُمْسِكَ لَهَا وَمَا يُمْسِكْ فَلَا مُرْسِلَ لَهُ مِنْ بَعْدِهِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ٢ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اذْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ هَلْ مِنْ خَالِقٍ غَيْرُ اللَّهِ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَأَنَّى تُؤْفَكُونَ٣﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"**Lavdërimi qoftë për All'llahun, krijuesin e qiejve dhe Tokës, i Cili i ka bërë engjëjt të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë. All'llahu, me të vërtetë, është i pushtetshëm për çdo gjë.**"

"**Begatitë, që All'llahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t'i pengojë askush, ndërsa atë, që Ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç Tij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.**"

"O njerëz! Kujtoni dhuntinë e All'llahut për ju! A ka ndonjë krijues, veç All'llahut, i cili ju furnizon nga qielli dhe Toka? S'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij. Atëherë, si po largoheni ju?"

Komentimi

Hapësi i bravave të portave

Edhe kjo sure, ashtu si suret "El Fàtiha", "Sebe" dhe "El Kehf", fillon me fjalën *"el hamdu lil'làhi"* - "Falënderimi e lavdërimi është vetëm për All'llahun, për Krijuesin e kësaj gjithësie, pa anë e pa fund. All'llahu i Lartësuar thotë: "**Lavdërimi qoftë për All'llahun, krijuesin e qiejve dhe Tokës."**.

Fjala *"Fàtir*, në rrënjën e saj *"fetare"*, do të thotë *"çarje për së gjati"*, sepse krijimi i çdo gjëje që gjendet, është i ngjashëm me një çarje të errësirës së mosekzistencës për daljen në dritën e ekzistencës. Ky term përdoret, në mënyrë të veçantë, për krijimin e njerëzve, ashtu siç e shikojmë në teoritë e shkencës së hadithit, ku thuhet se bota e qenieve, në fillim, ishte vetëm një grumbull dhe pastaj, në mënyrë graduale, pjesët e këtij "grumbulli" u ndanë njëra nga tjetra.

Përdorimi i fjalës *"Fàtir"* për All'llahun, të Gjithëfuqishmin, i jep fjalës një kuptim të ri dhe shumë më të qartë në kuptim: Po, ne e madhërojmë dhe e falënderojmë All'llahun për fuqinë e Tij

krijuese, sepse çdo gjë që ekziston, është vetëm prej All'llahut të Lartësuar dhe askush përveç Atij s'ka ndonjë send prej vetvetes.[1]

Rregullimi e sistemimi i punëve të kësaj bote, pa dyshim që është vetëm prej të Gjithëfuqishmit, Filluesit të çdo krijese, me gjykimin se bota jonë është bota e shkaqeve. Fjala *"Fàtir"* - *"Krijues"*, në vijim të ajetit, është si një parathënie që shpjegon edhe krijimin e engjëjve, pasi ajeti, menjëherë pas fjalës *"Fàtir"* - *"Krijues"*, fillon të flasë drejtpërdrejt për engjëjt dhe për fuqitë e mëdha që All'llahu u ka dhuruar atyre: "I **ka bërë engjëjt të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë. All'llahu, me të vërtetë, është i pushtetshëm për çdo gjë.**".

Këtu shtrohen tri pyetje:

E para: Si është kumti i engjëjve, që përmendet në këtë ajet? A është kumt ligjor dhe sjellje e urdhrave prej Filluesit të krijesave për te Profetët, apo është kumt ndërtues, domethënë ngarkimi me përgjegjësi të ndryshme në botën e krijimit, ashtu siç do të vijë në vijim, apo qëllimi me fjalën "kumt", është për të dyja mënyrat.

Nëse do të vërejmë fjalinë e parë të ajetit, që flet për krijimin e qiejve e të Tokës dhe ato që thuhen në fjalinë e fundit, që flet për numrin e krahëve të engjëjve, kjo fjali e ajetit tregon për fuqinë e engjëjve. Gjithashtu, në këtë frazë vërejmë se fjala "kumt" është përdorur në raport me të gjithë engjëjt, *"el melàiketu"* në gjuhën arabe, që në këtë ajet ka ardhur e bashkuar më nyjën shquese *"el"*, të emrave të arabishtes.

1 Kuptimin e fjalëve *"fàtir"* dhe *"fetare"* e kemi trajtuar në fundin e ajetit 10 të sures "Ibrahim", gjithashtu edhe në komentin e ajetit 14 të sures "El En'àm".

Nga ky ndërtim i fjalës *"el melàiketu"*, del qartë se bëhet fjalë për të gjithë engjëjt. Nga ana tjetër, fjala *"el melàiketu"* shpjegon se qëllimi i përdorimit të fjalës "kumt" ka një kuptim shumë të gjerë dhe përfshin të dy llojet e kumteve: "kumtin ligjor" dhe "kumtin ndërtues".

Përdorimi i fjalës "kumt" për "kumtin ligjor" dhe kumtimin e Revelatës së Profetëve, në Kur'anin Famëlartë, ka ardhur shumë herë. Gjithashtu, kjo fjalë është përdorur jo pak herë edhe për "kumtin ndërtues".

Në ajetin 21 të sures "Jùnus", lexojmë: "**Me të vërtetë, të dërguarit Tanë** (engjëjt) **shënojnë intrigat tuaja."**.

Në ajetin 61 të sures "El En'àm", lexojmë: "**Ai është Sunduesi mbi robtë e Vet. Ai ju dërgon rojtarë** (engjëj) **të cilët, kur ndonjërit nga ju i vjen vdekja, ia marrin shpirtin, duke mos bërë kurrfarë lëshimi."**.

Në ajetin 31 të sures "El Ankebùt", lexojmë: "**Dhe, pasi të dërguarit Tanë i sollën lajmin e mirë Ibrahimit, i thanë: 'Ne do t'i zhdukim banorët e këtij vendbanimi, sepse banorët e tij janë vërtet keqbërës.'"**.

Edhe në ajete të tjera të Kur'anit, shikojmë se engjëjt janë urdhëruar me detyra të ndryshme, detyra që numërohen prej "misioneve të engjëjve". Duke u bazuar mbi këto ajete, del qartë se fjala "kumt" ka një kuptim shumë të gjerë.

E dyta: Cili është qëllimi i përdorimit të fjalësn *"exhnihatin"* - *"krahë"*, për të cilën ajeti shprehet: "dy, tri dhe katër palë"?

Këtu nuk përjashtohet mundësia që, qëllimi i përdorimit të fjalës "krahë", të jetë fuqia për të kaluar, për t'u shndërruar dhe mundësia për punë, në atë mënyrë që disa kanë më shumë përparësi se disa të tjerë dhe kanë fuqi më të madhe.

Në ajet janë përmendur një seri gradash në lidhje me engjëjt; disa kanë katër palë krahë, disa dy palë, të tjerë kanë nga gjashtë palë dhe disa të tjerë kanë nga tetë palë krahë etj.

Fjala e ajetit *"exhnihatin" - "krahë"* është shumësi i fjalës *"xhenàh" – "krah, flatër"*, në saje të të cilave shpendi fluturon. Për shpendin, krahu është si dora për njeriun, sepse shpendi i përdor krahët e tij si mjet për të kaluar nga një vend në një tjetër. Më pas, kjo fjalë është përdorur si metaforë për mjetin lëvizës dhe element i fuqisë lëvizëse, ashtu siç thuhet, për shembull: njeriu e ka detyrim të fluturojë me të dy krahët, me dituri dhe me punë. Shumë shprehje të tilla theksojnë kuptimet metaforike të kësaj fjale.

Në ajetet e Kur'anit, vihet re se qëllimi i përdorimit të fjalëve: *"el arshu" - "froni"*; *"el kursij'ju" – "karrigia"*; *"el leuhu" – "tabela"*; *"el kalemu" – "lapsi"*, janë emra kuptimi dhe jo realiteti lëndor i këtyre gjërave.

Natyrisht që nuk është e mundur mbartja e fjalëve të Kur'anit në një kuptim tjetër nga kuptimi që shprehin, pa pasur një ajet tjetër krahasues, por, kur ka ajet krahasues, mbartja e kuptimit nuk është problem.

Në disa transmetime, lexojmë se Xhibrili, engjëlli i shfaqjes hyjnore, ka gjashtëqind palë krahë dhe ai, kur takohej me Profetin

Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mbulonte hapësirën ndërmjet Tokës e Qiellit.[1]

Në "Nehxhul Belàgah", kur Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, flet për madhësinë e engjëjve, ka thënë: *"Ka engjëj që i kanë këmbët të fiksuara në thellësi të Tokës, qafat e tyre arrijnë në lartësinë e qiejve, gjymtyrët u dalin jashtë kufijve të Tokës dhe shpatullat e tyre janë të përshtatura në kolonat mbajtëse të Arshit.*[2] *Ka engjëj të tjerë aq të mëdhenj, sa largësia nga veshi deri te sytë e tyre, është sa largësia që përshkohet me pesëqind vjet fluturim."*.[3]

Është e qartë se këto kuptime nuk mund të mbarten në përmasën trupore dhe lëndore, pasi qëllimi me këtë shprehje është që të shpjegohet madhështia morale dhe përmasat e largëta të fuqisë së engjëjve.

Ne dimë se, me *"krahët"*, zakonisht përfitohet në atmosferën e Tokës, e cila është e rrethuar me një veshje gazi prej ajri të ngjeshur dhe shpendët përfitojnë prej valëve ajrore kur fluturojnë. Në saje të krahëve, shpendët ngrihen lart e ulen poshtë. Por, sapo ne dalim jashtë mbështjelljes së gaztë të Tokës, domethënë, kur kalojmë në hapësirat ku ajri mungon, krahët në këto hapësira s'kanë asnjë lloj roli për të realizuar lëvizjen dhe në këtë gjendje janë si të gjitha gjymtyrët.

Kur flitet për atë engjëll që i ka këmbët në thellësi të Tokës dhe kokën në lartësinë e qiellit më të largët, kuptohet se ai s'ka nevojë për fluturim trupor.

---

1 Tefsiri "Nùruth Thekalejni", vëll. 4, f. 349.
2 "Nehxul Belàgah", Hytbeja 1.
3 Tefsiri i Ali Ibrahimit, cituar sipas tefsirit "Nuruth Thekalejni", vëll. 4, f. 349.

Çështja, nëse engjëjt janë trupa të tejdukshëm, ose janë abstraksione, me lejen e All'llahut, do të flasim në studimet e tjera, por qëllimi tani është të mësojmë se pendët e puplat, në raport me engjëjt, janë mjete të efektshme për lëvizje dhe tregojnë fuqinë e engjëjve, për të cilën flasin ajetet krahasuese që ne i pamë më sipër. Nga ky këndvështrim, "krahët" te engjëjt shprehin madhështinë dhe fuqinë, ashtu siç pamë se dy fjalët *"el arshu"* dhe *"el kursij'ju"* theksojnë përmasa të ndryshme të fuqisë së All'llahut në botën e Gjithësisë.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Engjëjt nuk hanë, nuk pinë, nuk martohen dhe rrojnë me flladin e Arshit."*.[1]

E treta: Fjalia e ajetit: "**Ai shton në krijim çfarë të dojë."**, a tregon shtimin e krahëve të engjëjve, ashtu siç kanë thënë disa interpretues të Kur'anit, apo ka një kuptim shumë më të gjerë se kjo që u tha, në atë mënyrë që, përveç shtimit të krahëve të engjëjve, fjala "shtim" përfshin edhe shtim në krijimin e qenieve të tjera.

Nga njëra anë, kjo fjali e ajetit nuk është e kushtëzuar. Nga ana tjetër, në transmetimet që kanë ardhur, në lidhje me interpretimin e këtyre ajeteve, theksohet se kuptimi i dytë është më shumë në përshtatje me fjalët e Kur'anit.

Në një frazë të një hadithi të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Është fytyra e bukur, zëri i bukur dhe floku i bukur."*.[1]

1 Në lidhje me kuptimin e fjalës *"el arshu"*, lexo shpjegimin që kemi vënë për këtë fjalë në komentin e ajetit 54 të sures "El A'ràf".

Në një hadith tjetër të ardhur prej të Dërguarit më të madh *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë fjalën e tij: *"Zbukurojeni Kur'anin me zërat tuaj, sepse zëri i bukur e shton bukurinë e Kur'anit"* dhe pastaj lexoi ajetin: "**Ai shton në krijim çfarë të dojë."**. [2]

Pas bisedës në lidhje me fuqinë krijuese të All'llahut të Gjithëfuqishëm dhe për rolin e "kumtit" të engjëjve, që janë ndërmjetësit e kumtimit të shfaqjes hyjnore, ajetet objekt studimi kalojnë në bisedën rreth mëshirës së All'llahut të Gjithëpushtetshëm, që është baza për të gjithë botën e ekzistencës. Në lidhje me këtë, ajeti njofton: "**Begatitë, që All'llahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t'i pengojë askush, ndërsa atë, që Ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç Tij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."**.

Me fjalë të përmbledhura, rezulton se të gjitha thesaret e mëshirës gjenden vetëm te All'llahu dhe Ai u jep prej mëshirës së Tij atyre që e meritojnë, për ata Ai hap portat e mëshirës, sipas kërkesave të Urtësisë së Tij. Njëkohësisht, ajeti njofton se njerëzit janë të pafuqishëm të mbyllin atë që e ka hapur All'llahu, edhe sikur të ndihmojnë njëri-tjetrin. Gjithashtu, njerëzit s'kanë fuqi të hapin portën që e ka mbyllur i Gjithëfuqishmi. Ky kuptim, në të vërtetë, është njëra degë e rëndësishme e studimit rreth Njëtimit të All'llahut (Teuhidit) dhe prej kësaj dege dalin degë të tjera. (Medito!)

---

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejàn" dhe tefsiri i Kurtubij'jit, fundi i ajetit objekt studimi.

2 "Bihàrul Enuàr", vëll. 92, f. 193.

Një kuptim i ngjashëm është shprehur edhe në ajete të tjera të Kur'anit, ashtu siç thotë All'llahu i Lartësuar në ajetin 107 të sures "Jùnus": "**Nëse All'llahu vendos që të të godasë ndonjë e keqe, askush nuk mund të ta largojë atë, përveç Tij e, nëse Ai do të të bëjë ndonjë të mirë, s'ka kush që ta pengojë mirësinë e Tij. Ai ia jep atë mirësi kujt të dojë prej robve të Tij. Ai është Falës dhe Mëshirëplotë."**.

Hulumtime

1- Fjala e ajetit *"jeftehu"*, në rrënjën e saj *"feteha"* – *"hapi"*, tregon për ekzistencën e depove të mëshirës hyjnore që përmenden edhe në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë. Në ajetin objekt studimi, tërheq vëmendjen fakti se, sapo të hapen këto depo, prej tyre, mbi të gjitha krijesat zbret mëshira, pa pasur nevojë për ndonjë send tjetër. Veç kësaj, askush nuk mund të ndalojë zbritjen e kësaj mëshire.

Fakti që në këtë ajet, zbritja e mëshirës ka ardhur para ndalimit të mëshirës, është argument që vërteton se mëshira e All'llahut gjithmonë e parakalon zemërimin e Tij.

2- Fjala e ajetit *"rahmetun"* - *"mëshirë"*, ka kuptim të gjerë dhe përfshin të gjitha dhuntitë hyjnore në botën e Gjithësisë, dhunti materiale e jomateriale. Ky është edhe shkaku që, kur besimtarit i mbyllen të gjitha dyert, ai e ndien se mëshira e All'llahut shtrihet në zemrën e në shpirtin e tij, prandaj ai është i

gëzuar, i kënaqur me aq sa ka, është i qetë dhe i siguruar, qoftë edhe në se është rob lufte i burgosur.

Herë tjetër, gjendja është e kundërta dhe kjo ndodh kur për njeriun të gjitha dyert janë të hapura. Megjithëkëtë, në thellësinë e vet, ai ndien se është në gjendje të ngushtë e nën presion. Botën, me tërë gjerësinë e saj, ai e mendon një burg të errët e shumë të egër. E gjitha kjo vjen se, në thellësitë e tij, nuk është hapur porta e mëshirës hyjnore. Kjo është një punë që ndihet konkretisht te të gjithë.

3- Përmendja e dy cilësive të larta të All'llahut: *"el azijzu"* - *"i Gjithëfuqishmi"*, *"el hakijmu"* - *"i Urti"*, ka ardhur për të shpjeguar më qartë fuqinë e All'llahut të Lartësuar, për të "lëshuar" dhe për të "ndaluar" mëshirën në çast.

Gjithashtu, janë një shenjë që tregon se lëshimi dhe ndalimi i mëshirës ndodh në çdo kohë që i Larti do. Por lëshimi e ndalimi bëhet mbi bazën e urtësisë së Tij, sepse fuqia e Filluesit të të gjitha sendeve dhe urtësia e Tij, janë të pandara.

Në të gjitha gjendjet, ky ajet i jep njeriut besimtar qetësi e rehati, e bën besimtarin që t'u rezistojë të gjitha ndodhive dhe të mos ketë frikë prej problemeve e, gjithashtu, e largon besimtarin prej mendjemadhësisë, atëherë kur ai ka sukses dhe arrin fitore.

Ajeti vijues e vë theksin mbi atë që në terminologjinë islame quhet *"teuhijdul ibàdeh"* - "adhurim kushtuar vetëm All'llahut, adhurim i ngritur mbi themelin e *"teuhijdul khàlikj'jeti uerr'rràzikij'jeti"* - "vetëm All'llahu ka fuqi të krijojë e të furnizojë". Ajeti i nderuar njofton: "**O njerëz! Kujtoni dhuntinë e All'llahut për ju!"**.

Mendoni me qetësi se cili është burimi i këtyre mirësive, i begative dhe i mundësive për jetën, që derdhen mbi ju? Kur'ani shtron pyetjen: "**A ka ndonjë krijues, veç All'llahut, i cili ju furnizon nga qielli dhe Toka?"**.

Kush e dërgon dritën e Diellit për ju, që me atë dritë të ecë jeta? Kush i lëshon pikat e shiut, që u japin jetë tokave të vdekura? Kush e dërgon për ju flladin që u gjallëron shpirtin? Cili është ai që nxjerr prej tokës mineralet, ushqimin tuaj, llojet e bimëve, të frutave dhe të begative të tjera?

Kur të mësoni se burimi i të gjitha këtyre begative është vetëm All'llahu, atëherë dijeni se: "**S'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij."**.

Si është e mundur që ju i shmangeni rrugës së vërtetë dhe shkoni në rrugën e gabuar, madje arrini deri aty sa të adhuroni idhujt, në vend që të adhuroni vetëm All'llahun e Lartësuar: "**Atëherë, si po largoheni ju?"**.

Fjala e ajetit "تُؤْفَكُونَ" - *"tu'fekùne"*, në rrënjën e saj *"ifkun"*, do të thotë: *"largim nga të gjitha anët e të vërtetës"* dhe nga ky kuptim, çdo gënjeshtre që i largohet të vërtetës, i thuhet shpifje. Por ka edhe prej atyre që thonë se fjala *"ifkun"* - *"shpifje"*, përdoret për gënjeshtrën në punë të liga dhe për akuzën në nder.

Engjëjt në Kur'anin Famëlartë

Në Kur'anin Famëlartë, engjëjt përmenden shpesh dhe në ajete të ndryshme të Kur'anit flitet për cilësitë, detyrat dhe funksionet e engjëjve. Madje Kur'ani Famëlartë besimin te engjëjt, e ka bërë pjesë të besimit, përveç besimit te All'llahu, te Profetët e te librat qiellorë, çka tregon rëndësinë shumë të madhe të kësaj çështjeje themelore të besimit, ashtu siç thuhet në ajetin 285 të sures "El Bekare": "I Dërguari i All'llahut i besoi asaj që iu zbrit prej Zotit të tij, po ashtu edhe besimtarët, secili besoi në All'llahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij dhe në të Dërguarit e Tij.".

Natyrisht, ekzistenca e engjëjve është prej punëve të fshehta dhe nuk mund të vërtetohet me këto cilësi që përshkruhen, përveçse me argument të shkruar në librat e fesë, prandaj, besimi te engjëjt është detyrim dhe është prej besimit në të fshehtat.

Në tërësi, Kur'ani Famëlartë i shpalos karakteristikat e engjëjve si më poshtë:

1- Engjëjt janë krijesa me logjikë dhe kanë ndjenja, janë robër të nderuar prej robve të All'llahut, ashtu siç njofton ajeti 26 i sures "El Enbijà": "jo, ata (engjëjt) rob të nderuar.".

2- Engjëjt janë të bindur ndaj urdhrave të All'llahut dhe kurrë nuk e kundërshtojnë urdhrin e Tij, ashtu siç njofton ajeti: "Ata (engjëjt) nuk flasin para Tij dhe veprojnë vetëm me urdhrin e Tij.".[1]

1 Sure "El Enbijà", ajeti 27.

3- Engjëjt kanë detyra të rëndësishme dhe të shumëllojshme, me të cilat janë ngarkuar prej Krijuesit të Madhëruar.

Një grup engjëjsh mbartin Arshin: "...dhe engjëjt qëndrojnë në anët e tij (Qiellit); atë Ditë tetë (engjëj) mbartin sipër tyre arshin e Zotit tënd.".[1]

Të tjerë janë ngarkuar me sistemimin e punëve: "Betohem për rregulluesit e punëve.".[2]

Të tjerë janë ngarkuar me marrjen e shpirtrave: "**E, kur t'u vijnë të dërguarit Tanë** (engjëj)**, për t'ua marrë shpirtin."**.[3]

Të tjerë kontrollojnë punët e njerëzve: "Mbi ata ka ruajtës. Shkrues të ndershëm. Ata e dinë se ç'bëni ju.".[4]

Një grup engjëjsh e ruajnë njeriun prej rreziqeve e aksidenteve: "Ai është Mposhtësi mbi robtë e Tij, Ai dërgon ruajtës për ju, derisa ndonjërit prej jush i vjen vdekja dhe kumtërit Tanë u marrin atyre shpirtin; (në punën e tyre) ata nuk bëjnë asnjë lëshim.".[5]

Të tjerë janë ngarkuar të zbatojnë dënimin mbi grupe të caktuara njerëzish: "Dhe kur të dërguarit Tanë erdhën te Lùti, ai u ndje shumë keq për ata, u rëndua shumë nga ardhja e tyre dhe tha: kjo është një ditë e vështirë.".[6]

---

1 Sure "El Hak'katu", ajeti 17.
2 Sure "En Nàziàt", ajeti 5.
3 Sure "El A'ràf", ajeti 37.
4 Sure "El Infitàr", ajetet 10-12.
5 Sure "El En'àm", ajeti 66.
6 Sure "Hùd", ajeti 77.

Engjëj të tjerë janë ngarkuar të forcojnë besimtarët, kur ata luftojnë: "Ju që keni besuar, kujtojeni të mirën që All'llahu bëri për ju, kur kundër jush erdhën ushtri; Ne lëshuan kundër tyre furtunë dhe ushtri që ju nuk i shihnit, por All'llahu i sheh punët që ju bëni.".[1]

Të tjerë janë ngarkuar me kumtimin e Shpalljes hyjnore dhe me zbritjen e librave qiellorë Profetëve: "Me urdhrin e Tij Ai i zbret engjëjt me Shpalljen atij që ai dëshiron prej robve të Vet që të paralajmërojnë se nuk ka zot tjetër përveç Meje dhe kini frikë prej Meje.".[2]

Sikur të rendisnim detyrat e tjera të engjëjve, studimi ynë do të zgjatej e do të zgjerohej shumë.

4- Engjëjt gjithmonë madhërojnë All'llahun e Lartësuar: "Engjëjt madhërojnë dhe falënderojnë Zotin e tyre, ata kërkojnë faljen e mëkateve për ata që janë në Tokë.".[3]

5- Fakti se njeriu, sipas përgatitjes së tij të plotë, ka mundësi të jetë në pozitën më të lartë dhe të jetë më i nderuar se engjëjt, është shkaku që engjëjt, pa asnjë përjashtim, u urdhëruan të bëjnë sexhde për krijimin e Ademit dhe e konsiderojnë Ademin mësuesin e tyre. (Referoju ajeteve 30-34 të sures "El Bekare".)

6- Engjëjt u janë shfaqur Profetëve në formën e njeriut dhe u shfaqen edhe të tjerëve në formën e njeriut, ashtu siç e lexojmë në ajetin 17 të sures "Merjem": "Ne dërguan te ajo (Merjemi) engjëllin Tonë dhe ai u paraqit te ajo njeri i zakonshëm.".

1 Sure "El Ahzàb", ajeti 9.
2 Sure "En Nahl", ajeti 2.
3 Sure "Esh Shùrà", ajeti 5.

Në Kur'anin Famëlartë thuhet se engjëjt u janë shfaqur në formën e njeriut Ibrahimit e Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*. (Ajetet 69-77, sure "Hùd".) Gjithashtu, në fundin e këtyre ajeteve, tregohet se populli i Lutit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i pa engjëjt në formën e njeriut. (Sure "Hùd", ajeti 78.)

Vallë, kjo shfaqje e engjëjve në formën njerëzore, është realitet konkret, apo shfaqja e tyre ishte në atë formë që përfaqësohet në fuqinë e konceptimit? Ajetet e Kur'anit tregojnë kuptimin e parë, edhe pse disa prej interpretuesve të dëgjuar të Kur'anit kanë parapëlqyer kuptimin e dytë.

7- Prej transmetimeve, mësohet se numri i engjëjve është shumë i madh dhe nuk mund të krahasohet me numrin e njerëzve, në asnjërën anë të kuptimit të fjalës "shumë i madh". Kur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur nëse engjëjt janë më shumë se njerëzit, ai ka thënë: "*Betohem në atë që ka shpirtin tim në dorën e Tij, engjëjt e All'llahut në Qiell janë më shumë se kokrrizat e dheut në Tokë; në Qiell s'ka asnjë vend që të mos ketë një engjëll që e adhuron dhe e madhëron All'llahun e Lartësuar. Në Tokë s'ka asnjë pemë e asnjë pëllëmbë vend, ku të mos jetë një engjëll përgjegjës, të cilin All'llahu e informon për punën e asaj peme apo të atij vendi. S'ka asnjë engjëll që nuk lutet për familjen e Profetit dhe kërkon faljen e mëkateve për dashamirët e familjes së Profetit dhe s'ka asnjë engjëll që nuk i mallkon ata që shfaqin armiqësi ndaj familjes së Profetit. Engjëjt i luten All'llahut që mbi këta armiq të lëshojë dënimin e Tij.*".[1]

8- Engjëjt as hanë, as pinë e as martohen. Në një transmetim të gjatë, të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi*

1 "Bihàrul Enuàr", vëll. 59, f. 176.

të!), lexojmë: *"Engjëjt nuk hanë, nuk pinë dhe nuk martohen. Ata rrojnë me flladin e Arshit."*.[1]

9- Engjëjt nuk flenë, nuk dobësohen dhe nuk janë të shkujdesur. Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të Besimtarëve, Imam Ali bin Ebu Talibit, lexojmë: *"Engjëjt që Ti i krijove dhe i vure të banojnë në qiejt Tuaj, engjëjt në asnjë çast nuk janë të shkujdesur, engjëjt nuk mëkatojnë, engjëjt janë krijesat më të ditura për madhërinë Tënde, engjëjve nuk u mbyllen sytë prej gjumit, engjëjt nuk harrojnë, engjëjt s'kanë faza të formimit të trupit, nuk janë në palcën kurrizore të mashkullit e as nuk janë ngjizur në mitra."*.[2]

10- Engjëjt kanë pozita të ndryshme, ashtu siç e lexojmë në ajetet 164-166 të sures "Es Sàf'fàt": "S'ka prej nesh (engjëjve) që nuk e ka pozitën e vet të njohur. Dhe ne (engjëjt) jemi të rreshtuar (në adhurim). Ne (engjëjt) e madhërojmë All'llahun.".

Në transmetimin e lartpërmendur, të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Ka engjëj që qëndrojnë në ruku për All'llahun, deri në Ditën e Kiametit. Gjithashtu, ka engjëj që qëndrojnë në sexhde për All'llahun deri në Ditën e Kiametit."*.[3]

Për më shumë informacion, në lidhje me cilësitë dhe kategoritë e engjëjve, lexo pjesën "Es'semàu uel àlemu" – "Qielli dhe Bota", të librit "Bihàrul Enuàr", kapitulli "Engjëjt", (vëll. 59, f. 144-326).

1 Burimi i mësipërm, f. 174; në lidhje me këtë çështje, janë cituar disa transmetime dhe mund t'i lexoni.
2 Burimi i mësipërm, f. 175.
3 "Bihàrul Enuàr", vëll. 59, f. 174.

Gjithashtu, lexo në "Nehxhul Belàgah", Ligjëratat 1, 91 dhe ligjërata "El Eshbàhu", si dhe ligjëratat (hytbet) 109 dhe 171.

Engjëjt me këto cilësi që u thanë, a janë apo nuk janë qenie lëndore?

Pa dyshim që engjëjt, me këto cilësi, është e pamundur të jenë prej lëndës së ngjeshur, por s'ka asnjë pengesë të thuhet që engjëjt janë qenie fluide dhe trupa përtej lëndës së zakonshme që ne njohim.

Vërtetimi absolut se për engjëjt nuk ka as kohë, as vend e as nuk pjesëtohen, nuk është një çështje e lehtë. Gjithashtu, arritja në këtë rezultat, s'ka ndonjë dobi të madhe. Është shumë e rëndësishme, që ne të njohim engjëjt me ato cilësi që i ka përshkruar Kur'ani dhe i lexojmë në transmetimet e vërtetuara për saktësinë e tyre. Ne duhet të dimë se engjëjt janë qenie të larta, që ngjiten deri te All'llahu, në pozitën e në detyrën që ato kanë. Ne nuk i besojmë engjëjt jashtë pozitës së adhurimit e të madhërimit të All'llahut të Lartësuar.

Gjithashtu, ne dimë se besime të ndryshme thonë se engjëjt janë ortakë të All'llahut në çështjen e krijimit, ose janë ortakë të All'llahut në adhurim. Të gjitha këto besime janë mohim i mirëfilltë dhe idhujtari e qartë.

Do të mjaftohemi vetëm me këtë shkoqitje në lidhje me engjëjt dhe hollësitë e shumta i lemë në librat e shkruar në lidhje me cilësitë dhe punët e engjëjve.

Në shumë shprehje të Teuratit, që flasin për engjëjt, lexojmë fjalën *"el àlihetu"* - *"zotat"*. S'ka dyshim që këtu kemi të bëjmë me një dukuri idhujtarie, që tregon se Teurati i tanishëm

është i shmangur, kurse Kur'ani Famëlartë është krejtësisht i pastër nga shprehje të tilla, sepse Kur'ani i sheh engjëjt vetëm në pozitën e robërisë ndaj All'llahut dhe si krijesa që adhurojnë vetëm All'llahun, si krijesa të bindura ndaj urdhrave të Tij. Madje Kur'ani, në disa ajete, shprehet hapur në lidhje me përparësinë e njeriut të plotësuar ndaj engjëjve, në pikëpamjen e pozitës së nderimit e të respektit që gëzon njeriu te All'llahu i Lartësuar.

Ajetet 4 – 7

﴿وَإِنْ يُكَذِّبُوكَ فَقَدْ كُذِّبَتْ رُسُلٌ مِنْ قَبْلِكَ وَإِلَى اللَّهِ تُرْجَعُ الْأُمُورُ٤ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يَغُرَّنَّكُمْ بِاللَّهِ الْغَرُورُ٥ إِنَّ الشَّيْطَانَ لَكُمْ عَدُوٌّ فَاتَّخِذُوهُ عَدُوًّا إِنَّمَا يَدْعُو حِزْبَهُ لِيَكُونُوا مِنْ أَصْحَابِ السَّعِيرِ٦ الَّذِينَ كَفَرُوا لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ كَبِيرٌ٧﴾

"Nëse ata të quajnë ty gënjeshtar edhe para teje të Dërguar të tjerë i kanë quajtur gënjeshtarë; tek All'llahu kthehen të gjitha punët."

"O njerëz! Pa dyshim, premtimi i All'llahut (Dita e Gjykimit) **është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli për All'llahun."**

"Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik! Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur."

"Për ata që nuk besojnë, ka dënim të rëndë, kurse për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka falje dhe shpërblim të madh."

Komentimi

Të mos ju mashtrojë djalli dhe kjo botë

Në tri ajetet e para të kësaj sureje, u trajtua Njëtimi i All'llahut dhe fuqia e Tij krijuese e furnizuese, kurse në ajetet objekt studimi sqarohet programi praktik i Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, prandaj biseda, në radhë të parë, i drejtohet atij dhe pastaj u drejtohet të gjithë njerëzve. Në vijim të ajeteve, sqarohen programet doktrinore dhe shpjegohen çështjet praktike të njerëzve.

Në fillim, këto ajete i japin një mësim Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që ai të mbajë qëndrime të drejta dhe të vazhdojë në rrugën e të vërtetës. Ky është mësimi më i rëndësishëm që i jepet atij. Ajeti i nderuar e njofton atë: "**Nëse ata të quajnë ty gënjeshtar edhe para teje të Dërguar të tjerë i kanë quajtur gënjeshtarë.**".

Profetët para teje rezistuan dhe nuk heshtën, ata punuan me ngulm, që të kryenin misionin me të cilin ishin ngarkuar, prandaj edhe ti ke detyrë të qëndrosh me vendosmëri dhe të përmbushësh kumtimin e kumtit, kurse punët e tjera janë në kompetencat e All'llahut, sepse: "**tek All'llahu kthehen të gjitha punët.**". All'llahu është Shikuesi e Kontrolluesi mbi të gjitha sendet dhe së shpejti Ai do të marrë në llogari të gjitha punët.

All'llahu i Lartësuar ka dijeni të plotë për vështirësitë që ti has në këtë rrugë, gjithashtu Ai nuk do t'i lërë përgënjeshtruesit

kundërshtarë e armiqësorë të kalojnë pa u dënuar. Mund të thuhet se ka vend për shqetësim, ose mund të thuhet se nuk do të ketë Ditë Gjykimi, por krahas ekzistencës së kësaj Gjykate të Madhe Hyjnore dhe regjistrave të punëve të njerëzve, që do të hapen në atë ditë të madhe, nuk mund të ketë më pretekst për shqetësim.

Ajetet në vijim shpjegojnë programin më të rëndësishëm për njerëzit. Ajeti i nderuar thotë: "**O njerëz! Pa dyshim, premtimi i All'llahut** (Dita e Gjykimit) **është i vërtetë."**. Kiameti, Llogaridhënia, librat e punëve të njerëzve, peshorja, shpërblimi, dënimi, Xhenneti dhe Zjarri, të gjitha, janë premtime hyjnore, të cilat All'llahu i Lartësuar patjetër do t'i zbatojë.

Duke marrë në konsideratë se këto premtime janë të vërteta, atëherë: "**Prandaj të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli për All'llahun.**". Nuk duhet të mashtroheni nga jeta e kësaj bote dhe nuk duhet t'ju mashtrojë djalli me faljen e All'llahut dhe me mëshirën e Tij.

Natyrisht që elementet ngacmuese të kësaj bote dhe gjërat e saj të bukura, në të vërtetë, kanë qëllim që t'ju shmangin nga premtimet e mëdha hyjnore. Gjithashtu, djajtë, xhind e njerëz, punojnë vazhdimisht me cytjet e me mashtrimet e tyre, që t'ju mashtrojnë me të gjitha rrugët e mundshme. Djajtë duan që ju të mos interesoheni për premtimet hyjnore, djajtë duan që ju të mos mendoni për Ditën e Madhe të Gjykimit dhe, nëse djajtë kanë mundësi, dijeni se ata punojnë vazhdimisht që t'ju mashtrojnë e t'ju çojnë në rrugën e humbjes. Djajtë duan që ju ta humbni jetën tuaj krejtësisht. Ata duan që lumturia dhe shpresat tuaja të jenë vrima në ujë, prandaj, kujdes dhe vetëm kujdes!

Përsëritja e paralajmërimit për njerëzit, që të mos mashtrohen as prej cytjeve të djajve dhe as prej gjërave të bukura të kësaj bote, tregon se mëkatet depërtojnë në brendësi të njeriut, nëpërmjet dy rrugëve:

1- Depërtojnë nëpërmjet dukurive mashtruese të kësaj bote, si: autoriteti, pozita, pasuria, mendjemadhësia dhe llojet e pasioneve të ulëta.

2- Depërtojnë nëpërmjet mashtrimit, me faljen e All'llahut dhe me bujarinë e Tij. Nga njëra anë, djalli e zbukuron këtë botë në sytë e njeriut dhe gjërat e punët tërheqëse të ndaluara ia paraqit si kënaqësi të lejuara, të dashura dhe me vlera të madha.

Nga ana tjetër, sa herë që njeriu mendon Botën Tjetër, sa herë mendon për Gjykatën e Drejtësisë Hyjnore dhe për qëndresën e forcën e madhe tërheqëse të kësaj bote, me mashtrimet e saj, djalli menjëherë përpiqet ta joshë njeriun me faljen e me mëshirën e All'llahut dhe e shtyn atë drejt punëve që çojnë në zvarritjen e plotësimit të detyrimeve, e shtyn të kalojë në nëpërkëmbjen e të drejtave të njerëzve, e shtyn të kundërshtojë urdhrat e All'llahut, deri sa njeriu, gjithnjë nën cytjen e djallit, arrin në atë shkallë sa nuk i bën përshtypje se po mëkaton e po kryen faje të rënda dhe përfundimi: shkujdesje e plotë ndaj faktit se All'llahu i Lartësuar është burimi i mëshirës dhe se për çështjen e dënimit, All'llahu është Mëshirëploti. Të mashtruarit harrojnë se edhe dënimi i Tij është shumë i ashpër. Kjo do të thotë se mëshira e Tij kurrë nuk mund të jetë motiv për të mëkatuar. Gjithashtu, edhe zemërimi i Tij nuk është shkak për dëshpërim dhe për prerjen e shpresave prej mëshirës së All'llahut.

Fjala e ajetit: "*garùr*" - "*mashtrues*", në kuptimin djalli, nga ana gjuhësore, është shkalla sipërore e mashtruesit jo të zakonshëm dhe tregon atë që çon në rrugën e humbjes. Në të vërtetë, kjo fjalë tregon të gjitha elementet e mashtrimit. Gjithashtu, mund të tregojë vetëm djallin, megjithëse kuptimi i dytë është më shumë në përshtatje me ajetin e dytë dhe në mënyrë të veçantë, kur ne dimë se Kur'ani Famëlartë, në shumë ajete, me fjalën "*garùr*" - "*mashtrues*", specifikon djallin.

Disa interpretues të Kur'anit, kanë një analizë të veçantë në lidhje me kuptimin e fjalës "mashtrues" dhe mund të përmblidhet në fjalinë: njerëzit që shihen me shumë elemente të mashtrimit e të joshjes, janë tri kategori:

1- I pafuqishmi, domethënë njeriu që gënjehet edhe me mashtrimin më të thjeshtë.

2- Më i fuqishëm se i pari. Këta nuk mashtrohen nga gjërat e bukura të kësaj bote, por, kur bukurive materiale të botës u bashkohen edhe cytjet e djajve, të cilët punojnë për të lëvizur pasionet e këtyre të "fuqishmëve", atëherë djajtë i shtyjnë ata të bëjnë punë të liga, gjithmonë, nëse arrijnë t'i mashtrojnë ata. Nga njëra anë kënaqësitë e kësaj bote dhe nga ana tjetër, cytjet e djajve, i shtyjnë individët e kësaj kategorie të bëjnë punë të këqija.

3- Kategoria e tretë, më të fuqishmit dhe më të diturit. Ata nuk vetëmashtrohen dhe askush s'ka mundësi t'i mashtrojë.

Fraza e ajetit: "**të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote"**, tregon kategorinë e parë; fraza vijuese e ajetit: "**të mos ju mashtrojë djalli për All'llahun"**, tregon kategorinë e dytë, kurse kategoria e tretë gjen shprehje në fjalën e All'llahut të Lartësuar:

“**Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robtë e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty.”**.[1-2]

Ajeti 6 paralajmëron dhe u tërheq vëmendjen të gjithë besimtarëve në lidhje me cytjet e djallit dhe kurtheve të tij: “**Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik!”**.

Është e njëjta armiqësi që djalli e filloi që kur u krijua Ademi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kur ai u betua pas përzënies së tij, për të qenë afër All'llahut, sepse nuk iu bind urdhërit hyjnor për t'i bërë sexhde Ademit, atëherë ai u betua dhe kërcënoi se do të ndiqte rrugën e armiqësisë ndaj Ademit dhe pasardhësve të tij dhe për këtë qëllim iu lut All'llahut që ta linte të jetonte deri në fundin e Botës.

Në të vërtetë, djalli i është përmbajtur fjalës së tij dhe nuk humb asnjë rast për të treguar armiqësinë e tij dhe për të goditur bijtë e Ademit. O bij të Ademit, a ju lejohet të mos e konsideroni djallin armikun tuaj të hapur? A ju lejohet të jeni të shkujdesur qoftë edhe vetëm për një çast dhe të mos e keni parasysh armiqësinë e djallit ndaj jush? Si është gjendja e atyre që e ndjekin djallin dhe atyre që shkojnë në rrugën e djallit, apo e merrni djallin për ndihmës e dashamirës dhe e konsideroni një shok që këshillon për të mirën tuaj? “A **do t'a merrnit atë dhe pasardhësit e tij për mbrojtës në vendin Tim, edhe pse ata janë armiqtë tuaj?”**.[3]

Këtu duhet shtuar se djalli është armik që sulmon nga të gjitha anët dhe armiqësinë e tij ndaj njeriut djalli e shpalli hapur,

1 Sure “El Hixhr”, ajeti 42.
2 Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 26, f. 5.
3 Sure “El Kehf”, ajeti 50.

që nga çasti kur atë e mallkoi All'llahu. Kur'ani Famëlartë sjell fjalët kërcënuese të djallit: "...**e do t'u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!"**.[1]

Djalli ju vë prita, ai ju sheh dhe ju nuk e shihni atë*:* "**Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë."**.[2]

Megjithëkëtë, kjo nuk do të thotë se ju jeni të pafuqishëm të mbroni veten tuaj para kurtheve e cytjeve të djallit. Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të Besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë se All'llahu i Lartësuar i dha Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* katër porosi dhe i kërkoi që t'i mbante gjithmonë në kujtesë:

Porosia e parë: Përderisa ti nuk mendon se mëkatet e tua janë falur, mos u merr me të metat e të tjerëve.

Porosia e dytë: Përderisa mendon që thesaret e Mia nuk janë mbaruar, mos u merakos për furnizimin tënd.

Porosia e tretë: Përderisa nuk sheh asgjësimin e pushtetit Tim, mos shpreso prej askujt tjetër përveçse prej Meje.

Porosia e katërt: Përderisa nuk e sheh djallin të vdekur, të mos jesh i sigurt prej kurtheve të tij.".[3]

1 Sure "El A'ràf", ajeti 17.
2 Sure "El A'ràf", ajeti 27
3 "Sefijnetul Bihàr", vëll. 1, f. 501.

Në Kur'an kanë ardhur shumë ajete që tregojnë armiqësinë e djallit ndaj njerëzve dhe shumë herë djalli në Kur'an përshkruhet me termin *"aduv'vun mubijnun" - "armik i hapur"*,[1] prandaj mbetet detyrë e vazhdueshme kujdesi për t'u ruajtur prej këtij armiku.

Në frazën e dytë të ajetit 6, All'llahu i Lartësuar, për të theksuar edhe më shumë mashtrimin e djallit, shton: "**Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur."**.

Fjala e ajetit *"hizb"*, në rrënjën e saj, është në kuptimin e një grupi me kapacitete vepruese, por zakonisht përdoret për të treguar çdo grup që ndjek një objektiv sipas një programi specifik.

Kurse qëllimi i përdorimit të fjalës *"hibsh'shejtani" - "partia e djallit"*, është të tregojë ata që ndjekin rrugën e djallit.

Grupi i djallit janë ata që e kanë rrethuar veten me kularin e adhurimit kushtuar djallit, ashtu siç e lexojmë në ajetin 100 të sures "En Nahl": "**Pushteti i djallit është vetëm mbi ata, që i binden atij dhe adhurojnë zota të tjerë veç All'llahut."**.

Si dhe: "Ata i ka nënshtruar djalli dhe ka bërë që ata të harrojnë porositë e All'llahut, ata janë partia e djallit; bëni kujdes, partia e djallit janë ata që kanë pësuar humbjen më të madhe.".

Tërheq vëmendjen fakti se Kur'ani e ka përmendur togfjalëshin "partia e All'llahut" në tri ajete. Gjithashtu, në tri ajete ka përmendur edhe togfjalëshin "partia e djallit". S'ka dyshim që

1 Shiko ajetet: 161 dhe 208 të sures "El Bekare"; ajetin 142 të sures "El En'àm"; ajetin 22 të sures "El A'ràf"; ajetin 5 të sures "Jùsuf"; ajetin 60 të sures "Jàsijn" dhe ajetin 62 të sures "Ez Zukhruf".

ka ardhur kështu, me qëllim që të bëhet e qartë se cilët janë ata që i janë bashkuar "partisë së All'llahut" dhe cilët janë anëtarë të partisë së djallit.

Natyrisht, djalli i bën thirrje partisë së vet që të mëkatojnë, të bëjnë faje dhe të zhyten në llumin e pasioneve të ulëta, u bën thirrje atyre t'i bëjnë shok All'llahut në adhurim, të ushtrojnë padrejtësi e të shtypin të tjerët. Rezultati për ata, patjetër, do të jetë e ardhmja më e keqe, zjarri i Xhehennemit.

Me lejen e All'llahut, do të shikojmë më shumë karakteristika të "partisë së All'llahut" dhe të "partisë së djallit", gjatë komentit të ajetit 22 të sures "El Muxhàdele".

Ajeti 7, sqaron përfundimin e lumtur të "partisë së All'llahut" dhe fundin e hidhur të "partisë së djallit": "**Për ata që nuk besojnë, ka dënim të rëndë, kurse për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka falje dhe shpërblim të madh."**.

Këtu meriton të shënohet fakti se Kur'ani është mjaftuar të përmendë vetëm fjalën "mohim", si shkak për dënimin, në një kohë që nuk është mjaftuar të përmendë vetëm "besimin", si shkak për faljen e mëkateve dhe arritjen e shpërblimit të madh. Por menjëherë, pas fjalës "besim", ka ardhur fjala "punë e mirë", sepse vetëm mohimi mjafton që mohuesi të jetë përgjithmonë në dënimin e zjarrit, kurse besimi, pa punën e mirë, nuk mjafton për realizimin e shpëtimit, sepse besimi dhe puna e mirë shkojnë krah për krah.

Në këtë ajet, më parë është përmendur "falja e mëkateve" dhe pastaj është përmendur "shpërblimi i madh", duke pasur

parasysh se “falja e mëkateve” në fillim i “pastron” besimtarët dhe i përgatit ata për të arritur “shpërblimin e madh”.

Ajetet 8 – 10

﴿أَفَمَنْ زُيِّنَ لَهُ سُوءُ عَمَلِهِ فَرَآهُ حَسَنًا فَإِنَّ اللَّهَ يُضِلُّ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ فَلَا تَذْهَبْ نَفْسُكَ عَلَيْهِمْ حَسَرَاتٍ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِمَا يَصْنَعُونَ٨ وَاللَّهُ الَّذِي أَرْسَلَ الرِّيَاحَ فَتُثِيرُ سَحَابًا فَسُقْنَاهُ إِلَى بَلَدٍ مَيِّتٍ فَأَحْيَيْنَا بِهِ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا كَذَلِكَ النُّشُورُ٩ مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْعِزَّةَ فَلِلَّهِ الْعِزَّةُ جَمِيعًا إِلَيْهِ يَصْعَدُ الْكَلِمُ الطَّيِّبُ وَالْعَمَلُ الصَّالِحُ يَرْفَعُهُ وَالَّذِينَ يَمْكُرُونَ السَّيِّئَاتِ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ وَمَكْرُ أُولَئِكَ هُوَ يَبُورُ١٠﴾

"**A është ai, që veprat e veta të këqija i duken të mira** (si ai që është i udhëzuar në Rrugën e Drejtë)**? Me të vërtetë, All'llahu shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në Rrugë të Drejtë kë të dojë. Ti mos e shqetëso veten deri në shkatërrim për humbjen e tyre! All'llahu është vërtet i Gjithëdijshëm për atë që bëjnë ata.**"

"**All'llahu është ai që i dërgon erërat, të cilat lëvizin retë. Ne i drejtojmë ato në viset e vdekura e, nëpërmjet tyre gjallërojmë tokën, pasi ka qenë e shkretë. Kështu do të jetë edhe Ringjallja.**"

"Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë All'llahut. Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë. Sa i përket atyre që kurdisin të këqija, ata do të kenë dënim të rëndë dhe dredhitë e tyre do të dështojnë."

Komentimi

Te All'llahu ngjitet fjala e mirë, kurse punën e mirë Ai e ngre lart

Në ajetet e mëparshëm, pamë se njerëzit u ndanë në dy grupe: "grupi i besimtarëve" dhe "grupi i mohuesve", ose "partia e All'llahut" dhe "partia e djallit". Ajetet 8-10 shpjegojnë njërën prej të veçantave shumë të rëndësishme të dy grupeve, por që realisht është burimi për të gjitha programet e të dy grupeve.

Në të vërtetë, kjo çështje është çelësi për të gjitha kombet që kanë shkarë në rrugën e humbjes dhe të armiqësisë ndaj të vërtetës, të cilët mendojnë se punët e tyre të këqija janë punë të bukura, për shkak se punët që ata bëjnë, janë në harmoni me pasionet e ulëta dhe me zemrat e tyre të errësuara. Është interesante se, një individ i tillë nuk e pranon këshillën. Në këtë individ s'ka asnjë lloj gatishmërie të dëgjojë ndonjë kritikë dhe kurrë nuk pranon të ndryshojë rrjedhën e jetës së tij. Gjithashtu, ai as nuk i diskuton punët e veta dhe as nuk mendon për përfundimin e keq të punëve që bën.

Edhe më interesante dhe më e hidhur për këta individë, është atëherë kur flitet rreth "punëmirëve" dhe "punëkëqijve", pasi ata mendojnë se përemri *"ata"* në frazën e parë, është kundër atyre dhe është kundër besimtarëve punëmirë, kur flitet për punëkëqijtë.

Është e habitshme se këta mohues kokëngjeshur, kur u lexohen këto ajete të Kur'anit, që flasin për "partinë e djallit" dhe për të ardhmen e tyre të zezë, ata i marrin në kuptimin për besimtarët punëmirë dhe veten e tyre e konsiderojnë si kriter të "partisë së All'llahut".

Në të vërtetë, kjo është një fatkeqësi e dhimbshme dhe shumë e madhe.

Këtu shtrohet pyetja se, kush është ai që ua zbukuron punët e këqija në sytë e tyre: është All'llahu, është dëshira e tyre vetjake, apo është djalli?

S'ka asnjë dyshim që faktori bazë për këtë zbukurim të të keqes janë dëshirat e tyre të sëmura dhe djalli. Por All'llahu është krijuesi i këtij efekti në punët e tyre. Bazuar mbi këtë, zbukurimi i punëve të këqija mund t'i atashohet edhe All'llahut të Lartësuar, sepse njeriu, kur futet në rrugën e mëkateve dhe mëkaton, nuk ndihet i qetë nga vetë natyra e krijimit të tij të pastër. Ai nuk ndihet i qetë, edhe për shkak të gjallërisë së qenies së tij, si edhe për shkak të qartësisë së mendjes së vet. Por, me përsëritjen e punëve të këqija, shqetësimi vjen duke u pakësuar, derisa arrin në atë shkallë, sa nuk shqetësohet fare për punët që bën dhe thellohet më shumë në rrugën e punëve të këqija. Në sytë e tij, e keqja i duket e bukur dhe arrin deri aty, sa të ketë iluzionin se punët e

këqija që bën, janë krenari dhe virtyte për të. Në këtë gjendje, ai zhytet në kënetën me ujë të prishur nga punët e këqija.

Në këtë ajet tërheq vëmendjen fakti se Kur'ani Famëlartë, kur pyet: "**A është ai, që veprat e veta të këqija i duken të mira** (si ai që është i udhëzuar në Rrugën e Drejtë)**?"**, nuk thotë se cili është zbukuruesi i punës së keqe dhe duket sikur ka qëllim të hapë para dëgjuesit horizontin që ai të përfytyrojë punë të ndryshme përballë gjendjes negative. Punëkeqi, në përfytyrimin tij ka gjendjen e njeriut normal, njeriut që ecën në rrugën e të vërtetës dhe në rrugën e besimit. Me fjalë të tjera, duket sikur dëshiron të thotë: Vallë, një njeri si ky, a është si ai që e ka parë të vërtetën?

Vallë, një njeri i këtillë, është si ai me zemër të pastër, që vazhdimisht i kërkon llogari vetvetes?

A ka këtu shpresë për shpëtim për këtë njeri?[1]

Në vijim, Kur'ani shpjegon shkakun e dallimit ndërmjet dy grupeve: "**Me të vërtetë, All'llahu shpie në humbje kë të dojë…"**.

Kur punët e liga zbukurohen në sytë e grupit të parë, patjetër që kjo është rezultat i vendimit hyjnor, që ata të hyjnë në rrugën e humbjes dhe Vetëm All'llahu, i Gjithëfuqishmi, e ka bërë këtë veçanti në shpirtrat e njerëzve, kur punët e këqija përsëriten dhe bëhen si damkë mbi njerëzit, madje njerëzit përshtaten me

1 Është e qartë se ajeti është një fjali vlerësuese dhe kuptimi mund të jetë: si ai që nuk është i këtillë; ose si ai që merr në llogari vetveten dhe punën e tij të keqe e shikon punë të keqe; ose a shpresohet që ai të përmirësohet, etj.

punët e këqija, derisa puna e keqe u bëhet zakon dhe u duket se është në përputhje të plotë me karakterin e tyre.

All'llahu i Gjithëfuqishëm u ka dhënë besimtarëve zemërpastër mendjemprehtësi, u ka dhënë edhe dëgjim të ndërgjegjshëm, që t'i kuptojnë të vërtetat ashtu siç janë.

Është e qartë se kjo dëshirë hyjnore është në përputhje me urtësinë e Tij. Gjithçka që All'llahu jep, është në përshtatje të plotë me dëshirën dhe urtësinë e Tij dhe për këtë, ajeti vijon me frazën: "**Ti mos e shqetëso veten deri në shkatërrim për humbjen e tyre!"**. Kjo shprehje është e ngjashme me frazën e ajetit 3 të sures "Esh Shuarà: "A mos do të vrasësh veten ngaqë ata nuk janë besimtarë?".[1]

Fjala e ajetit *"haseràtin"* - *"dëshpërime"*, sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, është kundrinor për fjalët e përparme të fjalisë dhe tregon se Muhammedi *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kishte vetëm një dëshpërim, por kishte disa syresh.

Njëjësi i fjalës *"dëshpërim"* - *"hasretun"*, tregon dëshpërimin e tij, që ata humbën udhëzimin në Rrugën e Drejtë. Në të njëjtën kohë, tregon edhe dëshpërim që me mosbesimin tek ata, humbi thelbi i njerëzores. Ai dëshpërohej, edhe për faktin se kishin humbur edhe ndjenjën e dallimit të punëve dhe kishin arritur deri kufirin që punën e keqe ata e shihnin si punë të bukur.

1 Për këtë ajet, është përmendur edhe një interpretim tjetër. Komentuesit kanë thënë se qëllimi është biseda e drejtpërdrejtë me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i thotë: "Mos vuaj nga brenda, për shkak të fyerjeve dhe kundërshtimeve të jobesimtarëve, sepse All'llahu ka dijeni të plotë për punët e tyre dhe shumë shpejt, në një kohë të përshtatshme, do të hakmerret ndaj atyre.".

Së fundi, ai dëshpërohej për rënien e tyre në zjarrin e zemërimit e të mposhtjes hyjnore.

Ajeti shprehet qartë dhe i thotë: ti, o Muhammed , nuk duhet të dëshpërohesh për ata, sepse: "**All'llahu është vërtet i Gjithëdijshëm për atë që bëjnë ata."**.

Është e qartë se jehona e tingullit të këtij ajeti ishte aq e fortë, sa Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* digjej nga brenda, ngaqë ata ishin në rrugën e humbjes dhe i shmangeshin të vërtetës. Kjo është gjendja e udhëheqësit të sinqertë hyjnor. Ai ndien dhimbje, për shkak se njerëzit nuk e pranojnë të vërtetën, por i dorëzohen të gabuarës. Ai ndien dhimbje se njerëzit hedhin pas murit shkaqet e lumturisë. Dhimbja e tij për të gjitha këto, ishte aq e madhe, sa ai dëshironte që shpirti t'i ndahej prej trupit.

Bazuar mbi studimet e mëparshme rreth udhëzimit në rrugën e të vërtetës dhe rënies në rrugën e humbjes, përfshirë edhe studimet rreth besimit e mohimit, ajeti 9, me shprehje të ngjeshura, kalon në çështjen e fillimit të krijimit dhe ringjalljes pas vdekjes. Gjithashtu, ajeti i sjell puqur ajetet e fillimit të krijimit me ajetet që vërtetojnë ringjalljen pas vdekjes, vetëm me një argument që tërheq vëmendje dhe për këtë, ajeti thotë: "**All'llahu është ai që i dërgon erërat, të cilat lëvizin retë. Ne i drejtojmë ato në viset e vdekura e, nëpërmjet tyre gjallërojmë tokën, pasi ka qenë e shkretë. Kështu do të jetë edhe Ringjallja."**.

Një sistem i hollësishëm drejton lëvizjen e erërave dhe pastaj lëvizjen e reve, pastaj shkakton rënien e pikave të shiut, ringjallëse të jetës dhe gjallërimin e tokës së vdekur. Ky është

argumenti më i mirë që vërteton se "Dora" e fuqisë dhe e urtësisë, është përtej sistemit të kësaj bote dhe është kjo "Dorë" që rregullon e sistemon punët e kësaj bote.

Në radhë të parë, urdhërohen të lëvizin erërat e nxehta, prej zonave ekuatoriale në drejtim të zonave të ftohta. Gjatë rrugës, këto erëra mbartin avujt e ujit të deteve dhe i ngjisin lart në qiell. Pastaj, erërat e ngopura me avuj uji lëvizin në mënyrë të sistemuar, që të bien në kontakt me erërat e ftohta polare, të cilat gjithmonë lëvizin në drejtim të kundërt me lëvizjen e erërave mbartëse të avujve të ujit dhe, kur këto erëra bien në kontakt me erërat e ftohta, erërat urdhërohen të kondensojnë avujt e ujit për të formuar retë.

Pastaj, e njëjta erë urdhërohet të mbartë retë e formuara dhe t'i dërgojë retë në shkretëtirën e vdekur, për të lëshuar mbi të pikat e shiut, që janë motivi i jetës në tokën e thatë.

Pas kësaj, me kushte specifike, urdhërohet toka dhe farërat që janë të shpërndara nëpër tokë, të pranojnë ujin, të mbijnë e të gjelbërojnë. Pas këtij urdhri, prej atyre qenieve të vockla dhe në dukje pa vlerë, mbijnë qenie të gjalla e të shumëllojshme dhe të bukura, del një tokë e gjelbëruar, e dobishme e frytdhënëse. Pa dyshim që të gjitha këto vërtetojnë fuqinë e All'llahut të Lartësuar e njëkohësisht dëshmojnë për urtësinë e Tij dhe tregojnë se ringjallja e tokës së vdekur është shëmbëllim i ringjalljes së madhe pas vdekjes.

Në të vërtetë, ajeti i mësipërm bën thirrje për Njëtimin e All'llahut nga disa anë.

"Argumenti i sistemeve" vërteton Njëtimin e All'llahut, kurse "lëvizja" nënkupton ekzistencën e një "lëvizësi" për çdo gjë që lëviz. Nga një anë tjetër, mirësitë që gëzojnë njerëzit, bëjnë thirrje për të falënderuar natyrshëm Mirësidhënësin.

Nga disa anë të tjera, ky ajet është një argument që vërteton çështjen e ringjalljes pas vdekjes.

Integrimi i qenieve në lëvizjen që bëjnë dhe ringjallja e jetës në tokën e vdekur, i thonë njeriut: O njeri, ti e shikon me sytë e tu ringjalljen në stinët e çdo viti dhe këtë ringjallje ti, o njeri, e shkel me këmbët e tua.

Është e domosdoshme të tërhiqet vëmendja në fjalën e ajetit "*tuthijru*" - "*shkaktojnë*". Kjo fjalë, në rrënjën e saj "*ithàretun*", është në kuptimin: "*përhapje* dhe *ndarje*", çka tregon se formimi i reve shkaktohet prej fryrjes së erërave mbi sipërfaqen e oqeaneve, kurse lëvizja e reve tregohet në frazën e ajetit: "**Ne i drejtojmë ato në viset e vdekura**.".

Është shumë e bukur ajo që lexojmë në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur atë e pyeti njëri prej sahabëve: "*O i Dërguar i All'llahut, si i ringjall All'llahu të vdekurit dhe cila është shenja për ringjalljen në krijimin e Tij?*".

I Dërguar i All'llahut tha: "*A nuk ke kaluar ndonjëherë në ndonjë luginë të vdekur, joprodhuese dhe, kur kalon më vonë, shikon se ajo luginë gëlon nga gjelbërimi.*".

Ai tha: "*Po, o i Dërguar i All'llahut.*".

Atëherë ai tha: *"Kështu do të ringjallë All'llahu të vdekurit dhe ajo që ti pe, është argument në krijimin e Tij."*.[1]

Rreth kësaj teme, ne kemi vënë një studim tjetër, në komentimin e ajetit 48 të sures "Er Rrùm".

Tani, pas këtij studimi që flet për Njëtimin e All'llahut, ajeti e vë theksin mbi përfytyrimin e rrezikshëm që kishin arritur idhujtarët e Mekës, të cilët besonin se madhështia e fuqia atyre u vinte prej idhujve që ata adhuronin dhe besimi në të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, do të ishte shkak që njerëzit t'i dëbonin ata nga vendi, ashtu siç e lexojmë në ajetin 57 të sures "El Kasas": "Nëse do të ndjekim udhëzimin në Rrugën e Drejtë së bashku me ty, shumë shpejt do të dëbohemi prej vendit tonë.".

Ajeti objekt studimi njofton: "**Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë All'llahut."**.

Në lidhje me fjalën e ajetit *"el iz'zete"* - *"fuqi e plotë, madhështi"*, Ràgibi shpjegon në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, "Mufredàtu El Fàdhil Kur'àn", se kjo fjalë tregon një gjendje që e ndalon njeriun të jetë mbi gjithçka. Në këtë kuptim arrijmë, edhe kur shikojmë në shprehjen e arabëve: *"erdun az'zàzun"* - *"tokë e fortë"*.

All'llahu i Lartësuar nuk mund të mposhtet, kurse të gjitha qeniet e krijuara, në saje të kufizimeve që kanë, e pranojnë mposhtjen. Bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se e gjithë fuqia

1 Tefsiri i Kurtubij'jit, vëll. 8, f. 409, fundi i ajetit objekt studimi.

vjen vetëm prej All'llahut dhe se çdo gjë që fitohet, është prej detit pa anë e pa fund të fuqisë së Tij.

Në një hadith të përcjellë prej Enesit, lexojmë se i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Zoti juaj çdo ditë thotë: Unë jam Fuqiploti dhe, kush dëshiron të fitojë dy botët, le t'i bindet Fuqiplotit.*".[1]

Në të vërtetë, njeriu i mençur e ka detyrim të furnizohet me ujë në burimin e ujit, sepse uji i pastër dhe me shumicë, vetëm në burim është i tillë dhe jo në enët e vogla me kapacitet mbajtës të kufizuar, ose në enë të ndotura prej dorës së këtij apo atij.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Hasanit *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: Xhenàdeh ibn Umej'jehi tha: "Hyra te Hasan bin Ali bin Ebù Tàlibi, kur ishte sëmurë nga sëmundja që vdiq dhe pashë se para duarve mbante një tas, ku hidhte gjakun copa-copa, që i dilte nga mëlçia, prej helmit që i kishte dhënë të pinte Muavija. Unë i thashë: 'O prijësi im, si e ke punën që nuk e mjekon veten?'".

Ai më tha: "*O Abdullah, me çfarë ta mjekoj vdekjen?*".

Unë thashë: "Të All'llahut jemi dhe te Ai do të kthehemi.".

Pastaj u kthye nga unë dhe ndërmjet porosive të shumta, më tha: "*Kur dëshiron madhështinë pa fisin tënd dhe, kur dëshiron autoritet pa pushtet, atëherë dil prej poshtërsisë së kundërshtimit të All'llahut dhe hyr në madhështinë e bindjes ndaj All'llahut…*".[2]

1 "Bihàrul Enuàr", vëll. 65, f. 120.
2 Burimi i mësipërm, vëll. 44, f. 129.

Sikur të shikojmë me vëmendje në disa ajete të Kur'anit, do të vërejmë se në këto ajete, fjala "madhështi", përmendet: për All'llahun, për të Dërguarin e tij dhe për besimtarët, si, për shembull, në ajetin 8 të sures "El Munàfikùn": "...madhështia e fuqia u takon All'llahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve.".

I Dërguari i All'llahut dhe besimtarët e fituan madhështinë e fuqinë prej rrezeve të madhështisë e fuqisë së Krijuesit dhe nga që ecën në rrugën e bindjes ndaj të Gjithëfuqishmit.

Më pas, ajeti tregon rrugën e arritjes te madhështia e fuqia: "**Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë."**.

Fjala e ajetit *"el kelimu et taj'jibu"*, është në kuptimin: fjalë e mirë në përmbajtjen e saj, domethënë se kuptimet e fjalës së mirë përputhen me gjendjen reale të punëve e të sendeve, ashtu siç janë në të vërtetë, por a mund të ketë send më të pastër, më real e më konkret se Qenia e All'llahut të Lartësuar, se feja e Tij e drejtë, se drejtësia e Tij e vërtetë? A mund të ketë gjë më konkrete se ata njerëz të mirë, që ecin në Rrugën e Tij dhe punojnë për përhapjen e fjalës së mirë?

Gjithashtu, togfjalëshi *"el amelu sàlihu" - "puna e mirë"*, është interpretuar në kuptimin e besimit të vërtetë në fillimin e krijimit, në ringjalljen pas vdekjes dhe në Profetësinë. Pa dyshim që një besim i saktë, ngjitet lart te All'llahu dhe ky besim i sinqertë e bën besimtarin të ngjitet lart, derisa të jetë pranë të Vërtetit, i Cili këtë besimtar e mbështjell me madhështinë e me fuqinë e Tij dhe bën që edhe besimtari të ketë fuqi e madhështi.

Është shumë e bukur që, nga kjo rrënjë e pastër të mbijë kërcelli dhe degët. Fryti i saj është puna e mirë, si dhe çdo punë e merituar, ndërtuese dhe e dobishme, qoftë kur puna e mirë është thirrje për të besuar në të Vërtetin, ose për të mbrojtur të dhunuarin nga padrejtësia e mizoria, qoftë kur është luftë për t'iu kundërvënë mizorit e tiranit, qoftë kur është për ndërtimin e shpirtit dhe për adhurim, ose edhe për të mësuar.

Në përgjithësi, çdo punë e mirë hyn në kuptim gjithëpërfshirës të togfjalëshit *"puna e mirë"*, sepse kur puna e mirë bëhet vetëm për hir të All'llahut të Lartësuar dhe për të fituar kënaqësinë e Tij, kjo punë e mirë ngjitet pranë të Lartit, ngjitet në qiellin e butësisë së Tij dhe është shkak për plotësimin dhe ngritjen lart të bërësit të punës së mirë, të cilin e bën që të gëzojë pushtet me pushtetin e të Vërtetit të Lartësuar.

Pikërisht, këtë kuptim shprehin edhe ajetet 24-25 të sures "Ibràhim": "A nuk ke menduar se si All'llahu fjalën e mirë e ka shëmbëllyer me pemën e mirë me rrënjë të stabilizuara (thellë në tokë) dhe degët e saj janë në qiell. Ajo (pema e mirë), me lejen e Zotit të vet, e jep frytin e saj në çdo kohë.".

Përveç asaj që u tha, disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se "fjala e mirë" është në kuptimin e frazës: *"là ilàhe il'lall'llàh"* - *"S'ka zot tjetër përveç All'llahut"*, ose është në kuptimin e frazës *"subhànall'llàh"* - *"All'llahu është i dëlirë nga të metat e nga nevojat"*, ose është në kuptimin e frazës: *"subhanall'llàh uelhamdu lil'làh ue là ilàhe il'lall'llàh uell'llàhu ekber"* - *"All'llahu është i dëlirë nga të metat e nga nevojat, falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm All'llahut, s'ka zot tjetër përveç All'llahut, All'llahu është më i madhi"* ose *"fjala e mirë"* është në kuptimin e vërtetimit të kumtit me të

cilin erdhi Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përfshirë edhe interpretime të tjera, që natyrisht vijnë pas pranimit të Njëtimit të All'llahut (Teuhidit). Të gjitha këto interpretime, janë kriter vërtetues për gjerësinë e madhe që përfshin koncepti *"fjala e mirë"*, pa vënë asnjë kufi se cila është *"fjala e mirë"*, pasi në diapazonin e kuptimit *"fjalë e mirë"*, hyn çdo fjalë e mirë me përmbajtje të shëndoshë.

Në të gjitha gjendjet, vetëm All'llahu i Lartësuar u jep jetë tokave të vdekura me anën e pikave të shiut, ashtu siç u shpjegua në ajetin e mësipërm dhe vetëm All'llahu s'ka asnjë të metë dhe s'ka nevojë për asnjë send. All'llahu e rrit *"fjalën e mirë"* dhe *"punën e mirë"* dhe i çon ato të jenë në fqinjësi Të.

Pastaj, ajeti njofton për ata që e kundërshtojnë punën e mirë: "**Sa i përket atyre që kurdisin të këqija, ata do të kenë dënim të rëndë dhe dredhitë e tyre do të dështojnë."**.

Megjithëse të shprishurit dhe punëkëqijtë pandehin se mund të fitojnë madhështi, pasuri e fuqi me mohimin, me padrejtësinë, me gënjeshtrën dhe me falsifikimin, në fund ata, nga njëra anë, e kanë vënë veten nën goditjen e dënimit hyjnor dhe nga ana tjetër, të gjithë punën e tyre e marrin vrundujt e erës dhe shkon pa asnjë dobi.

Në lidhje me këtë kategori individësh, Kur'ani njofton: "...ata, në vend që të adhuronin All'llahun, adhuruan zota të tjerë që të krenoheshin me ata (zotat e rremë).".[1] Kur'ani njofton edhe për hipokritët (munafikët), të cilët besojnë në krenarinë e vet dhe punojnë për poshtërimin e besimtarëve. Në lidhje me hipokritët,

1 Sure "Merjem", ajeti 81.

Kur'ani thotë: "Ata thonë: nëse ne kthehemi në Medine, me siguri më i fuqishmi do të dëbojë prej saj më të pafuqishmin."[1]

Të tjerë mendonin se afrimi pranë Faraonit është shkak për krenarinë e tyre. Të tjerë e kanë kërkuar respektin nëpërmjet dhunës, padrejtësisë dhe shtypjes. Por ata, në të vërtetë, gjithmonë rrëzohen poshtë, sepse vetëm besimi e puna e mirë janë ato që ngjiten te All'llahu i Gjithëpushtetshëm.

Fjala e ajetit *"mekrun"*, nga ana gjuhësore, do të thotë: të menduarit për zgjidhjen e problemeve. Por kjo fjalë, në shumë vende, ka ardhur në Kur'anin Famëlartë në kuptimin e të menduarit për punë të këqija dhe për të bërë keq, ashtu siç ka ardhur në ajetin objekt studimi.

Në fjalën e ajetit *"es sej'jàt"* - *"të këqijat, punë të këqija"*, përfshihet çdo punë e keqe dhe e urryer, madje është më përgjithësuese se të këqijat në besim dhe në punë. Disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se fjala *"es sej'jàt"* - *"të këqijat"*, është në kuptimin e komploteve që kurdisnin idhujtarët për të vrarë të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ose për ta larguar atë nga Meka. Në të vërtetë, kjo thënie e interpretuesve të Kur'anit është vetëm një prej kritereve me të cilët vërtetohet kuptimi i kësaj fjale, përveç kuptimit të saj përgjithësues.

Fjala e ajetit *"jebùru"* në rrënjën e saj: *"beuàr"* dhe *"bùràn"* është në kuptimin e mbetjes së mallrave stok nga mungesa e tejskajshme e kërkesës për mallra, në kuptimin që kjo mungesë kërkese bëhet shkak për prishjen e mallrave, prandaj kjo fjalë

1 Sure "El Munàfikùn", ajeti 8.

është përdorur në këtë ajet, për të shprehur prishjen dhe asgjësimin, madje edhe në të folmen e njerëzve qarkullon shprehja: "mbeti stok dhe u prish".

Dy hulumtime

1- E gjithë madhështia vjen prej All'llahut, emri i Tij u lartësoftë!

Si është e vërteta e madhështisë? A është madhështi vetëm arritja e një etape fuqie? Nëse është kështu, ku duhet të bëhet studimi rreth madhështisë? Cili send e cila punë i mundëson njeriut madhështinë?

Përgjigjja për këto pyetje për ne, bëhet e qartë, kur analizojmë se e vërteta e madhështisë, në radhë të parë, qëndron në fuqinë që duket qartë në zemrën e në shpirtin e njeriut. Madhështia është fuqia që e largon njeriun nga nënshtrimi dhe dorëzimi para tiranëve dhe mëkatarëve. Kur njeriu e zotëron fuqinë e madhështisë, me këtë fuqi kurrë nuk u nënshtrohet pasioneve të dëshirave dhe dëshirat e ndjenjat e ulëta kurrë nuk gjejnë rrugë që të jenë sunduese mbi të.

Madhështia është një fuqi me të cilën njeriu mbetet në nivelin më të lartë të qëndresës ndaj ndikimit të gjërave të bukura të kësaj bote.

Vallë, kjo fuqi a mund të ketë burim tjetër përveç besimit në All'llah, në Burimin origjinal të fuqisë e të madhështisë?

Kjo madhështi është në stadin e mendimit, të besimit dhe të shpirtit, kurse në stadin e punës, madhështia buron prej punëve të shëndosha dhe origjinës e metodës së hollësishme. Me fjalë të tjera, kjo shprehje mund të përmblidhet në frazën *"punë e mirë"*. Janë pikërisht këto të dyja, *"fjala e mirë"* dhe *"puna e mirë"*, ato që i japin njeriut mundësinë të ngrihet lart, i japin madhështi dhe fuqi.

Edhe magjistarët bashkëkohës të Faraonit, i filluan mashtrimet e magjisë së tyre me emrin e Faraonit dhe me fuqinë e tij, ashtu siç njoftohet në ajetin 44 të sures "Esh Shuarà: "**Për madhërinë e Faraonit, me të vërtetë, Ne do të jemi fitues patjetër!"**.

Por ata shumë shpejt u shpartalluan para shkopit të Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Magjistarët, nga ajo që panë, menjëherë dolën prej poshtërimit, ku i kishte vënë Faraoni dhe u strehuan në ombrellën e Njëtimit të All'llahut. Ata besuan dhe u bënë aq të fuqishëm, sa nuk mund të thyheshin, madje ata nuk u ndikuan fare as prej kërcënimeve më të tmerrshme të Faraonit. Ata nuk u merakosën se do t'u priteshin duart e këmbët, sepse besimi i sinqertë në All'llah, bëri që ata ta pinë me kënaqësi kupën e rënies dëshmor. Me qëndrimin e tyre, magjistarët, vërtetuan se tani, pasi besuan të vërtetën, nuk dorëzoheshin as para premtimit e as para kërcënimit.

Njëkohësisht, me punën e tyre, ata vërtetuan se nuk mund të mposhteshin. Historia e atyre magjistarëve që besuan

All'llahun, Zotin Një e të Vetëm, është për ne një botë e mbushur me mësime të larta.

2- Ndryshimi mes togfjalëshit "fjala e mirë" dhe "puna e mirë"

Pyetje: Mund të shtrohet pyetja: Përse, në ajetin objekt studimi, për fjalën e mirë thuhet: "**Tek Ai ngjiten fjalët e bukura"**, kur për punën e mirë ajeti thotë: "**veprën e mirë Ai e ngre Vetë."**?

Përgjigje: Kjo pyetje mund të ketë përgjigjen: *"Fjala e mirë"* tregon besimin dhe dorëzimin para All'llahut, që në të vërtetë është vetë ngjitja te All'llahu. Nga ky këndvështrim, besimi nuk është asgjë tjetër përveç dorëzimit te All'llahu me vetëdije e me bindje, kurse *"puna e mirë"*, është puna që All'llahu e pranon dhe për të cilën Ai e shumëfishon shpërblimin. All'llahu i jep vazhdimësi *"punës së mirë"* dhe pastaj Ai e ngre atë lart. (Shikoje me hollësi këtë çështje.)

Ajetet 11 – 12

﴿وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُطْفَةٍ ثُمَّ جَعَلَكُمْ أَزْوَاجًا وَمَا تَحْمِلُ مِنْ أُنْثَى وَلَا تَضَعُ إِلَّا بِعِلْمِهِ وَمَا يُعَمَّرُ مِنْ مُعَمَّرٍ وَلَا يُنْقَصُ مِنْ عُمُرِهِ إِلَّا فِي كِتَابٍ إِنَّ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ١١ وَمَا يَسْتَوِي الْبَحْرَانِ هَذَا عَذْبٌ فُرَاتٌ سَائِغٌ شَرَابُهُ وَهَذَا مِلْحٌ أُجَاجٌ وَمِنْ كُلٍّ تَأْكُلُونَ لَحْمًا طَرِيًّا وَتَسْتَخْرِجُونَ حِلْيَةً تَلْبَسُونَهَا وَتَرَى الْفُلْكَ فِيهِ مَوَاخِرَ لِتَبْتَغُوا مِنْ فَضْلِهِ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ١٢﴾

"**All'llahu ju ka krijuar së pari prej dheut** (Ademin), **pastaj** (pasardhësit e tij i ka krijuar) **nga pika e farës dhe më në fund ju ka bërë çifte. Dhe asnjë femër nuk mbetet shtatzanë e as nuk lind pa dijeninë e Tij. Jeta e askujt nuk zgjatet e as nuk shkurtohet pa qenë e shënuar në Libër. Me të vërtetë, kjo për All'llahun është e lehtë!"**

"**Edhe dy detet** (llojet e ujit) **nuk janë të njëjta: njëri është i ëmbël e i këndshëm dhe uji i pihet me shije, kurse tjetri është i njelmët dhe i hidhët. Ju ushqeheni me mish të njomë prej të dyve dhe prej tyre nxirrni stolitë që mbani. Shikoni anijet si çajnë ujin, ndërsa ju lundroni me to për të kërkuar nga dhuntitë e Tij. Ndoshta ju bëheni falënderues."**

Komentimi

Dy detet nuk janë të barabartë

Duke pasur në mendje bisedën e ajeteve të mëparshëm, rreth Njëtimit të All'llahut (Teuhidit), Ringjalljes dhe cilësive të All'llahut, ajetet 11-12, gjithashtu, shpalosin atë që është më e vlefshme dhe me më shumë horizont, shpalosin argumente që, nga njëra anë, tregojnë fuqinë e All'llahut dhe, nga ana tjetër, tregojnë për diturinë e Tij. Gjithashtu, nga një anë e tretë, tregojnë edhe çështjen e Ringjalljes.

Ajeti 11, në fillim flet për krijimin e njeriut dhe për etapat e krijimit të tij: "**All'llahu ju ka krijuar së pari prej dheut** (Ademin)**, pastaj** (pasardhësit e tij i ka krijuar) **nga pika e farës dhe më në fund ju ka bërë çifte."**.

Ajeti flet për tri etapa, prej etapave të krijimit të njeriut: dheut, spermatozoidit dhe etapës së çiftëzimit.

Është domethënës fakti që njeriu është krijuar prej dheut, sepse Ademi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u krijua prej dheut. Gjithashtu, të gjitha lëndët prej të cilave formohet trupi i njeriut, lëndët me të cilat njeriu ushqehet, ose lëndët prej të cilave formohet sperma e tij, të gjitha këto lëndë i përmban dheu.

Disa kanë shprehur mendimin se krijimi prej dheu tregon vetëm krijimin e parë, kurse krijimi prej spermatozoidit tregon etapat e krijimit, në kuptimin që etapa e parë është etapa e krijimit të përgjithshëm, duke marrë në konsideratë ekzistencën e të gjithë njerëzve me ekzistencën e Ademit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Etapa e dytë është etapa e parapëlqimit, që konsiston në ndryshimin e një njeriu prej një tjetri.

Në të gjitha gjendjet, etapa e çiftëzimit është etapa e vijimësisë së species njerëzore dhe ruajtjes së llojit njeri. Mundësia për të cilën janë shprehur disa, në lidhje me fjalën e ajetit: "*ezuàxhen*", (kjo fjalë këtu është në kuptimin e llojeve, ose në kuptimin e shpirtit e të trupit), apo interpretime të tjera të ngjashme, duken shumë të largëta për të qenë interpretime të sakta të kësaj fjale.

Në vijim, ajeti kalon në etapën e katërt e të pestë të krijimit të njeriut dhe flet për shtatzaninë e grave dhe për lindjen e fëmijës. Për të gjitha këto, ajeti njofton: "**Dhe asnjë femër nuk mbetet shtatzanë e as nuk lind pa dijeninë e Tij."**.

Patjetër që shtatzania, ndryshimet e shndërrimet e ndërlikuara që ndodhin në fetus, më pas periudha e lindjes apo shqetësimet dhe shndërrimet e papërfytyrueshme që ndodhin edhe te vetë nëna, nga njëra anë dhe nga një anë e dytë, ndryshimet që ndodhin në embrion e në fetus, të gjitha këto shndërrime ndodhin sipas një sistemi të rregulluar deri në hollësi, prandaj është e pamundur që të gjitha këto të mendohen pa u mbështetur në diturinë hyjnore, që s'ka as anë e as fund. Sikur sistemi që rregullon këtë proces të pësonte edhe një çartje të vogël, sa maja e gjilpërës, patjetër që kjo prishje kaq e vogël, do të çonte në prishjen e procesit të shtatzanisë, ose të procesit të lindjes dhe përfundimisht do të çonte në humbjen, në vdekjen e fetusit.

Këto pesë etapa të jetës së njeriut, janë njëra më e çuditshme se tjetra dhe shkaktojnë më shumë habi, janë shumë

larg njëra-tjetrës. Sa larg është toka e vdekur dhe e ngurtë prej njeriut të gjallë, të mençur, të zgjuar dhe shpikës?! Apo spermatozoidi i vockël, pa ndonjë vlerë dhe i formuar prej disa pikëzave uji të ndenjura, sa larg është prej njeriut, që di të orientohet, që është i bukur dhe i pajisur me shqisat dhe me aparatet e ndryshme të organeve të trupit?

Pas kësaj etape, vjen etapa e ndarjes së llojit njerëzor në dy gjini, mashkull ose femër, me të gjitha dallimet e shumta, në trup e në shpirt dhe në proceset fiziologjike, të cilat fillojnë që në çastet e para të ngjizjes së spermatozoidit, i cili vazhdon ecurinë e tij të veçantë deri në etapën e plotësimit në të dyja gjinitë, në përputhje me misionin që kanë për të kryer.

Pastaj fillon të duket misioni i nënës në pranimin e shtatzënisë, në ruajtjen e fetusit, në ushqimin e fëmijës dhe rritjen e tij. Për të gjitha këto çështje, dijetarët, gjatë shekujve, kanë qenë jo të qartë, derisa pohuan se kjo është prej çështjeve më të mahnitshme të ekzistencës.

Etapa e fundit në këtë rrugëtim të njeriut, është etapa e lindjes, është etapa e një shndërrimi të plotë, e shoqëruar me shumë gjëra të mahnitshme.

Cilët janë ata faktorë që e shtyjnë fetusin të dalë prej barkut të nënës së tij?

Si bëhet bashkërendimi mes kësaj pune dhe mes përgatitjes së trupit të nënës për të realizuar lindjen?

Si është e mundur për fetusin, që është përshtatur në një gjendje gjatë një periudhe kohe prej nëntë muajsh, të përshtatet në një gjendje të re dhe të gjitha pjesët e kësaj gjendjeje të re të

realizohen vetëm brenda një çasti të vetëm, ku këputet lidhja e fëmijës me nënën e tij dhe tani foshnja merr frymë në ajrin e atmosferës së Tokës? Për herë të parë foshnja tani e merr ushqimin nga goja, kurse para këtij çasti ushqehej nëpërmjet kordonit ombelikal. Tani foshnja ka dalë në një mjedis të mbushur me dritë, kur pak më parë ishte në mjedisin e errët të barkut të nënës së tij.

A nuk është e gjitha kjo argumenti më i madh që vërteton fuqinë, pa anë e pa fund të All'llahut dhe të punëve të Tij që s'kanë kufi?!

Vallë, lënda e ngurtë, e vdekur dhe kjo natyrë pa objektiv, a kanë mundësi të sistemojnë qoftë edhe njërën hallkë të vetme e të vogël prej mijëra hallkave të etapave të krijimit, duke përfituar prej rastësisë së verbër?

Është për të ardhur keq, kur dëgjon se njeriu mendon për këtë mundësi iluzion, në lidhje me krijimin e tij.

Më pas, ajeti e vë theksin mbi dy etapa të tjera të këtij programi mahnitës: flet për etapën e gjashtë dhe të shtatë, që fetusi kalon nëpër një krijimi tjetër. Ajeti përmend etapën e jetëgjatësisë së njeriut dhe të faktorëve që ndikojnë në jetëgjatësinë e njeriut, ose në pakësimin e saj. Për të gjitha këto, ajeti i nderuar thotë: "**Jeta e askujt nuk zgjatet e as nuk shkurtohet pa qenë e shënuar në Libër."**.[1]

1 Qëllimi i përdorimit të fjalës: *"kitàbin"* - *"libër"*, në ajet, është të tregojë diturinë e pakufizuar të All'llahut. Disa të tjerë kanë thënë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"libër"*, është *"leuhi mahfùdh"*, ose jeta e njeriut, por që përsëri rezulton në diturinë e All'llahut.

Patjetër ky proces u nënshtrohet ligjeve e programeve të studiuara deri në imtësi, ku vendimtare është dituria e All'llahut dhe fuqia e Tij absolute.

Por, cilët janë faktorët që ndikojnë në vazhdimin e jetës së njeriut? Cilët janë faktorët që e kërcënojnë vazhdimin e jetës së njeriut?

Me fjalë të përmbledhura, cilët janë faktorët që duhet të gërshetohen njëri me tjetrin, që i mundësojnë njeriut të jetojë njëqind vjet, ose më shumë, ose më pak? Dhe e fundit, cilët janë faktorët që e bëjnë domosdoshmëri ndryshimin në jetët e njerëzve? Për të gjitha këto, ka llogaritje të hollësishme dhe të ndërlikuara, por këtë llogaritje nuk i di askush përveç All'llahut dhe ato që ne dimë, në raport me ato që nuk dimë, konsiderohen gjëra që nuk merren në konsideratë.

Fjala e ajetit: "*muam'merin*", është në kuptimin e individit jetëgjatë dhe është marrë nga lënda: "*umrun*" - "*jetë*", e cila, në rrënjën e saj: "*imaretun*", është në kuptimin e kundërta e gërmadhave, domethënë popullim, kurse fjala: "*umrun*" - "*jetë*", është emër që tregon kohën e caktuar që jeton trupi në këtë botë.

Ajeti mbyllet me fjalinë: "**Me të vërtetë, kjo për All'llahun është e lehtë!"**.

Krijimi i kësaj qenieje të mahnitshme prej dheut dhe fillimi i krijimit të njeriut prej ujit të spermatozoidit, si dhe çështjet që kanë lidhje me gjininë dhe pastaj me martesën, me shtatzaninë, me lindjen, me jetën e gjatë, ose me jetën e shkurtër, të gjitha këto janë nën kontrollin e fuqisë së All'llahut, ose nën kontrollin e diturisë së Tij dhe të llogarisë. Të gjitha këto punë, për All'llahun

e Lartësuar janë shumë të thjeshta e të lehta. Të gjitha këto punë, nga njëra anë, janë prej argumenteve të shpirtrave, të cilat na lidhin ne me fillimin e botës së ekzistencës dhe, nga ana tjetër, ne njihemi me botën e ekzistencës. Gjithashtu, këto punë konsiderohen argumente të gjalla, që vërtetojnë mundësinë e Ringjalljes.

Ai që kishte fuqi të bënte krijimin e parë prej dheut e prej spermatozoidit, a mund të jetë i pafuqishëm ta kthejë jetën te njerëzit, edhe një herë tjetër?!

Ai që ka dijeni për të gjitha hollësitë e punëve që lidhen me këto ligje, mos vallë e ka problem, që të ruajë punët e njerëzve për Ditën e Ringjalljes?!

Ajeti 12 konsiderohet prej ajeteve me horizont të gjerë, që tregojnë madhështinë dhe fuqinë e All'llahut në krijimin e deteve, të begative dhe dobive të panumërta që vijnë prej tyre. Për të gjitha këto, ajeti thotë: "**Edhe dy detet** (llojet e ujit) **nuk janë të njëjta: njëri është i ëmbël e i këndshëm dhe uji i pihet me shije, kurse tjetri është i njelmët dhe i hidhët."**.[1]

Dy detet, në origjinë, janë formuar prej pikave të ujit të pastër e të shijshëm që zbret prej Qiellit në Tokë, por, pavarësisht se dy detet kanë të njëjtën origjinë, të dy shfaqen në forma plotësisht të kundërta dhe me dobi, gjithashtu, të ndryshme.

1 Fjala e ajetit: *"adhbun"* në fjalorin e Ràgibit, "Mufredàtu El Fàdhil Kur'àn", është në kuptimin e ujit të pastër e të ftohtë, kurse në fjalorin "Lisànul arab", kjo fjalë është shpjeguar në kuptimin: "ujë i mirë", por është mundësia që të dyja cilësitë, "i pastër" dhe "i ftohtë", të hyjnë në kuptimin i "mirë".

Është shumë domethënës fakti që njeriu, prej të dy deteve merr mish të freskët: "**Ju ushqeheni me mish të njomë prej të dyve dhe prej tyre nxirrni stolitë që mbani.**".

Veç kësaj, është edhe mundësia e përfitimit, që nëpërmjet dy deteve të transportoni mallra dhe të lëvizni nga njëri vend në një vend tjetër: "**Shikoni anijet si çajnë ujin, ndërsa ju lundroni me to për të kërkuar nga dhuntitë e Tij. Ndoshta ju bëheni falënderues."**.

Shiko me kujdes në fjalët e mëposhtme:

1- Fjala e ajetit *"furàtun"*, në fjalorin "Lisànul arab" është shpjeguar në kuptimin: *"ujë shumë i ëmbël"*.

Fjala e ajetit *"sàigun"*, do të thotë: ujë që pihet me shije, për shkak se është i ëmbël dhe është e kundërta e ujit të kripur, ose e ujit të njelmët, që është ujë i hidhur, të cilin njeriu e nxjerr nga goja menjëherë.

2- Disa interpretues të Kur'anit, kanë thënë se ky ajet është një model për ndarjen dhe dallimin mes besimtarit dhe mohuesit, por ajeti para dhe ajetet që vijnë pas këtij ajeti, që flasin për krijimin, madje edhe vetë ky ajet, dëshmon të vërtetën se kjo frazë e ajetit studion sekretet e Njëtimit të All'llahut, duke e vënë theksin në shumëllojshmërinë e ujërave, në ndikimet e ndryshme të ujërave dhe në dobitë e përbashkëta që vijnë prej tyre.

3- Ajeti ka përmendur tri dobi, prej dobive të shumta të deteve, që ishin: ëmbëlsia, veshjet për zbukurim dhe çështja e mbartjes së mallrave dhe transporti.

Ne dimë se deti është një burim shumë i rëndësishëm i lëndëve ushqyese që përdor njeriu. Çdo vit, prej deteve nxirren

miliona tonelata mishi të freskët, pa bërë njeriu asnjë lloj pune për rritjen e këtij mishi, sepse sistemi i baraspeshimit në natyrë është i përfshirë në një program të hollësishëm e të llogaritur në atë mënyrë, që njerëzit të kenë mundësi të përfitojnë prej kësaj tryeze hyjnore, pa qenë nevoja të bëjnë edhe mundimin më të vogël, por u thuhet merre dhe ushqehu.

Prej detit nxirren, gjithashtu, sende të ndryshme për zbukurim, si: perla, sadefi, koralet e fosilizuara në formën e gurëve të çmuar me ngjyra të bukura, etj.

Kur'ani Famëlartë është përqendruar të përmendë këto çështje, për shkak se shpirti i njeriut është krejtësisht i ndryshëm nga shpirti i kafshës, në përmbajtjen e tij në përmasa të shumta, prej të cilave është edhe "ndjenja për të bukurën", që, në të vërtetë, është burimi i bukurive të çështjeve estetike, artistike e letrare dhe ngopja me këto bukuri në mënyrë të shëndetshme, larg teprimit e lënies mangët dhe shpenzimit të tepërt, ngjallin gëzim në shpirt, i japin njeriut veprimtari e qetësi dhe e ndihmojnë njeriun të realizojë punët e rënda të jetës.

Për sa i përket çështjes së ngarkesave dhe transportit, që është njëra prej çështjeve më të rëndësishme të qytetërimit të njeriut dhe të jetës shoqërore, duke marrë parasysh se detet zënë pjesën më të madhe të globit të Tokës dhe janë të lidhur njëri me tjetrin, i bëjnë njeriut shërbimin më të rëndësishëm për transportin e mallrave e të udhëtarëve nga njëri vend në një vend tjetër. Këtë shërbim njeriut nuk ia ofron asnjë mjet tjetër transporti

në këtë shkallë kaq të gjerë, për shembull, vetëm një anije ka mundësi të mbartë në bordin e saj me dhjetëra mijë automobila.[1]

4- Natyrisht që përfitimi prej deteve nuk mund të reduktohet në ato që thamë më sipër dhe Kur'ani Famëlartë, kur përmend përfitimet që vijnë prej deteve, patjetër që nuk ka qëllim të reduktojë përfitimet prej tyre vetëm në këto tri përfitime që u thanë më sipër, pasi me detet ka lidhje edhe çështja e formimit të reve, e ilaçeve, e naftës, e veshjeve, e plehrave për tokat e varfra, ndikimi që kanë detet në shkaktimin e erërave dhe të tjera e të tjera begati që vijnë prej tyre.

5- Theksi që Kur'ani vë mbi "mishin e freskët", është një tregues me përmbajtje shumë të thellë, në lidhje me dobitë ushqyese të këtij "mishi të freskët", në krahasim me mishrat e ndenjur, mishrat e konservuar, apo nënprodhime të këtyre mishrave.

6- Këtu mund të shtrohet pyetja: Detet me ujë të kripur shtrihen në të gjithë globin. Ku janë detet me ujë të ëmbël?

Në përgjigje, mund të thuhet se edhe numri i liqeneve me ujë të ëmbël nuk është i vogël në sipërfaqen e Tokës dhe liqene të tilla ka shumë, në të gjitha kontinentet, shto edhe lumenjtë e mëdhenj, që në disa raste, gjithashtu quhen dete. Disa herë në Kur'an, gjatë tregimit të Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, përdoret fjala "det" për lumin Nil, si, për shembull, në ajetin 50 të

1 Në ditët e sotme janë ndërtuar anije cisternë për transportimin e naftës, me kapacitet mbartës deri pesëqind mijë tonelata. Asnjë mjet tjetër, përveç anijeve, s'ka mundësi ta mbartë këtë sasi kaq të madhe nafte. Gjithashtu, asnjë rrugë nuk e mban dot një peshë kaq të rëndë, pa thënë se edhe në të kaluarën, kapaciteti mbartës i anijeve ishte shumë më i madh se kapaciteti mbartës i kafshëve.

sures “El Bekare”; në ajetin 63 të sures “Esh Shuarà” dhe në ajetin 138 të sures “El A’raf”.

Edhe grykëderdhjet e lumenjve në dete e në oqeane, në të vërtetë janë liqene me ujë të ëmbël, sepse ujërat e lumenjve, kur derdhen në oqeane e në dete, e shtyjnë ujin e kripur dhe për një farë kohe dy llojet e ujërave mbeten të papërziera.

7- Fraza e ajetit: “**për të kërkuar nga dhuntitë e Tij**”, ka një kuptim shumë të gjerë dhe përfshin çdo lloj veprimtarie ekonomike, që ka si bazë detin.

Hulumtim

Faktorët lëndorë e moralë që ndikojnë në zgjatjen e jetës

Interpretuesit e Kur’anit kanë bërë studime të ndryshme mbi këto ajete, në lidhje me zgjatjen, ose me shkurtimin e jetës, me urdhrin e All’llahut. Gjithashtu, studimet e tyre janë shtrirë edhe mbi ato që thuhen në transmetimet islame, në lidhje me këtë çështje.

Natyrisht, ka një sërë faktorësh natyrorë, që ndikojnë në zgjatjen, ose në shkurtimin e jetës. Shumica e këtyre faktorëve njihet prej njerëzve, siç janë: ushqimi i shëndetshëm, pa e tepruar dhe pa e lënë mangët, puna fizike dhe vazhdimi i lëvizjes, mospërdorimi i ushqimeve gjumëndjellëse dhe i pijeve alkoolike,

largimi prej sendeve e prej veprimeve që vazhdimisht shkaktojnë eksitim dhe mbi të gjitha, besimi i fortë. Të gjithë këta faktorë e ndihmojnë njeriun të jetojë në siguri e në qetësi dhe në raste vështirësish, i japin fuqi të përballojë çdo problem.

Patjetër që ka edhe faktorë të tjerë jolëndorë, që në pamjen e jashtme nuk është e qartë lidhja që ata kanë me çështjen e jetëgjatësisë, por, transmetimet e ardhura në lidhje me çështjen e zgjatjes së jetës, kanë vërtetuar këtë lidhje dhe, si shembull, po rendisim transmetimet vijuese:

a) Transmetohet se i Dërguari *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Sadakaja dhe mbajtja e lidhjeve me të afërmin, popullojnë shtëpitë dhe zgjasin jetët."*.[1]

b) Prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* transmetohet: *"Ai që dëshiron të gëzohet, se do të ketë furnizim të bollshëm dhe të harrojë vdekjen, le të mbajë lidhjet me të afërmit e vet."*.[2]

c) Për sa u përket disa mëkateve të rënda, si prostitucioni dhe ndikimet që ka prostitucioni në shkurtimin e jetës, në transmetimin shumë të përhapur, të ardhur prej Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"O myslimanë, ruhuni nga prostitucioni, sepse në atë ka gjashtë veçanti, tri janë në këtë botë dhe tri të tjerat janë në Botën Tjetër. Veçantitë e prostitucionit në këtë botë janë: heq bukurinë e fytyrës, sjell varfëri dhe shkurton jetën."*.[3]

1 Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 354 dhe f. 355.
2 Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 354 dhe f. 355.
3 Burimi i mësipërm.

d) Transmetohet se Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Bamirësia dhe sadakaja shuajnë varfërinë, zgjasin jetën dhe sprapsin shtatëdhjetë vdekje të këqija."*.[1]

Kanë ardhur edhe transmetime të tjera që flasin për mëkate e për faje të tjera, si padrejtësia, madje kanë ardhur transmetime që flasin edhe për mëkatet në përgjithësi.

Disa interpretues të Kur'anit, që nuk kanë mundur të bëjnë dallimin mes "jetës së caktuar" dhe "jetës së varur", i kanë mënjanuar këto transmetime, pasi kanë besuar se janë në kundërshtim me tekstin e Kur'anit, që thotë se jeta e njeriut është deri në një kufi të caktuar, që nuk ndryshon.[2]

Sqarimi i çështjes: Pa dyshim që për njeriun ka një "jetë të caktuar" *(exhelun mahtùmun)* dhe një "jetë të varur" *(exhelun mual'lekun)*.

"Jetë e caktuar", është fundi i gatishmërisë së trupit për të qëndruar dhe me ardhjen e këtij fundi, me urdhrin e All'llahut, jeta e njeriut merr fund.

"Jeta e varur", ose "jeta e shpuar", ose "jeta e grabitur", përfundon me mbarimin e kushteve të afatit kohor të jetës, për shembull, njeriu kryen vetëvrasje. Nëse ai nuk do të kishte kryer këtë mëkat shumë të rëndë, jeta e tij do të vazhdonte edhe për shumë vite të tjera; ose jeta e tij shkurtohet si rezultat i pijeve alkoolike, ose i marrjes së drogave, ose nga dhënia pas epsheve pa asnjë kufi. Në këtë gjendje, trupi e humb fuqinë brenda një kohë

1 "Sefijnetul Bihàr", vëll. 2, f. 23, Lënda "Sadakaja".
2 Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 22, f. 164, fundi i ajetit objekt studimi.

të shkurtër, por, nëse ai do të ishte larguar nga punët e lartpërmendura, mund të jetonte edhe për shumë vite të tjera.

Praktika ka vërtetuar se këto punë mund të kuptohen prej të gjithëve dhe askush nuk mund ta mohojë këtë fakt.

Për sa i përket caktimit të jetës (kaderit), ka shumë çështje që kanë lidhje me "jetën e grabitur" dhe këto çështje, gjithashtu, nuk mund të mohohen.

Bazuar mbi ato që kanë ardhur nga transmetimet, rezulton se shpenzimi i pasurisë në Rrugën e All'llahut dhe mbajtja e lidhjeve me të afërmit, zgjasin jetën dhe sprapsin lloje të shumta pësimesh e sprovash të rënda, në të vërtetë kanë qëllim pikërisht këta faktorë.

Nëse nuk bëjmë ndarjen mes "jetës së grabitur" dhe "jetës së caktuar", nuk do të kemi mundësi të kuptojmë shumë punë që kanë lidhje me "vendimin" *(kadà)* e me "caktimin" *(kader)*, ose ndikimin e luftës në Rrugën e All'llahut dhe të punës së vazhdueshme gjatë gjithë jetës. Pa bërë këtë dallim, shumë çështje nuk do të gjenin zgjidhje.

Ky studim mund të sqarohet edhe vetëm me këtë shembull të thjeshtë:

Dikush ka blerë një makinë të re, që, sipas fabrikimit, parashikohet të vazhdojë në gjendje pune njëzet vjet, me kusht që të ruhet dhe t'i bëhen shërbimet e mirëmbajtjes. Në këtë gjendje, afati kohor i caktuar për këtë makinë është njëzet vjet. Por, nëse makinës nuk i bëhen shërbimet e mirëmbajtjes dhe pronari e lë makinën në dorën e njerëzve që nuk merakosen dhe nuk dinë ta ngasin makinën, ose e ngarkon makinën më shumë se kapaciteti,

ose çdo ditë e përdor nëpër rrugë malore, patjetër që "jeta e caktuar" e kësaj makine do të ulet deri në gjysmën e viteve të caktuara. Kjo ulje vjen për shkak të "grabitjes" së jetës së makinës. Por ne çuditemi, përse disa interpretues të Kur'anit nuk e kanë trajtuar këtë çështje kaq të qartë.

Ajetet 13 – 14

﴿يُولِجُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ وَيُولِجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ وَسَخَّرَ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ كُلٌّ يَجْرِي لِأَجَلٍ مُسَمًّى ذَٰلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ لَهُ الْمُلْكُ وَالَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ مَا يَمْلِكُونَ مِنْ قِطْمِيرٍ ١٣ إِنْ تَدْعُوهُمْ لَا يَسْمَعُوا دُعَاءَكُمْ وَلَوْ سَمِعُوا مَا اسْتَجَابُوا لَكُمْ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكْفُرُونَ بِشِرْكِكُمْ وَلَا يُنَبِّئُكَ مِثْلُ خَبِيرٍ ١٤﴾

"Ai e bën natën të kalojë në ditë dhe ditën të kalojë në natë. Ai i ka nënshtruar Diellin dhe Hënën, kështu që secili lëviz për një kohë të caktuar. Ky është All'llahu, Zoti juaj. Pushteti është i Tij! Kurse ata që ju i adhuroni krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës."

"Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t'ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kiametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhammed) **ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm."**

Komentimi

Idhujt nuk e dëgjojnë thirrjen tuaj

Ajetet 13-14 e vënë theksin mbi një pjesë tjetër të argumenteve të Njëtimit të All'llahut dhe të mirësive të Tij, që s'mbarohen kurrë, njëkohësisht e shtyjnë njeriun që, duke u njohur me këto mirësi, të falënderojë për të gjitha mirësitë vetëm të Adhuruarin e vërtetë dhe të heqë dorë prej çdo forme të vënies shok All'llahut në adhurim dhe prej çdo adhurimi tjetër besëtytni. All'llahu i Lartësuar njofton me fjalën e Tij: "**Ai e bën natën të kalojë në ditë dhe ditën të kalojë në natë."**.

Fjala e ajetit *"julixhu"*, në rrënjën e saj *"ijlàxh"*, është në kuptimin e hyrjes në një ngushticë, por mund të jetë edhe në kuptimin e shtimit, ose të pakësimit gradual të natës e të ditës gjatë rrotullimit vjetor të Tokës, çka çon në ardhjen e stinëve të vitit, me të gjitha ndikimet e begatitë e çdo stine; ose mund të jetë edhe në kuptimin e kalimit gradual prej natës në ditë; ose mund të jetë edhe në kuptimin e dukurisë së agimit e të muzgut, që pakëson rreziqet e kalimit të befasishëm prej dritës në errësirë, ose e kundërta.[1]

Në vijim, ajeti e vë theksin në nënshtrimin e Diellit e të Hënës. All'llahu i Lartësuar thotë: "**Ai i ka nënshtruar Diellin dhe Hënën"**, domethënë nënshtrimin më të mirë të lëvizjes së këtyre dy trupave qiellorë nga ana e realizimit të dobive të

1 Çështjen e kalimit gradual të natës e të ditës e kemi studiuar në komentin e ajetit 27 të sures "Àli Imràn".

ndryshme për njerëzit. Ky nënshtrim konsiderohet burimi për begatitë e ndryshme në jetën e njerëzve, sepse retë, era, Hëna, Dielli dhe trupat e tjerë qiellorë, janë në lëvizje të përhershme, që njeriu të ketë mundësi të vazhdojë jetën e tij, të zgjohet prej shkujdesjes dhe të mbajë në mendje Dhuruesin e vërtetë të këtyre mirësive. (Në lidhje me nënshtrimin e Diellit e të Hënës, kemi vënë një studim të veçantë në komentin e ajetit 2 të sures "Er Rra'd" dhe të ajetit 33 të sures "Ibràhijm".)

Dielli, së bashku me planetet e tij, përfshirë edhe Hënën, me lëvizjen e përpiktë e të sistemuar, sjellin dobi të përshtatshme dhe të mira për njerëzit. Megjithëkëtë, sistemi rregullues i të gjithë këtyre trupave qiellorë, nuk është i përjetshëm, domethënë se edhe këto makineri të stërmëdha, me dritën e me shkëlqimin që kanë, në fund të fundit, do të pësojnë defekt dhe do të ndalojnë punën, prandaj ajeti, pasi ka përmendur nënshtrimin e Diellit e të Hënës, thotë: "...**kështu që secili lëviz për një kohë të caktuar."**.

Në ajetet 1-2 të sures "Et Tekuijr", njoftohet pikërisht fundi i këtyre trupave qiellorë: "Kur Dielli të errësohet. Dhe kur yjet të kenë rënë.", të gjitha do të shkojnë drejt shuarjes e asgjësimit.

Në lidhje me togfjalëshin e ajetit "**kohë të caktuar"**, disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se ky togfjalësh tregon rrotullimin e Diellit dhe të Hënës rreth boshteve të veta dhe ky rrotullim, për Diellin, siç dihet, kryhet brenda një viti, kurse për Hënën kryhet brenda një muaji.[1]

Në Kur'anin Famëlartë, çështja e mbarimit të jetës së Diellit e të Hënës është përmendur në ajetin 61 të sures "En Nahl"; në

1 Tefsiri "Rùhul Bejàn" dhe tefsiri "Rùhul Xhinàn".

ajetin 45 të sures "El Fàtir"; në ajetin 42 të sures "Ez Zumer" dhe në ajetin 67 të sures "El Gàfir", çka tregon se interpretimi i mësipërm, si dhe interpretimi i parë, është i saktë.

Në vijim, ajeti flet se zotërimi i dritës është rezultat i studimit mbi Njëtimin e All'llahut. Ajeti njofton: "**Ky është All'llahu, Zoti juaj.**".

All'llahu është Ai që ka vendosur sistemin e gjumit, errësirën dhe lëvizjet e përpikta të Diellit e të Hënës, me të gjitha mirësitë që vijnë nga lëvizja e këtyre trupave qiellorë.

Ajeti njofton: "...**Pushteti është i Tij! Kurse ata që ju i adhuroni krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës."**.[1]

Ragibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, "Mufredàtu El Fàdhil Kur'àn", fjalën e ajetit "*kitmijr*", e ka shpjeguar në kuptimin e pejzës së hollë në bërthamën e hurmës dhe e ngjason me një send pa rëndësi, kurse Et Tabrasij, në tefsirin "Mexhmaul Bejàn", si dhe Kurtubij'ji në tefsirin e tij, kanë thënë se është ajo cipa e hollë dhe e tejdukshme që mbështjell të gjithë bërthamën e hurmës. Është e qartë se kjo fjalë është alegori, për të treguar një send shumë të parëndësishëm.

Patjetër që idhujt as dëmtojnë e as nuk sjellin dobi. Idhujt nuk e largojnë dëmin as prej jush e as prej vetes së tyre, idhujt as

1 Përemri lidhor "*el ledhijne*" - "të cilët", është shumës i gjinisë mashkullore dhe përdoret për qeniet me arsye. Idhujt këtu janë përmendur me këtë përemër, për shkak të besimit të idhujtarëve në ata trupa të ngurtë dhe, pasi janë përmendur në Kur'an, me këtë mënyrë, Kur'ani u përgjigjet idhujtarëve me një gjuhë shumë të ashpër.

nuk sundojnë e as nuk zotërojnë asgjë, qoftë një send sa cipëza që mbulon bërthamën e hurmës. Kështu janë idhujt, atëherë si ka mundësi që ju, o njerëz, jeni kaq të shkujdesur, sa të adhuroni idhujt dhe të prisni që idhujt të zgjidhin problemet tuaja?!

Ajeti vijues shton: "**Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj"**, sepse idhujt janë copa guri, ose copa druri dhe asgjë më shumë se trupa të ngurtë, pa ndjenja: "...**por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t'ju përgjigjeshin."**.

Kur bëhet e qartë se idhujt s'kanë fuqi të sjellin dobi, ose të dëmtojnë qoftë edhe aq sa është cipëza që mbështjell bërthamën e hurmës, si është e mundur të prisni që idhujt të bëjnë ndonjë gjë për të mirën tuaj, ose të zgjidhin ndonjë problem që keni?!

Por më e habitshme do të jetë në Ditën e Kiametit: "**Në Ditën e Kiametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre."**.

Idhujt do të thonë: "O Zoti ynë, ata nuk na kanë adhuruar ne, por në të vërtetë ata kanë adhuruar dëshirat e veta.".

Kjo dëshmi do të jetë ose me atë që quhet "gjuha e gjendjes", të cilën e kupton çdo njeri me veshët e qenies së tij, ose All'llahu i Lartësuar u jep idhujve në atë ditë organet e gjymtyrët e njeriut, që edhe idhujt të flasin dhe të dëshmojnë se idhujtarët, duke adhuruar idhujt, në të vërtetë i vinin shok All'llahut në adhurim dhe ishin shmangur nga e vërteta, megjithëse në realitet adhuronin hamendësimet dhe pasionet e veta.

Përmbajtja e këtij ajeti është e ngjashme me përmbajtjen e ajetit 28 të sures "Jùnus", ku All'llahu i Lartësuar thotë: "Ditën kur do t'i mbledhim të gjithë, atyre që i kanë vënë shok All'llahut

u themi: qëndroni në vendin tuaj, ju dhe idhujt tuaj; Ne bëjmë ndarjen në mes tyre dhe idhujt u thonë atyre: ju nuk na adhuruat ne.".

Një grup interpretuesish të Kur'anit, kanë thënë se shprehje të tilla kanë ardhur për të adhuruarit e veçantë, si engjëjt, ose Mesijhu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Ata, këtë mundësi, e mbështesin në faktin se vetëm ato që u përmendën, kanë cilësinë e të folurit dhe fjalia*:* "**Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj**", tregon se atë ditë ata janë të shqetësuar me veten e tyre deri në atë shkallë, sa edhe sikur ju o idhujtarë t'u flisni atyre drejtpërdrejt, ata nuk e dëgjojnë thirrjen tuaj.[1]

Por, duke shikuar në gjerësinë e kuptimit të frazës së ajetit: "**Nëse ju u luteni atyre"**, del qartë se qëllimi është për idhujt. Gjithashtu, edhe fraza: "**por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t'ju përgjigjeshin."**, ka lidhje vetëm me idhujt që ata kanë adhuruar në këtë botë. Më pas, All'llahu i Lartësuar, në mbyllje të ajetit, për të theksuar edhe më shumë këtë të vërtetë, thotë se askush nuk të njofton ty për të gjitha të vërtetat, siç të njofton All'llahu i Lartësuar: "**Askush nuk mund të të njoftojë ty** (o Muhammed) **ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm."**.

Kur ajeti njofton idhujtarët se idhujt do t'ju mohojnë në Ditën e Gjykimit, ju o idhujtarë do të ndiheni shumë ngushtë dhe mos u habisni prej kësaj fjale, sepse Ai që ju njofton ju, ka dijeni të hollësishme për çdo gjë që është në gjithësi dhe dituria e Tij përfshin të ardhmen, të kaluarën dhe të tashmen.

1 Kështu shpjegohet në tefsirin "Mexhmaul Bejàn", në tefsirin "Rùhul Meànij dhe në tefsirin e Kurtubij'jut.

Hulumtim

Feja është origjina e shndërrimeve

Doktrinat materialiste dhe komuniste e ndiejnë rrezikun e madh që u vinte prej feve të vërteta qiellore, prandaj materialistët dhe komunistët e kanë emërtuar fenë opium për popujt, domethënë se feja, sipas atyre, është një faktor që vë në gjumë mendimet e masave.

Kolonialistët, në Perëndim e në Lindje, punojnë shumë që të ngulisin në kokat e njerëzve këtë mendim, me anë të shkencëtarëve të fushës së shkencave shoqërore e të psikologëve, me qëllim që të çojnë masat në rrugën e gabuar dhe t'i largojnë nga feja e natyrshme me të cilën janë krijuar. Natyrisht, ajo që i shtyn kolonialistët të ndërmarrin këto veprime, është frika që ata kanë nga ngritja e popujve besimtarë, të armatosur me mendimet e feve qiellore dhe gatishmërinë që ata kanë për të rënë dëshmorë me zemër të hapur në rrugën e fesë së vërtetë. Por më shkatërruese se kjo, është se ata, lindjen e fesë ia atribuojnë injorancës së njerëzimit ndaj elementeve të natyrës.

Përgjigjja për këto fjalë është dhënë në vendin e duhur. Këtu ne nuk do të shpalosim të gjitha kundërpërgjigjet, por ajetet objekt studimi i bëjnë thirrje njeriut të mendojë e të sistemojë mendimet e punët e tij, pasi Kur'ani, rrugën e të menduarit e konsideron bazë për përparimin e plotësimin e Njerëzimit.

Si është e mundur të jetë Islami thirrje për të mpirë mendimet e njerëzve, ose Islami lindi, ngaqë njerëzit nuk kanë

dijeni rreth faktorëve të natyrës? Në të kundërt, Islami u bën thirrje njerëzve të ngrihen, të mendojnë, të jetojnë me pastërti, në një mjedis larg zhurmës së informacionit të helmuar, Islami u bën thirrje njerëzve të jetojnë larg fanatizmit e mllefit. A mund të akuzohet feja që u bën thirrje njerëzve për mendime të tilla, është opium për popullin, ose feja është faktor që trullos mendjet e njerëzve?!

Këtu mund të thuhet se njeriu ka detyrim të mos mendojë në mënyrë individuale, por duhet të dijë se e ka detyrim të këshillohet me të tjerët, të mbështesin mendimet e njëri-tjetrit për të dëgjuar thirrjen e vërtetë të Profetëve dhe të lexojnë faktet e argumentet me të cilët ata erdhën, sepse vetëm kështu, njeriu ka mundësi të dëgjojë të vërtetën e mirëfilltë.

Ngjarjet që kanë ndodhur në shekullin tonë dhe veçanërisht ngritja e revolucionarëve myslimanë në vende të ndryshme islame kundër fuqive të mëdha dhe kundër agjentëve të tyre në Lindje e në Perëndim, e kanë bërë botën errësirë të madhe para fytyrave të tyre dhe kanë lëkundur sundimin e tyre. Të gjitha këto, tregojnë se rreziku që i kërcënon këto fuqi, është pikërisht doktrina origjinale fetare dhe nga kjo kuptohet edhe qëllimi i akuzave që ata lëshojnë kundër besimeve fetare.

Është për t'u habitur se shkencëtarët e fushave shoqërore në Perëndim, kanë pohuar mosekzistencën e botës përtej natyrës dhe fenë e kanë konsideruar dukuri të sajuar prej njerëzve. Gjithashtu, ata mëtojnë ekzistencën e faktorëve të ndryshëm për lindjen e fesë, siç është faktori ekonomik, frika e njeriut, mospasja informacion, ngërçi vetjak i njeriut, etj.

Ata nuk e kanë gatishmërinë të mendojnë, qoftë edhe vetëm për një çast, për botën përtej natyrës që vërteton me argument të qartë e të mahnitshëm Njëtimin e Krijuesit të Madhëruar dhe shenjat e hapura të Profetësisë së Profetëve, si të Profetit tonë Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Gjithashtu, nuk e kanë gatishmërinë të ndahen prej gjykimeve të tyre, edhe pse dështimi i atyre gjykimeve tani është vërtetuar.

Ne nuk mund të krahasojmë këta të ashtuquajtur materialistë me idhujtarët e kohës së injorancës para Islamit, që ishin fanatikë, kokëngjeshur ndaj të vërtetës dhe nuk dinin. Materialistët e ditëve tona janë fanatikë, janë kokëngjeshur e armiqësorë, por nuk janë të paditur, prandaj janë edhe më të rrezikshëm dhe kanë shkarë në rrugën e humbjes më shumë se idhujtarët e kohës së injorancës para Islamit.

Vlen të përmendet se, në fundin e shumë ajeteve të Kur'anit, njeriut i bëhet thirrje të mendojë, të logjikojë e të kujtojë. Disa herë në ajete thuhet: **"Në këto ka argument për ata që mendojnë."** (sure "En Nahl", ajeti 11 dhe ajeti 69) .

Dhe: **"Në këto ka argumente për ata që mendojnë."** (sure "Err Rra'd", ajeti 3; sure "Ez Zumer", ajeti 42; sure "El Xhàthije", ajeti 13); në ajete të tjera thuhet **"në mënyrë që ata të mendojnë"** (sure "El A'ràf", ajeti 176 dhe sure "El Hashr", ajeti 21).

Herë tjetër, ajetet e Kur'anit e shtrojnë këtë kuptim në bisedë të drejtpërdrejtë: **"Kështu i shpjegon për ju All'llahu argumentet, që ju të mendoni."** (sure "El Bekare", ajeti 219 dhe ajeti 266).

Në Kur'anin Famëlartë kanë ardhur shumë thirrje si këto. Ka thirrje që të nxisin për të mësuar ligjin e fesë, domethënë kuptimin e ligjit të fesë, ka thirrje që i drejtohen mendjes e logjikës. Në ajete të tjera lavdërohen njerëzit që logjikojnë dhe tregohet pendimi shumë i hidhur për fanatikët që kapen pas besëtytnive e pas mendjes së tyre. Këto thirrje kanë ardhur në 46 ajete të Kur'anit Famëlartë dhe shumë prej dijetarëve kanë thënë se, sikur ne të duam t'i mbledhim këto ajete dhe interpretimet që janë bërë rreth tyre, patjetër që do të duhej një libër më vete.

Në këtë kuadër, Kur'ani Famëlartë ka përmendur edhe njërën prej cilësive të banorëve të zjarrit, që është mosmendimi dhe mosarsyetimi, ashtu siç e lexojmë në Fjalën e All'llahut të Lartësuar, në ajetin 10, të sures "El Mulk": **"...dhe thanë: sikur ne të kishim dëgjuar dhe të kishim logjikuar, nuk do të ishim ndër banorët e zjarrit."**.

Në ajetin 179, të sures "El A'ràf' njofton: **"Shumë prej xhindeve dhe njerëzve Ne i kemi bërë për Xhehennemin; ata kanë zemra, por me ato nuk kuptojnë; ata kanë sy, por me ata nuk shohin; ata kanë veshë, por me ata nuk dëgjojnë, ata janë si kafshët, madje janë edhe më të humbur; të këtillë janë të shkujdesurit."**.

Ajetet 15 – 18

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ ۖ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ١٥ إِنْ يَشَأْ يُذْهِبْكُمْ وَيَأْتِ بِخَلْقٍ جَدِيدٍ١٦ وَمَا ذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ بِعَزِيزٍ١٧ وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ ۚ وَإِنْ تَدْعُ مُثْقَلَةٌ إِلَىٰ حِمْلِهَا لَا يُحْمَلْ مِنْهُ شَيْءٌ وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ ۗ إِنَّمَا تُنْذِرُ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ بِالْغَيْبِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ ۚ وَمَنْ تَزَكَّىٰ فَإِنَّمَا يَتَزَكَّىٰ لِنَفْسِهِ ۚ وَإِلَى اللَّهِ الْمَصِيرُ١٨﴾

"O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për All'llahun, kurse All'llahu s'ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd."

"Nëse do, Ai ju zhduk dhe sjell krijesa të reja."

"Kjo gjë nuk është e vështirë për All'llahun."

"Asnjë shpirt i ngarkuar nuk do të mbartë barrën e tjetrit. Nëse i ngarkuari rëndë thërret dikë që t'ia mbartë, nuk do t'i merret asgjë nga barra, edhe sikur të jetë i afërt. Në të vërtetë, ti paralajmëron vetëm ata që i frikësohen Zotit të tyre në fshehtësi dhe që falin namazin. Kush e pastron veten (nga gjynahet)**, në të vërtetë e ka për dobinë e vet, ndërsa kthimi është tek All'llahu."**

Komentimi

Askush nuk mban barrën e tjetrit

Pas thirrjes së theksuar për Njëtimin e All'llahut dhe luftimin e çdo forme të vënies shok All'llahut në adhurim dhe adhurimit kushtuar idhujve, dikujt mundet t'i shkojë në mendje të thotë: Ç'nevojë ka All'llahu që të adhurohet dhe përse kërkohet me kaq këmbëngulje adhurimi? Përse ky theksim kaq i madh në adhurimin, kushtuar vetëm Atij?

Ajetet objekt studimi shpjegojnë qartë se, në të vërtetë, jemi ne ata që kemi nevojë të adhurojmë All'llahun e Lartësuar. All'llahu nuk ka nevojë të adhurohet. Për këtë, ajeti i nderuar thotë: "**O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për All'llahun, kurse All'llahu s'ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd.**".

Nuk mund të ketë bisedë më të rëndësishme e më me vlerë se kjo bisedë, që shpjegon pozicionin tonë në botën e ekzistencës ndaj Krijuesit të ekzistencës. Kjo bisedë zbulon për ne shumë gjëra të paqarta dhe u jep përgjigje pyetjeve të shumta.

Po, Ai që është i qëndrueshëm në Veten e Tij, Ai s'ka nevojë për asnjë tjetër përveç Vetes së Vet, Ai është Një dhe i Vetëm, Ai është All'llahu i Lartësuar, kurse të gjithë njerëzit e të gjitha qeniet kanë nevojë për Atë, në të gjitha punët e tyre. Qeniet gjithmonë kanë nevojë për Atë dhe janë të lidhura me këtë Qenie të pavarur, edhe sikur lidhja mes qenieve dhe All'llahut të ndërpritej, qoftë edhe vetëm për një çast, me siguri për të gjitha

qeniet do të vinte mosekzistenca, çka do të thotë se All'llahu, në mënyrë absolute, s'ka nevojë për asnjë njeri e për asnjë send, kurse njerëzit përfaqësojnë nevojën absolute. Ashtu siç qëndron All'llahu në Veten e Tij, ashtu qëndrojnë edhe krijesat vetëm me Atë, sepse All'llahu është qenie që s'ka as anë e as fund dhe Ai domosdoshmërish qëndron në Veten e Tij e në cilësitë e Tij.

Kur gjendja është e këtillë, atëherë ç'nevojë ka All'llahu i Lartësuar për adhurimin tonë?! Ne jemi nevojtarë dhe kemi nevojë që All'llahu i Lartësuar të plotësojë nevojat tona. Ne ecim në rrugën e plotësimit tonë nëpërmjet adhurimit që bëjmë për All'llahun e Lartësuar dhe me bindjen ndaj urdhrave të Tij. Me adhurimin tonë ne i afrohemi burimit të pashtershëm, që kurrë nuk mbaron dhe shuajmë etjen prej dritave të Qenies e të cilësive të Tij.

Në të vërtetë, ky ajet është shpjegim i zgjeruar i ajeteve të mëparshëm, ashtu siç e pamë fjalën e All'llahut të Lartësuar, edhe në ajetin 13 të sures "El Fàtir": "**Ky është All'llahu, Zoti juaj. Pushteti është i Tij. Kurse ata që ju i adhuroni krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës."**.

Njerëzit kanë nevojë vetëm për All'llahun dhe jo për ndonjë tjetër, prandaj njerëzit e kanë detyrim të mos i ulin kokat para ndonjë tjetri, përveçse para All'llahut dhe nevojat që kanë, t'i kërkojnë vetëm prej Tij, sepse të gjithë të tjerët kanë nevojë për All'llahun, ashtu siç kanë nevojë edhe njerëzit vetëm për Atë, madje edhe nderimi që u bëhet Profetëve të All'llahut, që janë udhëheqësit drejt së vërtetës, bëhet për shkak se ata janë të Dërguarit e të Lartit, janë përfaqësuesit e Tij te njerëzit dhe jo se Profetët, në vetvete, janë të pavarur.

All'llahu është *"ganij'jun"* - *"i Vetëmjaftueshmi"* dhe *"hamijdun"* - *"i Falënderuari"*, domethënë: Ai s'ka nevojë për asnjë njeri, Ai është Mëshirëploti, Ai është i Buti, Ai ka dhembshuri për krijesat e Veta, prandaj vetëm Ai meriton të lavdërohet e të falënderohet, sepse në thelb Ai është më i Mëshirshmi i mëshiruesve dhe, në mënyrë absolute, Ai nuk ia ka nevojën askujt.

Duke vështruar me kujdes, vërejmë se në këtë të vërtetë ka dy ndikime pozitive për besimtarët: nga njëra anë, i zbret ata prej "kalit" të mendjemadhësisë, egoizmit e tiranisë dhe, nga ana tjetër, u tërheq vërejtjen besimtarëve dhe u thotë se ata nuk zotërojnë asnjë send prej vetes së tyre në mënyrë të pavarur prej Tij dhe ata, pa dyshim, janë të siguruar për të gjitha gjërat që kanë në duart e tyre, prandaj njerëzit të mos ia shtrijnë dorën e të mos kërkojnë prej ndonjë tjetri, por t'i kërkojnë vetëm All'llahut dhe të mos e pranojnë pozitën e robërisë para asnjë tjetri përveç All'llahut. Njerëzit e kanë detyrim të ndihen të çliruar nga çdo lloj lidhjeje varësie prej ndonjë tjetri, përveç lidhjes e varësisë prej All'llahut dhe të punojnë të bazuar në vullnetin e tyre.

Me këtë këndvështrim gjithëpërfshirës, besimtarët shikojnë se çdo qenie në këtë botë, është vetëm prej rrezeve të Qenies së All'llahut të Lartësuar. Gjithashtu, besimtarët e dinë se vetëm All'llahu është shkaktuesi i shkaqeve dhe jo vetë shkaqet.

Një grup filozofësh, këtë ajet e kanë numëruar tregues të argumentit të njohur "mundësi dhe nevojë", ose "mundësi dhe domosdoshmëri", për të vërtetuar Atë që detyrimisht ekziston, megjithëse ajeti nuk është në pozitën e nxjerrjes së argumenteve, për të vërtetuar ekzistencën e All'llahut, por ajeti shpjegon cilësitë

e larta të All'llahut. Megjithëkëtë, argumenti i përmendur, mund të konsiderohet prej domosdoshmërive që njofton ky ajet.

Shpjegimi i shprehjeve: mundësi, domosdoshmëri, nevojë dhe mospasje nevojë

Të gjitha qeniet që ne shikojmë në këtë botë, të gjitha kanë një ditë "mosekzistence" dhe vetëm pas kësaj dite ato janë veshur me rrobën e ekzistencës, ose, thënë me një shprehje më të hollë: ditën kur nuk ishte asnjë send dhe pastaj u bënë trupa që ekzistojnë. Në vetvete, kalimi nga mosekzistenca në ekzistencë, është një argument që vërteton se sendet, në ekzistencën e tyre, janë të varura prej një ekzistence tjetër dhe nuk e kanë ekzistencën prej vetvetes.

Ne dimë se, çdo qenie e shkaktuar, ka lidhje dhe qëndron në saje të Shkaktuesit dhe se e gjithë qenia është nevojë, por ky shkak, gjithashtu, është i shkaktuar nga një shkak tjetër, i cili gjithashtu, ka nevojë. Nëse do të vazhdojmë me këtë seri që s'ka fund, rezulton se të gjitha qeniet kanë nevojë dhe dihet që tërësia e këtyre qenieve nuk mund të ekzistojë në vetvete, sepse fundi i nevojës përsëri është nevojë dhe për nevojën s'ka fund, sado zero të ketë para numrit, përsëri rezultati nuk do të jetë as edhe njëshi. Gjithashtu, nuk kanë fund as lidhjet me qenie të tjera, që rezultojnë se nga ana e tyre nuk kanë gjendje pavarësie.

Prej këtu dalim në përfundim se ne patjetër duhet të kemi lidhje me një Qenie që qëndron në vetvete dhe është e pavarur nga të gjitha anët, kemi nevojë për një Shkaktues dhe jo për një të shkaktuar. Shkaktuesi është vetëm All'llahu i Lartësuar, ose, thënë me termin islam, është "Vàxhibul Vuxhùd".

Pyetje: Këtu shtrohet pyetja: Përse ajeti i mësipërm, kur flet për njeriun, flet vetëm për nevojën që ai ka për All'llahun, në një kohë kur të gjitha qeniet janë të përbashkëta në këtë nevojë?

Përgjigje: Kur njeriu, që konsiderohet zotëria i krijesave, ka kaq shumë nevojë për All'llahun, është e qartë gjendja e qenieve të tjera. Me fjalë të tjera, të gjitha qeniet e tjera, së bashku me njeriun, janë të përbashkëta në nevojën. Kjo është ajo që quhet "mundësia e ekzistencës".

Fakti që ajeti flet vetëm për njeriun, është që njeriu të mbajë nën fre mendjemadhësinë e tij dhe në çdo gjendje të hedhë shikimin e tij vetëm te All'llahu, për të gjitha nevojat e sendet që i duhen dhe kjo cilësi të jetë prej cilësive të mira dhe prej virtyteve morale të njeriut, sepse vetëm vështrimi në All'llahun çon në kryeultësi, në heqjen dorë prej padrejtësisë, në lënien e krekosjes, të mendjemadhësisë, të mburrjes me fisin, të koprracisë, të mëtimeve, të smirës dhe të zgjojë kryeultësinë para të Vërtetit.

Për të theksuar këtë nevojë të njeriut, në ajetin vijues, All'llahu i Lartësuar thotë: "**Nëse do, Ai ju zhduk dhe sjell krijesa të reja."**.

All'llahu i Gjithëfuqishëm s'ka nevojë as për ju e as për adhurimin tuaj, por jeni ju ata që keni nevojë për Atë.

Ky ajet, është i ngjashëm me ajetin 133 të sures "El En'àm", ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"Zoti yt s'ka nevojë për asnjë send, Ai është zotëruesi i mëshirës; nëse Ai do, ju zhduk dhe pas jush sjell kë të dëshirojë, ashtu siç ju solli edhe ju prej pasardhësve të atyre që ishin para jush."**.

All'llahu i Lartësuar s'ka nevojë për adhurimin tuaj, Ai s'ka as frikë prej mëkateve tuaja. Në të njëjtën kohë, mëshira e Tij e madhe dhe e gjerë ju ka përfshirë të gjithë. Madhështisë së All'llahut nuk i pakësohet asnjë grimcë, edhe sikur bota të asgjësohet e gjitha. Gjithashtu, edhe krijimi i kësaj bote, nuk i shton asgjë madhështisë së Tij.

Në ajetin 17, All'llahu i Lartësuar, e rithekson këtë të vërtetë: **"Kjo gjë nuk është e vështirë për All'llahun."**. Patjetër, kur All'llahu shfaq vullnetin e Tij për një send, Ai urdhëron: "Bëhu!", dhe sendi menjëherë bëhet. Pa dyshim që kjo vërtetohet në të gjithë botën e ekzistencës.

Në të gjitha gjendjet, kur All'llahu i Lartësuar urdhëron të besoni, të bindeni dhe të bëni adhurim, këtë urdhër Ai e jep vetëm për të mirën tuaj dhe të gjitha mirësitë që vijnë prej besimit, bindjes e adhurimit, kthehen te ju.

Ajeti 18 e vë theksin mbi pesë çështje që kanë lidhje me studimin e bërë në ajetet e mësipërme:

E para: Duke u bazuar në sifjalinë e ajetit të mësipërm: "**Nëse do, Ai ju zhduk dhe sjell krijesa të reja."**, disave mund t'u shkojë në mendje pyetja, se në këtë ajet nuk janë qëllim vetëm fajtorët e mëkatarët, pasi, besimtarët punëmirë, kanë qenë në të gjitha kohët e në çdo shekull. Vallë, a u nënshtrohen edhe punëmirët dënimeve të renditura për punët e njerëzve të këqij dhe të gjykohen me asgjësim në mënyrë të barabartë? Ajeti përgjigjet: "**Asnjë shpirt i ngarkuar nuk do të mbartë barrën e tjetrit."**.

Fjala e ajetit *"uizrun"*, është në kuptimin e barrës së rëndë dhe rrënja e saj *"uezere"*, është në kuptimin e strehës në mal. Herë tjetër, kjo fjalë vjen në kuptimin e përgjegjësisë dhe shpreh mëkatin e peshën e rëndë të punës së keqe. Nga kjo rrënjë ka ardhur edhe fjala *"vezijr"* - *"ministër"*, në kuptimin e ngarkimit të tij me përgjegjësi. Gjithashtu, në formën e emrit, po nga e njëjta rrënjë, ka ardhur edhe fjala *"muvàzereh"*, e cila, ashtu siç e ka shpjeguar Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, "Mufredàtu El Fàdhil Kur'àn", është në kuptimin e bashkëpunimit, sepse njeriu, në rastin e bashkëpunimit në një punë, mban një pjesë të barrës së shokut të tij.

Fjalia: "**Asnjë shpirt i ngarkuar nuk do të mbartë barrën e tjetrit."**, konsiderohet njëra prej bazave shumë të rëndësishme të besimit islam. Nga njëra anë, kjo fjali ka lidhje me drejtësinë e All'llahut dhe tregon se, në të vërtetë, çdo njeri është peng i punës së vet dhe është vetëm All'llahu i Lartësuar Ai që e shpërblen njeriun për punën e për luftën e tij në rrugën e të mirës, ose e dënon për mëkatin e fajin që ai bën.

Nga ana tjetër, në këtë fjali theksohet ashpërsia e dënimit në Ditën e Kiametit. Dënimi është aq i rëndë, sa askush nuk do të ketë gatishmërinë të mbajë mbi supet e veta peshën e rëndë të mëkatit të tjetrit, sado i afërm të jetë njeriu që i kërkohet kjo ndihmë.

Duke vështruar edhe një herë në këtë kuptim, rezulton se kjo fjali ka një ndikim të madh në ndërtimin shpirtëror të njeriut, në kuptimin që njeriu është kontrollues i vetvetes dhe nuk ia lejon vetes të jetë prishës i atyre që ka pranë, ose të jetë prishës i mjedisit. Natyrisht që prishja e mjedisit nuk mund të

konsiderohet faktor ndikues për prishjen e shpirtit, sepse çdo njeri mban peshën e punës së tij.

Nga një anë tjetër, kjo fjali u jep njerëzve të kuptojnë dhe i bën të shikojnë qartë se llogaria e All'llahut për shoqërinë, nuk do të jetë llogari për të gjithë, pasi çdo individ do të merret në llogari në mënyrë të pavarur. Kjo do të thotë se, kur individi, me punët që ka bërë, ka pastruar veten dhe ka luftuar shkatërrimin, mbi atë individ nuk rëndon asnjë faj dhe ai s'ka asnjë lloj frike, edhe kur e gjithë bota është e ndotur me ndyrësinë e mohimit, vënies shok All'llahut, padrejtësisë dhe mëkatit.

Si bazë, asnjë program edukues nuk do të ketë ndikim, derisa nuk i kushtohet rëndësi kësaj baze shumë të rëndësishme. (Shikoje këtë çështje me hollësi.)

Kjo çështje shtrohet në një formë tjetër në fjalinë e dytë të ajetit. All'llahu i Lartësuar thotë: "**Nëse i ngarkuari rëndë thërret dikë që t'ia mbartë, nuk do t'i merret asgjë nga barra, edhe sikur të jetë i afërt."**.[1]

Në një hadith të përcjellë prej Ibn Abasit, ose prej ndonjë tjetri, thuhet: "*Një nënë dhe djali i saj do të vijnë në Ditën e Gjykimit me shumë mëkate. Nëna do t'i kërkojë të birit të mbajë disa prej*

1 Fjala e ajetit *"muthkaletun"*, është në kuptimin e njeriut që mban peshë të rëndë. Me këtë fjalë, këtu është qëllim pesha e rëndë e punëve që mban njeriu dhe ashtu siç e shpjegon Ràgibi, togfjalëshi "mban në shpinë", është në kuptimin e mbajtjes së shumë sendeve. Në kuptimin e mbajtjes, fjala "barrë" ka dallime të shumta në rrënjën e saj. Në këtë kuptim, fjala "barrë" thuhet për çdo send që mbahet mbi shpinë. Gjithashtu, përdoret edhe për peshën e ngarkuar në brendësi të sendeve, siç është fëmija në barkun e nënës, uji në brendësi të reve dhe frutat në pemë. Të gjitha këto kuptime të fjalës "barrë", janë të ngjashme me barrën e gruas, sepse ajo që thuhet në këtë ajet, është përngjasimi i fajit me barrën e ngarkuar mbi shpinë.

përgjegjësive të saj. Këtë shërbim nëna ia kërkon të birit kundrejt mundit që ka derdhur për ta rritur dhe ngaqë e ka mbajtur në barkun e saj, por djali i thotë nënës: 'Largohu prej meje! Unë jam në gjendje shumë më të keqe se ti!'".[1]

Këtu del pyetja: Vallë, a e mohon ky ajet atë që thuhet në transmetimet e shumta, në lidhje me "rrugën e keqe" dhe me "rrugën e mirë"? Në transmetime lexojmë: "*Kush hap një rrugë të mirë veprimi, ai ka shpërblimin për këtë rrugë të mirë dhe shpërblimin e atyre që punojnë sipas kësaj rruge, pa u pakësuar atyre asgjë nga shpërblimi që kanë prej punës në rrugën e mirë dhe, kush hap një rrugë të keqe, ai do të mbajë peshën e asaj rruge, si dhe peshën e punës së atyre që punuan sipas kësaj rrugë të keqe.*".

Nëse do të shikojmë edhe në një ndodhi të vetme, përgjigjja e qartë për këtë pyetje do të ishte: Mosregjistrimi i fajit të një njeriu kundër një tjetri, domethënë se ai s'ka dorë në atë punë, por, nëse ai ka pjesë në hapjen e një rruge veprimi, ose ndihmon, ose e nxit atë rrugë, apo thotë që është rrugë e mirë, ligjërisht është pranuar se ai është bashkëveprues dhe ka pjesë në atë rrugë veprimi, apo në atë punë.

Në fjalinë e tretë të ajetit 18, zbulohet e vërteta e paralajmërimeve të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilit i thuhet qartë se

1 Hadithi është cituar në tefsire të ndryshme dhe herë është thënë se përcjellësi i hadithit është Fedijl bin Ijàd, herë thuhet se përcjellësi i hadithit është Ibn Abasi. Por përjashtohet mundësia që hadithi të jetë i pavarur prej të dyve, prandaj ka mundësi që origjina e hadithit të jetë prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Referohu në tefsirin "Rùhul Xhinàn", në tefsirin e Kurtubij'jit dhe në tefsirin "Rùhul Meànij". Ne e kemi sjellë vetëm si kuptim.

paralajmërimet e tij ndikojnë vetëm në zemrat e përgatitura për të pranuar të vërtetën. Ajeti njofton: "**Në të vërtetë, ti paralajmëron vetëm ata që i frikësohen Zotit të tyre në fshehtësi dhe që falin namazin.**".

Nëse në zemër nuk ekziston frika ndaj All'llahut, në atë zemër nuk ekziston as ndjenja se është nën kontrollin e një fuqie të padukshme, për punët që bën sheshit dhe për punët që bën në fshehtësi. Gjithashtu, nuk sjell dobi as namazi i kryer, që çon në ringjalljen e zemrës, ose që të kujtohet All'llahu për të forcuar këtë ndjenjë, as edhe paralajmërimet e Profetëve, të gjitha nuk kanë ndonjë ndikim që mund të merret në konsideratë, nëse nuk është frika ndaj All'llahut.

Kur njeriu nuk ka përqafuar ndonjë doktrinë dhe nuk beson, nëse te ky njeri nuk ekziston shpirti i studimit për të vërtetën, kur mungon edhe ndjenja e përgjegjësisë për të njohur të vërtetën, ai njeri as nuk e dëgjon me vëmendje thirrjen e Profetëve dhe as nuk mendon për argumentet e All'llahut në këtë botë.

Në fjalinë e katërt, ajeti i rikthehet edhe një herë të vërtetës së madhe: All'llahu s'ka nevojë për asnjë njeri e për asnjë send. Ajeti thotë: "**Kush e pastron veten** (nga gjynahet)**, në të vërtetë e ka për dobinë e vet.**".

Në fund, ajeti tërheq vëmendjen e punëmirëve dhe të punëkëqijve, duke thënë, se, nëse njerëzit nuk e kanë marrë dënimin për punët e tyre të këqija, ose shpërblimin për punët e mira në këtë botë, kjo s'ka ndonjë rëndësi të madhe, sepse kthimi është te All'llahu. Ajeti njofton: "**kthimi është tek All'llahu.**", pasi të gjithë do të merren në llogari për punët e tyre.

Ajetet 19 – 23

﴿وَمَا يَسْتَوِي الْأَعْمَى وَالْبَصِيرُ ۱۹ وَلَا الظُّلُمَاتُ وَلَا النُّورُ ۲۰ وَلَا الظِّلُّ وَلَا الْحَرُورُ ۲۱ وَمَا يَسْتَوِي الْأَحْيَاءُ وَلَا الْأَمْوَاتُ إِنَّ اللَّهَ يُسْمِعُ مَنْ يَشَاءُ وَمَا أَنْتَ بِمُسْمِعٍ مَنْ فِي الْقُبُورِ ۲۲ إِنْ أَنْتَ إِلَّا نَذِيرٌ ۲۳﴾

“Nuk janë, kurrsesi, njësoj i verbëri dhe ai që sheh”,

“as errësira dhe drita”,

”as freskia (e hijes) **dhe vapa.”**

“Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit. All’llahu bën të dëgjojë kë të dojë Vetë, kurse ti (Muhammed) **nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varre.”**

“Ti je vetëm paralajmërues.”

Komentimi

Errësira nuk është e barabarta me dritën

Në përshtatje me studimet që pamë në ajetet më lart, rreth besimit dhe mohimit, ajetet 19-23 përmendin katër shembuj të bukur për besimtarin dhe për mohuesin. Njëkohësisht, këto ajete shpjegojnë qartë, në mënyrën më të dallueshme, ndikimet e besimit dhe të mohimit.

Në shembullin e parë, kemi krahasimin e "mohuesit e të besimtarit" me të "verbrin dhe me atë që sheh". Ajeti i nderuar thotë: **"Nuk janë, kurrsesi, njësoj i verbëri dhe ai që sheh."**.

Besimi është dritë dhe ndriçim i mendjes. Besimi i jep njeriut aftësinë të shikojë dhe të njohë botën. Mohimi është errësirë e plotë. Në mohim mungon besimi në të vërtetën, s'ka shikim të drejtë në botën dhe nuk ka as punë të mirë.

Ajeti 258 i sures "El Bekare", e thekson këtë çështje: **"All'llahu është përkrahës i atyre që besuan, Ai i nxjerr ata prej errësirave në dritë, kurse përkrahës të atyre që mohuan janë djajtë, të cilët i nxjerrin ata** (mohuesit) **prej dritës dhe i fusin në errësirat; këta janë banorët e zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë."**.

Meqenëse syri dhe të parit nuk mjaftojnë që të realizohet shikimi, patjetër duhet më shumë dritë e më shumë ndriçim, që njeriu të ketë mundësi të shohë me ndihmën e këtyre dy elementeve, domethënë syrit dhe pamjes. Për këtë, ajeti shton se nuk janë të barabarta as "**errësira me dritën"**.

Errësira është burim për shkarjen në rrugën e gabuar, errësira është shkak për heshtje, errësira është shkaktari i të gjitha llojeve të rreziqeve. Kurse drita e ndriçimi është burimi i jetës, është mjet për të siguruar mjetet e jetesës, lëvizjen, orientimin në rrugën e duhur, zhvillimin e plotësimin. Sikur të zhdukej drita, menjëherë do të ndalonte çdo lëvizje dhe të gjitha energjitë do të zhdukeshin në botë, përfundimisht vdekja do të ishte e përgjithshme, në të gjithë botën materiale. Kështu është edhe besimi në botën e moraleve: besimi është shkak i orientimit të drejtë, i plotësimit, jetës dhe i lëvizjes.

Në vijim, ajeti tjetër njofton se nuk janë të barabarta **"freskia** (e hijes) **dhe vapa"**. Besimtari freskohet nën hijen e besimit të tij dhe qetësohet nën hijen e besimit, në siguri të plotë. Kurse mohuesi, për shkak të mohimit të tij, digjet në zjarrin e dënimit të dhimbshëm.

Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit, "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala e ajetit **"**اَلْحَرُوْرُ**" -** *"el harùru"* do të thotë: erë e nxehtë. Të tjerë kanë thënë se është në kuptimin: **"**سَمُوْمْ**"** - *"semùm"* - *"erë shumë e nxehtë"*. Disa të tjerë kanë thënë se është në kuptimin: nxehtësia e madhe e Diellit.

Ez Zemakhsheriu, në tefsirin e tij "El Kesh'shàf", thotë: era shumë e nxehtë **"**سَمُوم**" -** *"semùm"* është gjatë ditës, kurse era e nxehtë **"**اَلْحَرُوْرُ**" -** *"el harùru"* është natën dhe ditën. Të tjerë kanë thënë se era e nxehtë është e veçantë për natën.[1] Në të gjitha gjendjet, era e nxehtë kundrejt hijes së ftohtë, që sjell qetësi e kënaqësi në shpirtin e në trupin e njeriut, qëndron shumë larg.

[1] Tefsiri "El Kesh'shàf", vëll. 3, f. 608.

Në ajetin vijues, All'llahu i Lartësuar, në vazhdën e krahasimeve, thotë: **"Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit."**. Besimtarët kanë gjallëri, janë të lumtur dhe lëvizin. Ata kanë orientim të drejtë dhe zhvillim. Besimtarët janë si pema e njomë me degë, gjethe, lule e fruta, kurse mohuesi i ngjet një druri të tharë, që s'ka njomësi, s'ka gjethe, lule. Ai dru nuk bën as hije dhe nuk vlen për gjë tjetër veçse për dru zjarri.

Në ajetin 122 të sures "El En'àm", lexojmë: **"Vallë, ai që ishte i vdekur dhe Ne e ngjallëm e i dhamë dritë me të cilën ai ecën në mesin e njerëzve, a është si ai që ka mbetur në errësirë dhe nuk del dot prej saj?"**.

Në frazën vijuese të këtij ajeti, All'llahu i Lartësuar shton: **"All'llahu bën të dëgjojë kë të dojë Vetë."**, domethënë e bën që ai të dëgjojë thirrjen për në të vërtetën, bën që ai t'i përgjigjet thirrjes për të besuar se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm dhe të dëgjojë thirrjen e Profetëve, kurse **"Kurse ti** (Muhammed) **nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varre."**.

Sado lart ta ngresh zërin, sado e afërt me zemrën të jetë fjala jote dhe sado i qartë të jetë shpjegimi yt, të vdekurit s'kanë mundësi të kuptojnë asgjë nga ato që ti u thua e u shpjegon atyre, për shkak se kanë humbur shpirtin njerëzor, si rezultat i mëkateve dhe i zhytjes së tyre në baltën e krekosjes me mendjemadhësinë e fisit, të kokëfortësisë, të padrejtësisë dhe të degjenerimit. Kuptohet se te një individ i tillë, mungon gatishmëria për të pranuar thirrjen tënde.

Por ti mos u shqetëso, përse ata nuk besojnë dhe as mos u hidhëro. Detyra jote është vetëm të kumtosh kumtin dhe të paralajmërosh, sepse ti: **"Ti je vetëm paralajmërues."**.

Hulumtime

1- Ndikimet e besimit dhe të mohimit

Ne dimë se Kur'ani nuk merr në konsideratë ndarjet gjeografike, racore, klasore e ndarje të tjera të ngjashme që përdoren për diferencimin mes njerëzve. Kur'ani shprehet qartë, se kufiri ndarës mes njerëzve, është besimi, ose mohimi dhe mbi këtë bazë, i gjithë njerëzimi ndahet në dy pjesë: në besimtarë dhe mohues.

Kur'ani Famëlartë, "besimin" (ijmànin) e ka krahasuar me "dritën", kurse "mohimin" (kufrin) e ka krahasuar me "errësirën". Ky krahasim është treguesi më i mirë që ka bërë Kur'ani Famëlartë, në lidhje me çështjen e mohimit (mosbesimit) dhe të besimit.[1]

Besimi (ijmàni) është një ndjenjë dhe një lloj shikimi i brendshëm, është një lloj diturie e njohje binjake me besimin e zemrës, është një lloj vërtetimi që depërton në thellësi të shpirtit të njeriut dhe është burim për të gjitha veprimtaritë ndërtuese.

Kurse mohimi (kufri) është injorancë, është mosnjohje, është edhe përgënjeshtrim që çon në budallallepsje, madje çon edhe në humbjen e çdo ndjenje për përgjegjësinë. Mohimi, gjithashtu, çon edhe në të gjitha lëvizjet djallëzore e shkatërruese.

[1] Referohu në suret: "El Bekare", ajeti 257; "El Màide", ajetet 15-16; "Ibràhim", ateti 1 dhe 5; "Ez Zumer", ajeti 22; "El Hadijd", ajeti 9 dhe në suren "Et Talàk", ajeti 11.

Ne dimë se "drita" është burimi i të gjithë jetës, i lëvizjes, i zhvillimit dhe i orientimit të drejtë në jetë, në raport me njeriun, kafshët e bimët. Drita është e kundërta e errësirës. Nëse errësira do të ishte e vazhdueshme, do të bëhej element i heshtjes, i gjumit, i vdekjes dhe i asgjësimit, prandaj, s'ka përse të çuditemi që Kur'ani Famëlartë ka krahasuar "besimin" me dritën, kurse "mohimin" e ka krahasuar me errësirën. Herë tjetër, Kur'ani, besimin e ka krahasuar me jetën, kurse mohimin me vdekjen. Në një vend tjetër, Kur'ani, besimin e krahason me "hijen freskuese", kurse mohimin me "erën përvëluese", ose besimtarin e krahason me atë që sheh, kurse mohuesin me të verbrin. Tani e kemi të qartë gjithçka që ka lidhje me këto katër krahasime.

Ne nuk largohemi shumë nga kjo çështje, nëse themi se, kur rrimë bisedojmë me një besimtar, ndiejmë ndikimin e dritës së besimit në të gjithë qenien e tij dhe mendimet e besimtarit ndriçojnë edhe atë që gjendet pranë tij. Biseda e besimtarit është e mbushur me shkëlqim, punët e morali i besimtarit na njeh me të vërtetën e jetës dhe me jetën e vërtetë.

Kurse mohuesi, në të gjithë qenien e tij, është i mbuluar nga errësira. Ai nuk mendon gjë tjetër, përveçse për dobitë materiale, për mënyrën si të jetë sa më lart nga ana e jetës materiale. Mendimi i mohuesit nuk i kapërcen kufijtë e jetës së tij vetjake. Mohuesi është i zhytur në pasionet e tij të sëmura. Shpirti e zemra e atij që bashkëbisedon me mohuesin, nuk përplaset me gjë tjetër, veçse me valët e errësirës, që vijnë prej mohimit të mohuesit.

Sqarimet që jep Kur'ani në këto ajete, shpjegojnë qartë atë që mund të kuptohet e të mendohet rreth besimit e mohimit, jo

vetëm në mënyrën që të kapet nga ndjenjat, por edhe në mënyrë konkrete.

2- Vallë, me të vërtetë të vdekurit nuk kuptojnë?

Duke mbajtur shënim ato që kanë ardhur në ajetet objekt studimi, shtrohen dy pyetjet vijuese:

E para: All'llahu i Lartësuar, i drejtohet të Dërguarit të Tij *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Kurse ti** (Muhammed) **nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varre."**.

Në hadithin shumë të njohur, thuhet se i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në ditën e Luftës së Bedrit, u është drejtuar njëzet e katër krerëve me rëndësi të kurejshëve, që ishin hedhur në humnerën më të ndotur e më të thellë prej luginave të vendit, të quajtur Bedr. Ai qëndroi në kampingun e ngritur në sheshin e Bedrit për tri net dhe vetëm ditën e tretë urdhëroi marshimin, shtrëngoi pajimet e kafshës së vet dhe filloi të ecë. Ndërkaq, sahabët e ndoqën dhe thanë mes tyre: "Me ç'po shikojmë, po shkon të kryejë nevojat vetjake.". Por ai shkoi e qëndroi në krye të humnerës, ku ishin hedhur trupat e krerëve të kurejshëve të vrarë në betejë dhe filloi t'i thërresë me emër e me emrin e babës: *"O filan, i biri i filanit, o filan, i biri i filanit… A jeni të gëzuar që nuk iu bindët All'llahut dhe të Dërguarit të Tij? Ne e gjetëm atë që na kishte premtuar Zoti ynë, po ju a e gjetët të vërtetë kërcënimin e Zotit juaj?"*.
Omeri i tha: "O i Dërguar i All'llahut, po u flet trupave që s'kanë shpirt?!".

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Betohem në Atë që e ka shpirtin e Muhammedit në dorën e Tij, ata i dëgjojnë fjalët që u them, më mirë se ju.*".[1]

Gjithashtu, në edukatën e varrimit të të vdekurve ka ardhur edhe këndimi i "telkinit" për të vdekurit dhe ky këndim është prej besimeve të vërteta.

Si mund të pajtohen këto punë, me ato që thuhen në ajetet objekt studimi?

Përgjigje*:* Përgjigjja për këtë pyetje bëhet e qartë, kur marrim parasysh faktet që vijojnë:

Fakti i parë: Në ajetet objekt studimi, bëhet fjalë rreth moskuptimit nga ana e të vdekurve në formën natyrore dhe të zakonshme, kurse hadithi i lartpërmendur, ose këndimi i "telkinit" për të vdekurin, ka lidhje me kushte të veçanta dhe jo të zakonshme, në atë mënyrë që All'llahu i Lartësuar i mundësoi të Dërguarit të Tij *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që në atë gjendje, fjala e tij të arrinte në veshët e të vdekurve.

Me fjalë të tjera, për njeriun në botën e Berzahut, koha ndërmjet varrimit deri në Ditën e Ringjalljes së përgjithshme, ndërpritet lidhja e tij me këtë botë, me përjashtim të rasteve që All'llahu lejon, që te ata të arrijë kjo lidhje, prandaj ne zakonisht nuk kemi mundësi të lidhemi me të vdekurit në kushte të zakonshme.

[1] Tefsiri "Rùhul Bejàn", fundi i ajetit objekt studimi. Ky hadith ka ardhur edhe në "Sahijhun" e Buhariut, me pak ndryshime në fjalë. ("Sahijhu" i Buhariut, vëll. 5, f. 97, K. "Vrasja e Ebù Xhehlit")

Fakti i dytë: Meqenëse fjala jonë nuk arrin te veshët e të vdekurve, ç'kuptim ka që ne i dërgojmë "selam" të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ose kur vizitojmë varrin e tij, kërkojmë ndërmjetësimin e tij për ne te All'llahu i Lartësuar?

Pavarësisht se një grup dogmatikësh mbështeten në iluzione të gabuara, kur kapen vetëm pas kuptimit të jashtëm të fjalëve të ajeteve të Kur'anit, pa u interesuar për brendinë e thellë që shprehin fjalët e ajeteve të Kur'anit Famëlartë, ose pa e kthyer kokën të shikojnë në hadithet e shumta që kanë ardhur në lidhje me këtë çështje, mundohen të mohojnë kuptimin e "ndërmjetësimit" dhe të vërtetojnë se "ndërmjetësimi" është i gabuar.

Përgjigje: Përgjigjja për këtë pyetje, bëhet e qartë, gjithashtu, me atë që ne përmendëm në fillim të përgjigjes për pyetjen e parë, se bashkëpunimi me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe me eulijatë (të dashurit) e All'llahut, është i ndryshëm nga bashkëpunimi me të tjerët, si dëshmorët, pa harruar se Profetët dhe eulijatë janë në radhën e parë të dëshmorëve. Kur'ani Famëlartë, në ajetin 169 të sures "Àli Imràn", për dëshmorët, thotë se janë të gjallë e të përjetshëm: **"Janë të gjallë dhe ushqehen te Zoti i tyre."**. Me urdhrin e All'llahut, ata ruajnë lidhjen e tyre me këtë botë dhe, kur ata janë në këtë botë, kanë mundësi të lidhen me të vdekurit, ashtu siç qe rasti me të vdekurit e Luftës së Bedrit.

Bazuar mbi këtë që u tha, në shumë hadithe të ardhura prej të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të shkruara në librat e haditheve të dy

grupeve islame, thuhet se i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe "miqtë e All'llahut" (eulijatë) e dëgjojnë "selamin" e atij që i përshëndet ata me "selam", qoftë kur përshëndetësi me "selam" është afër, qoftë kur është larg, madje i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe miqtë e All'llahut kanë dijeni për punët e njerëzve.[1]

Meriton të shënohet se ne jemi të urdhëruar të përshëndesim të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me "selam" në pjesën e fundit të "Tesheh'hudit", në të pesë namazet ditore, kur themi "es'selàmu alejke ej'juhen'nebij'ju ue rahmetull'llàhi ue berekàtuhù" - "Paqe e bekim për ty dhe mëshira e All'llahut e begatitë e Tij për ty o Profet.". Ky është besimi i të gjithë myslimanëve, përfshirë shi'at dhe sunitë, atëherë si është e mundur t'i flitet në vetën e dytë atij që, në origjinë, s'ka mundësi të dëgjojë?!

Edhe në lidhje me këndimin e "telkinit" për të vdekurin, kanë ardhur hadithe të shumta në "Sahijhun" e Muslimit, të përcjella prej Ebu Seijd El Khuderij, prej Ebu Hurejres, prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"***U kujtoni të vdekurve tuaj fjalën e Njëtimit "là ilàhe il'lell'llàh" - "S'ka zot tjetër përveç All'llahut."*.[2]

Çështja e lidhjes me shpirtrat e të vdekurve është trajtuar edhe në "Nehxhul Belàgah", ku thuhet: "Kur Prijësi i besimtarëve,

[1] "Keshful Irtijàb", f. 109. Gjithashtu, edhe ne kemi sjellë disa transmetime në lidhje me çështjen e paraqitjes së punëve, në komentin e ajetit 105 të sures "Et Teube".

[2] "Sahijhu" i Muslimit, vëll. 2, f. 631, "Kitàbul Xhenàiz".

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, po kthehej nga Beteja e Sifijnit, kaloi pranë varrezës së qytetit Kufe dhe iu drejtua të vdekurve në atë varrezë me këto fjalë: 'O banorë të banesave të egërsuara… Sikur atyre t'u lejohej të flisnin, me siguri që do t'ju njoftonin se furnizimi më i mirë që duhet të marrë njeriu, është përkushtimi.".[1]

3- Larmia e shprehjeve është pjesë e retorikës

Në të katërt shembujt e ardhur në ajetet objekt studimi, u vu re se krahasimet kanë ardhur me shprehje diametralisht të kundërta, si, për shembull, (i verbër dhe ai që sheh). Në këtë shembull, krahasimi ka ardhur në numrin njëjës, kurse në shembullin "të gjallët e të vdekurit", krahasimi ka ardhur në numrin shumës, ndërsa në shembullin (errësirat dhe dritë), krahasimi i parë "errësira" ka ardhur në numrin shumës dhe përngjasimi i dytë "dritë", ka ardhur në numrin njëjës. Kjo është njëra anë.

Nga ana tjetër, shihet se më përpara janë vënë krahasimet negative; në shembullin e parë dhe të dytë (i verbër - errësira), kurse krahasimet pozitive janë vënë përpara në shembullin e tretë e të katërt (freskia dhe të gjallët).

Së treti, në shembullin e dytë, të tretë dhe të katërt, është përsëritur këpuja mohuese, në një kohë që nuk është përsëritur në shembullin e parë.

[1] "Nehxul Belàga", "Fjalët e shkurtra", Fjalia 130.

Dhe në fund, folja **"**مَا يَسْتَوِي**" -** *"mà jesteuij" - "nuk është i barabartë"*, ka ardhur vetëm në shembullin e parë dhe në shembullin e fundit, kurse në tre shembujt e tjerë, kjo shprehje mungon.

Disa interpretues të Kur'anit, kanë shpjeguar se kjo larmi në shprehje ka ardhur për shkaqe të ndryshme dhe disa prej shpjegimeve të tyre paraqesin interes, kurse disa të tjera mbeten në pozitën e pyetjeve për kërkim llogarie.

Ndër shkaqet e bukura, të sjella për fjalën **"**اَلظُّلُمَاتُ**" -** *"edh'dhulumàtu" - "errësira"*, shihet se kjo fjalë ka ardhur në numrin shumës, kurse fjala krahasuese ka ardhur në numrin njëjës **"**اَلنُّورُ**" -** *"en nùru" - "dritë"*. Ka ardhur kështu, sepse fjala "errësira" është në kuptimin e mohimit (kufrit), që ka shumë degëzime, kurse e vërteta e "besimit" dhe Njëtimi i All'llahut s'ka kuptim tjetër veç asaj që shpreh fjala Njëtim (Teuhid). Besimi është si një vijë e drejtë që lidh dy pika dhe nuk mund të ketë vijë tjetër veç kësaj vije në mes dy pikave besim - Teuhid, në një kohë që errësira lidhet me mohimin, me mijëra e mijëra vija të deformuara që mund të hiqen në mes dy pikave: errësira - mohim.

Gjithashtu, edhe vënia më parë e krahasimeve me përmasë negative në dy shembujt e parë, në të vërtetë, është për të treguar se Islami i largon njerëzit prej injorancës dhe errësirave dhe i fut në dritën e udhëzimit, në rrugën e të vërtetës.

Për sa u përket dy krahasimeve të fundit, mund të thuhet se ato tregojnë etapat e tjera që Islami i rrënjosi në zemër dhe zgjeroi përmasën e pozitives në shoqëri.

Kur ne i kapërcejmë të gjithë këto, do të vëmë re se larmia e shprehjeve, në origjinë, i jep bisedës njomësi dhe një frymë të veçantë, çka e bën shprehjen shumë më ndikuese, shumë më të bukur dhe shumë më tërheqëse, kurse në rastin e përsëritjes së shprehjeve në të njëjtën mënyrë, bisedës i "rrëmbehet" butësia, me përjashtim të vendeve ku fjala ka ardhur e veçuar; prandaj, oratorët gjithmonë përpiqen të flasin me shprehje të larmishme, me synimin që fjala e tyre të jetë sa më ndikuese. Ne dimë se Kur'ani Famëlartë është në shkallën më të lartë të oratorisë dhe të rrjedhshmërisë së fjalës.

Bazuar mbi këto që u thanë, sikur të mos ishte kujdesi për rrjedhshmërinë e fjalës, do të ishte një punë tjetër dhe kaq mjafton, por është e mundur që brezat e ardhshëm të arrijnë të zbulojnë sekrete të tjera, veç atyre që ne kemi përmendur, kurse sekretet që nuk i dimë, deri tani këto sekrete mbeten të panjohura.

Ajetet 24 – 26

﴿إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ بِالْحَقِّ بَشِيرًا وَنَذِيرًا وَإِنْ مِنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ ٢٤ وَإِنْ يُكَذِّبُوكَ فَقَدْ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ وَبِالزُّبُرِ وَبِالْكِتَابِ الْمُنِيرِ ٢٥ ثُمَّ أَخَذْتُ الَّذِينَ كَفَرُوا فَكَيْفَ كَانَ نَكِيرِ ٢٦﴾

"Ne të kemi dërguar ty me të Vërtetën, për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar; nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues."

"Nëse ata të quajnë ty gënjeshtar, dije se edhe paraardhësit e këtyre i kanë përgënjeshtruar të Dërguarit e tyre, që u sollën prova të qarta, shkrime dhe një Libër ndriçues."

"Pastaj Unë i dënova mohuesit; eh, sa i tmerrshëm ka qenë dënimi Im!"

Komentimi

S'ka çudi më të madhe se mosbesimi

Në ajetet më lart, pamë individë të krahasuar me të vdekurit e me të verbrit, në zemrat e cilëve, këshillat e Profetëve nuk kishin as ndikimin më të vogël. Ajetet objekt studimi, shprehin dashamirësinë e All'llahut ndaj të Dërguarit të Tij *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nxitjen për lehtësimin e dhimbjeve të tij, që ai të mos vuante kaq shumë.

Në fillim, ajeti i nderuar njofton: **"Ne të kemi dërguar ty me të Vërtetën, për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar; nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues."**.

Mjafton që ti të bësh detyrën tënde, pa lënë asgjë mangët prej saj. Detyra jote është që thirrja jote të arrijë te veshët e tyre. Përgëzoji ata me shpërblimin e All'llahut, njëkohësisht, paralajmëroji ata, edhe për dënimin e All'llahut, pavarësisht se ata i përgjigjen ose jo thirrjes tënde.

Këtu të tërheq vëmendjen fakti se, All'llahu i Lartësuar, në ajetin e fundit të grupit të ajeteve para këtij grupi ajetesh, i flet drejtpërdrejt të Dërguarit të Tij *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i thotë: **"Ti je vetëm paralajmërues."**, kurse në ajetin 24, All'llahu i Lartësuar i thotë: **"Ne të kemi dërguar ty me të Vërtetën, për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar..."**, çka tregon se i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) nuk e kumton kumtin që mbart, nga vetja e tij, por ai është i urdhëruar prej All'llahut të Lartësuar.

Nëse ajeti i mëparshëm e përqendronte bisedën vetëm në paralajmërimin, kjo ishte për shkak se flitej për injorantët kokëngjeshur, të cilët ngjasonin me të vdekurit në varre dhe nuk mund të pranojnë asnjë fjalë, ajeti objekt studimi shpjegon, në mënyrën më të qartë e më të plotë, detyrën e dytë të Profetëve, që ka si objektiv përgëzimin e paralajmërimin. Në fund, ajeti e vë edhe një herë theksin mbi paralajmërimin, sepse paralajmërimi është pjesa themelore e thirrjes së Profetëve drejtuar idhujtarëve dhe mizorëve.

Fjala **"**خَلاَ**" -** *"khalà"*, në rrënjën e saj **"**اَلْخَلاَءُ**" -** *"el khalàu"*, do të thotë: *vend i vetmuar*, në të cilin s'ka asnjë shtëpi banimi e asgjë tjetër. Kjo fjalë përdoret për të treguar kohën dhe vendin e zbrazët dhe, meqenëse koha është kalimtare, edhe për kohët e kaluara thuhet "kohët e zbrazëta", sepse prej atyre kohërave s'ka mbetur asnjë gjurmë, sikur bota të mos ishte në ato kohë.

Bazuar mbi këtë shpjegim të fjalës **"**خَلاَ**" -** *"khalà"* - *"e zbrazët"*, fraza e ajetit: **"...nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues."**, është në kuptimin: çdo popull prej popujve të mëparshëm ka pasur paralajmërues.

Meriton të mbahet shënim se, në përputhje me ajetin e mësipërm, rezulton se në çdo popull ishte një paralajmërues, domethënë ishte një Profet. Megjithëse disa, fjalën **"paralajmërues"** e shtrijnë në një kuptim shumë të gjerë dhe kanë thënë se kjo fjalë përfshin edhe dijetarët e njerëzit e urtë, të cilët, gjithashtu, u tërheqin vërejtje dhe i paralajmërojnë njerëzit, duhet

të themi se ky kuptim është në kundërshtim me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.

Në të gjitha gjendjet, kjo fjalë nuk do të thotë se në çdo qytet, ose në çdo zonë është dërguar një Profet, jo, është e mjaftueshme që thirrja e Profetëve dhe fjala e tyre të arrijë në veshët e shoqërive të ndryshme, prandaj edhe Kur'ani thotë: **"...që në atë të mos ishte një paralajmërues"** dhe nuk thotë **"që prej asaj të mos ishte një paralajmërues."**.

Bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se nuk kemi asnjë kundërthënie mes këtij ajeti, që ka si objektiv arritjen e thirrjes së Profetëve te popujt dhe mes ajetit 44 të sures "Sebe": **"...as nuk kemi dërguar te ata para teje ndonjë paralajmërues."**. Ky ajet tregon se paralajmëruesi nuk është kusht të ishte prej mesit të tyre.

Në ajetin vijues, All'llahu i Lartësuar shton: **"Nëse ata të quajnë ty gënjeshtar."**, domethënë: në përgënjeshtrimin e tyre s'ka asgjë për t'u habitur dhe ti mos u dëshpëro se pse ata të quajnë gënjeshtar, sepse: **"...dije se edhe paraardhësit e këtyre i kanë përgënjeshtruar të Dërguarit e tyre, që u sollën prova të qarta, shkrime dhe një Libër ndriçues."**.

Nuk je vetëm ti që je bërë objekt përgënjeshtrimi prej atyre injorantëve që të rrethojnë, pavarësisht se ti vjen te ata me mrekulli e me Librin qiellor. Edhe Profetët e mëparshëm janë ndeshur me të njëjtin problem, prandaj ti mos u hidhëro, por vazhdo në rrugën tënde, me vendosmëri dhe dije, se për atë që është shkruar të udhëzohet në Rrugën e Drejtë, ai shumë shpejt do të udhëzohet në Rrugën e të Vërtetës.

Në lidhje me ndryshimin mes fjalëve të ajetit **"argument"**, **"broshura"** dhe **"Libër ndriçues"**, interpretuesit e Kur'anit kanë shprehur mendime të ndryshme interpretimi, por ato më të spikaturit janë dy interpretimet vijuese:

1- Fjala e ajetit **"**الْبَيِّنَات**" -** *"el bej'jinàt"* është në kuptimin e argumenteve të qarta dhe në kuptimin e mrekullive, që dëshmojnë të vërtetën e Profetit; kurse fjala e ajetit **"**الزُّبُر**" -** *"ez'zubur"* është shumësi i fjalës **"زَبُوْر" -** *"zebùr"* dhe ka ardhur në kuptimin e librit në të cilin janë shkruar dispozita (siç është shkrimi mbi pllaka guri e të ngjashme) dhe është metaforë që shpreh përsosjen e kërkesave të shkrimeve,[1] njëkohësisht tregon librat qiellorë të zbritur para Teuratit të Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Fjala e ajetit *"el kitàbil munijr"* tregon librin që i është zbritur Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe librat e tjerë qiellorë që janë zbritur para tij. (Në Kur'anin Famëlartë, për zbritjen e "Teuratit" dhe të "Inxhijlit" flitet në ajetet 44 dhe 46 të sures "El Màide". Këta dy libra qiellorë janë cilësuar me frazën: **"هدى ونور" -** *"huden ue nùrun"* - **"udhëzues dhe dritë"**. Në ajetin 15 të të njëjtës sure, Kur'ani Famëlartë është cilësuar gjithashtu me fjalën **"dritë"**.

2- Qëllimi i përdorimit të fjalës "zebùr", është të tregojë pjesë prej librit të Profetëve, që përmban këshilla dhe meditime (si "Zebùri" i Dàùdit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kurse me fjalën e ajetit *"el kitàbil munijr"* tregon librat qiellorë që përmbajnë

[1] Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ànit, "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala *"zebùr"* do të thotë shkrim i madh dhe çdo libri të madh i thuhet *zebùr*.

dispozita dhe ligje për çështje shoqërore dhe për çështje individuale, si: "Teurati", "Inxhijli" (Ungjilli) dhe Kur'ani. Duket se ky është interpretimi më i drejtë i kësaj fjale.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, e vë theksin mbi dënimin e dhimbshëm që pësuan grupet e mohuesve të mëparshëm, për të cilët ajeti njofton: **"Pastaj Unë i dënova mohuesit; eh, sa i tmerrshëm ka qenë dënimi Im!"**.

Ata nuk i shpëtuan dot dënimit hyjnor dhe, nëse do të kishin mundësi, ata gjithmonë do të vazhdonin të përgënjeshtronin.

Disa Ne i dënuam me tufan, disa të tjerë i dënuam me furtunat e erës shkatërruese, të tjerë i shkatërruam me zhurmën e madhe të rrufeve, ose me tërmet.

Në fundin e ajetit, vjen shpjegimi që tregon sa i fortë e i fuqishëm ishte dënimi që ra mbi ata mohues: **"Sa i tmerrshëm ka qenë dënimi Im!"**. Ky njoftim është i ngjashëm me atë njeri që, pasi ka realizuar një punë, pyet të pranishmit: "Hë, si ju duket puna ime?".

Në të gjitha gjendjet, këto ajete, nga njëra anë, i japin zemër dhe i sigurojnë të gjithë ata që ecin në Rrugën e All'llahut, përfshirë udhëheqësit e sinqertë të çdo populli, në çdo kohë e në çdo shekull dhe i porosit të mos hidhërohen, të mos e humbin shpresën, sepse kundërshtarët, jo vetëm që nuk e dëgjojnë fjalën e tyre, por edhe e mohojnë. Veç kësaj, ata duhet ta dinë se thirrjet hyjnore gjithmonë janë përballur me një kundërshtim të ashpër nga ana e fanatikëve mohues e mizorë.

Në të njëjtën kohë, dashamirësit dhe të dashuruarit me të vërtetën, gjithmonë kanë qëndruar përkrah atyre që bëjnë thirrje drejt të vërtetës, madje edhe janë flijuar në këtë rrugë.

Nga ana tjetër, fraza e ajetit: **"Sa i tmerrshëm ka qenë dënimi Im!"**, është një kërcënim i drejtpërdrejtë për mohuesit kokëngjeshur, që edhe ata ta dinë mirë se punët e tyre të këqija nuk mund të vazhdojnë gjithmonë, pasi, shpejt ose më vonë, edhe mbi ta do të bjerë dënimi i All'llahut.

Ajetet 27 – 28

﴿أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجْنَا بِهِ ثَمَرَاتٍ مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهَا وَمِنَ الْجِبَالِ جُدَدٌ بِيضٌ وَحُمْرٌ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهَا وَغَرَابِيبُ سُودٌ ۲۷ وَمِنَ النَّاسِ وَالدَّوَابِّ وَالْأَنْعَامِ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ كَذَلِكَ إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ ۲۸﴾

“Vallë, a nuk e sheh ti se si All’llahu e lëshon ujin prej qiellit dhe nëpërmjet tij krijon fruta llojesh e ngjyrash të ndryshme?! Nëpër male gjenden shtigje të bardha dhe të kuqe, ngjyrash të ndryshme dhe krejtësisht të zeza.”

“Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robtë e Tij, All’llahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) **All’llahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.”**

Komentimi

Çudira të ndryshme të krijimit

Këto ajete i rikthehen edhe një herë çështjes së Njëtimit të All'llahut *(Teuhidit)* dhe hapin një faqe të re prej Librit të krijimit, para atyre njerëzve që kanë aftësinë të shikojnë dhe t'u përgjigjen me ashpërsi idhujtarëve kokëngjeshur e atyre fanatikëve që mohojnë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm.

Kjo faqe e ndritur prej Librit madhor të krijimit, tërheq vëmendjen me shumëllojshmërinë e trupave të ngurtë dhe me larminë e madhe të bukurive të jetës në botën e bimëve, kafshëve dhe njerëzve. Në ajetet objekt studimi, tregohet se All'llahu, prej ujit pa ngjyrë, ka bërë mijëra e mijëra qenie me ngjyrë dhe se Ai, prej llojeve të caktuara e të kufizuara, ka krijuar qenie të shumëllojshme, njëra më e bukur se tjetra.

Ky "Skulptor", mjeshtër i përkryer, vetëm me një laps e vetëm me një bojë, krijoi llojet e formave të panumërta të jetës e të objekteve të ngurta, të cilat tërheqin vëmendjen e shikuesve dhe i lënë ata si të hutuar, nga mahnitja që shikojnë te krijesat.

Në radhë të parë, ajeti i nderuar thotë: **"Vallë, a nuk e sheh ti se si All'llahu e lëshon ujin prej qiellit dhe nëpërmjet tij krijon fruta llojesh e ngjyrash të ndryshme?!"**.

Ardhja e kësaj fjalie me një pyetje pohuese, vë në lëvizje te njerëzit ndjenjën për të bërë pyetje, është një shenjë që tregon se ky problem është aq i qartë, sa, kur një njeri e hedh vështrimin mbi sendet nga pozitat e kërkimit të së vërtetës, ai e sheh të

vërtetën, ai sheh frutat e lulet e bukura, sheh gjethet e gonxhet e ndryshme të formave nga më të ndryshmet, që kanë dalë prej një uji e prej një dheu të vetëm.

Përdorimi i fjalës **"ngjyrat"**, mund të ketë si qëllim ngjyrat e jashtme të frutave, të cilat janë të ndryshme edhe në të njëjtin lloj fryti, si, për shembull, fryti i mollës, që e shikojmë me ngjyra të ndryshme, pa përmendur llojet e tjera të frutave. Në këtë ajet, fjala **"ngjyrat"** mund të jetë metaforë edhe për ndryshimin në shije, në përbërje e veçori të ndryshme të frutave, madje në shumë lloje frutash shikohen varietete të ndryshme ngjyrash, si: për shembull, për rrushin njihen më shumë se pesëdhjetë varietete me ngjyra e nuanca ngjyrash të ndryshme, apo fryti i hurmës së Arabisë, që njihet në më shumë se shtatëdhjetë varietete.

Në këtë ajet, tërheq vëmendjen edhe përdorimi i vetës së tretë, kur flitet për All'llahun e Lartësuar e të Gjithëfuqishëm. Pastaj kalohet në vetën e parë. Kjo mënyrë shprehjeje nuk është e kufizuar vetëm në këtë ajet, por vihet re edhe në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë. Nga kjo mënyrë ardhjeje e fjalëve, duket sikur fjalia e parë i jep bashkëbiseduesit një kuptim e një njohje të re dhe me këtë kuptim e me këtë njohje, e sjell atë para Filluesit të çdo sendi dhe aty, në praninë e Tij të Shenjtëruar, i flitet drejtpërdrejt.

Më pas, ajeti e vë theksin mbi ngjyrat e ndryshme të maleve e të rrugëve. Nëpërmjet këtyre rrugëve të ngjyrosura, kalohet në specifikimin e çdo rruge në veçanti dhe në dallimin e njërës rrugë nga tjetra, ashtu siç njofton ajeti i nderuar: **"Nëpër male gjenden shtigje të bardha dhe të kuqe, ngjyrash të ndryshme dhe krejtësisht të zeza."**. Ky ndryshim në ngjyrë, nga

njëra anë, u jep maleve një bukuri të veçantë dhe, nga ana tjetër, është shkak për të dalluar rrugën dhe për të mos humbur në morinë e kthesave, të tatëpjetave e të përpjetave të shumta të rrugëve.

Së fundi, kjo shumëllojshmëri në ngjyra, është një argument që vërteton se vetëm All'llahu është i Gjithëfuqishëm, mbi të gjitha sendet.

Fjala e ajetit **"**جُدَدٌ**" -** *"xhudedun"*, është shumësi i fjalës "rrugë", "xhade".

Kurse fjalët e ajetit **"të bardha"**, **"të kuqe"**, tregojnë ngjyrën e dheut të rrugëve.

Fjala e ajetit **"**غَرَابِيْبُ**" -** *"garàbijbu"*, tregon ngjyrën shumë *të zezë* dhe është shëmbëllyer me pendët e korbit; kurse fjala **"**سُوْدٌ**" -** *"sùdun" - "e zezë"*, që ka ardhur puqur me fjalën *"garàbijbu" - "sterrë e zezë"*, ka ardhur për theksuar edhe më shumë ngjyrën e zezë që shihet në disa rrugë malore.

Ka mundësi që interpretimi i këtij ajeti të jetë: A nuk e sheh se vetë malet janë si rrugë të bardha, të kuqe e të zeza, kanë ngjyra të ndryshme mbi sipërfaqen e Tokës? Në mënyrë të veçantë, kjo dukuri dallohet kur njeriu hedh shikimin mbi këto rrugë nga një pikë e largët. Në këtë rast, ai sheh forma e linja të ndryshme, që zgjaten mbi sipërfaqen e Tokës, të bardha, të kuqe e të zeza dhe ngjyra të tjera të ndryshme.[1]

Në të gjitha gjendjet, nga njëra anë, formimi i maleve me ngjyra të ndryshme dhe, nga ana tjetër, ngjyrosja e rrugëve

[1] Tefsiri "El Mijzàn", vëll. 17, f. 42.

malore me ngjyra të ndryshme, është një argument tjetër që vërteton fuqinë dhe urtësinë e All'llahut të Lartësuar, por fuqia dhe urtësia e All'llahut shfaqet edhe në zbukurime e në forma të reja që merr toka gjatë stinëve të vitit.

Në ajetin vijues, shtrohet çështja e ngjyrave të ndryshme te njerëzit e te gjallesat e tjera. Për këtë, ajeti thotë: **"Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu."**.

Natyrisht që njerëzit, edhe pse janë prej të njëjtit baba e prej të njëjtës nënë, janë të racave të ndryshme dhe me ngjyra që dallohen nga njëri-tjetri. Disa e kanë lëkurën e trupit të bardhë, disa e kanë të zezë si bojë shkrimi, madje edhe brenda të së njëjtës racë, ka ndryshime të mëdha në ngjyrën e lëkurës, ashtu siç ka ndryshime edhe mes dy binjakëve, edhe pse e kanë kaluar së bashku periudhën e shtatzënisë në barkun e nënës, megjithëkëtë binjakët, që në fillim dallojnë nga njëri-tjetri. Nëse do t'i shikojmë binjakët me kujdes, do të gjejmë se ata nuk kanë të njëjtën ngjyrë lëkure, edhe pse janë prej një babai e prej një nëne të përbashkët, janë ngjizur në të njëjtën kohë dhe kanë marrë të njëjtin ushqim në fazën e fetusit.

Përveç ndryshueshmërisë së jashtme, njerëzit ndryshojnë edhe nga ana e brendshme e tyre, ndryshojnë në krijimin e tyre, në dëshirat, në veçoritë e personalitetit të tyre e në shijet që kanë dhe me këtë formohet një krijesë e pavarur, e harmonizuar me të gjitha nevojat e saj të veçanta.

Në botën e qenieve të gjalla, ka me mijëra e me mijëra lloje insektesh, shpendësh, zvarranikësh, kafshësh detare e lloje të shumta egërsirash dhe të gjitha kanë veçantitë e llojit dhe gjërat e

mahnitshme të krijimit të tyre, si një argument që përsëri vërteton fuqinë e madhe dhe diturinë e Krijuesit.

Kur vizitojmë ndonjë kopsht zoologjik, menjëherë habitemi dhe, pa dashjen tonë, menjëherë kthehemi të falënderojmë e të lavdërojmë All'llahun e Lartësuar, Krijuesin e Shpikësin e këtij arti kaq mahnitës që ne e shohim në faqet e librit të ekzistencës, megjithëse në këtë kopsht zoologjik, ne kemi parë vetëm një pjesë fare të vogël prej mijëra e mijërave qenieve të gjalla që janë në këtë botë.

Pas shpalosjes së këtyre argumenteve, që vërtetojnë Njëtimin e All'llahut (Teuhidin), në fundin e kësaj fraze të ajetit, All'llahu i Lartësuar thotë se puna qëndron kështu: **"كَذَٰلِكَ" - "dhe kështu është"**.

Në të vërtetë, mundësia e përfitimit prej ajeteve që flasin për krijimin, është shumë më e madhe te njerëzit e mençur, te intelektualët dhe për këtë All'llahu i Lartësuar njofton, në fundin e këtij ajeti: **"Në të vërtetë, nga robtë e Tij, All'llahut i frikësohen vetëm dijetarët."**.

Po, dijetarët, ata e kanë frikë All'llahun nga mesi i gjithë njerëzve, dijetarët e kanë arritur pozitën e lartë të diturisë vetëm në saje të frikës ndaj All'llahut. Kjo frikë është nga përgjegjësia, krahas kuptimit të madhështisë së All'llahut të Lartësuar. Kjo gjendje e frikës ndaj All'llahut, te ata, ka lindur si rezultat i "lundrimit" të tyre nëpër argumentet që janë në horizont dhe në vetë veten e tyre. Veç kësaj, frika ndaj All'llahut ka lindur te ata në saje të njohjes graduale me të vërtetën e fuqisë dhe të diturisë së All'llahut, si dhe në saje të njohjes me qëllimet e larta të krijimit.

Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", shpjegon se fjala **"أَخْشَيَةُ" -** *"el khashjetu"* - *"frikë"*, është në kuptimin e frikës prej përgjegjësisë me të cilën përballet njeriu, frikë se nuk e plotëson detyrën dhe misionin e tij, pa thënë se sa e rëndësishme është kjo përgjegjësi, e cila, gjithashtu, çon në frikën ndaj All'llahut, sepse All'llahu, Absoluti, ia ka besuar këtë mision njeriut, që është i kufizuar dhe shumë i dobët (Mendo në lidhje me këtë pikë!).

Prej frazës së ajetit: **"Në të vërtetë, nga robtë e Tij, All'llahut i frikësohen vetëm dijetarët."**, mësohet se dijetarë të vërtetë janë vetëm ata që e ndiejnë barrën e rëndë të përgjegjësisë ndaj detyrave që kanë. Me fjalë të tjera, dijetarët janë njerëz të punës dhe jo të fjalëve, sepse dituria e pashoqëruar me punën, është argument që tregon mungesën e frikës ndaj All'llahut dhe ai që nuk e ka ndjenjën e frikës ndaj All'llahut, nuk përfshihet në kuptimin e ajetit objekt studimi.

Kjo e vërtetë është shpalosur edhe në një transmetim të ardhur prej Imam Zejnel Abidinit, Ali ibn Hysenit *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: *"Dituria për All'llahun dhe puna, janë dy shokë të ngushtë. Kush e njeh All'llahun, ai e ka frikë All'llahun dhe kjo frikë e shtyn atë të punojë në bindje të All'llahut, prandaj dijetarët e mëdhenj dhe pasuesit e tyre, janë ata që e kanë njohur All'llahun, punojnë në Rrugën e All'llahut, kanë dëshirë të arrijnë te All'llahu"*, ashtu siç e lexojmë në fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"Në të vërtetë, nga robtë e Tij, All'llahut i frikësohen vetëm dijetarët."**.[1]

[1] "Reudatul Kàfij", cituar sipas tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 359.

Në një transmetim tjetër, të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, në komentin e këtij ajeti, lexojmë: "*Dijetar është ai, fjala e të cilit vërteton punën e tij dhe, nëse fjalën e tij nuk e vërteton puna që ai bën, ai nuk është dijetar.*".[1]

Në një transmetim tjetër, lexojmë: "*Më i dituri juaj për All'llahun është ai që e ka më shumë frikë All'llahun.*".

Me fjalë të përmbledhura, mund të themi se dijetarët, në logjikën e Kur'anit, nuk janë individë, trutë e të cilëve janë kthyer në kasaforta për mendimet e ndryshme të mbledhura këtu e atje dhe të mbushura me ligje e me ekuacione shkencore, që i shërbejnë vetëm dijetarit dhe dijetarët i lakojnë me gjuhët e tyre. Gjithashtu, nuk janë dijetarë të mirëfilltë as ata që banojnë nëpër shkolla, universitete e kabinete. Jo, dijetarë janë vetëm ata individë, shikimin e të cilëve e ka ndriçuar drita e diturisë dhe e njohjes. Në të gjithë qenien e tyre ata janë ndriçuar me Dritën e All'llahut, me dritën e besimit dhe me dritën e frikës ndaj Tij. Këta janë njerëzit që kanë lidhjen më të fuqishme me detyrimet e veta, krahas përgjegjësisë së madhe ndaj detyrimeve me të cilat janë ngarkuar.

Edhe në ajetin 80 të sures "El Kasas", lexojmë se, kur Karuni, nga mendjemadhësia ndjeu se ishte i kënaqur me veten e tij dhe mëtoi se pasurinë e madhe e kishte arritur në saje të diturisë së tij dhe, kur arriti në këtë shkallë të mendjemadhësisë, vendosi të ekspozojë pasuritë e tij të shumta para njerëzve. Adhuruesit e kësaj bote u gëzuan nga pasuritë e shumta e marramendëse që panë, shprehën ambicien e tyre, sikur edhe ata, brenda mundësive të kësaj bote, të kishin një pasuri si ajo e

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", fundi i ajeteve objekt studimi.

Karunit. Por dijetarët e Beni Israilëve u thanë atyre: "Të mjerët ju! A nuk e dini se shpërblimi i All'llahut, jo vetëm që është shumë më i mirë, por është edhe i qëndrueshëm për atë që beson dhe bën punë të mira? Shpërblimin e All'llahut e arrijnë vetëm të duruarit, të cilët ecin në Rrugën e Drejtë. Ajeti njofton: **"Atyre që u ishte dhënë dituria thanë: të mjerët ju, shpërblimi i All'llahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri punë të mira, por këtë** (shpërblim) **nuk e arrin askush përveç durimtarëve."**.

Në fundin e ajetit, All'llahu i Lartësuar, si argument të shkurtër, por kuptimplotë, për ato që u thanë më sipër, njofton: **"All'llahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës."**.

Madhështia dhe fuqia e pamat e All'llahut, për dijetarët është burimi për frikën ndaj All'llahut, por edhe falja e mëkateve që bën All'llahu, te dijetarët është shkak për shpresë. Këta dy emra të shenjtë, i mbajnë robtë e All'llahut mes frikës e shpresës. Nga ana tjetër, ne dimë se lëvizja drejt plotësimit nuk mund të vazhdojë pa maturinë e pa punën me përkushtim ndërmjet këtyre dy cilësive, në mënyrën më të mjaftueshme.

Ajetet 29 – 30

﴿إِنَّ الَّذِينَ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنْفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً يَرْجُونَ تِجَارَةً لَنْ تَبُورَ٢٩ لِيُوَفِّيَهُمْ أُجُورَهُمْ وَيَزِيدَهُمْ مِنْ فَضْلِهِ إِنَّهُ غَفُورٌ شَكُورٌ٣٠﴾

"Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e All'llahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë."

"All'llahu do t'ua plotësojë atyre shpërblimin dhe do t'ua shtojë nga dhuntitë e Tij. Me të vërtetë, Ai është Falës dhe Falënderues."

Komentimi

Tregtia është fitimprurëse, vetëm me All'llahun

Siç e pamë, në ajetet më lart, flitej për shkallën e "frikës" ndaj All'llahut te dijetarët, kurse në ajetet objekt studimi, flitet për shkallën e "shpresës" te dijetarët, në atë mënyrë që njeriu, në saje të këtyre dy "krahëve", frikës ndaj All'llahut dhe duke shpresuar prej Tij, ka mundësi të fluturojë për në qiellin e lumturisë dhe të

ecë në rrugën e plotësimit të tij, ashtu siç e lexojmë në Fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e All'llahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë."**.

Është e qartë se fjala e ajetit **"**يَتْلُونَ**" -** *"jetlùne" - "lexojnë"*, këtu nuk do të thotë lexim sipërfaqësor, pa menduar mbi atë që lexohet. Në të kundërt, leximi patjetër duhet të jetë shkak e motiv për të menduar dhe të menduarit nga ana e tij, është motiv për punën e mirë, e cila e lidh njeriun me All'llahun e Lartësuar. Puna e mirë e njeriut, në radhë të parë, shpaloset me faljen e namazit, kurse nga ana tjetër, është po puna e mirë që e lidh njeriun me krijesat e All'llahut dhe kjo lidhje shpaloset në shpenzimin nga ana e njeriut për hir të All'llahut, prej asaj që atij i tepron nga mirësitë që i ka dhënë All'llahu i Lartësuar. Kuptohet që fjala "shpenzim", përfshin çdo gjë që njeriu bën në rrugën e All'llahut dhe për hir të All'llahut, përfshin shpenzimin prej pasurisë së tij e punës së tij. Gjithashtu, fjala "shpenzim" përfshin ndikimin që ai ka te të tjerët, mendimin e tij krijues, moralin e tij, përvojën dhe gjithçka tjetër që atij i ka dhuruar All'llah i Lartësuar.

Ky shpenzim, herë është i fshehtë dhe tregon sinqeritet të plotë, herë është i hapur dhe tregon respekt ndaj dispozitave të All'llahut. Veç kësaj, shpenzimi i hapur është motiv nxitës, që edhe të tjerët të ndjekin rrugën e shpenzimit për hir të All'llahut.

Duke parë ato që thuhen në këtë ajet dhe në ajetet më lart, arrijmë në përfundimin se, me të vërtetë, dijetarët kanë cilësitë vijuese:

* Zemra e tyre është e mbushur me frikë ndaj All'llahut dhe kjo frikë te dijetarët shprehet me madhërimin e All'llahut të Lartësuar.

* Gjuha e tyre ka shumë dëshirë të përmendë All'llahun dhe të lexojë ajetet e Librit të Tij.

* Ata falin namaz dhe adhurojnë All'llahun.

* Shpenzojnë në fshehtësi dhe sheshit nga pasuria që kanë.

* Së fundi, nga ana e qëllimeve, horizonti i mendimit të tyre është i lartë, deri në atë shkallë, sa ata e kanë nxjerrë prej zemrës së tyre lidhjen me këtë botë lëndore të zhdukshme dhe përsiatin me përvojat e tyre, duke shpresuar fitimin, vetëm duke qenë pranë All'llahut të Lartësuar, sepse dora që shtrihet për t'i kërkuar All'llahut, asnjëherë nuk del shpresëhumbur.

Këtu meriton të mbahet shënim, se fjala e ajetit **"تَبُورَ" -** "*tebùre*", është në kuptimin e tejkalimit e të grumbullimit, por, meqenëse grumbullimi i tepërt çon në prishje, fjala ka ardhur në formën që tregon se kjo "tregti", kurrë nuk del me humbje dhe nuk njeh as prishje e as bllokim të mallit.

Në një hadith shumë të njohur, të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë se dikush i tha: "O i Dërguari i All'llahut, si është puna me mua, që nuk e dua vdekjen?".

Ai e pyeti: "*A ke pasuri?*".

Po, - i tha pyetësi.

Atëherë i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: *"Jepe atë."*.

Pyetësi tha: "Nuk mundem.".

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: *"Zemra e njeriut është së bashku me pasurinë e tij. Nëse ai e jep pasurinë, ka dëshirë të takohet me All'llahun dhe, nëse e vonon dhënien, ka dëshirë të qëndrojë sa më shumë me pasurinë."*.[1]

Hadithi, në të vërtetë pasqyron frymën e ajetit, i cili thotë se ata që falin namazin dhe shpenzojnë në Rrugën e All'llahut, ata shpresojnë dhe kanë lidhje me Botën Tjetër, sepse ata i çuan punët e mira në Botën Tjetër para se të shkojnë vetë atje dhe me këtë, ata kanë prirjen të bashkohen sa më shpejt me Botën e Ardhshme.

Ajeti 30, shpjegon qartë qëllimin e këtyre besimtarëve të sinqertë dhe thotë se ata janë njerëz që bëjnë punë të mira: **"All'llah do t'ua plotësojë atyre shpërblimin dhe do t'ua shtojë nga dhuntitë e Tij. Me të vërtetë, Ai është Falës dhe Falënderues."**.[2]

Në të vërtetë, kjo fjali tregon se sinqeriteti dhe përkushtimi te ata është në shkallën më të lartë dhe ata nuk presin asgjë tjetër përveç shpërblimit hyjnor. Me punët e mira ata, asnjëherë s'kanë qëllim hipokrizinë, që të duken se bëjnë punë të mirë, apo të lavdërohen prej këtij e prej atij tjetrit, gjithmonë te ata, çështja më

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 407, fundi i ajetit objekt studimi.

[2] Fraza e ajetit **"لِيُوَفِّيَهُمْ" -** *"li juvef'fijehum" - "që t'i japë të plotë"*, kur ka lidhje me fjalinë e ajetit të parë: **"Ata që lexojnë librin e All'llahut."**, kuptimi është: "Qëllimi i atyre me leximin, namazin dhe shpenzimin, është arritja e shpërblimit hyjnor". Por, kur frazën e mësipërme e lidhim me fjalën e ajetit të parë: *"len tebùre"*, kuptimi është: "Tregtia e tyre, asnjëherë nuk do të preket nga prishja, sepse shpërblyesi për ata është All'llahu i Lartësuar.".

e rëndësishme në punët e tyre të mira, ka qenë vetëm "nijeti i mirë".

Fjala e ajetit **"**أُجُور**" -** "*uxhùr*", në të vërtetë është dashamirësi nga ana e All'llahut dhe është sikur robtë e kërkojnë shpërblimin prej All'llahut kundrejt punëve të tyre, në një kohë që njerëzit, çdo gjë e kanë vetëm prej All'llahut të Lartësuar. Veç kësaj, atyre edhe fuqinë për të bërë punë të mira, ua ka dhënë All'llahu.

Edhe më e bukur se kjo shprehje, është Fjala e All'llahut të Lartësuar: **"...do t'ua shtojë nga dhuntitë e Tij."**. All'llahu i përgëzon ata se, përveç shpërblimit të zakonshëm për punët e mira, që në fakt është shumëfish më shumë se puna e bërë, përveç këtij shpërblimi, All'llahu i Lartësuar do t'u shtojë atyre prej mirësive e prej begative të Tij, do t'u shtojë atyre aq shumë, sa atyre nuk u shkon ndërmend dhe do t'u shtojë aq shumë, sa askush në këtë botë s'ka mundësi ta përfytyrojë.

Në një hadith të të Dërguarit të *All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të përcjellë prej Ibn Mesudit, në lidhje me Fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"...do t'ua shtojë nga dhuntitë e Tij."**, lexojmë: "Shtimi është ndërmjetësimi për atë njeri që do të futet në zjarr dhe që në këtë botë ka bërë punë të mira.".[1]

Kjo do të thotë se ata, jo vetëm që janë prej të shpëtuarve, por, me bujarinë e me dashamirësinë e All'llahut, janë shkak edhe për shpëtimin e të tjerëve.

Disa interpretues të Kur'anit, kanë thënë se fraza e ajetit: **"...do t'ua shtojë nga dhuntitë e Tij."**, tregon pozitën e

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 407, fundi i ajetit objekt studimi.

"dëshmuesit" që do të jetë në Ditën e Kiametit për besimtarët, të cilëve All'llahu do t'u mundësojë të shikojnë bukurinë e madhështisë së Tij dhe ata do ta shijojnë atë bukuri me kënaqësinë më të madhe. Duket qartë se, kjo frazë e ajetit, ka një kuptim shumë të gjerë dhe, përveç përmbajtjes së haditihit të mësipërm, përfshin edhe dhënien e dhuratave të tjera, të panjohura për ne.

Sifjalia e fundit e ajetit: **"Ai është Falës dhe Falënderues."**, tregon se e para butësi e dashamirësi e All'llahut ndaj atyre, është "falja" e mëkateve dhe shkarjeve që ata kanë bërë në disa raste, sepse shqetësimi më i madh për besimtarin është falja e mëkateve.

Pas qetësimit të tyre nga kjo brengosje, All'llahu i Lartësuar i përfshin ata me "falënderimin", domethënë i falënderon ata për punët e mira dhe u jep atyre shpërblimin më të madh e më të mirë.

Në tefsirin "Mexhmeul Bejàn", citohet proverbi arab "Falënderoj Atë me reuka". Arabët mendonin se "reuka" është një pemë pa gjethe dhe sipër saj qëndron qielli i vrenjtur, por ajo pemë nxjerr gjethet pa rënë shi.[1] Në të vërtetë, ky proverb shpreh falënderimin në shkallën më të lartë dhe do të thotë se All'llahu, edhe për punën më të vogël, jep shpërblimin më të madh. Patjetër që Krijuesi i një peme të këtillë, është shumë falënderues dhe shumë mëshirues.

[1] Burimi i mësipërm.

Hulumtim

Kushtet e kësaj tregtie të çuditshme

Të tërheq vëmendjen fakti se, shumë ajete të Kur'anit Famëlartë, e krahasojnë këtë botë me një shitore, tregtarët e të cilës janë njerëzit dhe blerës është All'llahu i Lartësuar; mallrat e kësaj shitoreje janë punët e mira të njerëzve, kurse çmimi që merret për mallrat e shitura, ose shpërblimi, është Xhenneti, mëshira dhe arritja e kënaqësisë së All'llahut të Lartësuar.[1]

Sikur të mendojmë seriozisht mbi këtë fakt, shumë shpejt do të shikojmë se kjo tregti e çuditshme me All'llahun e Lartësuar, nuk ka një të dytë, sepse "tregtia" me All'llahun ka veçori të atilla, që nuk i ka asnjë lloj tregtie tjetër:

1- All'llahu i Lartësuar i ka dhënë shitësit (njeriut) kapitalin e plotë dhe pastaj Ai është blerës te ky shitës.

2- All'llahu i Lartësuar është blerës, në një kohë që Ai, në mënyrë absolute, s'ka nevojë për asnjë send, pasi magazinat e të gjitha sendeve janë vetëm tek Ai.

3- All'llahu i Lartësuar e ble "mallin e pakët" me një çmim shumë të lartë, "jep siguri për pak gjë dhe fal për shumë gjëra",[2] "siguron dhe jep shumë për pak".

[1] Në suret: "Es Saf", ajeti 1; "Et Teube", ajeti 111; "El Bekare", ajeti 207; "En Nisà", ajeti 74.
[2] "Bihàrul Enuàr", vëll. 68, f. 75.

4- All'llahu i Lartësuar ble deri edhe mallin më të vogël, ashtu siç thuhet në ajetin 7 të sures "Ez Zelzeleh": **"Kush punon një të mirë që peshon sa një grimcë, atë do të gjejë."**.

5- Në disa raste, All'llahu jep një çmim që është i barabartë me shtatëqindfishin e mallit, ose edhe më shumë. (Sure "El Bekare", ajeti 261.)

6- Përveç që paguan me çmim shumë të madh, All'llahu i Lartësuar, me mirësinë e me mëshirën e Tij, u shton atyre edhe më shumë: **"...do t'ua shtojë nga dhuntitë e Tij."**. (ajeti objekt studimi)

Me të vërtetë, është fatkeqësi, kur njeriu i mençur e i lirë i mbyll sytë para një tregtie si kjo dhe kërkon një tregti tjetër, por edhe më zi se kjo është kur e shet mallin e tij për asgjë.

Prijësi i besimtarëve, Imam Ali bin Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: "*Vini re, një burrë i lirë e le këtë dhe dërdëllit për ata që e ushtrojnë atë, por dijeni se për ju s'ka çmim tjetër përveç Xhennetit, prandaj mos e shisni Xhennetin me asgjë tjetër veçse me Xhennet.*".[1]

[1] "Nehxhul Belàga", "Falët e shkurtra", Fjalia 456.

Ajetet 31 – 32

﴿وَالَّذِى أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ هُوَ الْحَقُّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ إِنَّ اللَّهَ بِعِبَادِهِ لَخَبِيرٌ بَصِيرٌ٣١ ثُمَّ أَوْرَثْنَا الْكِتَابَ الَّذِينَ اصْطَفَيْنَا مِنْ عِبَادِنَا فَمِنْهُمْ ظَالِمٌ لِنَفْسِهِ وَمِنْهُمْ مُقْتَصِدٌ وَمِنْهُمْ سَابِقٌ بِالْخَيْرَاتِ بِإِذْنِ اللَّهِ ذَلِكَ هُوَ الْفَضْلُ الْكَبِيرُ٣٢﴾

"Ajo që ta kemi shpallur ty në Libër, është e vërteta e cila konfirmon atë që është shpallur para tij. Sigurisht që All'llahu i njeh dhe i sheh mirë robtë e Vet."

"Pastaj, Ne ua dhamë Librin robëve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhammedit */Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)**. Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes** (duke bërë vepra të ndaluara)**, disa janë në rrugë të mesme** (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat)**, ndërsa disa, me lejen e All'llahut, shkojnë përpara me të mira** (përtej detyrimeve)**; kjo është dhuntia e madhe."**

Komentimi

Trashëgimtarët e vërtetë të trashëgimisë së Profetëve

Në ajetet më lart, u fol për besimtarët e sinqertë, të cilët lexojnë Librin hyjnor dhe atë që e lexojnë, e vënë në zbatim. Kurse në ajetet objekt studimi, flitet për atë Libër hyjnor dhe për argumentet e të vërtetave të tij, si dhe për mbajtësit e vërtetë të këtij Libri. Në ajetet objekt studimi, plotësohet biseda që u hap në ajetet më lart rreth Njëtimit të All'llahut (Teuhidit). Në këto ajete, biseda vazhdon rreth profetësisë. Ajeti i nderuar njofton: **"Ajo që ta kemi shpallur ty në Libër, është e vërteta e cila konfirmon atë që është shpallur para tij."**.

Duke marrë në konsideratë se fjala e ajetit *"el hak'ku"*, do të thotë: çdo send që përputhet dhe është në harmoni me realitetin, nga ky kuptim, kjo shprehje është argument që vërteton se ky Libër qiellor është i zbritur prej All'llahut të Lartësuar dhe me sa më shumë kujdes të shikojmë në këtë Libër qiellor, me kujdesin që meriton ky Libër famëlartë, aq më shumë do të gjejmë se ky Libër madhështor është në harmoni të plotë me realitetin.

Do të gjejmë se në këtë libër s'ka kundërthënie, rrena ose mite; do të gjejmë se parimet e këtij Libri dhe dituritë që ai përmban janë në harmoni të plotë me logjikën. Gjithashtu, do të gjejmë se edhe tregimet e historitë që përmenden në këtë Libër, nuk janë as legjenda e as mite. Mbi të gjitha, do të gjejmë se ligjet e këtij Libri shkojnë krah për krah me nevojat e njerëzve dhe kjo e vërtetë, nga ana e saj, është një argument që vërteton se ky Libër është "zbritur" prej All'llahut të Lartësuar.

Për ta bërë më të qartë pozitën e Kur'anit Famëlartë, në këtë ajet, Kur'ani është cilësuar me fjalën **"اَلْحَقُّ" -** *"el hak'ku" - "e vërteta"*, kurse në ajete të tjera, cilësimi i Kur'anit ka ardhur me fjalët: **"اَلنُّورُ" -** *"en'nru" – "dritë"*; **"أَلْبُرْهَانُ" -** *"el burhànu"* - "argument"; **"أَلْفُرْقَانُ" -***"el furkanu" - "ndarës"* (i të vërtetës nga e gabuara); **"أَلذِّكْرُ" -** *"edh'dhikru" - "kujtesë"*; **"أَلْمَوْعِظَةُ" -** *"el meuidhatu" - "këshillë;* **"أَلْهُدى" -** *"el hudà" - "udhëzues"*.

Secila prej tyre, shpreh njërën prej mirësive të Kur'anit dhe përmasat e tij, kurse fjala **"اَلْحَقُّ" -** *"el hak'ku"*, përfshin të gjitha mirësitë e lartpërmendura të Kur'anit.

Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", thotë se, në origjinë, fjala **"اَلْحَقُّ" -** *"el hak'ku"*, do të thotë: përshtatje dhe ngjashmëri. Veç kësaj, fjala *"el hak'ku"* thuhet për disa anë:

E para: Thuhet për atë që e bën sendin të jetë në bazë të urtësisë, prandaj për All'llahun e Lartësuar thuhet **"هُوَ الْحَقُّ" -** *"huvel-hak'ku" - "Ai është i Vërteti"*, ashtu siç e lexojmë në ajet: **"Ky është All'llahu, Zoti juaj, i Vërteti."**.[1]

E dyta: Thuhet për atë që e bën sendin të jetë sipas domosdoshmërisë së urtësisë, prandaj për të gjithë punën e All'llahut të Lartësuar, thuhet *"hakkun" - "e vërtetë"*, ashtu siç e lexojmë në ajet: **"All'llahu nuk e krijoi këtë veçse me të vërtetën."**.[2]

[1] Sure "Jùnus", ajeti 32.
[2] Sure "Jùnus", ajeti 5.

E treta: Thuhet për besimet që përputhen me realitetin, ashtu siç e lexojmë në Fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"All'llahu i udhëzoi me të vërtetën ata që kishin besuar për çështjet që kishin kundërshtime."**.[1]

E katërta: Thuhet për fjalët që thuhen ashtu siç duhen thënë dhe për punët që bëhen ashtu siç duhen bërë, aq sa është detyrë të thuhen e të bëhen në kohën e caktuar, siç është, për shembull, fjala që themi: "Puna jote është e vërtetë dhe fjala jote është e vërtetë.".[2]

Bazuar mbi këto që u thanë, në lidhje me vërtetësinë e Kur'anit Famëlartë, del qartë se, nga njëra anë, Kur'ani, si fjalë, është në përshtatje me interesat e me realitetet e njeriut, nga ana tjetër, besimet dhe dituritë që gjenden në Kur'an, janë në harmoni me realitetin. Nga një anë e tretë, Kur'ani është prej "endjes" e prej punës së All'llahut, i Cili e bëri këtë libër në bazë të së vërtetës, sepse vetë All'llahu është "i Vërteti" dhe të gjitha këto cilësi duken shumë qartë në këtë Libër madhor, prandaj këtë Libër të qartë e vërteton mendja e njeriut, i cili beson me vetëdije se vetëm All'llahu është i Vërteti.

Fraza e ajetit **"...që është shpallur para tij."**, është një argument tjetër për vërtetësinë e këtij Libri qiellor, sepse argumentet e këtij Libri përputhen me argumentet që janë

[1] Sure "El Bekare", ajeti 213.

[2] "Mufredàtu El Fàdhil Kur'àn", Lënda **"حَقٌّ"** - *"hak'kun"* - *"e vërteta"*, me disa shkurtime dhe e përmbledhur.

përmendur në librat e mëparshëm qiellorë, në të cilat tregohen shenjat e mbartësit të këtij Libri.[1]

Fjalia e fundit e ajetit 31: **"Sigurisht që All'llahu i njeh dhe i sheh mirë robtë e Vet."**, e bën të qartë vërtetësinë e Kur'anit dhe përshtatjen e tij me realitetin, si dhe me nevojat e Njerëzimit, sepse Kur'ani është Libër i zbritur prej All'llahut të Lartësuar, i Cili ka dijeni të plotë për robtë e Tij dhe, ashtu siç thotë ajeti, All'llahu është "Shikuesi" dhe i "Gjithinformuari" për gjërat që kanë lidhje me nevojat e robëve të Tij.

Por, cili është dallimi mes dy cilësive të larta të All'llahut: **"خَبِيْرٌ" -** *"khabijrun" - "i Gjithinformuari"* dhe **"بَصِيْرٌ" -** *"besijrun" - "Shikuesi"*?

Disa kanë thënë se emri i bukur i All'llahut **"خَبِيْرٌ" -** *"khabijrun" - "i Gjithinformuari"*, do të thotë: Ka dijeni për gjërat e brendshme: besimet, nijetet dhe përmasën shpirtërore të njeriut. Emri tjetër i bukur i All'llahut **"بَصِيْرٌ" -** *"besijrun" - "Shikuesi"*, është në kuptimin e diturisë së All'llahut për dukuritë e jashtme dhe përmasën fizike të njeriut.[2]

Të tjerë kanë thënë se fjala e ajetit **"خَبِيْرٌ" -** *"khabijrun"*, është në kuptimin që tregon zanafillën e krijimit të njeriut, kurse fjala **"بَصِيْرٌ" -** *"besijrun"*, është në kuptimin: All'llahu shikon punët e veprimet e njeriut.[3]

---

[1] Referohu në këtë tefsir në fundin e ajetit 41 të sures "El Bekare".
[2] "Et Tefsijrul Kebijr", fundi i ajetit objekt studimi.
[3] Tefsiri "Rùhul Meànij", fundi i ajetit objekt studimi.

Natyrisht që interpretimi i parë duket se është më në përshtatje me kuptimin e këtyre emrave të bukur të All'llahut, megjithëkëtë të dy kuptimet nuk mund të përjashtohen.

Ajeti vijues flet për problemin shumë të rëndësishëm që ka të bëjë me mbartësit e këtij Libri të madh qiellor, domethënë me ata që e ngritën lart "pishtarin" e Kur'anit Famëlartë, pasi ai i zbriti të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjatë kohës që ai ishte në këtë jetë dhe pas tij, gjatë rrjedhës së shekujve. Mbartësit e këtij Libri Famëlartë janë ata që e dinë përmendësh atë, janë ata që e ruajnë në mendjet e tyre. Për këta, ajeti i nderuar thotë: **"Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur** (nga ndjekësit e Muhammedit / *Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)**."**.

Është e qartë se këtu, fjala **"**ٱلْكِتَابَ**" -** *"el kitàbe" - "librin"*, tregon të njëjtin libër që u përmend në ajetin e parë, domethënë është Kur'ani Famëlartë. Nyja shquese **"**ٱلْ**"** - *"el"* para fjalës **"**كِتَاب**" -** *"kitàb"*, është në kuptimin "lënie në mirëbesim". Ajo që thuhet se qëllimi me fjalën *"librin"* tregon librat qiellorë dhe nyja shquese *"el"* e fjalës *"el kitàb"* është për të treguar llojin, duket një interpretim shumë i largët për të qenë i mundshëm. Veç kësaj, ky interpretim nuk është në përshtatje me atë që ka ardhur në ajetet më lart të kësaj sureje e në sure të tjera.

Fjala e ajetit **"**أَوْرَثْنَا**" -** *"eurethnà" - "ua lamë trashëgimi"*, ka ardhur edhe në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë. Rrënja e kësaj fjale **"**ٱلإِرْثُ**" -** *"el irthu" - "trashëgimi"*, thuhet për një send që arrihet pa lodhje e pa punë dhe All'llahu i Lartësuar e zbriti këtë Libër të

madh qiellor për myslimanët, pa bërë ata asnjë punë e pa u lodhur.

Për togfjalëshin **"robëve Tanë të zgjedhur"**, kanë ardhur transmetime të shumta me rrugët e Ehli Bejtit, që thonë se të "zgjedhurit" janë Imamët e ruajtur prej mëkateve.[1] Këto transmetime, siç kemi përsëritur shpeshherë, në radhë të parë, janë një kriter ku mund të vërtetohet fjala "i zgjedhur", por s'ka asnjë ndalim e asnjë pengim që fjala "i zgjedhur" të përfshijë dijetarët, mendimtarët, punëmirët dhe dëshmorët e ymetit islam, të cilët, jo vetëm që punuan shumë dhe u lodhën në rrugën e ruajtjes të këtij Libri të madh qiellor, por edhe vazhduan të zbatojnë urdhrat e ndalesat e tij, sipas udhëzimit të ajetit: **"robërve Tanë të zgjedhur"**.

Më pas, ajeti kalon në një diferencim shumë të rëndësishëm të njerëzve: **"Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes** (duke bërë vepra të ndaluara)**, disa janë në rrugë të mesme** (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat)**, ndërsa disa, me lejen e All'llahut, shkojnë përpara me të mira** (përtej detyrimeve)**; kjo është dhuntia e madhe."**.

Prej fjalëve të këtij ajeti, kuptohet qartë se tri grupet e përmendura në këtë ajet, janë në mesin e atyre për të cilët njofton All'llahu i Lartësuar në Fjalën e Tij: **"robëve Tanë të zgjedhur"**, domethënë trashëgimtarët dhe mbajtësit e Librit qiellor.

Është e qartë se All'llahu i Lartësuar, detyrën e rëndësishme të ruajtjes së këtij Libri qiellor, pas të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

[1] Referohu në tefsirin "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 361.

tij!) e ka bërë detyrim për ymetin islam, që e ka zgjedhur vetë All'llahu i Gjithëfuqishëm. Por në këtë ymet ka grupe të ndryshme, disa kanë lënë mangët detyrën e tyre madhore të mësimit përmendësh të Kur'anit dhe nuk punojnë sipas dispozitave të Kur'anit, por me këtë lënie mangët të këtij detyrimi, në të vërtetë, ata i kanë bërë padrejtësi vetes, ashtu siç njofton ajeti: **"**ظَالِمٌ لِّنَفْسِهِ**" - " i bëjnë dëm vetes"**.

Një grup tjetër, e ka kryer detyrën e ngarkuar për të mësuar përmendësh Kur'anin dhe për të punuar me dispozitat e tij, deri në shkallën më të lartë. Megjithëkëtë, puna e tyre nuk ka shpëtuar prej disa shkarjeve, madje ka edhe lënie mangët. Pikërisht në këtë grup vërtetohet fjala e ajetit **"**مُّقْتَصِدٌ**" -** *"muktesidun" - "mesatar"*.

Në fund, vjen grupi i të shquarve, të cilët e kanë plotësuar detyrën e tyre madhore në mënyrën më të mirë dhe i kanë kaluar të gjithë në fushën e garimit. Janë ata për të cilët njofton ajeti në frazën e tij: **"...ndërsa disa, me lejen e All'llahut, shkojnë përpara me të mira** (përtej detyrimeve)**."**.

Pyetje: Këtu mund të thuhet se ekzistenca e "grupit" që i bën padrejtësi vetes, bie në kundërshtim me fjalën e ajetit që njofton se të gjithë janë të përfshirë në fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"robëve Tanë të zgjedhur"**.

Përgjigje: Në përgjigje themi se kjo është e ngjashme me atë që ka ardhur për Beni Israilët, në ajetin 53 të sures "Gàfir": **"Ne i Dhamë Musait udhëzimin dhe Beni Israilëve u lamë trashëgim librin."**. Por ne dimë se të gjithë Beni Israilët nuk e kryen detyrën e tyre ndaj atij trashëgimi të madh.

Ose është i ngjashëm me atë që ka ardhur në ajetin 110 të sures "Àli Imràn": **"Ju jeni populli më i mirë për njerëzit."**.

Ose është i ngjashëm me atë që ka ardhur në ajetin 16 të sures "El Xhàthijeh" në lidhje me Beni Israilët: **"dhe i shquam ata nga njerëzit e tjerë"**.

Gjithashtu, është i ngjashëm edhe me atë që ka ardhur në ajetin 26 të sures "El Hadijd": **"Ne u dërguam** (Profetë) **Nùhun e Ibrahimin dhe pasardhësve të tyre u dhamë profetninë dhe librin; disa prej atyre u udhëzuan në Rrugën e Drejtë, por shumica e tyre u larguan nga Rruga e Drejtë."**.

Thelbi i fjalës në shembujt e këtyre ajeteve nuk është për të gjithë popullin, individ për individ, por për një grup prej atij populli, qofshin ata individë në brendi të shtresave të shoqërisë, apo në brendi të grupeve të ndryshme.[1]

Pyetje: Këtu mund të shtrohet pyetja: Përse biseda në këtë ajet fillon duke përmendur më parë ata që i bëjnë padrejtësi vetes, pastaj përmendet grupi i mesatarëve dhe në fund përmendet

[1] Disa janë shprehur se ndarja që ka ardhur në këtë ajet, në togfjalëshin **"robtë Tanë"** dhe ata të ndarët, nuk hyjnë në frazën e ajetit **"robëve Tanë të zgjedhur",** në kuptimin që të tri grupet nuk hyjnë te "trashëgimtarët e Librit", por hyjnë në kuptimin e frazës **"robtë Tanë"**. Kurse ata që përfshihen në togfjalëshin **"robëve Tanë të zgjedhur",** është vetëm grupi i tretë, është grupi i atyre që nxitojnë të bëjnë punë të mira. Në të vërtetë, ky interpretim duket shumë i largët për të qenë në harmoni me fjalët e ajetit, sepse të tri grupet janë prej atyre që i përmend ajeti. Ne dimë edhe nga hadithi, se jo të gjithë njerëzit hyjnë në kuptimin e togfjalëshit të ajetit: **"robëve Tanë të zgjedhur".** Përveç kësaj, duhet të shtojmë se përemri pronor në numrin shumës **"ﻧَﺎ"** - *"nà"* - *"tanë"*, në fjalën **"عِبَادِنَا" -** *"ibàdinà"* - **"robtë Tanë"**, shpreh lavdërim për All'llahun e Lartësuar, çka e bën ajetin jo në harmoni me interpretimin e mëtuar.

grupi i atyre që nxitojnë të bëjnë punë të mira, në një kohë që e kundërta e renditjes ka përparësi nga disa drejtime?

Përgjigje: Disa interpretues të mëdhenj të Kur'anit, në përgjigje të kësaj pyetjeje, kanë thënë: Qëllimi me këtë renditje është që pozitat e njerëzve të jenë sa më të qarta në serinë e plotësimit, sepse etapa e parë është mëkatimi e shkujdesja, pastaj vjen pozita e pendimit (teubes) dhe e kthimit. Në fund vjen orientimi e afrimi prej All'llahut të Lartësuar, në një kohë që mëkati e kundërshtimi vjen prej njeriut dhe me këtë, njeriu *"dhàlimun li nefsihi"* - *"i bën padrejtësi vetes"*, kurse ai që është në pozitën e pendimit (teubeh), domethënë "mesatari", i cili, pasi është penduar dhe, kur pendimi i tij pranohet, e shton punën e tij në rrugën e të vërtetës dhe kalon prej pozitës së afrimit për t'u ngjitur, në pozitën e atyre që "nxitojnë të bëjnë punë të mira".[1]

Të tjerë kanë thënë se kjo mënyrë renditjeje e tri grupeve të përmendura në këtë ajet, ka ardhur për shkak se ata janë më shumë ose më pak si numër dhe si mundësi. Të "padrejtët" janë shumica, "mesatarët" janë në gradën e dytë, kurse "ata që nxitojnë të bëjnë punë të mira", janë të përzgjedhurit dhe eulijatë, të cilët janë pakicë, edhe pse janë më të mirët e njerëzve, nga ana e cilësisë.[2]

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, në lidhje me interpretimin e këtij ajeti, lexojmë: *"Janë përmendur të parët njerëzit që i bëjnë padrejtësi vetes, me qëllim që ata të*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", komenti i ajetit objekt studimi.
[2] Tefsijri "Fi Dhilalil Kur'ani", fundi i ajetit objekt studimi.

mos e presin shpresën prej mëshirës së All'llahut, kurse punëmirët janë vënë në fund, që të mos u rritet mendja me punët e mira që bëjnë.".[1]

Gjithashtu, ka mundësi që çdonjëri prej këtyre tri kuptimeve, të jetë qëllim në këtë ajet.

Në lidhje me interpretimin e frazës për mirësinë e madhe që do të kenë trashëgimtarët e Librit, që ka ardhur në fundin ajetit me frazën: **"...kjo është dhuntia e madhe."**, disa kanë thënë se "mirësia më e madhe" është trashëgimia e Librit hyjnor. Të tjerë kanë thënë se kjo frazë tregon njerëzit që, me lejen e All'llahut, nxitojnë të bëjnë punë të mira dhe të ecin në këtë rrugë. Gjithsesi, duket se kuptimi i parë është më shumë në përshtatje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.

Hulumtim

Cilët janë ruajtësit e Librit Hyjnor?

Në Kur'anin Famëlartë thuhet se ymetin islam, All'llahu i Lartësuar e ka përfshirë në mirësi të shumta dhe mirësia më e rëndësishme është Kur'ani Famëlartë.

Ymeti islam është përzgjedhur të jetë më lart se ymetet e tjera dhe këto mirësi të mëdha i janë dhënë vetëm ymetit islam. Por krahas kësaj mirësie, i është dhënë edhe një përgjegjësi shumë

[1] Tefsiri "Rruhul Xhinan", fundi i ajetit objekt studimi.

e rëndë, përgjegjësi që është në përpjesëtim të drejtë me mirësitë me të cilat është nderuar. Me këto mirësi të mëdha hyjnore, ymeti islam është përfshirë në butësinë e në dashamirësinë hyjnore dhe për këtë, ky ymet do të jetë në radhën e **"atyre që nxitojnë të bëjnë punë të mira"**, përderisa e plotëson detyrën për ruajtjen e Kur'anit, të kësaj trashëgimie hyjnore kaq të madhe dhe në saje të këtij kujdesi që tregon, ymeti islam është përpara të gjitha ymeteve në punë të mira, në zhvillimin e diturive, në frikën ndaj All'llahut, në jetën e përkorë, në adhurim, në shërbimin ndaj njerëzve, në luftë në Rrugën e All'llahut, në interpretimin e diturive, në organizimin e në administrimin e drejtë të punëve, në flijim, në parapëlqim dhe në sakrificë. Pjesëtarët e ymetit islam janë në pararojë të këtyre punëve dhe garojnë në fushën e bërjes së punëve të mira, ndryshe ata nuk do të jenë prej atyre që e kanë plotësuar detyrimin për ruajtjen e kësaj trashëgimie të madhe, në mënyrë të veçantë, kur dimë se fraza e ajetit **"atyre që nxitojnë të bëjnë punë të mira"**, ka një kuptim shumë të gjerë dhe përfshin bërjen e të gjitha llojeve të punëve që përfshihen në harkun e punëve të mira prej punëve të jetës.

Po, mbartësit e kësaj trashëgimie janë vetëm ata që i kanë cilësitë e lartpërmendura. Nëse ata do t'i kthejnë shpinën këtij udhëzimi hyjnor, kaq të ndritur, dhe nuk do të kujdesen ta ruajnë madhështinë e shenjtërinë e kësaj trashëgimie, shumë shpejt do të jenë kriter përmes të cilit vërtetohet fjala e ajetit **"i bëjnë padrejtësi vetes së tyre"**, sepse përmbajtja e këtij udhëzimi hyjnor është vetëm e vetëm shpëtimi, mbarësia dhe fitorja e tyre. Ai që hedh për tokë recetën e ilaçeve që ka shkruar mjeku për të, me këtë veprim, dëmton veten, duke ndihmuar vazhdimin e dhimbjes e dëmtimin e tij. Ai që e thyen llambën e vetme të

ndriçimit, patjetër që do të ecë në një rrugë të errët dhe pa dyshim që rruga e errët e çon atë vetëm në humbje e do të sillet vërdallë. Le ta dijë njeriu, se All'llahu nuk ka nevojë për asnjë send dhe nuk ka nevojë për ndihmën e askërrkujt.

Edhe fajtorët kanë detyrë të mos harrojnë të vërtetën e madhe, se edhe ata janë të përfshirë në përmbajtjen e këtij ajeti të nderuar, janë të përfshirë në grupin për të cilin ajeti thotë: **"robëve Tanë të zgjedhur"**. Të mos harrojnë, se edhe ata e kanë fuqinë që të jenë prej të "zgjedhurve", prandaj e kanë detyrim të kapërcejnë etapën e "padrejtësisë ndaj vetes" dhe të kalojnë në etapën e "mesatarit" dhe prej kësaj etape, të lartësohen e të arrijnë krenarinë e atyre që **"shkojnë përpara me të mira**", sepse edhe mëkatarët, nga vetë natyra e pastër e krijimit dhe nga ndërtimi shpirtëror, janë prej atyre që i ka "zgjedhur" i Vërteti.

Ajetet 33 – 35

﴿جَنَّاتُ عَدْنٍ يَدْخُلُونَهَا يُحَلَّوْنَ فِيهَا مِنْ أَسَاوِرَ مِنْ ذَهَبٍ وَلُؤْلُؤًا وَلِبَاسُهُمْ فِيهَا حَرِيرٌ٣٣ وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِى أَذْهَبَ عَنَّا الْحَزَنَ إِنَّ رَبَّنَا لَغَفُورٌ شَكُورٌ٣٤ الَّذِى أَحَلَّنَا دَارَ الْمُقَامَةِ مِنْ فَضْلِهِ لَا يَمَسُّنَا فِيهَا نَصَبٌ وَلَا يَمَسُّنَا فِيهَا لُغُوبٌ٣٥﴾

“Ata do të hyjnë në kopshtet e Adnit të stolisur me bylyzykë ari e margaritarë dhe veshja e tyre do të jetë prej mëndafshi.”

“Pastaj do të thonë: ‘Lavdi All’llahut’, i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne. Vërtetë, Zoti ynë është Falës dhe Falënderues.”

“Është Ai që me mirësinë e Tij na ka pranuar në shtëpinë e banimit të përhershëm, në të cilën nuk do të lodhemi e nuk do të rraskapitemi.”

Komentimi

Falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm All'llahut, që e hoqi prej nesh brengosjen

Në të vërtetë, ky grup ajetesh është rezultati i asaj që u tha në ajetet më lart. All'llahu i Lartësuar njofton në këto ajete: **"Ata do të hyjnë në kopshtet e Adnit."**.[1]

Fjala e ajetit **"**جَنَّاتُ**" -** *"xhen'nàtu"* është shumësi i fjalës **"**جَنَّةٌ**" -** *"Xhennetun"*, që do të thotë: kopsht, si të gjithë kopshtet, me pemë të veshura me pemët e tokës.

Fjala tjetër e ajetit, **"**عَدْنٍ**" -** *"adnin"* do të thotë: qëndrueshmëri. Nga ky kuptim, togfjalëshi *"xhen'nàtu adnin"* - **"kopshtet e Adnit"**, është në kuptimin: "kopshtet e përjetshme dhe të qëndrueshme".

Në të gjitha gjendjet, ky togfjalësh tregon se mirësitë e mëdha të Xhennetit janë të përhershme dhe të qëndrueshme dhe nuk janë si mirësitë e kësaj bote, që janë të trazuara me shqetësimin, që rrjedh prej faktit se mirësitë e kësaj bote janë të

[1] Togfjalëshi i ajetit *"xhen'nàtu adnin"* - **"kopshtet e Adnit"** mund të jetë kallëzues për një kryefjalë të hequr. Në këtë rast, kuptimi i togfjalëshit është: "shpërblimi i tyre", ose: "ata do të kenë Xhennetet e Adnit". Siç shihet, ky togfjalësh është i ngjashëm me përmbajtjen e ajetit 31 të sures "El Kehf". Disa kanë thënë se togfjalëshi **"**جَنَّاتُ عَدْنٍ**" -** *"xhen'nàtu adnin"* - **"kopshtet e Adnit"**, është plotësor për togfjalëshin e ajetit të mëparshëm **"mirësia e madhe"**. Por, duke marrë në konsideratë se togfjalëshi **"mirësia e madhe"**, e ajetit të mëparshëm, tregonte trashëgiminë e Librit qiellor, togfjalëshi **"kopshtet e Adnit"** nuk ka si të jetë plotësor për togfjalëshin **"mirësia e madhe"**, përveçse kur shkaktarin e konsiderojmë në pozitën e shkakut.

asgjesueshme dhe nuk janë të vazhdueshme. Përveç kësaj, banorët e Xhennetit nuk do të kenë vetëm një Xhennet, por do të kenë nën "administrimin" e tyre disa syresh.

Në vijim, ajeti e vë theksin mbi tri lloje prej mirësive të Xhennetit. Disa nga ato mirësi janë të karakterit material, disa të tjera janë të karakterit të brendshëm moral. Veç kësaj, theksohet se në mirësitë e Xhennetit nuk ka asnjë lloj të mete. Ajeti njofton: **"...të stolisur me bylyzykë ari e margaritarë dhe veshja e tyre do të jetë prej mëndafshi."**.

Banorët e Xhennetit nuk janë tërhequr prej gjërave të bukura të botës së Tokës, nuk e kanë bërë veten robër të gjërave të bukura të botës së Tokës dhe as nuk kanë qenë robër të mendimit, për të pasur veshje të bukura, prandaj All'llahu i Lartësuar i kompenson ata me të gjitha këto gjëra të bukura dhe në Botën e Ardhshme do t'i veshë ata me rrobat më të bukura e më cilësore.

Banorët e Xhennetit e kanë stolisur jetën e tyre në botën e Tokës me punë të mira, prandaj All'llahu, Ditën e Gjykimit, ditën kur punët do të "trupëzohen", do t'i stolisë ata me lloje të shumta stolish.

Shpesh kemi thënë se fjalët që përdoren për të shprehur sendet në botën e kufizuar të Tokës, nuk mjaftojnë për të shpjeguar qartë kuptimet e fjalëve të Botës së Ardhshme dhe gjendjet e njerëzve në Ditën e Gjykimit të madh, sepse, për të shpjeguar qartë mirësitë dhe gjendjen e njerëzve në Botën e Ardhshme, lind nevoja për të tjera shkronja, për një tjetër kulturë dhe për një fjalor tjetër. Gjithsesi, për të shpjeguar sa më qartë mirësitë e mëdha të Botës së Ardhshme, patjetër duhet të

kërkojmë ndihmën e fjalëve që kemi në përdorimin e përditshëm, edhe pse janë me mundësi të kufizuara shprehjesh.

Pas përmendjes së këtyre mirësive materiale, ajeti vijues e vë theksin mbi mirësinë e madhe morale dhe njofton: **"Pastaj do të thonë: 'Lavdi All'llahut', i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne."**.

Banorët e Xhennetit e falënderojnë All'llahun, kur shohin pjesën e mirësive të mëdha që është caktuar për ta, kur shohin se, në saje të dashamirësisë hyjnore, prej tyre janë larguar të gjithë faktorët që sjellin brengosje e hidhërim, kur shohin se prej qiellit të shpirtrave të tyre, janë larguar retë e errëta të shqetësimit. Për ata nuk ka më frikë prej dënimit hyjnor, nuk ka më frikë prej dhimbjes tmerruese të vdekjes e asgjësimit. Ata nuk do të kenë asnjë shqetësim dhe në këto Xhennete ata nuk i fyen dot asnjë lloj shpifje e mashtruesve dhe nuk i mundon as shtypja e tiranëve të egër grabitës.

Disa interpretues të Kur'anit, e kanë konsideruar këtë brengosje e frikë të ngjashme me frikën e brengosjen që e pllakos njeriun në botën e Tokës. Disa të tjerë e kanë konsideruar humbjen në Ditën e Gjykimit, në bazë të rezultatit të punëve të tyre. Gjithsesi, në mes këtyre dy interpretimeve, s'ka asnjë kundërthënie dhe të dy interpretimet mund të futen në kuptimin e përgjithshëm të ajetit.

Në lidhje me fjalën e ajetit **"أَلْحَزَنُ" -** *"el hazenu"* ose **"أَلْحُزْنُ" -** *"el huznu"*, gjuhëtarët janë shprehur se të dyja këto fjalë shprehin të njëjtin kuptim dhe në origjinë shprehin gjendjen e ashpër në Tokë. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret për të shprehur ashpërsinë

shpirtërore, për shkak të brengosjes që sjell gjendja e ashpër dhe është e kundërta e gëzimit.[1]

Pastaj, banorët e Xhennetit shtojnë: **"Zoti ynë është Falës dhe Falënderues."**.

Falja e All'llahut i shleu shkarjet e fajet tona. Me bamirësinë e Tij, All'llahu na dhuroi këto mirësi të përjetshme, mbi të cilat kurrë nuk bie hija e brengosjes se do të mbarohen; me faljen e Tij, All'llahu na mbuloi shumë prej fajeve tona; me bamirësinë e Tij na dha shpërblime të shumta kundrejt punëve tona të thjeshta dhe aq të pakta.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh, e vë theksin mbi mirësinë e fundit: Në Botën e Ardhshme mungojnë faktorët që sjellin shqetësim, vështirësi, lodhje e fyerje dhe me gjuhën e banorëve të Xhennetit, ajeti njofton: **"Është Ai që me mirësinë e Tij na ka pranuar në shtëpinë e banimit të përhershëm, në të cilën nuk do të lodhemi e nuk do të rraskapitemi."**.

"Shtëpia e ardhshme", ku do të qëndrojnë banorët e Xhennetit, nuk do të jetë si shtëpitë që ata kishin në botën e Tokës. Në botën e Tokës, njeriu, sapo ambientohet me mjedisin dhe lidhet me atë mjedis, nuk vonon t'i tingëllojë zilja për lënien e kësaj bote, kurse në Botën e Ardhshme, ku jeta është e lidhur me përjetësinë, njeriun nuk e prek asgjë nga ato që e mundonin dhe e shqetësonin në botën e Tokës. Në Botën e Ardhshme, njeriu nuk do të ketë as lodhje e as ndonjë lloj mundimi, sepse banorët e Xhennetit, në çdo çast, kanë përpara një mirësi të re dhe një bukuri të re.

---

[1] Fjalor i fjalëve të Kur'anit, i autorit Ràgib El Isfehànij "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn".

Disa gjuhëtarë dhe interpretues të Kur'anit, janë shprehur se fjala e ajetit **"**نَصَبٌ**" -** *"nesabun"*, është në kuptimin: lodhje; kurse fjala tjetër e ajetit **"**لُغُوبٌ**" -** *"lugùbun"*, është në kuptimin: lodhje e madhe, rraskapitje. Në të njëjtën kohë, disa të tjerë bëjnë dallim mes dy fjalëve dhe kanë thënë se fjala **"**نَصَبٌ**" -** *"nesabun"*, përdoret për të treguar gjendjen e rënduar trupore, kurse fjala **"**لُغُوبٌ**" -** *"lugùbun"*, përdoret për të treguar gjendjen e rënduar shpirtërore[1], ose për të treguar gjendjen e dobësisë së shkaktuar prej punës së rëndë, prej gjendjes së rëndë e prej dhimbjes. Me këtë shpjegim, fjala **"**لُغُوبٌ**" -** *"lugùbun"*, është e ardhur prej fjalës **"**نَصَبٌ**" -** *"nesabun"*, por të dyja fjalët shprehin kuptimin: lodhje e rënduar, rraskapitje[2].

Me këtë shpjegim, del qartë se, në Botën Tjetër, për ata nuk do të ketë më faktorë që sjellin lodhjen e rraskapitjen e tyre trupore e shpirtërore.

[1] Referohu në tefsirin, "Rùhul Meànij", vëll. 22, f. 184.
[2] Burimi i mësipërm.

Ajetet 36 – 38

﴿وَالَّذِينَ كَفَرُوا لَهُمْ نَارُ جَهَنَّمَ لَا يُقْضَى عَلَيْهِمْ فَيَمُوتُوا وَلَا يُخَفَّفُ عَنْهُمْ مِنْ عَذَابِهَا كَذَلِكَ نَجْزِى كُلَّ كَفُورٍ٣٦ وَهُمْ يَصْطَرِخُونَ فِيهَا رَبَّنَا أَخْرِجْنَا نَعْمَلْ صَالِحًا غَيْرَ الَّذِى كُنَّا نَعْمَلُ أَوَلَمْ نُعَمِّرْكُمْ مَا يَتَذَكَّرُ فِيهِ مَنْ تَذَكَّرَ وَجَاءَكُمُ النَّذِيرُ فَذُوقُوا فَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ نَصِيرٍ٣٧ إِنَّ اللَّهَ عَالِمُ غَيْبِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ إِنَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ٣٨﴾

“Për jobesimtarët është përgatitur zjarri i Xhehennemit, ku ata nuk do të vdesin dhe as që do t’u lehtësohet dënimi. Ja, kështu Ne do t’i dënojmë mosmirënjohësit.”

“Atje, ata do të thërrasin: ‘O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë’. (Atyre do t’u thuhet)**: ‘Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte** (All’llahun)**?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni** (dënimin)**! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!’.”**

“Vërtet, All’llahu e njeh të fshehtën e qiejve e të Tokës dhe e di mirë ç’ka në zemrat e njerëzve.”

Komentimi

Zoti ynë, na nxirr që të bëjmë punë të mira

Kur'ani Famëlartë, kërcënimin dhe premtimin i vë përballë njëri-tjetrit dhe "kërcënimet" i përmend përkrah "përgëzimeve", me qëllim që të përforcohet prej të dy faktorëve: prej frikësimit dhe prej shpresës. Këta dy faktorë, frikësimi dhe shpresa, në të vërtetë, janë dy motive për lëvizjen plotësuese të njeriut, sepse njeriu, sipas kërkesave të "dashurisë për vetveten", bie nën ndikimin e instinktit për "tërheqjen e dobisë" dhe për "sprapsjen e dëmit".

Duke ndjekur bisedën që u trajtua në ajetet më lart, në lidhje me dhuntitë e mëdha hyjnore dhe dëshirën e besimtarëve për të nxituar në punë të mira, në ajetet 36-38, biseda kalon të dënimet e dhimbshme për mohuesit, përfshirë dënimet trupore dhe shpirtërore.

Në këtë grup ajetesh, biseda fillon me Fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"Për jobesimtarët është përgatitur zjarri i Xhehennemit."**. Ashtu siç është Xhenneti, banesa e përjetshme për besimtarët, po ashtu, zjarri, do të jetë banesë e përhershme për mohuesit.

Më pas, ajeti shton: **"...ku ata nuk do të vdesin dhe as që do t'u lehtësohet dënimi."**[1] Megjithëse ai zjarr i nxehtë dhe ai dënim i dhimbshëm mund t'i asgjësojë ata në çdo çast, por ata,

[1] Fraza e ajetit **"là jukdà alejhi"** është në kuptimin: nuk merret vendim kundër atyre.

për shkak të mosdaljes së urdhrit të All'llahut, Sunduesit të çdo sendi dhe patjetër edhe të vdekjes së tyre, nuk do të vdesin, por do të mbeten në jetë që të "shijojnë" dënimin e All'llahut. Vdekja për mohuesit do të ishte një rrugë shpëtimi prej dënimit të All'llahut, por All'llahu i Lartësuar ua ka mbyllur këtë rrugë shpëtimi.

Mbetet edhe një rrugëdalje tjetër, mbetet qëndrimi në jetë dhe atyre t'u lehtësohet dënimi në mënyrë graduale, ose atyre t'u shtohet fuqia për të mbajtur dënimin, por kjo përsëri do të ishte një lehtësim dënimi për ata. Mirëpo ajeti e ka mbyllur edhe këtë portë shpëtimi për ta dhe thotë: **"...as që do t'u lehtësohet dënimi."**.

Në vijim, ajeti e vë theksin mbi këtë kërcënim hyjnor të formës së prerë dhe thotë: **"Ja, kështu Ne do t'i dënojmë mosmirënjohësit."**.

Në fillim, ata mohuan mirësinë e ekzistencës së Profetëve dhe të librave qiellorë, pastaj ata shkatërruan "fondin" që All'llahu ka vënë në dispozicion të tyre për t'i ndihmuar ata që të arrijnë lumturinë. Patjetër, dënimi për mohuesit s'mund të jetë tjetër përveçse dënim i dhimbshëm, djegie në zjarrin që ata e kanë ndezur me duart e veta, kur ishin në botën e Tokës, prandaj All'llahu i Lartësuar iu mbyll atyre të gjitha dyert e shpëtimi në Botën Tjetër.

Tani kalojmë në ajetin vijues të grupit të ajeteve objekt studimi, ku përshkruhet një anë tjetër e dënimit të dhimbshëm. Ajeti e vë theksin mbi disa pika shumë të ndjeshme: **"Atje, ata do**

të thërrasin: 'O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë.'".[1]

Patjetër, kur ata do të shohin rezultatin e punëve të tyre të këqija, do të zhyten në një pendim të thellë, do të klithin nga thellësia e zemrës dhe do të kërkojnë të pamundurën, do të kërkojnë kthimin e tyre në botën e Tokës, që të bëjnë punë të mira.

Fjala e ajetit **"**صَالِحاً**" -** "*sàlihan*" - "*të mirë*", si mbiemër, tregon se ata nuk kanë bërë asnjë punë të mirë, qoftë edhe të vogël fare. Ky kuptim është në përputhje me faktin se ky dënim i dhimbshëm do të jetë për ata, që në jetën e tyre s'kanë pasur asnjë lidhje me All'llahun dhe ishin të mbytur në mëkate e faje, prandaj ata e kanë detyrim të bëjnë një pjesë prej punëve të mira, të cilat mund të jenë shkak për shpëtimin e tyre.

Fjala e ajetit **"**نَعْمَلْ**" -** "*na'mel*" - "*të bëjmë*", ka ardhur në formën e foljes së kohës së tashme, në kontekstin e të ardhmes dhe e përforcon kuptimin e theksimit të punës që ata kanë bërë. Gjithashtu, me këtë fjalë, ata thonë: "*Në të vërtetë ne ishin të mbytur në punët e këqija*".

Disa interpretues të Kur'anit, kanë thënë se lidhja mes mbiemrit "*e mirë*" dhe sifjalisë **"që ne bënim"**, është një shprehje e hollë, shumë e bukur, që shpreh kuptimin: "punët që bëmë, na dukeshin të bukura, se ishin në përshtatje me dëshirat tona dhe ashtu na i zbukuronte djalli. Për më tepër, ne pandehnim se ato ishin punë të mira, por tani kemi vendosur të kthehemi, që të

[1] Fjala e ajetit **"**يَصْطَرِخُونَ**" -** "*jestarikhùne*", në rrënjën e saj **"**صَرْخٌ**" -** "*sarkhun*", është në kuptimin e klithmës së fuqishme që i del njeriut prej zemrës, kur ai kërkon ndihmë për të shpëtuar prej dënimit të dhimbshëm, ose prej ndonjë forme tjetër dënimi.

bëjmë punë të mira, të vërteta, të ndryshme nga punët që kemi bërë.".

Fajtori në fillim ka ndjekur ligjin e krijimit të tij të pastër dhe, në saje të këtij krijimi të pastër, ai e ndien dhe e dallon të keqen e punëve të tij, por ai, pak e nga pak, u normalizua me punët që bënte dhe e keqja e punës që ai bënte, filloi t'i duket gjithnjë e më e vogël dhe kështu u zhyt edhe më shumë në punët e këqija, derisa të keqen filloi ta shikojë të bukur, ashtu siç thotë Kur'ani Famëlartë në ajetin 37 të sures "Et Teube": **"Atyre u dukej e bukur e keqja e punëve të tyre."**.

Kurse në ajetin 104 të sures "El Kehf", All'llahu i Lartësuar njofton: **"...dhe ata mendojnë se po bëjnë punë të mirë."**.

Në të gjitha gjendjet, përballë kërkesës që ata shtrojnë para All'llahut të Lartësuar për kthim në botën e Tokës, del refuzimi i formës së prerë nga ana e All'llahut, i Cili, me Fjalën e Tij u përgjigjet atyre: **"Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte** (All'llahun)**?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi?"**.

Nëse ju nuk përfituat nga gjithë ato të mira që kishit në dorë, për të shpëtuar dhe nuk deshët të shfrytëzoni këto raste, atëherë: **"Shijoni** (dënimin)**! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!"**.

Ky ajet u thotë mohuesve, me zë të lartë se juve nuk ju mungoi asgjë. Rastet që ju janë dhënë, ishin më se të mjaftueshme. Gjithashtu, për ju kanë ardhur paralajmëruesit e All'llahut në një masë të mjaftueshme. Ju i kishit këto dy kolona, që mundësojnë tërheqjen e vëmendjes dhe shpëtimin, prandaj ju s'keni asnjë

justifikim. Nëse për ju koha nuk do të ishte e mjaftueshme, atëherë ju do të kishit një justifikim, kurse ju, të gjitha këto, i kishit me tepricë. Atëherë ku qëndron justifikimi juaj?!

Fjala e ajetit **"نَذِيْرٌ" -** *"nedhijrun"* - *"paralajmërues"*, zakonisht në ajetet e Kur'anit ka ardhur për të treguar Profetët dhe në mënyrë të veçantë Profetin e Islamit, Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, megjithëse disa interpretues të Kur'anit kanë përmendur për këtë fjalë një kuptim shumë më të gjerë dhe kanë thënë se fjala **"paralajmërues"** përfshin Profetët, librat qiellorë, ngjarjet që e bëjnë njeriun që ai t'i thërrasë mendjes, si: vdekja e miqve, të afërmve, pleqëria e shoqëruar me pafuqi, etj.

Gjithashtu, meriton të mbahet shënim se, në transmetimet islame, thuhet se jeta e njeriut ka një kufi që për njeriun konsiderohet "ultimatum" dhe "kujtesë". Natyrisht që ky "ultimatum" dhe kjo "kujtesë" ka ardhur me shprehje të ndryshme, si, për shembull, në një hadith të gradës "Merfùun", të përcjellë prej Ibn Abasit, lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Atij që All'llahu i ka dhënë gjashtëdhjetë vjet jetë, në të vërtetë e ka falur atë."*.[1]

Në një fjalë të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Jeta për të cilën All'llahu e fal njeriun, është gjashtëdhjetë vjet."*.[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 4, f. 41.
[2] Burimi i mësipërm.

Gjithashtu, prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë hadithin: "Ditën e Gjykimit do të thuhet: *'Ku janë gjashtëdhjetëvjeçarët?'*. Kjo është jeta për të cilën All'llahu i Lartësuar thotë: **'Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte** (All'llahun)**?!'"**.[1]

Por, në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Në të vërtetë, ajeti i lartpërmendur është qortim për tetëmbëdhjetëvjeçarët."*.[2]

Natyrisht që transmetimi i fundit tregon kufirin më të ulët, kurse transmetimet e tjera tregojnë kufirin më të gjatë të jetës së njeriut, por në mes dy "kufijve" s'ka asnjë kundërthënie, madje këto dy kufij mund të përputhen edhe për mosha të tjera, sipas ndryshimit të individëve, por ajeti, në të gjitha gjendjet, e ruan gjerësinë e kuptimit të tij.

Në ajetin e fundit të këtij grupi ajetesh, vjen përgjigjja për kërkesën e mohuesve, për t'u kthyer në botën e Tokës. Ajeti njofton: **"Vërtet, All'llahu e njeh të fshehtën e qiejve e të Tokës dhe e di mirë ç'ka në zemrat e njerëzve."**.

Në të vërtetë, fjalia e parë është argument për fjalinë e dytë dhe do të thotë: Si ka mundësi që Ai që di sekretet e qiejve e të Tokës dhe të panjohurat e botës së ekzistencës, të mos ketë dijeni për sekretet e zemrave?!

Mirëpo, Ai s'ka nevojë për asgjë e nuk i mungon asnjë send. All'llahu i Lartësuar, nuk i përgjigjet kërkesës që i bënë

[1] Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthùr", vëll. 5, f. 254.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 4, f. 410.

banorët e zjarrit, për t'i kthyer në botën e Tokës, sepse Ai e di që ata përsëri do të ndiqnin të njëjtën rrugë të shtrembër që kishin ndjekur edhe më parë, ashtu siç theksohet kjo çështje në ajetin 28 të sures "El En'àm": **"Sikur ata të ktheheshin, me siguri do të përsërisnin atë që e kishin të ndaluar, në të vërtetë ata janë gënjeshtarë."**.

Veç kësaj, ajeti u tërheq vëmendjen edhe besimtarëve, që të nxitojnë e të jenë të sinqertë në nijetin e tyre dhe të mos vënë në konsideratë asgjë tjetër përveç All'llahut të Lartësuar, sepse qoftë edhe hija më e vogël në nijetin e tyre, All'llahu ka dijeni për atë dhe është një motiv për t'i dënuar ata në të njëjtën masë.

Dy Hulumtime

1- Cili është qëllimi i përdorimit të frazës "Dhàti-s'Sudùr"?

Sifjalia e ajetit: **"...e di mirë ç'ka në zemrat e njerëzve"**, me pak ndryshim në fjalë, ka ardhur në më shumë se dhjetë ajete të Kur'anit Famëlartë.

Fjala e ajetit **"ذَات" -** *"dhàt"*, njëjësi i të cilës është **"ذُو" -** *"dhù"*, në rrënjën e saj është në kuptimin e pronarit dhe zotëruesit të një sendi, megjithëse te filozofët është në kuptimin: burim, e vërtetë dhe thelbi i sendeve.

Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn, ka thënë se ky term nuk ekziston në të folmen e arabëve.

Bazuar mbi shpjegimin e mësipërm, rezulton se qëllimi i përdorimit të sifjalisë: **"...e di mirë ç'ka në zemrat e njerëzve"**, është: All'llahu ka dijeni për zotëruesin e për pronarin e zemrave, frazë me të cilën nënkuptohen besimet e qëllimet e njerëzve. Kur besimet dhe qëllimet zënë vend në zemrën e njeriut, është sikur janë zotërues e pronarë të zemrës, bëhen sundues në zemër dhe për këtë shkak, këto besime e qëllime konsiderohen pronarë e zotërues për zemrën e njeriut.

Kjo është identike me atë që kanë formuluar disa dijetarë të mëdhenj,[1] në kuadrin e nxjerrjes së kuptimeve prej kësaj fraze. Ata kanë thënë: "Njeriu, pikëpamjet dhe mendimet e tij dhe jo figura e gjymtyrët e tij.".

2- S'ka rrugë për t'u kthyer

Prej aksiomave plotësisht të pranuara, mësohet se jeta pas vdekjes është një etapë integruese në raport me jetën në botën e Tokës dhe kthimi i njeriut, edhe një herë në botën e Tokës pas vdekjes, nuk është mendim racional. Vallë, a mund të kthehemi ne te e djeshmja? A mundet që foshnja, pas lindjes, të rikthehet përsëri në fazat e zhvillimit që kaloi gjatë periudhës kur ishte fetus? Fryti i këputur, a mund të kthehet për herë të dytë në degën ku ishte? Prandaj, është krejtësisht e pamundur për banorët e Botës Tjetër, që të kthehen në jetën e botës së Tokës.

Edhe nëse do të hamendësojmë mundësinë e kthimit, në të vërtetë, njeriu që harron aq shumë, shumë shpejt nuk do të bënte

[1] Këtë formulim e ka bërë i ndjeri Kàshuf El Gitài, në librin "Aslu shiati ue usùluhà".

gjë tjetër veçse do të vazhdonte të bënte punët që ka bërë në kaluarën.

Mos shko larg, ne njerëzit, disa herë, nën trysninë e problemeve dhe të sfidave të vështira, vendosim të zotohemi sinqerisht para All'llahut, se do të bëjmë një punë, ose do të heqim dorë prej një pune tjetër, por, sapo të ndryshojnë kushtet e lartpërmendura, ndryshon edhe fjala jonë dhe e harrojmë vendimin që morëm. Me përjashtim të rasteve, ku për shkak të këmbënguljes, njeriu e realizon qëllimin, pa u pakushtëzuar me kushtet e lartpërmendura, ndryshe, sapo të ndryshojnë kushtet, edhe ai do të kthehej në gjendjen e tij të mëparshme.

Kjo e vërtetë ka ardhur në shumë ajete të Kur'anit Famëlartë, por, në tërësinë e saj, ka ardhur në ajetin 28 të sures "El En'àm", që e theksuam pak më sipër dhe pamë se ajeti i përgënjeshtron mohuesit dhe e hedh poshtë kërkesën e tyre.

Ajeti 53 i sures "El A'ràf" thotë se ata janë njerëz që kanë pësuar humbje dhe nuk shprehet hapur kundër kërkesës së tyre: **"A ka për ne ndonjë ndërmjetësues që të ndërmjetësojë për ne, ose të kthehemi dhe të bëjmë punë ndryshe nga punët që kemi bërë; ata humbën vetveten dhe u shkoi kot trillimi që kurdisën."**.

I njëjti kuptim ka ardhur në një formë tjetër, në ajetet 107-108 të sures "El Mu'minùn": **"Zoti ynë, na nxirr prej tij** (zjarrit) **dhe nëse u kthehemi punëve tona, atëherë ne jemi mizorë. Ai thotë: heshtni aty ku jeni dhe mos flisni."**.

Në të gjitha gjendjet, këto kërkesa të mohuesve për kthim në jetën e botës së Tokës, janë kërkesa pa kuptim dhe shpresa që

nuk mund të realizohen, pasi, edhe sikur të mendohet se ka mundësi, që ata me të vërtetë do të mbajnë premtimin për të bërë punë të mira, atyre, në Botën Tjetër, për shkak të dënimit të ashpër, u janë mbyllur të gjitha vendet nga mund të dalin dhe të gjitha kërkesat u errësohen.

Ajetet 39 – 41

﴿هُوَ الَّذِى جَعَلَكُمْ خَلَٰٓئِفَ فِى الْأَرْضِ ۚ فَمَنْ كَفَرَ فَعَلَيْهِ كُفْرُهُۥ ۖ وَلَا يَزِيدُ الْكَٰفِرِينَ كُفْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ إِلَّا مَقْتًا ۖ وَلَا يَزِيدُ الْكَٰفِرِينَ كُفْرُهُمْ إِلَّا خَسَارًا٣٩ قُلْ أَرَءَيْتُمْ شُرَكَآءَكُمُ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ ۖ أَرُونِى مَاذَا خَلَقُوا۟ مِنَ الْأَرْضِ أَمْ لَهُمْ شِرْكٌ فِى السَّمَٰوَٰتِ ۚ أَمْ ءَاتَيْنَٰهُمْ كِتَٰبًا فَهُمْ عَلَىٰ بَيِّنَتٍ مِنْهُ ۚ بَلْ إِنْ يَعِدُ الظَّٰلِمُونَ بَعْضُهُمْ بَعْضًا إِلَّا غُرُورًا٤٠ إِنَّ اللَّهَ يُمْسِكُ السَّمَٰوَٰتِ وَالْأَرْضَ أَنْ تَزُولَا ۚ وَلَئِنْ زَالَتَآ إِنْ أَمْسَكَهُمَا مِنْ أَحَدٍ مِنْ بَعْدِهِۦٓ ۚ إِنَّهُۥ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا٤١﴾

"Është Ai, që ju ka bërë trashëgimtarë në Tokë. Kush nuk beson, do të mbajë barrën e mohimit të vet. Mosbesimi u shton jobesimtarëve vetëm urrejtje para Zotit të tyre; mosbesimi u sjell atyre vetëm humbje."

"Thuaju: 'Vërini re idhujt që ju i adhuroni krahas All'llahut! Më tregoni, çfarë kanë krijuar ata në Tokë?! A kanë marrë gjë pjesë në krijimin e qiejve? Apo Ne u kemi dhënë idhujtarëve një Libër, ku kanë prova (për idhujtarinë që bëjnë)**?". Nuk është kështu, por keqbërësit i premtojnë njëri-tjetrit vetëm mashtrime."**

"Me të vërtetë, All'llahu mban ekuilibrin e qiejve dhe të Tokës, që të mos shkatërrohen. Kur ato nisin të shkatërrohen, askush nuk mund t'i mbrojë, pos Tij. Me të vërtetë, Ai është i Butë dhe Falës (i gjynaheve)**."**

Komentimi

Qiejt dhe Toka janë në dorën e fuqisë së All'llahut

Ajetet objekt studimi, kalojnë në një etapë tjetër specifikimi të faktorëve që tregojnë dobësinë dhe pavlefshmërinë e programeve të mohuesve dhe të idhujtarëve në fushën e marrëdhënieve dhe të mendimit, ashtu siç e pamë edhe në ajetet e mëparshëm. Në fillim, ajeti 39, thotë: **"Është Ai, që ju ka bërë trashëgimtarë në Tokë."**.

Fjala e ajetit **"**خَلآئِفَ**" -** *"khalàife"* - *"zëvendës"*, nga ana e kuptimit, është e barabartë me kuptimin zëvendës e përfaqësues i All'llahut në Tokë, ose zëvendës të popujve të mëparshëm (siç duket kuptimi i dytë këtu është më afër). Kjo fjali e ajetit, është argument që vërteton butësinë e madhe hyjnore ndaj njerëzve. Kjo butësi e All'llahut të Lartësuar, në radhë të parë, shfaqet në të gjitha mundësitë që u ka dhënë njerëzve për të jetuar. All'llahu u ka dhënë njerëzve mendje, ndjenja dhe aftësinë për të kuptuar. U ka dhënë njerëzve lloje të ndryshme të fuqive trupore. All'llahu e ka mbushur sipërfaqen e Tokës me lloje të shumta mirësish e begatish dhe e ka mësuar njeriun si të përfitojë prej këtyre

mirësive. Atëherë, si ka mundësi që njeriu, në këtë gjendje, harron dhe i kthen shpinën mirësisë së Tij dhe hidhet e adhuron ato statuja mitike, të punuara me dorën e tij?!

Në të vërtetë, kjo fjalë shpjegon atë që quhet *"Teuhijdu Rrububij'jeh"* - "S'ka zot tjetër përveç All'llahut". Gjithashtu, shpjegon edhe *"Teuhijdul Ibàdeti"* - "Adhurim vetëm All'llahut dhe askujt tjetër". Nga ana tjetër, kjo fjali u tërheq vëmendjen të gjithë njerëzve dhe u thotë: Dijeni mirë se qëndrimi juaj në këtë botë nuk është as i përhershëm e as i përjetshëm, ashtu siç janë ata zëvendës të popujve të kaluar vetëm për një periudhë kohe, pastaj radha e tyre përfundon. Të tjerë do të jenë zëvendës të atyre. Prandaj, të gjithë kanë detyrë të mendojnë çfarë bëjnë gjatë kësaj kohe kaq të shkurtër dhe si do t'i kujtojë ata historia në këtë botë.

Për të gjitha këto, ajeti në vijim njofton: **"Kush nuk beson, do të mbajë barrën e mohimit të vet. Mosbesimi u shton jobesimtarëve vetëm urrejtje para Zotit të tyre; mosbesimi u sjell atyre vetëm humbje."**.

Dy foljet **"u shton"** dhe **"u sjell"**, në realitet janë shpjegim për fjalinë: **"Kush nuk beson, do të mbajë barrën e mohimit të vet."**. Këtu ngrihen dy argumente, që tregojnë kthimin e rezultatit të mohimit kundër vetë mohuesit:

Argumenti i parë: Mohimi çon në zemërimin e All'llahut, i Cili ka dhënë të gjitha dhuntitë.

Argumenti i dytë: Përveç zemërimit hyjnor, mohimi për mohuesin, shumë shpejt nuk do të shtojë asgjë tjetër përveç humbjes e dëmtimit, duke i shkatërruar gjithçka që mohuesit kanë punuar gjatë jetës së tyre. E keqja e punës që ata kanë bërë, i fut

ata në degradim e në errësirë. Por a mund të ketë humbje më të madhe se kjo?!

Secili argument, është i mjaftueshëm për të asgjësuar e për të bërë të pavlefshëm programin e gabuar të mohimit, në të gjitha fushat e bashkëpunimit me jetën.

Përsëritja e fjalës *"là jezijdu"* - **"nuk shton"** dhe fakti që kjo fjalë ka ardhur në formën e foljes në kohën tashme, në kontekstin e të ardhmes, e thekson të vërtetën, se njeriu, normalisht, priret që për veten e tij të shtojë sa më shumë. Kur njeriu ecën në rrugën e Njëtimit të All'llahut, atij i shtohet lumturia e plotë, por, kur njeriu ndjek rrugën e mohimit, shumë shpejt do të ndeshet me zemërimin e shtuar të Filluesit të çdo sendi dhe do të ketë për hise vetëm humbje e dëmtim.

Meriton të theksohet se zemërimi hyjnor nuk është ashtu siç e kuptojmë ne zemërimin që mund të rrëmbejë njeriun. Zemërimi te njeriu është një lloj vlimi i brendshëm, që mund të jetë shkak për daljen prej njeriut të punëve të fuqishme, të mprehta dhe të ashpra. Zemërimi te njeriu mobilizon forcat për mbrojtje, ose edhe për hakmarrje, kurse zemërimi, në raport me All'llahun e Lartësuar, nuk ka asnjë gjurmë nga këto që u thanë për zemërimin e njeriut, pasi shenja të tilla zemërimi, janë të veçanta vetëm për qeniet e ndryshueshme, kurse zemërimi i All'llahut, është në kuptimin e ngritjes së mëshirës dhe në mospërfshirjen në butësinë hyjnore të atyre që bëjnë punë të këqija.

Ajeti vijues u përgjigjet idhujtarëve me një përgjigje të formës së prerë e të vendosur, duke u kujtuar atyre se, kur njeriu

ndjek një punë, ose është i varur prej ndonjë pune, është e detyrueshme të ketë një argument logjik kundër kësaj pune, ose një argument tekst të vërtetuar për saktësinë e tij, kurse ju, o mohues, përveç kurtheve dhe mashtrimeve, nuk keni asnjërin prej dy llojeve të argumenteve.

Ajeti i nderuar thotë: **"Thuaju: 'Vërini re idhujt që ju i adhuroni krahas All'llahut! Më tregoni, çfarë kanë krijuar ata në Tokë?! A kanë marrë gjë pjesë në krijimin e qiejve?'"**.[1]

Më thoni, nëse ata zotat tuaj, kanë krijuar ndonjë send në Tokë, apo janë ortakë me All'llahun në krijimin e qiejve?!

Duke marrë parasysh këtë gjendje, më thoni, cili është shkaku që ju i adhuroni idhujt? Që një send të jetë i adhuruar, adhurimi që i bëhet, tregon se ai send është krijues, por ju vazhdoni të dini se Krijuesi i qiejve e i Tokës është vetëm All'llahu i Lartësuar. Atëherë rezulton se kurrë nuk mund të ketë Krijues tjetër përveç All'llahut, sepse Krijuesi është Një e i Vetëm *(teuhijdul khàlikij'jeh)*. Njëkohësisht, fakti se nuk mund të ketë Krijues tjetër përveç All'llahut, është argument për atë që quhet *(teuhijdul ubùdij'jeh)* – i Adhuruari është Një e i Vetëm.

Tani që u vërtetua se ju s'keni asnjë argument logjik për të mbështetur mëtimin tuaj, vallë a keni ndonjë argument tekst, ashtu siç thotë ajeti: **"Apo Ne u kemi dhënë idhujtarëve një Libër, ku kanë prova** (për idhujtarinë që bëjnë)**?"**.

[1] Shprehja e ajetit **"أَرَأَيْتُمْ" -** *"ere'ejtum"*, është në kuptimin: A nuk e shihni?; ose është në kuptimin: A nuk mendoni? Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se është në kuptimin: Më njoftoni, më thoni. Në lidhje me kuptimin e kësaj shprehjeje, ne kemi vënë një studim të gjatë në komentin e ajetit 40 të sures "El En'àm".

Kurrsesi, ata s'kanë asnjë argument të qartë prej librave qiellorë, prandaj ata s'kanë gjë tjetër përveç trillimeve dhe mashtrimit, ashtu siç njofton ajeti: **"Nuk është kështu, por keqbërësit i premtojnë njëri-tjetrit vetëm mashtrime."**.

Me fjalë të tjera, kur adhuruesit e idhujve të të gjitha grupeve e kategorive, mëtojnë se idhujt kanë fuqi të plotësojnë kërkesat e tyre, atëherë e kanë për detyrë të ekspozojnë një model prej krijesave që kanë krijuar idhujt në Tokë dhe, nëse ata besojnë se idhujt që ata adhurojnë, kanë pamjen e engjëjve të shenjtë në qiell, ashtu siç mëtojnë, atëherë kanë detyrë të sjellin një argument, që të vërtetojë se adhuruesit e tyre janë ortakë në krijimin e qiejve. Nëse ata besojnë se këta ortakë s'kanë pjesë në krijim, por janë në pozitën e ndërmjetësimit, siç mëtojnë disa idhujtarë të tjerë, përsëri që të vërtetojnë mëtimin e tyre, duhet të sjellin një argument prej librave qiellorë.

Por ata nuk kanë asgjë prej këtyre argumenteve, prandaj ata janë mashtrues dhe mizorë dhe me fjalët që thonë, s'bëjnë gjë tjetër veçse mashtrojnë njëri-tjetrin.

Gjithashtu, meriton të mbahet shënim se, me fjalët e ajetit: **"**اَلأَرْضِ**"** - "Toka", **"**اَلسَّمَاوَاتِ**"** - "qiejt", qëllimi është tërësia e krijesave tokësore e qiellore. Nga ky këndvështrim, dy sifjalitë e ajetit: **"Çfarë kanë krijuar ata në Tokë?!"** dhe **"...pjesë në krijimin e qiejve?"**, tregojnë se ortakëria në qiej duhet të jetë me rrugë krijimi.

Gjithashtu, ardhja e emrit **"**كِتَابا**"** - *"kitàben"* - *"libër"*, në trajtën e pashquar, që i adresohet All'llahut të Lartësuar, tregon se

ata s'kanë prej librave qiellorë as argumentin më të vogël për të vërtetuar mëtimin e tyre.

Edhe fjala e ajetit **"**بَيِّنَةٍ**" -** *"bej'jinetin"* - *"argument i qartë"*, tregon argumentin e qartë prej librave qiellorë.

Fjala e ajetit **"**ظَّالِمُونَ**" -** *"dhàlimùne"* - *"mizorë, njerëz që bëjnë padrejtësi"*, forcon edhe një herë kuptimin se vënia shok All'llahut në adhurim (shirk), është padrejtësia e mizoria më e madhe.

Fjala e ajetit **"**غُرُور**" -** *"gurùr"*, tregon se adhuruesit e idhujve i morën këto mite prej njëri-tjetrit dhe u përhapën në mesin e tyre në formën e gojëdhanave dhe më vonë në formën e traditës së përcjellë prej njërit brez në brezin tjetër.

Ajeti vijues tregon se All'llahu i Lartësuar është Sunduesi Absolut mbi tërësinë e qiejve e të Tokës. Njëkohësisht, ky ajet vërteton *"Teuhijdi Khàlikij'jeh"* - *"All'llah është Krijuesi i vetëm"*, si dhe *"Teuhijdi Rrubùbij'jeh"* - *"Zot është vetëm All'llahu"*. Ky vërtetim vjen menjëherë pas hedhjes poshtë të ortakërisë për të adhuruarit iluzionarë në botën e krijimit. Ajeti thotë: **"Me të vërtetë, All'llahu mban ekuilibrin e qiejve dhe të Tokës, që të mos shkatërrohen."**.

Me All'llahun nuk ka lidhje vetëm fillimi i krijimit, pasi ruajtja dhe sistemimi i krijesave, gjithashtu, ka lidhje me fuqinë e All'llahut, madje krijesat, në çdo çast, kanë një krijim të ri dhe kështu krijimi në botën e ekzistencës vijon njëri pas tjetrit, që nga fillimi i krijimit. Sikur të ndërpritej lidhja mes krijimit dhe Filluesit madhështor të çdo sendi, nuk do të kishte asgjë tjetër përveçse mosekzistencë dhe shuarje të ekzistencës.

Është e vërtetë që ajeti përforcon çështjen e ruajtjes së drejtpeshuar të ekzistencës. Por, ashtu siç kanë vërtetuar studimet filozofike, "të mundshmet" domethënë qeniet, nuk mund të ekzistojnë e të qëndrojnë pa ndihmën e Filluesit të krijimit, pasi, në saje të lidhjes së pandërprerë krijesë-Krijues, ruhet jo vetëm drejtpeshimi në sistemin e krijimit, por edhe vazhdimësia e krijimit hyjnor të ri e të shumtë.

Këtu tërheq vëmendjen fakti se trupat qiellorë, që janë të pakushtëzuar me ndonjë send tjetër, kurrë nuk i largohen pozicionit dhe orbitës së caktuar për ato, që prej miliona vitesh, qoftë edhe fare pak, sa një mollëz gishti dhe kurrë nuk shmangen nga rruga e caktuar. Gjithashtu, ne vërejnë në sistemin tonë diellor se edhe Toka, në të cilën ne jetojmë, e vazhdon rrotullimin e saj rreth Diellit që prej miliona e miliarda vitesh dhe e vazhdon lëvizjen e saj të përcaktuar me saktësinë më të madhe. Natyrisht që kjo lëvizje drejtpeshohet në saje të forcës shtytëse dhe tërheqëse. Në të njëjtën kohë, Toka bën edhe rrotullimin rreth boshtit të saj dhe e gjitha kjo bëhet me urdhërin e All'llahut.

Për të theksuar edhe më shumë këto fakte, ajeti shton: **"Kur ato nisin të shkatërrohen, askush nuk mund t'i mbrojë, pos Tij."**.

As idhujt që ju i keni punuar vetë, as engjëjt, as ndonjë gjë tjetër e askush përveç All'llahut, nuk ka fuqi për këtë punë dhe me qëllim që rruga të mbetet e hapur edhe për idhujtarët e për ata që kanë shkarë në rrugën e gabuar, në fundin e ajetit, All'llahu i Lartësuar u kujton mohuesve se pendimi i tyre është i mirëpritur në çdo pjesë të rrugës së tyre: **"Me të vërtetë, Ai është i Butë dhe Falës** (i gjynaheve)**."**.

Në përputhje me "butësinë" e All'llahut, nuk përshpejtohet dënimi i tyre dhe në përputhje me "faljen" e Tij, pendimi i tyre pranohet, patjetër sipas kushteve që kërkohen për pranimin e pendimit në çdo etapë të rrugëtimit të tyre. Duke u bazuar mbi këtë, fundi i ajetit, duke treguar gjendjen e idhujtarëve, thekson se mëshira hyjnore i përfshin edhe mohuesit e të gjitha kategorive, në rast se ata pendohen dhe kërkojnë falje.

Disa interpretues të Kur'anit, kanë thënë se dy cilësitë e All'llahut "i Buti" dhe "Falësi", këtu janë përmendur për shkak të lidhjes që kanë këto dy cilësi të larta me çështjen e ruajtjes së qiejve e të Tokës. Kuptohet që asgjësimi i qiejve e i Tokës do të ishte asgjësim i përgjithshëm i Njerëzimit, por, në përputhje me butësinë e All'llahut dhe me faljen e Tij, njerëzit nuk do të goditen nga një katastrofë e tillë, pavarësisht se shumë fjalë e punë të mohuesve e bëjnë të detyrueshëm lëshimin e një dënimi të këtillë, ashtu siç lexojmë në ajetet 88-90 të sures "Merjem": **"Ata thanë: i Gjithëfuqishmi ka fëmijë. Ju** (mohuesit) **thatë një fjalë shumë të shëmtuar. Prej fjalës suaj gati u copëtuan qiejt, gati u ça Toka dhe gati u shembën malet."**.

Edhe këtu meriton të mbahet shënim fakti se sifjalia e ajetit: **"nëse ata asgjësohen"**, nuk është në kuptimin: "Kur ata të asgjësohen, ata nuk i ruan askush tjetër përveç All'llahut", por është në kuptimin: "Kur të afrohet rënia dhe asgjësimi i atyre të dyve (qiejve e Tokës), vetëm All'llahu i Lartësuar ka mundësi t'i ruajë ata, ndryshe s'ka kuptim të flitet për ruajtjen pas asgjësimit.".

Gjatë historisë njerëzore, shpesh ka ndodhur që astronomët të parashikojnë se filan trup qiellor, kometë ose jo kometë, do të

kalojë pranë globit të Tokës dhe ka mundësi të përplaset me të. Këto parashikime, natyrisht, shkaktojnë shqetësim te njerëzit dhe, në këto kushte, të gjithë e ndiejnë se askush nuk mund të ndikojë në një aksident të këtillë. Të gjithë e kuptojnë se, sikur njëri prej trupave qiellorë të lëvizë në drejtim të Tokës, ai trup, nën efektin e forcës tërheqëse, do të përplaset me Tokën dhe për rrjedhojë, nuk do të kishte më asnjë gjurmë nga qytetërimi njerëzor, madje mbi sipërfaqen e Tokës nuk do të mbetej asnjë gjurmë prej të gjitha qenieve të tjera. Prandaj, përveç fuqisë së All'llahut, nuk mund të ketë fuqi tjetër të aftë që e ndalon këtë përplasje.

Në të tilla gjendje, të gjithë njerëzit ndiejnë nevojën e ngutshme e absolute për All'llahun e Lartësuar, por, sapo të largohet mundësia e rrezikut, harrimi lëshon hijen e vet mbi njeriun.

Kjo katastrofë nuk vjen thjesht nga përplasja e dy trupave qiellorë, por mjafton edhe një shmangie fare e vogël nga rruga e çdo trupi qiellor, si, për shembull, sikur të shmanget Toka fare pak nga orbita e saj, do të ishte e mjaftueshme që vetëm kjo shmangie të çojë në një katastrofë që nuk mund të merret me mend.

Hulumtim

E vogla dhe e madhja janë të barabarta para fuqisë së All'llahut

Në ajetet objekt studimi, tërheq vëmendjen fakti, kur thuhet se qiejt qëndrojnë vetëm në saje të fuqisë së All'llahut. Në ajete të tjera të Kur'anit, e njëjta shprehje ka ardhur në lidhje me ruajtjen e shpendëve, që të mos bien kur janë lart në fluturim, në qiell, siç e lexojmë, për shembull, në ajetin 79 të sures "En Nahl": **"A nuk i shohin ata shpendët të fluturojnë në hapësirën e qiellit, që nuk i mban askush përveç All'llahut; në të vërtetë, në këtë ka argument për ata që besojnë."**.

Në një ajet tjetër, theksohet se krijimi i qiejve, pa anë e pa fund, është një argument që vërteton ekzistencën e All'llahut të Lartësuar. Në një ajet tjetër, flitet për krijimin e një insekti të vogël, siç është mushkonja, por edhe kjo është argument që vërteton ekzistencën e All'llahut.

Në ajete të tjera, All'llahu, herë betohet për Diellin, me cilësinë e tij si burim i madh i fuqisë në botën e ekzistencës, herë tjetër betohet në frytin e njohur të fikut.

Të gjitha këto tregojnë se para fuqisë së All'llahut, s'ka asnjë dallim mes të madhit e të voglit.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: "*E lavdishmja, e buta, e rënda, e lehta, e fuqishmja dhe e dobëta, në krijimin e All'llahut, janë të barabarta.*".[1]

Të gjitha këto tregojnë një send të vetëm, tregojnë vetëm fuqinë e të Gjithëfuqishmit të Lartësuar, në të gjitha përmasat, tregojnë kuptimin e fjalës "pafundësi". Kjo dukuri është e vërtetuar plotësisht. Kuptimet e fjalëve: "i vështirë", "i lehtë", "i vogël", "i madh", "i ndërlikuar", "i thjeshtë", etj., shprehin kuptimin në kufijtë e qenieve të kufizuara, por, kur vjen fjala për fuqinë absolute të All'llahut, të gjitha këto kuptime ndryshojnë krejtësisht dhe të gjitha janë në të njëjtin rresht, pa as më të voglin dallim mes tyre. (Mprihe shikimin!)

[1] "Nehxhul Belàga", Hytbeja 185.

Ajetet 42 – 44

﴿وَأَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ لَئِنْ جَاءَهُمْ نَذِيرٌ لَيَكُونُنَّ أَهْدَى مِنْ إِحْدَى الْأُمَمِ فَلَمَّا جَاءَهُمْ نَذِيرٌ مَا زَادَهُمْ إِلَّا نُفُورًا ٤٢ اسْتِكْبَارًا فِي الْأَرْضِ وَمَكْرَ السَّيِّئِ وَلَا يَحِيقُ الْمَكْرُ السَّيِّئُ إِلَّا بِأَهْلِهِ فَهَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا سُنَّتَ الْأَوَّلِينَ فَلَنْ تَجِدَ لِسُنَّتِ اللَّهِ تَبْدِيلًا وَلَنْ تَجِدَ لِسُنَّتِ اللَّهِ تَحْوِيلًا ٤٣ أَوَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَكَانُوا أَشَدَّ مِنْهُمْ قُوَّةً وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُعْجِزَهُ مِنْ شَيْءٍ فِي السَّمَاوَاتِ وَلَا فِي الْأَرْضِ إِنَّهُ كَانَ عَلِيمًا قَدِيرًا ٤٤﴾

"Ata (paganët e Mekës) **janë betuar solemnisht për All'llahun që, nëse u vjen ndonjë** (Profet) **paralajmërues, ata do të ndjekin udhëzimin e tij më shpejt se çdo popull tjetër. Por, kur u erdhi paralajmëruesi, kjo vetëm ua shtoi largimin prej Rrugës së Drejtë."**

"Ata u sollën me mendjemadhësi në Tokë dhe me dredhi të shëmtuara, të cilat godasin vetëm atë që i bën. Vallë, a presin ata diçka tjetër veç asaj që ka goditur të mëparshmit? Vërtet, Ti nuk mund të gjesh ndryshim ose shndërrim në ligjet e All'llahut."

“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë për të parë si ka qenë përfundimi i të mëparshmëve, të cilët kanë qenë më të fortë se këta? All’llahut nuk mund t’i shpëtojë asgjë, as në qiej, as në Tokë. Ai është vërtet i Gjithëdijshëm dhe i Fuqishëm për çdo gjë.”

Shkaku i zbritjes

Në tefsiret: “Ed Durr’rrul Menthùr”, “Rùhul Meànij”, “Mefàtijhul Gajbi” dhe në tefsire të tjerë, thuhet se para ngarkimit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me detyrën e profetësisë, kurejshët thoshin: “Ithtarët e librave të mëparshëm i përgënjeshtruan Profetët e tyre. All’llahu i mallkoftë jehuditët e të krishterët, të cilëve u erdhën Profetët, por ata i përgënjeshtruan. Betohemi në Allah, sikur të vijë te ne një i Dërguar, patjetër që do të jemi populli më i udhëzuar se çdo popull tjetër.”.

Por, kur në vendin e tyre Islami lëshoi rrezatimin e tij dhe te ata erdhi Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Librin qiellor, ata jo vetëm që e kundërshtuan, por edhe e përgënjeshtruan, madje e luftuan dhe praktikuan kundër tij llojet më të ndryshme të dredhive e të mashtrimeve.

Ajetet në fjalë kanë zbritur për të qortuar kurejshët për mëtimet e tyre të rrema.

Komentimi

Mendjemadhësia dhe mashtrimi ishin shkak i mjerimit të tyre

Ajetet në fjalë, flasin për idhujtarët e për të ardhmen e tyre n ë botën e Tokës dhe në Botën Tjetër.

Ajeti 42 njofton: **"Ata** (paganët e Mekës) **janë betuar solemnisht për All'llahun që, nëse u vjen ndonjë** (Profet) **paralajmërues, ata do të ndjekin udhëzimin e tij më shpejt se çdo popull tjetër."**.[1]

Fjala e ajetit **"**أَيْمَان**" -** *"ejmàn"* - *"betime"*, është shumësi i fjalës **"**يَمِيْن**" -** *"jemijn"* - *"betim"*. Në rrënjën e saj, kjo fjalë do të thotë "dora e djathtë" dhe fjala "betim" është një huazim i marrë prej kësaj fjale, si veprim i betuesit, apo përqafim mes dy vetëve, duke shtrënguar dorën e djathtë në mënyrë të ndërsjellë.

Fjala e ajetit **"**جَهْد**" -** *"xhehd"* - *"përpjekje"*, në rrënjën e saj, do të thotë përpjekje dhe punë e rëndë. Me këtë kuptim, shprehja **"**جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ**" -** *"xhehde ejmànihim"*, do të thotë: *"ata e rënduan shumë betimin e tyre, se do të bënin më të lartën që kishin mundësi."*.

[1] Fjala e ajetit **"**إِحْدَى**" -** *"ihdà"* - *"njëri"*, ka ardhur në numrin njëjës dhe kuptimi i ajetit është: "do të jenë shumë më të udhëzuar në rrugën e të vërtetës se ndonjë prej popujve." Kjo fjalë mund të tregojë jehuditët (sepse trajta e fjalës në numrin njëjës nuk është në kuptimin e përgjithësimit) dhe kjo duket që në vështrimin e parë. Disa interpretues të Kur'anit, kanë thënë se ajete të tjera krahasuese të kësaj gjendjeje, tregojnë se qëllimi në këtë ajet është përgjithësimi, sepse fjala këtu është në shkallën sipërore dhe të përforcimit. Gjithashtu, kjo fjalë thekson mëtimin e tyre, kur thoshin se me ardhjen e Profetit te ata, ata patjetër do të ishin populli më i udhëzuar se të gjithë popujt e përparshëm.

Por, kur ata lexuan fletët e historisë dhe u informuan për mosmbajtjen e besës dhe për mosfalënderimin e atyre popujve, si dhe për veprimet e tyre shumë të ulëta ndaj Profetëve të tyre, veçanërisht jehuditët, u çuditën shumë dhe për veten e vet pretenduan mëtime të mëdha, madje u krenuan se gjendja e tyre do të ishte shumë më e mirë se gjendja e popujve të mëparshëm.

Por, sapo u ballafaquan me sprovën dhe hynë në rrethin e ndezur të provimit, atëherë kur u realizua kërkesa e tyre për të pasur një Profet prej mesit të tyre dhe Profeti që u erdhi, ishte prej të njëjtës tokë, ajeti i nderuar, pas frazës së parë, në lidhje me gjendjen e tyre, njofton: **"Por, kur u erdhi paralajmëruesi, kjo vetëm ua shtoi largimin prej rrugës së drejtë."**.

Kjo fjali e këtij ajeti, tregon se ata, edhe para se i Dërguari më i nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* të vinte te ata, me kumtin e Islamit, ata u bënë e kundërta e asaj që mëtonin dhe ishin shumë larg prej fesë së All'llahut të Lartësuar. Në mesin e tyre, njihej prirja e Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* për t'u larguar prej gjërave të gabuara, por ata, në të vërtetë, nuk e respektonin këtë prirje të tij. Gjithashtu, në mesin e tyre nuk kishte ndonjë konsideratë për veprimet logjike për veprimet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Nuk i miratonin qëndrimet e tij ndaj besimeve, miteve, apo fanatizmit të tyre, para Islamit.

Veç kësaj, ata thoshin se thirrja e tij rrezikonte deri edhe interesat e tyre joligjore. Të gjitha këto, e thelluan vijën ndarëse mes tyre e mes të vërtetës. Ata ishin shumë larg nga e vërteta, por largësia e tyre nga e vërteta u shtua edhe më shumë pas ardhjes së

Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*.

Ajeti vijues shpjegon më qartë ajetin paraardhës dhe thotë se largimi i tyre nga e vërteta erdhi, sepse ata ecën në rrugën e mendjemadhësisë nëpër Tokë, te ata nuk ekzistonte dëshira për nënshtrim ndaj logjikës së të vërtetës. Ajeti njofton: **"Ata u sollën me mendjemadhësi në Tokë."**[1] Gjithashtu, ata ishin prej atyre që mashtronin dhe bënin punë të këqija. Ajeti thotë për ta: **"me dredhi të shëmtuara"**.

Por **"dredhitë e shëmtuara"** godasin vetëm atë që i bën.

Fjala e ajetit **"**لاَ يَحِيْقُ**" -** *"là jehijku"*, vetë folja **"**يَحِيْقُ**" -** *"jehijku"*, në rrënjën e saj **"**حَاقَ**" -** *"hàka"*, është në kuptimin e zbritjes e të goditjes, atëherë fjalia merr kuptimin: "nuk zbret, nuk prek, nuk rrethon" dhe tregon se mashtrimi, përkohësisht, mund të futë në rrethin e tij edhe të tjerë të pafajshëm, por mashtrimi, më në fund, do të bjerë mbi vetë mashtruesin, i cili është i diskredituar, i dobët dhe i pafuqishëm para krijimit të All'llahut. Është e qartë se mashtruesit, patjetër, do të pendohen para All'llahut të Lartësuar, sepse kjo është e ardhmja fatale, ku do të përfundojnë idhujtarët e Mekës.

Në fakt, ky ajet ka për qëllim të thotë se ata nuk u mjaftuan që u distancuan prej Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i*

[1] Shumica e interpretuesve të Kur'anit, kanë thënë se fjala e ajetit **"**إِسْتِكْبَاراً**" -** *"istikbàren"* - "mendjemadhësi", nga ana e sintaksës së gjuhës arabe, këtu është kundrinor shkaku dhe shpjegon shkakun e largimit të idhujtarëve nga e vërteta. Togfjalëshi *"mekre sej'ji'i"* - *"dredhia e keqe"*, i atashohet kundrinorit *"mendjemadhësi"*, në një kohë që disa të tjerë kanë thënë se ky togfjalësh i atashohet fjalës **"**نُفُوراً**" -** *"nufùren"* - *"largim"*.

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), por ata punuan me të gjitha fuqitë që kishin, për ta luftuar atë dhe thirrjen e tij. Shkaku për këtë mllef të tyre nuk ishte gjë tjetër veçse mendjemadhësia, mashtrimi dhe mosnjohja e të vërtetës.

Fundi i ajetit është një kërcënim i hapur për atë grup mendjemëdhenjsh e mashtruesish tradhtarë. Me një fjalë, me kuptim shumë të thellë e me fjalë mbresëlënëse që tronditin ndjenjat, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Vallë, a presin ata diçka tjetër veç asaj që ka goditur të mëparshmit?"**.[1]

Kjo fjali tregon përfundimin fatal që patën popujt e kaluar, si: populli i Nuhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* populli Ad, Themud dhe populli i Faraonit. Të gjithë ata popuj u asgjësuan me dënimin më të rëndë. Kur'ani Famëlartë, shpesh, na tregon anë të ndryshme për të ardhmen fatale e të dhimbshme të atyre popujve.

Për të përforcuar edhe më shumë atë që u përmend më përpara, në pjesën e fundit të ajetit vjen fjalia: **"Vërtet, Ti nuk mund të gjesh ndryshim ose shndërrim në ligjet e All'llahut."**. Si është e mundur që All'llahu i Lartësuar dënon një popull për punë të caktuar dhe nuk dënon të tjerët, që bëjnë të njëjtat punë si ata që u dënuan? A nuk është Ai i Drejti, i Urti, që e bën çdo gjë sipas kërkesave të urtësisë së Tij të pakushtëzuar dhe sipas kërkesave të drejtësisë së Tij gjithëpërfshirëse?!

---

[1] Ràgibi, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, "Mufredàtu el Fàdhil Kur'àn", për fjalën e ajetit **"نَظَرَ" -** *"nedhare"*, **"إِنْتِظَار" -** *"intidhàr"*, shpjegon se kjo fjalë, në disa raste, vjen në të njëjtin kuptim: pritje.

Ndryshimi i ligjeve mund të thuhet në raport me atë që ka një informacion e njohje të kufizuar dhe, kur njohja e tij shtohet me kalimin e kohës, atëherë njohja e re vihet mbi njohjen e mëparshme; ose, marrim shembullin e një dijetari, i cili nuk vepron sipas diturisë që ka dhe sipas drejtësisë, por veprimet e tij janë në përputhje me prirjet e tij të veçanta vetjake. All'llahu i Lartësuar është krejtësisht i dëlirë nga veprime të tilla njerëzore, prandaj nuk mund të mendohen këto veprime për All'llahun, sepse ligji i Tij është veprues, edhe për ata që do të vijnë më vonë. Me atë ligj, All'llahu vendos për të tashmen dhe po me po atë ligj, do të vendosë ashtu siç vendosi në të kaluarën, prandaj ligji i All'llahut kurrë nuk e pranon ndryshimin.

Kur'ani Famëlartë, në shumë ajete, e ka theksuar qëndrueshmërinë dhe pandryshueshmërinë e ligjeve të All'llahut. Në lidhje me këtë çështje, kemi vënë një bisedë të hollësishme në komentin e ajetit 62 të sures "El Ahzàb", ku kemi sqaruar se, në tërësi, kjo botë, bota e ekzistencës dhe e legjislacionit, ecën sipas ligjeve të qëndrueshme, që kurrë nuk ndryshojnë dhe këto ligje në Kur'anin Famëlartë janë përmendur me togfjalëshin: *"es sunenul ilàhij'jetu"* - **"ligjet hyjnore"**, të cilat kurrë nuk ndryshojnë.

Këto ligje, ashtu siç ishin vepruese në të kaluarën, janë vepruese edhe në ditët e sotme dhe do të jenë vepruese edhe nesër. Me këto ligje u dënuan mendjemëdhenjtë mohues, të cilëve nuk u sollën dobi këshillat e All'llahut. Gjithashtu, me këto ligje janë ndihmuar edhe ata që e përqafuan të vërtetën dhe nuk u thyen në rrugën e në punën e tyre të sinqertë. Këto dy kategori

ligjesh ishin e do të vazhdojnë të jenë të qëndrueshme siç ishin dje, janë sot dhe do të jenë e të pandryshueshme edhe nesër.[1]

Këtu meriton të theksohet fakti se, në disa ajete të Kur'anit, flitet për "mosndryshimin" e ligjeve hyjnore, si, për shembull, në ajetin 62 të sures "El Ahzàb"; në një vend tjetër flitet për "mosshmangien" e ligjeve hyjnore, si, për shembull, në ajetin 77 të sures "El Isrà"; kurse në ajetin në fjalë, theksohet njëherësh "mosndryshimi" dhe "mosshmangia" e ligjeve të All'llahut të Lartësuar.

Vallë, të dyja gjendjet e ligjeve hyjnore (mosndryshimi dhe mosshmangia), a shprehin një kuptim të vetëm, për faktin se janë përmendur së bashku, apo çdonjëra prej dy fjalëve: "ndryshim" dhe "shmangie" thekson një kuptim të pavarur?

Bazuar mbi këtë shpjegim, "ligjet e All'llahut" nuk pranojnë as ndryshim e as zëvendësim të plotë dhe as ndryshim relativ, nga ana e ashpërsisë dhe e zbutjes, ose e pakësimit dhe e shtimit. Në tërësinë e tyre, ligjet hyjnore tregojnë se All'llahu i Lartësuar bën që të bien dënime të ngjashme, në raport me faje e krime të ngjashme nga të gjitha anët dhe kurrë nuk bën që, mbi njërin grup të bjerë dënimi dhe mbi grupin tjetër të mos bjerë, ose dënimi për njërin grup të jetë më pak dhe për një grup tjetër dënimi të jetë më shumë. Ky është ligji i All'llahut, me këtë bazë

[1] Në lidhje me këtë çështje, kemi vënë një shpjegim të hollësishëm në suren "El Ahzàb", në ajetin 62 dhe në suren "El Isrà", në ajetin 77.

të qëndrueshme dhe për rrjedhojë, ligji i All'llahut nuk e pranon as ndryshimin e as shmangien.[1]

Çështja e fundit, ku duhet të qëndrojmë, është se ajeti, fjalën **"سُنَّةٌ" -** *"sun'netun" - "ligj"*, e sjell ngjitur me Emrin e All'llahut të Lartësuar **"اَللهِ" -** *"All'llàh"*, pra, e sjell me togfjalëshin **"سُنَّةُ اللهِ" -** *"ligji i All'llahut"*. Në një vend tjetër, të të njëjtit ajet, pas fjalës **"سُنَّةٌ" -** *"sun'netun"*, në kuptimin *"rrugë"*, shtohet fjala **"الأَوَّلِيْنَ" -** *"el eu'uelijne" - "të mëparshmit"* dhe sillet me togfjalëshin *"sun'netul eu'uelijne" -* "rruga e të mëparshmëve".

Në pamjen e jashtme, duket sikur ka një kundërthënie në mes dy gjendjeve, por, në të vërtetë, nuk ka asnjë kundërthënie, sepse në gjendjen e parë, fjalës **"سُنَّةٌ" -** *"sun'netun" - "ligj"*, i shtohet kryefjala, domethënë i shtohet vepruesi; kurse në gjendjen e dytë, fjalës **"سُنَّةٌ" -** *"sun'netun" - "rrugë"*, i shtohet kundrinori. Gjendja e parë shpreh vijimësinë e ligjit, kurse gjendja e dytë tregon se mbi cilin është zbatuar ligji.

---

[1] Interpretuesit e Kur'anit, fjalën e ajetit **"تَحْوِيْل" -** *"tehuijl"*, e kanë komentuar në kuptimin: *"ndërrimi i vendit të ndëshkimit"*, në kuptimin se All'llahu i Lartësuar e kalon ndëshkimin e Tij prej një njeriu dhe e lëshon mbi një njeri tjetër. Duke mbajtur shënim se ky komentim nuk është në harmoni me atë kuptim që shprehin fjalët e ajetit në fjalë, rezulton se nuk bëhet fjalë për kalimin e dënimit nga një njeri në një njeri tjetër, por theksohet se ligjet hyjnore nuk e pranojnë as shtimin, as pakësimin, as ndryshimin e as zëvendësimin. Duket sikur, këta interpretues të Kur'anit, kanë përzier dy fjalët **"تَحْوِيْل"** - *"tehuijl" - "e ndryshoi"* dhe **"تَحَوُّل"-***"tehav'vul" - "ndryshon"*. Në disa libra të sintaksës së gjuhës arabe, si, për shembull, në librin "Mexhmaul Bahrejni", shpjegohet se fjala **"تَحْوِيْل" -** *"tehuijl"*, do të thotë shndërrimin e një sendi në të kundërtën e asaj që ishte, kurse fjala **"تَحَوُّل" -** *"tehav'vul"*, do të thotë kalimin nga njëri vend në një vend tjetër.

Ajeti vijues u bën thirrje idhujtarëve dhe kriminelëve që të "lexojnë" gjurmët që kanë mbetur nga të mëparshmit dhe të shikojnë se si qe përfundimi ku ata arritën. Këtë "lexim", ata duhet ta bëjnë, me qëllim që të shohin me sytë e tyre vendet ku kanë jetuar të mëparshmit dhe, duke i parë me sy ato rrënoja, do të vërtetojnë edhe ato që kanë dëgjuar rreth tyre. Ajeti i nderuar thotë: **"Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë për të parë si ka qenë përfundimi i të mëparshmëve…?"**.

Nëse idhujtarët e mohuesit mendojnë se janë më të fuqishëm se të mëparshmit, në të vërtetë, janë në një dyshim shumë të madh, sepse popujt e mëparshëm ishin shumë më të fuqishëm se ata. Ajeti njofton: **"kanë qenë më të fortë se këta"**.

Faraonët që sunduan Egjiptin, Nemrudi që sundoi me fuqi absolute Babiloninë dhe sundues të tjerë shtetesh, të gjithë ishin të fuqishëm dhe fuqia e idhujtarëve të Mekës as që mund të krahasohet me fuqinë e atyre sundimtarëve të mëparshëm.

Përveç kësaj, njeriu, sado i fortë e i fuqishëm të jetë, në të vërtetë fuqia e forca e tij nuk është asgjë kundrejt fuqisë së All'llahut. Përse? Ajeti e shpjegon: **"All'llahut nuk mund t'i shpëtojë asgjë, as në qiej, as në Tokë. Ai është vërtet i Gjithëdijshëm dhe i Fuqishëm për çdo gjë."**[1]

Për All'llahun asgjë s'mbetet e panjohur, asnjë send nuk e kundërshton dot fuqinë e Tij, Atë askush nuk e mposht. Nëse ata

[1] Edhe më sipër, kemi thënë se shprehja e ajetit **"لِيُعْجِزَهُ" -** *"liju'xhizehù"* - **"që ta pengojë Atë"**, në rrënjën e saj **"عَجَزَ" -** *"axheze"*, këtu është në kuptimin: e bën atë të pamundur. Në ajete të tjera, kjo fjalë ka ardhur në kuptimin: arratisje prej fuqisë së All'llahut, ose në kuptimin e pamundësisë prej një njeriu.

mendjemëdhenj mashtrues mendojnë se mund të shpëtojnë prej fuqisë së All'llahut të Lartësuar, nga kjo anë, janë në një dyshim shumë të madh dhe, nëse ata nuk heqin dorë prej punëve të këqija, patjetër që do të përfundojnë ashtu siç përfunduan ata që jetuan para tyre.

Shpeshherë kemi parë në Kur'anin Famëlartë se All'llahu u bën thirrje mohuesve dhe mëkatarëve të "udhëtojnë nëpër Tokë", që të shohin me sytë e tyre gjurmët që kanë mbetur prej popujve të kaluar dhe fundin e tyre të dhimbshëm.

Në ajetin 9 të sures "Err Rùm" lexojmë: **"A nuk udhëtuan ata nëpër Tokë e të shohin si qe përfundimi i popujve të mëparshëm?! Ata ishin edhe më të fuqishëm se këta; edhe ata punuan më shumë dhe bënë ndërtime më shumë se këta; edhe atyre u erdhën të Dërguarit me argumente të qarta; atyre nuk u bëri padrejtësi All'llahu, por ata i bënë padrejtësi vetvetes."**.

Një kuptim i ngjashëm, ka ardhur edhe në suren "Jùsuf", në ajetin 109; në suren "El Haxh'xh", në ajetin 46; në suren "Gàfir", në ajetin 21 dhe në ajetin 82; në suren "El En'àm", në ajetin 11 dhe në sure të tjera.

Ky theksim i përsëritur, për të "udhëtuar nëpër Tokë", është një argument që vërteton ndikimin e veçantë që shkakton shikimi i atyre rrënojave në shpirtrat e njerëzve, prandaj njerëzit e kanë detyrim t'i shikojnë me sytë e tyre ato mbetje të të mëparshmëve, përveç asaj që lexojnë në librat e historisë dhe ato që dëgjojnë në lidhje me të mëparshmit. Le të shkojnë në ato vende, që të shikojnë fronat e shkatërruar të faraonëve, pallatet e rrënuara të kisrave, varret e braktisura të cezarëve, kockat e

ronitura të Nemrudit, tokën e zhveshur të popullit të Lutit e të Themudëve dhe le të dëgjojnë këshillat e tyre të heshtura, të dëgjojnë edhe rënkimin e tyre poshtë tokës, të shohin me sytë e tyre se si u dënuan ata dhe si qe përfundimi i mohuesve të mëparshëm.

Ajeti 45

﴿وَلَوْ يُؤَاخِذُ اللَّهُ النَّاسَ بِمَا كَسَبُوا مَا تَرَكَ عَلَى ظَهْرِهَا مِنْ دَابَّةٍ وَلَكِنْ يُؤَخِّرُهُمْ إِلَى أَجَلٍ مُسَمًّى فَإِذَا جَاءَ أَجَلُهُمْ فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِعِبَادِهِ بَصِيرًا﴾

"Sikur All'llahu t'i dënonte njerëzit sipas veprave që bëjnë, nuk do të mbetej në sipërfaqen e Tokës asgjë e gjallë, por Ai i shtyn ata deri në afatin e caktuar dhe, kur t'u vijë afati i tyre, ata do ta dinë se All'llahu i mbikëqyr mirë robtë e Vet."

Komentimi

Sikur të mos ishte butësia e mëshira e All'llahut...

Ajeti në fjalë është ajeti i fundit i sures "El Fàtir". Pas studimeve të "mprehta" dhe kërcënimeve të ashpra që erdhën në ajetet e ndryshme të kësaj sureje, në drejtim të idhujtarëve, mohuesve e mëkatarëve, sureja "El Fàtir" mbyllet me shpjegimin e butësisë e të mëshirës së All'llahut ndaj njerëzve, domethënë kjo sure, ashtu siç filloi, me mëshirën e All'llahut për njerëzit, po

ashtu mbyllet, me mëshirën dhe butësinë e All'llahut ndaj robëve të Tij. Nga ky këndvështrim, fillimi dhe fundi i sures është në harmoni të plotë me shpjegimin e qartë të mëshirës së All'llahut të Lartësuar.

Përveç kësaj, ne pamë se ajeti 44 i kërcënon kriminelët e mohuesit se do të kenë të njëjtin përfundim siç e kishin popujt e mëparshëm. Por këtu shtrohet pyetja: Kur "ligji i All'llahut" është veprues mbi të gjithë tiranët e mëkatarët, përse nuk u dënuan idhujtarët e Mekës?! Kësaj pyetjeje ajeti i përgjigjet duke thënë: **"Sikur All'llahu t'i dënonte njerëzit sipas veprave që bëjnë"**, dhe sikur All'llahu të mos u jepte njerëzve raste për të përmirësuar veten e për të menduar rreth të ardhmes që i pret, si dhe për të edukuar veten me moralin, **"nuk do të mbetej në sipërfaqen e Tokës asgjë e gjallë"**.

Po, sikur të donte All'llahu t'i dënonte njerëzit për fajet që bënin, patjetër do të kishte lëshuar mbi ta dënime të njëpasnjëshme: rrufe, tërmete e furtuna, do t'i shkatërronte kriminelët dhe prej tyre nuk do të mbetej asnjë shenjë se ata kishin jetuar në këtë Tokë, por: **"Ai i shtyn ata deri në afatin e caktuar"**, për t'u dhënë atyre raste që të pendohen e të përmirësojnë vetveten.

Kjo butësi dhe kjo shtyrje e dënimit, nga ana e All'llahut, ka përmasa e llogari të veçanta: shtyrja e afatit është derisa atyre u soset afati i caktuar për të jetuar në këtë botë, por: **"...kur t'u vijë**

afati i tyre, ata do ta dinë se All'llahu i mbikëqyr mirë robtë e Vet.".[1]

S'ka dyshim se All'llahu i Lartësuar i shikon punët që ata bëjnë dhe ka dijeni të plotë për qëllimet e tyre.

Këtu shtrohen dy pyetje dhe përgjigjja për të dyja pyetjet, shpjegohet me ato që u tha më sipër.

Pyetja e parë: Në vendimin e përgjithshëm: **"nuk do të mbetej në sipërfaqen e Tokës asgjë e gjallë"**, a përfshihen Profetët, eulijatë dhe njerëzit e tjerë punëmirë?

Përgjigje: Është e qartë se, në kuptimin e një vendimi të tillë, hyjnë pakica dhe shumica e tyre, por Profetët, eulijatë dhe njerëzit e tjerë punëmirë, të cilët janë pakicë, natyrisht që mbeten jashtë këtij vendimi, për faktin se çdo vendim e çdo dispozitë ka përjashtime, prandaj Profetët dhe njerëzit punëmirë janë të përjashtuar prej këtij vendimi. Kjo është e ngjashme me fjalën tonë, kur themi: njerëzit në këtë jetë janë të pavëmendshëm, të dhënë pas kësaj bote dhe janë mendjemëdhenj. Kuptimi i togfjalëshit "shumica prej tyre", shpjegohet qartë në ajetin 41 të

---

[1] Sifjalia **"Sikur All'llahu t'i dënonte njerëzit sipas veprave që bëjnë"**, është sifjali kushtore, kundrejt shpërblimit ose dënimit, prandaj përgjigjja do të bjerë mbi kushtin dhe, kur atyre u soset afati i jetës, All'llahu ose e shpërblen, ose e dënon, çdo njeri, sipas punës që ai ka bërë. Bazuar mbi këtë shpjegim, fraza vijuese e ajetit **"فَإِنَّ اللَّهَ" - " ata do ta dinë se All'llahu i mbikëqyr mirë robër e Vet"**, është prej llojit të "shkakut të shpërblimit". Gjithashtu, çështja e mosshtyrjes dhe e mospërshpejtimit të mbarimit të jetës, është trajtuar edhe në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë, si, për shembull, në ajetin 61 të sures "En Nahl". Bazuar mbi këto ajete, fjalia "**All'llahu i mbikëqyr mirë robtë e Vet"**, tregon se All'llahu i Lartësuar i njeh ata të gjithë dhe di se cilit prej tyre i është sosur afati i jetës.

sures "Err Rrùm": **"Degjenerimi doli sheshit në tokë e në det, për shkak të mëkateve që bëjnë njerëzit, prandaj le ta 'shijojnë' një pjesë të asaj që ata bënë; mbase kështu do të bëjnë kthesë."**.

Kuptohet se degjenerimi nuk është rezultat i punëve të të gjithë njerëzve, por është rezultat i punëve të shumicës së njerëzve.

Gjithashtu, edhe ajeti 32 i sures "El Fàtir", siç e pamë, i ndan njerëzit në tri grupime: në "ata që i bëjnë padrejtësi vetes", në "mesatarë" dhe në ata "që nxitojnë të bëjnë punë të mira". Ajeti i cituar është dëshmuesi i fundit për këtë kuptim.

Bazuar mbi këtë shpjegim, ajeti i mësipërm, në mënyrë absolute, nuk e mohon pagabueshmërinë e Profetëve.

Pyetja e dytë: Në shprehjen e ajetit **"**دَابَّة**" -** *"dàb'betun"*, a përfshihen edhe gjallesa të tjera përveç njerëzve, domethënë se edhe këto gjallesa do të asgjësohen, si rezultat i rënies së dënimit mbi njerëzit?!

Përgjigje: Përgjigjja për këtë pyetje bëhet e qartë, kur ne dimë origjinën e kafshëve që ecin mbi Tokë. Është fjala për kafshët prej të cilave njeriu ka dobi, por, kur mbi faqen e Tokës, nuk do të ketë njerëz, s'ka asnjë arsyetim që këto kafshë të ekzistojnë.[1]

---

[1] Fjala e ajetit **"**دَابَّة**"-***"dàb'betun",* në rrënjën e saj, do të thotë: ecje e lehtë. Kjo fjalë përdoret për të treguar kafshët dhe insektet; përdoret për të gjitha kafshët; por përdorimi i kësaj fjale është i njohur, veçanërisht për të treguar kuajt. Gjithashtu, kjo fjalë, në mënyrë të veçantë, thuhet për të treguar kafshët që përdoren për hipje.

Këtë studim po e mbyllim me hadithin e ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*E para është dituria. U shkrua çdo gjë, u bë gjykimi, kaderi (paracaktimi), u plotësua me vërtetimin e Librit dhe me besimin te Profetët, me lumturinë prej All'llahut për atë që beson dhe ka frikë All'llahun, me të keqen për atë që përgënjeshtron dhe mohon, me kujdestarinë prej All'llahut të Lartësuar për besimtarët dhe mosmbajtje përgjegjësie për veprimet e idhujtarëve.*". Pastaj i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*All'llahu i Lartësuar thotë: 'O bir i Ademit, me dashjen Time, ti ke atë që dëshiron për veten tënde. Me vullnetin Tim, ti do për veten tënde atë që dëshiron. Me mirësitë e Mia të shumta, që të kam dhënë, ti u forcove, që të mos më kundërshtosh Mua. Me fuqinë, me ruajtjen dhe me shëndetin që Unë të dhashë, ti i kreve detyrimet me të cilat të kam ngarkuar. Të gjitha mirësitë e tua janë prej Meje e të gjitha gjynahet e tua ndaj Meje janë të tuat. Të mirat ty të vijnë në saje të kujdestarisë Sime për ty, e keqja të vjen prej vetes tënde dhe për shkak të punëve të këqija do të dënohesh. Në saje të pushtetin Tim të shumtë mbi ty, ti hyre në bindjen Time. Me mendimin e keq tëndin për Mua, ti i preve shpresat prej mëshirës Sime. Lavdërimi e argumenti kundër teje është me fakte të qarta. Për Mua ka rrugë kundër teje për shkak të mëkatimit, te Unë ti ke shpërblimin e bukur për bamirësinë. Unë gjithnjë të paralajmëroj dhe nuk të ndëshkoj, kur ti je i shkujdesur*, ashtu siç thotë ajeti: '**Sikur All'llahu t'i dënonte njerëzit sipas veprave që bëjnë, nuk do të mbetej në sipërfaqen e Tokës asgjë e gjallë.'**. *Unë nuk të kam vënë detyrime më shumë se fuqia jote. Unë nuk të kam ngarkuar amanate të tjera, përveç atyre që ti vendose vetë t'i mbash. Unë jam i kënaqur prej teje, me atë çka ti je i kënaqur që e ke prej Meje.* All'llahu i Gjithëfuqishëm thotë: **'...por Ai i shtyn ata deri në afatin e**

caktuar dhe, kur t'u vijë afati i tyre, ata do ta dinë se All'llahu i mbikëqyr mirë robtë e Vet.'".[1]

O Zoti im, na bëj prej atyre që përfitojnë prej rasteve të para, që ato të mos na dalin prej dore dhe të kthehen te madhëria Jote bujare. Ndriçoji ditët tona, që kemi kaluar, me dritën e mirësive të Tua dhe të kënaqësisë Tënde!

O Zoti im, kur ne nuk përfshihemi në mëshirën Tënde, Xhehennemi që ne e ndezëm me punët tona të këqija, do të shtrijë gjuhët e flakëve të tij të zjarrta drejt nesh, ne do të na prekin flakët e tij përvëluese dhe, nëse Ti nuk i ndriçon zemrat tona me dritën e faljes Tënde, zemrat tona do të bëhen strehë për djallin e mallkuar.

O Zoti im, na ruaj prej çdo lloj idhujtarie, ndizi o Allah llambat e besimit e të Njëtimit të sinqertë në thellësi të zemrave tona! Na furnizo me frikë ndaj Teje me fjalë e me punët tona. Vetëm Ti i përgjigjesh lutjes.

[1] Tefsiri i Ali Ibrahimit, cituar sipas tefsirit "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 270.

SURE "JÂ SÎN"

Zbritur në Mekë, numri i ajeteve 83

Përmbajtja e sures "JÂ SÎN"

Edhe kjo sure e Kur'anit Famëlartë ka zbritur në Mekë, prandaj, nga ky këndvështrim, në përgjithësi ka të njëjtën përmbajtje si të gjitha suret e zbritura në Mekë. Kjo sure flet për Njëtimin e All'llahut (Teuhidin), për ringjalljen pas vdekjes, për profecinë, për Kur'anin. Gjithashtu, në këtë sure ka paralajmërime dhe përgëzime. Në këtë sure dallohen katër korpuse kryesore:

1- Në fillim kjo sure flet për kumtin e Profetit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, flet për Kur'anin Famëlartë e për zbritjen e këtij Libri të madh hyjnor, flet për ata që i besojnë Kur'anit dhe vazhdon me këtë temë deri në ajetin 11.

2- Një korpus tjetër i kësaj sureje, flet për kumtin e tre Profetëve të All'llahut, për thirrjen e tyre për të besuar All'llahun, Zotin Një e të Vetëm dhe për luftën e tyre të vazhdueshme e të gjatë kudër idhujtarisë. Në të vërtetë, kjo bisedë është qetësim e kënaqësi për Profetin e Islamit, Profetin Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, njëkohësisht i shpjegon atij rrugën e Shpalljes hyjnore.

3- Korpusi i tretë i ajeteve të kësaj sureje, duke filluar prej ajetit 33 deri në ajetin 44, është i mbushur me shprehje të holla, që tërheqin vëmendjen rreth Njëtimit të All'llahut, është një paraqitje shpjeguese për argumentet që tregojnë madhështinë e All'llahut në botën e ekzistencës. Megjithëkëtë, fundi i sures i rikthehet bisedës rreth Njëtimit të All'llahut.

4- Në korpusin e fundit të ajeteve të sures "Jâ Sîn", flitet për çështje që kanë lidhje me ringjalljen dhe me argumentet e ndryshme që vërtetojnë ringjalljen. Gjithashtu, në këto ajete flitet se si do të jetë grumbullimi në sheshin e Gjykimit të Madh, flitet për pyetjet që do t'u bëhen njerëzve dhe për përgjigjet që do të japin njerëzit në Ditën e Gjykimit. Në ajetet e këtij korpusi, flitet edhe për fundin e kësaj bote, më pas flitet për Xhennetin e për Xhehennemin. Kjo pjesë e ajeteve të kësaj sureje përmban kërkesa shumë të rëndësishme dhe shumë të hollësishme.

Gjatë këtyre studimeve, ka edhe ajete që e vënë njeriun në lëvizje dhe e shtyjnë të kthejë kokën e të zgjohet prej shkujdesjes dhe të qëndrojë larg injorantëve. Njëkohësisht, në këto ajete, paralajmërohen të shkujdesurit dhe injorantët. Pa dyshim që të katër studimet, kanë një ndikim të fuqishëm në zemër e në shpirt.

Si përfundim, në këtë sure, njeriu vihet përballë dëshmive të ndryshme, si: krijimi, Dita e Gjykimit, jeta, vdekja, paralajmërimi, përgëzimi. Të gjitha këto, në tërësinë e tyre, janë një recetë shërimi dhe një tubë këshillash që i zgjojnë njerëzit prej gjumit të shkujdesjes.

Mirësitë e sures "Jâ Sîn"

Surja "Jâ Sîn", me dëshminë e hadithe dhe të transmetimeve të shumta që kanë ardhur, në lidhje me përparësitë e mirësive për këtë sure, dëshmon se, për nga rëndësia e madhe që ka kjo sure, është quajtur "zemra e Kur'anit", ashtu siç e lexojmë në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Çdo send ka një zemër dhe zemra e Kur'anit është "Jâ Sîn".*".[1]

Në një transmetim të përcjellë prej Ebu Besirit, prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë fjalën e tij: "*Çdo send ka një zemër dhe zemra e Kur'anit është surja "Jâ Sîn". Kush e lexon këtë sure ditën, para se të erret, atë ditë ai është prej të ruajturve dhe të furnizuarve, derisa të erret; kush e lexon këtë sure natën, para se të bjerë për të fjetur, një mijë engjëj urdhërohen që ta ruajnë atë, atë natë, prej djallit të mallkuar dhe prej të gjitha sëmundjeve…*".[2]

Gjithashtu, në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Surja 'Jâ Sîn', në Teuràt thirret me emrin 'El muam'meh'*". Kur u pyet për kuptimin e kësaj fjale, "El muam'meh", ai tha: "*Ai që e këndon këtë sure, është i përfshirë në mirësitë e kësaj bote dhe të Botës Tjetër…*".[3]

Në lidhje më këtë çështje, kanë ardhur edhe hadithe e transmetime të tjera, prej të dyja grupimeve islame (syni e shi'a),

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 4, f. 416, fillimi i sures "Jâ Sîn".
2 Referohu burimit të nësipërm; "Uesàilu Shiia", vëll. 4, f. 886, K. "Leximi i Kur'anit" dhe "Bihàrul Enuàr", vëll. 92, 288.
3 Burimi i mësipërm.

por ne i kemi lënë mënjanë, sepse, po t'i përmendnim të gjitha, do të zgjateshim shumë.

Për të gjitha këto, është detyrë të pohohet se mbase njeriu nuk i arrin këto mirësi të veçanta me ndonjë sure tjetër të Kur'anit, ashtu siç i arrin me suren "Jâ Sîn".

Siç e kemi theksuar edhe më parë, këto mirësi të mëdha e këtë shpërblim të madh, nuk e arrin ai që mjaftohet vetëm me leximin e fjalëve, pa u thelluar në përmbajtjen e sures, sepse madhështia e mirësisë së kësaj sureje qëndron pikërisht në madhështinë e përmbajtjes së saj.

Përmbajtja e sures "Jâ Sîn" zgjon prej gjumit të shkujdesjes, fut në shpirt besimin, nxit frymën e përgjegjësisë dhe bën thirrje për përkushtim. Kur njeriu mendon rreth këtij argumenti dhe e vë në qendër të mendimit të tij, atëherë hija e këtij mendimi do të ndihet mbi punët e tij dhe pa dyshim që do të arrijë të fitojë jo vetëm mirësitë e kësaj bote, por edhe mirësitë e Botës Tjetër.

Për shembull, në ajetin 60 të kësaj sureje, ka ardhur paralajmërimi për të mos i dëgjuar fjalët e djallit. Për këtë ajeti njofton: "**Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni djallin, se ai është vërtet armik i hapët i juaji?**".

Është e qartë se, kur njeriu e mban parasysh këtë porosi hyjnore në mënyrë të plotë, ashtu siç u theksua në hadithet më lart, pa dyshim, ai që e lexon suren "Jâ Sîn", do të jetë i siguruar prej djallit të mallkuar. Por kur ky ajet lexohet pa shikuar në kuptimin e tij dhe puna bëhet jo sipas kuptimit të ajetit, atëherë lexuesi do të jetë prej shokëve më besnikë e më të sinqertë të djallit dhe kurrë nuk do të arrijë mirësitë që u thanë më sipër për këtë sure. Kjo vërtetohet në ajetet e kësaj sureje, ajet pas ajeti.

Ajetet 1 - 10

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿يس١ وَالْقُرْآنِ الْحَكِيمِ٢ إِنَّكَ لَمِنَ الْمُرْسَلِينَ٣ عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ٤ تَنْزِيلَ الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ٥ لِتُنْذِرَ قَوْمًا مَا أُنْذِرَ آبَاؤُهُمْ فَهُمْ غَافِلُونَ٦ لَقَدْ حَقَّ الْقَوْلُ عَلَى أَكْثَرِهِمْ فَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ٧ إِنَّا جَعَلْنَا فِي أَعْنَاقِهِمْ أَغْلَالًا فَهِيَ إِلَى الْأَذْقَانِ فَهُمْ مُقْمَحُونَ٨ وَجَعَلْنَا مِنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ سَدًّا وَمِنْ خَلْفِهِمْ سَدًّا فَأَغْشَيْنَاهُمْ فَهُمْ لَا يُبْصِرُونَ٩ وَسَوَاءٌ عَلَيْهِمْ أَأَنْذَرْتَهُمْ أَمْ لَمْ تُنْذِرْهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ١٠﴾

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"**Jâ Sîn.**"

"**Për Kur'anin plot urtësi!**"

"**Në të vërtetë, ti** (Muhamed) **je një nga të Dërguarit.**"

"**Në Rrugë të Drejtë**"

"**Me Shpalljen e të Plotfuqishmit, Mëshirëplotit.**"

"Që të paralajmërosh një popull, paraardhësit e të cilit nuk ishin të paralajmëruar, prandaj këta janë të pakujdesshëm."

"Shumica e tyre meritojnë dënimin Tonë, se ata nuk besojnë."

"Ne do t'u vëmë në qafë vargonj, të cilët do t'u arrijnë deri në mjekër, e kështu do të jenë si të mpirë."

"Ne kemi vënë pengesë para tyre dhe pas tyre e i kemi mbuluar, kështu që ata nuk shohin."

"Për ata është njëlloj, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove, ata nuk besojnë."

Komentimi

Kjo sure, si të gjitha njëzetë e tetë suret e tjera të Kur'anit, që fillojnë me germa të ndara, fillon me dy germa të ndara, fillon me germën "J" - "ياء" dhe me germën "S" - "سين".

Kemi folur me hollësi për germat e ndara në fillim të sures "El Bekare", të sures "Àli Imràn" dhe të sures "El A'ràf". Për suren "Jâ Sîn", ka interpretime të tjera për këto germa të ndara në fillim të disa prej sureve të Kur'anit Famëlartë.

Nga tërësia e këtyre interpretimeve, rezulton se fjala "Jâ Sîn", siç thamë në krye të këtij komenti, përbëhet prej dy

germave, prej germës "ي" - "*Jà*" dhe prej germës "س" -"*Sijn*", që tregojnë personin e të Dërguarit më të nderuar. Mbështetur mbi këtë interpretim, ajeti i parë i sures me këto dy germa, është në pozitën e një bisede drejtuar të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për të shpjeguar qartë çështjet që do të shpalosen në këtë sure.

Në disa hadithe e transmetime, ka ardhur se fjala "Jâ Sîn" është një prej emrave të të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[1]

Prej këtyre interpretimeve, është se bashkëbiseduesi këtu, është njeriu dhe germa "*Sijn*" bën shenjë për njeriun, por kjo mundësi interpretimi nuk e realizon harmoninë mes këtij ajeti dhe ajeteve vijues të sures, pasi biseda i drejtohet vetëm të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë*: "'Jâ Sîn', është një prej emrave të të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Argument për këtë është fjala e All'llahut të Lartësuar: "Me të vërtetë ti (Muhamed) je prej të Dërguarve. Je në Rrugën e Drejtë.".[2]

Menjëherë pas këtyre dy germave të ndara, si në të gjitha suret që fillojnë me germa të ndara, vjen biseda për Kur'anin Famëlartë. Surja fillon me betimin në Kur'an: "**Për Kur'anin plot urtësi!"**.

1 Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 374 dhe f. 375.
2 Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 375.

Në këtë ajet, tërheq vëmendjen fakti se Kur'ani Famëlartë përshkruhet me cilësorin *"el hakijm"* - *"i mbushur me urtësi"*, në një kohë që urtësia zakonisht është cilësi e njeriut të mençur. Me këtë mënyrë përshkrimi, duket sikur All'llahu i Lartësuar ka qëllim ta paraqesë Kur'anin si një qenie të gjallë, të mençur dhe udhëzues në Rrugën e Drejtë, libër që hap portat e urtësisë para Njerëzimit dhe çon në Rrugën e Drejtë. Këtë gjë e theksojnë edhe ajetet vijues.

Është e habitshme që All'llahu i Lartësuar betohet, megjithëse Ai s'ka nevojë të betohet, por betimet ku'ranore gjithmonë kanë dy dobi kryesore.

Dobia e parë: Theksi vihet mbi objektin për të cilin bëhet betimi.

Dobia e dytë: Shpjegohet madhësia dhe rëndësia e sendit për të cilin betohet All'llahu i Lartësuar. Në të vërtetë, betimi zakonisht nuk bëhet mbi gjëra pa vlerë.

Ajeti vijues shpjegon objektin për të cilin betohet All'llahu i Lartësuar në fillim të kësaj sureje të nderuar. Për këtë, ajeti thotë: "**Në të vërtetë, ti** (Muhamed) **je një nga të Dërguarit në Rrugë të Drejtë."**.[1]

1 Interpretuesit e Kur'anit ndajnë mendime të ndryshme, në lidhje me kompozimin e fjalisë "Je në Rrugën e Drejtë.". Disa kanë thënë se fjalia ka lidhje me fjalën e mëparshme *"el murselijne"* - *"të Dërguarve"*. Sipas këtij interpretimi, kuptimi është: "Kumti yt është në rrugën e drejtë.".
Disa të tjerë kanë thënë se, sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, kjo fjali është kallëzues i dytë (kallëzues pas kallëzuesi) dhe sipas këtij interpretimi, kuptimi i fjalisë është: "Ti me të vërtetë je i qëndrueshëm në rrugën e drejtë.".
Një grup i tretë, e konsideron këtë fjali plotësor gjendjeje. Kuptimi, sipas këtij interpretimi, është: "Ti me të vërtetë je prej të Dërguarve dhe je i vendosur të

Menjëherë, ajeti vijues thotë: "**Me Shpalljen e të Plotfuqishmit, Mëshirëplotit.**".[1]

Theksimi i fjalës "*el azijz*" - "*i Plotfuqishmi*", si mbiemër, për All'llahun e Lartësuar, ka ardhur për të shpjeguar fuqinë e Tij kundrejt një Libri madhështor si ky, një Libër që është një mrekulli e madhe gjatë shekujve e kohëve dhe asnjë fuqi tjetër, sado e madhe që të jetë, nuk ka mundësi ta fshijë ndikimin e madh të këtij Libri prej zemrave të njerëzve.

Gjithashtu, edhe cilësimi i All'llahut me mbiemrin "*err rrahijm*" - "*Mëshirëploti*", ka ardhur për të shpjeguar të vërtetën se mëshira e Tij e bën detyrim paracaktimin e një mirësie kaq të madhe si kjo për njerëzit.

Të tjerë interpretues të Kur'anit, kanë thënë se këto dy cilësi janë përmendur për të theksuar dy lloje të ndryshme reagimi të njerëzve kundrejt zbritjes së këtij Libri qiellor dhe ngarkimit të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me detyrën e profetësisë. Nëse ata e mohojnë, ose e përgënjeshtrojnë atë (Kur'anin), All'llahu i Gjithëfuqishëm i kërcënon ata me madhështinë e Tij, por, nëse ata hyjnë në portën e pranimit dhe dorëzohen, All'llahu i Lartësuar i përgëzon ata me mëshirën e Tij të veçantë.[2]

---

ecësh në rrugën e drejtë." (Natyrisht që këtu nuk kemi kundërthënie të kuptimeve).

1 Disa interpretues të Kur'anit, kanë thënë se fjala e ajetit "*tenzijl*" - "*zbritje*", është kundrinor i një foljeje vlerësuese dhe sipas këtij interpretimi, kuptimi është: "Zbriti Shpallja e të Gjithëfuqishmit, Mëshirëplotit". Duhet vënë në dukje se, të tjerë interpretues të Kur'anit, janë shprehur edhe për mundësi të tjera analize të kësaj fjalie.

2 Tefsiri "El Kebijr", fundi i ajetit objekt studimi.

Bazuar mbi këtë shpjegim, fuqia e madhe e All'llahut dhe mëshira e Tij e veçantë, rezulton se njëra cilësi e tij është paralajmërim dhe tjetra është përgëzim dhe me bashkimin e këtyre dy cilësive të larta, ky Libër madhështor qiellor është vënë në qarkullim në dorën e Njerëzimit.

Pyetje: Këtu mund të shtrohet pyetja: A është e mundur të vërtetohet drejtësia e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ose e Librit qiellor, me anën e një betimi ose theksimi?

Përgjigje: Përgjigjen e nxjerrin ajetet e lartpërmendura, të cilat, nga njëra anë, e përshkruajnë Kur'anin me mbiemrin *"el hakijm"* - *"të mbushur me urtësi"*, duke vënë në dukje se urtësia e këtij Libri madhor nuk është e panjohur për asnjë njeri. Kjo e vërtetë, në vetvete, është argument që dëshmon drejtësinë e këtij Libri.

Nga ana tjetër, cilësimi i të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me frazën "Je në Rrugën e Drejtë", do të thotë se përmbajtja e thirrjes së tij bëhet e qartë prej Rrugës së Drejtë. Gjithashtu, edhe jeta e Profetit të Islamit, para se të ngarkohej me detyrën e Shpalljes hyjnore, është një argument që vërteton se ai, gjatë gjithë jetës, nuk ka ndjekur rrugë tjetër përveç Rrugës së Drejtë.

Në studimet që kemi paraqitur në këtë libër, rreth drejtësisë së të Dërguarve, kemi thënë se njëra prej rrugëve më të rëndësishme, për të kuptuar të vërtetën e drejtësisë së të Dërguarve, është vërtetimi dhe njohja në mënyrë të hollësishme me përmbajtjen e thirrjeve të tyre. Studimet kanë vërtetuar se thirrjet që ata kanë bërë, gjithmonë kanë qenë në harmoni të plotë

me natyrën e pastër të krijimit të njeriut, me logjikën dhe me ndërgjegjen dhe thirrjet e Profetëve janë të kuptueshme dhe të pranueshme për mendimin njerëzor. Këtu duhet të shtohet se historia e jetës së të Dërguarit të Islamit *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vërteton se ai ishte burrë besnik, njeri i drejtë dhe nuk ishte as gënjeshtar e as falsifikues. Të gjitha këto cilësi, janë argumente të gjalla, që vërtetojnë se ai është i Dërguari i All'llahut dhe ajetet e mësipërme, në të vërtetë, theksojnë të dyja kërkesat. Bazuar mbi këtë shpjegim, betimi dhe mëtimi i mësipërm kurrë nuk ka qenë pa një shkak.

Veç kësaj, me qëllim që të depërtohet në zemrat e mohuesve dhe të kokëngjeshurve dhe fjala të ndikojë tek ata, edukata e diskutimit kërkon që shprehjet e shtruara për diskutim duhet të jenë sa më të përsosura, sa më të prera dhe të shoqëruara me vërtetues të fuqishëm.

Pyetje: Mbetet dhe kjo pyetje: Përse kjo fjali i drejtohet të Dërguarit më të nderuar dhe jo idhujtarëve, ose njerëzve në përgjithësi?

Përgjigje: Përgjigjja është theksimi i veçantë që bën ajeti, kur thotë se ti o Profet, je me të vërtetën dhe je në Rrugën e Drejtë, pavarësisht se ata i përgjigjen ose jo thirrjes tënde, prandaj ti puno me ngulm për të kumtuar thirrjen tënde madhore dhe mos u kushto kundërshtarëve as edhe interesimin më të vogël.

Ajeti vijues shpjegon qëllimin kryesor të zbritjes së Kur'anit: "**Që të paralajmërosh një popull, paraardhësit e të cilit nuk ishin të paralajmëruar, prandaj këta janë të**

pakujdesshëm.",[1] domethënë: të parëve të tyre nuk u ka ardhur ndonjë paralajmërues.

Është pranuar se qëllimi i përdorimit të fjalës "një popull", është të tregojë idhujtarët e Mekës, të cilëve u thuhet: asnjë popull s'ka mbetur pa i ardhur një paralajmërues dhe Toka është e mbushur me argumente që vërtetojnë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm, ashtu siç thotë vetë All'llahu i Lartësuar në ajetin 24 të sures "El Fàtir": "**Ne të kemi dërguar ty me të Vërtetën, për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar; nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues."**.

Këtu theksojmë se, në ajetin objekt studimi, qëllimi i përdorimit të fjalës "paralajmërues", është për paralajmëruesin konkret, për Profetin e madh të Islamit, fama e të cilit është e përhapur në të gjitha horizontet dhe se robtë e All'llahut, në gjithë

1 Interpretuesit e Kur'anit kanë dhënë mundësi të ndryshme në lidhje me kuptimin e fjalës *"mà"*. Shumica e tyre kanë thënë se është mohuese. Këtë mendim kemi edhe ne në tefsirin tonë, sepse fraza e fundit e ajetit objekt studimi "**janë të pakujdesshëm"**, është argument që e vërteton këtë kuptim, domethënë se mosekzistenca e një paralajmëruesi (Profeti) është shkak i shkujdesjes së njerëzve. Gjithashtu, edhe ajeti 3 i sures "Es Sexhde", është dëshmues për këtë kuptim, pasi, në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Për të paralajmëruar popullin, të cilit para teje nuk i ka ardhur kurrfarë paralajmëruesi, që të shkojë në Rrugë të Drejtë."**.

Disa të tjerë, kanë thënë se këpuja *"mà"* është lidhëse dhe, sipas këtij interpretimi, kuptimi i fjalisë është: "që ti të paralajmërosh një popull me atë që u paralajmëruan të parët e tyre". Disa interpretues të tjerë të Kur'anit, kanë thënë se këpuja *"mà"*, është rrënjë foljeje. Bazuar mbi këtë interpretim, kuptimi i fjalisë është: "që ti të paralajmërosh një popull me të njëjtin paralajmërim, që u paralajmëruan edhe të parët e tyre". Të dyja këto mundësi interpretimi paraqiten të shkallës "dobët".

Tokën, nuk kanë mbetur as edhe një ditë pa pasur argument që vërteton ekzistencën e All'llahut të Lartësuar. Nëse hedhim një vështrim mbi periudhën kohore që shtrihet nga koha e Mesihut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* deri në kohën kur erdhi i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, do të gjejmë se as edhe kjo periudhë kohore nuk ka qenë pa argument hyjnor, por vërejmë se ajo ishte një periudhë kohore gjatë të cilës nuk kishte ardhur ndonjë Profet prej atyre që në Kur'an cilësohen "*të vendosurit*" - "*ulul azmi*". Në lidhje me këtë çështje, Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: "*All'llahu i Lartësuar dërgoi Muhamedin në kohën kur asnjë arab nuk kishte lexuar libër dhe as nuk kishte pretenduar se është profet.*".[1]

Në të gjitha gjendjet, qëllimi i zbritjes së Kur'anit Famëlartë ishte tërheqja e vëmendjes dhe paralajmërimi i njerëzve të trullosur, zgjimi i tyre prej gjumit të shkujdesjes dhe t'u bëheshin atyre të njohura rreziqet që i rrethonin, t'u flitej atyre për fajet e për mëkatet që ata bënin, t'u shpjegohej se ata ishin të ndotur me ndyrësinë e idhujtarisë dhe të llojeve të ndryshme të punëve të liga që ata bënin. Po, Kur'ani Famëlartë, është baza e diturisë dhe e ndërgjegjësimit, është libër për të pastruar zemrën dhe shpirtin.

Në vijim, Kur'ani Famëlartë na njofton si do të jetë e ardhmja e mohuesve dhe e idhujtarëve. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: "**Shumica e tyre meritojnë dënimin Tonë, se ata nuk besojnë.**".

1 "Nehxhul Belàga", Hytbeja 33, Hytbeja 104.

Interpretuesit e Kur'anit janë shprehur për disa mundësi interpretimi, për kuptimin e fjalës së këtij ajeti *"el kaulu"* - " **meritojnë dënimin**".

Është e qartë se ky kërcënim hyjnor për ndëshkimin në Xhehennem, është për të gjithë pasuesit e djallit. Një kërcënim i njëjtë ka ardhur edhe në ajetin 13 të sures "Es Sexhde": "Vendimi Im është i formës së prerë se do të mbush Xhehennemin me xhind e me njerëz së bashku."; si dhe në ajetin 71 të sures "Ez Zumer": "…Vendimi për dënimin, patjetër që do të zbatohet për mohuesit.".

Në të gjitha gjendjet, ky kërcënim është i veçantë për të gjithë ata që kanë këputur të gjitha lidhjet e tyre me All'llahun e Lartësuar, kanë mbyllur të gjitha portat e udhëzimit të tyre në Rrugën e Drejtë dhe kokëfortësinë, mendjemadhësinë dhe idiotizmin e tyre i kanë çuar deri në caqet më të largëta. Por, ata kurrë nuk do të besojnë dhe për ata s'ka mbetur asnjë rrugë që të bëjnë kthesë, sepse i kanë shembur të gjitha urat prapa tyre.

Në të vërtetë, njeriu që pranon përmirësimin dhe udhëzimin në Rrugën e Drejtë, është individi, që natyrën e pastër të krijimit të tij, me besimin në All'llah, Zotin Një e të Vetëm (Teuhid), nuk e ka ndotur me punë të liga dhe me degjenerim moral, ndryshe, errësira absolute do të jetë zotëruese mbi zemrën e tij dhe do të mbyllë për të, të gjitha dritaret e shpresës.

Duket qartë se, qëllimi i përdorimit të fjalës "shumicë", është të tregojë krerët e idhujtarëve e të mohuesve, të cilët, jo vetëm që kurrë nuk besuan, por ata e luftuan Islamin me të gjitha rrugët, deri me armë dhe duke adhuruar idhujt ata vazhduan t'i vënë shok All'llahut në adhurim. Ata ishin dhe mbetën në rrugën

e humbjes, prandaj për ata s'ka mbetur asnjë hije ku mund të fusin kokën, deri në fundin e punës së tyre.

Megjithëkëtë, shumica e idhujtarëve arabë përqafuan Islamin, pas çlirimit të Mekës, ashtu siç njofton All'llahu i Lartësuar me fjalën e Tij: "**Dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e All'llahut grupe-grupe."**.[1]

Kjo e vërtetë, në lidhje me idhujtarët e mohuesit, dëshmohet edhe në ajetet vijuese, që flasin për ekzistencën e një dige para dhe prapa tyre dhe gjendjen e tyre me pamundësi që të shohin, prandaj për ata nuk sjell dobi, nëse paralajmërohen ose jo.[2]

Ajeti vijues vazhdon përshkrimin e shtresës së kokëngjeshurve: "**Ne do t'u vëmë në qafë vargonj, të cilët do t'u arrijnë deri në mjekër, e kështu do të jenë si të mpirë."**, domethënë: atyre u mbetet koka lart, për shkak të prangave që kanë rreth qafave.

Fjala e ajetit *"eglàlen" - "pranga"*, është në kuptimin: veshja e një sendi me mburojë dhe vënia e tij në mes. Kjo fjalë tregon hallkën e prangës, që mbështillet rreth gjymtyrëve dhe pastaj lidhet me zinxhir dhe vihet ose në qafë, ose në të dy duart. Kur prangat janë në qafë, në përgjithësi, janë të lidhura vetëm me një zinxhir. Me këtë lloj prangosjeje, individi është nën një presion të rëndë dhe është në kufijtë e një ndëshkimi shumë të ashpër.

---

1 Sure "En Nasr", ajeti 2.

2 Mbështetur mbi atë që shpalosëm, del qartë se qëllimi i përdorimit të përemrit *"ata" - "him"* në fjalën *"ektherihim" - "shumica e tyre"*, është për udhëheqësit e popullit dhe jo për popullin. Këtë të vërtetë e dëshmojnë ajetet që vijojnë pas këtij ajeti.

Nëse për gjendjen e etjes thuhet "etje e fortë", fjala "e fortë", në kuptimin e ashpërsisë, thuhet edhe për gjendjen e humbjes së rëndë dhe të zemërimit të madh. Kjo mënyrë përshkrimi e gjendjes së njeriut, tregon se gjendja e ashpërsisë ka depërtuar në brendësi të zemrës e të trupit të njeriut. Në origjinën e saj, rrënja e fjalës *"eglàlen" - "gal'letun"*, është në kuptimin e hyrjes e të futjes dhe në këtë kuptim përdoret edhe për të treguar realizimin e fitimit, ose mbledhjen e prodhimeve bujqësore.[1]

Por pranga e vënë rreth qafës, në disa raste, mund të jetë edhe e gjerë dhe për këtë shkak, ajo ushtron shtrëngim edhe mbi nofullat. Ky shtrëngim bën që koka të vështrojë lart. Nga kjo mënyrë prangosjeje, i prangosuri provon ndëshkim mbi ndëshkim dhe nga dhimbja që i shkakton lëvizja e kokës, ai nuk është në gjendje të shohë as gjymtyrët e tij.

Sa bukur e krahason Kur'ani Famëlartë gjendjen e idhujtarëve me gjendjen e këtij njeriu me pranga në qafë! Në të vërtetë, ata e kanë prangosur veten me "traditën e verbër", ata e kanë lidhur këtë traditë të verbër me zinxhirin e "zakoneve e të traditave mitike" dhe janë këto pranga të rënda e të gjera që i bëjnë kokat e tyre të vështrojnë përpjetë dhe nuk i lënë të shikojnë të vërtetën. Nga ndjekja e traditave të verbra, ata janë bërë si robër lufte, të lidhur me zinxhirë të rëndë, që s'kanë mundësi as të lëvizin e as të merren me veprimtari, madje nuk kanë as fuqi për të parë e për të shikuar punët.[2]

---

1 Fjalori "Mufredàtu El Fadhil Kur'àn", i autorit Ragib El Isfehànij, fjalori "Kutrul Muhijt" dhe tefsiri "Mexhmaul Bahrejn", Lënda "Gal".

2 Nga sa thamë më sipër, është bërë e qartë se përemri i gjinisë femërore *"hije" - "ato"*, në frazën "**do t'u arrijnë deri në mjekër**", u referohet prangave, të cilat, duke ushtruar trysni në nofulla, ua ngrenë atyre kokat lart; kurse fraza e fundit

Në të gjitha gjendjet, ajeti i mësipërm konsiderohet shpjegim i zgjeruar i gjendjes së asaj shtrese mohuesish në këtë botë e i gjendjes së tyre në Botën Tjetër. Në të vërtetë, Bota Tjetër është konkretizim në formë trupi i çështjeve të kësaj bote. Këtu s'ka asgjë që të na çudisë, përse është përdorur koha e shkuar, për të përshkruar Botën Tjetër, pasi shumë ajete të Kur'anit Famëlartë, flasin në kohën e shkuar, sa herë njoftojnë për ngjarje të pranuara, që do të ndodhin në të ardhmen. Fakti që Kur'ani flet për këto ngjarje në kohën e shkuar, argumenton se ngjarja e ardhshme, patjetër do të ndodhë, prandaj Kur'ani thotë se ngjarja ka ndodhur, por me këtë mënyrë paraqitjeje, ka mundësi që të tregojë për të dy kuptimet, domethënë: tregon gjendjen e mohuesve në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Një grup prej interpretuesve të Kur'anit, duke folur për shkakun e zbritjes së këtij ajeti dhe të ajetit vijues, ka thënë se këto dy ajete kanë zbritur për Ebu Xhehlin, ose për një burrë prej tribusë Makhzùm, ose për njërin prej kurejshëve, të cilët shpeshherë kishin këmbëngulur për të vrarë të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Por All'llahu i Lartësuar i ndaloi ata prej kësaj pune me rrugë mrekullie. Sa herë që ata bëheshin gati të godisnin Profetin Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, atyre u verboheshin sytë, ose u hiqej krejtësisht fuqia për të lëvizur.[1]

---

e ajetit "do të **jenë si të mpirë",** është shpjegim përforcues për këtë. Fjala që kanë thënë disa të tjerë, se përemri *"hije"* - *"ato"*, u referohet "duarve", megjithëse duart nuk janë përmendur në ajet, duket interpretim shumë i largët.
1 Tefsiri "Rùhul Meànij", vëll. 12, f. 199.

Megjithëkëtë, shkaku i zbritjes nuk është pengesë që kuptimi i ajetit të jetë përgjithësues dhe shumë më i gjerë, domethënë se në kuptimin e ajetit të përfshihen të gjithë krerët e mohuesve dhe të kokëngjeshurve. Në brendësi të saj, kjo shprehje është një përforcim për atë që thamë për komentimin e sifjalisë "**ata nuk besojnë**", domethënë se qëllimi i përdorimit të përemrit *"hum"* - *"ata"*, është të tregojë krerët e mohuesve e të hipokritëve dhe jo shumicën e idhujtarëve.

Ajeti vijues bën një përshkrim tjetër të gjendjes së atij grupimi dhe flet për faktorët e shkaqet që i bëjnë ata të mos i pranojnë të vërtetat. Në lidhje me këtë çështje, ajeti njofton: "**Ne kemi vënë pengesë para tyre dhe pas tyre e i kemi mbuluar."**. Ata kanë mbetur të rrethuar në mes këtyre dy pengesave e nuk gjejnë rrugë as të ecin përpara e as të kthehen prapa, sepse "**ata nuk shohin"**.

Shiko sa i bukur është ky përshkrim krahasues! Nga njëra anë, ata janë si robër lufte të lidhur me pranga e zinxhirë, nga ana tjetër, pranga e gjerë, e vënë në qafën e tyre, bën që ata ta mbajnë kokat lart, në drejtim të qiellit. Kjo gjendje i pengon të shohin sendet që kanë rreth vetes. Nga një anë e tretë, ata janë të rrethuar mes dy digave, para dhe prapa tyre, prandaj s'kanë mundësi as të ecin përpara e as të kthehen prapa. Nga një anë e katërt, ata "nuk shohin", sepse sytë e tyre e kanë humbur fuqinë për të parë.

Pa mendoni pak, se çfarë pret ai që është në këtë gjendje? Deri në ç'masë i kupton ai të vërtetat? Çfarë mundësie ka ai për të parë? Si ka mundësi që, në këtë gjendje, ai të hedhë hapat? E tillë është edhe gjendja e mendjemëdhenjve kokëfortë, ata janë të verbër e të shurdhuar për të parë e për të dëgjuar të vërtetat!

Për të gjitha këto, në ajetin e fundit të këtij grupi ajetesh, All'llahu i Lartësuar thotë: "**Për ata është njëlloj, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove, ata nuk besojnë."**.

Sado ndikuese të jetë fjala jote në zemër dhe sido që të jetë ndikimi i Shpalljes qiellore, nuk do të ketë asnjë ndikim, kur nuk gjejnë mjedisin e përshtatshëm. Dihet që, sikur mbi këtë mjedis me tokë të kripëzuar, të shndrisë Dielli për mijëra vjet dhe mbi këtë Tokë të binin shirat e begatë, apo mbi atë Tokë të frynte gjithmonë flladi i pranverës, prej asaj Toke nuk do të mbinte asnjë lloj bime, përveç shkurreve e gjembaçëve, pasi pranimi nga ana e pranuesit, është kusht që të jetë së bashku me veprimtarinë e vepruesit.

Hulumtime

1- Humbja e mjeteve të njohjes

Që njeriu të njohë mjedisin që e rrethon, ka nevojë të përfitojë prej rrugëve e mjeteve që quhen "mjetet e njohjes".

Një pjesë prej këtyre mjeteve janë të brendshme "bàtininjeh" dhe një pjesë janë të jashtme "dhàhirij'jeh".

Mendja, ndërgjegjja, besimi që është në natyrën e krijimit, janë mjete të brendshme të njohjes, kurse shqisat e trupit, sytë, veshët dhe shqisat e tjera, janë mjete të dukshme të njohjes.

Këtyre mjeteve, All'llahu i Lartësuar u ka dhënë fuqinë që ata të forcohen në mënyrë graduale dhe, kur njeriu arrin të përfitojë në mënyrë të drejtë e të saktë prej këtyre mjeteve, atëherë ai ka mundësi të dallojë të vërtetat në mënyrën më të mirë dhe me të gjitha hollësitë.

Por, kur këto mjete njohjeje përdoren në rrugë të gabuar, ose, kur prej këtyre mjeteve nuk është përfituar asgjë, atëherë këto mjete njohjeje trazohen në mënyrë të plotë dhe të vërtetat i pasqyrojnë në të kundërtën që janë, plotësisht ashtu si pasqyra, kur e ka mbuluar një shtresë e trashë pluhuri, ose, kur pasqyra është e gërvishtur, ose është e mbuluar me piklime mizash. Në këtë gjendje, mbi këtë pasqyrë, sendet nuk pasqyrohen, ose, edhe nëse pasqyrohen, figura që shihet mbi këtë pasqyrë nuk përputhet me realitetin.

Punët e gabuara dhe qëndrimet e shmangura janë shkaku që njeriut i hiqen mjetet e njohjes, thënë ndryshe, vetë njeriu, me punët e me qëndrimet e tij të padenja, shkakton që të mos i ketë këto dhunti të larta. Nga ky këndvështrim, ky njeri ka kryer krim ndaj vetes së tij.

Ajetet më lart, çështjen shumë të rëndësishme, që ka të bëjë me të ardhmen e njeriut, e krahasojnë dhe e shpjegojnë qartë se mendjemëdhenjtë, fanatikët që këmbëngulin në gjërat pa vlerë, egoistët dhe hipokritët, nga njëra i ngjasojnë të lidhurit me pranga e zinxhirë dhe, në fakt, ata janë të lidhur me zinxhirët e mendjemadhësisë, të pasioneve të ulëta, të mashtrimit e traditës së verbër. Të gjitha këto pranga e zinxhirë, janë vënë në qafat e në duart e tyre, kështu ata u ngjajnë të rrethuarve ndërmjet dy digave të forta, nëpër të cilat ata s'kanë mundësi të kalojnë.

Nga ana tjetër, edhe sytë e tyre janë të mbyllur dhe nuk mund të shikojnë.

Vetëm pranga e vënë në qafë dhe zinxhirët janë të mjaftueshëm për t'i penguar ata që të mos bëjnë asnjë lëvizje. Gjithashtu, edhe dy digat e mëdha janë të mjaftueshme që t'u ndalojnë atyre çdo lloj veprimtarie, duke shtuar se edhe verbimi i tyre është një faktor tjetër pengues, i pavarur në tërësinë e faktorëve të tjerë, që i privojnë ata nga çdo lloj mundësie.

Këto dy diga të larta, janë aq afër njëra me tjetrën, sa vetëm këto dy diga janë të mjaftueshme që t'u heqin atyre mundësinë për të parë; gjithashtu, këto dy diga janë të mjaftueshme që t'u heqin atyre mundësinë për të lëvizur. Shpesh kemi thënë se për njeriun ekziston mundësia që të udhëzohet në Rrugën e Drejtë, derisa ai nuk ka arritur në një shkallë kaq të ulët, por, pasi ka arritur deri në këtë gradë të ulët, edhe sikur të mblidheshin të gjithë Profetët së bashku, me të gjithë njerëzit e mirë dhe t'u lexonin atyre të gjithë librat qiellorë, as kjo nuk do të kishte qoftë edhe ndikimin më të vogël tek ata.

Në ajetet e Kur'anit dhe në transmetime, theksohet fuqishëm se, kur njeriu bën ndonjë shkarje prej Rrugës së Drejtë, ose kur bën ndonjë faj, ka detyrë që menjëherë të pendohet, t'i drejtohet All'llahut të Lartësuar, të kërkojë prej Tij faljen e mëkatit dhe të mos e shtyjë pendimin për në të ardhmen, por ta bëjë atë sa më shpejt dhe pa vonesë, madje, këtë ta bëjë me këmbëngulje e në mënyrë të përsëritur. Që njeriu të mos arrijë deri në këtë shkallë të ulët, ka detyrim të pastrojë ndryshkun që i ka zënë zemra, të shembë ndalesat e pengesat e vogla, para se ato të bëhen diga të mëdha.

Gjithashtu, detyra e tij është të ruajë rrugën e plotësimit ku ai ecën dhe të shkundë pluhurin që i ka rënë në të dy sytë, sepse vetëm duke vepruar në këtë mënyrë, ai ka mundësi të shohë e të kuptojë të vërtetat.

2- Digat para dhe prapa

Disa interpretues të Kur'anit, kanë shtruar pyetjen: Penguesi kryesor që ndalon vazhdimin e lëvizjes, është diga që ndodhet përpara njeriut, atëherë ç'kuptim ka diga prapa tij?

Kësaj pyetjeje, disa i janë përgjigjur: Për njeriun ka një udhëzim në Rrugën e Drejtë, në saje të natyrës së krijimit të tij, domethënë se njeriu ka një udhëzim që është në vetë njeriun, por për njeriun ka edhe një udhëzim teorik deduktiv. Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar sikur i thotë njeriut: "Ne para tyre kemi bërë një digë", domethënë: "Ne i kemi privuar ata të ecin në rrugën e udhëzimit teorik". Gjithashtu, "Ne bëmë një digë edhe prapa tyre", domethënë: Ne i pengojmë ata të kthehen në udhëzimin për në Rrugën e Drejtë me të cilin janë krijuar.[1]

Disa të tjerë kanë thënë se diga para tyre tregon pengesat që i ndalojnë ata të arrijnë Botën Tjetër dhe ecjen në rrugën e lumturisë së përjetshme, kurse diga prapa tyre i ndalon ata të arrijnë lumturinë në këtë botë.[2]

Është i mundur edhe interpretimi vijues: Kur atij që ecën, i zë rrugën një digë që është vënë para tij, ai e humb rastin të arrijë

1 Tefsiri "El Kebijr", vëll. 26, f. 45, fundi i ajetit objekt studimi.
2 Tefsiri i "Kurtubijjut", vëll. 15, f. 10, fundi i ajetit objekt studimi.

atje ku kishte qëllim të arrinte, prandaj ai kthehet, që të gjejë një rrugë tjetër, nëpër të cilën ka mundësi të arrijë atje ku kishte qëllim të arrinte. Por kur atij i mbyllet edhe rruga prapa tij, ai shumë shpejt e sheh veten se përfundimisht e ka të pamundur të arrijë atje ku kishte qëllim të arrinte.

Nisur nga kjo përgjigje, bëhet e qartë edhe përgjigjja për pyetjen vijuese: Përse nuk janë përmendur digat djathtas e majtas? Nuk janë përmendur, sepse njeriu nuk e arrin qëllimin e tij duke ecur majtas e djathtas. Përveç kësaj, diga zakonisht ndërtohet në një vend, dy anët e të cilit, ana e djathtë dhe ana majtë, janë të mbyllura dhe kalimi i vetëm nëpër atë luginë ishte vendi ku u ndërtua diga, e cila, pas ndërtimit të saj, e mbyll edhe këtë rrugë kalimi, kështu njeriu praktikisht mbetet në një rrethim të plotë.

3- Privim i plotë nga ecja në rrugët e horizonteve dhe të shpirtit

Njihen dy rrugë për njohjen e All'llahut:

E para: Të menduarit në shenjat e All'llahut, që janë në trupin njeriut e në shpirtin e tij. Këto shenja quhen "argumentet shpirtërore".

E dyta: Të menduarit te argumentet që gjenden në mjedisin rrethues, në Tokë, në Qiell, në yje e në planete, në male e në dete. Të gjitha këto quhen "argumente të horizontit". Për të dyja këto lloje argumentesh, Kur'ani Famëlartë flet në ajetin 53 të sures "Fus'silet": "Ne do të bëjmë që ata të shohin argumentet Tanë në horizonte e në veten e tyre, derisa atyre t'u bëhet e qartë se Ai (All'llahu) është i vërtetë.".

Por, kur njeriu e humb fuqinë e njohjes, për atë mbyllet njëherësh rruga që të shikojë te argumentet shpirtërore dhe te argumentet që janë në horizont.

Në ajetet e mësipërme, sidomos në ajetin: "**Ne do t'u vëmë në qafë vargonj, të cilët do t'u arrijnë deri në mjekër, e kështu do të jenë si të mpirë.**", tregohet kuptimi i parë, sepse prangat i ngrenë lart kokat e tyre, në atë mënyrë që ata s'kanë mundësi të shohin as veten. Kështu edhe digat, para e prapa tyre, i ndalojnë ata të shohin çfarë ka rreth tyre dhe sado që të hedhin sytë për të parë, ata nuk do të shohin gjë tjetër përveç dy digave. Me këtë ata janë të privuar të shohin argumentet që janë horizont.

Ajetet 11 – 12

﴿إِنَّمَا تُنْذِرُ مَنِ اتَّبَعَ الذِّكْرَ وَخَشِيَ الرَّحْمَنَ بِالْغَيْبِ فَبَشِّرْهُ بِمَغْفِرَةٍ وَأَجْرٍ كَرِيمٍ۝١١ إِنَّا نَحْنُ نُحْيِي الْمَوْتَى وَنَكْتُبُ مَا قَدَّمُوا وَآثَارَهُمْ وَكُلَّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ فِي إِمَامٍ مُبِينٍ۝١٢﴾

"**Në të vërtetë, paralajmërimi yt i sjell dobi vetëm atij që ndjek Këshillën** (Kur'anin) **dhe i frikësohet të Gjithëmëshirshmit, edhe pa e parë Atë. Këtij jepi lajmin e mirë për falje gjynahesh dhe shpërblim bujar!"**

"**Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e** (punëve të) **tyre. Ne e kemi llogaritur çdo gjë në një Libër të qartë."**

Komentimi

Kush e pranon paralajmërimin tim?

Në ajetet 1-10 të sures "Jâ Sîn", flitet për atë grup njerëzish që nuk kanë gatishmërinë të pranojnë paralajmërimet hyjnore, prandaj për ata janë të barabartë si paralajmërimi, ashtu edhe

mosparalajmërimi. Në ajetet 11-12, flitet për një shtresë tjetër, që është e kundërta e shtresës për të cilën flisnin ajetet 1-10 dhe sipas metodës shpjeguese të Kur'anit, kjo mënyrë shpalosjeje bëhet me qëllim që të qartësohet kërkesa për të bërë krahasimin mes dy shtresave.

Ajeti 11 thotë: "**Në të vërtetë, paralajmërimi yt i sjell dobi vetëm atij që ndjek Këshillën** (Kur'anin) **dhe i frikësohet të Gjithëmëshirshmit, edhe pa e parë Atë. Këtij jepi lajmin e mirë për falje gjynahesh dhe shpërblim bujar!"**.

Këtu duhet të mbajmë shënim çështjet vijuese:

1- Në këtë ajet, janë përmendur dy cilësi të njerëzve që kanë ndjekur këshillat e paralajmërimet hyjnore. Këto dy cilësi janë: "ndjekja e Kur'anit" dhe "frika ndaj All'llahut pa e parë me sy". Pa dyshim, qëllimi me këto dy cilësi është theksimi i gatishmërisë vetjake dhe i "fuqisë" së njohjes, me të cilën janë pajisur njerëzit, domethënë paralajmërimi ndikon vetëm te ata individë që dëgjojnë me vëmendje dhe zemrat i kanë të përgatitura të pranojnë të vërtetën. Në këta individë, paralajmërimi lë dy shenja:

Shenja e parë: Ndjekja e këshillës dhe e Kur'anit Famëlartë;

Shenja e dytë: Ndjenja e frikës para All'llahut dhe e përgjegjësisë.

Thënë ndryshe, këto dy gjendje te këta individë, në saje të "fuqisë" së brendshme për të njohur, që ata kanë, janë të dukshme në punën e tyre. Këta individë, pasi janë paralajmëruar, janë e kundërta e mohuesve, të cilët i kanë zemrat të verbuara dhe janë krejtësisht të shkujdesur, pasi mohuesit nuk kanë veshë të

dëgjojnë me vëmendje dhe janë prej atyre që kurrë nuk kanë frikë prej All'llahut.

Ajeti 11 është i ngjashëm me ajetin 2 të sures "El Bekare", ku lexojmë: "Ky është libri, në të cilin s'ka dyshim dhe është udhëzues për të devotshmit.".

2- Shumë interpretues të Kur'anit janë shprehur se qëllimi i përdorimit të fjalës e ajetit *"edh dhikru"* është "Kur'ani Famëlartë" sepse, në Kur'anin Famëlartë, fjala *"edh'dhikru"*, është përmendur shpesh për të shprehur këtë kuptim.[1] Por s'ka asnjë ndalesë se qëllimi i përdorimit të kësaj fjale mund të jetë edhe kuptimi gjuhësor i saj: përkujtim. Në këtë përkujtim, përfshihen të gjitha ajetet e Kur'anit dhe të gjitha paralajmërimet e Profetëve, që janë udhëheqësit hyjnorë.

3- Fjala e ajetit *"khashije"* - *"ka frikë"*, siç kemi shpjeguar edhe më sipër, është në kuptimin e frikës, të përzier me ndjenjën për madhështinë e All'llahut të Lartësuar; kurse fjala vijuese e ajetit *"err rrahmàn"* - *"i Gjithëmëshirshmi"*, këtu thekson mëshirën gjithëpërfshirëse të All'llahut. Kjo cilësi e bukur e All'llahut, ka një kuptim shumë ndikues e të bukur dhe do të thotë se ky individ e ndien frikën prej madhështisë së All'llahut.

Në të njëjtën kohë, fjala *"err rrahmàn"* - *"i Gjithëmëshirshmi"*, është edhe në kuptimin: ai individ e shpreson mëshirën e All'llahut. Me fjalë të tjera, te këta individë, frika dhe shpresa janë

1 Shiko suren "En Nahl", ajetin 44; suren "Es Saff", ajetin 41; suren "Ez Zukhruf", ajetin 44; suren "El Kamer", ajetin 25. Në të njëjtën kohë, fjala e ajetit *"edh'dhikru"* - "përkujtim", në Kur'anin Famëlartë, ka ardhur në kuptimin e përkujtimit pa kushte.

në baraspeshë të plotë, çka përbën një faktor për lëvizje të vazhdueshme plotësuese.

Këtu të tërheq vëmendjen fakti se fjala *"All'llah"*, në disa ajete të Kur'anit, ku flitet për shpresën, përfaqëson frikën dhe madhështinë, ashtu siç e lexojmë në ajetin 21 të sures "El Ahzàb": "Ai që shpreson në All'llahun (shpërblimin e All'llahut) dhe në Botën Tjetër.". Ajeti shpjegon qartë se shpresa, patjetër, duhet të jetë e shoqëruar me frikën ndaj All'llahut, por edhe kjo frikë patjetër duhet të jetë e shoqëruar me shpresën. (Mendo!)

4- Fjala e ajetit *"bil gajbi"*, këtu tregon rrugën për njohjen e All'llahut me anë të kërkimit të argumenteve, sepse All'llahu i Lartësuar, në raport me shqisat e njeriut, është i padukshëm, prandaj njohja e All'llahut dhe pamja e bukurisë së Tij, mund të realizohet vetëm me shikimin e zemrës, nëpërmjet shenjave që vërtetojnë madhështinë e All'llahut të Lartësuar.

Gjithashtu, fjala *"bil gajbi"*, mund të jetë edhe në kuptimin: i fshehur prej syve të njerëzve, domethënë se frika ndaj All'llahut nuk duhet të shprehet vetëm me fjalë, sepse kështu merr formën e hipokrizisë. Në të kundërt, frika ndaj All'llahut patjetër duhet të jetë e fshehtë, e brendshme.

Disa interpretues të Kur'anit, fjalën *"bil gajbi"*, e kanë interpretuar në kuptimin e Kiametit, sepse vetëm atë ditë, të gjitha punët e fshehura, që nuk i kapin shqisat tona, do të jenë të dukshme. Interpretimi i parë është më shumë në përshtatje me kuptimin e kësaj fjale.

5- Togfjalëshi i ajetit *"fe besh'shirhu"* - *"përgëzoje atë"*, në të vërtetë, është plotësim i paralajmërimit, pasi i Dërguari i

All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në fillim paralajmëron dhe, kur njeriu ndjek Kur'anin dhe i frikësohet madhështisë së All'llahut, këto dy cilësi janë të dukshme te fjalët dhe te puna e tij. Pikërisht në këtë fazë, All'llahu i Lartësuar e përgëzon atë.

Me çfarë e përgëzon? Në radhë të parë, e përgëzon me atë që ka shqetësuar mendimet e të gjithëve më shumë se çdo gjë tjetër: shkarjet që bën njeriu. Por All'llahu i Lartësuar, për shkak të ndjekjes së Kur'anit dhe të frikës ndaj madhështisë së Tij, do t'ia falë të gjitha shkarjet dhe më pas do t'i japë një shpërblim bujar, një shpërblim shumë të vyer, masën dhe llojin e të cilit nuk e di askush, përveç All'llahut të Lartësuar.

Gjithashtu, në këtë ajet bie në sy se fjala *"magfiretun"* - *"falje mëkatesh"* dhe te togfjalëshi *"exhrin kerijm"* - *"shpërblim bujar"*, ka ardhur në trajtën e pashquar. Ne dimë se përdorimi i trajtës së pashquar në çështje të tilla, është për të njoftuar sa e madhe do të jetë falja e mëkateve dhe sa i madh do të jetë shpërblimi bujar.

6- Disa interpretues të Kur'anit, mendojnë se germa *"f"*, në togfjalëshin *"fe besh'shirhu"* - *"përgëzoje atë"*, është për diferencim dhe tregon se ata që ndjekin "dhikrin", përkujtimin, Kur'anin dhe kanë frikë All'llahun, rezultati i kësaj pune për ata është vetëm falja e mëkateve dhe shpërblimi bujar. Siç shihet, në fillim është renditur "falja e mëkateve", pastaj vjen "shpërblimi bujar".

Në ajetin vijues, në përshtatje me temën që trajton ajeti 11, rreth shpërblimit bujar, për ata që besojnë në paralajmërimet hyjnore me të cilat kanë ardhur Profetët, ajeti 10 trajton çështjen e ringjalljes pas vdekjes, librit të punëve, llogaridhënien dhe

shpërblimin, ose dënimin. Ajeti i nderuar njofton: "**Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit…"**.

Përdorimi i përemrit të vetës së parë në numrin shumës *"nehnu"* - "Ne", tregon fuqinë e madhe që në mesin tonë dihet se përfaqëson All'llahun e Lartësuar. Gjithashtu, ky përemër tregon se u pritet rruga pyetjeve rreth mënyrës së ringjalljes së kockave të kalbura dhe rreth mënyrës se si do të rikthehet shpirti te trupi, për herë të dytë. Çështja e fuqisë së All'llahut nuk kufizohet vetëm në ringjalljen e të vdekurve, por edhe në: "**shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e** (punëve të) **tyre.**", që tregon për "librin e punëve", në të cilin është regjistruar çdo punë që njeriu ka bërë në këtë botë, qoftë e vogël apo e madhe. Ky libër ruhet për t'u hapur në Ditën e Llogaridhënies.

Sifjalia e ajetit *"mà kad'demù"* - "**shënojmë veprat që kanë bërë**", tregon punët që ata kanë bërë, prej të cilave s'ka mbetur asnjë gjurmë. Kurse togfjalëshi "وَآثَارَهُمْ" *"uàthàrehum"* - " **gjurmët e** (punëve të) **tyre**", tregon punët që kanë mbetur pas vdekjes së njerëzve. Këto gjurmë pasqyrohen në mjedisin rrethues, siç mund të jetë, për shembull, një sadaka vijuese (vakëfet: ndërtesa dhe qendra bamirësie të llojeve të ndryshme që mbeten pas vdekjes së njeriut dhe prej të cilave përfitojnë njerëzit).

Gjithashtu, sifjalia *"mà kad'demù"* - " **veprat që kanë bërë**", mund të tregojë edhe punët anësore vetjake, kurse togfjalëshi *"uàthàrehum"* - "gjurmët e tyre", tregon punët që bëhen model, si rrugë veprimi për t'u ndjekur dhe që sjellin mirësi e begati pas vdekjes së njeriut. Por "gjurmët" mund të jenë edhe të atilla që sjellin sherr, mëkate e faje. Kuptimi i ajetit është shumë i gjerë dhe në të mund të përfshihen të dy interpretimet.

Më pas, ajeti, për të shtuar përforcimin, thekson: **"Ne e kemi llogaritur çdo gjë në një Libër të qartë."**.

Shumica e interpretuesve të Kur'anit, janë shprehur se këtu togfjalëshi i ajetit **"në një Libër të qartë"**, është në kuptimin e *"leuhi mahfùdh"*, libri ku janë regjistruar dhe ruhen të gjitha punët, qeniet dhe ngjarjet që ndodhin në këtë botë.

Fjala e ajetit *"imàmin"*, mund të tregojë se ky Libër, në Ditën e Gjykimit do të jetë udhërrëfyes për engjëjt e ngarkuar me detyrën e shpërndarjes së shpërblimit ose të dënimit, ose është kriter për vlerësimin e punëve të njerëzve dhe për të caktuar masën e shpërblimit ose të dënimit, sipas punëve të regjistruara në këtë libër.

Vlen të mbahet shënim se fjala *"imàm"*, në disa ajete të Kur'anit Famëlartë ka ardhur për të shprehur Teuratin, ashtu siç e lexojmë në fjalën e All'llahut të Lartësuar, në ajetin 17 të sures "Hùd": "Ai që bazohet mbi një argument prej Zotit të tij dhe që e përforcon një dëshmues prej tij (Kur'àni); edhe më parë libri i Musait ishte prijës dhe mëshirë.".

Përdorimi i fjalës *"imàmin"*, në mënyrë të pakushtëzuar në këtë ajet, ka ardhur për të treguar Teuratin dhe flet për njohuritë, dispozitat dhe urdhrat e ardhura në Teurat, si dhe për shenjat që jepen në të, në lidhje me ardhjen e Profetit të Islamit, Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për të gjitha këto, Teurati mund të jetë udhëheqës e prijës për njerëzimin. Bazuar mbi këtë fjalë të shkruar në Librin e All'llahut, rezulton se kuptimi i kësaj fjale është në përputhje me kuptimin e saj origjinal, në të gjitha ajetet ku është përdorur.

Dy hulumtime

1- Llojet e librave me të cilët vërtetohen punët e njerëzve

Prej ajeteve të Kur'anit, mësohet se punët e njerëzve shkruhen dhe ruhen në më shumë se një libër dhe kështu, në Ditën e Llogaridhënies, nuk ka më vend, as për dëshmitarë e as për justifikim.

Libri i parë, është "regjistri i punëve vetjake", në të cilin janë të numëruara, një për një, të gjitha punët që bën individi gjatë jetës së tij, ashtu siç e lexojmë në fjalën e All'llahut të Lartësuar, në ajetin 14 të sures "El Isrà": "Lexoje librin tënd, sot është e mjaftueshme t'i bësh llogarinë vetvetes.".

Atë ditë, britmat e thirrjeve të kriminelëve do të ngrihen në kupën e qiellit, ashtu siç e lexojmë fjalën e All'llahut të Lartësuar, në ajetin 49 të sures "El Kehf": "Ata do të thonë: 'Të mjerët ne, si është puna me këtë libër që s'ka lënë (mëkat) as të vogël e as të madh pa e numëruar.'".

Këtë libër, punëmirët do ta marrin në dorën e djathtë, kurse punëkëqijtë e marrin atë në dorën e majtë. (Sure "El Hàk'kah", ajetet 19 dhe 25.)

Libri i dytë, regjistri i punëve të ymetit (bashkësisë së besimtarëve dhe jobesimtarëve). Në këtë libër janë shkruar qartë linjat shoqërore të jetës së ymetit, ashtu siç njofton Kur'ani Famëlartë, në ajetin 28 të sures "El Xhàthijeh": "çdo popull do të thirret te libri i vet".

Libri i tretë, *"el leuhul mahfùdh"*, libri i përgjithshëm, i ruajtur, ku janë regjistruar jo vetëm punët e njerëzve të mëparshëm e të mëvonshëm, por të gjitha ngjarjet botërore. Ky libër është një dëshmi tjetër për punët e njerëzve në atë vendgrumbullim të madh. Në të njëjtën kohë, ky libër është udhërrëfyes edhe për engjëjt e ngarkuar me çështjet e llogaridhënies, si dhe për engjëjt e ngarkuar me zbatimin e vendimit për dhënien e shpërblimit dhe për zbatimin e dënimit.[1]

2- Çdo gjë ne e kemi regjistruar

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: I Dërguari i All'llahut ndaloi në një vend pa bimësi dhe u tha shokëve të tij: *"Më sillni dru."*.

Ata i thanë: *"O i Dërguari i All'llahut, këtu jemi në një vend pa bimësi."*.

Atëherë ai tha: *"Çdonjëri prej jush le të sjellë aq sa ka mundësi."*.

Ata sollën ato që kishin dhe i hidhnin para tij njëra mbi tjetrën. Ndërkaq, i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Kështu grumbullohen njëri mbi tjetrin edhe mëkatet. Bëni kujdes prej mëkateve, që ju bëjnë të urryer, sepse për çdo send, ka një kërkues. Vini re, kërkuesit e atij sendi i shkruhen punët me të cilat është paraqitur, si dhe*

1 Referohu në këtë tefsir, në fundin e ajetit 39 të sures "Er Rra'd" dhe në ajetin 59 të sures "El En'àm".

gjurmët e mbetura prej punëve të tyre. Ne e kemi regjistruar çdo gjë në librin e qartë.".[1]

Ky transmetim, tregon në mënyrë konkrete grumbullimin e fajeve të vogla, por që prej atyre mund të ndizet një zjarr i madh, me flakë të gjata.

Në një hadith tjetër, lexojmë se ata të fisit Beni Selemeh banonin në periferi të Medines dhe deshën të shpërnguleshin afër xhamisë. Me këtë rast, zbriti ajeti: "Pa dyshim, Ne i ngjallim të vdekurit dhe Ne shkruajmë ato me të cilat janë paraqitur dhe gjurmët e tyre.".

Atëherë i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Gjurmët tuaja shkruhen."*, domethënë: shkruhen hapat që ju hidhni për të ardhur në xhami dhe për ato do të shpërbleheni. Pas kësaj fjale, ata nuk u shpërngulën.[2]

Tani u bë e qartë se kuptimi i ajetit është shumë i gjerë e gjithëpërfshirës. Gjithashtu, kuptimi i këtij ajeti është kriter vërtetues për çdo punë që ne përmendëm.

1 Tefsiri "Nùruth Thekalejn", vëll. 4, f. 378.

2 Tefsiri i "Kutubij'jit", vëll. 10, f. 12; hadithi është cituar prej Ebu Seijd El Khuderij, ashtu siç ka ardhur në "Sahijhun" e Tirmidhiut. Një hadith i ngjashëm, i përcjellë prej Xhabir bin Abdullah El Ensariut, ka ardhur edhe në "Sahihun" e Muslimit. Interpretues të tjerë të Kur'anit, si: El Alusij'ji, Fakhru Rrazij, Et Tabrasi dhe dijetari poliedrik Et Tabatabaij, e kanë cituar këtë hadith me pak ndryshime në fjalë.

Ajetet 13 – 19

﴿وَاضْرِبْ لَهُمْ مَثَلًا أَصْحَابَ الْقَرْيَةِ إِذْ جَاءَهَا الْمُرْسَلُونَ١٣ إِذْ أَرْسَلْنَا إِلَيْهِمُ اثْنَيْنِ فَكَذَّبُوهُمَا فَعَزَّزْنَا بِثَالِثٍ فَقَالُوا إِنَّا إِلَيْكُمْ مُرْسَلُونَ١٤ قَالُوا مَا أَنْتُمْ إِلَّا بَشَرٌ مِثْلُنَا وَمَا أَنْزَلَ الرَّحْمَنُ مِنْ شَيْءٍ إِنْ أَنْتُمْ إِلَّا تَكْذِبُونَ١٥ قَالُوا رَبُّنَا يَعْلَمُ إِنَّا إِلَيْكُمْ لَمُرْسَلُونَ١٦ وَمَا عَلَيْنَا إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ١٧ قَالُوا إِنَّا تَطَيَّرْنَا بِكُمْ لَئِنْ لَمْ تَنْتَهُوا لَنَرْجُمَنَّكُمْ وَلَيَمَسَّنَّكُمْ مِنَّا عَذَابٌ أَلِيمٌ١٨ قَالُوا طَائِرُكُمْ مَعَكُمْ أَئِنْ ذُكِّرْتُمْ بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ مُسْرِفُونَ١٩﴾

"Përmendu atyre shembullin e banorëve të qytetit, kur u erdhën të dërguarit."

"Ne u dërguam atyre dy vetë, që ata i quajtën gënjeshtarë. Pastaj i përforcuam të dërguarit me një të tretë e ata thanë: 'Ne, me të vërtetë, jemi dërguar te ju!'"

"Banorët u thanë: 'Ju jeni vetëm njerëz si ne, e i Gjithëmëshirshmi nuk ju ka Shpallur asgjë; ju vetëm gënjeni.'"

"Ata u përgjigjën: 'Zoti ynë e di që ne jemi vërtet të dërguar te ju.'"

"Dhe kemi detyrë vetëm që të shpallim qartë."

"Banorët thanë: 'Ne parandiejmë fatkeqësi nga ju. Nëse nuk tërhiqeni, do t'ju gurëzojmë dhe me siguri do t'ju godasë një dënim i dhembshëm prej nesh.'"

"Ata u përgjigjën: 'Fatkeqësia, që ju ndollët, mund të vijë vetëm nga vetja juaj. Vallë, për shkak se po ju këshillojmë, na kërcënoni?! Ju jeni popull që kaloni çdo lloj kufiri.'"

Komentimi

Sillu atyre shembullin e banorëve të atij vendbanimi

Në vijim të studimeve që pamë në ajetet më lart, që flisnin për Kur'anin, profetësinë e të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për besimtarët e sinqertë dhe për mohuesit kokëngjeshur, ajetet objekt studimi shpalosin një model prej qëndrimit të popujve të mëparshëm, në lidhje me këtë çështje. Ky grup ajetesh dhe disa ajete vijuese, që në tërësi janë tetëmbëdhjetë ajete, flasin për historinë e disa Profetëve të mëparshëm, të cilët u dërguan për të udhëzuar në Rrugën e Drejtë adhuruesit e idhujve, që i vinin shok All'llahut në adhurim. Këta adhurues, Kur'ani Famëlartë, i emërton me togfjalëshin "*as'hàbel karjeti*" - "**banorëve të qytetit**" dhe tregon se ata, jo vetëm që i kundërshtuan Profetët që u erdhën, por edhe i përgënjeshtruan. Patjetër që fundi i atyre mohuesve nuk mund të

ishte tjetër veçse dënimi i dhimbshëm. Me këtë shembull, nga njëra anë, u tërhiqej vëmendja idhujtarëve të Mekës dhe, nga ana tjetër, qetësohej e kënaqej i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, së bashku me besimtarët e paktë të atyre ditëve të para të fillimeve të Islamit. Në të gjitha gjendjet, përmendja e këtij tregimi, në zemrën e kësaj sureje, e cila vetë është quajtur zemra e Kur'anit, ka ardhur për shkak të ngjashmërisë së kushteve që paraqiten në këtë tregim me kushtet e myslimanëve të atyre ditëve.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh, njofton: "**Përmendu atyre shembullin e banorëve të qytetit, kur u erdhën të dërguarit."**.[1]

Fjala e ajetit *"el karjetu"*, në origjinë, është emër për një vend ku banojnë njerëz; herë tjetër, kjo fjalë thuhet edhe për një bashkësi njerëzish të mbledhur në një vend, prandaj kuptimi i kësaj fjale është shumë i gjerë dhe përmbledh qytete e fshatra e çdo vendbanim. Në leksikun e gjuhës arabe dhe në Kur'anin Famëlartë, shpesh fjala *"el karjetu"*, ka ardhur për të treguar qytete të rëndësishme, si për shembull: Egjiptin, Mekën etj.

Por, si quhej ky vendbanim, fshat apo qytet, që përmendet në këtë ajet?

Thënia më e përhapur në mesin e interpretuesve të Kur'anit është se me fjalën e ajetit *"el karjetu"* - *"vendbanim"*, qëllimi është për qytetin Entakijeh, që është njëri prej qyteteve të

1 Disa janë shprehur se togfjalëshi "**banorëve të qytetit**", sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe, është kundrinor i foljes *"idrib"* – "sillu", kurse fjala *"methelen"* - *"shembull"*, është kundrinor i dytë për të njëjtën folje. Disa të tjerë kanë thënë se folja tregon shembullin që urdhërohet të sjellë i Dërguari. Por peshorja anon më shumë nga interpretimi i parë.

rajonit të Shamit, ose, siç i thoshin bizantinët, Antakia, që numërohej prej qyteteve më të përmendura të tyre. Në ditët e sotme, gjeografikisht shtrihet në tokat që janë brenda kufirit të shtetit të Turqisë. Me lejen e All'llahut, në studimet vijuese do të trajtojmë me hollësi bisedën rreth këtij vendbanimi.

Në të gjitha gjendjet, prej ajeteve të kësaj sureje të nderuar, del qartë se banorët e atij vendbanimi ishin adhurues të idhujve dhe se të dërguarit u erdhën atyre që t'u bënin thirrje të besonin se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhid) dhe të hiqnin dorë nga vënia shok All'llahut në adhurim.

Pas kësaj paraqitjeje të përgjithshme, ajetet objekt studimi kalojnë në detajimin e ngjarjeve që ndodhën mes të dërguarve dhe banorëve të atij vendbanimi, ashtu siç njofton ajeti vijues: "**Ne u dërguam atyre dy vetë, që ata i quajtën gënjeshtarë. Pastaj i përforcuam të dërguarit me një të tretë e ata thanë: 'Ne, me të vërtetë, jemi dërguar te ju!'"**.[1]

Për sa i përket faktit se cilët janë këta të dërguar, disa interpretues të Kur'anit, pas debateve të zhvilluara mes tyre, kanë thënë se emrat e dy të dërguarve, janë: Shem'ùn dhe Johàn. I treti quhej Polis. Interpretues të tjerë mëtojnë emra të tjerë për tre të dërguarit e përmendur në ajetin objekt studimi.

Gjithashtu, në lidhje me këta tre të dërguar, ka një debat, nëse ata janë të dërguar të All'llahut të Lartësuar, apo janë të dërguar prej Mesijhut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Por në mesin e interpretuesve të Kur'anit, nuk ka kundërshtim për sifjalinë e

1 Disa interpretues të Kur'anit, kanë thënë se fjala e ajetit *"idh"* - "kur", këtu tregon "banorët e qytetit". Të tjerë kanë thënë se kjo fjalë ka lidhje me një folje të hequr. Vlerësimi, sipas këtij interpretimi, është: "kujtoju atyre".

ajetit *"idh erselnà"* - "Kur Ne dërguam", që të dërguarit prej Mesijhut të jenë edhe të dërguar të All'llahut. Në të vërtetë, fjalët e ajetit tregojnë se interpretimi i parë është në harmoni me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit. Veç kësaj, nuk ka dallim në raport me rezultatin që ka qëllim të specifikojë Kur'ani Famëlartë.

Tani, le të shikojmë si reagoi populli i atij qyteti, që kishte rënë në rrugën e humbjes ndaj thirrjes që bënë të Dërguarit. Për këtë çështje, Kur'ani Famëlartë thotë se ata iu përgjigjën të Dërguarve me të njëjtin justifikim mjeran, pas të cilit janë kapur gjithmonë shumica e mohuesve, në ballafaqimin e tyre me Profetët, ashtu siç e lexojmë në ajetin vijues: "**Banorët u thanë: 'Ju jeni vetëm njerëz si ne, e i Gjithëmëshirshmi nuk ju ka Shpallur asgjë; ju vetëm gënjeni.'"**.

Me mendjen e tyre, ata thoshin se, nëse është vendosur ardhja e një të Dërguari prej All'llahut të Lartësuar, i Dërguari patjetër duhet të ishte prej engjëjve që janë më afër All'llahut dhe jo një njeri i zakonshëm si ne. Ky ishte preteksti që ata nxirrnin për të përgënjeshtruar të Dërguarit dhe për të mohuar zbritjen e legjislacioneve hyjnore. Ka mundësi që ata të kishin dijeni se të gjithë Profetët, gjatë gjithë historisë, ishin prej pasardhësve të Ademit, ndër ta edhe Ibrahimi, miku i All'llahut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kumtin e të cilit ata e njihnin dhe e dinin se Ibrahimi ishte njeri, pa folur për faktin që i Dërguari, patjetër, duhet të ishte njeri, ndryshe si do të kuptonte një i Dërguar jo njeri nevojat, problemet dhe dhimbjet e njerëzve?

Këtu shtrohet edhe pyetja: Përse ajeti e thekson "mëshirën e përgjithshme" të All'llahut? All'llahu i Lartësuar, duke mundësuar mbartjen e kësaj cilësie në fjalët e njerëzve, kuptohet

se përgjigjja përmbahet në vetë fjalët e tyre, domethënë se All'llahu i Lartësuar, duke e përfshirë të gjithë botën me mëshirën e Tij, patjetër duhet të dërgojë edhe Profetë, për të edukuar shpirtrat e njerëzve, t'u bëjnë thirrje njerëzve të futen në rrugën e udhëzimit të drejtë dhe të plotësimit njerëzor.

Gjithashtu, ka mundësi që të Dërguarit, duke theksuar mëshirën gjithëpërfshirëse të All'llahut, donin t'u thoshin atyre se vetëm All'llahu është i Gjithëmëshirshmi, Ai i shikon njerëzit me dashamirësi e butësi dhe All'llahu kurrë nuk u shkakton probleme robve të Tij, duke u dërguar atyre Profetë, ndryshe do t'i linte ata në punën e vet! Me këtë thirrje, të Dërguarit u shpjegonin idhujtarëve të atij vendbanimi që të linin mënjanë mendimin e tyre të gabuar, se ardhja e Profetëve do t'u shkaktonte atyre probleme dhe të mos i paragjykonin të Dërguarit si këmbëtersë.

Në të gjitha gjendjet, Profetët që u erdhën atyre, as nuk u dëshpëruan prej kundërshtimit të atyre njerëzve që kishin rënë në rrugën e humbjes dhe as nuk shfaqën shenja dobësimi, por, përballë kundërshtimit të atyre idhujtarëve, ata thanë: "**Ata u përgjigjën: 'Zoti ynë e di që ne jemi vërtet të dërguar te ju.'"**.

Me këtë përgjigje, të Dërguarit ua bënë të qartë idhujtarëve dhe u thanë se përgjegjësia e tyre ishte të kumtonin kumtin hyjnor, ta shpjegonin atë në mënyrën më të qartë dhe vetëm kaq, ashtu siç e lexojmë në ajetin vijues: "K**emi detyrë vetëm që të shpallim qartë."**.

Është e qartë se këta të Dërguar nuk u mjaftuan vetëm me mëtimin e thjeshtë, ose me betimet se ata janë të dërguar prej All'llahut, por, ashtu siç mësohet prej togfjalëshit të ajetit "**të**

shpallim qartë" dhe për të vërtetuar fjalët që thanë, ata sollën argumente dhe bënë mrekulli, që dëshmonin vërtetësinë e thirrjes e të mëtimit të tyre, ndryshe nuk mund të miratohej vërtetësia e togfjalëshit "**të shpallim qartë"**. Por, kumtimi sa më qartë i kumtit, patjetër duhet të bëhet me një rrugë që i mundëson çdo individi, në të gjitha shoqëritë, ta kuptojë me lehtësi qëllimin e këtij kumti, por kjo mund të realizohet vetëm duke sjellë disa argumente dhe mrekulli që t'i shihnin të gjithë.

Në disa transmetime, tregohet se këta të Dërguar kishin "fuqi" të shëronin disa të sëmurë, madje edhe të sëmurë të atillë, shërimi i të cilëve ishte i pamundur, por ata i shëronin këta të sëmurë me lejen e All'llahut të Lartësuar, ashtu siç i shëronte të sëmurët Isai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Megjithëkëtë, idhujtarët, jo vetëm që nuk u nënshtruan para kësaj logjike të qartë dhe para atyre mrekullive që panë me sytë e tyre, por e shtuan edhe më shumë ashpërsinë në ballafaqimin e tyre me të Dërguarit. Me ashpërsinë që i karakterizonte, arritën deri aty sa i përgënjeshtruan të Dërguarit dhe më pas i kërcënuan se do t'i trajtonin me ashpërsi, ashtu siç e lexojmë në fjalinë e parë të ajetit vijues: "**Banorët thanë: 'Ne parandiejmë fatkeqësi nga ju.'"**.[1]

Ka mundësi të kenë ndodhur disa ngjarje negative te ata njerëz, gjatë kohës kur atyre u erdhën të Dërguarit e lartpërmendur, megjithëse ngjarjet me të cilat ata u goditën, në të vërtetë, ishin pasojë e mëkateve që ata bënin, ose ngjarjet që i

1 Në lidhje me fjalën e ajetit "*tetaj'jur*" - "*tersllëk*", është folur me hollësi në komentin e ajetit 131 të sures "El A'ràf" dhe në fundin e ajetit 47 të sures "En Neml".

goditën ata, mund të ishin edhe paralajmërime hyjnore për ta. Madje, disa interpretues të Kur'anit, kanë thënë se në tokën e tyre nuk ranë shira për një kohë të gjatë,[1] megjithëkëtë, ata jo vetëm që nuk nxorën mësim nga ky paralajmërim, por shpallën sheshit edhe qëllimet e tyre të liga, nëpërmjet gjuhës së kërcënimeve të hapura, kur u thanë të Dërguarve: "**Nëse nuk tërhiqeni, do t'ju gurëzojmë dhe me siguri do t'ju godasë një dënim i dhembshëm prej nesh."**.

Vallë, a është kërcënimi i tyre me "**dënim i dhembshëm"**, për të cilin flet ajeti, vetëm për të theksuar ashpërsinë e dënimit me gjuajtje me gurë?

Këtu janë dy mundësi dhe me sa duket, mundësia e parë është më afër të vërtetës, sepse dënimi me gjuajtje me gurë është prej llojeve më të zeza të ndëshkimit dhe mund të përfundonte me vdekjen e të dënuarit. Ka mundësi që, përmendja e togfjalëshit "**dënim i dhembshëm"**, të jetë një shenjë që u thotë të Dërguarve: ne do t'ju gjuajmë me gurë, derisa të vdisni; ose me këtë fjalë ata u thoshin të Dërguarve se, përveç gjuajtjes me gurë, ne do të ushtrojmë mbi ju lloje të tjera ndëshkimesh të dhimbshme, prej ndëshkimeve që praktikoheshin në kohët e hershme, siç ishte shpimi i syve me shufra të skuqura hekuri, ose derdhja e metalit të shkrirë në gojë, ose lloje të tjera torturash të ngjashme.

Disa interpretues të Kur'anit, janë shprehur se gurëzimi, tregon torturën trupore, kurse "**dënim i dhembshëm"**, është

1 Tefsiri i "Kurtubij'jit", ajetet objekt studimi.

ndëshkimi moral e shpirtëror.[1] Interpretimi i parë duket më i afërt me kuptimin e jashtëm që shpreh fraza e ajetit.

S'ka dyshim se ata që ndjekin rrugën e gabuar, rrugën e mizorisë, të padrejtësisë dhe të shkatërrimit, nuk kanë logjikën që t'u mundësojë atyre të ulen e të diskutojnë, sepse ata, në të vërtetë, gjithmonë mbështeten te kërcënimet, presionet e dhuna dhe nuk e kuptojnë se ata që ecin në Rrugën e All'llahut, kurrë nuk janë dorëzuar para kërcënimeve të këtilla. Në të kundërt, ata kanë vazhduar të ecin gjithnjë e më shumë në rrugën e tyre të drejtë, që në ditën e parë që këmba e tyre ka filluar të ecë në rrugën e thirrjes për të besuar All'llahun, Zotin Një e të Vetëm dhe në këtë rrugë, ata i kanë vënë shpirtrat e tyre nën nofullat e morsetës së torturave dhe janë të gatshëm për çdo lloj sakrifice e flijimi.

Në këtë pikë të kërcënimeve, vjen përgjigjja e të Dërguarve hyjnorë kundrejt përçartjeve të atyre idhujtarëve: "**Ata u përgjigjën: 'Fatkeqësia, që ju ndollët, mund të vijë vetëm nga vetja juaj. Vallë, për shkak se po ju këshillojmë, na kërcënoni?!'**".

Me këto fjali, të Dërguarit u thoshin atyre se, kur ju thoni se ju ndjek fati i keq, ose kur mbi ju bien ngjarje që ju bëjnë pesimistë, ose kur begatitë e All'llahut largohen prej jush, dijeni mirë se shkak për të gjitha këto janë ato që ju keni në thellësi të shpirtrave tuaj, në mendimet tuaja të degraduara e në punët tuaja të liga dhe jo në thirrjen tonë. Ju e keni mbushur botën tuaj të

1 Është kështu kur fjala e ajetit *"lenerxhumen'nekum"* - "ne do t'ju dënojmë me gjuajtje me gurë", është në kuptimin e sharjeve, të akuzave të ndryshme dhe të akuzave për imoralitet.

brendshme duke adhuruar idhujt, duke ndjekur dëshirat e ulëta dhe duke plotësuar epshet tuaja. Por me këto punë, ju vetë i ndërpretë begatitë që gëzonit prej mirësive të All'llahut të Lartësuar.

Një grup interpretuesish të Kur'anit, janë shprehur se fraza e ajetit *"ein dhuk'kirtum"* - "**Vallë, për shkak se po ju këshillojmë"**, është fjali e pavarur. Ata kanë thënë se kjo sifjali, do të thotë: "Mos vallë, për Profetët që erdhën te ju, të cilët ju këshilluan e ju paralajmëruan dhe për të gjitha këto, shpërblimi nga ana juaj është kërcënimi, ndëshkimi e dënimi, madje ju e konsideroni fatkeqësi praninë e tyre në mesin tuaj? Në një kohë që ne nuk sollëm te ju gjë tjetër veçse dritë, udhëzim në Rrugën e Drejtë, mirësi e begati. Vallë për një shërbim të tillë, përgjigjja juaj është kërcënimi e fjalët e këqija?!"[1]

Në fund, të Dërguarit u thanë atyre: "**Ju jeni popull që kaloni çdo lloj kufiri."**.

Në të vërtetë, problemi juaj është se ju e teproni në të gjitha punët, madje ju kaluat çdo kufi, kur mohuat të besoni se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm dhe i vutë shok All'llahut, duke adhuruar idhujt. Por dijeni, se shkaku për mohimin tuaj, përsëri është se ju e tepruat dhe nuk doni të shihni të vërtetën e qartë. Nëse shoqëria juaj ndihet pesimiste, përsëri shkaku për këtë është se ju tejkaloni çdo kufi me mëkatet që bëni, ju e ndotni veten me ndyrësinë e imoraliteteve dhe e fundit, ata që synojnë vetëm punën e mirë, ju i kërcënoni me vdekje. Edhe kjo sjellja juaj e vrazhdë, është për

1 Vlerësimi për sifjalinë *"ein dhuk'kirtum"* - "**Vallë, për shkak se po ju këshillojmë"**, është: Vetëm se ju këshilluam, na u kundërvutë me të këtilla punë? ose: A, pse ju këshilluam dhe ju mësuam të vërtetën e fjalës sonë?

shkak se e teproni në të gjitha drejtimet dhe i tejkaloni të gjitha caqet e arsyes.

Do të rikthehemi të shpjegojmë tregimin për këta njerëz dhe do të shikojmë si u ndodhi të Dërguarve që erdhën tek ata, por këtë do ta shikojmë gjatë komentimit të ajeteve të tjera, me të cilat plotësohet tregimi për këta të Dërguar.

Ajetet 20 - 27

﴿وَجَاءَ مِنْ أَقْصَى الْمَدِينَةِ رَجُلٌ يَسْعَى قَالَ يَا قَوْمِ اتَّبِعُوا الْمُرْسَلِينَ٢٠ اتَّبِعُوا مَنْ لَا يَسْأَلُكُمْ أَجْرًا وَهُمْ مُهْتَدُونَ٢١ وَمَا لِيَ لَا أَعْبُدُ الَّذِي فَطَرَنِي وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ٢٢ أَأَتَّخِذُ مِنْ دُونِهِ آلِهَةً إِنْ يُرِدْنِ الرَّحْمَنُ بِضُرٍّ لَا تُغْنِ عَنِّي شَفَاعَتُهُمْ شَيْئًا وَلَا يُنْقِذُونِ٢٣ إِنِّي إِذًا لَفِي ضَلَالٍ مُبِينٍ٢٤ إِنِّي آمَنْتُ بِرَبِّكُمْ فَاسْمَعُونِ٢٥ قِيلَ ادْخُلِ الْجَنَّةَ قَالَ يَا لَيْتَ قَوْمِي يَعْلَمُونَ٢٦ بِمَا غَفَرَ لِي رَبِّي وَجَعَلَنِي مِنَ الْمُكْرَمِينَ٢٧﴾

"Dhe nga skajet e qytetit erdhi një njeri, duke nxituar dhe tha: 'O populli im, ndiqni të Dërguarit!'"

"Ndiqni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi e që janë në Rrugë të Drejtë!"

"Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë?"

"Vallë, përse duhet të adhuroj zota të tjerë përveç Tij? Nëse i Gjithëmëshirshmi do të dëshironte të më godiste me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i atyre (zotave) **nuk do të më sillte kurrfarë dobie e as që do të mund të më shpëtonin."**

"Atëherë, unë do të isha me siguri në humbje të dukshme."

"**Unë i kam besuar Zotit tuaj, prandaj, më dëgjoni."**

"'(Pasi e vrau populli i vet, atij) **iu tha: Hyr në Xhennet!' Ai tha: 'Ah, sikur ta dinte populli im.'"**

"**Se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar."**

Komentimi

Luftëtarët në Rrugën e All'llahut, ngarkuan shpirtin e tyre mbi shpatullat e veta

Ajetet objekt studimi e vënë theksin mbi një anë tjetër të luftës së të Dërguarve të përmendur në këtë tregim dhe flasin për mbrojtjen e studiuar të besimtarëve të paktë në numër. Njëkohësisht, në këto ajete nxitet trimëria e besimtarëve kundrejt dhunës së mohuesve dhe idhujtarëve, që ishin shumicë. Gjithashtu, në këto ajete tregohet qëndrimi i atyre besimtarëve të paktë, që sfiduan mohuesit dhe mbrojtën të Dërguarit, deri në frymën e fundit.

Ajeti 20, fillon me njoftimin: "**Dhe nga skajet e qytetit erdhi një njeri, duke nxituar dhe tha: 'O populli im, ndiqni të Dërguarit!'"**.

Shumica e interpretuesve të Kur'anit, kanë thënë se ky burrë quhej Habib Marangozi *(Habijbu Nexh'xhàr)*, i cili ishte prej atyre njerëzve që dëgjonin me vëmendje fjalët e të Dërguarve;

ishte prej besimtarëve që e kishin kuptuar të vërtetën e thirrjes së të Dërguarve dhe hollësitë e mësimeve të tyre. Ai ishte një besimtar i vendosur në besimin e tij dhe, kur mori vesh se qendra e qytetit ishte e trazuar dhe njerëzit mund të vrisnin Profetët që kishin ardhur te ata, ai u nis me nxitim, ashtu siç kuptohet nga vetë kuptimi i foljes *"nxiton"*, derisa arriti në qendrën e qytetit, ku mbrojti të vërtetën me të gjitha fuqitë e tij dhe doli në mbrojtje të të Dërguarve, pa asnjë rezervë.

Fjala "njeri", në këtë ajet, ka ardhur në trajtën e pashquar, çka tregon se ai ishte njeri i zakonshëm dhe në shoqërinë ku jetonte, nuk kishte ndonjë gjë që e dallonte nga të tjerët. Megjithëkëtë, ai ecte i vetëm në rrugën e tij, në të njëjtën kohë ai hyri në betejën që zhvillohej në mes mohimit e besimit dhe doli në mbrojtje të së vërtetës. Qëndrimi i këtij njeriu ishte një mësim për besimtarët e kohës së të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, edhe pse në fillimet e Islamit ishin vetëm fare pak besimtarë, por, gjithsesi, barra e përgjegjësisë binte vetëm mbi shpatullat e tyre, prandaj, në atë kohë, heshtja ishte e papranueshme, qoftë edhe vetëm prej një individi.

Shprehja e ajetit *"aksal medijneti"* - "**skajet e qytetit"**, tregon se jehona e thirrjes së atyre të Dërguarve kishte arritur edhe në pikat më të largëta të qytetit dhe kishte ndikuar në zemrat e përgatitura për të pranuar besimin. Këtu duhet të kihet parasysh se, në rrethinat e qyteteve, zakonisht banojnë njerëz të varfër, por që kanë gatishmërinë jo vetëm të pranojnë të vërtetën më shumë se banorët e pasur të qendrës së qytetit, por ata besojnë sinqerisht në të vërtetën. Veç kësaj, banorët e rrethinave janë e kundërta e banorëve të qendrave të qyteteve, të cilët e kalojnë jetën në

mirëqenie ekonomike, çka e bën të vështirë që ata të pranojnë thirrjen për të besuar të vërtetën.

Shprehja tjetër e ajetit *"jà kaumi"* - "**O populli im"**, shpjegon qartë zjarrin që digjej në zemrën e atij besimtari të vendosur në besimin e tij dhe dhimbjen e fortë që ai ndiente për banorët e qytetit të tij, prandaj ai i këshillon ata të dëgjojnë të Dërguarit dhe t'i ndjekin ata, megjithëse kjo thirrje, atij si individ, nuk i sillte asnjë përfitim material.

Tani le ta shikojmë këtë burrë luftëtar në Rrugën e All'llahut, se me çfarë logjike dhe me çfarë argumentesh u flet banorëve të qytetit:

Në fillim, ai u thotë atyre: "**Ndiqni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi."**. Kjo thirrje e tij, në vetvete, është argumenti i parë që dëshmon të vërtetën e thirrjes së atyre Profetëve, të cilët, me thirrjen që u bënë banorëve të atij qyteti, nuk përfitonin asgjë materiale për veten e tyre; të Dërguarit nuk duan që ju t'i falënderoni; gjithashtu, ata nuk duan prej jush as shpërblim e as ndonjë përfitim tjetër.

Këtë të vërtetë, ajetet e Kur'anit e theksojnë disa herë në lidhje me Profetët e All'llahut. Gjithashtu, në ajetet e Kur'anit theksohet edhe sinqeriteti e pastërtia e zemrës së Profetëve. Çështja e moskërkimit shpërblim nga ana e Profetëve për thirrjen që kanë bërë, vetëm në suren "Esh Shuarà" përsëritet pesë herë, ashtu siç e lexojmë në ajetet: 109; 127; 145; 164 dhe 180 të kësaj sureje: "dhe për këtë unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim".

Nga përmbajtja e thirrjes dhe e fjalëve të tyre, burri besimtar u thotë njerëzve të atij qyteti se këta të Dërguar, veç të

tjerave, "**janë në Rrugë të Drejtë"**. Kjo frazë tregon se mospranimi i një thirrjeje, vjen për dy shkaqe: ose thirrja është e gabuar dhe është e atillë që çon në rrugën e humbjes, ose thirrja është e drejtë dhe e vërtetë, por ata që e bëjnë këtë thirrje, kanë qëllim që, me thirrjen që bëjnë, të kërkojnë të kenë përfitime vetjake, çka çon në shpërfytyrimin e vetë thirrjes. Por, kur thirrja është e drejtë dhe, kur me thirrjen nuk synohen përfitime vetjake, nuk ka më kuptim të ketë ngurrim për t'iu përgjigjur kësaj thirrjeje të drejtë e të vërtetë.

Ajeti vijues kalon në një argument tjetër, që flet për Njëtimin e All'llahut dhe konsiderohet kolona mbajtëse e thirrjes së Profetëve. Ajeti njofton: "**Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar?"**.

Ai që meriton të adhurohet, është vetëm Krijuesi, Sunduesi, Dhuruesi dhe jo idhujt, që as nuk dëmtojnë e as nuk sjellin dobi. Natyra e pastër e krijimit u thotë njerëzve: detyra juaj është të adhuroni vetëm Krijuesin dhe jo këto sende të rëndomta, të punuara me duart tuaja.

Vënia e theksit mbi fjalën *"fetarenij"* - "**më ka krijuar"**, mund të jetë një shenjë që tregon edhe kuptimin: Kur unë vështroj me kujdes në natyrën origjinale të krijimit tim, vë re fare qartë se, në thellësinë time, ka një zë që më bën thirrje të adhuroj Krijuesin. Këtë thirrje të brendshme unë e gjej në harmoni me mendjen. Si është e mundur që unë të mbyll sytë, kur këtë thirrje e përforcon natyra e pastër e krijimit tim dhe mendja ime?!

Këtu të tërheq vëmendjen fakti se ai njeri nuk tha se si është puna me ju, që nuk adhuroni All'llahun, Atë që ju krijoi, por thotë: "**Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar?"**.

Me këtë frazë, në radhë të parë, ai shtron pyetjen: Përse të mos besoj? Duke folur për veten e tij, patjetër që biseda do të ndikojë më shumë në shpirtin e dëgjuesve dhe pastaj ai u shpjegon atyre se kthimi dhe e ardhmja është vetëm te All'llahu, te i Gjithëfuqishmi: "**tek i Cili do të ktheheni të gjithë"**.

Domethënë: Mos mendoni se All'llahu ka dijeni për punët e për jetën tuaj vetëm në jetën e kësaj bote. Jo, e ardhmja juaj në Botën Tjetër, gjithashtu, është te All'llahu, prandaj orientojeni veten drejt Atij që e ka në dorë të ardhmen tuaj në të dyja botët.

Nga një anë e tretë, shikojmë rezultatin që ai arrin me bisedën që do të bëjë rreth idhujve dhe do të vërtetojë robërinë e tij të plotë vetëm për All'llahun e Lartësuar. Me këtë pohim, ai hedh poshtë adhurimin kushtuar idhujve dhe pastaj bisedën e tij e plotëson me një fjali pyetëse: "**Vallë, përse duhet të adhuroj zota të tjerë përveç Tij? Nëse i Gjithëmëshirshmi do të dëshironte të më godiste me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i atyre** (zotave) **nuk do të më sillte kurrfarë dobie e as që do të mund të më shpëtonin."**.

Këtu, ai njeri, përsëri, flet për veten e tij, por tani, në fjalën e tij, del qartë se ai nuk ka qëllim as të jetë sundues e as të jetë i parë mbi ta. Me fjalën e tij, ai i vë kufirin pretekstit kryesor të adhuruesve të idhujve, që thoshin: "Ne i adhurojmë idhujt, me qëllim që idhujt të ndërmjetësojnë për ne te All'llahu.". Me fjalën e tij, ai njeri u thotë atyre: "Çfarë ndërmjetësimi? Çfarë ndihme dhe çfarë shpëtimi prisni prej idhujve? Vetë idhujt kanë nevojë për ju, që t'i ndihmoni e t'i mbroni ata. Çfarë mundësie kanë idhujt, që të bëjnë ndonjë gjë për ju, kur gjendeni në gjendje të rënduar?".

Fjala *"err rrahmànu"* - "i Gjithëmëshirshmi", përveç faktit që tregon mëshirën e gjithanshme të All'llahut, në të njëjtën kohë, tregon se vetëm All'llahu është shkaku që ju gëzoni të gjitha të mirat e dhuntitë. Në vetvete, kjo shprehje është argument që vërteton se vetëm All'llahu meriton të adhurohet. Me fjalën e tij, ai njeri besimtar, e bën të qartë se i Gjithëmëshirshmi nuk dëshiron të dëmtohet asnjë njeri, por, kur njeriu, me veprimet e tij, në kundërshtim me urdhrin e All'llahut, arrin deri aty sa të dalë jashtë mëshirës së All'llahut, atëherë ai e ka hedhur veten në rrethin e zemërimit të All'llahut.

Më pas, ky besimtar, luftëtar në Rrugën e All'llahut, për të theksuar edhe më shumë fjalën e tij, thotë se, nëse unë do të adhuroj idhujt, në të vërtetë, i kam bërë idhujt shokë të All'llahut. Nëse unë do të adhuroj idhujt, vetëkuptohet që jam në rrugën e humbjes, madje në një humbje shumë të thellë, ashtu siç njofton ajeti vijues: "**Atëherë, unë do të isha me siguri në humbje të dukshme."**, domethënë, jam në humbjen më të madhe. Si është e mundur, që njeriu, i pajisur me mendje, të arrijë deri aty sa i vë këta trupa të ngurtë krah për krah me Krijuesin e qiejve e të Tokës?!

Kur ky besimtar, luftëtar i dalluar në Rrugën e All'llahut, i jep fund paraqitjes së këtyre argumenteve me kuptime ndikuese, shpall sheshit para të gjithëve: "**Unë i kam besuar Zotit tuaj, andaj, më dëgjoni!"**.

Cilët janë ata që ai u thotë: "**Unë i kam besuar Zotit tuaj, andaj, më dëgjoni?"**. Fjalët e ajetit tregojnë se ata ishin një grup idhujtarësh prej banorëve të atij qyteti, të cilët, duke adhuruar idhujt, i vinin shok All'llahut; kurse togfjalëshi "**Zotit**

tuaj", gjithashtu, nuk është në kundërshtim me këtë kuptim. Kjo shprehje ka ardhur në shumë ajete të Kur'anit Famëlartë dhe u drejtohet mohuesve, kur atyre u shtrohen argumentet që vërtetojnë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm.[1]

Edhe folja e ajetit "më dëgjoni", nuk është në kundërshtim me atë që thamë, sepse kjo ishte një thirrje drejtuar atyre idhujtarëve, që të dëgjonin e të ndiqnin fjalën e tij. Gjithashtu, kjo fjalë, është në përputhje edhe me atë që thuhet në ajetin 38 të sures "El Gàfir", në lidhje me besimtarin prej familjes së Faraoni, i cili tha: "O populli im, më ndiqni mua që t'ju udhëzoj në Rrugën e Drejtë.".

Këtu duhet të theksohet se, disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se në këtë ajet, fjala u drejtohet atyre të Dërguarve, kurse togfjalëshi "Zotit tuaj" dhe fjala tjetër "më dëgjoni", janë të afërta me këtë kuptim, por ata, për këtë interpretim, nuk kanë sjellë ndonjë argument të fuqishëm.

Tani le të shikojmë si qe reagimi i atyre idhujtarëve ndaj këtij besimtari të pastër.

Kur'ani nuk thotë ndonjë gjë në lidhje me qëndrimin e atyre idhujtarëve, por, prej ajeteve më poshtë, mësohet se ata u vërsulën kundër tij dhe e vranë.

Fjala e atij besimtari ishte ndikuese, fjala e tij ishte motiv për entuziazëm, fjala e tij ishte e mbushur me argumente të fuqishme, që nuk mund të kundërshtoheshin, ishte fjalë që depërtonte në zemër. Por fjalët e atij besimtari nuk mund të kishin

1 Shih ajetet 3 dhe 32 të sures "Jùnus"; ajetet 3 dhe 52 të sures "Hùd"; ajetin 24 të sures "En Nahl" dhe ajetin 29 të sures "El Kehf".

asnjë ndikim pozitiv mbi ato zemra të zeza, të mbushura vetëm me kurthe e me mashtrime, prandaj ndodhi e kundërta, fjalët e atij besimtari shtuan në zemrat e tyre edhe më shumë urrejtje e zemërim. Në zemrat e atyre mohuesve, fjalët e besimtarit shtuan edhe më shumë flakët e zjarrit të armiqësisë kundër të vërtetës, prandaj, jobesimtarët u hodhën kundër atij njeriu trim dhe e vranë atë në mënyrën më barbare që mund të mendohet. Thuhet se, kur ata e qëllonin atë me gurë, ai thoshte: "O Zoti im, udhëzoje popullin tim në rrugën e drejtë!".

Megjithatë ata e vranë njeriun besimtar.[1]

Në një transmetim tjetër, thuhet se ata e shkelmuan njeriun besimtar aq rëndë, derisa ai vdiq.[2]

Këtë të vërtetë, Kur'ani Famëlartë e bën të qartë me një frazë të shkurtër dhe thotë: **"**(Pasi e vrau populli i vet, atij) **iu tha: Hyr në Xhennet!"**.

E njëjta shprehje ka ardhur edhe në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë dhe konkretisht në ajetin 169 të sures "Àli Imràn", ku flitet për dëshmorët e rënë në Rrugën e All'llahut: "Mos mendoni se ata që u vranë në Rrugën e All'llahut janë të vdekur, jo, ata janë gjallë dhe ushqehen te Zoti i tyre.".

Këtu vlen të mbahet shënim se ajeti i Kur'anit njofton se hyrja e atij besimtari në Xhennet është e shoqëruar me rënien e tij dëshmor, kështu që koha ndarëse mes besimtarit që përmendet në ajetin objekt studimi dhe dëshmorit që vritet në luftë në Rrugën e All'llahut është aq e vogël, sa Kur'ani Famëlartë, me shprehjen e

1 Tefsiri i "Kurtubij'jit", vëll. 15, f. 18-19.
2 Tefsiri "Et Tibjàn", vëll. 8, f. 414.

tij dashamirëse, ka përmendur hyrjen e atij besimtari në Xhennet, në vend të rënies dëshmor, çka tregon sa e afërt është rruga e rënies dëshmor me arritjen e lumturisë së përhershme.

Është e qartë se, me fjalën "Xhennet", qëllimi është për Xhennetin e Berzakhut, pasi ajetet e Kur'anit Famëlartë dhe transmetimet, njoftojnë se Xhenneti i përjetshëm do të jetë për besimtarët në Ditën e Gjykimit. Gjithashtu, edhe Xhehennemi do të jetë pjesa që u takon mohuesve.

Bazuar mbi këtë shpjegim, rezulton se në botën e Berzakhut ka një Xhennet dhe një Xhehennem, që janë model i Xhennetit e i Xhehennemit, që do të shohin njerëzit në Ditën e Gjykimit. Në Kur'anin Famëlartë flitet shpesh për Xhennetin e për Xhehennemin. Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të Besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Varri është një kopsht prej kopshteve të Xhennetit, ose është një gropë prej gropave të zjarrit.*".[1]

Për sa i përket asaj që kanë thënë disa interpretues të Kur'anit, se kjo shprehje e ajetit tregon fjalët që do t'i thuhen këtij besimtari trim në Ditën e Gjykimit, se kjo shprehje tregon edhe të ardhmen e tij, duhet të pohojmë se ky interpretim është në kundërshtim me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.

Në të gjitha gjendjet, shpirti i pastër i këtij besimtari, pa dyshim që u ngrit lart, pranë mëshirës së All'llahut dhe ai gëzon mirësitë e Xhenneteve, prandaj besimtari dëshmor kishte vetëm një dëshirë, kur tha: **"Ah, sikur ta dinte populli im!"**.

1 "Bihàrul Enuàr", vëll. 6, f. 218.

Çfarë ishte ajo që ai kishte aq shumë dëshirë ta dinte populli i tij? Ajeti vijues e shpjegon qartë dëshirën e tij: **"Se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!"**.[1]

Me këto fjalë, besimtari thotë se, sikur ata të kishin sy që shikojnë të vërtetën. Por ata sytë i kanë të mbuluara me perden e trashë e të rëndë të interesave të kësaj bote, kështu që ata nuk i shohin dot mirësitë e mëdha dhe respektin që do të kenë prej All'llahut të Lartësuar. Besimtari ka dëshirë t'u thotë jobesimtarëve se, sikur ta dini, se me çfarë butësie e dashamirësie më ka rrethuar mua All'llahu kundrejt armiqësisë suaj kundër meje. Ah, sikur ata të shihnin dhe të besonin, por, është për të ardhur keq!

Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për këtë besimtar, lexojmë: *"Në të vërtetë, ai i këshilloi ata jo vetëm kur ishte gjallë, por i këshilloi edhe pas vdekjes së tij."*.[2]

Këtu duhet të shënohet, se ai besimtar, në fillim flet për mirësinë e madhe të faljes hyjnore, pastaj flet për nderimin. Kjo do të thotë se në fillim është detyrë që shpirti të lahet me ujin e faljes së mëkateve, që të jetë krejtësisht i pastër prej fajeve, pasi vetëm shpirti i pastër zë vendin që i takon në rrethin e afrimit dhe të nderimit hyjnor.

1 Në lidhje me pozicionin e fjalës *"mà"* - *"ato"*, interpretuesit e Kur'anit janë shprehur për tri mundësi dhe kanë thënë: është rrënjë foljeje, ose është përemër lidhor, ose është fjalë pyetëse. Mundësia për të qenë fjalë pyetëse, është shumë larg realitetit, kështu që më afër mbetet të jetë përemër lidhor, pasi edhe me mundësinë rrënjë foljeje, nuk ndryshon shumë në kuptim.
2 Tefsiri i "Kurtubij'jit", vëll. 8, f. 5464.

Gjithashtu, këtu duhet të theksohet se patjetër duhet të mendojmë mirë se nderimi e respekti do të jenë për shumicën e njerëzve, por duhet të dihet se, si rregull, nderimi shtohet e zmadhohet krahas shtimit të përkushtimit, ashtu siç e lexojmë këtë të vërtetë në ajetin 13 të sures "El Huxhuràt": "Më i nderuari juaj te All'llahu është më i devotshmi prej jush.". Gjithashtu, nderimi pa kushte, në Kur'anin Famëlartë ka ardhur për dy kategori të veçanta:

Kategoria e parë: "Engjëjt e afruar", ashtu siç e lexojmë në ajetet 26-27 të sures "El Enbijà": "Ata janë rob të nderuar. Ata nuk flasin para Tij dhe veprojnë vetëm me urdhrin e Tij.".

Kategoria e dytë: Njerëzit me gradën më të plotësuar të besimit. Për këtë kategori, Kur'ani Famëlartë flet në ajetin 35 të sures "El Meàrixh" dhe i quan "të sinqertët": "Ata janë në Xhennete dhe të nderuar.".[1]

Pa dyshim që kjo ishte e ardhmja e atij njeriu besimtar e luftëtar i vërtetë në Rrugën e All'llahut, i cili e kreu misionin e tij pa lënë asgjë mangët në mbrojtje të të Dërguarve hyjnorë. Në fund, piu edhe kupën e rënies dëshmor. Me rënien dëshmor, ai arriti të jetë pranë mëshirës së Zotit të Tij bujar.

Tani le të shikojmë si qe e ardhmja e atyre njerëzve vrasës, tiranë e mizorë.

Megjithëse Kur'ani Famëlartë nuk thotë asgjë si përfundoi puna e atyre tre Profetëve që u dërguan te ai popull, një grup interpretuesish të Kur'anit kanë thënë se ata mizorë i vranë të

1 Tefsiri "El Mijzàn", vëll. 17, f. 82.

Dërguarit, vranë edhe atë njeriun besimtar. Të tjerë janë shprehur se ai njeri i mirë punoi me mohuesit me fjalën e tij dhe ra dëshmor, që të shpëtonte të Dërguarit prej komploteve që idhujtarët kurdisën kundër tyre, madje ai u mundua t'i çonte të Dërguarit në një vend më të sigurt. Por zbritja e ndëshkimit të dhimbshëm hyjnor mbi ata njerëz, anon më shumë nga interpretimi i parë, ashtu siç është vetë shprehja e ajetit *"min ba'dihi"* - "pas tij", domethënë: ndëshkimi hyjnor zbriti mbi idhujtarët, pas rënies dëshmor të atij besimtari. Bazuar mbi këtë interpretim, thënia e dytë rezulton më e saktë. (Mendo mirë në këtë çështje.)

Hulumtime

1- Tregimi i të Dërguarve në Antakia

Antakia është prej qyteteve më të vjetra të Shamit dhe, sipas disa thënieve, është ndërtuar afërsisht treqind vjet para erës së re. Numërohej prej tri qyteteve më të mëdha romake të asaj kohe, nga ana e pasurisë, e dijes dhe e tregtisë.

Antakia është çliruar nga ushtria myslimane, që komandohej prej Ebu Ubejdetul Xherr'rràh, në kohën e kalifit të dytë. Banorët e qytetit pranuan të paguanin xhizjen dhe të mbeteshin në fenë e tyre.

Pas Luftës së Parë Botërore, qyteti ra nën pushtimin e francezëve dhe, kur francezët do të linin Shamin, territorin e këtij qyteti ata e bashkuan me tokat e Turqisë, nga frika se, pas largimit të tyre, banorët e Antakias, që ishin të krishterë, si francezët, do të përndiqeshin për shkak të fesë.

Për nga rëndësia fetare, qyteti i Antakias, për të krishterët, konsiderohet qyteti i dytë pas Kudsit (Jeruzalemit), ashtu siç e konsiderojnë myslimanët Medinen e ndritur. Të krishterët besojnë se Mesihu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* filloi ta shpallë thirrjen e tij në këtë qytet dhe më pas, së bashku me dy besnikët e tij, Polos dhe Barnaba,[1] pikërisht në Antakia, ata filluan të ftojnë njerëzit të besojnë Krishterimin, domethënë se Krishterimi filloi të përhapet nga Antakia. Rëndësia e madhe e këtij qyteti, theksohet edhe në Kur'anin Famëlartë.[2]

Et Tabrasi thotë në tefsirin "Mexhmaul Bejàn": "Isai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dërgoi dy misionarë prej apostujve të tij në qytetin e Antakias. Kur dy misionarët po i afroheshin qytetit, takuan një bari të moshuar që po kulloste dhentë e tij të pakta dhe e përshëndetën. Ky bari plak ishte Habibi, burri që përmendet në suren 'Jâ Sîn'.".

Bariu i moshuar i pyeti ata të dy se kush ishin.

---

1 "Polos" është prej misionarëve të krishterë të njohur dhe ka punuar shumë për përhapjen e Krishterimit, kurse Barnaba, emri origjinal i të cilit është Jusuf (Josif) ishte prej shokëve të Polos dhe të Markut. Barnaba ka shkruar një Ungjill të njohur, ku përmenden shumë përgëzime për ardhjen e Profetit të Islamit, por të krishterët nuk besojnë në vërtetësinë e Ungjillit të Barnabasë dhe thonë se këtë Ungjill e ka shkruar ndonjëri prej myslimanëve.

2 Tefsiri "Rùhul Xhinàn", margjinatura e dijetarit Esh Sha'aràni (Ndjesë pastë!).

Ata i thanë: "Jemi dy misionarë, që na ka dërguar Isai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe ai na ka ngarkuar me detyrën që t'u bëjmë thirrje të hiqni dorë nga adhurimi i idhujve dhe të adhuroni vetëm të Gjithëmëshirshmin.".

Ai i pyeti: "Ju të dy a keni ndonjë argument?".

Të dy u përgjigjën: "Po, kemi. Me lejen e All'llahut, ne shërojmë të sëmurin, i sjellim shikimin atij që ka lindur i verbër, shërojmë edhe të sëmurët me lebrozë.".

I moshuari tha: "Unë kam një djalë të sëmurë, që ka zënë shtratin prej shumë vitesh.".

Ata të dy i thanë: "Le të shkojmë së bashku në shtëpinë tënde, që të mësojmë si është gjendja e djalit.".

I moshuari hyri në shtëpinë e tij, së bashku me ata të dy, të cilët, sapo e lëmuan djalin e tij, ai menjëherë u ngrit më këmbë shëndoshë e mirë. Me dorën e këtyre dy burrave, All'llahu i Lartësuar shëroi shumë të sëmurë të tjerë.

Mbreti që i sundonte banorët e këtij vendi, adhuronte idhujt dhe, kur e njoftuan për praninë e këtyre dy burrave në mesin e tyre, menjëherë i thirri dhe i pyeti se kush ishin.

Ata thanë: "Jemi të dërguar të Isait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe kemi ardhur të të bëjmë thirrje ty, që të heqësh dorë prej adhurimit të idhujve, që as nuk dëgjojnë e as nuk shikojnë, prandaj të bëjmë thirrje të adhurosh vetëm All'llahun e Lartësuar, që dëgjon e sheh.".

Mbreti menjëherë tha: "Do të kemi një zot tjetër përveç zotave tanë?".

Ata të dy thanë: "Po, do të keni për Zot vetëm Atë që të ka bërë ty dhe ata zotat tuaj.".

Mbreti tha: "Ngrihuni derisa unë të shikoj punën tuaj.".

Njerëzit i morën të dy burrat, i çuan në treg, ku i rrahën.

Në një transmetim tjetër, thuhet se Isai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i dërgoi dy misionarët në Antakia, por nuk u takuan me mbretin e Antakias dhe kështu u zgjat koha e qëndrimit të tyre, derisa një ditë mbreti doli në treg. Ndërkaq dy misionarët thanë: "All'llahu ekber".

Mbreti u zemërua dhe urdhëroi burgosjen e atyre dy burrave, gjithashtu, urdhëroi që çdonjëri prej tyre të rrihej me njëqind goditje me kamxhik. Kur ata i përgënjeshtruan të dy të dërguarit, atëherë Isai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dërgoi të parin e apostujve, Simonin e pastër (Sem'ùnu s'safà), me mision, që të ndihmonte dy të dërguarit e parë. Simoni hyri në qytet i maskuar dhe filloi të afrohej e të miqësohej me ata që ishin pranë mbretit. Ata e deshën Simonin dhe u shoqëruan me të. Njëkohësisht njoftuan edhe mbretin, i cili e thirri dhe mbeti i kënaqur nga miqësia e tij, madje e nderoi dhe e trajtoi me mirësi. Më pas, një ditë prej ditësh, Simoni i tha: "O mbret, kam dëgjuar se ke burgosur dy burra dhe ke urdhëruar të rrihen, kur ata të bënë thirrje të besosh një fe tjetër, ndryshe nga feja jote, por a e ke dëgjuar fjalën e atyre të dyve?".

Mbreti tha: "Unë u zemërova shumë nga ato fjalë.".

Atëherë Simoni foli: "Nëse mbreti mendon, thirri ata të dy që të mësosh se ç'do të thonë.".

Mbreti i thirri. Kur dy burrat u paraqitën, Simoni u tha atyre: "Kush ju dërgoi ju të dy këtu?".

Ata thanë: "Na dërgoi All'llahu, na dërgoi Ai që ka krijuar çdo send dhe është Një e vetëm. Ai s'ka shok e ortak.".

Simoni u tha: "Çfarë argumenti keni?".

Ata të dy thanë: "Çfarë të dëshironi.".

Mbreti urdhëroi të sillnin një djalë që kishte lindur pa sy dhe balli i këtij djali shtrihej deri në vendin e dy syve. Dy të dërguarit vazhduan të luten, derisa vendi i syve u ça. Ata formuan me baltë dy toptha balte në formën e lajthisë, i vunë dy topthat e baltës në vendin që u hap. Topthat e baltës u bënë sy me bebe dhe djali filloi të shohë. Mbreti u habit nga kjo punë.

Simoni i tha mbretit: "Si mendon? Nëse do t'i kërkosh zotit tënd të bëjë një gjë të këtillë siç bënë këta të dy, do të ishte nder i madh për ty dhe për zotat tuaj, nëse do të bënin një gjë të këtillë.".

Mbreti tha: "Ty nuk të mbaj asgjë të fshehtë, zotat që ne adhurojmë, as nuk dëmtojnë e as nuk sjellin ndonjë dobi.".

Pastaj mbreti u tha dy të dërguarve: "A ka fuqi Zoti juaj të ngjallë një të vdekur, që të besojmë në atë dhe në fjalën tuaj?".

Ata thanë: "Zoti ynë është i fuqishëm për të gjitha sendet.".

Atëherë mbreti tha: "Kemi një të vdekur që ka vdekur para shtatë ditëve dhe nuk e kemi varrosur, pasi kemi pritur të kthehet babai i tij, që nuk gjendet këtu.".

E sollën të vdekurin, i cili ishte tjetërsuar dhe kishte filluar të mbante erë. Dy të dërguarit filluan t'i luten Zotit të tyre me zë të lartë, por edhe Simoni filloi t'i lutej në fshehtësi Zotit të tij. Ndërkaq, i vdekuri u ngrit në këmbë dhe u tha atyre: "Unë kam vdekur para shtatë ditëve dhe gjatë kësaj kohe më kanë futur në shtatë lugina prej zjarri, prandaj unë u paralajmëroj të hiqni dorë nga ata që ju adhuroni dhe të besoni All'llahun.".

Përsëri mbreti u çudit shumë nga kjo ndodhi.

Kur Simoni u sigurua se fjala e tij ndikoi te mbreti, i bëri thirrje mbretit të besojë All'llahun dhe mbreti besoi. Besoi edhe një pjesë e banorëve të mbretërisë së tij, ndërsa një pjesë tjetër e tyre nuk besoi.

Një transmetim të ngjashëm, të ardhur prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, me disa ndryshime, e ka cituar edhe El Ajàshij në tefsirin e tij.[1]

Por, nga leximi i ajeteve të mësipërme, rezulton se është shumë larg që banorët e atij qyteti të kenë besuar, sepse Kur'ani Famëlartë, tekstualisht thotë: "Ajo ishte vetëm një britmë tmerruese dhe ata të gjithë mbetën të vdekur.".

Ka mundësi, që në këtë transmetim, ka dyshime nga ana e përcjellësit të transmetimit.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 8, f. 479, fundi i ajeteve objekt studimi.

Gjithashtu, vlen të përmendet se fjala e ajetit *"el murselijne"* - *"të dërguarit"*, në ajetet para këtij grupi ajetesh, tregon se ata ishin Profetë të dërguar prej All'llahut të Lartësuar. Përveç kësaj, ajetet e Kur'anit njoftojnë se banorët e atij vendbanimi, u thanë të Dërguarve: "Ata (banorët) thanë: ju jeni njerëz si ne dhe i Gjithëmëshirshmi nuk ka zbritur asnjë send.".[1] Shembuj të tillë, në Kur'anin Famëlartë, zakonisht janë të veçantë për Profetët, edhe pse është thënë që të dërguarit e profetëve janë të Dërguar të All'llahut, megjithëse kjo thënie duket shumë e largët.

2- Ç'mësojmë prej këtij tregimi?

Në tregimin që u shpalos në ajetet objekt studimi, mësojmë disa çështje, prej të cilave:

a) Besimtarët kurrë nuk e kanë të vështirë të ecin edhe të vetëm në Rrugën e All'llahut, ashtu siç e pamë të vepronte besimtari Habib Marangozi, të cilin nuk e frikësoi fakti që adhuruesit e idhujve ishin shumicë në qytetin e tij.

Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, thotë: "Mos u frikësoni të ecni në rrugën e udhëzimit, për shkak se jeni pakicë.".[2]

b) Besimtari ka dëshirë të udhëzojë njerëzit në Rrugën e Drejtë dhe ndien dhimbje, kur njerëzit shkojnë në rrugën e humbjes, madje edhe kur ai bie dëshmor në Rrugën e All'llahut,

1 Sure "Jâ Sîn", ajeti 15.
2 "Nehxhul Belàga", Hytbeja 201.

uron që të tjerët ta shohin pozitën që ai gëzon, me qëllim që të bëhet shkak që edhe të tjerët të besojnë!

c) Thirrja e Profetëve, në vetvete, është argument se ata janë të udhëzuar në Rrugën e Drejtë dhe në të vërtetën: "**janë në Rrugë të Drejtë!**".

ç) Thirrja për të besuar All'llahun, jo vetëm që duhet të jetë e zhveshur nga çdo lloj qëllimi për të kërkuar shpërblim, por patjetër duhet të jetë mbresëlënëse.

Ka raste që humbja është e dukshme, domethënë është humbje e qartë. Edhe adhurimi i idhujve është vërtetues i humbjes së qartë.

d) Ata që janë në Rrugën e Vërtetë, mbështeten në realitet, kurse ata që kanë rënë në rrugën e humbjes, mbështeten në iluzione e në pandehma.

e) Në raste fatkeqësish e katastrofash, shkak për këto është vetë njeriu dhe punët e tij.

f) Tejkalimi i masës dhe shpërdorimi është shkak për shumë shmangie e katastrofa.

g) Misioni i Profetëve dhe i atyre që ndjekin Profetët është "kumtimi i qartë" i kumtit hyjnor dhe thirrja e hapur për të besuar All'llahun, Zotin Një e të Vetëm, pavarësisht se njerëzit i përgjigjen ose jo kësaj thirrjeje.

h) Mbledhja e sa më shumë faktorëve dhe elementeve të rëndësishme, për të siguruar fitoren, epërsinë dhe forcën, ashtu siç njofton ajeti: "Atëherë Ne i përforcuam me një të tretë.".

i) All'llahu i Lartësuar s'ka nevojë të mobilizojë fuqitë e Tokës e të Qiellit, për të shkatërruar krerët e kundërshtarëve dhe të mëkatarëve, por mjafton vetëm një shenjë.

j) Mes rënies dëshmor e Xhennetit s'ka kohë ndarëse dhe dëshmori, sapo e lë jetën e kësaj bote, menjëherë pritet prej hurive të Xhennetit.[1]

k) Në radhë të parë, All'llahu i Lartësuar e pastron njeriun prej fajeve e mëkateve dhe pastaj e afron atë pranë mëshirës së Tij, ashtu siç njofton ajeti i nderuar: "**Se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!"**.

l) Përkrahësi i të vërtetës ka detyrë të mos frikësohet dhe të mos ndihet i vetmuar nga kundërshtimi i armiqve, sepse armiqtë kështu e kanë kundërshtuar të vërtetën gjatë gjithë kohëve, ashtu siç e lexojmë në ajetin e nderuar: "Sa humbje e madhe për robtë, të cilët sa herë u vinte një Profet, nuk lanë pa u tallur me atë.".

A mund të ketë humbje më të madhe e më të rëndë, se sa kur njeriu i mbyll sytë e tij, thjesht nga fanatizmi e mendjemadhësia dhe nuk e sheh Diellin me rrezet e tij ndriçuese?

m) Ndër të gjithë njerëzit, ata që u kanë besuar Profetëve të parët, kanë qenë njerëzit e thjeshtë, ata që nuk kishin përkrahje, ashtu siç e lexojmë në ajetin: "**Dhe nga skajet e qytetit erdhi një njeri…"**.

1 Në lidhje me këtë çështje, kemi cituar një transmetim të hollësishëm të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjatë komentit të ajetit 169 të sures "Àli Imràn".

n) Profetët i pasuan ata që nuk merrnin parasysh lodhjen gjatë punës së tyre në rrugën e të vërtetës dhe punuan me shpejtësi, ashtu siç njofton ajeti: "**duke nxituar"**.

o) Është domosdoshmëri që Rruga e Shpalljes Hyjnore, rruga e thirrjes për të besuar vetëm All'llahun e Lartësuar, të mësohet prej të Dërguarve Hyjnorë, të cilët përdorën të gjitha mundësitë dhe metodat ndikuese për të depërtuar në zemrat e njerëzve të shkujdesur. Në ajetet objekt studimi dhe në transmetimet që kemi sjellë në këtë paragraf, ka disa modele që duhet të merren si shembull veprimi në fushën e Shpalljes Hyjnore.

3- Shpërblimi dhe dënimi në Berzakh

Në ajetet objekt studimi, njoftohet se besimtari Habib Marangozi, pas rënies dëshmor, hyri në Xhennet dhe menjëherë uroi: **"Ah, sikur ta dinte populli im!"**.

Dihet se këto ajete, si dhe ajetet e tjera që flasin për dëshmorët, nuk kanë të bëjnë me Xhennetin që do të jetë pas Ringjalljes dhe dhënies llogari.

Në ajetet e Kur'anit, bëhet e qartë se para nesh, gjithashtu, ka një Xhennet dhe një Xhehennem edhe në etapën e Berzakhut, ku dëshmorët gëzojnë mirësitë e Xhennetit, kurse tiranët shtypës të tipit të familjes së Faraonit, digjen në zjarrin e Xhehennemit. Duke vështruar në këtë kuptim, gjejnë zgjidhje shumë çështje të vështira në dukje për t'u kuptuar në lidhje me Xhennetin e me zjarrin, siç janë çështjet në lidhje me udhëtimin natën (el Isrà) të

Profetit tonë *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe me ngjitjen (el Mi'ràxh) e tij në sferat e larta të hapësirës, apo edhe çështje të tjera të ngjashme.

4- Udhëheqësit e popujve

Eth Tha'lebij'ji, në tefsirin e tij, citon një hadith të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Në pararojë të popujve, janë tre njerëz, që nuk kanë mohuar as për aq kohë sa një lëvizje e qerpikut: Ali bin Ebu Talibi, besimtari që përmendet në suren "Jâ Sîn" dhe besimtari prej familjes së Faraonit. Ata janë të sinqertët në Rrugën e Drejtë. Aliu është më i miri i tyre."*.[1]

Një kuptim i përafërt ka ardhur në një hadith tjetër prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cituar në tefsirin "Ed Durr'rrul Menthùr". Midis të tjerash, lexojmë: *"Besimtarë të sinqertë në Rrugën e Drejtë janë tre: Habib Marangozi, besimtari që përmendet në suren 'Jâ Sîn', i cili tha*: **'O populli im, ndiqni të Dërguarit!'**; *Hazekijli, besimtari prej familjes së Faraonit, i cili tha: A doni të vrisni një njeri, sepse thotë: Zoti im është All'llahu? Dhe, Ali ibn Ebu Talibi, është më i miri i tyre."*.[2]

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejàn", vëll. 4, f. 421;Tefsiri i "Kurtubij'jit"; tefsiri "El Mijzàn" dhe Tefsiri "Nùruth Thekalejn".

2 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthùr", sipas citimit të ardhur në tefsirin "El Mijzàn", vëll. 17, f. 86.

Përmbajtja

Ajetet 31 – 34……..…5
Komentimi……...6
Kështu duhet të jenë gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*…….6
Çfarë kuptohet me fjalën "injorancë"?.....10
Hulumtim……..18
1- Ajeti i pastrimit është një fakt i qartë i mbrojtjes nga gjynahu *(el ismetu)*……...18
2- Për kë ka zbritur ajeti i pastrimit?.....19
3- Si është vullneti në këtë ajet?.....26
4- Injoranca e shekullit të njëzetë……...28

Ajeti 35……...31
Shkaku i zbritjes……32
Komentimi…….....33
Personaliteti i gruas dhe pozita e saj në Islam……33
Hulumtim……..38
Te All'llahu janë të barabartë, edhe burri, edhe gruaja……..38
Ajetet 36 – 38……41
Shkaku i zbritjes……42
Komentimi……45
Rebelimi i madh ndaj zakonit……45
Dy hulumtime…….....54

1- Legjenda mashtruese……...54
2- Shpirti i Islamit është dorëzimi para All'llahut……...58
Ajeti 39……..61
Komentimi…….61
Cilët janë përcjellësit *(el mubeligun)* e vërtetë?.....61
Hulumtime……63
1- Çfarë kuptimi ka fjala kumtim *(teblijg)*?.....63
2- Çfarë kptimi ka fjala *"el khashjetu"*?.....63
3- Përgjigje për një pyetje……64
4- A e kanë përdorur Profetët *tekijjetun* (fshehjen)?.....65
5- Kushti i triumfit në përcjelljen e mesazhit ……...67
Ajeti 40……..69
Komentimi…….69
Çështja e vulosjes së profetësisë…….69
Hulumtime……73
1- Çfarë është vula?.....73
2- Argumentet tregojnë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është vula e Profetëve…..…..76
Përgjigje për disa pyetje…….…80
a) Si harmonizohet vulosja me rrugëtimin e njeriut drejt përsosmërisë?.....80
b) Si harmonizohen ligjet e pandryshueshme me nevojat e ndryshueshme?.....82
3- Si mund të privohet njerëzimi nga mirësia e lidhjes me botën e të padukshmes *(el gajbu)*?.....84
Ajetet 41 – 44……87
Komentimi…….88
Përshëndetja e All'llahut dhe e engjëjve është lehtësim për besimtarët…….88
Hulumtime……94
1- All'llahu duhet të përmendet në çdo situate……...94
2- Një sqarim për togfjalëshin "takimi i All'llahut"……...96
3- Shpërblimet e besimtarëve janë të përgatitura që tani……...98

Ajetet 45 – 48……99
Komentimi……...100
Pishtari ndriçues…….100
Hulumtime……..102
Këtu kërkohet kujdes, për disa pika:……..102
Ajeti 49……111
Komentimi……...111
Një anë e ligjeve të ndarjes *(divorcit)*……111
Ajeti 50……117
Komentimi……...118
Ti mund të martohesh me këto gra……..118
Hulumtim……124
Ana urtësisë në poligaminë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe* bekimi *i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*……..124
Ajeti 51……128
Shkaku i zbritjes…….128
Komentimi……..130
Zgjidhja e një problemi tjetër në jetën e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*……130
Hulumtim……134
A ishte ky ligj në të drejtën e të gjitha grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*?.....134
Ajeti 52……136
Komentimi……..136
Një ligj tjetër i rëndësishëm për gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*……136
Hulumtime……..138
1- Filozofia e këtij ligji……138
2- Transmetimet kundërshtuese……...140
3- A është e lejuar ta shikosh gruan e ardhshme, para martesës?...142
Ajetet 53 – 54……..144
Shkaku i zbritjes……..145

Komentimi……...147
Hulumtime……..156
1- Mikpritja……..157
2- Ruajtja e thjeshtësisë në mikpritje……158
3- E drejta e mikut……..158
4- Detyrat e mikut……...160
Ajeti 55……162
Shkaku i zbritjes……162
Komentimi……..163
Kuptimet e përjashtuara nga ligji i hixhabit……...163
Ajetet 56 – 58……166
Komentimi……...167
Salavati për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe përshëndetja e tij me selam…….....167
Ajetet 59 – 62……..179
Shkaku i zbritjes……..180
Komentimi……...181
Një paralajmërim i ashpër për ofenduesit dhe fabrikuesit e thashethemeve……...…181
Hulumtime……..187
1- Fillo me veten tënde!.....187
2- Kurimi nga dy mënyra……..188
3- Pozita e fortë e myslimanëve……188
4- Shkulja e rrënjëve të shkatërrimit……189
5- Ligjet e pandryshueshme të All'llahut……189
Ajetet 63 – 68……..192
Komentimi……...193
Kur do të bëhet Kiameti?.....193
Ajetet 69 – 71……..297
Komentimi……...298
Me çfarë e ofenduan dhe e akuzuan Musain *(Paqja qoftë mbi të!)*?.....298
Thoni të vërtetën që të rregullohen veprat tuaja……...202
Ajetet 72 – 73……..205

Komentimi……...206
Mbajtja e amaneteve hyjnore është një nga vlerat më të mëdha të njerëzimit……206
SURJA "SEBÈ"……...217
Përmbajtja e sures……...218
Mirësia e kësaj sureje……219
Ajetet 1 – 2……..221
Komentimi……..222
All'llahu është zotëruesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshëm për çdo gjë……..……..222
Ajetet 3 – 5……..228
Komentimi……..229
Ajetet 6 – 9……..235
Komentimi……..….236
Dijetarët e mendojnë thirrjen tënde se ajo është e vërtetë……...….236
Ajetet 10 – 11……..245
Komentimi……...245
Dhuratat e mëdha të All'llahut për Daudin *(Paqja qoftë mbi të!)*…..245
Ajetet 12 – 14……..252
Komentimi……...….253
Madhështia e Sulejmanit dhe vdekja e tij, është leksion që duhet të merret në considerate……...253
Hulumtime……...…264
1- Fragmente nga jeta e Sulejmanit *(Paqja qoftë mbi të!)*……264
2- Përse u fsheh vdekja e Sulejmanit për një periudhë kohore?.....266
3- Sulejmani në Kur'anin dhe Teuratin e sotëm……268
4- Të paktë janë robtë e Mi falënderues……..273
Ajetet 15 – 17……..277
Komentimi……...278
Mohimi e çoi në humbje qytetin e lartë……...278
Ajetet 18 – 19……..284
Komentimi……...285

"Ne i bëmë ata rrëfenja dhe i përndamë plotësisht"!!.....285
Hulumtime……289
1- Fundi i habitshëm i popullit Sebe……289
2- Mrekullia historike e Kur'anit……..291
3- Vëmendje e rëndësishme rreth mësimit në një histori të shkurtër……..292
Ajete 20 – 21.....295
Komentimi……...……295
Askush nuk është i detyruar të ndjekë shejtanin……...295
Ajetet 22 – 27……..299
Komentimi……...300
Më thoni përse?.....300
Hulumtim……310
Mënyra e nënshtrimit të zemrës……...310
Ajetet 28 – 30……..315
Komentimi……...315
Thirrja botërore ……..315
Ajetet 31 – 33……..322
Komentimi……...323
Ajetet 34 – 38……..329
Komentimi……..330
Pasuritë dhe fëmijët nuk janë argument i të afruarit te All'llahu…330
Hulumtim……..…..337
Kriteri vlerësimit……...337
Ajetet 39 – 42……..…342
Komentimi……...343
Largimi i adhuruesve nga të adhuruarit e tyre……..…343
Hulumtime……..…348
1- Shpenzimi në Rrugë të All'llahut është shkak i shtimit dhe jo i pakësimit……348
2- Sigurojini pasuritë tuaja me garanci hyjnore…….352
3- Hapësira e nocionit të dhënies…….353
Ajetet 43 – 45……..354

Komentimi……...355
Me çfarë logjike i mohojnë argumentet e All'llahut?.....355
Ajeti 46……362
Komentimi……...362
Revolucioni i mendimit është themeli i çdo revolucioni të vërtetë……362
Dy hulumtime……367
1- Pavarësia e ajeteve të Kur'anit Famëlartë dhe komentimi i tërthortë i tyre……..367
2- Disa transmetime islame rreth të menduarit dhe meditimit…...370
Ajetet 47 – 50……..372
Komentimi……..…….373
E kota u zhduk pa fillim dhe pa kthim……...373
Ajetet 51 – 54……..381
Komentimi……..382
Nuk ka shpëtim për jobesimtarët……382
Sure "El Fàtir".....389
Përmbajtja e sures.....390
Mirësia e leximit të sures "El Fàtir".....392
Ajetet 1 – 3.....394
Komentimi.....395
Hapësi i bravave të portave.....395
Hulumtime.....402
Engjëjt në Kur'anin Famëlartë..... 405
Ajetet 4 – 7.....412
Komentimi.....413
Të mos ju mashtrojë djalli dhe kjo botë.....413
Ajetet 8 – 10.....422
Komentimi.....423
Te All'llahu ngjitet fjala e mirë, kurse punën e mirë Ai e ngre lart.....423
Dy hulumtime.....436

1- E gjithë madhështia vjen prej All'llahut, emri i Tij u lartësoftë!.....436
2- Ndryshimi mes togfjalëshit "fjala e mirë" dhe "puna e mirë".....438
Ajetet 11 – 12.....439
Komentimi.....440
Dy detet nuk janë të barabartë.....440
Hulumtim.....449
Faktorët lëndorë e moralë që ndikojnë në zgjatjen e jetës.....449
Ajetet 13 – 14.....454
Komentimi.....455
Idhujt nuk e dëgjojnë thirrjen tuaj.....455
Hulumtim.....460
Feja është origjina e shndërrimeve.....460
Ajetet 15 – 18.....464
Komentimi.....465
Askush nuk mban barrën e tjetrit.....465
Ajetet 19 – 23.....475
Komentimi.....476
Errësira nuk është e barabarta me dritën.....476
Hulumtime.....479
1- Ndikimet e besimit dhe të mohimit.....479
2- Vallë, me të vërtetë të vdekurit nuk kuptojnë?.....481
3- Larmia e shprehjeve është pjesë e retorikës.....485
Ajetet 24 – 26.....488
Komentimi.....489
S'ka çudi më të madhe se mosbesimi.....489
Ajetet 27 – 28.....495
Komentimi.....496
Çudira të ndryshme të krijimit.....496
Ajetet 29 – 30.....504
Komentimi.....504
Tregtia është fitimprurëse, vetëm me All'llahun.....504

Hulumtim.....510
Kushtet e kësaj tregtie të çuditshme.....510
Ajetet 31 – 32.....512
Komentimi.....513
Trashëgimtarët e vërtetë të trashëgimisë së Profetëve.....513
Hulumtim.....522
Cilët janë ruajtësit e Librit Hyjnor?.....522
Ajetet 33 – 35.....525
Komentimi.....526
Falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm All'llahut, që e hoqi prej nesh brengosjen.....526
Ajetet 36 – 38.....531
Komentimi.....532
Zoti ynë, na nxirr që të bëjmë punë të mira.....532
Dy Hulumtime.....538
1- CIli është qëllimi i përdorimit të frazës "Dhàti-s'Sudùr"?.....538
2- S'ka rrugë për t'u kthyer.....539
Ajetet 39 – 41.....542
Komentimi.....543
Qiejt dhe Toka janë në dorën e fuqisë së All'llahut.....543
Hulumtim.....552
E vogla dhe e madhja janë të barabarta para fuqisë së All'llahut...552
Ajetet 42 – 44.....554
Shkaku i zbritjes.....555
Komentimi.....556
Mendjemadhësia dhe mashtrimi ishin shkak i mjerimit të tyre.....556
Ajeti 45.....566
Komentimi.....566
Sikur të mos ishte butësia e mëshira e All'llahut.....566
Sure Ja Sin.....572
Përmbajtja e sures "JÂ SÎN".....573
Mirësitë e sures "Jâ Sîn".....575

Ajetet 1 – 10.....577
Komentimi.....578
Hulumtime.....591
1- Humbja e mjeteve të njohjes.....591
2- Digat para dhe prapa.....594
3- Privim i plotë nga ecja në rrugët e horizonteve dhe të shpirtit...595
Ajetet 11 – 12.....597
Komentimi.....597
Kush e pranon paralajmërimin tim?.....597
Dy hulumtime.....604
1- Llojet e librave me të cilët vërtetohen punët e njerëzve.....604
2- Çdo gjë ne e kemi regjistruar.....605
Ajetet 13 – 18.....607
Komentimi.....608
Sillu atyre shembullin e banorëve të atij vendbanimi.....608
Ajetet 20 – 27.....618
Komentimi.....619
Luftëtarët në Rrugën e All'llahut, ngarkuan shpirtin e tyre mbi shpatullat e veta.....619
Hulumtime.....630
1- Tregimi i të Dërguarve në Antakia.....630
2- Ç'mësojmë prej këtij tregimi?.....636
3- Shpërblimi dhe dënimi në Berzakh.....639
4- Udhëheqësit e popujve.....639

ألأمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء الثاني و العشرون

تيرانا: 2021

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء بیست و دو)

نویسنده: فقیه مفسّر حضرت آیة الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: حاجی سلیم اصطفی (ره) و ادموند عبازی

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْیَا

ویرایش: یریدا کولا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2021